



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Genël Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, Gjykatës rezervë

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 18 maj 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

Valeria Boliçi

Mathju Halling

Xhejms Paç

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Elenor Stevenson

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

Almudena Bernabeu Garsia

I.	AKUZAT .....	2
A.	Akuzat dhe format e përgjegjësive penale .....	2
B.	Akuza të shumëfishta .....	5
C.	Pretendime që kanë të bëjnë me persona kundër të cilëve nuk është paraqitur Aktakuzë .....	6
II.	PRANIMI DHE VLERËSIMI I PROVAVE .....	8
A.	Aspekte të përgjithshme .....	8
B.	Pranimi i provave .....	8
1.	Prova për fakte dhe rrethana që i paraprijnë periudhës së Aktakuzës .....	9
2.	Dëshmitë e dorës së dytë dhe e drejta për ballafaqim .....	10
3.	Ligjshmëria e kontrollimeve dhe kronologjia e mbajtjes në ruajtje të provave .....	11
4.	Provat lidhur me drejtësinë dhe kryerjen e krimeve gjatë luftës në vitet 1998-1999 .....	12
5.	Provat që kanë të bëjnë me “argumentet mbrojtëse” .....	13
C.	Vlerësimi i provave .....	13
1.	Prezumimi i pafajësisë dhe detyrimi i vërtetimit .....	13
2.	Standardi i vërtetimit .....	14
3.	Vlerësimi i provave në kuadër të Aktgjyimit .....	15
(a)	Provat e drejtpërdrejta dhe rrethore .....	16
(b)	Kategori specifike të provave .....	16
(c)	Dëshmitarët .....	17
i)	Dëshmitë e të akuzuarve .....	18
ii)	Kundërshtimet ndaj besueshmërisë së dëshmitarëve .....	19
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE .....	26
A.	Aspekte të përgjithshme .....	26
B.	Shkelja e fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392(1) të KPK-së .....	26
1.	Elementet materiale .....	27
(a)	Parashtrimet e palëve .....	27
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	28
2.	Elementet mendore .....	31
(a)	Parashtrimet e palëve .....	32
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	32
C.	Shkelja e fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392(2) dhe (3) të KPK-së .....	33
1.	Elementet materiale .....	33
(a)	Parashtrimet e palëve .....	33
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	34
2.	Elementet mendore .....	37
(a)	Parashtrimet e palëve .....	37
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	37
D.	Frikësimi gjatë procedurës penale sipas nenit 387 të KPK-së .....	38
3.	Elementet materiale .....	38

(a)	Parashtrimet e palëve .....	39
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	39
4.	Elementet mendore.....	41
(a)	Parashtrimet e palëve .....	42
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	42
E.	Hakmarrja.....	45
1.	Elementet materiale.....	46
(a)	Parashtrimet e palëve .....	46
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	47
2.	Elementet mendore.....	49
(a)	Parashtrimet e palëve .....	49
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	49
F.	Pengimi i personave zyrtarë sipas nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së .....	51
1.	Elementet materiale.....	51
(a)	Parashtrimet e palëve .....	51
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	52
2.	Elementet mendore.....	55
(a)	Parashtrimet e palëve .....	55
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	55
G.	Pengimi i personave zyrtarë sipas nenit 401(2)-(3) të KPK-së.....	56
1.	Elementet materiale.....	56
(a)	Parashtrimet e palëve .....	57
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	57
2.	Elementet mendore.....	61
(a)	Parashtrimet e palëve .....	62
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	62
H.	Format e përgjegjësisë penale .....	63
1.	Kryerja .....	63
2.	Bashkëkryerja .....	63
(a)	Parashtrimet e palëve .....	64
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	64
3.	Nxitja .....	65
(a)	Parashtrimet e palëve .....	65
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykses .....	66
4.	Ndihma .....	67
5.	Marrëveshja për të kryer vepër penale .....	68
6.	Tentativa .....	69
IV.	NGJARJET NË FJALË.....	70
A.	Grupi i parë i dokumenteve.....	71

7 shtator 2020 .....	71
(a) Dorëzimi i dokumenteve .....	71
(b) Këqyrja e dokumenteve .....	72
(c) Njoftimi për mediat lidhur me konferencën për shtyp të OVL-UÇK-së .....	73
(d) Konferenca e parë për shtyp.....	73
(e) Paraqitjet e të akuzuarve në media.....	76
(f) Artikuj të mëtejshëm në media dhe korrespondenca me ZPS-në.....	77
8 shtator 2020 .....	78
(a) Sekuestrimi i grupit të parë të dokumenteve.....	78
(b) Artikuj të mëtejshëm në media .....	79
(c) Paraqitjet e ndihmësve në media .....	79
(d) Postimet në <i>Facebook</i> .....	79
9-15 shtator 2020.....	79
(a) Artikuj të mëtejshëm në media .....	79
(b) Dorëzimi i dokumenteve nga gazeta <i>Infokus</i> .....	79
(c) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media .....	80
(d) Postimet në <i>Facebook</i> .....	81
(e) Vendimi i kryesisë së OVL-UÇK-së .....	81
B. Grupi i dytë i dokumenteve.....	82
16 shtator 2020 .....	82
(a) Dorëzimi i dokumenteve .....	82
(b) Këqyrja e dokumenteve .....	83
(c) Konferenca e dytë për shtyp.....	84
(d) Artikujt në media .....	85
(e) Paraqitjet e të akuzuarve në media.....	85
(f) Postimet në <i>Facebook</i> .....	85
17 shtator 2020 .....	86
(a) Paraqitjet e të akuzuarve në media.....	86
(b) Sekuestrimi i grupit të dytë të dokumenteve.....	86
(c) Paraqitje të mëtejshme të të akuzuarve dhe të ndihmësve në media .....	87
(d) Postimet në <i>Facebook</i> .....	89
(e) Artikuj të mëtejshëm në media .....	89
18-21 shtator 2020.....	89
(a) Artikuj të mëtejshëm në media .....	89
(b) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media .....	90
(c) Postimet në <i>Facebook</i> .....	93
C. Grupi i tretë i dokumenteve.....	93
22 shtator 2020 .....	93
(a) Dorëzimi i dokumenteve .....	93

(b)	Këqyrja e dokumenteve .....	94
(c)	Njoftimi për mediat i konferencës për shtyp të OVL-UÇK-së.....	95
(d)	Konferenca e tretë për shtyp .....	95
(e)	Postimet në <i>Facebook</i> .....	96
(f)	Sekuestrimi i grupit të tretë të dokumenteve.....	97
(g)	Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media .....	97
(h)	Artikuj të mëtejshëm në media .....	99
23-24 shtator 2020.....		99
(a)	Artikuj të mëtejshëm në media .....	99
(b)	Postimet në <i>Facebook</i> .....	99
(c)	Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media .....	99
D.	Kontrollimi i selisë së OVL-UÇK-së dhe arrestimi i të akuzuarve .....	100
V.	KONSTATIME MBI PAKETAT .....	101
A.	Sekuestrimi i tri grupeve të dokumenteve dhe kronologjia e mbajtjes në ruajtje të paketave	101
1.	Dorëzimi, shpërndarja dhe marrja në dorëzim e tri grupeve të dokumenteve .....	101
2.	Sekuestrimi dhe kronologjia e mbajtjes në ruajtje .....	102
(a)	Kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të paketave ...	102
(b)	Sekuestrimi i parë .....	103
(c)	Sekuestrimi i dytë .....	107
(d)	Sekuestrimi i tretë .....	110
(e)	Dorëzimi i dokumenteve nga gazeta <i>Infokus</i> .....	112
3.	Përfundim .....	113
B.	Përmbajtja e paketave .....	116
1.	Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të.....	117
(a)	Paketa 1 .....	117
i)	Përmbajtja e përgjithshme e paketave 1 dhe 4 .....	117
ii)	Emrat e dëshmitarëve në paketat 1 dhe 4 .....	120
(b)	Paketa 2 .....	121
(c)	Paketa 3 .....	123
2.	Deklaratat e të akuzuarve.....	125
(a)	Këqyrja e tri grupeve të dokumenteve.....	125
(b)	Deklaratat e atëhershme të të akuzuarve .....	127
i)	Grupi i parë i dokumenteve .....	127
ii)	Grupi i dytë i dokumenteve .....	128
iii)	Grupi i tretë i dokumenteve .....	129
(c)	Dëshmitë e të akuzuarve.....	130
(d)	Përfundim .....	132
3.	Përfundim mbi përmbajtjen e paketave .....	133
C.	Autenticiteti i paketave.....	134

1.	Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të.....	134
(a)	Paketa 1 .....	135
(b)	Paketa 2 .....	136
(c)	Paketa 3 .....	136
2.	Deklaratat e të akuzuarve .....	138
(a)	Deklaratat e asokohshme të të akuzuarve .....	138
(b)	Dëshmitë e të akuzuarve.....	142
i)	Dëshmia e z. Gucati .....	142
ii)	Dëshmia e z. Haradinaj .....	143
(c)	Përfundim .....	145
3.	Përfundim mbi autenticitetin e paketave .....	145
D.	Konfidencialiteti i informacionit të paketave .....	146
1.	Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të.....	146
(a)	Paketat 1 dhe 4.....	147
(b)	Paketa 2 .....	149
(c)	Paketa 3 .....	150
2.	Deklaratat e të akuzuarve .....	151
(a)	Deklaratat e asaj kohe.....	152
i)	Urdhri i Parë dhe Urdhri i Dytë.....	152
ii)	Dokumentet ishin “sekrete”, “të ndjeshme” ose “konfidenciale” .....	152
iii)	Dokumentet përmbanin emra të dëshmitarëve të mbrojtur .....	154
(b)	Dëshmitë e të akuzuarve.....	155
(c)	Përfundim .....	159
3.	Përfundim mbi konfidencialitetin e informacionit që përmbanin paketat .....	159
VI.	PIKAT E AKTAKUZËS .....	160
A.	Shkelja e fshehtësisë së procedurës – informacioni i mbrojtur (Pika 5) .....	161
1.	Parashtrimet e palëve .....	161
2.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm .....	163
(a)	Informacioni i cili “sipas ligjit nuk mund të zbulohet” ose “është shpallur fshehtësi me vendim të gjykatës ose organit kompetent” .....	163
(b)	Informacioni “i nxjerrë në procedurë zyrtare” .....	167
(c)	“Zbulon informacion” .....	168
(d)	“Pa autorizim” .....	172
(e)	Përfundim .....	173
3.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal.....	173
4.	Përfundim .....	177
B.	Shkelja e fshehtësisë së procedurës– Personat e mbrojtur (Pika 6).....	178
1.	Parashtrimet e palëve .....	178
2.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale... 181	181

(a)	“Personi i mbrojtur në procedurë penale” .....	181
i)	Përkufizimi i termit “person” .....	181
ii)	“Të mbrojtur në procedurë penale” .....	184
(b)	“Zbulon informacion mbi identitetin ose të dhënat personale” .....	186
(c)	“Pa autorizim” .....	188
(d)	Përfundim .....	190
3.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale .....	190
4.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi formën e rëndë të veprës penale .....	192
(a)	Pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së .....	192
i)	Pasoja të rënda .....	192
ii)	Të vetëdijshëm se mund të ndodhin pasoja të rënda .....	197
iii)	Përfundim .....	199
(b)	Procedura penale të penguar ndjeshëm ose të pamundësuar .....	199
5.	Përfundim .....	201
C.	Frikësim gjatë procedurës penale (Pika 3) .....	202
1.	Parashtrimet e palëve .....	202
2.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm .....	204
(a)	Kërcënimi i rëndë .....	204
i)	Shkalla e zbulimit .....	205
ii)	Zbulimi publik dhe shpërndarja e gjerë .....	205
iii)	Dëshmitarët tani “dihen” dhe nuk mund të mbrohen .....	207
iv)	Komentet poshtëruese dhe nënçmuese .....	209
v)	Konteksti në lidhje me Kosovën .....	213
vi)	Sa të rënda ishin kërcënimet .....	216
vii)	Përfundim .....	217
(b)	Çdo person që jep ose ka të ngjarë t’i japë deklaratë ose informacion policisë ose gjykatësit .....	217
(c)	Përfundim .....	218
3.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal .....	218
4.	Përfundim .....	224
D.	Hakmarrja (Pika 4) .....	225
1.	Parashtrimet e palëve .....	225
2.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm .....	227
(a)	“Cilitdo personi” .....	227
(b)	“Veprim të dëmshëm” .....	228
(c)	Përfundim .....	229
3.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal .....	230
4.	Përfundim .....	233
E.	Pengimi i personave zyrtarë me anë të kërcënimit të rëndë (Pika 1) .....	233

1.	Parashtrimet e palëve .....	233
2.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale... 234	
	(a) “Personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” .....	235
	(b) “Kërcënim i rëndë” .....	235
	(c) “Pengon” .....	237
	i) Rëndësia e dëshmitarëve për procedurat penale.....	237
	ii) Kuadri i vlerësimit në kontekstin e kësaj çështjeje .....	238
	iii) Frikësimi i dëshmitarëve.....	239
	iv) Ndikimi në aftësinë e ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime .....	240
	v) Devijimi i kapaciteteve të ZPS-së.....	240
	vi) Përfundim .....	241
	(d) “Tentativat për pengim” .....	241
	(e) Përfundim .....	242
3.	Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale .....	242
4.	Përfundim .....	247
F.	Pengimi i personave zyrtarë—përmes veprimit të përbashkët në grup (Pika 2) .....	248
	1. Parashtrimet e palëve .....	248
	2. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale... 250	
	(a) “Personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare” .....	250
	(b) “Merr pjesë në një grup personash me veprim të përbashkët” .....	250
	i) Z. Klinaku.....	254
	ii) Z. Tomë Gashi.....	256
	(c) “Pengon” .....	257
	(d) “Tentativa për pengim” .....	257
	(e) Përfundim .....	258
	3. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale .....	258
	4. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi formën e rëndë të veprës penale .....	260
	5. Përfundim .....	262
G.	Pengimi i personave zyrtarë— forma e rëndë e përbashkët .....	262
VII.	FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE .....	263
	A. Parashtrimet e palëve.....	263
	B. konstatimet e trupit gjykses .....	266
	1. Bashkëkryerja .....	266
	(a) <b>Sjellja e përbashkët e të akuzuarve</b> .....	267
	(b) Pjesëmarrja e z. Gucati në bashkëkryerje.....	268
	i) Pika 5.....	269
	ii) Pika 6.....	271
	iii) Pika 3.....	272
	iv) Pika 1.....	274



(c)	Pjesëmarrja e z. Haradinaj në bashkëkryerje.....	275
i)	Pika 5.....	275
ii)	Pika 6.....	277
iii)	Pika 3.....	278
iv)	Pika 1.....	279
(d)	Pjesëmarrje me synim e të akuzuarve .....	280
(e)	Përfundim .....	280
2.	Kryerja individuale.....	281
(a)	Z. Gucati.....	281
(b)	Z. Haradinaj.....	282
3.	Tentativa .....	283
4.	Marrëveshja për kryerjen e veprës penale.....	284
(a)	Marrëveshja për kryerjen e veprës penale.....	284
(b)	Marrëveshja për veprime thelbësore për kryerjen e veprës penale .....	284
(c)	Synimi.....	285
(d)	Përfundim .....	285
5.	Nxitja .....	285
6.	Ndihma .....	289
7.	Përfundim .....	292
VIII.	ARGUMENTET MBROJTËSE .....	292
A.	Përshkrim i përgjithshëm .....	292
B.	Argumentet mbrojtëse në kornizën ligjore të DHS-së.....	293
C.	Interesi publik.....	294
1.	Parashtrimet e palëve .....	294
2.	Ushtrimi i ligjshëm i të drejtave kushtetuese dhe interesi publik.....	296
(a)	Aspekte ligjore.....	296
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	298
i)	Tregues veprimesh të papërshtatshme në informacionin e mbrojtur .....	299
ii)	Qëllimi i të akuzuarve në zbulimin e informacionit të mbrojtur.....	302
iii)	Ligjshmëria e kufizimit të të drejtave të të akuzuarve .....	303
(c)	Përfundim .....	304
3.	Argumenti mbrojtës bazuar në rolin e sinjalizuesit .....	305
(a)	Aspekte ligjore.....	305
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	305
(c)	Përfundim .....	308
D.	Shtytja për kryerjen e veprës penale .....	308
1.	Aspekte ligjore .....	309
(a)	Parashtrimet e palëve .....	309
(b)	Konstatimet e Trupit Gjykes .....	309

(c) Përfundim .....	312
2. Aspekte në lidhje me gjykimin e drejtë .....	312
(a) Parashtrimet e palëve .....	312
(b) Konstatimet e Trupit Gjykses .....	312
(c) Përfundim .....	316
3. Vlerësimi i pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale .....	316
(a) Parashtrimet e palëve .....	316
(b) Konstatimet e Trupit Gjykses .....	317
i) Qëndrimi i të akuzuarve .....	317
ii) Origjina e rrjedhjes së informacionit dhe personat që bënë tri dorëzimet .....	320
iii) Përpjekjet hetimore të ZPS-së .....	321
iv) Faktorët rrethorë të Guccatit .....	323
4. Përfundim .....	330
E. Gabimi ligjor .....	331
1. Parashtrimet e palëve .....	331
2. Aspekte ligjore .....	331
3. Konstatimet e Trupit Gjykses .....	331
F. Nevoja ekstreme .....	338
1. Parashtrimet e palëve .....	338
2. Aspekte ligjore .....	338
3. Konstatimet e Trupit Gjykses .....	338
G. Gabim faktik.....	339
1. Parashtrimet e palëve .....	339
2. Aspekte ligjore .....	339
3. Konstatimet e Trupit Gjykses .....	340
H. Vepra e rëndësisë së vogël .....	341
1. Parashtrimet e palëve .....	341
2. Aspekte ligjore .....	342
3. Konstatimet e Trupit Gjykses .....	342
I. Përfundim.....	343
IX. STATUSI I INFORMACIONIT TË PAKETAVE .....	343
X. DËNIMI .....	344
A. Parashtrimet e palëve.....	344
B. Dispozitat ligjore përkatëse.....	347
1. Qëllimi i dënimit .....	347
2. Dënimet për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit .....	349
3. Përcaktimi dhe drejtpeshimi i faktorëve përkatës.....	349
(a) Faktorët e përmendur në Ligj dhe Rregullore .....	349
(b) Faktorët e përmendur në KPK .....	350

(c) Faktorët e përmendur në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare .....	351
(d) Drejtpeshimi i faktorëve përkatës .....	352
4. Përcaktimi i dënimit të duhur .....	354
C. Konstatimet e Trupit Gjykes .....	356
1. Z. Gucati .....	356
(a) Pesha e veprave penale .....	356
(b) Lloji dhe shkalla e pjesëmarrjes së z. Gucati .....	359
(c) Rrethanat individuale të z. Gucati .....	361
(d) Përcaktimi i dënimit për z. Gucati .....	362
2. Z. Haradinaj .....	365
(a) Pesha e veprave penale .....	365
(b) Lloji dhe shkalla e pjesëmarrjes së z. Haradinaj .....	368
(c) Rrethanat individuale të z. Haradinaj .....	369
(d) Përcaktimi i dënimit për z. Haradinaj .....	370
XI. VENDIM .....	373
MENDIMI MË VETE I GJYKATËSIT BARTE .....	1
A. Interpretimi i elementit subjektiv të nenit 387 të KPK-së .....	1
B. Neni 401 i KPK-së: pengimi individual dhe/ose si grup .....	3
C. Ndikimi në Aktgjykim .....	10

**TRUPI GJKUES II**, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 158-159, 163 dhe 165 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") shqiptoi Vendimin e Gjykimit ("Aktgjykimi") në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt* më 18 maj 2022. Arsyetimet me shkrim për Aktgjykimin paraqiten më poshtë në pajtim me rregullën 159 të Rregullores.

1. Kjo çështje ka të bëjë me veprimet e **HYSNI GUCATIT** ("z. Gucati") dhe **NASIM HARADINAJT** ("z. Haradinaj") (bashkërisht "të akuzuarit") gjatë një periudhe trejavore prej 7 shtatorit 2020 deri më 25 shtator 2020 në lidhje me të cilat akuzohen të akuzuarit.

2. Gjykimi në këtë çështje filloi më 7 tetor 2021<sup>1</sup> dhe u mbyll më 17 mars 2022.<sup>2</sup> Midis 18 tetorit 2021 dhe 28 janarit 2022, Trupi Gjykues dëgjoji ose mori dëshmitë e pesëmbëdhjetë dëshmitarëve.<sup>3</sup> Gjatë gjyimit, Trupi Gjykues pranoi 238 prova materiale.<sup>4</sup> Në këtë Aktgjykim, Trupi Gjykues u referohet vetëm versioneve në anglishte të provave dhe transkripteve.<sup>5</sup>

3. Aktgjykimin i bashkëngjitet mendimi më vete i Gjykatësit Barte.

4. Shtojca publike 1 përfshin historikun procedural të çështjes. Shtojca publike 2 përmban listën me shkurtesa, termat e përkufizuara dhe format e shkurtra të parashtrimeve dhe jurisprudencës të përdorura në Aktgjykim dhe në mendimin më vete të Gjykatësit Barte. Shtojca publike 3 përmban listën e faqeve të transkriptit që do të riklasifikohen si publike.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> Transkripti, 7 tetor 2021, f. 747.

<sup>2</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3855.

<sup>3</sup> F597/A01.

<sup>4</sup> F598/A01.

<sup>5</sup> Kur Trupi Gjykues i referohet një prove materiale (*p.sh.* P1, 1D1, 2D1 ose C1), ai i referohet versionit në anglishte dhe numrit (numrave) të faqes në të. Gjithashtu, kur i referohet transkriptit të një seance, Trupi Gjykues i referohet versionit në anglishte të transkriptit. Numrat e faqeve janë ata të dosjeve në formatin PDF në *Legal Workflow*.

<sup>6</sup> *Shih më poshtë* para. 928-929 (Statusi i informacionit të paketave).

## I. AKUZAT

### A. AKUZAT DHE FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

5. Në Aktakuzën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") pretendohet se:

- së paku midis prillit dhe shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj bënë deklaratata me të cilat akuzuan dëshmitarë se bashkëpunonin me ZPS-në dhe persona të tjerë se ishin, ndër të tjera, gënjeshtarë, bashkëpunëtorë dhe tradhtarë. Kjo sjellje tregon qartë synimin dhe motivin e tyre për të dëmtuar dhe penguar procedurat zyrtare të Dhomave të Specializuara ("DHS"), përfshirë hetimet e ZPS-së ("procedurat e DHS-së");<sup>7</sup>
- së paku midis 7 dhe 25 tetorit 2020 ("periudha e Aktakuzës"), z. Gucati, z. Haradinaj dhe të tjerë shpërndanë pa autorizim informacion konfidencial dhe jopublik ("informacioni konfidencial") në lidhje me hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS") dhe ZPS-së, inkurajuan të tjerë të shpërndanin më tej informacionin konfidencial, dhe ndërmorën veprime të tjera për qëllimin e deklaruar të pengimit të punës së DHS-së/ZPS-së. Ky informacion konfidencial përfshinte dokumente të shënuara si "konfidenciale" dhe emra, të dhënat personale dhe dëshmitë e qindra dëshmitarëve të mbrojtur në kontekstin e procedurave të DHS-së dhe proceseve penale të mëparshme në Kosovë, ose në lidhje me Kosovën;<sup>8</sup>
- z. Gucati dhe z. Haradinaj organizuan dhe bashkërenduan shpërndarjen e paautorizuar dhe veprime që lidheshin me të, ndër të tjera, së bashku me disa persona të tjerë, përmes këqyrjes së informacionit konfidencial, pjesëmarrjes në vendime nëse dhe si të shpërndahej ai informacion, dhe

---

<sup>7</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 5. *Shih gjithashtu* F251/A02; F251/A01/RED.

<sup>8</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 6.

organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje në lidhje me të, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike të tjera, në të cilat informacioni konfidencial u shpërnda dhe diskutua publikisht.<sup>9</sup>

6. Në lidhje me këto veprime, kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj u ngritën dy akuza për “Vepra penale kundër rendit publik” për:

- **Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare**, me anë të kërcënimit të rëndë, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës (“KPK”), dhe nenet 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 1); dhe
- **Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 2).<sup>10</sup>

7. Ndaj të akuzuarve u ngritën katër akuza për “Vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administrimit publik” për:

- **Frikësim gjatë procedurave penale**, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 387 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 3);<sup>11</sup>
- **Hakmarrje**, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(2), 33, 35, dhe 388(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 4);<sup>12</sup>
- **Shkelje të fshehtësisë së procedurës**, me anë të zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, e

---

<sup>9</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 7.

<sup>10</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 25-28, 48.

<sup>11</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 29-30, 48.

<sup>12</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 31-32, 48.

ndëshkueshme sipas neneve 17, 31, 32(1)-(2), 33, 35 dhe 392(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 5);<sup>13</sup> dhe

- **Shkelje të fshehtësisë së procedurës**, me anë të zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 392(2)-(3) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit (Pika 6).<sup>14</sup>

8. ZPS-ja pretendon se përmes veprimeve të tyre dhe në shkelje të nenit 16(3) të Ligjit, të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale individuale për këto vepra penale përmes formave të përgjegjësisë të renditura në vijim:

- kryerje, vetë dhe/ose përmes bashkëkryerjes, të veprave penale në Pikat 1-6;
- tentativë për kryerjen e veprave penale të Pikave 1-4 dhe 6;
- marrëveshje për kryerjen e veprave penale sipas Pikave 1-6 dhe ndërmarrje e veprimeve thelbësore për të kryer këto vepra penale;
- nxitje dhe ndihmë në kryerjen e veprave penale të Pikave 1-6;
- nxitje për kryerjen e veprave penale të Pikave 1-6, dhe këto vepra penale u tentuan të kryheshin; dhe/ose
- nxitje për kryerjen e veprave penale të Pikave 1-4 dhe 6, dhe këto vepra penale as u kryen e as u tentuan.<sup>15</sup>

9. Aktakuza pretendon se kjo u bë me dijeninë dhe synimin e nevojshëm, në kuptimin që të akuzuarit:

- synuan të kryenin dhe nxisnin ose ndihmonin kryerjen (e tentuar) të veprave penale të Pikave 1-6;<sup>16</sup>

---

<sup>13</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 33, 48.

<sup>14</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 34-35, 48.

<sup>15</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 37-44, 47(i)-(vi).

<sup>16</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 45.

- si alternativë, të akuzuarit: (i) ishin të vetëdijshëm se veprat penale të Pikave 1-6 mund të ndodhnin si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre, dhe se veprimet ose mosveprimet e tyre mund të nxisnin ose ndihmonin kryerjen e veprave penale; dhe (ii) u pajtuan me kryerjen e tyre.<sup>17</sup>

10. Në pajtim me nenet 6(2) dhe 15(2) të Ligjit, Trupi Gjykses i gjykon këto akuza duke qenë se lidhen me procedurat dhe zyrtarët e DHS-së dhe/ose të ZPS-së dhe për rrjedhojë përfshihen në juridiksionin e DHS-së.

## **B. AKUZA TË SHUMËFISHTA**

11. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja ka të drejtë të ngrëjë akuza të cilat pasqyrojnë llojin, kuadrin dhe peshën e sjelljes së fajshme të pretenduar të të akuzuarve. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se palët pajtohen se ZPS-ja në parim lejohet të paraqesë akuza të shumëfishta në lidhje me të njëjtën sjellje të përgjithshme.<sup>18</sup>

12. Megjithatë, ZPS-ja gjithashtu duhet të sigurojë që akuzat e shumëfishta nuk shkaktojnë ngatërresë ose vonesë të paarsyeshme. Akuzat dhe format e shumëfishta të përgjegjesisë penale në lidhje me të njëjtat sjellje ose me sjellje që përkojnë, ndërllojnë punën tashmë të mundimshme për të identifikuar se cilat prej provave të paraqitura kanë lidhje me cilën pikë (cilat pika) dhe formë (forma) të përgjegjesisë penale. Akuzat e përsëritura gjithashtu mund të jenë të padrejta ndaj të akuzuarve, në rastet kur krijojnë paqartësi në lidhje me llojin e akuzave të paraqitura nga Prokuroria ose me provat që kanë lidhje me ndonjë aspekt të tyre.

13. Në çështjen në fjalë, Trupi Gjykses vëren se i njëjti grup faktesh dhe rrethanash ka lidhje me pika dhe/ose forma të përgjegjesisë penale të shumëfishta. Në

---

<sup>17</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 46.

<sup>18</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 147; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3483; Transkripti, 17 mars 2022, f. 3806, 3824. *Shih gjithashtu F567/RED.*



rregullën 158(2) të Rregullores kërkohet që Trupi Gjykses të vendosë veçazi për çdo akuzë, përfshirë edhe për secilën formë përkatëse të përgjegjësisë penale. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do të trajtojë secilën akuzë, por do t'u referohet, sipas rastit, fakteve dhe rrethanave që diskutohen në akuza të tjera. Gjithashtu, Trupi Gjykses do të trajtojë secilën përgjegjësi penale, por do t'u referohet, sipas rastit, fakteve dhe rrethanave që diskutohen në forma të tjera të përgjegjësisë penale. Trupi Gjykses do të shtjellojë veçanërisht formën e përgjegjësisë penale sipas së cilës të akuzuarit u shpallën përgjegjës penalisht.

#### C. PRETENDIME QË KANË TË BËJNË ME PERSONA KUNDËR TË CILËVE NUK ËSHTË PARAQITUR AKTAKUZË

14. ZPS-ja ngriti akuza vetëm kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj për veprat penale të pretenduara në Aktakuzë. Megjithatë, në pjesë të ndryshme të Aktakuzës, ZPS-ja përmend persona të tjerë, të cilët ajo pretendon se kontribuan ose morën pjesë në kryerjen e këtyre veprave penale, konkretisht: (i) Faton Klinaku ("z. Klinaku") dhe Tomë Gashi ("z. Tomë Gashi");<sup>19</sup> (ii) anëtarë ose përfaqësues të tjerë të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL-UÇK");<sup>20</sup> dhe (iii) persona të cilët morën pjesë, shikuan ose u informuan për tri konferencat e shtypit dhe paraqitje të tjera në media, dhe disa përfaqësues të shtypit ose persona që zotëronin ose kishin qasje në informacionin konfidencial ("personat e tjerë").<sup>21</sup> ZPS-ja u referohet z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe anëtarëve të tjerë ose përfaqësuesve të OVL-UÇK-së bashkërisht si "ndihmës". Dosja Paraprake dhe Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së përmbajnë argumente të hollësishme lidhur me veprimet dhe

---

<sup>19</sup> IA4-F7, para. 6, 16.

<sup>20</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 6-7, 25-26, 28-31, 33-34, 39, 41-46.

<sup>21</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 41-46.

sjelljet e z. Klinaku dhe të z. Tomë Gashi, për të cilët ZPS-ja deklaroi se morën pjesë me vetëdije në kryerjen e veprave penale të përfshira në Aktakuzë.<sup>22</sup>

15. Gjatë gjykimit u ngrit tema e përgjegjesisë penale të personave kundër të cilëve nuk është paraqitur aktakuzë, në lidhje me dëshmitarin e ZPS-së (W04866), Halil Berisha ("z. Berisha"). Palët shprehën mendimin se z. Berisha nuk kreu asnjë veprë penale me përpilimin dhe publikimin e disa artikujve në lidhje me materialin që mori.<sup>23</sup> Në deklaratat përmbyllëse, Mbrojtja e ftoi Trupin Gjykses që të vlerësonte sjelljen dhe të kuptuarit e ligjit nga të akuzuarit krahasuar me z. Berisha dhe të nxirrte përfundimin se ashtu siç z. Berisha nuk kreu asnjë veprë penale, nuk kryen as dy të akuzuarit.<sup>24</sup>

16. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk ngriti akuza kundër z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe ndonjë ndihmësi tjetër, personave të tjerë ose z. Berisha. Në përputhje me prezumimin e pafajësisë, Trupi Gjykses merr në shqyrtim sjelljen dhe deklaratat e këtyre personave aq sa është e nevojshme për vlerësimin e përgjegjesisë penale të të akuzuarve.<sup>25</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të nxjerrë përfundime në lidhje me përgjegjësinë penale për asnjërin nga këta persona.<sup>26</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses nuk do të nxjerrë asnjë përfundim në lidhje me përgjegjësinë penale të të akuzuarve nga mendimet e palëve për personat kundër të cilëve nuk është paraqitur aktakuzë.

---

<sup>22</sup> *Shih p.sh.* F181/A1 Dosja Gjyqësore Paraprake e ZPS-së, para. 10, 22, 24, 30-31, 34, 57-58, 79-80, 83-85, 93-94, 97-100, 116, 122, 128, 130, 132, 140, 154-155, 161, 169, 173, 175-179, 185-187, 192-194, 197, 208-213, 215; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 24, 27-29, 44-45, 50-51, 60, 63, 66, 70, 80-81, 94, 105, 113-114, 122, 187, 194-197, 261-262, 264-267, 270, 272, 275-276, 278-282, 351, 357, 415. *Shih gjithashtu* F181/A01/RED; F565/RED. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3458-3460, 3512-3515, 3524; Transkripti, 17 mars 2022, f. 3754, 3774, 3779, 3789.

<sup>23</sup> Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1507; Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1577, 1632.

<sup>24</sup> Transkripti, 15 mars 2022, f. 3552-3585, 3590-3599; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3693, 3712. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 230, 329. *Shih gjithashtu* F566/RED.

<sup>25</sup> ECtHR, [Karaman Judgment](#), para. 40-44, 64.

<sup>26</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 26-27; F502 Vendimi për Prova Jogojore të Gucatit, para. 47.

## II. PRANIMI DHE VLERËSIMI I PROVAVE

### A. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

17. Korniza e përgjithshme për pranimin dhe vlerësimin e provave përcaktohet në nenet 21, 37, 40(6)(e) dhe (h) të Ligjit dhe rregullat 137-140 të Rregullores. Trupi Gjykses gjithashtu i referohet Urdhrit të tij për Zhvillimin e Procedurave, të cilin e miratoi në fillim të këtij procesi, pasi shqyrtoi parashtrime nga palët, për të mundësuar kryerje të drejtë dhe të shpejtë të këtij gjykimi.<sup>27</sup>

18. Trupi Gjykses vlerësoi dhe peshoi provat brenda kësaj kornize të përgjithshme dhe mbajti parasysh Kushtetutën e Kosovës ("Kushtetuta") dhe të drejtat themelore që ajo garanton. Sipas rastit, Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh praktikën dhe jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve të tjerë që veprojnë në sisteme normative të krahasueshme me atë që zbatohet në DHS.

### B. PRANIMI I PROVAVE

19. Në pajtim me rregullën 138(1) të Rregullores, Trupi Gjykses pranoi prova që lidheshin me çështjen, ishin autentike dhe kishin vlerë provuese, dhe që vlera provuese e tyre nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre. Trupi Gjykses shtjelloi interpretimin e vet të këtyre dy kriterëve në dy vendime për pranimin e materialeve jogojore.<sup>28</sup>

20. Trupi Gjykses më poshtë do të trajtojë një numër aspektesh konkrete në lidhje me pranimin e provave gjatë gjykimit.

---

<sup>27</sup> F314/A01 Urdhër mbi Zhvillimin e Procedurave.

<sup>28</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 11; F502 Vendimi për Prova Jogojore të Gucatit, para. 9-13.

## 1. Prova për fakte dhe rrethana që i paraprijnë periudhës së Aktakuzës

21. Trupi Gjykes kujton konstatimet e tij se prova është e rëndësishme në qoftë se lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me elementet e veprës (veprave) penale ose me formën (format) e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë ose me faktet dhe rrethanat juridikisht thelbësore për çështjen e një pale.<sup>29</sup> Trupi Gjykes këshilloi palët që materialet provuese që synonin t'i paraqisnin t'i përqendronin në periudhën kohore që lidhet me Aktakuzën.

22. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Trupi Gjykes përjashtoi provat që lidhen me periudhën kohore që i parapriu ose pasoi periudhën e Aktakuzës.<sup>30</sup> ZPS-ja paraqiti prova në lidhje me veprimet dhe deklaratat që u atribuoheshin të akuzuarve para periudhës së Aktakuzës. Megjithëse këto nuk përbënin veprim të fajshëm për ndonjëerë prej veprave penale të paraqitura në Aktakuzë,<sup>31</sup> ato ishin rrethana në të cilat ZPS-ja u mbështet për të vërtetuar se të akuzuarit, gjatë gjithë kohës përkatëse, kishin synimin kriminal të nevojshëm.<sup>32</sup> Trupi Gjykes rrjedhimisht pranoi prova të tilla kur ishin relevante për nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me synimin e të akuzuarve.<sup>33</sup>

23. Provat që lidhen me këto rrethana trajtohen në pjesët përkatëse të këtij Aktgjykimi.<sup>34</sup>

---

<sup>29</sup> F502 Vendimi për Prova Jogojore të Gucatit, para. 10; F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 12.

<sup>30</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 313; [Ngeze and Nahimana 5 September 2000 Decision](#), f. 6; [Kabiligi 13 November 2000 Decision](#), f. 4-5.

<sup>31</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 5.

<sup>32</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 21-23; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 7.

<sup>33</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Simba 29 July 2004 Decision](#), f. 3. *Shih gjithashtu* [Ngeze and Nahimana 5 September 2000 Decision, Separate Opinion of Judge Shahabuddeen](#), para. 9-17.

<sup>34</sup> *Shih më poshtë* para. 572-574, 600 (Pika 3), 659, 666 (Pika 1), 855, 858 (Argumentet mbrojtëse).

## 2. Dëshmitë e dorës së dytë dhe e drejta për ballafaqim

24. Trupi Gjykses vë në dukje se nuk ka barrierë procedurale për pranimin e dëshmime të dorës së dytë në prova.<sup>35</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk përjashtoi automatikisht provat që nuk ishin dëshmi e drejtpërdrejtë e çfarë kishte parë, thënë, bërë ose dëgjuar një dëshmitar, por ishin të llojit të dorës së dytë.<sup>36</sup>

25. Trupi Gjykses refuzoi të pranonte dëshmi të dorës së dytë kur ato cenonin padrejtësisht të drejtën e të akuzuarve për ballafaqim.<sup>37</sup> Duke përjashtuar prova të tilla, Trupi Gjykses zbatoi parimin e mishëruar në nenin 6(3)(d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"), nenin 31(4) të Kushtetutës dhe nenin 21(4)(f) të Ligjit, sipas të cilëve i akuzuari ka të drejtë të ballafaqohet dhe të kundërshtojë provat e paraqitura kundër tij.<sup>38</sup> Ky parim kërkon që, përpara se një i akuzuar të dënohet, të gjitha provat kundër tij ose saj duhet të paraqiten në prani të tij ose saj në seancë publike, me qëllim të argumentimit ballafaques.<sup>39</sup> Çfarëdo përjashtimi nga ky parim nuk duhet të cenojë të drejtat e të akuzuarit.<sup>40</sup>

26. Në zbatimin e këtyre parimeve, Trupi Gjykses përjashtoi shënimet zyrtare të ZPS-së, në të cilat u regjistruan deklaratat që u atribuoheshin personave që pretendoheshin se ishin prekur nga veprimet e të akuzuarve ("shënimet për kontaktet").<sup>41</sup> Trupi Gjykses nuk i pranoi këto shënime sepse, ndër të tjera, asnjë nga personat e lartpërmendur nuk u thirrën për të dhënë dëshmi gjatë gjykimit dhe nuk u dha asnjë arsye e vlefshme për mosparaqitjen e tyre.<sup>42</sup> Trupi Gjykses e gjykoi këtë si rrezik që do të cenonte rëndë të

---

<sup>35</sup> *Shih p.sh.* ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), para. 226; ICC, [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 874.

<sup>36</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Aleksovski 16 February 1999 Decision](#), para. 15; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 13.

<sup>37</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 90.

<sup>38</sup> ECtHR, [Cutean Judgment](#), para. 60.

<sup>39</sup> ECtHR, [Al-Khawaja and Tahery GC Judgment](#), para. 118-119.

<sup>40</sup> ECtHR, [Schatschaschwili GC Judgment](#), para. 111-131.

<sup>41</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 86.

<sup>42</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 91.

drejtën e të akuzuarve për t'u ballafaquar në mënyrë të efektshme me akuzat e paraqitura kundër tyre.<sup>43</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses refuzoi pranimin e deklaratave të përpiluara nga një hetues i ZPS-së i cili nuk u thirr për të dhënë dëshmi në gjykim, pa u dhënë ndonjë arsye e vlefshme për mosparaqitjen e tij.<sup>44</sup> Provat të cilat Trupi Gjykses i pranoi nëpërmjet procedurës për pranimin e provave jogojore – jo në gjykim të hapur në prani të të akuzuarve – ishin objekt i argumenteve ballafaqese.<sup>45</sup>

### 3. Ligjshmëria e kontrollimeve dhe kronologjia e mbajtjes në ruajtje të provave

27. Trupi Gjykses vë në dukje se në çështjen aktuale u ngritën kundërshtime lidhur me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të materialit të sekuestruar në selinë e OVL-UÇK-së.<sup>46</sup> Këto argumente trajtohen në hollësi në pjesët përkatëse të Aktgjykimit.<sup>47</sup>

28. Për qëllimet e kësaj çështjeje, Trupi Gjykses vë në dukje se, në përputhje me rregullën 138(1) të Rregullores, dëshmia ose evidenca e kronologjisë së mbajtjes në ruajtje nuk është kusht për pranimin e provave. Ekzistenca, konkretësia dhe besueshmëria e një evidence të tillë, në qoftë se ekziston, janë faktorë që kanë lidhje të mundshme me vlerësimin e kushteve të pranueshmërisë së provave të mbledhura. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se nuk ka konsensus ose standard ndërkombëtar lidhur me mënyrën dhe formën në të cilën duhet mbajtur evidenca e kronologjisë së mbajtjes në ruajtje të provave. Pranueshmëria e provave të mbledhura mund të ndikohet vetëm në qoftë se mangësitë e supozuara të kronologjisë së ruajtjes së provave ngrenë dyshime në lidhje me autenticitetin dhe/ose besueshmërinë e atyre provave. Sido që të jetë, besueshmëria dhe autenticiteti i provave të mbledhura gjatë një operacioni sekuestrimi gjithmonë duhen vlerësuar duke mbajtur parasysh të gjitha

<sup>43</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së, para. 93.

<sup>44</sup> Transkripti, 19 tetor 2021, f. 937-939 (Urdhër Gojor mbi Pranueshmërinë e Disa Provave Materiale). *Shih gjithashtu* ECtHR, [Al-Khawaja and Tahery Judgment](#), para. 119.

<sup>45</sup> F334 Vendimi për Prova Jogojore të ZPS-së; F291; F308; F309; F502 Vendimi për Prova Jogojore të Guccatit; F487; F488; F496. *Shih gjithashtu* F308/RED; F309/RED; F487/RED.

<sup>46</sup> *Shih më poshtë* para. 302-304 (Konstatime mbi paketat).

<sup>47</sup> *Shih më poshtë* para. 305-330 (Konstatime mbi paketat).

rrethanat përkatëse, e jo vetëm në bazë të evidencës zyrtare që është bërë, në qoftë se është bërë, gjatë operacionit të sekuestrimit.

29. Në përputhje me rregullën 139(7) të Rregullores, gjatë vlerësimit të provave, Trupi Gjykses mori parasysh mënyrën e mbledhjes së provave në këtë çështje dhe ndikimin që kjo mund të ketë pasur në kryerjen dhe drejtësinë e procesit gjyqsor.

#### **4. Provat lidhur me drejtësinë dhe kryerjen e krimeve gjatë luftës në vitet 1998-1999**

30. Trupi Gjykses konstatoi se karakteri i konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, përfshirë edhe drejtësia e pretenduar e tij, apo kryerja e krimeve nga persona që i përkisnin cilëso palë gjatë atij konflikti, nuk janë aspekte që lidhen me çështjen gjyqsore aktuale. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk lejoi paraqitjen dhe nuk pranoi prova të tilla, por pranoi prova lidhur me përvojat personale të të akuzuarve gjatë atij konflikti.<sup>48</sup>

31. Megjithëse Trupi Gjykses lejoi paraqitjen dhe pranoi prova lidhur me pretendimin e Mbrojtjes lidhur me interesin publik,<sup>49</sup> ai qartësisht përcaktoi kuadrin e këtyre provave.<sup>50</sup> Trupi Gjykses gjithashtu qartësoi se provat lidhur me interesin publik nuk përfshinin zbardhjen e krimeve të pretenduara serbe gjatë konfliktit.<sup>51</sup>

32. Trupi Gjykses lejoi paraqitjen e provave lidhur me bindjen e të akuzuarve nëse ndonjë anëtar i UÇK-së mund të kishte kryer krime, përfshirë gjatë konfliktit, dhe nëse ai krim mund të hetohet dhe ndiqet penalisht në mënyrë të përligjur nga TFHS-ja ose

---

<sup>48</sup> Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2110 (Urdhër Gojor për Ekipet e Mbrojtjes në lidhje me Marrjen në Pyetje të Dëshmitarëve të Tyre); Transkripti, 14 janar 2022, f. 3041. Lidhur me provat e pranuar në lidhje me përvojën personale të të akuzuarve gjatë konfliktit të armatosur, *shih p.sh.* 1D3, para. 4-7; 2D1, para. 10-12.

<sup>49</sup> *Shih më poshtë* para. 806-809 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>50</sup> F470, para. 61.

<sup>51</sup> Transkripti, 14 janar 2022, f. 3041.

ZPS-ja, pasi këto aspekte kanë lidhje të mundshme me synimin kriminal dhe motivet e të akuzuarve.<sup>52</sup>

## 5. Provat që kanë të bëjnë me “argumentet mbrojtëse”

33. Trupi Gjykses lejoi të dy ekipet e Mbrojtjes të paraqisnin prova në lidhje me të gjitha argumentet mbrojtëse që ngritën të akuzuarit, përfshirë për sa i përket pretendimit për interesin publik dhe shtytjes për kryerje të veprës penale, pavarësisht nga mungesa e një baze ligjore dhe e rregullimit të qartë të tyre në kornizën ligjore të DHSK-së. Trupi Gjykses do t'i trajtojë këto tema në pjesët përkatëse të këtij Aktgjykimi.<sup>53</sup>

## C. VLERËSIMI I PROVAVE

### 1. Prezumimi i pafajësisë dhe detyrimi i vërtetimit

34. Trupi Gjykses ka zbatuar prezumimin e pafajësisë të përcaktuar në nenin 31(5) të Kushtetutës dhe nenin 21(3) të Ligjit, që mishëron një parim të përgjithshëm juridik. Rrjedhimisht, ZPS-ja kishte detyrimin për të provuar fajësinë e të akuzuarve. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses nuk kërkoi nga të akuzuarit të provonin pafajësinë e tyre, e as të paraqisnin prova të ndonjë fakti me rëndësi materiale për mbrojtjen e tyre. Megjithatë të dy të akuzuarit vendosën të paraqisnin prova, ata nuk kishin detyrimin e kundërshtimit të provave të ZPS-së.<sup>54</sup> Gjithashtu, mosparaqitja nga të akuzuarit të provave të besueshme dhe ku mund të mbështetesh, nuk u interpretua si tregues i fajësisë.<sup>55</sup>

---

<sup>52</sup> Transkripti, 14 janar 2022, f. 3041.

<sup>53</sup> *Shih më poshtë* para. 801-832, 833-889 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>54</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Kalimanzira Appeal Judgment](#), para. 20. *Shih gjithashtu* ICTR, [Zigiranyirazo Appeal Judgment](#), para. 19; [Muhimana Appeal Judgment](#), para. 18.

<sup>55</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Kamuhanda Trial Judgment](#), para. 85. *Shih gjithashtu* ICTR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 414.



## 2. Standardi i vërtetimit

35. Në përputhje me rregullën 140(2) të Rregullores, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm u zbatua për faktet që përbëjnë elementet e veprës (veprave) penale dhe formës (formave) të përgjegjesisë penale që përmban Aktakuza, si dhe për faktet mbi të cilat bazohet shpallja e fajësisë.<sup>56</sup> Sikurse kërkohet nga e njëjta dispozitë, kushti i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm nuk u zbatua veçazi për çdo provë. Trupi Gjykses rrjedhimisht ka përcaktuar nëse pesha e të gjitha provave ishte e mjaftueshme për të vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm elementet e veprave penale që përmban Aktakuza, dhe përfundimisht përgjegjësinë e të akuzuarve.

36. Në zbatimin e standardit të vërtetimit, Trupi Gjykses iu përmbajt parimeve në vijim. “Dyshimi i arsyeshëm” nuk mund të konsistojë në një dyshim imagjinar ose të pabazë, mbështetur në simpati ose paragjykim.<sup>57</sup> Ai duhet të bazohet në logjikë dhe arsyetim të shëndoshë dhe të ketë lidhje racionale me provat, mungesën e provave ose mospërputhshmëritë në prova.<sup>58</sup> Standardi “jashtë dyshimit të arsyeshëm”:

nuk do të thotë jashtë dyshimit të kotë, imagjinar ose jorealit, por do të thotë se fajësia e të akuzuarit duhet të vërtetohet plotësisht me siguri morale, përpara se ai të dënohet. Thënë ndryshe, ai është dyshim i tillë që, pas shqyrtimit të plotë të të gjitha provave, një person i paanshëm dhe reflektues i ngarkuar me përgjegjësinë e marrjes së vendimit, do të mbetet në atë gjendje mendore që nuk do të mund të thoshte se ndjeu një bindje të palëkundur në nivelin e sigurisë morale për vërtetësinë e akuzës.<sup>59</sup>

37. Sa u përket provave rrethore, në përputhje me rregullën 140(3) të Rregullores, standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm përmbushet vetëm në qoftë se përfundimi i nxjerrë prej këtyre provave është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund

<sup>56</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Šainović et al. Appeal Judgment](#), para. 132; [Martić Appeal Judgment](#), para. 55; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 125; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 10; ICTR, [Ntagerura et al. Appeal Judgment](#), para. 174, fn. 356.

<sup>57</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Halilović Appeal Judgment](#), para. 109; ICTR, [Rutaganda Appeal Judgment](#), para. 488; [Delalić et al. Trial Judgment](#), para. 601.

<sup>58</sup> *Shih p.sh.* [Rutaganda Appeal Judgment](#), para. 488.

<sup>59</sup> NMT, [US v. Pohl et al.](#), f. 965.

të nxirrej prej provave të paraqitura.<sup>60</sup> Në qoftë se provat lejohet nxjerrjen e një përfundimi tjetër të arsyeshëm (përfundimeve të tjera të arsyeshme), që përputhen ose me mosekzistencën e faktit i cili kërkohet të deduktohet, ose me pafajësinë e të akuzuarit,<sup>61</sup> standardi i vërtetimit jashtë dyshimit të bazuar nuk përmbushet.<sup>62</sup>

### 3. Vlerësimi i provave në kuadër të Aktgjykimit

38. Në përputhje me rregullën 139(2) të Rregullores, gjatë shqyrtimit nëse janë vërtetuar pretendimet faktike, Trupi Gjykses kreu vlerësim tërësor dhe i peshoi të gjitha provat të marra në tërësi për të përcaktuar nëse janë vërtetuar faktet në fjalë. Për këtë arsye, disa prova të veçanta, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve të ndryshëm ose dokumentet e pranuar si prova, u analizuan duke mbajtur parasysh tërësinë e provave të paraqitura.<sup>63</sup> Në pajtim me rregullën 139(6) të Rregullores, Trupi Gjykses nuk e refuzoi një provë automatikisht si jo të besueshme për shkak të mospërputhjeve. Në disa raste, veçanërisht në lidhje me deklarata dhe dëshmi të dëshmitarëve, Trupi Gjykses pranoi pjesë të provave dhe refuzoi pjesë të tjera.

39. Në përputhje me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses mori parasysh, por nuk kërkoi konfirmim për të vërtetuar veprën penale ose sjelljen e paraqitur në Aktakuzë.

---

<sup>60</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Kvočka et al. Appeal Judgement](#), para. 237; [Šainović et al. Appeal Judgment](#), para. 995; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 14.

<sup>61</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Ntagerura et al. Appeal Judgment](#), para. 306; ICTY, [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 458.

<sup>62</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 120; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 10, 14; [Kvočka et al. Appeal Judgment](#), para. 237; [Šainović et al. Appeal Judgment](#), para. 995.

<sup>63</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Mrkšić and Šljivančanin Appeal Judgment](#), para. 217; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 8; [Orić 21 October 2004 Order](#), para. 4; [Milošević Appeal Judgment](#), para. 20, fn. 59; [Halilović Appeal Judgment](#), para. 119; [Orić Appeal Judgment](#), para. 86; [Limaj et al. Trial Judgment](#), para. 20; ICTR, [Ntagerura et al. Appeal Judgment](#), para. 174; [Karemera et al. 29 May 2009 Decision](#), para. 13-14, 16-17, 20, 22.

40. Trupi Gjykses gjithashtu ka marrë parasysh veçoritë që lidhen me prova të drejtpërdrejta dhe rrethimore, kategori të tjera konkrete të provave, dhe të dëshmitëve të dëshmitarëve, sikurse shpjegohet më poshtë.

(a) Provat e drejtpërdrejta dhe rrethimore

41. Provat mund të jenë të drejtpërdrejta ose rrethimore. Si prova të drejtpërdrejta, Trupi Gjykses konsideroi ato që janë konfirmim i drejtpërdrejtë i një fakti, siç është dëshmia e një dëshmitari okular. Gjithashtu, edhe një dokument, evidencë, ose objekt mund të jetë provë e drejtpërdrejtë, kur më vete mund të vërtetojë një fakt. Provat e drejtpërdrejta nuk kanë nevojë për nxjerrjen e deduksioneve.<sup>64</sup>

42. Provat rrethimore janë prova për një numër rrethimash të ndryshme lidhur me një ngjarje, nga të cilat mund të deduktohet në mënyrë të arsyeshme fakti në fjalë.<sup>65</sup> Në përputhje me rregullën 139(5) të Rregullores, Trupi Gjykses i vlerësoi provat rrethimore me kujdes dhe dha konstatime të arsyetuara, në veçanti në lidhje me përputhshmërinë dhe lidhjen e brendshme logjike të këtyre provave.

(b) Kategori specifike të provave

43. Disa kategori provash u trajtuan me kujdes të posaçëm. Për shembull, në rastin e dëshmitëve të dorës së dytë<sup>66</sup> dhe lajmeve në media,<sup>67</sup> Trupi Gjykses i vlerësoi ato duke mbajtur parasysh llojin e veçantë provues të tyre. Sa u përket dëshmitëve të dorës së dytë, Trupi Gjykses mbajti parasysh se pesha që i atribuohet kësaj kategorie, nëse i atribuohet ndonjë peshë, do të varej prej rrethimave konkrete të çështjes.<sup>68</sup> Në përputhje me këtë, Trupi Gjykses i vlerësoi dëshmitët e dorës së dytë sipas rastit duke

---

<sup>64</sup> *Shih p.sh.* United States of America, [Santos v. City of Providence et al. Jury Instructions](#), f. 5.

<sup>65</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 14; [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 458.

<sup>66</sup> *Shih më lart* para. 24-26.

<sup>67</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 22.

<sup>68</sup> *Shih p.sh.* ICC, [Ngudjolo Chui Appeal Judgment](#), para. 226; [Bemba et al. Appeal Judgment](#), para. 874.

mbajtur parasysh, në veçanti, konfirmimin e tyre nga prova të tjera dhe deri në çfarë mase Mbrojtja pati mundësi t'i verifikonte dhe t'i kundërshtonte këto dëshmi.<sup>69</sup> Trupi Gjykses përgjithësisht nuk pranoi si prova materiale jогоjore lajmet në media për të përcaktuar vërtetësinë e përmbajtjes së tyre. Përpara se t'i pranonte ato, Trupi Gjykses kërkoi kontekstualizim nëpërmjet dëshmitarit përkatës.<sup>70</sup>

(c) Dëshmitarët

44. Në përputhje me rregullën 139(4) të Rregullores, gjatë përcaktimit të peshës që i kushtohet dëshmisë së një dëshmitari, Trupi Gjykses vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë e dëshmisë së tij apo të saj. Në këtë aspekt, ai mbajti parasysh, ndër të tjera, sjelljen e dëshmitarëve, lidhjen e dëshmitarëve me ndonjërin prej palëve, gjasën dhe përputhshmërinë e dëshmimeve të tyre, si dhe rrethanat e çështjes dhe konfirmimin nga prova të tjera.<sup>71</sup> Në përputhje me rregullën 139(3) të Rregullores, Trupi Gjykses gjykoi se dëshmia e një dëshmitari të vetëm për një fakt material, nga ana juridike, nuk kërkonte vërtetim.<sup>72</sup> Në kësi rastesh, Trupi Gjykses e analizoi dëshminë e dëshmitarit me kujdes shumë të madh përpara se ta pranonte si bazë të mjaftueshme për konstatimin në fjalë.<sup>73</sup> Në pajtim me rregullën 139(6) të Rregullores, mospërputhjet e vogla midis dëshmimeve të dëshmitarëve të ndryshëm, ose midis dëshmisë së ndonjë dëshmitari të caktuar dhe deklaratave të mëparshme me shkrim të tij ose të saj, nuk u konsideruan se i zhvlerësonin këto dëshmi.<sup>74</sup> Gjithashtu, në pajtim me rregullën 140(4) të Rregullores dhe në pajtim me konstatimet e veta për pranueshmërinë e provave duke pasur parasysh të drejtën për ballafaqim, Trupi

<sup>69</sup> *Shih më lart* para. 24-26. *Shih p.sh.* ICTY, [Aleksovski 16 February 1999 Decision](#), para. 15. *Shih gjithashtu* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 13.

<sup>70</sup> F334 Vendimi për Prova Jогоjore të ZPS-së, para. 39. *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 22.

<sup>71</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 11.

<sup>72</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 506; [Karadžić Trial Judgment](#), para. 12.

<sup>73</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 12.

<sup>74</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Karadžić Trial Judgment](#), para. 12; [Milutinović et al. Trial Judgment](#), para. 49.

Gjykues nuk bazoi asnjë vendim fajësie vetëm ose në masë vendimtare, në dëshminë e një dëshmitari të cilin Mbrojtja nuk pati mundësi ta merrte në pyetje.<sup>75</sup>

45. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues paraqet këto konstatime lidhur me: (i) dëshmitë e të akuzuarve; dhe (ii) kundërshtimet e ngritura lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të dëgjuar.

i) Dëshmitë e të akuzuarve

46. Neni 21(4)(h) i Ligjit parashikon se i akuzuari nuk detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose të pranojë fajësinë. Të akuzuarit në këtë çështje vendosën lirisht që të jepnin dëshmi. Vendimi i të akuzuarve për të dhënë dëshmi nuk do të thotë se ata pranuan detyrimin për vërtetimin e pafajësisë e tyre,<sup>76</sup> as nuk do të thotë se duhet zgjedhur ose dëshmia e të akuzuarit, ose ajo e një dëshmitari të ZPS-së. Trupi Gjykues u ka kushtuar vëmendjen e duhur dëshmime të të akuzuarve dhe të dëshmitarëve të tjerë.<sup>77</sup>

47. Në pajtim me rregullat 139(2), (4) dhe 142(4) të Rregullores, për të vendosur se çfarë peshe t'i japë dëshmisë së të akuzuarit, Trupi Gjykues duhet të vlerësojë besueshmërinë e të akuzuarit dhe, në kontekst të tërësisë së provave, nëse mund të bazohesh në dëshminë e tij.<sup>78</sup> Trupi Gjykues ka vepruar kështu në lidhje me të dy të akuzuarit. Trupi Gjykues do të përmbledhë shkurtimisht konstatimet e veta në këtë aspekt.

48. Trupi Gjykues konstatoi se pjesë të deklaratës me shkrim dhe pjesë të dëshmisë së z. Gucati ishin të besueshme, veçanërisht përshkrimi i tij i sinqertë në lidhje me kohën dhe rrethanat e përgjithshme të ngjarjeve që përbëjnë historikun e kësaj çështjeje. Trupi Gjykues trajtoi me shumë më tepër kujdes besueshmërinë e aspekteve të tjera të

---

<sup>75</sup> *Shih më lart* para. 24-26.

<sup>76</sup> *Shih më lart* para. 34. *Shih p.sh.* ICTY, [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 13; [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 560.

<sup>77</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Vasiljević Trial Judgment](#), para. 13; [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 560.

<sup>78</sup> *Shih p.sh.* ICTR, [Karera Appeal Judgment](#), para. 19, 27-29; ICTY, [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 21.

dëshmisë të tij, sepse në lidhje me arsyet e pretenduara për veprimet dhe synimet e tij, z. Gucati dha shpjegime që nuk përputheshin ose ishin në kundërshtim me përshkrimet që ai kishte bërë në atë kohë dhe/ose me prova të tjera të besueshme.<sup>79</sup>

49. Trupi Gjykses konstatoi se pjesë të deklaratës me shkrim dhe aspekte të kufizuara të dëshmisë së z. Haradinaj ishin të besueshme, konkretisht kur ato u konfirmuan nga prova të tjera, dhe Trupi Gjykses u mbështet në to lidhur me disa prej konstatimeve të veta. Trupi Gjykses konstatoi se një pjesë e madhe e dëshmisë gojore të tij nuk ishte e besueshme. Trupi Gjykses vë në dukje veçanërisht se gjatë marrjes në pyetje nga Prokuroria, z. Haradinaj në mënyrë të përsëritur nuk iu përgjigj pyetjeve të prokurorit, shpesh u bënte bisht përgjigjeve, mbajti fjalime që nuk kishin lidhje, dha shpjegime të pagjasa, refuzoi të trajtonte fakte dhe sugjerime të paraqitura prej prokurorit, mohoi deklaratat që kishte bërë edhe kur u ballafaqua me videoincizimet e atyre deklaratave, u përpoq të minimizonte rolin e tij ose natyrën e deklaratave, bëri interpretime të pagjasa të deklaratave të tij ose të të tjerëve dhe shtrembëroi ngjarjet në mënyrë që të paraqiste një version më të favorshëm për mbrojtjen e tij.<sup>80</sup> Trupi Gjykses i mori parasysh këto aspekte kur bëri konstatimet e veta dhe në vlerësimin e besueshmërisë së z. Haradinaj në përgjithësi.

ii) Kundërshtimet ndaj besueshmërisë së dëshmitarëve

50. W04841. Që të dy ekipet e Mbrojtjes kundërshtuan besueshmërinë e dëshmitares W04841 të ZPS-së, Zdenka Pumper (“znj. Pumper”), dhe mbështetshmërinë e dëshmisë së saj, me arsyetimin se ajo kishte kryer shqyrtim të kufizuar të autenticitetit

---

<sup>79</sup> *Shih më poshtë* para. 373-374, 450-452 (Konstatimet mbi paketat). *Shih p.sh.* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168-2169, 2190, 2200; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2240-2254, 2285, 2287, 2310-2317, 2277-2279; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2343-2351, 2353-2355, 2358-2363. *Shih gjithashtu* 1D3, para. 16.

<sup>80</sup> *Shih më poshtë* para. 375, 416-420, 453-455 (Konstatimet mbi paketat). *Shih p.sh.* DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2725-2726, 2744, 2782, 2785, 2885; Transkripti, 13 janar 2022, f. 3000, 3002-3004. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 107, 111.

dhe konfidencialitet të materialit të sekuestruar ose të marrë nga ZPS-ja dhe nuk kishte bërë disa verifikime (p.sh. nëse informacioni tashmë ishte publik).<sup>81</sup> ZPS-ja i kundërshtoi këto argumente.<sup>82</sup>

51. Trupi Gjykses i trajton kundërshtimet konkrete në lidhje me provat për përmbajtjen, autenticitetin dhe konfidencialitetin e materialit të sekuestruar në pjesët përkatëse të këtij Aktgjykimi.<sup>83</sup> Në kontekstin aktual, Trupi Gjykses thekson se ka konstatuar se dëshmia e znj. Pumper është me shumë vlerë provuese, e përputhshme në thelb, dhe e hollësishme. Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se znj. Pumper e kreu shqyrtimin brenda kompetencave të saj dhe udhëzimeve që i ishin dhënë dhe se çdo problem që del nga ai shqyrtim nuk rrjedh prej neglizhencës ose njëanshmërisë së saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka konstatuar se znj. Pumper është e besueshme dhe se mund të mbështetet në dëshminë e saj.

52. W04842. Që të dy ekipet e Mbrojtjes kundërshtuan besueshmërinë e dëshmitarit W04842 të ZPS-së, Miro Jukiq ("z. Jukiq").<sup>84</sup> ZPS-ja i hodhi poshtë këto pretendime.<sup>85</sup>

53. Në veçanti, Mbrojtja kundërshtoi dëshminë e z. Jukiq në lidhje me pikat në vijim: (i) mospërputhjet në datat e shënimeve për kontaktet që ai përpiloi në lidhje me intervistat me dëshmitarët pas ngjarjeve të përfshira në Aktakuzë;<sup>86</sup> (ii) ekzistencën e

---

<sup>81</sup> *Shih p.sh.* W04842 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1056, 1059, 1062, 1064, 1069-1070, 1127, 1129, 1132-1133, 1142, 1144-1145; Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1321; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3653-3657, 3693-3694; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 79, 270-271, 310, 320-322, 324, 326, 328, 351, 356, 358-359, 515; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 87(a), 107. *Shih gjithashtu* F439, para. 92(a); F440, para. 151-152. *Shih gjithashtu* F439/RED; F440/RED.

<sup>82</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 136-137.

<sup>83</sup> *Shih më poshtë* para. 331-381, 382-423, 424-458 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>84</sup> *Shih p.sh.* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 33, 72, 135, 143-151, 153-157, 159-161, 172-176, 239-243; Transkripti, 15 mars 2021, f. 3618-3625, 3694; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1860, 1880-1881, 1892; F440, para. 46.

<sup>85</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 136, 140. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2021, f. 3469-3474.

<sup>86</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1864-1869, 1877-1878, 1899; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3621-3625. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 373.

zyrës rajonale të ZPS-së në Prishtinë;<sup>87</sup> (iii) praninë e pretenduar të tij në një takim, edhe pse kjo nuk përmendet në shënimin për kontaktin lidhur me atë takim;<sup>88</sup> (iv) numrin e dëshmitarëve që ZPS-ja thirri pas ngjarjeve të përfshira në Aktakuzë;<sup>89</sup> (v) numrin e dëshmitarëve që deklaruan se ishin kërcënuar drejtpërdrejt gjatë ose pas ngjarjeve të paraqitura në Aktakuzë;<sup>90</sup> (vi) shpjegimin e z. Jukiq lidhur me disa biseda që kishte pasur me dëshmitarë pas ngjarjeve të përfshira në Aktakuzë;<sup>91</sup> (vii) numrin e dëshmitarëve që ishin objekt i zhvendosjes;<sup>92</sup> dhe (viii) kohën që z. Jukiq kaloi duke u marrë me pasojat e veprimeve të të akuzuarve.<sup>93</sup>

54. Trupi Gjykses do të trajtojë shkurtimisht më poshtë tri kundërshtimet e para të parashtruara më sipër. Kundërshtimet e tjera shtjellohen më në hollësi në Pikën 6.<sup>94</sup>

55. Sa u përket mospërputhjeve të datave në shënimet për kontaktin, Trupi Gjykses vë në dukje se z. Jukiq shpjegoi se mospërputhjet midis kohës së mbajtjes së shënimeve dhe datave në to ishin për shkak të gabimeve të shtypit,<sup>95</sup> vonesave në përfshirjen e shënimeve në *Zylab*<sup>96</sup> ose mënyrave të ndryshme të shënimit të datës.<sup>97</sup> Z. Jukiq

<sup>87</sup> *Shih p.sh.* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3469.

<sup>88</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 236; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3625. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1749-1750.

<sup>89</sup> *Shih p.sh.* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 237.

<sup>90</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 146-147, 153-159, 238; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3609-3611. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1834.

<sup>91</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 144; *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3621-3622; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1703-1706, 1758-1759; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1833, 1880-1881.

<sup>92</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 170, 173-175, 371-372. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1888-1889; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3618-3621.

<sup>93</sup> *Shih* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 70-71, 88; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1823-1824. *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3609, 3626.

<sup>94</sup> *Shih më poshtë* para. 536-541 (Pika 6).

<sup>95</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1729; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1843, 1847-1848, 1853.

<sup>96</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1725-1727; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1843-1844, 1847-1849, 1852-1854, 1857-1860, 1862, 1864.

<sup>97</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1845-1846.



gjithashtu bëri të qartë se vendosja e datës në shënime në një periudhë të mëvonshme nuk përbënte ndryshim të *thelbit* të atyre shënimeve.<sup>98</sup>

56. Sa i përket pretendimit të Mbrojtjes së Haradinajt se dëshmia e z. Jukiq në lidhje me ekzistencën e zyrës rajonale të ZPS-së në Prishtinë ishte e pavërtetë, bazuar në një përgjigje që z. Jukiq i dha Mbrojtjes së Gucatit,<sup>99</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Haradinajt zgjodhi që të mos i bënte pyetje z. Jukiq në atë kohë.<sup>100</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se z. Jukiq deklaroi qartë kur u mor në pyetje prej Mbrojtjes së Gucatit, se punonjësit e ZPS-së nuk kanë pasur “zyrë”, “përfaqësues zyrtarë të përhershëm atje”.<sup>101</sup> Trupi Gjykses rrjedhimisht konstaton se dëshmia e z. Jukiq në lidhje me këtë pikë është e besueshme.

57. Sa i përket pranisë së pretenduar të tij në një takim pavarësisht se në shënimin për kontaktin lidhur me atë takim nuk përmendet prania e tij, Trupi Gjykses vë në dukje se shënimi nuk u paraqit për t’u pranuar si provë për vërtetësinë e përmbajtjes së tij.<sup>102</sup> Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se shënimi për kontaktin nuk ishte përpiluar nga z. Jukiq dhe përpiluesi i shënimit nuk u thirr si dëshmitar. Sido që të jetë, duke marrë parasysh se z. Jukiq në atë kohë ishte punonjës për sigurinë e dëshmitarëve,<sup>103</sup> Trupi Gjykses konsideron se do të ishte krejtësisht e logjikshme që ai të ishte i pranishëm në ato takime edhe pa u regjistruar prania e tij.

58. Për arsyet e lartpërmendura dhe të atyre të paraqitura në pjesët përkatëse të Aktgjykimit,<sup>104</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar se dëshmia e z. Jukiq është provuese dhe

---

<sup>98</sup> *Shih p.sh.* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1848-1849.

<sup>99</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 136, 241; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1776-1777.

<sup>100</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1899-1900. Mbrojtja e Haradinajt mori në pyetje shkurtimisht z. Jukiq më 15 dhjetor 2021, për tema që nuk lidheshin me temën aktuale.

<sup>101</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1776-1777.

<sup>102</sup> ERN 084247-084248 RED.

<sup>103</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1690.

<sup>104</sup> *Shih më poshtë* para. 536, 540 (Pika 6).

përgjithësisht e përputhshme në thelb. Trupi Gjykses bindet se mospërputhjet në dëshminë e tij, në rast se ka të tilla, nuk janë rezultat i pavërtetësisë dhe njëanshmërisë. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se të dy ekipet e Mbrojtjes u mbështetën në dëshminë e z. Jukiq, kur e konsideronin atë të favorshme.<sup>105</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka konstatuar se z. Jukiq është i besueshëm dhe dëshmia e tij e mbështetshme.

59. W04866. Gjatë dëshmisë së tij, z. Haradinaj e kundërshtoi dëshminë e z. Berisha dhe tha se asnjëherë nuk i kishte kërkuar z. Berisha që të bënte kopje të dokumenteve për gazetarët e tjerë gjatë konferencës për shtyp të mbajtur më 7 shtator 2020.<sup>106</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Haradinajt nuk e kundërshtoi z. Berisha gjatë marrjes në pyetje në lidhje me përshkrimin e tij se çfarë i kishte thënë z. Haradinaj.<sup>107</sup> ZPS-ja parashtrroi se z. Berisha ishte bashkëpunues dhe bëri përshkrim asnjans të ngjarjeve.<sup>108</sup> Trupi Gjykses konstaton se dëshmia e z. Haradinaj në lidhje me këtë aspekt nuk shërben për asgjë dhe se nuk është e besueshme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e pranon dëshminë e z. Berisha lidhur me këtë pikë si të besueshme.

60. W04876. Që të dy ekipet e Mbrojtjes e kundërshtuan besueshmërinë e dëshmitarit W04866 të ZPS-së, Daniel Moberg ("z. Moberg"), duke theksuar mungesën e kujtesës së tij lidhur me kronologjinë e ngjarjeve.<sup>109</sup> Sipas ZPS-së, pranimi nga z. Moberg i kufizimeve të kujtesës së tij, e bënë dëshminë e tij edhe më të mbështetshme.<sup>110</sup> Gjatë vlerësimit të provave në lidhje me tri operacionet e sekuestrimit, Trupi Gjykses mori

---

<sup>105</sup> *Shih p.sh.* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 137, 163, 178-179, 462, 523; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3603, 3605, 3607 (Mbrojtja e Gucatit).

<sup>106</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2733; 2D1, para. 60. *Shih gjithashtu* W04866 (Halil Berisha) Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1522.

<sup>107</sup> *Shih*, në veçanti, Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1634-1635.

<sup>108</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 136, 138-139.

<sup>109</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3586; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3671, 3688-3689, 3693; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 283. *Shih gjithashtu* W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1945, 1947-1948, 1950-1951, 1955.

<sup>110</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 136, 141.

parasysh kujtesën e kufizuar të z. Moberg,<sup>111</sup> dhe ka konstatuar se ajo nuk ndikoi në besueshmërinë e tij si dëshmitar ose në mbështetjen në dëshminë e tij.

61. DW1241, DW1242, DW1243, DW1244. Sa u përket dëshmitarëve të Mbrojtjes së Gucatit DW1241, Taibe Miftari (“z. Miftari”), DW1242, Elmedina Ballhazhi (“z. Ballhazhi”), DW1243, Pren Marashi (“z. Marashi”) dhe DW1244, Metush Kryeziu (“z. Kryeziu”), ZPS-ja parashtrroi se anësia e theksuar në favor të të akuzuarve dhe njohuritë e pakta të tyre për lidhjen me akuzat, cenuan mbështetshmërinë e dëshmive të tyre.<sup>112</sup> Gjatë vlerësimit të dëshmive të këtyre dëshmitarëve, Trupi Gjykses mori parasysh lidhjen e tyre të afërt me të akuzuarit dhe mendimet e tyre për ngjarjet që përmenden në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykses ka konstatuar se pjesë të dëshmive të tyre janë përgjithësisht të besueshme, në veçanti sa i përket përshkrimit të kronologjisë së ngjarjeve që përbëjnë historikun e kësaj çështjeje.<sup>113</sup>

62. DW1245. ZPS-ja kundërshtoi besueshmërinë e dëshmitarit DW1245 të Mbrojtjes së Gucatit, Çelë Gashit (“z. Çelë Gashi”), duke argumentuar se ai e ndryshoi dëshminë lidhur me kohën që shpenzoi duke këqyrur materialin “për t’i mbështetur më mirë argumentet e Mbrojtjes”.<sup>114</sup> Trupi Gjykses pajtohet me ZPS-në dhe gjykon se dëshmia e z. Çelë Gashi lidhur me këtë çështje ishte e pavërtetë, sepse binte ndesh me shumë versione të asaj kohe të dhëna nga të akuzuarit lidhur me kohën e shpenzuar për këqyrjen e materialit përkatës, si edhe me deklaratën me shkrim të dhënë më parë prej tij.<sup>115</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses ka konstatuar se pjesë të kufizuara të dëshmisë së z.

---

<sup>111</sup> *Shih më poshtë* para. 318, 322 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>112</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 147-148.

<sup>113</sup> *Shih më poshtë* para. 208, 210, 244-245, 275-276 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>114</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 147. *Shih gjithashtu* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2583-2584, 2591-2598, 2603-2604, 2606-2607.

<sup>115</sup> 1D9, para. 14.

Çelë Gashi janë të besueshme, konkretisht përshkrimi i kronologjisë dhe rrethanave të përgjithshme të disa ngjarjeve që përbëjnë historikun e kësaj çështjeje.<sup>116</sup>

63. DW1246, DW1252. Sa u përket dëshmitarëve DW1246, Rashit Qalaj (“z. Qalaj”) dhe DW1252, Ana Majers [Anna Myers] (“znj. Majers”) të Mbrojtjes së Haradinajt, ZPS-ja argumentoi se, ndër të tjera, ata nuk dinin “asgjë me rëndësi” në lidhje me çështjen.<sup>117</sup> Trupi Gjykses ka konstatuar se të dy dëshmitarët ishin përgjithësisht të besueshëm dhe u mbështet në disa aspekte të dëshmive të tyre që kishin lidhje me shqyrtimin nga Trupi Gjykses të argumenteve mbrojtëse të ngritura në këtë çështje.<sup>118</sup>

64. DW1253. ZPS-ja gjithashtu kundërshtoi dëshminë e dëshmitarit ekspert DW1253, Robert Rid [Robert Reid] (“z. Rid”) të Mbrojtjes së Haradinajt mbi bazën se, ndër të tjera, atij nuk iu dha informacioni i nevojshëm për të vlerësuar hetimin e ZPS-së dhe nuk e shqyrtoi siç duhej informacionin që mori.<sup>119</sup> Duke marrë parasysh se Mbrojtja e Haradinajt nuk ia paraqiti në kohë Trupit Gjykses kërkesat për t’i dhënë qasje z. Rid në provat përkatëse,<sup>120</sup> Trupi Gjykses ngurron të shprehet se ky dëshmitar nuk ishte në gjendje ta shqyrtonte siç duhej informacionin që përfundimisht e mori. Gjithashtu, z. Rid ishte i gatshëm ta ndryshonte ose cilësonte dëshminë e tij kur iu dha informacion shtesë lidhur me disa aspekte përkatëse të analizës së tij. Sido që të jetë, Trupi Gjykses ka konstatuar se z. Rid është i besueshëm dhe pjesë të dëshmisë së tij janë të mbështetshme, në veçanti përshkrimi dhe analiza e praktikave në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) në lidhje me mbledhjen e provave dhe kujtimet e tij lidhur me frikësimin e dëshmitarëve në Kosovë.<sup>121</sup>

---

<sup>116</sup> *Shih më poshtë* para. 211, 243-245 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>117</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 149.

<sup>118</sup> *Shih më poshtë* para. 827, 830, 848, 867 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>119</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3259-3266, 3250-3354; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 150-152.

<sup>120</sup> F529/COR, para. 25-26.

<sup>121</sup> *Shih më poshtë* para. 577-578 (Pika 3), 646 (Pika 1).

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

#### A. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

65. Në bazë të neneve 6(2), 15(2), 16(3) dhe 64 të Ligjit, në gjykimin e kësaj çështjeje Trupi Gjykses zbatoi nenet 17, 28, 31, 32, 33, 35, 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së.<sup>122</sup>

66. Në interpretimin e këtyre dispozitave, Trupi Gjykses u kushtoi vëmendjen e duhur konstatimeve përkatëse të Gjykatësit të Procedurës Paraprake<sup>123</sup>. Këto konstatime janë plotësisht të arsyetuara dhe nuk kanë qenë objekt i asnjë kërkesë për apel.

67. Në funksion të sqarimit ose interpretimit të këtyre dispozitave, Trupi Gjykses ka mbajtur gjithashtu parasysh dispozitat përkatëse të KPK-së që nuk janë të zbatueshme në Dhomat e Specializuara, si dhe vendime të gjykatave të Kosovës. Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh Komentarin e Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012, Ligjit nr. 04/L-082 ("KPK i vitit 2012"), me autorë *Salihun dhe të tjerët*, si një burim informues, por jo domosdoshmërisht bindës, për interpretimin e të gjitha aspekteve përkatëse.

#### B. SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS SIPAS NENIT 392(1) TË KPK-SË

68. Në nenin 392(1) të KPK-së thuhet:

Kushdo që pa autorizim zbulon informata për të cilat është njoftuar në procedurën zyrtare, që sipas ligjit nuk mund të zbulohen apo ato informata janë shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

---

<sup>122</sup> Nenet 6(2), 15(2) dhe 16(3) të Ligjit i referohen KPP-së së vitit 2012, Ligji nr. 04/L-082. Veprat penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së janë të ngjashme me veprat përkatëse sipas neneve 395, 396, 400 dhe 409 të KPK-së të vitit 2012. *Shih* F147, *Vendim mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes*, para. 28-34. *Shih gjithashtu* F147/RED.

<sup>123</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit. *Shih gjithashtu* F74/RED.

## 1. Elementet materiale

69. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së, nevojiten këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) zbulimi i paautorizuar i (ii) informacionit të nxjerrë në procedura zyrtare (iii) që sipas ligjit nuk duhet zbuluar dhe që është shpallur si i fshehtë me vendim të gjykatës apo të një autoriteti kompetent.<sup>124</sup>

### (a) Parashtrimet e palëve

70. Mbrojtja e Gucatit parashtron se: (i) autorizimi buron nga interesi publik;<sup>125</sup> (ii) informacioni duhet t'i jetë bërë i ditur kryesit në një procedurë zyrtare;<sup>126</sup> dhe (iii) klasifikimi i informacionit si "sekret" dallon nga klasifikimi si "konfidencial".<sup>127</sup> Mbrojtja e Haradinajt i përsërit dhe bashkohet me këto argumente.<sup>128</sup>

71. ZPS-ja parashtron se: (i) interesi publik nuk jep automatikisht autorizim për të nxjerrë informacion;<sup>129</sup> (ii) nuk është kusht që informacioni t'i jetë dhënë kryesit në procedurë zyrtare;<sup>130</sup> (iii) hetimet e prokurorisë përfshihen në "procedurat zyrtare";<sup>131</sup> (iv) informatat që "sipas ligjit nuk mund të zbulohen" përfshijnë të gjithë informacionin e mbrojtur sipas kornizës ligjore të DHS-së;<sup>132</sup> (v) nuk është e nevojshme që informacioni të jetë shpallur "sekret" sipas Ligjit 03/L-178;<sup>133</sup> dhe (vi) neni 392(1) i KPK-së nuk vendos kufizime për mënyrën se si zbulohet informacioni.<sup>134</sup>

---

<sup>124</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 34.

<sup>125</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3648-3649; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 653; para. 20-22.

<sup>126</sup> F439, para. 78.

<sup>127</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 68; F439, para. 76.

<sup>128</sup> F342, para. 8, 10-11; F439, para. 11, 41.

<sup>129</sup> F341, para. 28.

<sup>130</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3435; F447, para. 55. *Shih gjithashtu* F447/RED.

<sup>131</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3435; F447, para. 55.

<sup>132</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3434; F565, Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 234; F341, para. 29; F447, para. 54.

<sup>133</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3434.

<sup>134</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3429.

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

72. Trupi Gjykses konstaton se zbulimi i informacionit mund të përfshijë afishimin, publikimin, transmetimin ose shpërndarjen publike të materialit, në original ose në formë të kopjuar/incizuar, citimin, përshkrimin, ose përmendjen e përmbajtjes së materialit, si dhe vënien e materialit në dispozicion të të tjerëve për të mundësuar leximin, kopjimin ose incizimin e materialit apo të përmbajtjes së tij prej tyre.<sup>135</sup>

73. Gjithashtu, Trupi Gjykses gjykon se zbulimi i informacionit është bërë “pa autorizim” nëse nuk është e lejuar me ligj apo me vendim të gjykatës apo të autoritetit kompetent.<sup>136</sup> Neni 392(1) i KPK-së nuk përcakton shprehimisht asnjë arsye mbi bazën e së cilës do të autorizohej zbulimi i informacionit. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses do të trajtojë lidhjen, nëse ka, ndërmjet pretendimit të interesit publik të paraqitur nga Mbrojtja dhe kësaj dispozite në diskutimin lidhur me Pikën 5 dhe me argumentet mbrojtëse.

74. Sa i përket çështjes nëse informacioni duhet të jetë nxjerrë zyrtarisht në kontekstin e procedurës zyrtare, Trupi Gjykses thekson se, në përputhje me KPK-në dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”), hetimet e prokurorisë përfshihen në kuadrin e “procedurës penale”, e cila përfshihet në përkufizimin e “procedurës zyrtare”.<sup>137</sup> Rrjedhimisht, në kuptim të nenit 392(1) të KPK-së,<sup>138</sup> hetimet e ZPS-së cilësohen si “procedurë zyrtare”. Për këtë arsye, termi “nxjerrje” duhet të interpretohet se përfshin informacionin e shkëmbyer brenda TFHS-së/ZPS-së për hetim dhe ndjekje penale, si dhe informacionin e shkëmbyer midis TFHS-së/ZPS-së dhe homologëve të tyre gjatë bashkëpunimit me ta për hetimin. Ky term mund t’u referohet edhe llojeve të tjera të komunikimit zyrtar të informacionit gjatë procedurës paraprake, gjatë gjykimit ose

---

<sup>135</sup> *Shih*, ndonëse me më pak hollësi, F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 35.

<sup>136</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 35.

<sup>137</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 36.

<sup>138</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 36.

apelit, si dëshmime të dëshmitarëve, provave të paraqitura nga palët, ose përmbajtjes së parashtrimeve të protokolluara që i paraqiten panelit kompetent.

75. Për sa i përket pyetjes nëse duhet që informacioni t'i bëhet i ditur *kryesisht* gjatë procedurës zyrtare, Trupi Gjykses thekson se nuk ka asgjë në formulimin e nenit 392(1) të KPK-së që të sugjerojë ekzistencën e një kriteri të tillë. Një konstatim i ndryshëm nga ky do të thotë se një person i cili dëgjon, ose rastësisht vihet në zotërim ose i tregohet një informacion i mbrojtur i cili është nxjerrë në një procedurë zyrtare, nuk ka detyrimin sipas nenit 392(1) të KPK-së që të mos e zbulojë më tej informacionin, pasi atij ose asaj informacioni nuk i është dhënë zyrtarisht. Ky interpretim është në mospërputhje me kuptimin e drejtpërdrejtë të dispozitës dhe, nëse pranohet, do t'i mundësonte kujtdo tjetër përveç personit të parë që e mori informacionin, që të ishte jashtë fushëveprimit të ligjit. Një interpretim i tillë do të ishte në kundërshtim me vetë qëllimin e dispozitës që është mbrojtja e fshehtësisë së procedurës.

76. Sa i takon llojit të informacionit, Trupi Gjykses sqaron se neni 392(1) i KPK-së u referohet dy llojeve të informacionit të nxjerrë në çfarëdo procedure zyrtare: (i) informacionit "që sipas ligjit nuk duhet të zbulohet" dhe (ii) informacionit që "është shpallur si fshehtësi me vendim të gjykatës apo të organit kompetent".

77. Lloji i parë përfshin informacionin lidhur me të cilin ekziston një ligj ose dispozitë në ligj që, ose: (i) ndalon shprehimisht nxjerrjen e atij informacioni, ose (ii) e kategorizon, klasifikon ose përshkruan informacionin në një mënyrë që parandalon në mënyrë të nënkuptuar nxjerrjen e tij. Në kuadër të kornizës ligjore të DHS-së, neni 62(1) i Ligjit parashikon që, duke pasur parasysh rrethanat e sigurisë dhe privatësisë, dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës Administrative dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar "nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës" dhe se "nuk ekziston e drejta e përgjithshme për të



pasur qasje” në to.<sup>139</sup> Kjo dispozitë e klasifikon të gjithë dokumentacionin e DHS-së dhe ZPS-së si jopublik dhe përshkruan se përgjithësisht publiku nuk ka qasje në të. Në këtë mënyrë, neni 62(1) i Ligjit përcakton një kufizim të përgjithshëm për qasjen në dokumentacionin e DHS-së dhe ZPS-së, që rezulton në ndalimin e nxjerrjes së tij. Neni 62(2) i Ligjit e konfirmon më tej këtë ndalim duke vënë në dukje se qasja në këto të dhëna miratohet (i) përmes paraqitjes së kërkesës dhe (ii) vetëm nëse një qasje e tillë (iii) është në interes të drejtësisë dhe mbron dhe ruan konfidencialitetin dhe mbrojtjet që u sigurohen personave nga DHS-ja ose ZPS-ja.

78. Lloji i dytë përfshin informacionin të cilin gjykata ose autoriteti kompetent e ka shpallur të fshehtë. Neni 392(1) i KPK-së nuk i përshkruan nocionet “gjykatë” apo “autoritet kompetent”. Trupi Gjykoës konsideron se këto i referohen çdo autoriteti gjyqësor apo autoriteti tjetër të cilit i është dhënë me ligj kompetenca për ta shpallur një informacion si të fshehtë, çka përfshin detyrimisht gjykatat penale dhe autoritetet prokuroriale. Termi “fshehtësi” këtu përdoret në kuptimin e tij të përgjithshëm, që do të thotë se informacioni nuk mund t’u jepet personave të paautorizuar. Këtë e vërteton edhe titulli i dispozitës, i cili i referohet “fshehtësisë” së procedurës, pra pjesëve jopublike ose të mbrojtura të procedurës.<sup>140</sup> Shprehja “shpallur [...] me vendim” i referohet çdo veprimi të ndërmarrë nga një autoritet kompetent, nëpërmjet të cilit informacioni shpallet, deklarohet, përshkruhet, shënjohe ose trajtohet si i fshehtë në përmbushjen e funksioneve të atij autoriteti.<sup>141</sup> Në kuadër të kornizës ligjore të DHS-së, një panel kompetent mund të urdhërojë masa për mbrojtjen e informacionit në përputhje me, ndër të tjera, nenet 23, 39(11), 40(6)(d), 54(8), 58, 62(2) të Ligjit, rregullat

---

<sup>139</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 37(a).

<sup>140</sup> Neni 392(1) i KPK-së përdor termat “fshehtësi” dhe “i/e fshehtë” në të njëjtën mënyrë si në nenet 85(1)-(2), 95(1), 236(2)-(4) dhe 473(1) të KPPK-së. Ai nuk u referohet “sekreteve shtetërore”, “sekreteve zyrtare”, “sekreteve tregtare” apo “sekreteve afariste” të parashikuara edhe në dispozitat e tjera të KPK-së.

<sup>141</sup> *Shih* përkufizime të ndryshme të termit “shpall” (“declare”) në gjuhën angleze në *OED Online*, Oxford University Press, March 2022, <[www.oed.com/view/Entry/48260](http://www.oed.com/view/Entry/48260)>, parë më 13 maj 2022.

82, 105, 108 të Rregullores, ose me çfarëdo dispozite tjetër të zbatueshme.<sup>142</sup> Ligji dhe Rregullorja gjithashtu i mundësojnë ZPS-së të zbatojë, me kërkesë të saj, masa mbrojtëse në përputhje me, ndër të tjera, nenet 35(2)(f) dhe 54(8) të Ligjit, rregullat 30(2)(a), 82, 106, 107(1) të Rregullores ose çfarëdo dispozitash të tjera të zbatueshme.<sup>143</sup> Kompetenca e DHS-së dhe ZPS-së për të urdhëruar ose miratuar masa mbrojtëse konfirmohet gjithashtu nga neni 61(3)-(4) i Ligjit. Sipas kësaj dispozite, kur dokumentacionit ose informacionit i është dhënë statusi konfidencial i mbrojtur nga DHS-ja ose ZPS-ja, ai mund të jepet vetëm me urdhër të panelit ose me pëlqimin e Prokurorit të Specializuar.

79. Trupi Gjykes më tej thekson se prova që një informacion i caktuar nuk mund të zbulohet sipas ligjit ose është shpallur i fshehtë me vendim të një gjykate apo autoriteti kompetent, zakonisht është pjesë e vetë aktit, i cili, ndër të tjera, mund të jetë në formën e një ligji ose dokumenti tjetër legjislativ, urdhri gjyqësor ose dokumenti zyrtar të një autoriteti kompetent.

## 2. Elementet mendore

80. Në nenin 21 të KPK-së thuhet:

1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai ose ajo pranon shkaktimin e saj

81. Vepra penale e zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur duhet të kryhet me dashje [synim], në kuptimin e nenit 21 të KPK-së.<sup>144</sup>

---

<sup>142</sup> F74Vendimi i Konfirmimit, para. 37(b).

<sup>143</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 37(c).

<sup>144</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 38.

(a) Parashtrimet e palëve

82. Mbrojtja e Gucatit parashtron se për të dyja format e synimit, kryesi duhet të ketë “dijeni” se informacioni ishte i fshehtë.<sup>145</sup> Mbrojtja e Haradinajt i përsërit këto argumente dhe shton se interpretimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake është tepër i gjerë.<sup>146</sup>

83. ZPS-ja parashtron se për këtë vepër penale mjafton synimi i drejtpërdrejtë ose eventual, që do të thotë se mjafton të veprohet me vetëdijen se mund të zbulohet informacion i fshehtë edhe pa pasur dijeni faktike për të.<sup>147</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykues

84. Trupi Gjykues konstaton se, në përputhje me nenin 21 të KPK-së, për veprën penale sipas nenit 392(1) të KPK-së duhet të provohet një prej këtyre elementeve mendore (*synimi kriminal*): synimi i drejtpërdrejtë ose eventual.

85. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për të zbuluar, pa autorizim, informacion të mbrojtur të nxjerrë gjatë procedurës zyrtare, i cili sipas ligjit nuk duhet të zbulohet ose është shpallur si i fshehtë.<sup>148</sup>

86. Për synimin eventual, kryesi duhet: (i) të ketë vepruar me vetëdijen se si pasojë e veprimeve të tij ose të saj, mund të zbulohet pa autorizim informacion i mbrojtur i nxjerrë gjatë procedurës zyrtare, i cili sipas ligjit nuk duhet të zbulohet ose është shpallur si i fshehtë; dhe (ii) kryesi pajtohet me pasojën.<sup>149</sup>

---

<sup>145</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 652-653; F439, para. 80.

<sup>146</sup> F342, para. 9.

<sup>147</sup> F341, para 30.

<sup>148</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 39.

<sup>149</sup> Në përgjithësi, Vendimi i Konfirmimit, para. 40.

## C. SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS SIPAS NENIT 392(2) DHE (3) TË KPK-SË

87. Në nenin 392(2) të KPK-së thuhet:

Kushdo që pa autorizim zbulon të dhëna për identitetin apo të dhënat personale të personit të mbrojtur në procedurë penale apo në programin e veçantë të mbrojtjes, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

88. Në nenin 392(3) të KPK-së thuhet:

Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni rezulton me pasoja të rënda për personin e mbrojtur ose procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet në masë të madhe, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet

### 1. Elementet materiale

89. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së, nevojiten këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) zbulimi i paautorizuar i (ii) informacionit për identitetin ose të dhënat personale të (iii) personit të marrë në mbrojtje në një procedurë penale ose në një program të posaçëm mbrojtjeje.<sup>150</sup>

(a) Parashtrimet e palëve

90. Mbrojtja e Gucatit parashtron se: (i) të dhënat personale të ofruara nga palë të treta nuk janë të mbrojtura sipas nenit 392(2) të KPK-së;<sup>151</sup> (ii) informacioni duhet të jetë i një personi të marrë në mbrojtje në procedurën penale në të cilën informacioni i është bërë i ditur kryesisht;<sup>152</sup> dhe (iii) informacioni duhet të jetë i një personi të marrë në “mbrojtje” në kohën e kryerjes së veprës penale të pretenduar.<sup>153</sup> Mbrojtja e Haradinajt i përsërit këto argumente.<sup>154</sup>

---

<sup>150</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 41.

<sup>151</sup> F345, para. 10-11.

<sup>152</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 81; F439, para. 86.

<sup>153</sup> F439, para. 89.

<sup>154</sup> F342, para. 14-15.

91. ZPS-ja parashtron se: (i) të dhënat personale që janë në letërkëmbimin konfidencial me palët e treta janë të mbrojtura;<sup>155</sup> (ii) nuk është kusht që kryesi të jetë pjesë e së njëjtës procedurë penale si dëshmitari;<sup>156</sup> dhe (iii) dijenia e publikut se një individ është dëshmitar nuk e ndryshon statusin e tij të mbrojtur.<sup>157</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

92. Trupi Gjykses thekson se kjo vepër penale përbën një formë të zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur sipas nenit 392(1) të KPK-së dhe ndëshkohet me dënim më të rëndë.<sup>158</sup> Për rrjedhojë, konstatimet sipas nenit 392(1) të KPK-së për këtë nënkategori zbatohen *mutatis mutandis*, përveç nëse Trupi Gjykses vendos ndryshe.<sup>159</sup>

93. Sa u përket veprimit të zbulimit të paautorizuar të informacionit, kuadrit të “procedurës penale” dhe aspektit të së nxjerrjes së informacionit për kryesin, në dallim nga nxjerrja e informacionit për persona të tjerë, Trupi Gjykses u referohet konstatimeve të veta të bëra më lart.<sup>160</sup>

94. Për sa i takon personit të mbrojtur, Trupi Gjykses sqaron se neni 392(2) i KPK-së u referohet dy llojeve të personave: (i) atyre “të mbrojtur në procedurë penale”; dhe (ii) atyre “në programin e veçantë të mbrojtjes”.

95. Lloji i parë përfshin personat të cilët ligji i konsideron të mbrojtur, si edhe ata për të cilët është dhënë urdhër apo miratuar masë mbrojtëse në procedurë penale. Trupi Gjykses nënvizon se kushti për të qenë i mbrojtur në procedurë penale nuk kërkon domosdoshmërisht urdhër gjyqësor; ai mund t’i referohet edhe një statusi të mbrojtur të parashikuar me ligj (p.sh. për dëshmitarët e mitur ose dëshmitarët e tjerë të

---

<sup>155</sup> F341, para. 32; F447, para. 61.

<sup>156</sup> F447, para. 60.

<sup>157</sup> F447, para. 60.

<sup>158</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 42.

<sup>159</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 43.

<sup>160</sup> *Shih më lart* para. 73-74. F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 43.

cenueshëm) ose masave të zbatuara nga autoritetet e prokurorisë gjatë hetimeve të tyre. Në kornizën ligjore të DHS-së, ky kusht mund t'i referohet një urdhri për masa mbrojtëse të lëshuar nga një panel kompetent në përputhje me, ndër të tjera, nenet 23, 39(11), 40(6)(f), 58 të Ligjit, rregullat 80, 81, 105, 108 të Rregullores, ose ndonjë dispozitë tjetër ligjore përkatëse.<sup>161</sup> Ai mund t'u referohet edhe dispozitave konkrete të Ligjit dhe Rregullores që parashikojnë mbrojtjen e kategorive të veçanta të dëshmitarëve, siç është neni 23(2) i Ligjit. Ky kusht mund të përfshijë gjithashtu masat mbrojtëse të miratuara nga ZPS-ja gjatë hetimeve të saj, në përputhje me, ndër të tjera, nenin 35(2)(f) të Ligjit, rregullën 30(2)(a) të Rregullores ose dispozita të tjera ligjore të zbatueshme.<sup>162</sup> Në të njëjtën mënyrë, dhe në pajtim me nenin 62 të Ligjit, person "i mbrojtur në procedurë penale" mund të jetë edhe një person identiteti ose të dhënat personale të të cilit gjenden në dokumentet ose materialet e DHS-së ose ZPS-së, nxjerrja e të cilave nuk është autorizuar.<sup>163</sup>

96. Lloji i dytë përfshin personat që policia ose gjykata i ka përfshirë në programet e mbrojtjes. Në kornizën ligjore të DHS-së, në këtë kategori hyjnë të gjithë personat e përfshirë në programet e mbrojtjes së DHS-së ose ZPS-së

97. Rrjedhimisht, prova për statusin e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së, përfshirë informacionin për autoritetin që e urdhëron atë status apo kohëzgjatjen e masës, nëse është e kufizuar, është vetë akti (ligji, urdhri i gjykatës, dokumenti i autoritetit kompetent).

98. Sa i përket "identitetit" të personave të parashikuar në nenin 392(2) të KPK-së, Trupi Gjykses nënvizon se neni 392(2) i KPK-së nuk synon të mbrojë identitetet e personave *si të tillë*, por identitetet e tyre si dëshmitarë, viktima, persona për të cilët ka interes ose pjesëmarrës të tjerë në procedurën penale. Rrjedhimisht, fakti që identiteti

---

<sup>161</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 44(a).

<sup>162</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 44(b).

<sup>163</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 44(c).

i një personi dihet publikisht nuk mund të barazohet me zbulimin e identitetit të tij ose të saj si *“person i mbrojtur në procedurë penale”*. Gjithashtu, Trupi Gjykes konstaton se *“identiteti”* përfshin të dhëna të tilla si: mbiemri/mbiemrat, përfshirë edhe mbiemrin e vajzërisë apo emrin/emrat e mëparshëm, emrin/emrat dhe çfarëdo pseudonimi të mëparshëm apo të tanishëm.<sup>164</sup> *“Të dhënat personale”* të personave të parashikuar në nenin 392(2) të KPK-së përfshijnë të dhëna të tilla si: numri personal i identifikimit, data dhe vendi i lindjes, adresa ose vendbanimi i mëparshëm apo i tanishëm; lloji, vendi, koha dhe/ose kohëzgjatja e punësimit të mëparshëm ose të tanishëm; identiteti i anëtarëve të familjes; përkrahimi ose vendndodhja e pasurive të rëndësishme (shtëpia, vetura); dhe çdo e dhënë tjetër që mund të çojë në identifikimin e personit.<sup>165</sup>

99. Së fundi, Trupi Gjykes është i mendimit se, sikurse përcaktohet në nenin 392(2) të KPK-së, për formën bazë të kësaj vepre penale, nuk është kusht që zbulimi i paautorizuar të çojë në dëm apo në ndonjë pasojë tjetër ligjërish të ndaluar.<sup>166</sup>

100. Nga ana tjetër, neni 392(3) i KPK-së ndëshkon një formë të rëndë të kësaj vepre penale, kur (i) zbulimi i paautorizuar çon në pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së; ose (ii) procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet shumë.<sup>167</sup> Pasojat e rënda mund të përfshijnë cenimin thelbësor të sigurisë, mbrojtjes, mirëqenies, jetës private ose dinjitetit të personave të mbrojtur ose familjeve të tyre. Vështirësimi në masë të madhe ose pamundësimi i procedurës penale mund të përfshijë pamundësinë ose vështirësitë konkrete për mbledhjen e provave, ruajtjen e sigurisë së procedurës apo të dëshmitarëve, si edhe devijimin e konsiderueshëm të kapaciteteve për trajtimin e pasojave të tilla.<sup>168</sup>

---

<sup>164</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 45.

<sup>165</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 45.

<sup>166</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 46.

<sup>167</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 46.

<sup>168</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 46.

## 2. Elementet mendore

101. Vepra penale e zbulimit të paautorizuar të identitetit ose e të dhënave personale të personave të mbrojtur duhet të kryhet me dashje [synim], brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

### (a) Parashtrimet e palëve

102. Mbrojtja e Gucatit parashtron se kryesi duhet të ketë dijeni se informacioni është i një personi i cili është objekt i masave mbrojtëse konkrete në procedurë penale.<sup>169</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit këto argumente dhe shton se kryesi duhej të kishte ditur për ekzistencën e urdhrit dhe përmbajtjen e tij<sup>170</sup>

103. ZPS-ja parashtron se mjafton synimi eventual dhe se të njëjtët faktorë për elementet mendore sipas nenit 392(1) të KPK-së, vlejné për nenin 392(2).

### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

104. Trupi Gjykses konstaton se, në përputhje me nenin 21 të KPK-së, për veprën penale sipas nenit 392(2) të KPK-së duhet të provohet një prej këtyre elementeve mendore (*synimi kriminal*): synimi i drejtpërdrejtë ose eventual.<sup>171</sup>

105. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me dijeninë dhe dëshirën për të zbuluar pa autorizim informacion për identitetin ose të dhënat personale të personave të mbrojtur në procedurë penale ose në një program të posaçëm mbrojtjeje.<sup>172</sup>

106. Për synimin eventual, kryesi duhet (i) të ketë vepruar i vetëdijshëm se si pasojë e veprimeve të tij ose të saj, mund të zbulohet pa autorizim informacion për identitetin

---

<sup>169</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 653-654; F439, para. 90.

<sup>170</sup> F342, para. 17.

<sup>171</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 47.

<sup>172</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 48.



ose të dhënat personale të personave të mbrojtur në procedurë penale ose në një program të posaçëm mbrojtjeje dhe (ii) kryesi është pajtuar me këtë pasojë.<sup>173</sup>

107. Sa i përket formës së rëndë sipas nenit 392(3) të KPK-së, Trupi Gjykses, pasi ka marrë parasysh nenin 24 të KPK-së, konstaton se rrethanat rënduese duhet të jenë shkaktuar, më së paku, nga neglizhenca e kryesit, brenda kuptimit të nenit 23 të KPK-së.

#### **D. FRIKËSIMI GJATË PROCEDURËS PENALE SIPAS NENIT 387 TË KPK-SË**

108. Në nenin 387 të KPK-së thuhet:

Kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtion dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të përmbahet nga dhënia e deklaratës ose për të dhënë deklaratë të rreme, ose për të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacionet e tilla ndërliohen me pengimin e procedurës penale, dënohet me gjobë deri në njëqind e njëzet e pesëmijë (125.000) Euro dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

#### **1. Elementet materiale**

109. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale, brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së, duhet të ekzistojnë këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) përdorimi i forcës, kërcënimit të rëndë apo ndonjë mënyrë tjetër e detyrimit, premtimit të një dhurate, apo i ndonjë forme tjetër përfitimi (ii) kundër një personi që jep ose ka të ngjarë t'i japë deklaratë ose informacion policisë, prokurorit apo gjykatësit.<sup>174</sup>

---

<sup>173</sup> Vendimi i Konfirmimit, para. 49.

<sup>174</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 58.

(a) Parashtrimet e palëve

110. Mbrojtja e Gucatit parashtron se: (i) mosdhënia e informacionit duhet të jetë e lidhur me një vepër penale sipas nenit 386 të KPK-së;<sup>175</sup> (ii) nuk ka asnjë bazë për ta kufizuar formulimin “kur informacionet e tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale” vetëm për “të mos dhënë informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit”;<sup>176</sup> dhe (iii) për ekzistuar vepra penale duhet të provohet se është shkaktuar një pasojë.<sup>177</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit dhe pajtohet me argumentet e Mbrojtjes së Gucatit.<sup>178</sup>

111. ZPS-ja argumenton se: (i) nuk ka nevojë të provohet se është shkaktuar pasojë;<sup>179</sup> dhe (ii) kushti që informacioni duhet të jetë i lidhur me “pengimin e procedurës penale” vlen vetëm për rastet e mosdhënies së informacionit të vërtetë policisë, prokurorit apo gjykatësit.<sup>180</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

112. Trupi Gjykses konstaton se vepra penale sipas nenit 387 të KPK-së mund të kryhet vetëm me anë të një prej mënyrave të renditura në atë nen, d.m.th. përmes përdorimit të forcës, kërcënimit të rëndë, detyrimit, premtimit të një dhurate apo ndonjë forme tjetër përfitimi. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses ka një këndvështrim më të ngushtë se ai i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, konkretisht që neni 387 i KPK-së ndalon çdo sjellje që mund të ketë (ose që kryesi pret të ketë) pasojë ose ndikim në deklaratën ose në informacionin që do të jepet nga personi.<sup>181</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses

---

<sup>175</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3632; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 49.

<sup>176</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 44-51; F439, para. 58.

<sup>177</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3631-3632; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 43, 48; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 656-657; F439, para. 51.

<sup>178</sup> F342, para. 26-31; F440, para. 11, 30-31.

<sup>179</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3448; F447, para. 37.

<sup>180</sup> F447, para. 38.

<sup>181</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 59.

miraton përkufizimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me “forcën”, “kërcënimin e rëndë” dhe “detyrimin”.<sup>182</sup>

113. Për sa i takon personit që nxitet, Trupi Gjykses fillimisht thekson se titulli i nenit 387 të KPK-së është “Frikësimi gjatë *procedurës penale*” (theksimi i shtuar). Sikurse u konstatua më lart nga Trupi Gjykses, hetimet e prokurorisë janë pjesë e “procedurës penale”.<sup>183</sup> Rrjedhimisht, termi “person” i përdorur në nenin 387 të KPK-së duhet të interpretohet se përfshin jo vetëm “palët” në procedurë penale (d.m.th. prokurorinë dhe të akuzuarit), viktimat pjesëmarrëse ose dëshmitarët e thirrur para një Trupi Gjykses, por edhe çdo person tjetër dëshmia e të cilit kërkohet nga autoritetet e prokurorisë në kuadër të hetimeve të tyre.<sup>184</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se neni 387 i KPK-së i referohet “personit tjetër” që duhet të nxitet. Kjo do të thotë se ky person duhet të jetë i identifikueshëm ose si individ ose, të paktën, si anëtar i një kategorie individësh qartësisht të identifikueshëm. Sipas kornizës ligjore të DHS-së, një person që mund t’i japë dëshmi TFHS-së, ZPS-së dhe/ose një trupi gjykses të DHS-së për krime apo vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, është objekt i nenit 387 të KPK-së.<sup>185</sup>

114. Sa i përket cilësimit “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale”, Trupi Gjykses vë sërish në dukje fushëveprimin e dispozitës, siç pasqyrohet në titullin e saj, në shprehjen (“procedurës penale”), si dhe vendosjen dhe formulimin e cilësimit të lartpërmendur. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykses gjykon se shprehja “kur informacione të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale”

---

<sup>182</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 60: “Forca mund të përfshijë çdo formë të dhunës fizike apo të dehjes të ushtruar ndaj një personi. Kërcënimi i rëndë mund të përfshijë kërcënimet për të përdorur dhunë apo për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit, mirëqenies, sigurisë apo privatësisë të një personi. Detyrimi ka të bëjë me çdo veprim kufizimi apo shtrëngimi të një personi (poshtëshënimet nuk janë përfshirë në citim).

<sup>183</sup> *Shih më lart* para. 74 dhe poshtëshënimi 137.

<sup>184</sup> *Shih*, ndonëse me fushëveprim më të gjerë, F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 61.

<sup>185</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 61.

përshkruan alternativën e tretë, d.m.th. personin që nuk “jep informacione të vërteta pranë organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit” dhe, në çdo rast, ajo nuk e kufizon zbatimin e të gjithë dispozitës.<sup>186</sup>

115. Për sa i takon aspektit nëse për këtë vepër penale duhet të vërtetohet shkaktimi i pasojës, Trupi Gjykses konstaton se shprehja “kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze [...] për të nxitur” – nuk kërkon vërtetim të rezultatit. Neni 387 i KPK-së nuk kërkon që të provohet se forca apo kërcënimi i rëndë faktikisht e nxitën personin që të mos japë deklaratë, të japë deklaratë të rreme apo të mos japë informacion të vërtetë. Ky interpretim është plotësisht në pajtim me qëllimin e dispozitës, që është mbrojtja e të dhënave të dëshmitarëve dhe të dhënësve të tjerë të informacionit dhe, më në përgjithësi, mbrojtja e integritetit të procedurës penale përmes penalizimit të kryesit që synon të ushtrojë ndikim mbi një dëshmitar.<sup>187</sup>

## 2. Elementet mendore

116. Vepra penale e frikësimit, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së, duhet të kryhet me synim.

---

<sup>186</sup> Neni i barasvlershëm i Kodit të Përkohshëm Penal të vitit 2003 titullohej “Frikësimi gjatë procedurës penale për krimin e organizuar”. Shih UNMIK/REG/2003/25, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 6 korrik 2003, neni 310. Në tekstin e atij neni përfshihet formulimi “kur informacionet e tilla ndërlihen me kryerjen e krimit të organizuar”. Neni 395 i KPK-së të vitit 2012 nuk përmbante më asnjë referencë për krimin e organizuar; titulli i tij i referohej vetëm frikësimit gjatë procedurës penale dhe referenca për krimin e organizuar në tekst u zëvendësua me një referencë për pengimin e procedurës penale. Kjo u rivendos në nenin 387 të KPK-së.

<sup>187</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 62, që i referohet [Aktgjykimit në lidhje me Akuzat për Shpërfillje të Gjykatës](#), para. 21; [Aktgjykimi në lidhje me Akuzat për Shpërfillje të Gjykatës](#), para. 18; ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, Trial Chamber VII, [Public Redacted Version of Judgment pursuant to Article 74 of the Statute](#), ICC-01/05-01/13-1989-Red, 19 October 2016, paras 43, 48; *Prosecutor v. Bemba et al.*, Appeals Chamber, [Public Redacted Judgment on the appeals of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo, Mr Aimé Kilolo Musamba, Mr Jean-Jacques Mangenda Kabongo, Mr Fidèle Babala Wandu and Mr Narcisse Arido against the decision of Trial Chamber VII entitled “Judgment pursuant to Article 74 of the Statute”](#), ICC-01/05-01/13-2275-Red, 8 March 2018, para. 737.

## (a) Parashtrimet e palëve

117. Mbrojtja e Gucatit parashtron se frikësimi është një veprë penale që kryhet me një synim konkret.<sup>188</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit këto argumente.<sup>189</sup>

118. ZPS-ja parashtron se mjafton synimi standard, i drejtpërdrejtë ose eventual.<sup>190</sup>

## (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

119. Trupi Gjykses rikujton se neni 21 i KPK-së përcakton se vepra penale mund të kryhet me synim të drejtpërdrejtë ose eventual (*dashje/umišljaj*). Dispozita nuk përcakton nëse ndonjë veprë penale sipas KPK-së mund të kryhet vetëm me një rëndë ose tjetrën nga këto dy forma. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se KPK-ja nuk e njeh shprehimisht nocionin e “synimit konkret” ose “synimit të posaçëm” si një kategori të veçantë të synimit kriminal. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vëren se neni 22 i KPK-së njeh, ndër të tjera, “qëllimin” ( *në serbisht: namera*) si një element të veprave penale që mund të deduktohet nga rrethanat faktike. Megjithatë, neni 22 i KPK-së nuk përcakton nëse qëllimi ka të bëjë me të gjitha veprat penale apo vetëm me ato që janë kryer me synim të drejtpërdrejtë apo eventual. Duke iu kthyer tekstit të KPK-së, Trupi Gjykses vëren se asnjë nga dispozitat e tij nuk i referohet shprehimisht synimit të drejtpërdrejtë apo eventual. Në vend të tyre, KPK-ja përdor shpesh formulime të tilla si “me vetëdije”,<sup>191</sup> “me dashje”, “me qëllim”, “qëllimisht”<sup>192</sup> dhe “me qëllim të”<sup>193</sup>. Trupi Gjykses thekson se termat e përdorur në gjuhët shqipe ose serbe për këto formulime jo

<sup>188</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3633, 3715-3717; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 660, 672.

<sup>189</sup> F342, para. 32.

<sup>190</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3502; F341, para. 21.

<sup>191</sup> *Shih p.sh.*, nenet 218, 223, 235, 280(1)(4), 282(1)(2)-(4), 336(1)-(2), 383(1), 390(1) të KPK-së.

<sup>192</sup> *Shih p.sh.*, nenet 126(2), 128(6), 145(2)(1)-(4), 147(2)(1)-(4), 148, 158(3), 159(5), 160(4), 161(4), 167(1), 168(1), 169(2), 173(1)(5), (11), 184(1), 196(3), 231(1), 279(1), 290(2), 325(1), 414(3)(1)-(2), 415(1) të KPK-së.

<sup>193</sup> *Shih p.sh.*, nenet 134, 142, 162(1), 182(1), 248(1), 261(1), 267(1), 284(1), 292(1), 301(1), 313(1), 317(1), 323(1), 386(1), 388(1), 389(1) të KPK-së.

domosdoshmërisht pasqyrojnë termat e përdorur në gjuhën angleze.<sup>194</sup> Trupi Gjykses vëren gjithashtu edhe përdorimin e shprehjeve “[me qëllim] që të [folja]” për “[in order] to [verb]”,<sup>195</sup> “me qëllim të” për “with the aim of”<sup>196</sup> ose “me qëllim të” për “for the purpose of”.<sup>197</sup> Dy formulimet e fundit [në anglishte] nuk diferencohen në versionin në shqip të KPK-së, i cili për të dyja përdor frazën “me qëllim të”, që përfshin termin ligjor për “qëllimin”.<sup>198</sup> Në versionin në gjuhën serbe përdoren disa terma të ndryshme për të dyja.<sup>199</sup>

120. Duke pasur parasysh termat e papërcaktuara të nenit 21 të KPK-së dhe në mungesë të kufizimeve të përcaktuara shprehimisht në KPK në lidhje me zbatimin e synimit dhe qëllimit si elemente të veprës penale dhe duke marrë parasysh mënyrën si janë përdorur formulimet, shumica e Trupit Gjykses nuk mund të arrijë në përfundimin se ligjvënësi ka dashur të penalizojë vepra penale të caktuara vetëm nëse

<sup>194</sup> *Shih p.sh.*, në versionin në gjuhën shqipe, “knowingly” është “me vetëdije” (nenet 218, 223 të KPK-së), “me dijeni” (nenet 235, 280(1.4), 282(1.2-1.4), 383(1), 390(1) të KPK-së) ose “me dashje” (nenet 336(1)-(2) të KPK-së). “Intentionally” është “me dashje” (nenet 17, 27, 28, 32, 33, 126(2), 128(6), 158(3), 173(1.5), (1.11), 184(1), 196(3), 231(1), 279(1), 414(3.1-3.2) të KPK-së), “me vetëdije” (neni 415(1) i KPK-së) ose si “me qëllim” ose “qëllimisht” (nenet 145(2.1-2.4), 147(2.1-2.4), 148, 159(5), 160(4), 161(4), 167(1), 168(1), 169(2), 290(2), 325(1) të KPK-së). “With the intent to” është “me qëllim të”, që përfshin termin ligjor për “qëllimin” në versionin në gjuhën shqipe të nenit 22 të KPK-së. Në versionin në gjuhën serbe “knowingly” është “svesno” (nenet 218, 223, 235, 280(1.4), 282(1.2-1.4), 336(1)-(2), 383(1), 390(1) të KPK-së). “Intentionally” është “svesno” (nenet 126(2), 168(1), 173(1.11), 184(1), 279(1), 415(1) të KPK-së), “umišljajno” ose “smišljeno” (nenet 128(6), 196(3) të KPK-së), “namerno” (nenet 145(2.1-2.4), 147(2.1-2.4), 148, 158(3), 159(5), 160(4), 161(4), 167(1), 169(2), 231(1), 325(1), 414(3.1-3.2) të KPK-së) dhe “hotimično” (neni 290(2) i KPK-së). “With the intent to” është “u nameri”, që përfshin termin ligjor për “qëllimin” në versionin në gjuhën serbe të nenit 22 të KPK-së, ndonëse neni 248(1) i KPK-së përdor “sa ciljem” për të njëjtin term.

<sup>195</sup> *Shih p.sh.*, nenet 34, 164(2), 165(3), 168(4), 171(1), 181(1)-(2), 194(1), 233, 282(1.3), 283(2), 297, 309, 310, 387, 403 të KPK-së.

<sup>196</sup> *Shih p.sh.*, nenet 113(13), 119(1), 120, 121, 122, 123, 124(4), 128(6) të KPK-së.

<sup>197</sup> *Shih p.sh.*, nenet 113(15), 133(2), 137, 138(4), 154(1), 163(2), 164(10.1), 173(173(1.6-1.7)), 196(3), 199(3), 239(6) të KPK-së.

<sup>198</sup> *Shih p.sh.*, versioni në gjuhën shqipe të dispozitave të renditura në poshtëshënimet 70, 73 dhe 74. *Shih gjithashtu* neni 22 i KPK-së (versioni në gjuhën shqipe).

<sup>199</sup> Në versionin në gjuhën serbe “with the aim of” është “u cilju” ose “sa ciljem” (nenet 113(13) dhe 128(6) të KPK-së) dhe “u nameri” (nenet 119(1), 120, 121, 122, 123, 124(4) të KSC-së). “With the purpose of” është “sa ciljem” ose “u cilju” (nenet 113(2.15), 133(2), 173(1.6-1.7), 196(3), 239(6) të KPK-së), “u sorhu” (neni 137 i KPK-së) dhe “u nameri” (nenet 138(4), 154(1), 163(2), 164(10.1), 199(3) të KPK-së).

kryhen me synim të drejtpërdrejtë, apo të kërkojë ekzistencën e synimit të drejtpërdrejtë për çdo veprë penale që kryhet për një qëllim. Fakti që sisteme të tjera juridike përjashtojnë mundësinë që veprat penale me “synim konkret”, të kryhen me synim eventual, ose që një numër autorësh kanë shprehur mendimin se kështu duhet të jetë, nuk i mundëson këtij Trupi Gjykses t’i importojë parime të tilla në sistemin juridik të Kosovës, duke ndryshuar në këtë mënyrë dispozitat e KPK-së. Në fakt, shumica e Trupit Gjykses, mendon se neni 21 zbatohet pa dallim për të gjitha veprat penale të përmendura në KPK dhe pavarësisht nëse për një veprë penale nevojitet edhe qëllimi konkret. Forma e synimit për secilën veprë penale duhet të deduktohet nga provat në tërësi.

121. Sa i përket nenit 387 të KPK-së, Trupi Gjykses thekson praninë e frazës “për të nxitur”, e cila është interpretuar se pasqyron kriterin e “synimit të drejtpërdrejtë, konkret”.<sup>200</sup> Trupi Gjykses konstatoi më lart se shprehja “kushdo që përdor forcën apo kanosjen serioze [...] për të nxitur” nuk kërkon vërtetim të rezultatit.<sup>201</sup> Në fakt, shumica e Trupit Gjykses mendon se shprehja “për të nxitur” tregon ose dëshirën e kryesit sipas nenit 21(2) të KPK-së, ose pasojën e ndaluar të pranuar të veprimeve të tij ose të saj sipas nenit 21(3) të KPK-së.<sup>202</sup> Kjo konfirmohet nga fraza të ngjashme të përdorura në dispozita të tjera që penalizojnë veprat penale të sjelljes së paligjshme.<sup>203</sup>

122. Në përputhje me konstatimet e veta të mësipërme, shumica e Trupit Gjykses nuk gjykon se fraza “për të nxitur” kufizon formën e synimit të zbatueshëm për këtë veprë penale. Sipas nenit 387 të KPK-së, interpretuar në kuadër të nenit 21 të KPK-së, kryesi mund të dëshirojë të nxisë një person ose mund të jetë i vetëdijshëm se një person mund të nxitet si rezultat i veprimeve të kryesit, dhe pajtohet që kjo të ndodhë. Një përcaktim i ndryshëm nga ky do të nënkuptonte se çdo kryes që përdor me synim

---

<sup>200</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3716.

<sup>201</sup> *Shih më lart* para. 115.

<sup>202</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 62.

<sup>203</sup> *Shih p.sh.*, nenet 165(3), 171(1), 181(1)-(2), 194(1), 233, 283(2), 309, 310, 403 të KPK-së.

forcë ose kërcënim të rëndë ndaj dëshmitarëve në një gjykim penal, me pasojën e pranuar, por jo domosdoshmërisht të dëshiruar, që dëshmitarët të mos japin dëshmi, do të mbetet i pandëshkuar. Një interpretim i tillë është në mospërputhje me kuptimin e drejtpërdrejtë të formulimit të nenit 387 të KPK-së, i lexuar bashkë me nenin 21(3) të KPK-së. Po kështu, ai është në mospërputhje me synimin e nenit 387 të KPK-së që është parandalimi dhe ndëshkimi i veprimeve të frikësimit gjatë procedurave penale. Nuk ka asnjë sugjerim se ligjvënësi ka pasur ndër mend këtë rezultat.

123. Si rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se formulimi i nenit 387 të KPK-së nuk përlligj zbatimin e nenit 2(3) të KPK-së, sipas të cilit në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të të akuzuarit. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se qëllimi i nenit 2(3) të KPK-së nuk është që t'i mundësojë një pale që të konstatojë një paqartësi të paqenë në KPK me qëllim që të propozojë një interpretim të favorshëm të një dispozite të caktuar. Përkundrazi, qëllimi është që neni 2(3) i KPK-së të zbatohet kur nuk është e mundshme që një paqartësi e tillë të zgjidhet me mjetet e tjera të interpretimit. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me këtë.

124. Për këto arsye, shumica e Trupit Gjykses konstaton se vepra penale sipas nenit 387 të KPK-së mund të kryhet me synim të drejtpërdrejtë ose eventual.<sup>204</sup>

## E. HAKMARRJA

125. Në nenin 388(1) të KPK-së thuhet:

Kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person, përfshirë ndërhyrjen në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës të ndonjë personi me qëllim të hakmarrjes, për shkak të dhënies së informatave të vërteta policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

---

<sup>204</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 63.



## 1. Elementet materiale

126. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale të hakmarrjes, brenda kuptimit të nenit 388(1) të KPK-së, nevojiten këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) një veprim i dëmshëm (ii) ndaj cilitdo personi (iii) që i jep informata të vërteta policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale. Trupi Gjykses thekson se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përfshirë nocionin e “informatave të vërteta” në elementet materiale të veprës penale, por nuk ka bërë ndonjë konstatim konkret në lidhje me të.<sup>205</sup> Për arsyet e përcaktuara më poshtë, Trupi Gjykses do t’i trajtojë “informatat e vërteta” sipas kriterëve për synimin kriminal.

### (a) Parashtrimet e palëve

127. Mbrojtja e Gucatit parashtron se për këtë veprë penale nevojitet: (i) që të provohet se është shkaktuar një pasojë;<sup>206</sup> dhe (ii) që objekti i hakmarrjes të ketë dhënë informata të vërteta dhe, rrjedhimisht, nëse informatat e dhëna ishin të rreme, atëherë nuk është kryer veprë penale.<sup>207</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit dhe pajtohet me argumentet e Mbrojtjes së Gucatit.<sup>208</sup>

128. ZPS-ja parashtron se: (i) nuk është e nevojshme që dëmi i synuar të ketë ndodhur;<sup>209</sup> dhe (ii) nuk ka rëndësi nëse dëshmitari faktikisht ka dhënë ose nuk ka dhënë informata të vërteta;<sup>210</sup> ajo që kërkohet është synimi për t’u hakmarrë ndaj atij personi.<sup>211</sup>

---

<sup>205</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 52.

<sup>206</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3640.

<sup>207</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 60-61; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 654-655; F439, para. 68-69.

<sup>208</sup> F342, para. 20-22; F440, para. 11, 34-38.

<sup>209</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3450; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 222; F341, para. 23.

<sup>210</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3451.

<sup>211</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 224; F447, para. 49.

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

129. Për sa i përket formulimit “ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person”, Trupi Gjykses vëren se ky veprim nuk kufizohet vetëm në kuadrin e nenit 388(1) të KPK-së. Shembujt e dhënë në dispozitë (“ndërhyrja në punësimin e ligjshëm apo sigurimin e mjeteve të jetesës të ndonjë personi”) janë për ilustrim. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses pajtohet me analizën dhe konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që përfshijnë forma të ndryshme të ndërhyrjes së rëndë në të drejtat ose interesat e personit, ndër të cilat ato përmes dhunës, kërcënimeve të rënda, ndërhyrjes në sigurinë, mirëqenien, privatësinë, dinjitetin ose çdo ndërhyrje tjetër të dëmshme ndaj personit ose anëtarëve të familjes së ngushtë të tij.<sup>212</sup>

130. Sa i përket personit ndaj të cilit drejtohet veprimi i dëmshëm, Trupi Gjykses vëren se neni 388(1) të KPK-së nuk e përcakton termin. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se “cilindo person” mund t’i referohet një individit ose një kategorie individësh. Gjithashtu, shprehjen “cilindo person” në këtë kontekst Trupi Gjykses e interpreton se përfshin jo vetëm dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar, por edhe çdo person që ka dhënë ose është duke dhënë informacion në kuadër të hetimeve të policisë ose prokurorisë. Sipas kornizës ligjore të DHS-së, një person i cili ka dhënë ose është duke i dhënë informacion TFHS-së, ZPS-së dhe/ose një Trupi Gjykses të DHS-së për krime ose vepra penale në juridiksionin e DHS-së, është objekt i nenit 388(1) të KPK-së.<sup>213</sup>

131. Sa i takon aspektit nëse personi duhet t’i ketë dhënë informata “të vërteta” policisë ose hetuesve të prokurorisë, Trupi Gjykses vëren se fraza “me qëllim të hakmarrjes për shkak të dhënies së informatave të vërteta lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale” cilëson elementin e synimit kriminal dhe nuk është pjesë e elementit të veprimit të fajshëm të kësaj vepre penale. Një konstatim i

---

<sup>212</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 53.

<sup>213</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 53.

ndryshëm nga ky do të thoshte se asnjë veprim i dëmshëm nuk do të ishte i ndëshkueshëm sipas nenit 388(1) të KPK-së, në qoftë se nuk do të vërtetohej se personi kishte thënë të vërtetën lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të një vepre penale. Kjo do të çonte në pasojën absurde që personat të cilët nuk mund të provojnë se dëshmitë e tyre janë të vërteta ose dëshmitë e të cilëve vihen në dyshim, kundërshtohen, apo konsiderohen jo të besueshme, nuk do të ishin të mbrojtur me ligj nga veprimet hakmarrëse. Kjo do të ngrinte gjithashtu pyetjen se cili autoritet është kompetent për të përcaktuar vërtetësinë e informacionit të dhënë. Gjithashtu, kjo do t'i lejonte kujt do që është akuzuar për kryerjen e asaj vepre penale që të vinte në dyshim vërtetësinë e informacionit dhe, në këtë mënyrë, t'i shmangej përgjegjësisë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se interpretimi i vet se vërtetësia e informacionit është pjesë e synimit kriminal dhe jo e veprimit të fajshëm, përputhet më së miri me qëllimin e dispozitës: mbrojtja e personave që japin informacion për vepra penale dhe, më në përgjithësi, mbrojtja e integritetit të procedurës penale. Rrjedhimisht, kuptimi dhe kuadri i “informatave të vërteta” do të diskutohet tek elementet mendore të kësaj vepre penale.

132. Për sa i përket aspektit nëse për të vërtetuar ekzistencën e kësaj vepre penale duhet të provohet se është shkaktuar një pasojë, Trupi Gjykses vëren se veprimi i dëmshëm duhet të ndërmerret ndaj një personi që ka dhënë ose është duke dhënë informacion në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale.<sup>214</sup> Nëse veprimi i dëmshëm ndërmerret përpara se personi të japë një informacion të tillë, ai nuk përmbush elementet e hakmarrjes. Faza “kushdo që ndërmerr ndonjë veprim të dëmshëm për cilindo person” tregon se duhet të ndodhë një veprim në një formë të dëmshme, si përdorimi i dhunës, kërcënimeve, përfundimi i punësimit, ulja në detyrë ose ulja e papërligjur e pagës. Megjithatë, neni 388(1) i KPK-së nuk kërkon që të

---

<sup>214</sup> *Shih p.sh., Salihu dhe të tjerë*, neni 396(1) i KPK-së të vitit 2012, nm. 3, f. 1125.

provohet se është shkaktuar ndonjë dëm apo pasojë e mëtejshme, ose krahas veprimit të dëmshëm që u krye.

## 2. Elementet mendore

133. Vepra penale e hakmarrjes, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së<sup>215</sup>, duhet të kryhet me synim.

### (a) Parashtrimet e palëve

134. Mbrojtja e Gucatit parashtron se: (i) për veprën penale të hakmarrjes nevojitet synim konkret;<sup>216</sup> dhe (ii) duhet që kryesi të besojë se informacioni i dhënë ishte i vërtetë.<sup>217</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit këto argumente.<sup>218</sup>

135. ZPS-ja parashtron se për këtë vepër penale nevojitet synim konkret,<sup>219</sup> por se është e nevojshme vetëm që kryesi të veprojë me dijeninë se informacioni i dhënë nga dëshmitari, ndaj të cilit ai u hakmor, mund të jetë i vërtetë.<sup>220</sup>

### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

136. Trupi Gjykses thekson se palët janë pajtuar se për veprën penale sipas Pikës 4 nevojitet synim konkret.

137. Trupi Gjykses konstatoi më lart se KPK-ja nuk e njeh shprehimisht nocionin e “synimit konkret”, se fraza të tilla si “me qëllim të” nënkuptojnë qëllimin e veprës penale (në serbishte *namera*). Shumica e Trupit Gjykses gjithashtu konstatoi se në KPK nuk ka asgjë që sugjeron se veprat penale për të cilat nevojitet qëllim mund të kryhen

---

<sup>215</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 55.

<sup>216</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3640, 3716-3717; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 655.

<sup>217</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3641-3642; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 61; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 654-655; F439, para. 68.

<sup>218</sup> F342, para. 25.

<sup>219</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3450; F341, para. 25.

<sup>220</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3451.

vetëm me synim të drejtpërdrejtë.<sup>221</sup> Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses mban parasysh se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar se për hakmarrjen nevojitet synim konkret dhe se, gjatë gjithë gjykimit, palët u mbështetën në këtë konstatim kur bënë parashtrime në lidhje me këtë vepër penale. Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk do të devijojë nga konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Sidoqoftë, Trupi Gjykses është bindur se formulimi “me qëllim të hakmarrjes” i nenit 388(1) të KPK-së tregon element të qëllimit.

138. I interpretuar në këtë kontekst, qëllimi për t’u hakmarrë sipas nenit 388(1) të KPK-së kërkon që kryesi të jetë deri diku i vetëdijshëm për vërtetësinë e informacionit. Konkretisht, kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm se personi ndaj të cilit hakmerret, ka dhënë ose po jep, të paktën deri në njëfarë mase, informacion të vërtetë për kryerjen ose kryerjen e mundshme të një veprë penale. Trupi Gjykses pranon se dispozita do të kishte qenë më konsistente nëse do të hiqej fjala “e vërtetë”. Megjithatë, nuk i takon Trupit Gjykses të ndryshojë KPK-në. Trupi Gjykses duhet ta zbatojë atë kështu siç është. Lidhur me paqartësinë në shprehjen (“me qëllim të hakmarrjes, për shkak të dhënies së informatave të vërteta”), ajo duhet të zgjidhet në favor të të akuzuarve. Rrjedhimisht, dhe në përputhje me formulimin e nenit 388(1) të KPK-së, është e pamjaftueshme të tregohet se kryesi ka besuar se informacioni mund të jetë i vërtetë ose se ai apo ajo nuk ishte i interesuar apo e interesuar për vërtetësinë e informacionit. Në të njëjtën kohë, thjesht pretendimi apo deklarata e kryesit se ai ose ajo nuk e dinte ose nuk besonte se informacioni ishte i vërtetë, ose se e konsideronte informacionin të rremë, nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të përjashtuar mundësinë se vepra penale është kryer. I takon ZPS-së të vërtetojë, mbi bazën e provave të disponueshme, se në kohën e kryerjes së veprës penale, kryesi ishte i vetëdijshëm se personi ndaj të cilit u hakmor kishte dhënë, të paktën deri në njëfarë mase, informacion të vërtetë për kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprës penale.

---

<sup>221</sup> *Shih më lart* para. 119-120.

**F. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË SIPAS NENIT 401(1) DHE (5) TË KPK-SË**

139. Në nenin 401(1) të KPK-së thuhet:

Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

140. Në nenin 401(5) të KPK-së thuhet:

Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria, zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

**1. Elementet materiale**

141. Trupi Gjykues konstaton se për veprën penale të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së, nevojiten këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) përdorimi i forcës ose kërcënimit të rëndë që sjell si rezultat (ii) pengimin ose tentativën për të penguar një person zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, ose detyrimi i atij personi për të kryer detyrat zyrtare.<sup>222</sup> Trupi Gjykues më tej konstaton se formulimi i nenit 401(1) të KPK-së ("pengon ose tenton të pengojë") tregon se vepra penale mund të kryhet, ose kur pengimi ka ndodhur faktikisht, ose kur ai është tentuar.

**(a) Parashtrimet e palëve**

142. Mbrojtja e Gucatit parashtron se kërcënimi i rëndë: (i) nënkupton kërcënim të rëndë për përdorim të forcës;<sup>223</sup> (ii) duhet të jetë me përdorim të menjëhershëm të

---

<sup>222</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 67.

<sup>223</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3644; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 12; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 660; F439, para. 20.

forcës ndaj vetë personit zyrtar;<sup>224</sup> dhe (iii) duhet të kryhet në të njëjtën kohë me veprimin zyrtar.<sup>225</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit dhe pajtohet me argumentet e Mbrojtjes së Gucatit.<sup>226</sup>

143. ZPS-ja pretendon se: (i) nuk është e nevojshme që kërcënimi i rëndë të jetë kërcënim për përdorim të forcës;<sup>227</sup> (ii) kërcënimi mund t'u drejtohet personave të tjerë që nuk janë persona zyrtarë, ose edhe objekteve;<sup>228</sup> dhe (iii) nuk është kusht të provohet se është penguar zbatimi i një detyre zyrtare të caktuar.<sup>229</sup>

#### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

144. Për sa i përket kuptimit të kërcënimit të rëndë [“kanosjes serioze”], Trupi Gjykses vëren se në formulimin e nenit 401 të KPK-së nuk ka asgjë që sugjeron se “kërcënimi i rëndë” i referohet vetëm kërcënimit për përdorim të forcës.<sup>230</sup> Trupi Gjykses vëren se Kodi i Përkohshëm Penal i vitit 2003, në nenin përkatës për të njëjtën vepër penale, përmbante frazën “me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës”.<sup>231</sup> Kjo frazë u hoq si në KPK-në e vitit 2012 ashtu dhe në KPK.<sup>232</sup> Trupi Gjykses e interpreton këtë heqje si një tregues të qartë se ligjvënësi e

<sup>224</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3645; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 20; F345, para. 5; F439, para. 26-28.

<sup>225</sup> Transkripti, 16 March 2022, f. 3645; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 20; F439, para. 28.

<sup>226</sup> F342, para. 33-36; F440, para. 11.

<sup>227</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3455, 3475-3476; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 172; F341, para. 8; F447, para. 10.

<sup>228</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3456; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para 172; F341, para. 10; F447, para. 12.

<sup>229</sup> F341, para. 9.

<sup>230</sup> *Për krahasim, Salihu dhe të tjerë*, neni 409(1) i KPK-së të vitit 2012, f. 1165.

<sup>231</sup> *Shih UNMIK/REG/2003/25*, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 6 korrik 2003, neni 316(1): “Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet”.

<sup>232</sup> Neni 409(1) i KPK-së të vitit 2012: “Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet”.

kupton termin “kanosje serioze” se përfshin jo vetëm kërcënimin për përdorim të forcës, por çdo kërcënim të rëndë për veprim të dëmshëm. Trupi Gjykses mban parasysh edhe dispozitat e tjera të KPK-së, në të cilat përdoret termi “kanosje” për të përshkruar veprime të dëmshme të ndryshme nga përdorimi i forcës,<sup>233</sup> apo që tregojnë qartë se në cilat raste “kanosja” ka të bëjë me përdorimin e forcës apo dhunës.<sup>234</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se neni 401 i KPK-së nuk e specifikon dhe as nuk e kufizon llojin apo kategorinë e veprimit që mund të cilësohet si kërcënim i rëndë. Si rezultat, Trupi Gjykses pajtohet me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se “kërcënimi i rëndë” përfshin kërcënimin për të përdorur forcën apo për të shkaktuar dëmtim të rëndë të shëndetit, mirëqenies, sigurisë apo privatësisë së një personi.<sup>235</sup>

145. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se termi “pengon” nënkupton parandalimin, pengimin ose vonimin e lëvizjes, kalimit apo ecurisë së diçkaje.<sup>236</sup>

146. Sa i përket personit të cilit i drejtohet “kërcënimi i rëndë”, Trupi Gjykses thekson se neni 401(1) i KPK-së përdor termin “person zyrtar”. Duke marrë parasysh nenin 113(2) të KPK-së<sup>237</sup>, Trupi Gjykses konstaton se, në kuadër të kornizës ligjore të DHS-së, “person zyrtar”, në pajtim me nenin 401(1) të KPK-së, është çdo person i autorizuar të veprojë në emër të DHS-së ose të ZPS-së, përfshirë gjykatësit, prokurorët, hetuesit apo çdo zyrtar tjetër të DHS-së apo ZPS-së.<sup>238</sup> Trupi Gjykses më tej vëren se në formulimin e nenit 401 të KPK-së nuk kërkohet që forca ose kërcënimi i rëndë të drejtohet vetëm ndaj personit zyrtar.<sup>239</sup> Kufizimi i zbatimit të kësaj vepre penale në veprimet e drejtuara ndaj personave zyrtarë do të përjashtonte situatat në të cilat forca

---

<sup>233</sup> *Shih p.sh.*, nenet 181, 160(2)(7), 161(2)(5), 167(4), 168(4), 169, 170(6)(5), 171, 227(3)(2), 229(2)(2) të KPK-së.

<sup>234</sup> *Shih p.sh.*, nenet 114, 118, 121, 158(1), 160(2)(1), 161(2)(1), 227(3)(1), 229(2)(1), 247(3) të KPK-së.

<sup>235</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 70.

<sup>236</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 70.

<sup>237</sup> Në nenin 113(2) të KPK-së personi zyrtar përkufizohet, ndër të tjera, si “person të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve” (Neni 113(2.4) i KPK-së).

<sup>238</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 69.

<sup>239</sup> *Shih p.sh.*, *Salihu dhe të tjerë*, Neni 409(1) i KPK-së të vitit 2012, nm. 3-4, f. 1165-1166. *Shih gjithashtu*, F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 68.



apo kërcënimi i rëndë drejtohet ndaj një ose më shumë personave të tjerë ose ndaj një objekti, për të penguar zbatimin të detyrave ose funksioneve zyrtare të atij personi. Kjo do të ishte në kundërshtim me bazën logjike të dispozitës për veprën penale – që synon të garantojë që detyrat zyrtare të mos pengohen, drejtpërdrejt apo tërthorazi – dhe do të përfshinte në tekst një kufizim që ligjvënësi nuk e ka parashikuar. Si rezultat, Trupi Gjykses konsideron se “kërcënimi i rëndë” mund të drejtohet ndaj një personi zyrtar, një personi tjetër apo një objekti.

147. Për sa u takon termave “detyra zyrtare” dhe “funksione zyrtare”, brenda kuptimit të nenit 401(1) dhe (5) të KPK-së, Trupi Gjykses vëren se ato përdoren në formën e tyre në shumës; formulimi i këtyre dispozitave nuk sugjeron se kërkohet ndonjë konkretësi e veçantë, d.m.th., përcaktimi i formës dhe llojit të detyrës konkrete kryerja e së cilës është penguar.<sup>240</sup> Trupi Gjykses gjykon se, në kuadër të kornizës ligjore të DHS-së, “detyrat zyrtare” dhe “funksionet zyrtare” të ushtruara nga “personi zyrtar” kanë të bëjnë me çdo përgjegjësi apo punë të zyrtarëve të DHS-së apo ZPS-së në kontekstin e procedurave zyrtare, përfshirë hetimet e ZPS-së.<sup>241</sup> Rrjedhimisht, këto dispozita kërkojnë që të vërtetohet se detyrat zyrtare përfshihen në kompetencat e personit zyrtar.<sup>242</sup>

148. Për sa i përket qëllimit dhe kohës së pengimit, Trupi Gjykses vëren se neni 401(1) i KPK-së i referohet pengimit ose tentativës për të penguar personin zyrtar “në kryerjen e detyrave zyrtare”. Sipas interpretimit të Trupit Gjykses kjo frazë do të thotë se përdorimi i forcës ose kërcënimi i rëndë duhet të synojë pengimin e kryerjes së detyrave të personit zyrtar përpara ose ndërkohë që ato ushtrohen ose pritet të ushtrohen. Nuk ka nevojë që përdorimi i forcës ose kërcënimi i rëndë të ndodhin pikërisht në atë moment kur personi është duke ushtruar në mënyrë aktive një detyrë

---

<sup>240</sup> *Shih p.sh., Salihu dhe të tjerë*, Neni 409(1) i KPK-së të vitit 2012, nm. 5, f. 1166.

<sup>241</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 69.

<sup>242</sup> *Shih p.sh., Salihu dhe të tjerë*, Neni 409(1) i KPK-së të vitit 2012, nm. 5, f. 1166.

të caktuar; ai mund të ndodhë në një moment tjetër, me qëllim pengimin e kryerjes së një detyre zyrtare të ardhshme ose një detyre zyrtare që po kryhet në vijimësi

149. Së fundi, Trupi Gjykses konstaton se, në rastet kur vepra penale sipas nenit 401(1) të KPK-së është kryer ndaj një zyrtari të DHS-së apo ZPS-së, janë përmbushur gjithashtu edhe kriteret e formës së rëndë të veprës penale sipas nenit 401(5) të KPK-së.<sup>243</sup>

## 2. Elementet mendore

150. Vepra penale e pengimit të personave zyrtarë, sipas nenit 401(1) dhe/ose (5) të KPK-së, duhet të kryhet me synim, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

### (a) Parashtrimet e palëve

151. Mbrojtja e Gucatit parashtron se në rastin e tentativës për kryerje të veprës penale, vetëm synimi i drejtpërdrejtë është i mjaftueshëm.<sup>244</sup> Mbrojtja e Haradinajt pajtohet me këto parashtrime.<sup>245</sup> ZPS-ja nuk ka shprehur qëndrim në lidhje me këtë.

### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

152. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale sipas nenit 401(1) të KPK-së si dhe formën e saj të rëndë sipas nenit 401(5) të KPK-së, nevojitet njëri nga këto elemente mendore (*synimi kriminal*): synimi i drejtpërdrejtë ose eventual.

153. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për përdorimin e forcës ose të kërcënimit të rëndë për ta penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>246</sup>

---

<sup>243</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 69.

<sup>244</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 662.

<sup>245</sup> F342, para. 37-38.

<sup>246</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 72.

154. Për synimin eventual, kryesi duhet (i) të ketë përdorur forcën ose kërcënimin e rëndë me vetëdijen se, si pasojë e veprimeve të tij ose të saj, mund të ndodhë pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtareve dhe (ii) është pajtuar që kjo të ndodhë.<sup>247</sup>

155. Trupi Gjykses më tej konstaton se në formulimin e nenit 401(1) ose (5) të KPK-së nuk ka asgjë që sugjeron se tentativa për kryerjen e kësaj veprë penale mund të bëhet vetëm me synim të drejtpërdrejtë. Përkundrazi, formulimi dhe qëllimi i atij ndalimi ligjor lejojnë qartazi mundësinë që tentativa për kryerjen e veprës penale të bëhet me synim eventual, siç përcaktohet më sipër.

## G. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË SIPAS NENIT 401(2)-(3) TË KPK-SË

156. Në nenin 401(2) të KPK-së thuhet:

Kushdo që merr pjesë në një grup të personave që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

157. Në nenin 401(3) të KPK-së thuhet:

Udhëheqësi apo organizatori i grupit që kryen veprë penale nga paragrafi 2. i këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

### 1. Elementet materiale

158. Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së, nevojiten këto elemente materiale (*veprimi i fajshëm*): (i) pjesëmarrja në një grup personash që me veprim të përbashkët (ii) pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>248</sup> Trupi Gjykses më tej konstaton se formulimi i nenit 401(2) të KPK-

---

<sup>247</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 73.

<sup>248</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 74.

së (“pengon ose tenton të pengojë”) tregon se vepra penale mund të kryhet ose kur pengimi ka ndodhur faktikisht, ose kur ai është tentuar të kryhet.

(a) Parashtrimet e palëve

159. Mbrojtja e Gucatit parashtron se: (i) kjo vepër penale është subsidiare dhe zbatohet vetëm kur nuk është vërtetuar forma më e rëndë e saj sipas nenit 401(1) të KPK-së;<sup>249</sup> (ii) “veprimi i përbashkët” duhet t’i referohet veprimit të përbashkët për përdorimin e forcës ose kërcënimit të rëndë;<sup>250</sup> dhe (iii) veprimi i përbashkët duhet të ndodhë në të njëjtën kohë me veprimin zyrtar të penguar.<sup>251</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit dhe pajtohet me argumentet e Mbrojtjes së Gucatit.<sup>252</sup>

160. ZPS-ja parashtron se: (i) pengimi nga një grup paraqet rrezik të shtuar dhe përligj masë ndëshkuese shtesë;<sup>253</sup> dhe (ii) pengimi nuk kufizohet vetëm në veprimet e përbashkëta për të përdorur forcën ose kërcënimin e rëndë apo situatat e veprimit të turmës.<sup>254</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

161. Sa i përket nocionit të “grupit”, Trupi Gjykses merr parasysh nenin 113(12) të KPK-së dhe konstaton se ai duhet të përbëhet nga tre ose më shumë persona.<sup>255</sup>

162. Për sa i takon llojit të “veprimit të përbashkët”, Trupi Gjykses thekson se në formulimin e nenit 401(2) të KPK-së nuk ka asgjë që sugjeron se “veprimi i përbashkët” duhet të nënkuptojë forcën ose kërcënimin e rëndë. Ndonëse “veprimi i përbashkët”

---

<sup>249</sup> F345, para. 8.

<sup>250</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3646-3647, 3695; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 30; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 662, 671, *shih gjithashtu* F345, para. 9.

<sup>251</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 31; F439, para. 39.

<sup>252</sup> F342, para. 39; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 663, 671; F440, para. 11.

<sup>253</sup> F341, para. 13.

<sup>254</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3459; F447, para. 31; F341, para. 14.

<sup>255</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 75.

faktikisht mund të lidhet me përdorimin e forcës dhe formave të tjera të veprimeve të dhunshme nga një grup, ai mund të marrë edhe forma të tjera, si ngritja e barrikadave ose bllokimi i rrugëve. Megjithëse në shembuj të tillë zakonisht flitet për veprim të “turmes”, në formulimin e nenit 401(2) të KPK-së nuk ka asgjë që sugjeron se “veprimi i përbashkët” duhet t’i referohet vetëm dhunës së “turmes” ose duhet të kufizohet në ndonjë lloj të veçantë veprimesh.<sup>256</sup> Neni 401(2) i KPK-së ndëshkon veprimin kriminal të përbashkët pa e kufizuar në një formë të caktuar. Rrjedhimisht, “veprimi i përbashkët” sipas nenit 401(2) të KPK-së nuk mund të kufizohet në dhunën e “turmes”, por përfshin në parim çdo lloj veprimitarie kriminale të përbashkët që kërkon arritjen e qëllimit pengues përkatës.<sup>257</sup>

163. Për sa i përket pjesëmarrjes në një grup, Trupi Gjykses thekson se kjo përfshin çdo person i cili, me veprimet e veta, merr pjesë, kontribuon ose mundëson në ndonjë formë tjetër veprimin e përbashkët të pengimit ose tentativën për të penguar një person zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>258</sup> Trupi Gjykses nënvizon se neni 401(2) i KPK-së nuk kërkon që veprimet e secilit pjesëmarrës në grup të kontribuojnë drejtpërdrejt në qëllimin pengues.

164. Për sa i përket nocionit, kuadrit, qëllimit dhe kohës së pengimit, si dhe kuptimit të termave “person zyrtar” dhe “detyra zyrtare”, Trupi Gjykses u referohet konstatimeve të tij lidhur me nenin 401(1) të KPK-së.<sup>259</sup>

165. Për sa i përket lidhjes ndërmjet paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 401 të KPK-së, Trupi Gjykses vëren se formulimi i paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 401 të KPK-së nuk sugjeron që dy format e kësaj vepre penale përjashtojnë reciprokisht njëra-tjetrën. Paneli vëren se në një çështje gjyqësore, Gjykata e Apelit e Kosovës ka konstatuar se “këto dispozita

---

<sup>256</sup> Për krahasim, Salihu dhe të tjerë, neni 409(2) i KPK-së të vitit 2012, f. 1167.

<sup>257</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 75.

<sup>258</sup> Shih p.sh., Salihu dhe të tjerë, neni 409(2) i KPK-së të vitit 2012, f. 1167-1168.

<sup>259</sup> Shih më lart para. 145-148.

janë në raportin e bashkimit ideal në formën e subsidiaritetit të nënkuptuar. Vepra më e lehtë [domethënë, barasvlerësja sipas nenit 401(2) të KPK-së] është subsidiare në situatat kur nuk vërtetohet vepra më e rëndë”<sup>260</sup>. Më tej, Gjykata e Apelit e Kosovës u shpreh se “dënimi për të dy veprat penale [...] nuk do të ishte i pranueshëm për shkak se ato nuk janë në raportin e bashkimit real”.<sup>261</sup> Sipas përkufizimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës “bashkimi real” konsiston në “kryerjen nga i njëjti person të shumë veprave penale përmes veprimeve të veçanta.”<sup>262</sup> Në lidhje me këto konstatime, Trupi Gjykses vëren si më poshtë.

166. Së pari, Gjykata e Apelit në atë rast nuk identifikoi bazën ligjore mbi të cilën u mbështet për zbatimin e teorisë së bashkimit. Në vend të kësaj, ajo u shpreh se “në sistemet e ligjit civil – siç është Kosova – gjykatat synojnë ta zgjidhin problemin e njëjtë duke zbatuar rregullat e teorisë së bashkimit.”<sup>263</sup> Nuk është e qartë se cila ishte baza ligjore mbi të cilën u mbështet ky konstatim.<sup>264</sup> Gjykata e Apelit mund të jetë mbështetur në nenin 71(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës të 6 korrikut 2003, që përkon me nenin 76 të KPK-së.<sup>265</sup> Megjithatë, nuk është lehtësisht e qartë që arsyetimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës vërtet u bazua në atë dispozitë.<sup>266</sup> Trupi

<sup>260</sup> [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.3, f.29.

<sup>261</sup> [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.3, f.29.

<sup>262</sup> [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.3, f.28.

<sup>263</sup> [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.3, f.27.

<sup>264</sup> *Shih p.sh., Čelebići Appeal Judgment*, para. 406-413, ku vihen në dukje qasjet e ndryshme në vende të ndryshme lidhur me këtë aspekt.

<sup>265</sup> [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.4, f. 31.

<sup>266</sup> Neni 76(1) i KPK-së është i njëjtë me nenin 71(1) të UNMIK/REG/2003/25, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, 6 korrik 2003, dhe me nenin 80(1) të KPK-së të vitit 2012. Që të tre përcaktojnë se: “nëse kryesi me një apo më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra dhe pastaj, për të gjitha këto vepra shqipton vendimin unik”.

Gjykues vëren se neni 76 i KPK-së nuk është i përfshirë shprehimisht në Ligj dhe, bazuar në nenin 3(2)(c) dhe (4) të Ligjit, ai nuk është i zbatueshëm.<sup>267</sup>

167. Së dyti, Trupi Gjykses vëren se të dyja palët kanë pranuar se është në kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses që të ketë si orientim standardin e fajësisë së shumëfishtë që zbatohet në tribunalët ndërkombëtarë.<sup>268</sup> Ky standard u formulua si vijon:

Vendimet për fajësi të shumëfishtë të shqiptuara në pajtim me dispozita të ndryshme statutore por mbi bazën e të njëjtës sjellje, janë të lejueshme vetëm nëse secila dispozitë statutore në fjalë ka një element materialisht të ndryshëm që nuk e përmban tjetra. Një element është materialisht i ndryshëm nga një tjetër nëse kërkon prova për një fakt, që nuk kërkohet nga tjetri

Kur ky kriter nuk përmbushet, Dhoma duhet të vendosë se për cilën vepër penale do të shqiptojë vendim fajësie. Kjo duhet bërë mbi bazën e parimit se duhet të konfirmohet vendimi i fajësisë sipas dispozitës më konkrete. Rrjedhimisht, nëse një grup faktesh trajtohet në dy dispozita, njëra prej të cilave përmban një element materialisht të ndryshëm, atëherë vendimi i fajësisë duhet të shqiptohet vetëm mbi bazën e asaj dispozite.<sup>269</sup>

168. Palët nuk identifikuan ndonjë bazë tjetër ligjore që parasheh përdorimin e ndonjë standardi tjetër.

169. Së treti, Trupi Gjykses gjykon se elementet e paragrafit 2 të nenit 401 të KPK-së janë të ndryshme nga të paragrafit 1 të nenit 401 të KPK-së. Konkretisht, paragrafi 1 i nenit 401 të KPK-së kërkon vërtetimin e përdorimit të forcës ose të kërcënimit të rëndë nga kryesi, që nuk është element i veprës penale sipas paragrafit 2 të nenit 401 të KPK-

<sup>267</sup> *Shih gjithashtu* rregullën 163(4) e Rregullores që përshkruan një kriter të ngjashëm dhe nenin 44(4) të Ligjit, sipas të cilit dënimi që shqiptohet kundër personit të shpallur fajtor për krim sipas nenit 15(2) të Ligjit është në përputhje me dënimet për ato krime të përcaktuara në KPK-në e vitit 2012.

<sup>268</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3805-3806, 3808, 3822-3824 (Mbrojtja e Gucatit); Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 147. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Gucatit argumentoi në të njëjtën kohë se paragrafi 2 i nenit 401 të KPK-së ishte subsidiar i paragrafit 1 të nenit 401 të KPK-së. *Shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 146.

<sup>269</sup> ICTY, [Čelebići Appeal Judgment](#), paras 412-413. *Shih p.sh.* ICTY, [Strugar Appeal Judgment](#), para. 321-322; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 1032-1033; ICTR, [Nahimana et al. Appeal Judgment](#), para. 1019; [Ntagerura et al. Appeal Judgment](#), para. 425; ICC, [Bemba Trial Judgment](#), paras 746-748; [Katanga Trial Judgment](#), para. 1695.

së. Rrjedhimisht, sikurse u konstatua më lart,<sup>270</sup> veprimet penguese të parapara në paragrafin 2 mund të kryhen me çfarëdo forme veprimesh kriminale të përbashkëta, të cilat jo domosdoshmërisht përfshijnë përdorimin e forcës apo të kërcënimit të rëndë. Gjithashtu, paragrafi 2 i nenit 401 të KPK-së kërkon veprimin e përbashkët të një grupi personash, që nuk kërkohet në paragrafin 1 të nenit 401 të KPK-së. Paragrafi 2 i nenit 401 të KPK-së nuk është formë subsidiare apo mbetëse, dhe as formë e rëndë e paragrafit 1 të nenit 401 të KPK-së. Përkundrazi, ai penalizon një formë tjetër pengimi që bart rrezikun konkret të veprimit të përbashkët të disa – më së paku tre – kryesve.

170. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes gjykon se kryesi mund të përmbushë kriteret e të dyja veprave penale dhe të shpallet fajtor në lidhje me to, ndonëse dënimi që jepet për këto vepra duhet të pasqyrojë në tërësi llojin dhe peshën e sjelljes në fjalë.

171. Së fundi, neni 401(3) i KPK-së parashikon një dënim më të rëndë nëse kryesi është udhëheqësi apo organizatori i grupit.<sup>271</sup> Trupi Gjykes, në lidhje me këtë, thekson se neni 401(3) i KPK-së nuk e kufizon një rol të tillë në pozitat zyrtare. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes gjykon se për formën e rëndë të veprës penale sipas nenit 401(3) të KPK-së mund të dënohen edhe udhëheqësit apo organizatorët *de facto*.

## 2. Elementet mendore

172. Vepra penale e pengimit të personit zyrtar përmes pjesëmarrjes në një grup, duhet të kryhet me synim, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.

---

<sup>270</sup> *Shih më lart*, para. 162.

<sup>271</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 77.



(a) Parashtrimet e palëve

173. Mbrojtja e Gucatit parashtron se përdorimi i fjalës “të përbashkët” e bën të qartë se vetëm synimi i përbashkët i drejtpërdrejtë i tre apo më shumë personave është i mjaftueshëm.<sup>272</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit këto argumente.<sup>273</sup>

174. ZPS-ja parashtron se mjafton synimi i drejtpërdrejtë, ose eventual.<sup>274</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

175. Në përputhje me nenin 21 të KPK-së, Trupi Gjykses konstaton se për veprën penale sipas nenit 401(2) të KPK-së si dhe formën e rëndë të saj sipas nenit 401(3) të KPK-së, është i nevojshëm ose synimi i drejtpërdrejtë, ose ai eventual.

176. Për synimin e drejtpërdrejtë, kryesi duhet të ketë vepruar me vetëdijen dhe dëshirën për të marrë pjesë në një grup në mënyrë që përmes veprimit të përbashkët të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>275</sup>

177. Për synimin eventual, kryesi duhet (i) të ketë vepruar me vetëdijen se, si pasojë e pjesëmarrjes së tij ose të saj në grup, personi zyrtar mund të pengohet nga veprimi i përbashkët në kryerjen e detyrave zyrtare dhe (ii) është pajtuar me pasojën.<sup>276</sup>

178. Trupi Gjykses më tej konstaton se në formulimin e nenit 401(2) të KPK-së nuk ka asgjë që sugjeron se për pjesëmarrjen në veprimin e përbashkët të një grupi duhet synim i drejtpërdrejtë dhe se vepra penale nuk mund të kryhet me synim eventual, siç u përcaktua më lart. Gjithashtu, dispozita nuk kërkon që të gjithë personat e grupit të marrin pjesë me të njëjtën formë synimi. Rrjedhimisht, disa mund të marrin pjesë me synim të drejtpërdrejtë, ndërsa të tjerët me synim eventual. Të përbashkët duhet të

---

<sup>272</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 662.

<sup>273</sup> Parashtrime të Haradinajt, para. 41-42.

<sup>274</sup> F341, para. 15.

<sup>275</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 79.

<sup>276</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 80.

jenë veprimi ose veprimet e grupit, dhe jo domosdoshmërisht synimi i anëtarëve të grupit.

## H. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

### 1. Kryerja

179. Në nenin 17(1) të KPK-së thuhet:

Kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.

180. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se kryerja, brenda kuptimit të nenit 17(1) të KPK-së, kërkon që kryesi të kryejë fizikisht elementet objektive të veprës penale ose të mos veprojë kur sipas ligjit i kërkohet të veprojë.<sup>277</sup>

181. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se për kryerjen nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>278</sup> Veprat penale mund të kryhen edhe nga neglizhenca nëse këtë e përcakton shprehimisht ligji.<sup>279</sup> Për veprat penale të paraqitura në Aktakuzë, KPK-ja nuk përcakton se ato mund të kryhen nga neglizhenca.

### 2. Bashkëkryerja

182. Në nenin 31 të KPK-së thuhet:

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.

---

<sup>277</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 83.

<sup>278</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82.

<sup>279</sup> Neni 17(2) i KPK-së.

(a) Parashtrimet e palëve

183. Mbrojtja e Gucatit parashtron se për bashkëkryerjen nevojitet synim konkret, përkatësisht dijëni dhe dashje nga ana e kryesit.<sup>280</sup> Mbrojtja e Haradinajt përsërit këto argumente dhe shton se veprimet e bashkëkryesve duhet të jenë të bashkërenduara gjatë kryerjes së veprës penale.<sup>281</sup>

184. ZPS-ja parashtron se formulimi tekstual i kësaj dispozite nuk të çon në përfundimin se është i nevojshëm synimi konkret. ZPS-ja shton se formulimi nuk përmban kriterin që bashkëkryesit t'i kenë kryer krimet me "dijëni dhe dashje" dhe, edhe sikur ta përmbante këtë kriter, këto fjalë përgjithësisht kuptohen si shprehje vetëm e synimit të përgjithshëm.<sup>282</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

185. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se bashkëkryerja, brenda kuptimit të nenit 31 të KPK-së, kërkon që (i) dy apo më shumë persona së bashku (ii) të marrin pjesë në kryerjen e veprës penale ose të kontribuojnë thelbësisht në kryerjen e veprës penale në ndonjë mënyrë tjetër.<sup>283</sup>

186. Trupi Gjykses konstaton se për kryerjen e përbashkët nuk nevojitet një marrëveshje e shprehur para kryerjes së veprës penale. Për të deduktuar ekzistencën e marrëveshjes, mjafton që veprimet e bashkëkryesve të jenë të bashkërenduara gjatë kryerjes së veprës penale.<sup>284</sup> Trupi Gjykses më tej konstaton se neni 31 i KPK-së nuk përcakton se çfarë përbën pjesëmarrje ose kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale.<sup>285</sup> Trupi Gjykses gjithashtu gjykon, në kundërshtim me konstatimet e

---

<sup>280</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 662.

<sup>281</sup> F342, para. 44.

<sup>282</sup> F341, para. 40.

<sup>283</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 84.

<sup>284</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 85.

<sup>285</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 86.

Gjykatësit të Procedurës Paraprake, se nuk është kusht që çdo kryes të përmbushë të paktën një prej elementeve materiale të nevojshme të veprës penale të kryer bashkërisht.<sup>286</sup> Thjesht, ai ose ajo duhet të ketë kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale edhe pa përmbushur personalisht një nga elementet e veprës penale.

187. Në lidhje me elementet subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se për bashkëkryerjen nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>287</sup> Gjithashtu, bashkëkryesi përgjigjet penalisht brenda kufijve të synimit të tij apo të saj. Rrjedhimisht, është e mundshme që njëri bashkëkryes të veprojë me synim të drejtpërdrejtë, ndërsa një tjetër me synim eventual.<sup>288</sup>

### 3. Nxitja

188. Në nenin 32(1)-(3) të KPK-së thuhet:

1. Kushdo që me dashje e shtyn personin tjetër të kryejë vepër penale dënohet sikurse ta kishte kryer vetë atë vepër penale, nëse vepra penale është kryer.
2. Kushdo që me dashje e shtyn personin tjetër të kryejë vepër penale dënohet sikurse ta kishte kryer vetë atë vepër penale, nëse vepra penale është tentuar por nuk është kryer
3. Kushdo që me dashje e shtyn personin tjetër të kryejë vepër penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe vepra penale as që është tentuar, nxitësi dënohet për tentativë..

(a) Parashtrimet e palëve

189. Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt shprehën qëndrimin se forma e tretë e nxitjes sipas nenit 32(3) të KPK-së mund të zbatohet vetëm për veprat për të cilat parashikohet një dënim me së paku pesë vjet burgim.<sup>289</sup>

---

<sup>286</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 86.

<sup>287</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82.

<sup>288</sup> *Shih p.sh., Salihu dhe të tjerë*, neni 31 i KPK-së së vitit 2012, f. 153-154.

<sup>289</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 685.

190. Në lidhje me nenin 32(3) të KPK-së, ZPS-ja parashtron se, në qoftë se për ndonjë nga veprat penale të paraqitura në Aktakuzë spektri i dënimit mund t'i kalojë pesë vjet burgim, edhe nëse nuk është dënimi më i ulët, atëherë për atë vepër penale zbatohet forma e tretë e nxitjes.<sup>290</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykes

191. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjesisë penale, Trupi Gjykes konstaton se nxitja, brenda kuptimit të nenit 32 të KPK-së, kërkon që kryesi të ushtrojë ndikim psikologjik mbi një person tjetër me qëllim krijimin ose forcimin e vendimit të personit tjetër për ta kryer veprën penale. Një ndikim i tillë, ndër të tjera, mund të marrë formën e inkurajimit, nxitjes apo ushtrimit të presionit ndaj personit për ta kryer veprën penale, si edhe të orientimit apo udhëzimit të atij personi në kryerjen e veprës penale.<sup>291</sup>

192. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjesisë penale, Trupi Gjykes konstaton se për nxitjen nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>292</sup>

193. Në lidhje me zbatimin e kësaj forme të përgjegjesisë penale për veprat penale për të cilat janë ngritur akuzat, Trupi Gjykes thekson se neni 32 i KPK-së parashikon tri forma të nxitjes. E para, sipas nenit 32(1) të KPK-së, kërkon që kryesi të nxisë një person tjetër të kryejë vepër penale dhe nxitësi mban përgjegjësi nëse vepra penale kryhet. Sipas formës së dytë, në bazë të nenit 32(2) të KPK-së, nxitësi mban përgjegjësi edhe nëse vepra penale u tentua të kryhet, por nuk u krye. Sipas formës së tretë, në bazë të nenit 32(3) të KPK-së, nxitësi mban përgjegjësi për nxitjen e një vepre penale të

---

<sup>290</sup> Transkripti, 8 shtator 2021, f. 684.

<sup>291</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 88. *Shih edhe Salihu dhe të tjerë*, neni 32 i KPK-së të vitit 2012, nm. 10, f. 160.

<sup>292</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82.

dënueshme me së paku 5 (pesë) vjet burgim, edhe nëse vepra penale nuk u tentua të kryhej.<sup>293</sup> Në dallim nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,<sup>294</sup> sipas Trupit Gjykues shprehja “të dënueshme me të paktën pesë (5) vjet burgim” do të thotë se forma e tretë e nxitjes mund të zbatohet vetëm për veprat penale për të cilat parashikohet një dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim.<sup>295</sup> Për asnjë nga veprat penale të përfshira në Aktakuzë nuk parashikohet një dënim me të paktën 5 vjet burgim. Për këtë arsye, Trupi Gjykues konstaton se, sipas nenit 32(3) të KPK-së, forma e tretë e nxitjes nuk mund të zbatohet për asnjërën nga gjashtë pikat e Aktakuzës.

#### 4. Ndhma

194. Në nenin 33(1)-(2) të KPK-së thuhet:

1. Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet me dënim më të butë sesa kryesi i veprës.
2. Ndhma për të kryer një vepër penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimin paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

195. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykues konstaton se ndihma, brenda kuptimit të nenit 33(1) të KPK-së, kërkon që personi të ndihmojë kryesin në kryerjen e veprës penale.<sup>296</sup> Trupi Gjykues më tej

<sup>293</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 89.

<sup>294</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 90.

<sup>295</sup> Për krahasim, KPK-ja përdor një formulim të ndryshëm në nenin 28(2), në të cilin thuhet “tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim, dënohet”. Shih gjithashtu Salihu dhe të tjerë, neni 32(3) i KPK-së të nenit 2012, nm 1, f. 163: “Në këso raste, shtytësi dënohet për tentativë nëse për atë vepër penale parashihet dënimi me së paku pesë vjet burgim” dhe “[...] shtytësi përgjigjet penalisht vetëm për veprën penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me së paku pesë vjet burgim” (theksimi i shtuar).

<sup>296</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 91.

konstaton se një ndihmë e tillë përfshin, ndër të tjera, veprimet e renditura në nenin 33(2) të KPK-së.<sup>297</sup>

196. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se për ndihmën nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>298</sup> Nuk është e nevojshme që personi i cili ndihmon në kryerjen e veprës penale të synojë kryerjen e asaj vepre penale, por ai ose ajo duhet t'i japë ndihmë kryesit me vetëdije dhe qëllimisht. Megjithatë, nuk është e nevojshme që personi i cili ndihmon kryerjen e një vepre penale të dijë të gjitha hollësitë e veprës penale, për shembull vendin, datën ose mënyrën dhe mjetet e kryerjes.<sup>299</sup>

## 5. Marrëveshja për të kryer vepër penale

197. Në nenin 35(1)-(2) të KPK-së thuhet:

1. Kushdo që merret vesh me një apo më shumë persona për të kryer vepër penale dhe një apo më shumë nga ata persona ndërmerr çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale, dënohet me dënimin e paraparë për atë vepër penale.

2. Për qëllime të këtij neni, shprehja “veprim i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale” nuk duhet të jetë veprim penal por duhet të jetë hap i rëndësishëm përgatitor drejt kryerjes së veprës penale të cilën personat janë pajtuar që ta kryejnë.

198. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykses konstaton se marrëveshja për të kryer vepër penale, brenda kuptimit të nenit 35 të KPK-së, kërkon që (i) kryesi të merret vesh me një ose më shumë persona të tjerë për të kryer një vepër penale, dhe (ii) një apo më shumë nga ata persona të ndërmarrin çfarëdo veprimi të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale.<sup>300</sup> Gjithashtu, Trupi

---

<sup>297</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 92.

<sup>298</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82. *Shih p.sh. Salihu dhe të tjerë*, neni 33 i KPK-së të vitit 2012, nm. 18, f. 168.

<sup>299</sup> *Shih p.sh. Salihu dhe të tjerë*, neni 33 i KPK-së të vitit 2012, nm. 16, f. 168.

<sup>300</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 93.

Gjykues i kushton vëmendje shpjegimit të shprehjes “veprim i rëndësishëm drejt kryerjes së veprës penale” sipas nenit 35(2) të KPK-së.<sup>301</sup>

199. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykues konstaton se për marrëveshjen për të kryer vepër penale nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>302</sup>

## 6. Tentativa

200. Në nenin 28(1)-(3) të KPK-së thuhet:

1. Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale.

2. Tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me tre ose më shumë vjet burgim, dënohet. Tentativa për të kryer ndonjë vepër penale tjetër, dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj.

3. Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet.

201. Në lidhje me elementet objektive të kësaj forme të përgjegjësisë penale, Trupi Gjykues konstaton se tentativa, brenda kuptimit të nenit 28 të KPK-së, kërkon që kryesi të ketë ndërmarrë veprime për kryerjen e veprës penale por veprimi nuk ka përfunduar apo nuk janë përmbushur elementet e veprës penale të synuar.<sup>303</sup> Trupi Gjykues thekson se neni 28 i KPK-së nuk bën përcaktim të mëtejshëm të kufijve se çfarë përbën ndërmarrjen e veprimit drejt kryerjes së veprës penale. Gjithsesi, Trupi Gjykues konsideron se një veprim i tillë duhet të shkojë përtej veprimeve

---

<sup>301</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 94.

<sup>302</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82.

<sup>303</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 95.



përgatitore.<sup>304</sup> Rrjedhimisht, kryesi bën tentativë për kryerjen e veprës penale nëse ai ose ajo ka filluar kryerjen e një ose më shumë elementeve materiale të veprës penale.<sup>305</sup>

202. Sa u takon elementeve subjektive të kësaj forme të përgjegjesisë penale, Trupi Gjykses konstaton se për tentativën nevojitet synim i drejtpërdrejtë ose eventual, brenda kuptimit të nenit 21 të KPK-së.<sup>306</sup>

203. Në lidhje me zbatimin e kësaj forme të përgjegjesisë penale ndaj veprave penale për të cilat janë ngritur akuzat, Trupi Gjykses thekson se, në pajtim me nenin 28(2) të KPK-së, tentativa për të kryer vepër penale është e ndëshkueshme vetëm nëse (i) për veprën penale të kryer mund të shqiptohet dënim me tre ose më shumë vjet burgim ose (ii) nëse ajo parashihet shprehimisht në ligj.<sup>307</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se tentativa mund të jetë e ndëshkueshme vetëm në lidhje me veprat penale në Pikat 1-4 dhe 6 të Aktakuzës. Neni 392(1) i KPK-së (Pika 5) parasheh dënim me deri një vit burgim dhe nuk parasheh shprehimisht ndëshkimin e tentativës për kryerje.<sup>308</sup>

#### IV. NGJARJET NË FJALË

204. Gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit morën tri grupe dokumentesh nga burime të panjohura, ("tri grupet e dokumenteve") që i përkisnin punës ose hetimeve të TFHS-së dhe ZPS-së. Materiali u dorëzua në selinë e OVL-UÇK-së në Prishtinë më 7 shtator 2020, 16 shtator 2020, dhe 22 shtator 2020 ("tri dorëzimet").

205. Pas çdo dorëzimi, të akuzuarit organizuan dhe mbajtën konferencë për shtyp gjatë së cilës diskutuan dhe i bënë të disponueshme për gazetarët secilën nga tri grupet e dokumenteve ("tri konferencat për shtyp").

---

<sup>304</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 96.

<sup>305</sup> *Shih*, ndonëse me formulim më të kufizuar, F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 96.

<sup>306</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82; *Salihu dhe të tjerët*, neni 28 i KPK-së së vitit 2012, nm. 2b), f. 130-131.

<sup>307</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 97.

<sup>308</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 97.

206. Gjatë periudhës së njëjtë, të akuzuarit, individualisht ose bashkërisht, dhanë një numër intervistash për mediat në lidhje me këtë material. Ata gjithashtu komentuan në lidhje me materialin dhe ribotuan artikuj në media sociale lidhur me të.

## A. GRUPI I PARË I DOKUMENTEVE

### 7 shtator 2020

#### (a) Dorëzimi i dokumenteve

207. Më 7 shtator 2020, afërsisht midis orës 9.15 dhe 10.00 të mëngjesit,<sup>309</sup> në dukje pa ndonjë paralajmërim,<sup>310</sup> një person i panjohur dorëzoi një grup dokumentesh që kishin lidhje me hetimet e TFHS-së dhe ZPS-së (“grupi i parë”) në selinë e OVL-UÇK-së në Prishtinë (“dorëzimi i parë”).<sup>311</sup>

208. Personi hyri në selinë e OVL-UÇK-së dhe la një kuti kartoni në recepsion afër sekretares së OVL-UÇK-së, znj. Miftari.<sup>312</sup> Personi tha se do të sillte materiale të tjera dhe se kjo paketë ishte për “personin që flet në televizor”.<sup>313</sup> Z. Gucati dhe znj. Miftari

---

<sup>309</sup> P1, f. 1 (z. Gucati vlerësoi se dorëzim u bë afërsisht në orën 9.15 paradite); 1D4, para. 3; 1D9, para. 10 (znj. Miftari dhe z. Gashi vlerësuan se dorëzimi ndodhi “afërsisht në orën 10:00”); 1D19; 1D20; 1D21; 1D22 (fragmentet nga filmimi i kamerave të sigurisë tregon se dorëzimi ndodhi në orën 9.53 paradite); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2414; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2453; DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2582; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2720 (përcakton si kohë 9.30-10.00 paradite). *Shih gjithashtu* P24, f. 7 (z. Haradinaj vlerëson se dorëzimi ndodhi afërsisht në orën 9.00 paradite); 2D1, para. 46 (z. Haradinaj sugjeron se arriti midis orës 10.00 paradite dhe 10.30 paradite, në kundërshtim me përshkrimet e tij të mëparshme).

<sup>310</sup> P1, f. 4 (z. Haradinaj: “Ne s’kemi pas paralajmërim për këto. Na e kanë pru, e kanë lanë paketën. Janë ato zonjat që e kanë pranë. Jemi dal e kemi këqyr”). *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2181.

<sup>311</sup> P1, f. 1; P9, f. 1; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2453-2455.

<sup>312</sup> *Shih p.sh.* 1D3, para. 13; 1D4, para. 3-6; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2165. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2453-2454.

<sup>313</sup> 1D3, para. 13; 1D4, para. 5-7; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2165, 2212; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2403-2404; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2454.

e kuptuan se kjo u referohej të dy të akuzuarve,<sup>314</sup> ndërsa z. Haradinaj mendoi se kjo i referohej atij.<sup>315</sup>

209. Personi fliste shqip pa theks.<sup>316</sup> Ai nuk mund të identifikohet me ndonjë mënyrë tjetër.<sup>317</sup>

210. Znj. Miftari informoi z. Gucati, z. Haradinaj dhe z. Klinaku se një person i panjohur kishte lënë një kuti në zyrën e saj.<sup>318</sup> Z. Gucati, z. Haradinaj dhe z. Klinaku shkuan ta inspektonin kutinë, për të cilën ata patën frikë se mund të përmbante bombë ose eksplozivë.<sup>319</sup> E hapën kutinë dhe zbuluan dokumentet; më pas e çuan në zyrën e z. Gucati.<sup>320</sup> Në selinë e OVL-UÇK-së në atë kohë ishin të pranishëm edhe z. Çelë Gashi dhe z. Elvir Gucati.<sup>321</sup>

(b) Këqyrja e dokumenteve

211. Z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku dhe z. Çelë Gashi këqyrën përmbajtjen e kutisë.<sup>322</sup> Sipas z. Gucati, mbi dokumentet ishte edhe një shënim me shkrim dore në të

---

<sup>314</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2403-2404; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2471-2472.

<sup>315</sup> 2D1, para. 48; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2723.

<sup>316</sup> *Shih p.sh.* 1D4, para. 6 (znj. Miftari: "Njeriu foli në gjuhën shqipe dhe nuk kishte asgjë të pazakonshme apo të çuditshme lidhur me mënyrën si foli ai"); Transkripti, DW1241 (Taibe Miftari) 9 dhjetor 2021, f. 2454-2455.

<sup>317</sup> 1D4, para. 4, 8; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2165. *Shih gjithashtu* P1, f. 1.

<sup>318</sup> *Shih p.sh.* 1D3, para. 13; 1D4, para. 3-10; 2D1, para. 48; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2165; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2454; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2720-2722.

<sup>319</sup> 1D3, para. 13; 1D4, para. 10; 2D1, para. 49; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2396-2397; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2455.

<sup>320</sup> 1D3, para. 13; 1D4, para. 10-11; 2D1, para. 49-51; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2252; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2455; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2723.

<sup>321</sup> 1D3, para. 12; 1D4, para. 7; 1D9, para. 10; 2D1, para. 47; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2454.

<sup>322</sup> P1, f. 1; 1D3, para. 13-16; 1D9, para. 14; 2D1, para. 50-51; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2253; DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2583-2584, 2591, 2594-2600.

cilin thuhej se më vonë do të silleshin edhe 7.000 dokumente shtesë.<sup>323</sup> U vlerësua se grupi i parë i dokumenteve përmbante afërsisht 4.000 dokumente ose faqe dokumentesh;<sup>324</sup> ai përbëhej nga katër grumbuj dokumentesh identike.<sup>325</sup>

212. Z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku, z. Çelë Gashi dhe ndoshta edhe dy anëtarë të tjerë të kryesisë së OVL-UÇK-së vendosën se duhej organizuar një konferencë për shtyp në lidhje me dorëzimin e parë.<sup>326</sup> Z. Gucati autorizoi z. Klinaku që të informonte mediat dhe t'i ftonte të merrnin pjesë në konferencë.<sup>327</sup>

(c) Njoftimi për mediat lidhur me konferencën për shtyp të OVL-UÇK-së

213. Shpejt pas dorëzimit të parë, gazeta *Infokus* botoi artikullin e parë në lidhje me të.<sup>328</sup>

(d) Konferenca e parë për shtyp

214. Afërsisht rreth orës 1.00 pasdite më 7 shtator 2020,<sup>329</sup> të dy të akuzuarit organizuan dhe mbajtën konferencën e parë për shtyp, në funksionet e tyre përkatëse si kryetar dhe nënkryetar të OVL-UÇK-së (“konferenca e parë për shtyp”).<sup>330</sup>

<sup>323</sup> 1D3, para. 15; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2166; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2394-2396.

<sup>324</sup> P1, f. 1-2; P17, f. 7; P24, f. 7; 1D3, para. 19; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2172. *Shih gjithashtu* P9, f. 7; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2723-2724. *Shih më poshtë* para. 362, 398 (Konstatime mbi paketat).

<sup>325</sup> *Shih p.sh.* 2D1, para. 53, 61; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2723-2724. *Shih më poshtë* para. 363, 374 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>326</sup> *Shih p.sh.* 1D3, para. 17; 2D1, para. 52; DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2169; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>327</sup> 1D3, para. 18; DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 56; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>328</sup> P129, f. 8; 1D2, f. 32.

<sup>329</sup> 1D3, para. 19; 2D1, para. 55; DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2414; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2729.

<sup>330</sup> P1. *Shih gjithashtu* P51.

215. Në të morën pjesë rreth 12 deri 25 gazetarë, përfshirë nga mediat në vijim: *gazeta Infokus, Kosovo Press, Ekonomia online, dhe ndoshta Kallxo.com*.<sup>331</sup>

216. Grupi i parë i dokumenteve u ekspozua në tavolinë përpara të akuzuarve.<sup>332</sup> Gazetarët i shfletuan ato.<sup>333</sup>

217. Z. Gucati filloi duke përshëndetur gazetarët e pranishëm dhe bëri një hyrje të përgjithshme për arsyet e thirrjes së konferencës së parë, konkretisht për dorëzimin e parë.<sup>334</sup> Z. Gucati më pas i dha fjalën z. Haradinaj, duke thënë se z. Haradinaj kishte shikuar shkurtimisht grupin e parë të dokumenteve dhe i kishte analizuar me z. Klinaku dhe të tjerë, dhe “për çdo send, për çdo informim që do të ketë këtu do t’ju njoftojë”.<sup>335</sup>

218. Kur z. Haradinaj mori fjalën ai tha se “jemi befasu për të mirë” nga dorëzimi i parë, duke sugjeruar se grupi i parë i dokumenteve ishte dëshmi e njëanshmërisë së DHS-së/ZPS-së dhe kritikoi ata të cilët përkrahën krijimin e saj.<sup>336</sup> Z. Haradinaj shtoi se ata patën kohë vetëm sa të shfletonin grupin e parë të dokumenteve, por “kishin vërejtur shumë”.<sup>337</sup> Ai shpjegoi se ata e organizuan konferencën për shtyp pa u përgatitur, sepse e konsideronin grupin e parë të dokumenteve të rëndësishëm për mediat dhe publikun; duke theksuar se çdo dokument që “del” nga DHS-ja është “aty”, i disponueshëm për mediat.<sup>338</sup>

---

<sup>331</sup> 2D1, para. 57-58; W04866 (Halil Berisha) Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1516-1517; Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1634; DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2730.

<sup>332</sup> DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2171; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2370, 2382; DW1249 (Nasim Haradinaj) Transkripti, 11 janar 2022, f. 2730-2731.

<sup>333</sup> P1. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 57.

<sup>334</sup> P1, f. 1; 1D3, para. 20.

<sup>335</sup> P1, f. 1.

<sup>336</sup> P1, f. 1-2.

<sup>337</sup> P1, f. 2. *Shih gjithashtu* P1, f. 4.

<sup>338</sup> P1, f. 4.

219. Më vonë gjatë konferencës së parë për shtyp, z. Haradinaj deklaroi se ata nuk dinin as si ishte marrë grupi i parë i dokumenteve, e as qëllimin e dorëzimit të parë.<sup>339</sup> Ai tha që ai besonte se dorëzimi i parë ishte provokim nga DHS-ja/ZPS-ja, duke marrë parasysh natyrën “top sekret” të dokumenteve që përfshiheshin në grupin e parë të dokumenteve.<sup>340</sup> Z. Haradinaj gjithashtu dha komente të hollësishme në lidhje me përmbajtjen e grupit të parë të dokumenteve.<sup>341</sup> Z. Haradinaj më pas kritikoi DHS-në, vuri në dyshim aftësinë e saj për të mbrojtur dëshmitarët duke mbajtur parasysh dorëzimin e parë,<sup>342</sup> dhe tha se ata po e publikonin grupin e parë të dokumenteve për ta bërë të ditur këtë paftësi për t’i mbrojtur.<sup>343</sup>

220. Z. Haradinaj, në prani të z. Gucati, u zotua se do t’u jepte gazetarëve kopje të grupit të parë të dokumenteve, i ftoi ata të bënin kopje, dhe theksoi se do të mund të lexonin sa emra të donin në të.<sup>344</sup> Z. Haradinaj gjithashtu i nxiti gazetarët të shikonin deklaratat dhe emrat e përfshirë në grupin e parë të dokumenteve.<sup>345</sup> Mediat morën tri nga katër kopjet e dokumenteve që përfshiheshin në grupin e parë të dokumenteve.<sup>346</sup> Kopjen e fundit e mori ZPS-ja më vonë.<sup>347</sup>

221. Kur përfundoi konferenca e parë për shtyp, gazetarët dhe kameramanët filluan të filmonin ose të fotografonin grupin e parë të dokumenteve.<sup>348</sup> Njëri prej gazetarëve, z. Berisha, kërkoi të merrte një kopje; z. Haradinaj iu përgjigj se mund t’i merrte dokumentet<sup>349</sup> dhe shtoi se, meqë nuk kishte kopje të mjaftueshme për të gjitha mediat,

---

<sup>339</sup> P1, f. 5.

<sup>340</sup> P1, f. 5.

<sup>341</sup> P1, f. 2, 3, 8.

<sup>342</sup> P1, f. 2-3. *Shih gjithashtu* P1, f. 5.

<sup>343</sup> P1, f. 2-3, 5.

<sup>344</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 5-7.

<sup>345</sup> P1, f. 8.

<sup>346</sup> *Shih p.sh.* Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1960. *Shih më poshtë* para. 236 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>347</sup> *Shih më poshtë* para. 236 (Ngjarjet në Fjalë).

<sup>348</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1519-1520. *Shih p.sh.* P1, f. 1, 6, 8.

<sup>349</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1520; Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1585-1586. *Shih më lart* para. 59 (Pranimi dhe vlerësimi i provave).

gazetarët duhej të bashkëpunonin me media të tjera nëse kërkonin kopje dhe të ndanin dokumentet me to.<sup>350</sup> Z. Berisha i shikoi dokumentet në tavolinë me kameramanin e tij për afërsisht 10 minuta, dhe më pas mori një pjesë të tyre – afërsisht 1000 faqe<sup>351</sup> – dhe u largua për në zyrën e tij.<sup>352</sup> Konferenca e parë përfundoi rreth orës 2.00 pasdite.<sup>353</sup>

(e) Paraqitjet e të akuzuarve në media

222. Më pas më 7 shtator 2020, z. Gucati u paraqit në programin televiziv “Imazh” të RTK1.<sup>354</sup> Z. Gucati shpjegoi rrethanat e dorëzimit të parë.<sup>355</sup> Ai dha hollësi dhe komentoj në lidhje me disa informacione që përfshiheshin në grupin e parë të dokumenteve, si për shembull për një numër deklaratash të dëshmitarëve, si dhe hollësi të intervistave që përfshiheshin aty.<sup>356</sup> Z. Gucati deklaroi se grupi i parë i dokumenteve tregonte bashkëpunimin midis ZPS-së dhe autoriteteve serbe.<sup>357</sup>

223. Ai theksoi se: (i) grupit të parë të dokumenteve i ishte bashkëngjitur një shënim ku thuhej se do të dorëzoheshin edhe 7.000 dokumente shtesë,<sup>358</sup> (ii) nuk patën kohë të mjaftueshme të shikonin të gjitha dokumentet;<sup>359</sup> dhe (iii) një kopje iu dorëzua *KosovaPress-it*.<sup>360</sup> Ai tha se sipas mendimit të tij grupi i parë i dokumenteve ishte autentik.<sup>361</sup>

<sup>350</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1521-1522.

<sup>351</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1520-1521; Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1633-1634. *Shih gjithashtu* Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1587-1588.

<sup>352</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1585.

<sup>353</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2733.

<sup>354</sup> P9.

<sup>355</sup> P9, f. 1.

<sup>356</sup> P9, f. 10.

<sup>357</sup> P9, f. 6.

<sup>358</sup> P9, f. 4. ZPS-ja nuk e ka gjetur atë shënim. *Shih gjithashtu* P92, para. 13; 1D3, para. 15; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2166.

<sup>359</sup> P9, f. 6. *Shih gjithashtu* P9, f. 7.

<sup>360</sup> P9, f. 5.

<sup>361</sup> P9, f. 4-5.

224. Z. Gucati vuri në dyshim mbrojtjen e dëshmitarëve nga DHS-ja.<sup>362</sup> Z. Gucati tha se nuk do të bënin të ditur emrat, sepse ata nuk i njihnin personat, ndër të cilët, siç tha ai kishte serb, romë dhe turq.<sup>363</sup> Personat që ai i identifikoi në grupin e parë të dokumenteve se kanë bashkëpunuar me DHS-në ai i përshkroi si “shqipfolës”,<sup>364</sup> “tradhtarë”<sup>365</sup> dhe “bashkëpunëtorë”.<sup>366</sup> Z. Gucati tha se në grupin e parë të dokumenteve ai pa “shumë gjin që na kemi besu n’ta”;<sup>367</sup> ai shprehu mendimin se disa dëshmitarë morën pjesë në intervista për të marrë “letrat për t’u dhënë azil në perëndim” dhe se versionet e tyre përmbanin “shumë trillime”.<sup>368</sup> Z. Gucati pranoi se “mund të ndodhnin [gjëra]” si pasojë e publikimit të emrave të identifikuar në grupin e parë të dokumenteve.<sup>369</sup>

(f) Artikuj të mëtejshëm në media dhe korrespondenca me ZPS-në

225. Më 7 shtator 2020, [REDAKTUAR] botoi disa artikuj të mëtejshëm në lidhje me përmbajtjen e grupit të parë të dokumenteve.<sup>370</sup>

226. Në të njëjtën ditë, gazeta *Infokus* informoi ZPS-në se ata kishin në posedim materialin e marrë nga OVL-UÇK më 7 shtator 2020.<sup>371</sup>

227. Gjithashtu më 7 shtator 2020, ZPS-ja mori nga [REDAKTUAR] fotografi të dokumenteve që përfshiheshin në paketat 1 dhe 4.<sup>372</sup>

---

<sup>362</sup> P9, f. 5.

<sup>363</sup> P9, f. 6-7.

<sup>364</sup> P9, f. 6, 12.

<sup>365</sup> P9, f. 12.

<sup>366</sup> P9, f. 11, 13.

<sup>367</sup> P9, f. 9.

<sup>368</sup> P9, f. 11.

<sup>369</sup> P9, f. 8.

<sup>370</sup> *Shih p.sh.* P125, f. 1, 4; P125ET, f. 1-2; P129, f. 1, 12, 14, 15; 1D2, f. 1, 9, 44, 50, 55, 61. *Shih gjithashtu* P86, para. 13-18.

<sup>371</sup> P98, para. 4. *Shih gjithashtu* P98, f. 7; P98.1.

<sup>372</sup> P101. *Shih më poshtë* para. 338 (Konstatimet mbi paketat).



**8 shtator 2020**

## (a) Sekuestrimi i grupit të parë të dokumenteve

228. Më 8 shtator 2020, përfaqësuesit e ZPS-së arritën në selinë e OVL-UÇK-së.

229. Përfaqësuesit e ZPS-së i dorëzuan z. Klinaku urdhrin e Gjykatësit të Vetëm të DHS-së (“Gjykatësi i Vetëm”) në lidhje me OVL-UÇK-në (“Urdhri i Parë”).<sup>373</sup> Z. Klinaku iu lexuan paragrafët 22 dhe 25 të Urdhrit të Parë si dhe rregulla 42(1) e Rregullores në anglisht dhe iu përkthyen në shqip; atij iu dha një kopje e Urdhrit të Parë.<sup>374</sup>

230. Paragrafët 22(a) dhe (c) të Urdhrit të Parë: (i) autorizonin ZPS-në të sekuestronte dokumentet në posedim të z. Gucati dhe/ose të OVL-UÇK-së;<sup>375</sup> dhe (ii) urdhëronin z. Gucati, OVL-UÇK-në dhe gjithë personat e tjerë që kishin në posedim materialin në fjalë dhe/ose përmbajtjen e tyre, që të mos kopjonin dhe shpërndanin më tej, nëpërmjet çfarëdo mjeti të komunikimit, dokumentet dhe përmbajtjen e tyre.<sup>376</sup>

231. Asnjëri nga të akuzuarit nuk ishte i pranishëm në selinë e OVL-UÇK-së atë ditë, por z. Klinaku kontaktoi z. Gucati gjatë kontrollit; z. Gucati e udhëzoi z. Klinaku t’ia dorëzonte dokumentet ZPS-së.<sup>377</sup> Në përputhje me Urdhrin e Parë, ZPS-ja sekuestroi një numër dokumentesh nga grupi i parë i dokumenteve në posedim të OVL-UÇK-së (“sekuestrimi i parë”).<sup>378</sup> ZPS-ja i referohet këtij materiali si “paketa 1”.<sup>379</sup>

<sup>373</sup> F5 Urdhri i Parë; 1D3, para. 28; 1D4, para. 14-17; 1D9, para. 17-22; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2181-2182. *Shih gjithashtu* P56; P57; P92, para. 2-4, 6; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2456-2457.

<sup>374</sup> P92, f. 3-4, 6; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1930.

<sup>375</sup> P52, para. 22(a).

<sup>376</sup> P52, para. 22 (c).

<sup>377</sup> DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2182-2183. *Shih gjithashtu* W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1959-1960; 1D3, para. 27-28.

<sup>378</sup> P92.

<sup>379</sup> P86, para. 5. *Shih më poshtë* para. 334-345 (Konstatime mbi paketat).

(b) Artikuj të mëtejshëm në media

232. Më 8 shtator 2020, gazeta *Infokus* botoi një artikull lidhur me sekuestrimin e parë.<sup>380</sup>

(c) Paraqitjet e ndihmësve në media

233. Më 8 shtator 2020, z. Klinaku u paraqit në emisionin e lajmeve të *RTK1* ku diskutoi nxjerrjen e grupit të parë të dokumenteve dhe sekuestrimin e parë.<sup>381</sup>

(d) Postimet në *Facebook*

234. Më 8 shtator 2020, në profilet e të dy të akuzuarve në *Facebook* dolën postime në lidhje me dorëzimin e parë dhe sekuestrimin e parë.<sup>382</sup>

## 9-15 shtator 2020

(a) Artikuj të mëtejshëm në media

235. Midis 9 dhe 11 shtatorit 2020, *Gazeta Infokus* dhe [REDAKTUAR] botuan tre artikuj të tjerë në lidhje me grupin e parë të dokumenteve.<sup>383</sup>

(b) Dorëzimi i dokumenteve nga gazeta *Infokus*

236. Pasi kontaktoi ZPS-në më 7 shtator 2020, më 9 shtator 2020, gazeta *Infokus* i dorëzoi ZPS-së vullnetarisht dokumentet që i kishte marrë gjatë konferencës së parë

---

<sup>380</sup> P129, f. 4; P129ET, f. 4; 1D2, f. 23.

<sup>381</sup> P13.

<sup>382</sup> P60, f. 25-26, P80 (i njëjti postim në profilin e z. Haradinaj); P78, P79 (i njëjti postim në profilin e z. Haradinaj); P83, f. 49 (profili i z. Gucati, në të cilin u paraqit postimi nga profili i z. Haradinaj).

<sup>383</sup> P129, f. 2-3; 1D2, f. 5, 20 (dy artikuj të botuara nga gazeta *Infokus* më 9 shtator 2020); P125, f. 9; P125, f. 3 ([REDAKTUAR]).

për shtyp (“grupi i katërt i dokumenteve”).<sup>384</sup> ZPS-ja i referohet grupit të katërt të dokumenteve si “paketa 4”.<sup>385</sup>

(c) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media

237. Më 9 shtator 2020, z. Haradinaj u paraqit në emisionin televiziv “Imazh” të RTK1, gjatë të cilit përsëri u diskutuan përmbajtja, prejardhja dhe autenticiteti i grupit të parë të dokumenteve, shpërndarja e tyre gazetarëve dhe aspekti i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunimi me Serbinë.<sup>386</sup> Z. Haradinaj ftoi gazetarët të kishin “guximin” të publikonin informacionin.<sup>387</sup>

238. Më 10 shtator 2020, z. Klinaku mori pjesë në një program televiziv të *Top Channel*-it si përfaqësues i OVL-UÇK-së ku diskutoi, ndër të tjera, sekuestrimin e parë.<sup>388</sup>

239. Më 11 shtator 2020, z. Haradinaj dha një intervistë – që më vonë u ribotua në profilin e tij në *Facebook*<sup>389</sup> – në programin televiziv “Imazh” të RTK1.<sup>390</sup> Gjatë asaj interviste, z. Haradinaj u zotua se OVL-UÇK-ja do të bënte publik material të ngjashëm me grupin e parë të dokumenteve sa herë që të merrnin material të tillë.<sup>391</sup> Ai gjithashtu diskutoi, ndër të tjera, autenticitetin dhe përmbajtjen e grupit të parë të dokumenteve, këqyrjen e tij prej OVL-UÇK-së, DHS-në dhe bashkëpunimin e saj me zyrtarë serbë dhe problemin e mbrojtjes së dëshmitarëve.<sup>392</sup>

---

<sup>384</sup> P99; P100. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 887-892.

<sup>385</sup> P89, para. 5.

<sup>386</sup> P24.

<sup>387</sup> P24, f. 3, 10.

<sup>388</sup> P22; P60, f. 23-24; P76.

<sup>389</sup> P60, f. 21-22.

<sup>390</sup> P21.

<sup>391</sup> P21, f. 3.

<sup>392</sup> P21, f. 3-5.

(d) Postimet në *Facebook*

240. Më 9, 10, 11 dhe 12 shtator 2020, në profilin e z. Haradinaj në *Facebook* dolën disa postime në lidhje me grupin e parë të dokumenteve.<sup>393</sup> Këto postime përmbanin paraqitjet në media të z. Klinaku (10 shtator 2020) dhe të z. Haradinaj (11 shtator 2020).<sup>394</sup>

241. Më 10 shtator 2020, në profilin e z. Gucati në *Facebook* doli një postim në lidhje me grupin e parë të dokumenteve.<sup>395</sup>

(e) Vendimi i kryesisë së OVL-UÇK-së

242. Më 14 ose 15 shtator 2020, 23 anëtarët e kryesisë së OVL-UÇK-së – ndër të cilët të dy të akuzuarit – vendosën njëzëri të vijonin të bënin publike materiale të tilla në qoftë se do t'i vinin organizatës në posedim përsëri.<sup>396</sup>

---

<sup>393</sup> P60, f. 29; P61, f. 3-4; P83, f. 1 (9 shtator 2020); P60, f. 23-24; P76; P77 (i njëjti postim në profilin e z. Haradinaj) (10 shtator 2020); P60, f. 21-22, 27-28 (11 shtator 2020); P83, f. 2 (12 shtator 2020).

<sup>394</sup> P60, f. 23-24; P76 (10 shtator 2020); P60, f. 21-22 (11 shtator 2020).

<sup>395</sup> P83, f. 48.

<sup>396</sup> 1D4, para. 26; 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475.

## B. GRUPI I DYTË I DOKUMENTEVE

### 16 shtator 2020

#### (a) Dorëzimi i dokumenteve

243. Më 16 shtator 2020, rreth orës 3.30 pasdite,<sup>397</sup> një person i panjohur dorëzoi një grup të dytë dokumentesh (“grupi i dytë i dokumenteve”) në selinë e OVL-UÇK-së (“dorëzimi i dytë”).<sup>398</sup> *Arbresh.info* filmoi dorëzimin e dytë.<sup>399</sup>

244. Ky person, që nuk mendohet të jetë i njëjti person që bëri dorëzimin e parë,<sup>400</sup> la tri kuti në një tavolinë afër tavolinës së znj. Miftari.<sup>401</sup> Ai nuk tha asgjë dhe u largua.<sup>402</sup> Nuk kishte asnjë tregues me anë të të cilit mund të identifikohet personi.<sup>403</sup> Z. Klinaku e ndoqi atë për pak kohë dhe pastaj u kthye kur u mendua se ai mund të ishte i armatosur.<sup>404</sup> Më pas kutitë i morën nga zyra e znj. Miftari dhe i çuan në zyrën e z. Gucati.<sup>405</sup>

---

<sup>397</sup> P2, f. 1 (“afërsisht në orën 15.30”); 1D4, para. 18; 1D23, 1D24, 1D25, 1D26 (fragmente nga filmimi i kamerave të sigurisë që tregojnë dorëzimin në orën 15:32); DW1242 (Elmedina Ballhazhi), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2456. Znj. Ballhazhi vlerësoi se dorëzimi ishte bërë midis orës 11.00 paradite dhe 12 në mesditë, që nuk përputhet me provat. *Shih p.sh.* 1D5, para. 3. Nga përshkrimi i saj duket se ajo ka ngatërruar kohën dhe datën që përshkroi. *Shih p.sh.* DW1242 (Elmedina Ballhazhi), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2513. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 70: Z. Haradinaj gaboi duke e dhënë kohën e dorëzimit midis orës 9.30 dhe 10.30 paradite.

<sup>398</sup> *Shih p.sh.* P2, f. 1; 1D3, para. 33; 1D4, para. 18; 1D9, para. 24-25; 2D1, para. 70.

<sup>399</sup> 1D5; 1D6.

<sup>400</sup> 1D4, para.22. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2457; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2743-2744.

<sup>401</sup> 1D4, para.19. *Shih gjithashtu* 1D9, para. 24-25; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2456.

<sup>402</sup> 1D4, para.19. *Shih gjithashtu* 1D9, para. 24-27; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2212; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2462.

<sup>403</sup> 1D3, para. 34; 1D4, para. 22; 1D9, para.26; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2188.

<sup>404</sup> 1D3, para. 34; 1D4, para. 21; 1D9, para.27; 2D1, para. 71; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2188-2189; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2457; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2741-2742. *Shih gjithashtu* P17, f. 9.

<sup>405</sup> 1D3, para. 34; 1D4, para. 21, 23; 2D1, para. 70. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2457; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2743.

## (b) Këqyrja e dokumenteve

245. Në selinë e OVL-UÇK-së në atë kohë ishin të pranishëm z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku, znj. Miftari, z. Çelë Gashi, z. Elvir Gucati dhe z. Faik Fazliu.<sup>406</sup>

246. Sikurse edhe herën e parë, z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku dhe personat e tjerë të pranishëm këqyrën grupin e dytë të dokumenteve.<sup>407</sup> Pas këqyrjes, ata supozuan se materiali ishte i DHS-së/ZPS-së.<sup>408</sup> Grupi i dytë i dokumenteve përfshinte midis 1300 dhe 2600 faqe dokumente.<sup>409</sup> Dukej se në të përfshiheshin tre grumbuj dokumentesh të njëjta,<sup>410</sup> prej të cilave disa në anglisht, shqip dhe serbisht.<sup>411</sup>

247. Sikurse me grupin e parë të dokumenteve, z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së OVL-UÇK-së që ishin të pranishëm vendosën të organizonin një konferencë për shtyp për të informuar mediat.<sup>412</sup> Z. Gucati autorizoi z. Klinaku që t'i informonte mediat dhe t'i ftonte të merrnin pjesë.<sup>413</sup>

---

<sup>406</sup> 1D3, para. 32-33; 1D4, para. 18, 20; 1D9, para. 24; 2D1, para. 70; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2186-2188; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2456-2457; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2740.

<sup>407</sup> 1D3, para. 36-37; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2744-2746. *Shih gjithashtu* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2587-2589.

<sup>408</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2191.

<sup>409</sup> P2, f. 10-11; P17, f. 2. *Shih gjithashtu* 2D1, para.75; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2744.

<sup>410</sup> 2D1, para. 75.

<sup>411</sup> 2D1, para. 79.

<sup>412</sup> 1D3, para. 35; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190-2191; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410.

<sup>413</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190-2191.

(c) Konferenca e dytë për shtyp

248. Afërsisht pas një orë e gjysmë,<sup>414</sup> OVL-UÇK mbajti një konferencë për shtyp ("konferenca e dytë për shtyp") ku të pranishëm ishin të dy të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së, ndër të cilët edhe z. Klinaku.<sup>415</sup>

249. Gjatë konferencës së dytë për shtyp, të dy të akuzuarit diskutuan përmbajtjen e grupit të dytë të dokumenteve në prani të njëri-tjetrit. Z. Gucati prezantoi temën.<sup>416</sup> Ai tha se ata nuk arritën të kapnin personin që i solli dokumentet dhe nuk arritën të kuptonin se kush ishte ai.<sup>417</sup> Z. Gucati tregoi një dokument në serbishte dhe ftoi të pranishmit t'i merrnin dokumentet.<sup>418</sup> Ai përmendi emra të zyrtarëve të TFHS-së dhe të Serbisë nga grupi i dytë i dokumenteve.<sup>419</sup> Z. Gucati tha se ata nuk patën kohë të këqyrnin plotësisht grupin e dytë të dokumenteve dhe shtoi se z. Haradinaj e kishte këqyrur materialin aq sa kishte mundur.<sup>420</sup>

250. Z. Gucati më pas i dha fjalën z. Haradinaj, i cili diskutoi dhe përshkroi, ndër të tjera, përmbajtjen dhe natyrën konfidenciale të grupit të dytë të dokumenteve, mendimet e tij për dorëzimin e dytë, dhe dyshimet e tij për DHS-në, duke pasur parasysh bashkëpunimin e saj me autoritetet serbe.<sup>421</sup> Z. Haradinaj tregoi arsyet e publikimit të dokumenteve dhe tha se nuk e konsideronin të paligjshëm zbulimin e emrave të zyrtarëve.<sup>422</sup> Ai përsëriti se do ta bënin publik materialin sa herë që ta merrnin.<sup>423</sup> Z. Haradinaj gjithashtu i nxiti të pranishmit që ta botonin informacionin.<sup>424</sup>

---

<sup>414</sup> *Shih* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2597.

<sup>415</sup> P2; 2D1, para. 80.

<sup>416</sup> P2, f. 1-2.

<sup>417</sup> P2, f. 1.

<sup>418</sup> P2, f. 1-2.

<sup>419</sup> P2, f. 1. *Shih gjithashtu* 1D3, para. 36; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2191-2192.

<sup>420</sup> P2, f. 2.

<sup>421</sup> P2, f. 2-4, 6-8, 11.

<sup>422</sup> P2, f. 4.

<sup>423</sup> P2, f. 4.

<sup>424</sup> P2, f. 7.

251. Sikurse në konferencën e parë për shtyp, të akuzuarit i ftuan përfaqësuesit e mediave që ishin të pranishëm, të merrnin ose të kopjonin materialin.<sup>425</sup> Një numër i papërcaktuar i përfaqësuesve të mediave iu përgjigjën kësaj ftese dhe morën disa nga materialet.<sup>426</sup> Të dy të akuzuarit u larguan nga dhoma; disa gazetarë qëndruan pas.<sup>427</sup>

(d) Artikujt në media

252. Më 16 shtator 2020, gazeta *Infokus* botoi dy artikuj në lidhje me grupin e dytë të dokumenteve.<sup>428</sup>

(e) Paraqitjet e të akuzuarve në media

253. Më 16 shtator 2020, z. Haradinaj mori pjesë në emisionin televiziv të quajtur “Prime Time” në Kanal10, ku ai, ndër të tjera, diskutoi autenticitetin dhe përmbajtjen e grupit të parë dhe grupit të dytë të dokumenteve, tha se mirëpriste dorëzime të mëtejshme, kritikoi DHS-në dhe ngriti dyshime për përligjjen e krijimit të saj.<sup>429</sup> Gjithashtu, u diskutuan pasojat e mundshme të publikimit të këtij materiali, ku z. Haradinaj tha se ata nuk ishin përgjegjës për asgjë përderisa nuk zbuloheshin emrat e dëshmitarëve.<sup>430</sup> Ai gjithashtu deklaroi se dëshironte të dëmtonte DHS-në.<sup>431</sup>

(f) Postimet në *Facebook*

254. Më 16 shtator 2020, në profilin e të akuzuarve në *Facebook* dolën postime në lidhje me grupin e dytë të dokumenteve.<sup>432</sup>

---

<sup>425</sup> P2, f. 4, 9-10. *Shih gjithashtu* P50.

<sup>426</sup> *Shih p.sh.* P4, f. 3; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2281-2283; 2D1, para. 79.

<sup>427</sup> 2D1, para. 80.

<sup>428</sup> P129, f. 9, 13; 1D2, f. 35, 47.

<sup>429</sup> P5, f. 1; P18, f. 2-4, 7.

<sup>430</sup> P18, f. 3.

<sup>431</sup> P18, f. 5-7.

<sup>432</sup> P60, f. 19-20; P74 (z. Haradinaj); P83, f. 47 (z. Gucati).



**17 shtator 2020****(a) Paraqitjet e të akuzuarve në media**

255. Më 17 shtator 2020, para sekuestrimit të grupit të dytë të dokumenteve, z. Haradinaj dha një intervistë për *KosovaPress*. Aty, ai përsëriti mendimet e tij për DHS-në, se dorëzime të mëtejshme ishin të mirëpritura dhe se ata do të nxirrnin çfarëdo materiali që do të merrnin. Ai gjithashtu theksoi se gazetarët kishin marrë shumë material.<sup>433</sup>

**(b) Sekuestrimi i grupit të dytë të dokumenteve**

256. Më 17 shtator 2020, përfaqësues të ZPS-së arritën në selinë e OVL-UÇK-së.<sup>434</sup>

257. Të pranishëm ishin z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku, z. Kryeziu, z. Marashi dhe një gazetar.<sup>435</sup> Gjithashtu i pranishëm ishte edhe z. Tomë Gashi, avokat nga Prishtina.<sup>436</sup> Përfaqësuesit e ZPS-së i dorëzuan z. Gucati një urdhër të Gjykatësit të Vetëm (“Urdhri i Dytë”) që autorizonte sekuestrimin e dokumenteve dhe urdhëronte që materiali në fjalë të mos kopjohej dhe të mos shpërndahej më tej.<sup>437</sup> Pas disa diskutimeve, përfaqësuesit e OVL-UÇK-së u pajtuan që ZPS-ja mund ta merrte materialin pa praninë e policisë së Kosovës.<sup>438</sup>

---

<sup>433</sup> P33, f. 1-3.

<sup>434</sup> 1D3, para. 38; 1D4, para. 27; 1D8, para. 10, 13; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2193.

<sup>435</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2197; P7, f. 7-8; 2D1, para. 85

<sup>436</sup> 2D1, para. 89-90, 92.

<sup>437</sup> F7 Urdhri i Dytë; P4, f. 8; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2289-2295. Hetuesi i ZPS-së përforcoi edhe gojarisht udhëzimin se materiali nuk duhej të shpërndahej. *Shih gjithashtu* Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2292-2293, 2295.

<sup>438</sup> 1D3, para. 42; 2D1, para. 93; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2197; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288-2289.

258. Në përputhje me Urdhrin e Dytë, ZPS-ja sekuestroi dokumente të grupit të dytë që ishin ende në zotërim të OVL-UÇK-së ("sekuestrimi i dytë").<sup>439</sup> Këtij materiali ZPS-ja i referohet si "paketa 2".<sup>440</sup>

(c) Paraqitje të mëtejshme të të akuzuarve dhe të ndihmësve në media

259. Menjëherë pas sekuestrimit të dytë, më 17 shtator 2020, z. Gucati dhe anëtarë tjerë të OVL-UÇK-së mbajtën konferencën për shtyp.<sup>441</sup> Në të morën pjesë si z. Gucati ashtu edhe z. Tomë Gashi.<sup>442</sup>

260. Gjatë asaj konference u diskutua gjerësisht grupi i dytë i dokumenteve, efekti i nxjerrjes së tyre dhe sekuestrimi i dytë.<sup>443</sup> Z. Gucati tha se ata nuk dinin se kush ua dha këtë material, tregoi se mediave u kishin dhënë rreth 70% të dokumenteve që kishin marrë dhe shpjegoi arsyet për publikimin e tyre.<sup>444</sup>

261. Z. Tomë Gashi, në cilësinë e avokatit të OVL-UÇK-së, pretendoi se veprimet e tyre ishin të ligjshme me kusht që të mos publikonin emrat e dëshmitarëve.<sup>445</sup> Ai gjithashtu i këshilloi gazetarët që të mos i publikonin këto emra<sup>446</sup>. Z. Tomë Gashi u tregoi gazetarëve edhe dy dokumente nga grupi i dytë që ai tha se ishin të DHS-së/ZPS-së, si dhe Urdhrin e Dytë.<sup>447</sup> Ai gjithashtu shprehu një sërë pretendimesh, ndër të tjera, për DHS-në/ZPS-në, burimin e grupit të dytë të dokumenteve, dhe sekuestrimin e dytë.<sup>448</sup>

---

<sup>439</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1937-1941.

<sup>440</sup> P86, para. 19.

<sup>441</sup> 1D3, para. 44.

<sup>442</sup> P4. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2290.

<sup>443</sup> P4, f. 2-3, 8.

<sup>444</sup> P4, f. 3.

<sup>445</sup> P4, f. 3-5, 7, 9-10.

<sup>446</sup> P4, f. 3-5, 7, 9-10

<sup>447</sup> P4, f. 1, 3.

<sup>448</sup> P4, f. 6-7.

262. Më 17 shtator 2020, z. Haradinaj mori pjesë në emisionin televiziv “Frontal” të T7, ku, ndër të tjera, diskutoi dorëzimin e dytë dhe sekuestrimin e dytë.<sup>449</sup> Ai pretendoi se ZPS-ja kishte marrë vetëm afërsisht 20% të grupit të dytë të dokumenteve dhe tha se gazetarët kishin marrë pjesën tjetër.<sup>450</sup> Z. Haradinaj gjithashtu bëri thirrje për nxjerrje të mëtejshme të atij materiali<sup>451</sup> dhe përgëzoi mediat për botimin e dokumenteve.<sup>452</sup> Pjesëmarrësit gjithashtu shkëmbyen mendime në lidhje me grupin e dytë të dokumenteve, ndër të tjera, për prejardhjen e tij,<sup>453</sup> natyrën e ndjeshme të tij,<sup>454</sup> dhe mbrojtjen e atyre që kishin emrat në të,<sup>455</sup> dhe pasojat e mundshme për dëshmitarët si rezultat i nxjerrjes publike të tij.<sup>456</sup> U diskutua edhe ligjshmëria e veprimeve të z. Haradinaj.<sup>457</sup>

263. Në të njëjtën ditë, më 17 shtator 2020, z. Haradinaj u paraqit edhe në një transmetim në *Euronews Albania*, ku ai, ndër të tjera, pretendoi se DHS-ja u shërbente interesave të serbëve,<sup>458</sup> la të kuptohet se informacionin në të cilin mbështetet ZPS-ja e kishin dhënë kriminelë serbë të luftës,<sup>459</sup> dhe konfirmoi se grupi i parë dhe grupi i dytë i dokumenteve ishin dokumente të DHS-së/ZPS-së.<sup>460</sup> Z. Haradinaj gjithashtu kritikoi DHS-në dhe mediat.<sup>461</sup>

264. Në të njëjtën ditë, z. Haradinaj dha një intervistë tjetër në emisionin televiziv “Pressing” të T7.<sup>462</sup> Ai shpjegoi se ata po e nxirrnin informacionin për të demaskuar

---

<sup>449</sup> P6, f. 3-5.

<sup>450</sup> P6, f. 17-18. *Shih gjithashtu* P6, f. 23.

<sup>451</sup> P6, p 4.

<sup>452</sup> P6, f. 16.

<sup>453</sup> P6, f. 29-30.

<sup>454</sup> P6, f. 18-20.

<sup>455</sup> P6, f. 9, 17, 40-41.

<sup>456</sup> P6, f. 21-22.

<sup>457</sup> P6, f. 15, 36.

<sup>458</sup> P19, f. 1.

<sup>459</sup> P19, f. 3-4.

<sup>460</sup> P19, f. 2.

<sup>461</sup> P19, p 3.

<sup>462</sup> P34.

DHS-në dhe për të mbrojtur anëtarët e OVL-UÇK-së.<sup>463</sup> Ai bëri thirrje për më shumë dorëzime.<sup>464</sup> Z. Haradinaj shprehu shpresën se nuk do të ngrihej aktakuzë kundër z. Thaçi dhe të tjerëve si rezultat i nxjerrjes së informacionit.<sup>465</sup> Ai gjithashtu tha se gjatë sekuestrimit të dytë, ZPS-ja kishte konfirmuar se dokumentet ishin autentike.<sup>466</sup>

(d) Postimet në *Facebook*

265. Më 17 shtator 2020, në profilin e z. Haradinaj në *Facebook* dolën tri postime në lidhje me grupin e parë dhe grupin e dytë të dokumenteve dhe dorëzimin e tyre.<sup>467</sup>

(e) Artikuj të mëtejshëm në media

266. Gjithashtu më 17 shtator 2020, gazeta *Infokus* dhe [REDAKTUAR] botuan katër artikuj në lidhje me grupin e dytë të dokumenteve.<sup>468</sup>

## 18-21 shtator 2020

(a) Artikuj të mëtejshëm në media

267. Midis 18 dhe 21 shtatorit 2020, [REDAKTUAR] botoi një artikull tjetër dhe [REDAKTUAR] një videomaterial në lidhje me grupin e parë dhe grupin e dytë të dokumenteve.<sup>469</sup>

---

<sup>463</sup> P34, f. 2.

<sup>464</sup> P34, f. 2.

<sup>465</sup> P34, f. 2.

<sup>466</sup> P34, f. 2-3.

<sup>467</sup> P61, f. 1-2; P72; P73.

<sup>468</sup> P129, f. 5, 7; 1D2, f. 29 (*Gazeta Infokus*); P124, f. 3; P128; 1D10; [REDAKTUAR].

<sup>469</sup> P125, f. 11; P123.

(b) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media

268. Më 18 shtator 2020, z. Haradinaj me z. Tomë Gashi u paraqitën në emisionin televiziv "Open Studio" të RTK3.<sup>470</sup> Dorëzimin e dytë ai e quajti "mrekulli" dhe shprehu shpresën se personi që solli materialin do të mbante premtimin për më shumë dorëzime.<sup>471</sup> Z. Haradinaj gjithashtu deklaroi se burimi i dokumenteve ishte i parëndësishëm dhe se faktori i vetëm me rëndësi ishte "me u dëshmue që nuk ka qenë gjykatë e Kosovës".<sup>472</sup> Në të njëjtën kohë, ai pretendoi se ZPS-ja kishte pranuar se dokumentet ishin të vetat,<sup>473</sup> dhe se, sido që të ishte, gazetarët kishin marrë 80% të materialit.<sup>474</sup>

269. Z. Tomë Gashi deklaroi se DHS-ja nuk ishte në gjendje të mbronte dëshmitarët.<sup>475</sup> Ndonëse pretendoi se publikimi i informacionit në lidhje me bashkëpunimin midis institucioneve nuk përbënte vepër penale,<sup>476</sup> z. Tomë Gashi i këshilloi gazetarët dhe të tjerët në zotërim të dokumenteve që të mos i bënin publike identitetet e dëshmitarëve.<sup>477</sup> Z. Tomë Gashi shtoi se dëshmitarët nuk kishin arsye për t'u ndier të kërcënuar.<sup>478</sup> Si z. Haradinaj ashtu edhe z. Tomë Gashi pretenduan se deklaratat me shkrim të dëshmitarëve ishin marrë nën presion ose frikësim.<sup>479</sup> Z. Haradinaj gjithashtu tha se arsyeja e publikimit të materialit ishte për të treguar se puna e DHS-së "është zero", duke shtuar se ai mendonte se "kjo gjykatë ka marrë fund".<sup>480</sup> Z. Tomë Gashi në mënyrë të përsëritur e lidhi këtë çështje me shpresën se akuzat që

---

<sup>470</sup> P7.

<sup>471</sup> P7, f. 2.

<sup>472</sup> P7, f. 13.

<sup>473</sup> P7, f. 11.

<sup>474</sup> P7, f. 7, 11. *Shih gjithashtu P17, f. 6.*

<sup>475</sup> P7, f. 5.

<sup>476</sup> P7, f. 14.

<sup>477</sup> P7, f. 4-5, 8, 15.

<sup>478</sup> P7, f. 8-9.

<sup>479</sup> P7, f. 6, 9.

<sup>480</sup> P7, f. 6.

pritej të ngriheshin kundër z. Thaçi dhe të tjerëve nuk do të konfirmoheshin.<sup>481</sup>

Z. Haradinaj shprehu të njëjtën shpresë.<sup>482</sup>

270. Më 19 shtator 2020, z. Haradinaj u intervistua nga *ABC News Albania*.<sup>483</sup> Ai pretendoi se DHS-ja ishte e njëanshme dhe se mandati i saj kishte përfunduar.<sup>484</sup> Ai i përshkroi bisedat me ZPS-në gjatë sekuestrimi të dytë, përfshirë edhe në lidhje me natyrën “e ndjeshme” të dokumenteve.<sup>485</sup> Z. Haradinaj pretendoi se dokumentet “ishin marrë si fakte me ngritë aktakuzë” dhe se deklaratat me shkrim të dëshmitarëve ishin marrë nën presion.<sup>486</sup> Z. Haradinaj gjithashtu tregoi para kamerave një version të legalizuar të Urdhrit të Dytë, bashkë me një dokument të ZPS-së që konfirmonte marrjen e materialit të sekuestruar.<sup>487</sup> Ai tha se ZPS-ja mori 20% të grupit të dytë të dokumenteve.<sup>488</sup> Z. Haradinaj tha se mirëpriste dorëzime të mëtejshme; ai gjithashtu lavdëroi dhe shprehu përkrahjen e tij për personat që ishin pas dy dorëzimeve.<sup>489</sup> Z. Haradinaj shprehu mendimin se rrjedhja njollosi reputacionin e DHS-së.<sup>490</sup>

271. Më 20 shtator 2020, z. Haradinaj ishte i ftuar në programin televiziv “Kosovo Show”, në të cilin ai tha se nuk e njihte DHS-në/ZPS-në.<sup>491</sup> Z. Haradinaj shtoi se sipas mendimit të tij rrjedhja e materialit vinte në dyshim besueshmërinë e DHS-së/ZPS-së,<sup>492</sup> dhe se personi përgjegjës për dorëzimet ishte “më se i mirëseardhur”.<sup>493</sup> Z. Haradinaj përsëriti arsyet e tij për publikimin e materialit.<sup>494</sup> Ai gjithashtu pretendoi

---

<sup>481</sup> P7, f. 5, 16-17.

<sup>482</sup> P7, f. 12-13.

<sup>483</sup> P17.

<sup>484</sup> P17, f. 1, 3.

<sup>485</sup> P17, f. 2, 4-5.

<sup>486</sup> P17, f. 2.

<sup>487</sup> P17 materiali filmik, minutat 00:13:20-00:14:32. *Shih gjithashtu* P17, f. 5-6.

<sup>488</sup> P17, f. 6.

<sup>489</sup> P17, f. 5.

<sup>490</sup> P17, f. 9.

<sup>491</sup> P25, f. 9.

<sup>492</sup> P25, f. 2.

<sup>493</sup> P25, f. 3.

<sup>494</sup> P25, f. 9-10.

se dokumentet ishin rimarrje e vendimeve të vjetra të fajësisë të dhëna nga organet serbe dhe se dëshmitarët ishin manipuluar ose morën përfitime për dëshmitë e tyre.<sup>495</sup> Duket se z. Haradinaj e mohoi që rrjedhja do të mund të krijonte rrezik për dëshmitarët dhe fajësoi DHS-në për mosmbrojtjen e emrave të tyre.<sup>496</sup>

272. Në të njëjtën ditë, 20 shtator 2020, z. Haradinaj mori pjesë në një emision tjetër, tek *Reporteri*, ku diskutoi rrjedhjen e materialit,<sup>497</sup> mirëpriti dorëzime të tjera,<sup>498</sup> dhe lavdëroi ata që dorëzuan dy grupet e para të dokumenteve.<sup>499</sup> Z. Haradinaj shprehu indiferencë lidhur me prejardhjen e materialit dhe mënyrën se si u mor ai.<sup>500</sup> Ai përsëriti se detyra e perceptuar e OVL-UÇK-së ishte që ta nxirrte materialin.<sup>501</sup> Ai shprehu mendimin se materiali i hoqi maskën DHS-së/ZPS-së dhe tregoi se ajo kishte mbledhur informacion nga “kriminelë, gjakpirës”.<sup>502</sup> Z. Haradinaj gjithashtu la të kuptohej se përshkrimet e dëshmitarëve ishin jo të besueshme.<sup>503</sup> Ai shprehu mendimin se grupi i parë i dokumenteve tregoi se “qyqonat”, “budallët”, “spiunët e lindur” nuk do të mund të mbroheshin.<sup>504</sup> Z. Haradinaj gjithashtu sugjeroi se DHS-ja ishte e njëanshme, politike dhe raciste,<sup>505</sup> dhe se ajo “ka me u rrëzuar krejt, sepse tash edhe dëshmitarët po e dinë që po dihen”.<sup>506</sup> Z. Haradinaj gjithashtu konfirmoi se mediat i kishin marrë dokumentet;<sup>507</sup> ai deklaroi se ata prisnin që mediat të publikonin më tej përmbajtjen e atij materiali.<sup>508</sup>

---

<sup>495</sup> P25, f. 5-7.

<sup>496</sup> P25, f. 7-8.

<sup>497</sup> P8, f. 1-4.

<sup>498</sup> P8, f. 4.

<sup>499</sup> P8, f. 24.

<sup>500</sup> P8, f. 17.

<sup>501</sup> P8, f. 6-7.

<sup>502</sup> P8, f. 7.

<sup>503</sup> P8, f. 7.

<sup>504</sup> P8, f. 26.

<sup>505</sup> P8, f. 27.

<sup>506</sup> P8, f. 30-31.

<sup>507</sup> P8, f. 10.

<sup>508</sup> P8, f. 21-22.

(c) Postimet në *Facebook*

273. Më 18 dhe 21 shtator 2020, në profilin e z. Gucati në *Facebook* dolën dy postime në lidhje me dokumentet.<sup>509</sup> Në postimin e 21 shtatorit 2020 thuhet, ndër të tjera, se DHS-ja pranoi se grupi i parë dhe grupi i dytë ishin dokumente zyrtare, përfshirë emrat e shumicës së dëshmitarëve dhe ishin “shumë konfidenciale dhe të ndjeshme”.<sup>510</sup>

274. Më 18, 19, 20 dhe 21 shtator 2020, në profilin e z. Haradinaj në *Facebook* dolën disa postime.<sup>511</sup> Postimet e 18 shtatorit 2020 përmbanin paraqitjet në media të z. Haradinaj në *Euronews Albania* (17 shtator 2020)<sup>512</sup> dhe *Open Studio* të RTK3-it (18 shtator 2020).<sup>513</sup> Në postimin e z. Haradinaj të 19 shtatorit 2020 tregohet paraqitja e tij në *Kanal10* (16 shtator 2020).<sup>514</sup> Postimi më 20 shtator 2020 kishte materialin filmik të [REDAKTUAR].<sup>515</sup>

**C. GRUPI I TRETË I DOKUMENTEVE****22 shtator 2020**

## (a) Dorëzimi i dokumenteve

275. Më 22 shtator 2020, një grup tjetër dokumentesh (“grupi i tretë i dokumenteve”) iu dorëzua OVL-UÇK-së. Afërsisht, midis orës 10.00 dhe 11.00 paradite një person i panjohur – i ndryshëm nga ata që sollën dokumentet dy herët e para<sup>516</sup> – hyri në selinë

---

<sup>509</sup> P83, f. 46 (18 shtator 2020); P59 (21 shtator 2020).

<sup>510</sup> P59, f. 3.

<sup>511</sup> P60, f. 14-17 (18 shtator 2020); P60, f. 10-11 (19 shtator 2020); [REDAKTUAR]; P68 (21 shtator 2020).

<sup>512</sup> P60, f. 14-15.

<sup>513</sup> P60, f. 16-17.

<sup>514</sup> P60, f. 12-13.

<sup>515</sup> [REDAKTUAR].

<sup>516</sup> 1D4, para. 34. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458-2459.



e OVL-UÇK-së dhe i la dokumentet në dysheme ("dorëzimi i tretë").<sup>517</sup> Personi i panjohur tha në shqip<sup>518</sup> se do të sillej edhe më shumë material në CD.<sup>519</sup> Znj. Miftari informoi anëtarët e tjerë të OVL-UÇK-së për dorëzimin e tretë.<sup>520</sup>

(b) Këqyrja e dokumenteve

276. Në selinë e OVL-UÇK-së, në atë kohë ishin të pranishëm z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku, dhe znj. Miftari si dhe disa përfaqësues të KFOR-it gjerman.<sup>521</sup> Përfaqësuesit e KFOR-it këqyrën dhe fotografuan grupin e tretë të dokumenteve.<sup>522</sup> Z. Haradinaj i kishte autorizuar ata për këtë dhe u sugjeroi se nuk ishte problem që ata ta bënin këtë.<sup>523</sup>

277. Grupi i tretë i dokumenteve përbëhej nga dy kopje të të njëjtit grup dokumentesh,<sup>524</sup> të gjitha në gjuhën angleze.<sup>525</sup> Që të dy të akuzuarit (dhe të tjerë) shpenzuan kohë duke këqyrrur përmbajtjen e tyre.<sup>526</sup> Z. Gucati, z. Haradinaj dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së OVL-UÇK-së të pranishëm në selinë e OVL-UÇK-së vendosën përsëri që të organizonin një konferencë për shtyp.<sup>527</sup>

---

<sup>517</sup> P35, f. 1 (z. Gucati: "rreth orës 15 në 11"); P163; P164; 1D4, para. 28, 31; 1D9, para. 30; 1D27; 1D28; 1D29; 1D30 (fragmente nga filmimi i kamerave të sigurisë tregon dorëzimin në orën 10.34 paradite); 2D1, para. 102, 104: Z. Haradinaj tha që ndodhi pak më vonë, në orën 11.00-11.30 paradite, e që kundërshton përshkrimin e asaj kohe të z. Gucati, kujtesën e znj. Miftari dhe filmimin e kamerave të sigurisë të asaj ngjarjeje. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458-2459.

<sup>518</sup> P35, f. 10-11; 1D4, para. 32, 34; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2459, 2474.

<sup>519</sup> P12, f. 4; 1D3, para. 46. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2199, 2213-2215.

<sup>520</sup> 2D1, para. 104.

<sup>521</sup> P35, f. 9; 1D3, para. 46; 1D4, para. 33; 1D9, para. 30; 2D1, para. 102; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2198; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2459.

<sup>522</sup> P35, f. 9; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2200.

<sup>523</sup> 2D1, para. 108-109.

<sup>524</sup> P35, f. 2; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1214.

<sup>525</sup> 2D1, para. 106, 111.

<sup>526</sup> 2D1, para. 107, 111; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2199-2200; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2297. *Shih gjithashtu më poshtë* para. 361 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>527</sup> 1D3, para. 47; 2D1, para. 107; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2200; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410.

(c) Njoftimi për mediat i konferencës për shtyp të OVL-UÇK-së

278. Pak pas dorëzimit të tretë, [REDAKTUAR] dhe gazeta *Infokus* botuan artikujt e parë në lidhje me të.<sup>528</sup>

(d) Konferenca e tretë për shtyp

279. Më vonë atë ditë, 22 shtator 2020, rreth orës 1.00 pasdite,<sup>529</sup> që të dy të akuzuarit mbajtën një konferencë për shtyp (“konferenca e tretë për shtyp”).<sup>530</sup> Z. Klinaku dhe z. Çelë Gashi ishin gjithashtu të pranishëm.<sup>531</sup> Në këtë konferencë morën pjesë afërsisht njëzet e pesë (25) organe të medias.<sup>532</sup>

280. Grupi i tretë i dokumenteve u ekspozua mbi një tavolinë përpara të akuzuarve.<sup>533</sup> Të dy të akuzuarit e diskutuan përmbajtjen e grupit të tretë të dokumenteve në prani të njëri-tjetrit. Z. Gucati përsëri bëri prezantimin e temës dhe tha se grupi i tretë i dokumenteve kishte rrjedhur nga DHS-ja dhe se përfshinte emrat e personave që ata nuk ishin të autorizuar t’i nxirrnin.<sup>534</sup> Ai më pas kritikoi DHS-në për bashkëpunim me Serbinë dhe për pamundësinë e saj për të mbrojtur dokumentet e veta.<sup>535</sup> Z. Gucati më pas i dha fjalën z. Haradinaj i cili “ka lexu pak më shumë pak më shumë, për nja 30 minuta, sa ka mujt me lexu”.<sup>536</sup>

281. Z. Haradinaj përshkroi përmbajtjen e grupit të tretë të dokumenteve dhe tha se aty përmendeshin shumë emra.<sup>537</sup> Ai ftoi personin që kishte dorëzuar grupin e tretë të

---

<sup>528</sup> P125ET.4; P129, f. 11; 1D2, f. 41.

<sup>529</sup> 2D1, para. 110.

<sup>530</sup> P35. *Shih gjithashtu* P3.

<sup>531</sup> P35. *Shih gjithashtu* P3.

<sup>532</sup> P12, f. 7; 2D1, para. 110. *Shih gjithashtu* P30, f. 5.

<sup>533</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2200-2201. *Shih gjithashtu* P3; P35.

<sup>534</sup> P35, f. 1.

<sup>535</sup> P35, f. 2.

<sup>536</sup> P35, f. 2.

<sup>537</sup> P35, f. 2-3.

dokumenteve që të sillte CD-në e premtuar dhe u zotua se do ta bënte atë publike.<sup>538</sup>

Z. Haradinaj e përshkroi grupin e tretë të dokumenteve si një “mrekulli.”<sup>539</sup> Ai përsëriti se ata po mbronin anëtarët e OVL-UÇK-së,<sup>540</sup> dhe se ishte i gatshëm të shkonte në burg për publikim të materialit.<sup>541</sup>

282. Të akuzuarit treguan dhe paraqitën një numër dokumentesh dhe ftuan gazetarët të bënin kopje,<sup>542</sup> duke i nxitur ata që t’i publikonin dokumentet.<sup>543</sup> Z. Gucati tha se grupi i tretë i dokumenteve iu tregua KFOR-it gjerman që ishte i pranishëm në seli në kohën e dorëzimit të tretë.<sup>544</sup> Z. Haradinaj pretendoi se ZPS-ja mori afërsisht 20% të grupit të dytë të dokumenteve, pjesa tjetër ishte shpërndarë dhe marrë nga gazetarë.<sup>545</sup>

283. Në fund të konferencës së tretë për shtyp, z. Gucati ftoi gazetarët të këqyrnin grupin e tretë të dokumenteve dhe të dy të akuzuarit ua ofruan dokumentet të pranishmëve.<sup>546</sup> Gjatë dhe pas konferencës së tretë për shtyp gazetarët morën dhe fotografuan dokumentet nga grupi i tretë i dokumenteve.<sup>547</sup>

#### (e) Postimet në *Facebook*

284. Në të njëjtën ditë, 22 shtator 2020, në profilet e të dy të akuzuarve në *Facebook* dolën postimet e tyre në lidhje me dorëzimin e tretë.<sup>548</sup>

---

<sup>538</sup> P35, f. 2, 8.

<sup>539</sup> P35, f. 3.

<sup>540</sup> P35, f. 3.

<sup>541</sup> P35, f. 12-13.

<sup>542</sup> P35, f. 2, 4-5, 7, 13-15.

<sup>543</sup> P35, f. 12-14.

<sup>544</sup> P35, f. 9.

<sup>545</sup> P35, f. 6.

<sup>546</sup> P35, f. 14-15.

<sup>547</sup> 1D3, para. 49; 2D1, para. 111. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2201.

<sup>548</sup> P60, f. 3-5; P67 (i njëjti postim në profilin e z. Haradinaj); P64; P65; P66; P83, f. 44-45.

## (f) Sekuestrimi i grupit të tretë të dokumenteve

285. Pak orë pas konferencës së tretë për shtyp, përfaqësues të ZPS-së arritën në selinë e OVL-UÇK-së. Të pranishëm ishin të akuzuarit, z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi.<sup>549</sup> ZPS-ja u dorëzoi urdhrin e lëshuar nga Prokurori i Specializuar që urdhëronte z. Gucati dhe OVL-UÇK-në të dorëzonin të gjitha dokumentet dhe të dhënat, duke përfshirë materialin e brendshëm të punës të ZPS-së, të mos incizonin ose kopjonin në asnjë lloj forme e të mos i shpërndanin më tej këto dokumente.<sup>550</sup> ZPS-ja sekuestroi materialin që mbeti nga grupi i tretë i dokumenteve (“sekuestrimi i tretë”).<sup>551</sup> ZPS-ja i referohet këtij materiali si “paketa 3”.<sup>552</sup>

## (g) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media

286. Pas sekuestrimit të tretë, më 22 shtator 2020, që të dy të akuzuarit bashkë me z. Tomë Gashi morën pjesë në një intervistë të transmetuar nga selia e OVL-UÇK-së. Të akuzuarit dhe z. Tomë Gashi diskutuan me hollësi burimin dhe autenticitetin e grupit të tretë të dokumenteve, sekuestrimin e tretë dhe publikimin e dokumenteve.<sup>553</sup>

287. Më vonë po atë ditë, 22 shtator 2020, z. Haradinaj mori pjesë në emisionin televiziv “Imazh” të RTK1, ku, ndër të tjera, diskutoi autenticitetin dhe sekuestrimin e grupit të tretë të dokumenteve,<sup>554</sup> dhe deklaroi se e kishte këqyrur atë, edhe pse jo në hollësi.<sup>555</sup> Ai përsëriti se marrja e grupit të tretë të dokumenteve ishte një “mrekulli”.<sup>556</sup> Z. Haradinaj përsëriti indiferencën e tij në lidhje me burimin e materialit dhe deklaroi

---

<sup>549</sup> P12, f. 1-3.

<sup>550</sup> P54. *Shih gjithashtu* P30, f. 5; P58; 1D3, para. 50; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1937-1941; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2201-2202. *Shih gjithashtu më poshtë* para. 320, 440 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>551</sup> 1D3, para. 51; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2202.

<sup>552</sup> P86, para. 28.

<sup>553</sup> P12, f. 1-7.

<sup>554</sup> P30, f. 1, 5, 10.

<sup>555</sup> P30, f. 3.

<sup>556</sup> P30, f. 2.

se ajo që kishte rëndësi ishte se materiali dëmtonte punën e DHS-së.<sup>557</sup> Z. Haradinaj rikonfirmoi kundërshtimin e tij ndaj DHS-së,<sup>558</sup> dhe ftesën e tij për mediat që ta publikonin materialin.<sup>559</sup> Aty u diskutua edhe ligjshmëria e veprimeve të të akuzuarit dhe se materiali që po nxirrej ishte i mbrojtur.<sup>560</sup>

288. Në të njëjtën ditë, 22 shtator 2020, z. Haradinaj mori pjesë në një emision televiziv tjetër "Pressing" në T7.<sup>561</sup> Z. Haradinaj lavdëroi personat që dorëzuan tri grupet e dokumenteve,<sup>562</sup> kritikoi DHS-në për mosmbrojtjen e këtij informacioni konfidencial,<sup>563</sup> dhe përsëriti vendosmërinë e tij për të publikuar këto materiale.<sup>564</sup> Z. Haradinaj dhe të pranishmit e tjerë diskutuan, ndër të tjera, ndikimin dhe pasojat e tri dorëzimeve, duke përfshirë edhe nëse ato përbënin pengim të drejtësisë.<sup>565</sup>

289. Më 22 shtator 2020, edhe z. Gucati u paraqit në dy programe televizive. Në një program televiziv të transmetuar në KTV, z. Gucati, ndër të tjera, diskutoi burimin, përmbajtjen dhe sekuestrimin e tri grupeve të dokumenteve, pasojat e mundshme të veprimeve të tij, dhe shpjegoi se ai i nxori dokumentet për të treguar njëanshmërinë e DHS-së nëpërmjet bashkëpunimit të saj me Serbinë.<sup>566</sup> Z. Gucati shtoi se ai do të dëshironte të shpërbënte DHS-në dhe se do t'i publikonte dokumente të tilla nëse atyre do t'u jepej sërish informacion i ri.<sup>567</sup> Ai gjithashtu sugjeroi se DHS-ja humbi besueshmërinë e saj si pasojë e rrjedhjes së informacionit.<sup>568</sup>

---

<sup>557</sup> P30, f. 18.

<sup>558</sup> P30, f. 15.

<sup>559</sup> P30, f. 5-9, 20.

<sup>560</sup> P30, f. 15-16.

<sup>561</sup> P11.

<sup>562</sup> P11, f. 2.

<sup>563</sup> P11, f. 3.

<sup>564</sup> P11, f. 4, 8, 29.

<sup>565</sup> P11, f. 24-25, 30, 35, 38, 47, 56, 64-65.

<sup>566</sup> P28, f. 1-2, 10-11, 13-14.

<sup>567</sup> P28, f. 7, 11. *Shih gjithashtu* P28, f. 12-13.

<sup>568</sup> P28, f. 13-14.

290. Në një emision të transmetuar nga *Euronews Albania*, z. Gucati përsëriti se dokumentet erdhën nga DHS-ja,<sup>569</sup> shprehu shpresën se gjykata do të zhbëhej,<sup>570</sup> dhe deklaroi se ata do të nxirrnin çdo material të ri që do të merrnin për të treguar njëanshmërinë e DHS-së.<sup>571</sup>

(h) Artikuj të mëtejshëm në media

291. Më 22 shtator 2020, *Top Channel* dhe gazeta *Infokus* botuan tre artikuj të tjerë në lidhje me grupin e tretë të dokumenteve.<sup>572</sup>

### 23-24 shtator 2020

(a) Artikuj të mëtejshëm në media

292. Më 23 dhe 24 shtator 2020, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe *Top Channel* botuan artikuj të tjerë në lidhje me grupin e tretë të dokumenteve.<sup>573</sup>

(b) Postimet në *Facebook*

293. Më 24 shtator 2020, në profilin e z. Haradinaj në *Facebook* u postua një lajm nga *Euronews Albania* në lidhje me publikimin e “dosjeve të ZPS-së” si edhe një intervistë me z. Haradinaj.<sup>574</sup>

(c) Paraqitjet e të akuzuarve dhe të ndihmësve në media

294. Më 24 shtator, z. Gucati u paraqit në emisionin televiziv “Imazh” në *RTK1* gjatë të cilit ai diskutoi edhe një herë publikimin e tri grupeve të dokumenteve dhe foli për

---

<sup>569</sup> P29, f. 1.

<sup>570</sup> P29, f. 1.

<sup>571</sup> P29, f. 2.

<sup>572</sup> P155; P129, f. 6, 10. *Shih gjithashtu* P156; 1D2, f. 26, 38.

<sup>573</sup> P120; P121; P122; P157; P159. *Shih gjithashtu* P158; P160.

<sup>574</sup> P60, f. 1-2. *Shih gjithashtu* P62.

njërin prej këtyre dokumenteve.<sup>575</sup> Ai e cilësoi DHS-në si të njëanshme dhe të padrejtë, dhe përsëriti se ata do të publikonin çfarëdo materiali që do të merrnin.<sup>576</sup>

295. Në të njëjtën ditë, më 24 shtator 2020, z. Haradinaj u paraqit shkurtimisht në *Euronews Albania*, ku përsëriti se nuk do të bashkëpunonte dhe nuk do ta mbështeste DHS-në.<sup>577</sup>

296. Gjithashtu më 24 shtator 2020, z. Klinaku u paraqit si përfaqësues i OVL-UÇK-së në emisionin televiziv “Debat Plus” në RTV, në të cilin ai diskutoi publikimin e grupit të tretë të dokumenteve, publikimin e emrave të dëshmitarëve dhe pasojat e saj.<sup>578</sup>

#### D. KONTROLLIMI I SELISË SË OVL-UÇK-SË DHE ARRESTIMI I TË AKUZUARVE

297. Më 25 shtator 2020, përfaqësues të ZPS-së arritën në selinë e OVL-UÇK-së dhe arrestuan z. Gucati, në zbatim të fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm.<sup>579</sup> ZPS-ja gjithashtu kontrolloi selinë e OVL-UÇK-së në përputhje me të njëjtin urdhër të Gjykatësit të Vetëm.<sup>580</sup> Z. Tomë Gashi, si avokat i OVL-UÇK-së, ishte i pranishëm gjatë kontrollimit.<sup>581</sup>

298. Në të njëjtën ditë, më 25 shtator 2020, z. Haradinaj dha pesë intervista, duke përfshirë në *KlanKosova* dhe *Euronews Albania*.<sup>582</sup> Gjatë këtyre intervistave, z. Haradinaj përsëriti ndër të tjera: (i) ftesën e tij që gazetarët të publikonin materialin e nxjerrë;<sup>583</sup>

---

<sup>575</sup> P31.

<sup>576</sup> P31, f. 1-2.

<sup>577</sup> P16, f. 1.

<sup>578</sup> P23.

<sup>579</sup> 1D3, para. 53-56; 2D1, para. 118. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2202-2204; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2791-2792.

<sup>580</sup> *Shih p.sh.* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1391-1407; Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1479-1488; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2002-2003; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2459-2460.

<sup>581</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1484; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2204.

<sup>582</sup> P14; P15; P26; P27; P32.

<sup>583</sup> P27, f. 1.

(ii) mendimet e tij për DHS-në, duke theksuar se ai nuk do t'i zbatonte urdhrat e DHS-së dhe se nuk e njihete atë;<sup>584</sup> dhe (iii) se ai do të mirëpriste dorëzime të tjera.<sup>585</sup>

299. Z. Haradinaj u arrestua më vonë atë ditë, 25 shtator 2020, me urdhër të Gjykatësit të Vetëm.<sup>586</sup>

## V. KONSTATIME MBI PAKETAT

### A. SEKUESTRIMI I TRI GRUPEVE TË DOKUMENTEVE DHE KRONOLOGJIA E MBAJTJES NË RUAJTJE TË PAKETAVE

#### 1. Dorëzimi, shpërndarja dhe marrja në dorëzim e tri grupeve të dokumenteve

300. Siç vërehet më lart, të akuzuarit morën përmes tri dorëzimeve tri grupet e dokumenteve.<sup>587</sup> Të akuzuarit publikuan, vunë në dispozicion dhe/ose i shpërndanë tri grupet e dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp dhe në paraqitje të tjera në media.<sup>588</sup> Të akuzuarit nuk e kundërshtuan faktin se i kishin në zotërim tri grupet e dokumenteve, as se e vunë në dispozicion të mediave një pjesë të madhe të këtij materiali. Në fakt, të akuzuarit bënë të ditur se afërsisht 70-80% e tri grupeve të dokumenteve iu dhanë mediave.<sup>589</sup> Gjithashtu, të dy të akuzuarit bënë të ditur se çfarë

---

<sup>584</sup> P14, f. 1; P15, f. 1-2; P26, f. 2; P32, f. 1-2.

<sup>585</sup> P15, f. 2.

<sup>586</sup> P14; 2D1, para. 118-125. *Shih gjithashtu* DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2802-2809.

<sup>587</sup> *Shih më lart* para. 207, 243, 275 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>588</sup> *Shih më lart* para. 214-296 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>589</sup> P4, f. 3; P6, f. 17-18; P7, f. 7, 11; P17, f. 6; P35, f. 6; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2281-2283.



kishte mbetur në zotërim të OVL-UÇK-së nga grupi i parë,<sup>590</sup> i dytë<sup>591</sup> dhe i tretë<sup>592</sup> i dokumenteve, iu dorëzua ZPS-së.

301. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se gjatë tri operacioneve të sekuestrimit ZPS-së iu dorëzuan dokumentet e mbetura nga tri grupet e dokumenteve. Trupi Gjykses duhet të përcaktojë nëse pjesa e mbetur që u sekuestrua përkon me ato që ZPS-ja i ka regjistruar si paketat 1, 2 dhe 3 (“paketat”).<sup>593</sup>

## 2. Sekuestrimi dhe kronologjia e mbajtjes në ruajtje

(a) Kundërshtimet e Mbrojtjes lidhur me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të paketave

302. Mbrojtja e ka kundërshtuar kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të materialit që sekuestroi ZPS-ja në selinë e OVL-UÇK-së. Konkretisht, Mbrojtja e Haradinajt parashtroi se ZPS-ja nuk e kishte përmbushur kushtin e rregullës 39(4) të Rregullores për të hartuar një inventar të hollësishëm.<sup>594</sup> Ajo parashtroi gjithashtu se si pasojë e të metave dhe mangësive të pretenduara të operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit të kryera nga ZPS-ja dhe në mungesë të procedurave të duhura të

---

<sup>590</sup> P24, f. 5-6 (z. Haradinaj); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2390-2391, 2393. *Shih gjithashtu* P7, f. 2-3; P17, f. 3-4; P21, f. 4; P24, f. 2-3; P29, f. 2 (z. Gucati); P33, f. 1; 1D3, para. 28 (z. Gucati); 2D1, para. 67, 115 (z. Haradinaj); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2182-2183; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2738; Transkripti, 14 janar 2022, f. 3079-3080.

<sup>591</sup> P4, f. 3-4, 8-9 (z. Gucati); P6, f. 17-18 (z. Haradinaj); P7, f. 7 (z. Haradinaj); P8, f. 13 (z. Haradinaj); P17, f. 1, 4-6 (z. Haradinaj); P28, f. 7 (z. Gucati); P29, f. 2 (z. Gucati); P30, f. 10 (z. Haradinaj); P35, f. 6 (z. Haradinaj); 1D3, para. 42 (z. Gucati); 2D1, para. 92-94, 115 (z. Haradinaj); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2197; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2282-2284; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2770-2771.

<sup>592</sup> P28, f. 7 (z. Gucati); P29, f. 2 (z. Gucati); P30, f. 1, 5, 10 (z. Haradinaj); 1D3, para. 50 (z. Gucati); 2D1, para. 114-115 (z. Haradinaj); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2202; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2786-2787.

<sup>593</sup> *Shih më lart* para. 228-231, 256-258, 285 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>594</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 514. *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3687.

kronologjisë së mbajtjes në ruajtje, autenticiteti i materialit nuk mund të vërtetohet dhe nuk mund të mbështetesh në paketat.<sup>595</sup>

303. ZPS-ja u përgjigj se provat e vërtetojnë qartë autenticitetin e paketave, theksoi se tabelat e znj. Pumper ishin më të hollësishme se çdo inventar që mund të ishte përgatitur ditën e operacioneve të sekuestrimit dhe shprehu mendimin se është ruajtur kronologjia e mbajtjes në ruajtje.<sup>596</sup>

304. Trupi Gjykes vëren se kundërshtimi lidhur me mungesën e inventarit dhe çdo mangësi të tjetër të pretenduar në kronologjinë e mbajtjes në ruajtje ka të bëjë me aspektin nëse: (i) pjesa e mbetur e grupit të parë të dokumenteve e sekuestruar në selinë e OVL-UÇK-së më 8 shtator 2020 përkon me paketën 1; (ii) pjesa e mbetur e grupit të dytë të dokumenteve e sekuestruar në selinë e OVL-UÇK-së më 17 shtator 2020 përkon me paketën 2; dhe (iii) pjesa e mbetur e grupit të tretë të dokumenteve e sekuestruar në selinë e OVL-UÇK-së më 22 shtator 2020 përkon me paketën 3.

(b) Sekuestrimi i parë

305. Trupi Gjykes vëren se sekuestrimi i parë u autorizua nga Gjykatësi i Vetëm me Urdhrin e Parë, që mbështetej në nenet 35(3), 39(3) dhe 53(1) të Ligjit dhe rregullat 31-32, 37, 39 dhe 202 të Rregullores. Nuk ka të dhëna për gabim në bazën ligjore të Urdhrit të Parë, kështu që Trupi Gjykes nuk e trajton më tej këtë aspekt.

306. Urdhri i Parë përcaktonte kohën, kohëzgjatjen dhe shkallën e sekuestrimit,<sup>597</sup> kushtet për zbatimin dhe dorëzimin e urdhrin,<sup>598</sup> kushtet për mbajtjen, ruajtjen dhe

---

<sup>595</sup> F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 180-198; F287, para. 54; F317, para. 42, 45; F440, para. 142-143, 146-148; F444, para. 13; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 261-263, 265-267, 288-289, 300-301, 514; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3686-3689, 3698-3701. *Shih gjithashtu* F260/RED; F317/RED. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1384.

<sup>596</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3480-3481, 3526-3529.

<sup>597</sup> P52, para. 15-16

<sup>598</sup> P52, para. 20, 23.

mbrojtjen e materialit të sekuestruar<sup>599</sup> dhe detyrimet e ZPS-së lidhur me raportimin.<sup>600</sup>

Trupi Gjykses do t'i trajtojë këto me radhë.

307. Sa i takon kohës, kohëzgjatjes dhe shkallës së sekuestrimit, Gjykatësi i Vetëm i kërkoi ZPS-së: (i) ta zbatonte Urdhrin e Parë brenda pesë ditësh duke filluar nga lëshimi i tij;<sup>601</sup> dhe (ii) të sekuestronte materialin që z. Gucati dhe/ose OVL-UÇK-ja morën në mëngjesin e 7 shtatorit 2020 dhe çfarëdo materiali të ngjashëm që kishte lidhje e që mund të merrej midis lëshimit të Urdhrit të Parë dhe zbatimit të tij.<sup>602</sup> ZPS-ja e kreu sekuestrimin brenda një dite pas Urdhrit të Parë, më 8 shtator 2020.<sup>603</sup> Gjithashtu, ZPS-ja sekuestroi pjesën e mbetur të grupit të parë të dokumenteve, në përputhje me shkallën e sekuestrimit të autorizuar në Urdhrin e Parë.<sup>604</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk konstaton asnjë mangësi nga ZPS-ja në përmbushjen e këtyre masave.

308. Sa i takon zbatimit dhe dorëzimit të urdhrin, Gjykatësi i Vetëm e autorizoi ZPS-në, si autoriteti kompetent sipas rregullës 49(1) të Rregullores, ta dorëzonte dhe zbatonte Urdhrin e Parë.<sup>605</sup> Gjykatësi i Vetëm e urdhëroi gjithashtu ZPS-në ta kryente sekuestrimin në përputhje me rregullën 39 të Rregullores.<sup>606</sup> ZPS-ja ia dorëzoi Urdhrin e Parë z. Klinaku, si përfaqësues i OVL-UÇK-së.<sup>607</sup> Z. Klinaku nënshkroi vërtetimin e marrjes në dorëzim ("vërtetimi i dorëzimit të parë"), ku materiali i sekuestruar përshkruhej si "dokumente dorëzuar OVL-UÇK-së" dhe "1 stivë dokumentesh, të printuara".<sup>608</sup> Z. Klinaku nuk paraqiti asnjë ankesë lidhur me kryerjen e operacionit në

---

<sup>599</sup> P52, para. 18-19.

<sup>600</sup> P52, para. 17.

<sup>601</sup> P52, para. 15.

<sup>602</sup> P52, para. 16.

<sup>603</sup> P92, para. 1; P52, para. 15.

<sup>604</sup> P92, para. 7; P52, para. 16, 22(a).

<sup>605</sup> P52, para. 20.

<sup>606</sup> P52, para. 23.

<sup>607</sup> P92, para. 2-4, 6.

<sup>608</sup> P56.

vërtetimin e dorëzimit të parë apo në një faqe të shkruar me dorë të cilën e nënshkroi (“shënimi me shkrim dore i Klinakut”).<sup>609</sup> Përpara se t’i dorëzonte dokumentet, z. Klinaku foli në telefon me z. Gucati, i cili e udhëzoi t’ia jepte materialin ZPS-së.<sup>610</sup> Z. Klinaku gjithashtu bëri të ditur se nuk ishte nevoja të ishte i pranishëm një avokat.<sup>611</sup>

309. Rregulla 39(4) e Rregullores kërkon që ZPS-ja të hartojë një inventar me përshkrim të hollësishëm dhe informacion lidhur me çdo material të sekuestruar (“inventari i rregullës 39(4)”). E njëjta rregull u kërkon ZPS-së, vëzhguesit të pavarur, personit përkatës dhe mbrojtësit të tij, nëse është i pranishëm, të nënshkruajnë inventarin e rregullës 39(4). Kjo rregull lejon më tej shënimin e vërejtjeve në të njëjtin inventar në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit. I vetmi dokument i njohur që mban nënshkrimet e ZPS-së, vëzhguesit të pavarur dhe z. Klinaku është vërtetimi i dorëzimit të parë. Shënimi me shkrim dore i Klinakut mban nënshkrimin e z. Klinaku dhe të një punonjësi të ZPS-së. Asnjëri prej këtyre dy dokumenteve nuk duket se është inventar sipas rregullës 39(4) me “përshkrim dhe informacion të hollësishëm në lidhje me secilin send të sekuestruar”. Gjithashtu, Trupi Gjykes nuk ka marrë në prova asnjë inventar sipas rregullës 39(4) të sekuestrimit të parë. Trupi Gjykes nuk ka marrë as prova që të tregojnë se pas sekuestrimit të parë u hartua një inventar sipas rregullës 39(4).

310. Sa i takon kronologjisë së mbajtjes në ruajtje dhe raportimit, Urdhri i Parë e urdhëronte ZPS-në të “ruajë, mbrojë dhe transferojë materialin e sekuestruar në përputhje me procedurën standarde të kronologjisë së ruajtjes së dokumenteve”.<sup>612</sup> Gjithashtu, Urdhri i Parë i kërkoi ZPS-së të “marrë masa të përshtatshme për mbrojtjen e materialit të sekuestruar nga humbja, qasja e rastësishme apo e paautorizuar,

---

<sup>609</sup> P56; P57.

<sup>610</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2182-2183. *Shih gjithashtu* W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1959-1960; 1D3, para. 27-28.

<sup>611</sup> P92, para. 5.

<sup>612</sup> P52, para. 18.

ndryshimi, shpërndarja ose asgjësimi”.<sup>613</sup> Gjithashtu, Urdhri i Parë i kërkoi ZPS-së t'i dorëzonte Gjykatësit të Vetëm, brenda një afati të përcaktuar, një raport ku të përmendte: (i) datën, orën, kohëzgjatjen, vendndodhjen, shkallën dhe rrethanat e sekuestrimit;<sup>614</sup> (ii) përmbushjen e kushteve të rregullës 39 të Rregullores;<sup>615</sup> dhe (iii) procedurën dhe masat paraprake përkatëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar.<sup>616</sup> Në përputhje me Urdhrin e Parë, ZPS-ja dorëzoi, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh, një raport mbi sekuestrimin e parë.<sup>617</sup>

311. Sa i takon kronologjisë së mbajtjes në ruajtje pas sekuestrimit të parë, Trupi Gjykses vëren sa vijon. Së pari, z. Moberg, përfaqësuesi i ZPS-së i cili sekuestroi çfarë kishte mbetur nga grupi i parë i dokumenteve dhe i cili kreu ose ishte i pranishëm në hapat që kishin të bënin me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të dokumenteve, përpiloi për këtë një notë zyrtare, si edhe dëshmoi në gjykim.<sup>618</sup> Ai përmendi se dokumentet e sekuestruara dhe vërtetimin e dorëzimit të parë personeli i ZPS-së i transportoi në mjediset e ZPS-së në Prishtinë, ku ato u skanuan.<sup>619</sup> Më tej, versionet e skanuara digjitale iu transmetuan të shifruara ZPS-së në Hagë.<sup>620</sup> Kopjet në letër të dokumenteve të sekuestruara u vendosën në dy qese të veçanta provash dhe vërtetimi i dorëzimit të parë u fut në njëren prej këtyre qeseve.<sup>621</sup> Të dyja qeset e provave u vulosën dhe u futën në një kasafortë në mjediset e ZPS-së në Prishtinë,<sup>622</sup> deri kur u transportuan në zyrën e ZPS-së në Hagë.<sup>623</sup> Znj. Pumper dëshmoi se mundi të verifikonte se dokumentet që

---

<sup>613</sup> P52, para. 18.

<sup>614</sup> P52, para. 17.

<sup>615</sup> P52, para. 17.

<sup>616</sup> P52, para. 18.

<sup>617</sup> F8. Shtojca 1 përmban dokumentin e nënshkruar të dorëzimit, pranuar si prova P56. *Shih gjithashtu F8/RED.*

<sup>618</sup> P92; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021.

<sup>619</sup> P92, para. 10-11; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1931, 1958.

<sup>620</sup> P92, para. 11; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1931, 1958.

<sup>621</sup> P92, para. 12; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1931-1932, 1958.

<sup>622</sup> P92, para. 12; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1931-1932, 1958.

<sup>623</sup> P92, para. 14; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1932, 1958.

ajo i kishte shqyrtuar si “paketa 1”, ishin dokumentet e marra gjatë sekuestrimit të parë, për shkak të renditjes së njëpasnjëshme të NRP-ve (ERN)<sup>624</sup> me të cilat dokumentet ishin regjistruar në skedarin e provave të ZPS-së. Konkretisht, znj. Pumper dëshmoi se vërtetimi i dorëzimit të parë ishte “ballina” (ERN 080449), pas së cilës vinte materiali i sekuestruar i identifikuar si “paketa 1” (ERN 080450-081339) dhe shënimi me shkrim dore i Klinikut (ERN 081340), që ishte faqja e fundit.<sup>625</sup>

(c) Sekuestrimi i dytë

312. Trupi Gjykues vëren se sekuestrimi i grupit të dytë të dokumenteve u autorizua nga Gjykatësi i Vetëm me Urdhrin e Dytë, që mbështetej në nenet 35(3), 39(3) dhe 53(1) të Ligjit dhe rregullat 31-32, 37, 39 dhe 202 të Rregullores. Nuk ka të dhëna për gabime apo keqinterpretime në bazën ligjore të Urdhrit të Dytë, kështu që Trupi Gjykues nuk e trajton më tej këtë aspekt.

313. Urdhri i Dytë përcaktonte kohën, kohëzgjatjen dhe shkallën e sekuestrimit,<sup>626</sup> , kërkesat për zbatimin dhe dorëzimin e tij,<sup>627</sup> kërkesat për mbajtjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar<sup>628</sup> dhe detyrimet e ZPS-së lidhur me raportimin.<sup>629</sup> Trupi Gjykues do t'i trajtojë këto me radhë.

314. Sa i takon kohës, kohëzgjatjes dhe shkallës së sekuestrimit, Gjykatësi i Vetëm i kërkoi ZPS-së: (i) ta zbatonte Urdhrin e Dytë brenda pesë ditësh duke filluar nga lëshimi i tij,<sup>630</sup> dhe (ii) të sekuestronte materialin që z. Guçati dhe/ose OVL-UÇK morën pasditen e 16 shtatorit 2020 dhe çfarëdo materiali të ngjashëm që kishte lidhje

---

<sup>624</sup> “Numrat e regjistrimit të provave” që u caktohen materialeve provuese.

<sup>625</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 854-857, 859.

<sup>626</sup> P53, para. 15-16.

<sup>627</sup> P53, para. 20, 23.

<sup>628</sup> P53, para. 18-19, 24(b).

<sup>629</sup> P53, para. 17, 24(a).

<sup>630</sup> P53, para. 15.

e që mund të merrej midis lëshimit të Urdhrit të Dytë dhe zbatimit të tij.<sup>631</sup> ZPS-ja e kreu sekuestrimin e dytë më 17 shtator 2020, ditën kur u lëshua Urdhri i Dytë.<sup>632</sup> Gjithashtu, ZPS-ja sekuestroi pjesën e mbetur të grupit të dytë të dokumenteve, në përputhje me kuadrin e sekuestrimit të autorizuar në Urdhrin e Dytë.<sup>633</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk konstaton asnjë mangësi nga ZPS-ja në zbatimin e këtyre masave.

315. Sa i takon zbatimin dhe dorëzimit të urdhrin, Gjykatësi i Vetëm autorizoi ZPS-në, si autoriteti kompetent sipas rregullës 49(1) të Rregullores, që të dorëzonte dhe zbatonte Urdhrin e Dytë.<sup>634</sup> Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm e urdhëroi ZPS-në ta kryente sekuestrimin në përputhje me rregullën 39 të Rregullores.<sup>635</sup> ZPS-ja ia dorëzoi Urdhrin e Dytë z. Gucati.<sup>636</sup> Z. Gucati nënshkroi vërtetimin e marrjes në zotërim (“vërtetimi i dorëzimit të dytë”),<sup>637</sup> ku materiali i sekuestruar përshkruhej si “dokumente të sjella në OVL nga një person i paidentifikuar, 16.9.2020”, dhe ku nuk paraqitej asnjë ankesë lidhur me kryerjen e operacionit.<sup>638</sup>

316. Si edhe në sekuestrimin e parë, i vetmi dokument i njohur i cili mban nënshkrimet e ZPS-së, vëzhguesit të pavarur dhe z. Gucati është vërtetimi i dorëzimit të dytë.<sup>639</sup> Gjithashtu, si edhe në sekuestrimin e parë, Trupi Gjykses nuk ka marrë si provë asnjë inventar sipas rregullës 39(4). Trupi Gjykses nuk ka marrë as prova që të tregojnë se u hartua një inventar sipas rregullës 39(4) pas sekuestrimit të dytë.

---

<sup>631</sup> P53, para. 16.

<sup>632</sup> P55; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1937-1940, 1950.

<sup>633</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1937-1941; P53, para. 16, 22(a).

<sup>634</sup> P53, para. 20.

<sup>635</sup> P53, para. 23.

<sup>636</sup> P4, f. 8; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1939; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2289-2293, 2295.

<sup>637</sup> P55; 2D1, para. 94, 115; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2291.

<sup>638</sup> P55.

<sup>639</sup> P55.

317. Sa i takon kronologjisë së mbajtjes në ruajtje dhe raportimit, Urdhri i Dytë përmbante të njëjtat kushte si edhe Urdhri i Parë.<sup>640</sup> Në përputhje me Urdhrin e Dytë, ZPS-ja dorëzoi, brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh, një raport të sekuestrimit të dytë.<sup>641</sup>

318. Në lidhje me kronologjinë e mbajtjes në ruajtje pas sekuestrimit të dytë, Trupi Gjykses vëren sa vijon. Së pari, përfaqësuesi i ZPS-së që përgatiti notë zyrtare në lidhje me sekuestrimin e dytë nuk u thirr si dëshmitar nga palët dhe Trupi Gjykses nuk e pranoi si provë notën zyrtare të përgatitur prej tij lidhur me këtë ngjarje.<sup>642</sup> Për pasojë, Trupi Gjykses nuk mund të mbështetet në versionin e këtij përfaqësuesi të ZPS-së. Së dyti, z. Moberg, i cili dëshmoi për tri operacionet e sekuestrimeve, deklaroi se nuk mund të bënte më dallimin midis sekuestrimit të dytë dhe sekuestrimit të tretë, por pohoi se në të dy rastet u sekuestruan dokumente.<sup>643</sup> Z. Moberg dëshmoi se dokumentet e sekuestruara u morën nga personeli i ZPS-së në qese provash dhe u çuan në mjediset e ZPS-së në Prishtinë, ku u skanuan, përpara se t'i dërgoheshin të shifruara ZPS-së në Hagë.<sup>644</sup> Së treti, znj. Pumper dha dëshmi në lidhje me sekuestrimin e dytë, përfshirë edhe në bazë të vërtetimit të dorëzimit të dytë.<sup>645</sup> Znj. Pumper dëshmoi se ajo mundi të verifikonte se dokumentet të cilat ajo i kishte shqyrtuar si "paketa 2", ishin dokumentet e marra gjatë sekuestrimit të dytë, për shkak të renditjes së njëpasnjëshme të NRP-ve (ERN) me të cilat dokumentet ishin regjistruar në skedarin e provave të ZPS-së. Në veçanti, znj. Pumper dëshmoi se vërtetimi i dorëzimit të dytë ishte "ballina" (ERN 079500), pas së cilës vinte ai që dukej se ishte

---

<sup>640</sup> P53, para. 17-19.

<sup>641</sup> F28. *Shih gjithashtu* F00028/RED.

<sup>642</sup> Transkripti, 19 tetor 2021, f. 937-939 (Urdhër Gojor mbi Pranimin e Disa Provave Materiale (P92MFI, P103MFI dhe P105MFI).

<sup>643</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1938-1940.

<sup>644</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1939-1941.

<sup>645</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 911-913.



kopje e Urdhrit të Dytë, që nuk ishte produkt i ZPS-së,<sup>646</sup> dhe në fund vinte materiali i sekuestruar (ERN 079512-080448).<sup>647</sup>

(d) Sekuestrimi i tretë

319. Trupi Gjykues vëren se sekuestrimi i tretë u autorizua nga Prokurori i Specializuar më 22 shtator 2020, në pajtim me nenet 35(2) dhe 53(1) të Ligjit (Urdhri i ZPS-së).<sup>648</sup> Nuk ka të dhëna për gabime apo keqinterpretime në bazën ligjore të Urdhrit të ZPS-së, kështu që Trupi Gjykues nuk e trajton më tej këtë aspekt.

320. Urdhri i ZPS-së i kërkoi z. Gucati dhe OVL-UÇK-së, ndër të tjera, të “dorëzonte menjëherë të gjitha dokumentet dhe të dhënat, përfshirë edhe produktin e brendshëm të punës, të Zyrës së Prokurorit të Specializuar”.<sup>649</sup> ZPS-ja shkoi në selinë e OVL-UÇK-së po atë ditë që u lëshua urdhri i ZPS-së,<sup>650</sup> të cilin ia dorëzoi OVL-UÇK-së. Z. Haradinaj nënshkroi një dokument ku vërtetohej “marrja e urdhrit për dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave” (“vërtetimi i marrjes”), dhe nuk paraqiti asnjë ankesë lidhur me kryerjen e operacionit.<sup>651</sup>

321. Më 23 shtator 2020, ZPS-ja i dorëzoi Gjykatësit të Vetëm njoftim lidhur me sekuestrimin e tretë.<sup>652</sup> Më 25 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se, meqë Urdhri i ZPS-së nuk parashikonte apo nuk sillte për pasojë kontrollimin apo hyrjen me detyrim në selinë e OVL-UÇK-së dhe meqë dukej se dokumentet i ishin dorëzuar vullnetarisht ZPS-së pas dorëzimit të Urdhrit të ZPS-së, nuk nevojitej një miratim sipas

---

<sup>646</sup> Trupi Gjykues vëren se Urdhri i Dytë, i pranuar si provë (P53), mban numrin ERN 092017-092027.

<sup>647</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 912-914.

<sup>648</sup> P54.

<sup>649</sup> P54.

<sup>650</sup> Trupi Gjykues bindet se data fillestare 9 shtator 2020 u shtyp gabimisht e tillë në Urdhrin e ZPS-së dhe se ndreqja e bërë me dorë për 22 shtator 2020 është data e saktë. *Shih* P54. *Shih më poshtë* para. 874 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>651</sup> P58.

<sup>652</sup> F10. Shtojca 1 përmban Urdhrin e ZPS-së dhe vërtetimin e marrjes, pranuar si prova, përkatësisht me numër P54 dhe P58. Në njoftim, ZPS-ja parashtronte se sekuestrimi i tretë nuk ishte objekt i rregullave 37-39 të Rregullores (para. 5). *Shih gjithashtu* F10/RED.

rregullës 38(3) të Rregullores.<sup>653</sup> Gjykatësi i Vetëm nuk trajtoi aspektin nëse, në këto rrethana ishte i nevojshëm një inventar sipas rregullës 39(4). Gjithsesi, Trupi Gjykses nuk mori në prova asnjë inventar të tillë, as nuk mori ndonjë provë që të tregonte se pas këtij sekuestrimi ishte përgatitur një inventar sipas rregullës 39(4). Gjithashtu, nuk u mor asnjë provë se ishte përgatitur një dokument ku të regjistrohej sekuestrimi apo marrja e materialit. Dokumenti i vërtetimit mban nënshkrimet e një përfaqësuesi të ZPS-së dhe të z. Haradinaj, por i referohet vetëm marrjes së Urdhrit të ZPS-së.

322. Urdhri i ZPS-së nuk përcaktonte me hollësi procedurën për mbajtjen dhe ruajtjen e dokumenteve të sekuestruara. Sa i takon kronologjisë së mbajtjes në ruajtje pas këtij sekuestrimi, Trupi Gjykses vëren si vijon. Së pari, si edhe në sekuestrimin e dytë, përfaqësuesi i ZPS-së që përgatiti notën zyrtare lidhur me sekuestrimin e tretë nuk u thirr si dëshmitar nga palët dhe Trupi Gjykses refuzoi të pranonte si provë një dokument të përgatitur prej tij ku evidentohej procesi i sekuestrimit.<sup>654</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk mund të mbështetet në versionin e këtij përfaqësuesi të ZPS-së. Së dyti, z. Moberg pohoi se ZPS-ja i sekuestroi dokumentet gjatë sekuestrimit të tretë.<sup>655</sup> Së treti, znj. Pumper dëshmoi në lidhje me sekuestrimin e tretë, përfshirë edhe mbi bazën e dokumentit të vërtetimit.<sup>656</sup> Znj. Pumper dëshmoi gjithashtu se kishte mundur të verifikonte se dokumentet e “paketës 3” shqyrtuar prej saj, ishin ato të sekuestruara gjatë sekuestrimit të tretë.<sup>657</sup> Në veçanti, znj. Pumper dëshmoi se: (i) ajo transportoi njërin prej qeseve të provave të sekuestrimit të tretë, e hapi qesen dhe e përfshiu përmbajtjen e saj në prova, ku iu caktuan numrat ERN;<sup>658</sup> dhe (ii) hapi qesen tjetër të vulosur të provave që i përkiste të njëjtit sekuestrim, dhe e përfshiu përmbajtjen e saj

---

<sup>653</sup> F17, para. 9. *Shih gjithashtu* F17/RED.

<sup>654</sup> Transkripti, 19 tetor 2021, f. 937-939 (Urdhër Gojor për Pranimin e Disa Provave Materiale (P92MFI, P103 MFI dhe P105MFI).

<sup>655</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1939.

<sup>656</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 922-924.

<sup>657</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 921.

<sup>658</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 921.

në prova, ku iu caktuan numrat ERN.<sup>659</sup> Znj. Pumper tha gjithashtu se numrat ERN të dokumenteve që njihen si paketa 3 të cilat ajo i shqyrtoi më vonë, përkonin me numrat ERN që kishte marrë pasi i kishte dorëzuar dokumentet në qeset e provave për t'u përfshirë në skedarin e provave të ZPS-së.<sup>660</sup>

(e) Dorëzimi i dokumenteve nga gazeta *Infokus*

323. Me qëllim përcaktimin e përmbajtjes së paketave të diskutuara më poshtë, Trupi Gjykses do të trajtojë edhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje lidhur me grupin e katërt të dokumenteve.

324. Sikurse thuhet më lart, në vijim të informimit nga gazeta *Infokus*,<sup>661</sup> më 9 shtator 2020, z. Moberg dhe një tjetër përfaqësues i ZPS-së shkuan në zyrën e kësaj gazete, ku morën në dorëzim grupin e katërt të dokumenteve.<sup>662</sup> Dokumentet u dorëzuan vullnetarisht dhe vërtetimi i marrjes së tyre nga ZPS-ja u nënshkrua nga z. Berisha dhe z. Moberg ("dokumenti i dorëzimit").<sup>663</sup> Dokumenti i dorëzimit e përshkruante grupin e katërt të dokumenteve si "dokumente dorëzuar në gazeta *Infokus*" dhe "dokumente nga OVL-UÇK-ja".<sup>664</sup>

325. Sa i takon kronologjisë së mbajtjes në ruajtje pas kësaj marrjeje në dorëzim, Trupi Gjykses vëren si vijon. Së pari, z. Berisha dëshmoi se ZPS-ja i mori me vete të gjitha dokumentet që gazeta *Infokus* i kishte marrë gjatë konferencës së parë për shtyp.<sup>665</sup> Z. Berisha gjithashtu e identifikoi dokumentin e dorëzimit si të nënshkruar prej tij gjatë dorëzimit të dokumenteve.<sup>666</sup> Së dyti, z. Moberg, përfaqësuesi i ZPS-së i cili mori

---

<sup>659</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 922.

<sup>660</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 921-922.

<sup>661</sup> P98, para. 4-6. *Shih më lart* para. 226 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>662</sup> P99, para. 1-3. *Shih më lart* para. 236 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>663</sup> P99, para. 1, 3; P100.

<sup>664</sup> P100.

<sup>665</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1532.

<sup>666</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1535-1536.

grupin e katërt të dokumenteve, përpiloi për këtë një notë zyrtare.<sup>667</sup> Në këtë dokument, z. Moberg bënte të ditur se i kishte vendosur dokumentet në dy qese provash (dokumenti i dorëzimit u fut në njëren prej këtyre qeseve), të cilat u transportuan më pas me veturë në mjediset e ZPS-së në Prishtinë.<sup>668</sup> Më 17 shtator 2020, z. Moberg ua dorëzoi dy qeset e provave përfaqësuesve të ZPS-së për t'i transportuar në zyrat e ZPS-së në Hagë.<sup>669</sup> Së treti, znj. Pumper dëshmoi për marrjen në dorëzim, përfshirë edhe mbi bazën e dokumentit të dorëzimit.<sup>670</sup> Znj. Pumper gjithashtu dëshmoi se ishte në gjendje të konfirmonte që dokumentet e “paketës 4” shqyrtuar prej saj, ishin ato që ishin marrë në zyrën e gazetës *Infokus* më 9 shtator 2020, për shkak të renditjes së njëpasnjëshme të numrave ERN me të cilët dokumentet ishin regjistruar në skedarin e provave të ZPS-së. Në veçanti, znj. Pumper dëshmoi se dokumenti i dorëzimit ishte “ballina” (ERN 078569), pas së cilës vinte grupi i katërt i dokumenteve i identifikuar si “paketa 4” (ERN 078570-079499).<sup>671</sup>

### 3. Përfundim

326. Trupi Gjykses pranon se ZPS-ja nuk i dorëzoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe nuk paraqiti në prova një dokument i cili të përmbushë kriteret e inventarit sipas rregullës 39(4), apo ndonjë dokument tjetër të hollësishëm ku të përshkruhet secili material i sekuestruar në lidhje me secilin prej sekuestrimeve. Sa u takon sekuestrimit të parë dhe sekuestrimit të dytë, Trupi Gjykses mendon se do të duhej të kishte qenë kompetencë e Gjykatësit të Vetëm apo e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të vendoste nëse do t'i kërkonte më tej shpjegim ZPS-së në lidhje me mungesën e një inventari sipas rregullës 39(4), në kuadër të detyrimeve të raportimit të kësaj të fundit. Gjykatësi i Vetëm vendosi ta ushtronte kompetencën diskrecionale dhe vendosi se nuk

---

<sup>667</sup> P99.

<sup>668</sup> P99, para. 5.

<sup>669</sup> P99, para. 6.

<sup>670</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 889-891.

<sup>671</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 890-893.

ishte i nevojshëm një veprim i tillë. Sa i takon sekuestrimit të tretë, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja bëri të ditur se nuk zbatohet rregulla 39 e Rregullores dhe se Gjykatësi i Vetëm nuk e trajtoi konkretisht këtë aspekt, megjithëse ai konstatoi se rregulla 38(3) e Rregullores nuk ishte e zbatueshme.<sup>672</sup> Dorëzimi vullnetar i grupit të katërt të dokumenteve, në mungesë të një urdhri, nuk mbulohet prej rregullave 37-39 të Rregullores.

327. Rregulla 39(4) e Rregullores parashikon se “Prokurori i Specializuar përpilon listën e inventarit të sendeve të sekuestruara me përshkrim dhe informacion të hollësishëm në lidhje me secilin send të sekuestruar”. Ky kusht është detyrues dhe nuk i lë ZPS-së hapësirë për vendimmarrje nëse do ta përpilojë apo jo një dokument të tillë. Rrjedhimisht, ZPS-ja do të duhej ta kishte përpiluar këtë, por nuk e ka zbatuar Rregulloren. Njëherazi, Rregullorja nuk parashikon asnjë mjet ligjor apo masë ndreqëse e cila do të mund të përdorej në rast mospërbushjeje të këtij kushti. Trupi Gjykses vëren se kushti i përpilimit të një inventari ka për qëllim, ndër të tjera, të sigurojë që ZPS-ja të jetë në gjendje të vërtetojë integritetin e provave të mbledhura në përgjigje të ndonjë kundërshtimi ndaj pranueshmërisë së tyre, nëse paraqiten si prova në gjykim.<sup>673</sup> Integriteti i provave të mbledhura mund të vërtetohet edhe përmes dëshmisë së hetuesit që mori pjesë në sekuestrimin e materialit përkatës ose përmes ndonjë mënyre tjetër të ngjashme.<sup>674</sup>

328. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vëren se provat lidhur me secilin sekuestrim apo marrje në dorëzim përfshijnë dëshminë e z. Moberg, që ka qenë i pranishëm në të katër herët e marrjes së materialit.<sup>675</sup> Provat përfshijnë edhe dëshminë e znj. Pumper e cila konfirmoi se dokumentet të cilat ajo i kishte shqyrtuar si paketat 1-4, ishin ato që u

---

<sup>672</sup> F17, para. 4, 9.

<sup>673</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3238.

<sup>674</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3238-3239.

<sup>675</sup> P92; P99; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1930-1932, 1936-1941, 1958.

përfshinë në skedarin e provave të ZPS-së, pasi u morën nga selia e OVL-UÇK-së dhe nga zyra e gazetës *Infokus*.<sup>676</sup> Trupi Gjykses vëren gjithashtu se nuk ka asnjë provë që ndonjë prej këtyre dokumenteve të ketë ardhur nga një burim tjetër veç selisë së OVL-UÇK-së dhe zyrës së gazetës *Infokus*. Po kështu, nuk ka asnjë provë që ndonjë material i sekuestruar nga selia e OVL-UÇK-së apo i marrë nga zyra e gazetës *Infokus* të mos jetë dorëzuar në skedarin e provave të ZPS-së apo se gjatë procesit është cenuar integriteti i ndonjë dokumenti.

329. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses bindet se kronologjia e mbajtjes në ruajtje të materialit të sekuestruar është vërtetuar në mënyrë adekuate nga provat në dokumentacionin gjyqësor dhe se: (i) pjesa e mbetur nga grupi i parë i dokumenteve, që u sekuestrua në selinë e OVL-UÇK-së më 8 shtator 2020 përkon me paketën 1; (ii) pjesa e mbetur nga grupi i dytë i dokumenteve, që u sekuestrua në selinë e OVL-UÇK-së më 17 shtator 2020 përkon me paketën 2; dhe (iii) pjesa e mbetur nga grupi i tretë i dokumenteve, që u sekuestrua në selinë e OVL-UÇK-së më 22 shtator 2020 përkon me paketën 3. Trupi Gjykses gjithashtu bindet se grupi i katërt i dokumenteve që ZPS-ja e mori nga gazeta *Infokus* më 9 shtator 2020 përkon me paketën 4.

330. Pas këtij konstatimi, Trupi Gjykses do t'i referohet këtej e tutje materialit të marrë në selinë e OVL-UÇK-së dhe në zyrën e gazetës *Infokus* si paketat 1-4. Trupi Gjykses do të vijojë t'u referohet tri grupeve të dokumenteve kur të trajtojë veprimet e të akuzuarve gjatë periudhës së Aktakuzës. Gjithsesi, për konstatimet lidhur me veprat penale për të cilat ngrihen akuzat, Trupi Gjykses mbështetet vetëm në provat e administruara në dokumentacionin gjyqësor.

---

<sup>676</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 854-857, 859, 889-893, 912-914, 921-924.

## B. PËRMBAJTJA E PAKETAVE

331. ZPS-ja nuk i paraqiti paketën 1 dhe paketën 3 në tërësi si prova.<sup>677</sup> Një version i redaktuar i paketës 2 (P104) është pjesë e dokumentacionit. ZPS-ja argumentoi se nxjerrja e paketave 1 dhe 3 për të akuzuarit do të rrezikonte që t'u kthehej mjete me të cilin kryen veprat penale për të cilat akuzohen.<sup>678</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtroi gjithashtu se masat kompensuese të urdhëruara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në vend të nxjerrjes së plotë janë efektive dhe kanë ruajtur drejtësinë e procesit, në veçanti përshkrimi tabelor i paketave nga znj. Pumper.<sup>679</sup>

332. Megjithëse pajtohet se nxjerrja e paketave 1 dhe 3 për të akuzuarit do të mbartte rreziqe të rritura, si për ata të cilëve u përmenden emrat në to, ashtu edhe për hetimet e ZPS-së, Trupi Gjyqësor mendon gjithashtu se mungesa e këtij materiali nga dokumentacioni i çështjes gjyqësore e ka ndërlikuar konstatimin e përmbajtjes, autenticitetit dhe konfidencialitetit të paketave. Trupi Gjyqësor është i vetëdijshëm se akuzat penale mund të vërtetohen në mënyra të ndryshme,<sup>680</sup> por ai thekson se nxjerrja e materialit të kundërshtuar i cili qëndron në thelb të akuzave të ngritura (po të jetë nevoja, edhe me redaktime të kufizuara) është mënyra më efektive dhe ndonjëherë mënyra e vetme përmes së cilës mund të vendoset një çështje gjyqësore.

333. Për të përcaktuar përmbajtjen e paketave, Trupi Gjyqësor u mbështet në: (i) deklaratat dhe dëshminë në sallë të gjyqit të znj. Pumper lidhur me përmbajtjen e tyre dhe provat materiale në lidhje me të, gjegjësisht pjesë të pranuar si prova nga paketat 1 dhe 4, P104 (paketa 2), pjesë të pranuar si prova nga paketa 3 dhe artikuj në media; (ii) sipas rastit, dëshmi të dëshmitarëve të tjerë; dhe (iii) deklaratat e të akuzuarve.

---

<sup>677</sup> *Shih më poshtë* para. 339, 354 (Konstatime mbi paketat).

<sup>678</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 166.

<sup>679</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 166-167.

<sup>680</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 169.

## 1. Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të

### (a) Paketa 1

334. Për të përcaktuar përmbajtjen e paketës 1 përmes dëshmisë së znj. Pumper, Trupi Gjykses do të marrë parasysh edhe dëshminë e z. Berisha lidhur me paketën 4. Z. Berisha ka përshkruar se paketa 4 e cila përkon me grupin e katërt të dokumenteve, është marrë nga grupi i parë i dokumenteve në konferencën e parë për shtyp.<sup>681</sup> Në bazë të kësaj, përmbajtja e paketës 4 ka lidhje me përcaktimin e përmbajtjes së grupit të parë të dokumenteve dhe, përfundimisht, të paketës 1.

#### i) Përmbajtja e përgjithshme e paketave 1 dhe 4

335. Sa i takon përmbajtjes së paketës 1, znj. Pumper deklaroi se: (i) përmbante 891 faqe dokumentesh të shkruara në gjuhën angleze, serbe dhe gjermane;<sup>682</sup> (ii) mbi 200 dokumente ishin të shkruara në gjuhën serbe, me shkronja latine ose cirilike;<sup>683</sup> dhe (iii) përmbante një dokument në gjermanishte të hartuar nga personeli i KFOR-it gjerman.<sup>684</sup>

336. Znj. Pumper deklaroi më tej se paketa 1 përshinte: (i) mbi njëqind “kërkesa konfidenciale për ndihmë” të TFHS-së (“kërkesat e TFHS-së”) drejtuar autoriteteve kompetente serbe nga viti 2013 deri në 2015,<sup>685</sup> më së shumti të përbëra nga letër përcjellëse dhe shtojca konfidenciale;<sup>686</sup> (ii) përgjigjet e Prokurorisë Serbe për Krimet e Luftës (“PSKL”) ndaj kërkesave të TFHS-së (“përgjigjet e PSKL-së”); dhe (iii) dokumente të autoriteteve serbe, si raporte të brendshme të PSKL-së dhe të policisë serbe (“MPB”) dhe komunikime të brendshme midis PSKL-së dhe MPB-së

---

<sup>681</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1520-1521.

<sup>682</sup> P86, para. 6; P88, para. 5-6.

<sup>683</sup> P88, para. 6.

<sup>684</sup> P88, para. 13.

<sup>685</sup> P86, para. 7, 9; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 860, 862.

<sup>686</sup> P86, para. 8.



("dokumentet serbe").<sup>687</sup> Znj. Pumper gjithashtu tha se disa prej këtyre dokumenteve serbe u referoheshin masave të marra në mbështetje të hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.<sup>688</sup>

337. Znj. Pumper hartoi edhe një tabelë në të cilën përshkruante, sipas numrit të faqeve, çdo dokument që përmbante paketa 1 dhe jepte, ndër të tjera, tregues të cilët sugjeronin natyrën konfidenciale të dokumentit dhe nëse përmendeshin emra dëshmitarësh (të mundshëm) ("tabela e paketës 1").<sup>689</sup>

338. Gjithashtu, znj. Pumper bëri të ditur se fotografitë të cilat ZPS-ja i mori më 7 shtator 2020, në orën 6:34 të mbrëmjes nga një media kosovare ("shtatë fotografitë") përmbanin pamje të fotografuara nga ekrani të tri kërkesave të TFHS-së dhe të një dokumenti serb që bënë pjesë në paketën 1.<sup>690</sup>

339. Trupi Gjykues vëren se pesë pjesë të shkëputura nga paketa 1 për të cilat foli znj. Pumper gjatë dëshmisë së saj duket se janë kërkesat e TFHS-së drejtuar PSKL-së për marrje provash.<sup>691</sup>

340. Sa i takon paketës 4, z. Berisha dëshmoi se dokumentet të cilat i mori nga konferenca e parë për shtyp: (i) ishin përafërsisht 1000 faqe;<sup>692</sup> (ii) përmbanin letërkëmbim, komunikim midis zyrtarëve të TFHS-së dhe prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë të Serbisë;<sup>693</sup> dhe (iii) përfshinin kërkesa nga TFHS-ja drejtuar prokurorëve serbë për të ndihmuar në gjetjen e dëshmitarëve dhe adresave të tyre dhe se këta dëshmitarë përmendeshin me emër në këto kërkesa.<sup>694</sup>

---

<sup>687</sup> P86, para. 7; P88, para. 8; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 860-861.

<sup>688</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 886-887; P90 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 1), f. 16, 18-19, 23, 30, 45, 47.

<sup>689</sup> P90 (Shtojca 1 – Tabela mbi paketën 1); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 869-870.

<sup>690</sup> P89, para. 14-16, 18, 20. *Shih gjithashtu* P101; P102.

<sup>691</sup> P93, P94, P95, P96, P97.

<sup>692</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1520-1521.

<sup>693</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1572-1573, 1600, 1626.

<sup>694</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1572-1573. *Shih gjithashtu më lart* para. 343.

341. Znj. Pumper tha se paketa 4 përbëhej nga 930 faqe.<sup>695</sup> Ajo deklaroi gjithashtu se të gjitha dokumentet të cilat i përmbante paketa 1 i përmbante edhe paketa 4, me përjashtim të katër dokumenteve.<sup>696</sup> Në lidhje me këtë, znj. Pumper paraqiti një tabelë në të cilën përshkruante, sipas numrit të faqeve, secilin dokument që përmbante paketa 4. Ajo përmendi, ndër të tjera, tregues që sugjeronin natyrën konfidenciale të dokumentit dhe nëse përmendeshin emrat dëshmitarësh (të mundshëm), faqet përkatëse në paketën 1 dhe një përshkrim të dallimeve, nëse kishte, midis dokumenteve që përmbanin të dyja paketat 1 dhe 4 (“tabela e paketës 4”).<sup>697</sup>

342. Znj. Pumper tha gjithashtu se paketa 4 përmbante një sërë dokumentesh të cilat nuk i përmbante paketa 1, që ishin: (i) kërkesa të tjera të TFHS-së; (ii) dokumente të tjera serbe; dhe (iii) një dokument prej dy faqesh në gjuhën shqipe, në dukje pa lidhje me dokumentet e tjera të paketës 4.<sup>698</sup> Gjithashtu, gjashtë prej shtatë fotografive tregonin dokumente të cilat i përmbante paketa 1, që ishin: (i) katër kërkesa të TFHS-së, tri prej të cilave i përmbante paketa 1; dhe (ii) dy dokumente serbe, një prej të cilave i përmbante paketa 1.<sup>699</sup>

343. Trupi Gjykses vëren se, pas konferencës së parë për shtyp, disa media dhanë hollësi siç pretendohet nga kërkesa të TFHS-së, përfshirë emra, të dhëna personale të dëshmitarëve dhe/ose informacione të lidhura me përmbajtjen e tyre.<sup>700</sup> Gjithashtu, në disa artikuj në media dolën pamje të fotografuara nga ekrani të faqeve ku dukeshin

---

<sup>695</sup> P89, para. 7.

<sup>696</sup> P89, para. 8, ndryshuar me P87. W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 891, 893-895, 904.

<sup>697</sup> P91 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 4).

<sup>698</sup> P89, para. 11-13.

<sup>699</sup> P89, para. 14-20. *Shih gjithashtu* P101; P102.

<sup>700</sup> P123; P124, f. 1-2 (1D16), 3-4 (P128), 5; P125, f. 9-10 (P125ET.3); P129, f. 1 (1D2, f. 1-4, 9-19), 12 (1D2, f. 44-46), 14 (1D2, f. 50-54), 15 (1D2, f. 55-67); 1D17. *Shih gjithashtu* P86, para. 13-14 (ku i referohet P125, f. 4-8), para. 15 (ku i referohet P125, f. 1-3), para. 16 (ku i referohet P124, f. 1-2), para. 17 (ku i referohet P124, f. 3-4) dhe para. 18 (ku i referohet P124, f. 4-5).

kryesisht kërkesat e TFHS-së.<sup>701</sup> Disa dolën nga gazeta *Infokus*, me përshkrime dhe/ose pamje të fotografuara nga ekrani të përmbajtjes së paketës 4.<sup>702</sup>

ii) Emrat e dëshmitarëve në paketat 1 dhe 4

344. Në kontekstin e shqyrtimit të paketave, znj. Pumper konsideronte si dëshmitar çdo person me të cilin TFHS-ja/ZPS-ja ishte takuar dhe prej të cilit kishte marrë informacion, përfshirë edhe në formën e intervistës.<sup>703</sup> Si dëshmitar të mundshëm, ajo konsideronte këdo prej të cilit ZPS-ja kërkonte të merrte, përfshirë përmes organizatave të tjera, informacion, përfshirë në formën e intervistës.<sup>704</sup> Znj. Pumper gjithashtu vërejti se, gjatë shqyrtimit, kishte kontrolluar nëse individët e identifikuar ishin ose nuk ishin regjistruar në listën tërësore të dëshmitarëve të ZPS-së.<sup>705</sup>

345. Sa i takon paketës 1, znj. Pumper tha se: (i) në mbi 150 dokumente përmendeshin emrat e 699 individëve;<sup>706</sup> (ii) shtojcat konfidenciale të kërkesave të TFHS-së rendisnin “qindra emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm”,<sup>707</sup> në lidhje me të cilët TFHS-ja kërkonte të merrte përmes autoriteteve kompetente serbe ndihmë për kryerjen e intervistave dhe dokumentacion të deklaratave të mëparshme;<sup>708</sup> (iii) në dokumentet serbe përmendeshin emrat e dhjetëra viktimave dhe dëshmitarëve të cilët ishin intervistuar nga TFHS-ja/ZPS-ja;<sup>709</sup> (iv) të njëjtët emra (të përmendur në dokumentet serbe) përmendeshin edhe në dokumentet që bënin pjesë në kërkesat e

---

<sup>701</sup> P123; P124, f. 1-2 (1D16), 3-4 (P128), 5; P125, f. 1-3 (1D11), 4-8 (P129, f. 14; 1D2, f. 50-54); P129, f. 15 (1D2, f. 55-67); 1D17.

<sup>702</sup> P125, f. 1-3 (P125ET.1; 1D11), 4-8 (P125ET.2; P129, f. 14; 1D2, f. 50-54); P129, f. 1 (1D2, f. 1-4, 9-19), 12 (1D2, f. 44-46), 15 (1D2, f. 55-67).

<sup>703</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080.

<sup>704</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080.

<sup>705</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1079.

<sup>706</sup> P88, para. 10 ndryshuar me P87. Znj. Pumper nuk saktësoi nëse i identifikonte të gjithë këta individë si dëshmitarë apo si dëshmitarë të mundshëm.

<sup>707</sup> P86, para. 9.

<sup>708</sup> P86, para. 8.

<sup>709</sup> P88, para. 11; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 886-887.

TFHS-së të cilat përmbanin lista të intervistave të TFHS-së, të cilat i përmbante edhe paketa 1;<sup>710</sup> dhe (v) ajo përmbante edhe 35 deklaratave ose pjesë të deklaratave të viktimave dhe dëshmitarëve të marra nga autoritetet serbe, në të cilat kishte edhe të dhëna personale dhe informacion të hollësishëm për krime të rënda.<sup>711</sup> Znj. Pumper identifikoi edhe katër individë, [REDAKTUAR], emrat e të cilëve dhe të dhëna të tjera ishin përfshirë në shtojcat e kërkesave të TFHS-së, “në mesin e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve potencialë të tjerë që TFHS-ja kishte kërkuar të intervistonte dhe në lidhje me të cilët ishte kërkuar procesverbali i deklaratave të mëparshme”.<sup>712</sup> Në tabelën e paketës 1, znj. Pumper identifikoi një numër të madh dokumentesh si dokumente që përmbanin emra dëshmitarësh (të mundshëm).<sup>713</sup>

346. Sa i takon paketës 4, znj. Pumper deklaroi se: (i) kërkesat shtesë të TFHS-së, jo të përfshira në paketën 1, përmbanin dhjetëra emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm të TFHS/ZPS-së;<sup>714</sup> dhe (ii) dokumentet serbe të papërfshira në paketën 1 përmbanin, ndër të tjera, procesverbal të pjesshëm ose të plotë të deklaratave të dëshmitarëve të cilat i kishin marrë autoritetet serbe, raporte të lëshuara dhe komunikime mes MPB-së dhe PSKL-së dhe dokumente dhe lista të cilat përmbanin emra dhe të dhëna personale të individëve të cilët ajo i identifikoi si viktimë, dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm të TFHS-së/ZPS-së.<sup>715</sup>

#### (b) Paketa 2

347. Znj. Pumper e përshkroi paketën 2 se përmbante: (i) 937 faqe dokumentesh të shkruara në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe;<sup>716</sup> dhe (ii) kryesisht kopje të

---

<sup>710</sup> P88, para. 11.

<sup>711</sup> P88, para. 12 ndryshuar me P87.

<sup>712</sup> P86, para. 10; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 884-885.

<sup>713</sup> P90 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 1).

<sup>714</sup> P89, para. 11.

<sup>715</sup> P89, para. 12.

<sup>716</sup> P86, para. 20.

aktgjytimeve të lëshuara nga gjykatat e Kosovës dhe institucione të tjera gjyqësore, përfshirë nga TPNJ, në lidhje me krime të luftës.<sup>717</sup> Kopjet e këtyre aktgjytimeve nuk kishin asnjë stemë apo shenja tipike të dokumenteve të TFHS-së apo ZPS-së.<sup>718</sup>

348. Znj. Pumper gjithashtu tha se paketa 2 përfshinte gjashtë faqe të cilat i përmbante edhe paketa 1, që mbulonin (pjesë të) tri kërkesave të TFHS-së dhe dy dokumente serbe ("gjashtë faqet").<sup>719</sup> Për këto, znj. Pumper paraqiti një tabelë të ngjashme me atë që kishte përgatitur për paketën 1, ku përshkruhej secila faqe duke dhënë, ndër të tjera, tregues që sugjeronin natyrën konfidenciale të dokumentit dhe nëse përmendeshin emra dëshmitarësh ose dëshmitarësh të mundshëm ("tabela e paketës 2").<sup>720</sup>

349. Trupi Gjyqësor vëren se versioni i pranuar si provë i paketës 2, P104, e mbështet dëshminë e mësipërme. Ajo përmban: (i) aktgjytime të gjykatave të Kosovës, ose pjesë apo dublikata të tyre;<sup>721</sup> (ii) një aktakuzë të Prokurorisë Speciale të Kosovës;<sup>722</sup> (iii) aktakuza dhe përmbledhje aktgjyqimesh të TPNJ-së ose pjesë apo dublikata të tyre;<sup>723</sup> dhe (iv) gjashtë faqet me redaktime.<sup>724</sup>

350. Sipas znj. Pumper, njëra prej gjashtë faqeve, një pjesë e shkëputur nga një kërkesë e TFHS-së, u referohej masave logjistike për kryerjen e intervistave.<sup>725</sup> Një tjetër faqe, që ishte një pjesë e shkëputur nga një dokument serb, përmbante udhëzime drejtuar autoriteteve serbe në vijim të një kërkesë të TFHS-së për të gjetur adresën dhe për të ndihmuar me intervistën e një dëshmitari të mundshëm të përmendur me emër në një

<sup>717</sup> P86, para. 21; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 914.

<sup>718</sup> P86, para. 21; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1197.

<sup>719</sup> P86, para. 22-27; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 914-917; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1197-1200.

<sup>720</sup> P90 (Shtojca 3 – Tabela e paketës 2).

<sup>721</sup> P104, f. 1-415, 524-614, 628-834.

<sup>722</sup> P104, f. 416-480.

<sup>723</sup> P104, f. 496-523, 621-627, 835-937.

<sup>724</sup> P104, f. 615-620. *Shih gjithashtu* P139-P144, që janë pjesë të shkëputura nga paketa 1 të cilat përkrijnë me gjashtë faqet e paketës 2 dhe P145-150, që janë pjesë të shkëputura nga paketa 4 të cilat përkrijnë me gjashtë faqet e paketës 2. *Shih* F427, para. 30, 33.

<sup>725</sup> P86, para. 24; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1200-1204.

shtojcë konfidenciale të papërfshirë në paketën 2.<sup>726</sup> Ndërsa një faqe tjetër, gjithashtu e shkëputur nga një dokument serb, përmbante emrat, datëlindjet dhe funksionet profesionale të së paku dy dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së/ZPS-së.<sup>727</sup>

351. Trupi Gjykses vëren më tej se, pas konferencës së dytë për shtyp, një sërë raportesh i referoheshin dorëzimit të dytë,<sup>728</sup> por shumica nuk përmbanin hollësi në lidhje me grupin e dytë të dokumenteve. Sidoqoftë në një artikull në media kishte një pamje të fotografuar nga ekrani të një faqeje që tregonte një dokument të TPNJ-së si pjesë të paketës 2.<sup>729</sup>

(c) Paketa 3

352. Znj. Pumper përshkroi se paketa 3: (i) përbëhej nga dy kopje të paplota të të njëjtit dokument;<sup>730</sup> (ii) ishte e shkruar në gjuhën angleze; dhe (iii) përfshinte kopje të paplota të “një dokumenti konfidencial të ZPS-së”, i cili përbëhej nga 261 faqe, që u përkiste hetimeve të ZPS-së dhe procedurave zyrtare dhe që përbënte produkt të brendshëm pune.<sup>731</sup>

353. Znj. Pumper dha hollësi në lidhje me dy kopjet e paplota. E para, “kompleti 1”, kishte 245 faqe, ndërsa e dyta, “kompleti 2”, arrinte në 244 faqe.<sup>732</sup> Të dy thuhej se ishin kopje të paplota të “një memorandumi të brendshëm konfidencial të ZPS-së, që u përket hetimeve dhe procedimeve zyrtare të ZPS-së dhe që përbën produkt të punës

---

<sup>726</sup> P86, para. 26; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1207-1209.

<sup>727</sup> P86, para. 27; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 916-917; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1209-1210.

<sup>728</sup> P129, f. 5, 7 (1D2, f. 29-31), 9 (1D2, f. 35-37), 13 (1D2, f. 47-49).

<sup>729</sup> P125, f. 12; P104, f. 835.

<sup>730</sup> P86, para. 29; P90, para. 7; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 951; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1214.

<sup>731</sup> P86, para. 29; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 951; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1215.

<sup>732</sup> P90, para. 8(i), 9(i); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 926-927.

së brendshme”.<sup>733</sup> Znj. Pumper tha gjithashtu se grupi 1 dhe grupi 2 përfshinin një analizë të provave të disponueshme dhe të ligjit të zbatueshëm në lidhje me pesë persona të dyshuar të ZPS-së, gjegjësisht z. Azem Syla, z. Thaçi, z. Jakup Krasniqi, z. Kadri Veseli dhe z. Rexhep Selimi.<sup>734</sup> Ajo deklaroi se dukej se të dyja kopjet mbanin datën e dhjetorit 2019, por përmbanin data konkrete të intervistave me dëshmitarë dhe të dyshuar deri në mars 2020.<sup>735</sup>

354. Trupi Gjykses vëren se katërmbëdhjetë provat materiale të pranuar si pjesë të shkëputura nga paketa 3 duket se janë, dhe janë përshkruar nga znj. Pumper si, dyshe faqesh përkuese nga grupi 1 dhe grupi 2, që përmbajnë analizë të provave dhe të aspekteve ligjore në lidhje me to.<sup>736</sup>

355. Znj. Pumper tha gjithashtu se paketa 3 përmbante referenca për: (i) emra dhe prova të dhëna nga dëshmitarë, dëshmitarë të mundshëm dhe të dyshuar;<sup>737</sup> dhe (ii) “afërsisht 150 dëshmitarë (të mundshëm)”.<sup>738</sup> Znj. Pumper identifikoi [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], emri [REDAKTUAR] ishte në paketën 3.<sup>739</sup>

356. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se, pas konferencës së tretë për shtyp, disa artikuj në media përshkruanin përmbajtjen dhe/ose jepnin pamje të fotografuara nga ekrani të faqeve nga grupi i tretë i dokumenteve, për të cilat bënin të ditur se OVL-UÇK-ja i kishte vënë në dispozicion. Në veçanti, disa artikuj në media jepnin hollësi nga projekt-aktakuza e pretenduar, përfshirë emrat e të dyshuarve, hollësi të analizës, si

---

<sup>733</sup> P90, para. 8(i), 9(i); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 926-927.

<sup>734</sup> P86, para. 29; P90, para. 8(i), 9(i); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 926, 931-932; Transkripti, 19 tetor 2021, f. 952; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1215.

<sup>735</sup> P90, para. 8(ii), 9(ii); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 950.

<sup>736</sup> P106; P107; P108; P109; P110; P111; P112; P113; P114; P115; P116; P117; P118; P119; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 927-930; Transkripti, 19 tetor 2021, f. 940-948.

<sup>737</sup> P86, para. 31; P90, para. 8(i), 9(i); W04841 (Zdenka Pumper); Transkripti, 18 tetor 2021, f. 926; Transkripti, 19 tetor 2021, f. 949.

<sup>738</sup> P90, para. 8(iv), 9(iv); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 950.

<sup>739</sup> P86, para. 31.

edhe emra dhe/ose informacione të tjera personash.<sup>740</sup> Gjithashtu, disa artikuj në media jepnin pamje të fotografuara nga ekrani të faqeve të cilat përmbanin informacionin e lartpërmendur.<sup>741</sup>

## 2. Deklaratat e të akuzuarve

357. Trupi Gjykses ka bërë një vlerësim të deklaratave të atëhershme dhe dëshmimeve të të akuzuarve lidhur me përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve për të konstatuar nëse dhe deri ku: (i) i konfirmojnë provat lidhur me përmbajtjen e paketave; dhe (ii) ishin të vetëdijshëm të akuzuarit për përmbajtjen e dokumenteve të cilat i shpërndanë dhe i përshkruan publikisht.

### (a) Këqyrja e tri grupeve të dokumenteve

358. Siç konstatohet më lart, të akuzuarit shqyrtuan secilin prej tri grupeve të dokumenteve pas dorëzimit të tyre.<sup>742</sup>

359. Sa i takon grupit të parë të dokumenteve, z. Gucati bëri një këqyrje disi sipërfaqësore.<sup>743</sup> Këqyrja e bërë nga z. Haradinaj ishte më e gjerë dhe zgjati, siç tha ai

---

<sup>740</sup> P120; P121; P122; P155; P156; P157; P158; P159; P160. *Shih gjithashtu* P86, para. 36-74.

<sup>741</sup> P120; P121; P122; P125, f. 14-18 (P125ET.4;1D12); P155; P156; P157; P158; P159; P160. *Shih gjithashtu* P86, para. 36-74.

<sup>742</sup> *Shih më lart* para. 211, 246, 276-277 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>743</sup> P1, f. 1 (z. Gucati: "është më i informum Nasimi [për dokumentet], se Nasimi i ka hulumtu pak. Këto i ka këqyrë, i ka analizu me Fatonin [Klinaku] e me shokë të tjerë"); 1D3, para. 14, 16; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168-2169.



atëherë, 3 deri në 4 orë.<sup>744</sup> Asnjëri prej dy të akuzuarve nuk bëri këqyrje të çdo dokumenti.<sup>745</sup>

360. Sa i takon grupit të dytë të dokumenteve, të akuzuarit kishin në dispozicion rreth një orë e gjysmë për ta këqyrrur përpara konferencës së dytë për shtyp, megjithëse nuk është e qartë nëse të gjithë këtë kohë e përdorën për këqyrje.<sup>746</sup> Këqyrja nuk ishte shteruese, por z. Haradinaj tha se lexoi aq sa mundi gjatë asaj kohe.<sup>747</sup>

361. Sa i takon grupit të tretë të dokumenteve, të akuzuarit kishin në dispozicion rreth një orë e gjysmë për ta këqyrrur, megjithëse nuk është e qartë nëse të gjithë këtë kohë e përdorën për këqyrje.<sup>748</sup> Provat tregojnë se këqyrja e grupit të tretë të dokumenteve ishte më sipërfaqësore se e grupeve të mëparshme dhe mund t'i ketë marrë z. Haradinaj rreth 30 minuta.<sup>749</sup>

---

<sup>744</sup> P8, f. 20, 33 ([Panelist]: “Paske lexu shumë, për katër orë. z. Haradinaj: Unë jam specialist për lexim”); P18, f. 3-4 (z. Haradinaj: “sa kemi mundur... për tre orë”); P21, f. 4 (z. Haradinaj: “Në çfarë kemi mujtë për katër orë me pa, ka të dhëna të njerëzve me emra e me mbiemra”), 5 (z. Haradinaj: “Sa kemi mujtë na përciptazi për katër orë me shfletu, e sa kemi mujtë.”); P24, f. 7 (z. Haradinaj: “normal që i kem pas katër orë në disponim me i bo ato. Deri në ora një, prej orës nëntë e diçka”); P25, f. 4 (z. Haradinaj: “Dosjen e parë kemi pas kohë nja tri katër orë me e shfletue, po ka qenë një volum i madh do t’thotë, prej 800 deri në 1200/1300 fletë”).

<sup>745</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj: “Po ne i kemi shiku vetëm shkarazi. Dhe ato që kemi vërejtë këtu, kemi vërejtë shumë.”), 4 (z. Haradinaj: “Ne e kemi lexu, për shkarazi. [...] sepse s'patëm kohë me i lexu. E shihni çfarë materiali a? Qe ju me e marre me e lexu i doni një javë ditë me i lexu këto”), 5 (z. Haradinaj: “Kaq përciptazi”); P9 f. 7 (z. Gucati: “nuk i kemi kontrollu t’gjitha ato dokumenta tu pa ça po duket ... n’ekran kështu. Ka pas shumë, mbi 4000 që thashë. Ne nuk i kemi bo, ne i kemi has disa dokumenta që kemi kontrollu edhe n’moment na ka ra lista n’dorë, lista që kish listat e ndryshme, lista t’ndryshme që ishin mbrena ato”), 10 (z. Gucati: “na s’kena mujtë me shpalu t’gjitha ato me kontrollu”); P24, f. 3 (z. Haradinaj: “po ne s'kem mujtë me lexu deri n'fund tash”), 5, 7 (z. Haradinaj: “ne i kemi shfletu pra, e kemi këqyr”).

<sup>746</sup> *Shih më lart* para. 243, 246, 248 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>747</sup> P2, f. 1 (z. Gucati: “ne s’kemi pas kohë as me i kontrollu [...] Më shumë është edhe Nasimi që ka bë sa ka mujtë. [...] më shumë ka punu ky se unë në këtë drejtim”); P7, f. 17 (z. Haradinaj: “Shkurt i kemi pa. Një orë e gjysmë”); P8, f. 9 ([Panelist]: “Ai ke lexu, Nasim, dosjet? z. Haradinaj: Po, kemi lexu sa kemi mujtë, brenda orarit të kohës që kemi pas”); P33, f. 3 (z. Haradinaj: “mes orës kur po vjen, që ndoshta s’po muj mbërrimë as me lexu shumë, [...] Kemi pas kohë me lexu edhe gazetarët kanë marr boll”).

<sup>748</sup> *Shih më lart* para. 275, 277, 279 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>749</sup> P30, f. 3-4 (z. Haradinaj: “s’kem mbri me lexu shumë sepse kem dashë me u konë pak ma ... jau kemi lënë mediat me i marrë materialet”); P35, f. 2 (z. Gucati: “Nasimi pak a shumë, jo se më shumë ngjarje se unë, po ka lexu pak më shumë për nja 30 minuta sa ka mujtë me lexu”).

## (b) Deklaratat e atëhershme të të akuzuarve

## i) Grupi i parë i dokumenteve

362. Z. Gucati e përshkroi grupin e parë të dokumenteve se: (i) përmbante “dikun afër 4000 dosje të Gjykatës Speciale”;<sup>750</sup> (ii) pasqyronte bashkëpunimin midis DHS-së dhe prokurorëve serbë;<sup>751</sup> dhe (iii) përmbante emra dëshmitarësh si edhe informacione mbi intervistat me dëshmitarë të bëra në vende konkrete.<sup>752</sup> Gjithashtu, z. Gucati përmendi se grupi i parë i dokumenteve përmbante numra referimi dhe data,<sup>753</sup> vula dhe nënshkrime<sup>754</sup> dhe dokumente që i përkisnin Adem Jasharit dhe ish-anëtarëve të tjerë të UÇK-së të përmendur me emra.<sup>755</sup>

363. Z. Haradinaj vërejti se grupi i parë i dokumenteve: (i) konsistonte në katër kopje/dosje me “dikun ke 1000-1200-1300-1400 faqe”;<sup>756</sup> (ii) përmbante kontakte midis Klint Uilliamsonit dhe Vlladimir Vukçeviqit (“z. Vukçeviq”);<sup>757</sup> (iii) përmbante “emnat e të gjithë dëshmitarëve”;<sup>758</sup> dhe (iv) përfshinte deklarata të dëshmitarëve me emrat dhe të dhënat e tyre personale,<sup>759</sup> fletëthirrje për persona konkretë<sup>760</sup> dhe kërkesa drejtuar Serbisë për të dhënë vendndodhjen e dëshmitarëve.<sup>761</sup> Gjithashtu, z. Haradinaj: (i) vërejti se grupi i parë i dokumenteve përmbante “shumë”;<sup>762</sup> (ii) dalloi emrat dhe kombësinë e dëshmitarëve si edhe emrat e zyrtarëve të TFHS-së dhe

---

<sup>750</sup> P1, f. 1.

<sup>751</sup> P9, f. 6.

<sup>752</sup> P1, f. 4; P9, f. 5, 7, 10.

<sup>753</sup> P28, f. 13-14. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2248-2250 (ku pretendon se u vu në dijeni për këtë *post-facto* nga një gazetar).

<sup>754</sup> *Shih, p.sh.*, P9, f. 5-6; P28, f. 13-14.

<sup>755</sup> *Shih, p.sh.*, P9, f. 9, 13-14.

<sup>756</sup> P1, f. 2; P24, f. 7.

<sup>757</sup> P1, f. 2; P21, f. 4.

<sup>758</sup> P1, f. 2.

<sup>759</sup> P1, f. 2, 5; P24, f. 8; P21, f. 4-5.

<sup>760</sup> P1, f. 2.

<sup>761</sup> P24, f. 8.

<sup>762</sup> P1, f. 2. *Shih gjithashtu* P21, f. 5.

zyrtarëve serbë;<sup>763</sup> (iii) ishte në gjendje të përcaktonte se disa prej dëshmitarëve ishin intervistuar më herë;<sup>764</sup> (iv) pa datat dhe vendet e intervistave, vendbanimet dhe numrat e telefonit të dëshmitarëve;<sup>765</sup> (v) identifikoi një fletëthirrje të lëshuar nga një zyrtar i njohur;<sup>766</sup> (vi) vërejti bashkëpunimin me shefa të njohur policie ku bëhej i ditur vendbanimi i tyre (i pretenduar);<sup>767</sup> (vii) identifikoi gjuhën e dokumenteve;<sup>768</sup> (viii) dalloi kërkesat e TFHS-së dhe letrat e falënderimit për bashkëpunimin;<sup>769</sup> dhe (ix) pranoi se kishte lexuar dokumente në serbokroatisht.<sup>770</sup>

364. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se, gjatë konferencës së parë për shtyp, z. Gucati dhe z. Haradinaj treguan para kamerës faqe të grupit të parë të dokumenteve.<sup>771</sup>

ii) Grupi i dytë i dokumenteve

365. Z. Gucati përshkroi se grupi i dytë i dokumenteve: (i) përmbante tri kopje të të njëjtave dokumente;<sup>772</sup> (ii) që tregonin se DHS-ja ka bashkëpunuar me prokurorët serbë;<sup>773</sup> dhe (iii) përmbante emra të zyrtarëve serbë.<sup>774</sup>

366. Z. Haradinaj përshkroi se grupi i dytë i dokumenteve përmbante: (i) tri kopje;<sup>775</sup> (ii) komunikime midis Klint Uilliamsonit dhe Kwai Hong Ipit, nga njëra anë, dhe z.

<sup>763</sup> *Shih, p.sh.*, P1, f. 2; P21, f. 4-5; P24, f. 8-9.

<sup>764</sup> P1, f. 2; P21, f. 5; P24, f. 8.

<sup>765</sup> P1, f. 2-3, 5; P21, f. 5; P24, f. 8.

<sup>766</sup> P1, f. 2.

<sup>767</sup> P1, f. 2; P21, f. 4; P24, f. 8.

<sup>768</sup> *Shih, p.sh.*, P1, f. 4-5.

<sup>769</sup> P24, f. 8.

<sup>770</sup> P1, f. 5.

<sup>771</sup> P1 material filmik, minutat 00:01:17-00:01:18 (z. Gucati), 00:14:44-00:14:49 (z. Gucati), 00:14:33-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj).

<sup>772</sup> P2, f. 10-11. Sipas z. Gucati secila kopje përmbante 800-900 faqe, duke qenë gjithsej 2400 faqe. Sidoqoftë, z. Haradinaj u përgjigj se ishin më pak se 800 faqe në secilën kopje dhe se totali ishte rreth 1300-1400 faqe.

<sup>773</sup> P2, f. 1.

<sup>774</sup> P2, f. 1.

<sup>775</sup> P2, f. 11.

Vukçeviq dhe të tjerëve, nga ana tjetër;<sup>776</sup> (iii) emra dëshmitarësh dhe data dhe vende të intervistave/vendbanime;<sup>777</sup> (iv) aktgjykime të gjykatave të Kosovës dhe TPNJ-së, përfshirë aktakuzën kundër Ramush Haradinajt;<sup>778</sup> dhe (v) faqe “më të paklasifikume” se grupi i parë i dokumenteve.<sup>779</sup> Z. Haradinaj më tej pretendoi se në bazë të grupit të dytë të dokumenteve kishte identifikuar: (i) 57 komunikime të Klint Uilliamsonit me z. Vukçeviq;<sup>780</sup> (ii) “mbi 130 komunikime” të David Shvendimanit me një tjetër zyrtar shtetëror serb;<sup>781</sup> dhe (iii) 37 komunikime të “Kai Ipit” me [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] “e kësi”.<sup>782</sup>

367. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se gjatë konferencës së dytë për shtyp, z. Gucati tregoi për kamerat faqe nga grupi i dytë i dokumenteve.<sup>783</sup>

iii) Grupi i tretë i dokumenteve

368. Z. Gucati përshkroi se grupi i tretë i dokumenteve tregonte se ishte përgatitur një aktakuzë<sup>784</sup> dhe se përmbante emra.<sup>785</sup>

369. Z. Haradinaj përshkroi se grupi i tretë të dokumenteve: (i) konsistonte në dy kopje;<sup>786</sup> (ii) përmbante një projekt-aktakuzë, të përgatitur së fundmi, përfshirë emrat e të dyshuarve, akuzat e ngritura kundër tyre dhe arsyet mbi të cilat mbështeteshin;<sup>787</sup> (iii) përmendte “të dhënat të shumë njerëzve [të tjerë]”, si ish-ushtarë dhe zyrtarë serbë

<sup>776</sup> P2, f. 2-3; P18, f. 3; P2, f. 1, 3; P17, f. 7; P18, f. 3; P19, f. 1, 4; 2D1, para. 76.

<sup>777</sup> P18, f. 3.

<sup>778</sup> P2, f. 4; P6, f. 30.

<sup>779</sup> P2, f. 11.

<sup>780</sup> P2, f. 2.

<sup>781</sup> P2, f. 2-3. *Shih gjithashtu* P7, f. 6.

<sup>782</sup> P2, f. 3.

<sup>783</sup> P2 material filmik, minutat 00:01:17-00:01:18 (z. Gucati), 00:11:14-00:11:16 (z. Gucati), 00:11:44-00:11:46 (z. Gucati), 00:14:33-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj).

<sup>784</sup> P35, f. 2; P28, f. 13; P29, f. 1.

<sup>785</sup> P29, f. 1; P35, f. 1, 14.

<sup>786</sup> P30, f. 4.

<sup>787</sup> P35, f. 2-3; P30, f. 2, 4.

dhe emri i një ish-“të brendshmi” të UÇK-së”;<sup>788</sup> (iv) përmbante emrat e vendeve të cilat ai mund t’i lidhte me një çështje gjyqësore të TPNJ-së;<sup>789</sup> (v) i referohej kohës gjatë luftës;<sup>790</sup> dhe (vi) përmbante vula dhe stema zyrtare.<sup>791</sup>

370. Trupi Gjykses vëren se, gjatë konferencës së tretë për shtyp, z. Gucati dhe z. Haradinaj treguan për kamerën faqe nga grupi i tretë i dokumenteve.<sup>792</sup>

371. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se z. Gucati ishte i pranishëm gjatë të tri konferencave për shtyp kur z. Haradinaj bëri komente të ndryshme lidhur me përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve.

372. Trupi Gjykses mendon se përshkrimet prej të akuzuarve të tri grupeve të dokumenteve përkojnë në thelb me natyrën e informacionit të cilin znj. Pumper e identifikoi si të pranishëm në paketat.

(c) Dëshmitë e të akuzuarve

373. Gjatë dëshmisë së tij, z. Gucati në mënyrë të përsëritur pretendoi se e kishte këqyrur materialin në mënyrë sipërfaqësore.<sup>793</sup> Z. Gucati gjithashtu kërkoi ta minimizonte shkallën e dijenisë së tij për përmbajtjen e materialit. Ai theksoi faktin se nuk flet anglisht dhe se flet shumë pak serbisht dhe se, rrjedhimisht, nuk mund t’i kuptonte dokumentet e shkruara në këto dy gjuhë.<sup>794</sup>

374. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se z. Gucati pranoi gjatë dëshmisë së tij se kishte marrë dijeni në atë kohë se grupi i parë i dokumenteve përmbante: (i) katër kopje

---

<sup>788</sup> P35, f. 2-3; P11, f. 9, 55-56; P30, f. 3.

<sup>789</sup> P35, f. 2.

<sup>790</sup> P35, f. 4.

<sup>791</sup> P35, f. 3-4.

<sup>792</sup> P35 material filmik, minutat 00:01:17-00:01:18 (z. Gucati), 00:14:33-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj).

<sup>793</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168-2169, 2190, 2200; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2240-2254. *Shih gjithashtu* 1D3, para. 16.

<sup>794</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168-2169.

identike;<sup>795</sup> (ii) emra dhe deklarata dëshmitarësh;<sup>796</sup> (iii) emra zyrtarësh serbë të përfshirë në bashkëpunimin me TFHS-në/ZPS-në;<sup>797</sup> (iv) stema, vula dhe nënshkrime në dokumente;<sup>798</sup> dhe (v) dokumente që kishin të bënin me Adem Jasharin.<sup>799</sup> Z. Gucati tha edhe se kishte lexuar “shtatë ose tetë”, “jo më shumë se dhjetë” deklarata dëshmitarësh që kishte grupi i parë i dokumenteve.<sup>800</sup> Z. Gucati gjithashtu pranoi se kishte dalluar dokumente nga çështje gjyqësore të TPNJ-së në grupin e dytë të dokumenteve.<sup>801</sup> Sa i takon grupit të tretë të dokumenteve, z. Gucati pranoi se në atë kohë kishte vënë re kishte të bënte me një projekt-aktakuzë dhe se përmbante emra të cilët nuk u lejohej t’i nxirrnin.<sup>802</sup> Sidoqoftë, ai pretendoi se nuk e kishte kuptuar se këta ishin emra dëshmitarësh.<sup>803</sup>

375. Në dëshminë e tij z. Haradinaj kërkoi ta minimizonte kohën që kishte kaluar duke këqyruar tri grupet e dokumenteve dhe dijeninë e tij për përmbajtjen e tyre. Ai dëshmoi se kishte kaluar vetëm “10, 20 minuta” duke këqyruar grupin e parë të dokumenteve,<sup>804</sup> “10 deri 15 minuta” duke lexuar grupin e dytë të dokumenteve,<sup>805</sup> dhe jo më shumë se 3 minuta duke këqyruar grupin e tretë të dokumenteve.<sup>806</sup>

---

<sup>795</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2250-2254 (ku identifikon ballina dhe nënshkrime të ngjashme në dokumente dhe thotë se formati, numri i faqeve dhe përmbajtja e dokumenteve ishte e njëjtë në të katër grupet e dokumenteve).

<sup>796</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2255 (“Më së pari kam pa dëshmitarët serbë, që s’ lejohet të përmenden emrat, në faqet e para kam pa deklaratat e tyre”), 2263 (“po ne e kemi ditë, ka dëshmitarë prej të gjitha kombësive”). *Shih gjithashtu* 1D3, para. 23.

<sup>797</sup> *Shih, p.sh.*, DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2243 (“Unë e thashë edhe ma herët, [REDAKTUAR] Vladimir Vukçeviçin edhe [REDAKTUAR] në bashkëpunim, po [REDAKTUAR] i kam pa këto dy emra që keni bashkëpunuar me këta dy”), f. 2257, 2263-2266; P59.

<sup>798</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2242, 2247, 2250, 2274.

<sup>799</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2256; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2370-2371, 2423, 2426, 2431-2432.

<sup>800</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2425-2426.

<sup>801</sup> *Shih, p.sh.*, 1D3, para. 37; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2193.

<sup>802</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2297-2303.

<sup>803</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2298-2303.

<sup>804</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2725-2726).

<sup>805</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2744. *Shih gjithashtu* f. 2744.

<sup>806</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2785. *Shih gjithashtu* Transkripti, 11 janar 2022, f. 2782; Transkripti, 13 janar 2022, f. 3000, 3002-3004. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 107, 111.

Gjithashtu, siç thuhet më lart,<sup>807</sup> z. Çelë Gashi e kundërshtoi deklaratën e tij të mëparshme se ai dhe të tjerët kishin kaluar 2-3 orë duke e këqyrur grupin e parë të dokumenteve dhe dëshmoi se kishte kaluar vetëm 30 deri 40 minuta për këtë punë.<sup>808</sup> Sidoqoftë Trupi Gjykses vëren se këqyrja prej z. Haradinaj e dy grupeve të para nga tri grupet e dokumenteve duket se ishte mjaftueshmërisht e gjerë për t'i mundësuar atij të komentonte mbi dallimet mes informacioneve që përmbanin ato.<sup>809</sup>

376. Për këto arsye, Trupi Gjykses i ka trajtuar me shumë kujdes dëshmitë e dy të akuzuarve në këtë aspekt, ngaqë duket qartë se pasqyrojnë një orvatje nga ana e tyre për të pretenduar se kishin më pak dijeni për përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve se ç'kishin në të vërtetë.

#### (d) Përfundim

377. Trupi Gjykses bindet se deklaratat e atëhershme të z. Gucati, prania e tij gjatë prezantimeve të z. Haradinaj në tri konferencat për shtyp dhe disa prej pranimeve që bëri gjatë dëshmisë së tij tregojnë se ai ishte në dijeni të përmbajtjes së përgjithshme të tri grupeve të dokumenteve, megjithëse në shkallë më të vogël se z. Haradinaj. Gjithashtu, Trupi Gjykses bindet se deklaratat e asokohshme të z. Haradinaj tregojnë nivelin e hollësishëm që ai kishte dijeni lidhur me përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve. Dy të akuzuarit ishin të vetëdijshëm, duke filluar në konferencën e parë për shtyp, se tri grupet e dokumenteve përfshinin emra dëshmitarësh.

---

<sup>807</sup> *Shih më lart* para. 62 (Pranimi dhe vlerësimi i provave).

<sup>808</sup> *Krahaso* 1D9, para. 14 *me* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2583-2584.

<sup>809</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2745 ("Si burim, si burim dukej si i njëjshëm, por shkrime të tjera këtu, shkrime të tjera. Shumica ka qenë fletfalënderimet, korrespondencat, bashkëpunimi, kërkimi i sigurimit të vendin në Serbi, me i marr në pyetje. Këto kanë qenë, që në atë të parin kanë qenë më shumë -- tjetër – dhe kanë qenë shumë në të parin. Dhe nuk e di, ka pas në të parin, ka pasur edhe serbisht shumë të shkruara, shqip, anglisht. Ka pasur dokumente të vjetra të gjykatave që janë kryer në Kosovë. Këto i di saktë kur ka ardhur dëshmitari numër 1 dhe na i ka shpjeguar se çfarë kanë qenë se jo për momentin aty kur i kam këqyrur").

378. Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se deklaratat e atëhershme të të akuzuarve, si edhe pjesë të dëshmisë së tyre mbi çfarë kishin dijeni për tri grupet e dokumenteve konfirmojnë dëshmitë e znj. Pumper, z. Berisha, versione ose pjesë të shkëputura nga paketat, të pranuar si prova dhe artikujt në media.

### 3. Përfundim mbi përmbajtjen e paketave

379. Pas këqyrjes së provave, Trupi Gjykues bindet se si paketa 1, ashtu edhe paketa 4, përmbanin së paku kategoritë e mëposhtme të informacionit: (i) kërkesat e TFHS-së; (ii) përgjigjet e PSKL-së; dhe (iii) dokumente serbe. Paketat 1 dhe 4 përfshinin gjithashtu emrat e qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në lidhje me hetime të TFHS-së/ZPS-së, përfshirë edhe të katër zyrtarëve serbë, që janë [REDAKTUAR].

380. Gjithashtu, Trupi Gjykues bindet se paketa 2 përmbante kategoritë e mëposhtme të informacionit: (i) dokumente gjyqësore të Kosovës dhe të TPNJ-së; dhe (ii) gjashtë faqe me redaktime që përmbanin kërkesat e TFHS-së dhe dy dokumentet serbe. Gjashtë faqet përfshinin emrat dhe të dhëna të tjera personale të së paku dy dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së/ZPS-së.

381. Trupi Gjykues gjithashtu bindet se paketa 3 përmbante dy kopje të paplota të një produkti të punës së brendshme të ZPS-së, ku analizoheshin prova dhe aspekte ligjore në lidhje me to për pesë të dyshuar të ZPS-së. Në paketën 3 përmendeshin afërsisht 150 dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm, [REDAKTUAR].



## C. AUTENTICITETI I PAKETAVE

382. Mbrojtja kundërshtoi edhe autenticitetin e tri grupeve të dokumenteve, në lidhje me nëse bënin pjesë në dokumentacionin e një apo më shumë hetimeve të ZPS-së.<sup>810</sup>

383. Për të verifikuar autenticitetin e paketave, Trupi Gjykses u mbështet në: (i) deklaratat dhe dëshminë e znj. Pumper lidhur me autenticitetin e tyre, përfshirë tregues për këtë, pjesë të shkëputura nga paketat 1 dhe 4, të pranuar si prova, P104 si edhe pjesë të shkëputura nga paketa 3, të pranuar si prova; dhe (ii) deklaratat e të akuzuarve.

384. Mbështetur në konstatimet e tij lidhur me kategoritë e informacionit që përmbanin paketat,<sup>811</sup> Trupi Gjykses do të përqendrohet në verifikimin e autenticitetit të kategorive të identifikuara të dokumenteve.

### 1. Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të

385. Znj. Pumper bëri të ditur kur dha dëshminë e saj në sallë se verifikimi i autenticitetit të materialit që iu mor OVL-UÇK-së ishte ende në proces dhe se ajo nuk kishte kontrolluar nëse çdo dokument ishte autentik.<sup>812</sup> Megjithatë, znj. Pumper dëshmoi për procesin e gjetjes, në skedarin e të dhënave të ZPS-së, të kopjeve përkatëse të materialit që iu sekuestrua OVL-UÇK-së dhe për tregues të autenticitetit të cilët ajo i kishte vënë re në një pjesë të materialit.

---

<sup>810</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 300-301; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3686-3689, 3699-3701; Transkripti, 17 mars 2022, f. 3768-3769.

<sup>811</sup> *Shih më lart* para. 379-381 (Konstatime mbi paketat).

<sup>812</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1068-1069.

## (a) Paketa 1

386. Znj. Pumper dëshmoi se kishte gjetur disa pjesë të shkëputura të paketës 1 në skedarin e provave të ZPS-së.<sup>813</sup> Ajo dëshmoi gjithashtu se pjesa dërrmuese e kërkesave të TFHS-së ishin të ngarkuara në një prej skedarëve të ZPS-së dhe mbanin numër regjistrimi.<sup>814</sup> Ajo bëri gjithashtu të ditur se kërkesat e TFHS-së në paketën 1 ishin të shënuara me stemën e TFHS-së në këndin e lartë majtas, përfshirë edhe adresën, adresën e postës elektronike dhe adresën e faqes në internet të TFHS-së në këndin e poshtëm majtas dhe ishin nënshkruar nga prokurorë të TFHS-së, të identifikuar me emër dhe titull.<sup>815</sup> Të dhënat që jepen në tabelën e paketës 1 gjithashtu përshkruajnë tregues të autenticitetit, si titulli, kur ka, numri dhe autori i dokumentit, përfshirë edhe për kërkesat e PSKL-së dhe dokumentet serbe.<sup>816</sup>

387. Trupi Gjykses vëren se pjesë të shkëputura nga paketa 1 që janë pranuar si prova, mbajnë të gjitha stemën e TFHS-së, duket se kanë numër regjistrimi (njëri prej të cilëve është i redaktuar), datë dhe titull dhe janë nënshkruar të gjitha nga prokurorë të TFHS-së.<sup>817</sup>

388. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se shumicën e dokumenteve që përmban paketa 4 i përmban edhe paketa 1.<sup>818</sup> Sa u takon dokumenteve që i përmban paketa 4, por jo paketa 1, znj. Pumper i identifikoi si kërkesa të TFHS-së dhe dokumente serbe që kishin të bënin me hetime penale konfidenciale.<sup>819</sup>

389. Mbështetur në këto prova, Trupi Gjykses bindet se kërkesat e TFHS-së, përgjigjet e PSKL-së dhe dokumentet serbe të cilat i përmbajnë paketat 1 dhe 4 janë kopje

---

<sup>813</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 876-879. Znj. Pumper iu referua P94, P95, P96 dhe P97.

<sup>814</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1199.

<sup>815</sup> P86, para. 7. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 864.

<sup>816</sup> P90 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 1). *Shih gjithashtu* P90, para. 4.

<sup>817</sup> P93; P94; P95; P96; P97.

<sup>818</sup> P89, para. 8-10.

<sup>819</sup> P89, para. 11-12.

dokumentesh origjinale që kanë të bëjnë me hetime të TFHS-s/ZPS-së dhe/ose hetime serbe.

(b) Paketa 2

390. Znj. Pumper dëshmoi se mundi të gjente pesë nga gjashtë faqet në njëren prej skedarëve të ZPS-së.<sup>820</sup>

391. Trupi Gjykues vëren se gjashtë faqet në paketën 2 përmbajnë tregues të autenticitetit. Ato mbajnë stema të TFHS-së ose stema serbe, duket se kanë numra regjistrimi, data dhe/ose tituj dhe të gjitha veç njëres kanë nënshkrime ose vula zyrtare.<sup>821</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues bindet se gjashtë faqet janë kopje dokumentesh autentike që kanë të bëjnë me hetime të TFHS-së/ZPS-së dhe/ose hetime serbe.

392. Sa i takon pjesës tjetër të paketës 2, ZPS-ja nuk deklaroi se përmbante informacion konfidencial.<sup>822</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykues nuk e analizon me hollësi autenticitetin e saj por vëren se duket se janë kopje dokumentesh gjyqësore autentike të Kosovës dhe TPNJ-së.

(c) Paketa 3

393. Znj. Pumper u mbështet në një krahasim të paketës 3 dhe një prej versioneve të ndryshme të punës të të njëjtit dokumentacion që gjendej në njëren prej skedarëve të ZPS-së.<sup>823</sup> Znj. Pumper bëri të ditur se shumica e faqeve në paketën 3 kishin një krye të faqes dhe një fund të faqes.<sup>824</sup> Ajo deklaroi se kreu i faqes përfshinte simbolin e ZPS-

---

<sup>820</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1198-1210. Znj. Pumper nuk mbante mend nëse pesë faqet gjendeshin në *Zylab* apo në dosjen DT. Gjashtë faqet janë P104, f. 615-620.

<sup>821</sup> P104, f. 615-620.

<sup>822</sup> P104, f. 496-523, 835-930. *Shih gjithashtu* P2, f. 4-5; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3519-3520.

<sup>823</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 951-952; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1218-1225. *Shih gjithashtu* DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3276-3277 (ku e miraton këtë metodë).

<sup>824</sup> P86, para. 35; P90, para. 8(iii), 9(iii).

së dhe fjalët “Zyra e Prokurorit të Specializuar” në qendër si edhe fjalët “Produkt i brendshëm pune KONFIDENCIAL, përshkrimi i lidhjes me NKP-në dhjetor 2019” në këndin e djathtë të sipërm.<sup>825</sup> Znj. Pumper gjithashtu bëri të ditur se disa faqe nuk kishin krye dhe/ose fund të faqes, me sa duket ngaqë nuk i kishte kapur fotokopja ato pjesë të originalit.<sup>826</sup>

394. Trupi Gjykses vëren se pjesë të shkëputura nga paketa 3 të pranuar në provat gjyqësore mbajnë të gjitha stemën e ZPS-së dhe shënimin “KONFIDENCIAL” në krye të faqes dhe/ose në fund të faqes.<sup>827</sup> Të gjitha me përjashtim të një dysheje duket se përmbajnë në këndin e sipërm të djathtë fjalët “Produkt i brendshëm pune”.<sup>828</sup>

395. Trupi Gjykses vëren argumentin e Mbrojtjes se versione të ndryshme të publikuara të dokumenteve që përmban paketa 3 kishin shenja të ndryshme (p.sh., nënvizime të bëra me dorë dhe vrima të bëra me kapëse aktesh). Sipas Mbrojtjes, këto shenja mund të sugjeronin se gazetarët të cilët publikuan pjesë të shkëputura nga këto dokumente, mund t'i kenë marrë nga një burim tjetër.<sup>829</sup> Trupi Gjykses vëren se nuk ka asnjë provë që këto shenja të jenë bërë përpara apo pasi materiali ishte çuar në OVL-UÇK dhe/ose përpara apo pas konferencës së tretë për shtyp. Për më tepër, paketa 3 nuk është tjetër veçse çfarë që ka mbetur nga grupi i tretë i dokumenteve, pjesën më të madhe të së cilës e kishin marrë gazetarët gjatë konferencës së tretë për shtyp.<sup>830</sup> Gjithashtu, nuk ka asnjë provë që ndonjë gazetar të ketë marrë kopje të dokumenteve ose faqe të dokumenteve që i përmban paketa 3 në një mënyrë tjetër dhe jo si rezultat i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i shpërndarjes së këtij materiali nga të akuzuarit më

---

<sup>825</sup> P86, para. 35; P90, para. 8(iii), 9(iii); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 929.

<sup>826</sup> P86, para. 35; P90, para. 8(iii), 9(iii); W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 928-929.

<sup>827</sup> P106; P107; P108; P109; P110; P111; P112; P113; P114; P115; P116; P117; P118; P119.

<sup>828</sup> P106; P107; P108; P109; P110; P111; P114; P115; P116; P117; P118; P119. Këndi i sipërm i djathtë i P112 dhe P113 nuk duket plotësisht, por duken fjalët “përshkrimi i lidhjes me NKP-në dhjetor 2019”.

<sup>829</sup> *Shih, p.sh.*, W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1351-1376.

<sup>830</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2786 (ku z. Haradinaj deklaroi se përfaqësuesit e mediave “kanë marrë shumë” material). *Shih gjithashtu* 2D1, para. 110-112, 114; 1D3, para. 49-50.

22 shtator 2020. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se paketa 3 përmbante dy kopje të paplota që iu sekuestruan OVL-UÇK-së.<sup>831</sup> Sidoqoftë, këto shenja të ndryshme nuk ngrenë asnjë dyshim lidhur me vërtetësinë e materialit. Përmbajtja e të gjitha versioneve është identike dhe nuk ndikohet nga të tilla shenja si nënvizime të bëra me dorë dhe vrima kapësesh aktesh.

396. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses bindet se paketa 3 përmban kopje dokumentesh autentike të ZPS-së.

## 2. Deklaratat e të akuzuarve

397. Trupi Gjykses ka shqyrtuar deklaratat e asaj kohe dhe dëshmitë e të akuzuarve sa i takon autenticitetit të tri grupeve të dokumenteve për të konstatuar nëse dhe deri ku: (i) konfirmojnë provat lidhur me autenticitetin e paketave; dhe (ii) kanë qenë të vetëdijshëm të akuzuarit për autenticitetin e dokumenteve të cilat i shpërndanë apo i përshkruan publikisht.

### (a) Deklaratat e asokohshme të të akuzuarve

398. Sa i takon grupit të parë të dokumenteve, në konferencën e parë për shtyp, z. Gucati i përshkroi si “dikun afër 4000 dosje të Gjykatës Speciale”.<sup>832</sup> Në të njëjtin rast, në prani të z. Gucati, z. Haradinaj deklaroi se “na u duk se janë [të gjitha] të origjinalit”.<sup>833</sup>

399. Në një paraqitje në media më 7 shtator 2020 pas konferencës së parë për shtyp, z. Gucati vërente se “tash mund të ndodhë gjithçka, mund të ndodhë edhe që t’jenë t’falsifikum”, por ai shprehu mendimin e tij se në bazë të kontrolleve të tyre dhe të

---

<sup>831</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 926.

<sup>832</sup> P1, f. 1.

<sup>833</sup> P1, f. 4.

nënshkrimeve në dokumente ai mendonte se grupi i parë i dokumenteve ishte autentik.<sup>834</sup>

400. Më 9 shtator 2020, z. Haradinaj tha sa vijon për grupin e parë të dokumenteve:

Unë mendoj që duhet eksperti, ndoshta po ... mesa kemi pa, po. Mesa kem pa dhe sa ... brena aftësisë tonë shihet q'është tamam, e saktë janë tamam dokumente. Shihet edhe reagimi i atyre që m'tregun dje që janë konë e kanë murrë atë kopjen nga Tribunali. Kështu që po. Po, na besojmë që asht. Prandaj mbetet ta vërtetojë drejtësia, e kuptoni, s'japëm përgjegjësi për at punë.<sup>835</sup>

401. Në të njëjtin rast, z. Haradinaj më tej deklaroi se grupi i parë i dokumenteve "janë bash të Gjykatës Speciale dhe do t'bindesh ti [...]"<sup>836</sup> dhe se "ka ka dali, ju ka dalë, është materiali i tyre".<sup>837</sup> Më 11 shtator 2020, z. Haradinaj deklaroi: "për sa kemi pa na, është material taman, taman i rrjedhun prej njerëzve të tyre. Dhe në kuptimin e asaj që është i tyre. Është i Prokurorit".<sup>838</sup>

402. Sa i takon grupit të dytë të dokumenteve, më 16 shtator 2020, z. Haradinaj deklaroi se "Jemi tut por s'na e ka prurë kush me na mashtruar, [...] Po jo. Është materiali i tyre. Është nënshkrimi i tyre, është komunikimi i tyre".<sup>839</sup> Z. Haradinaj dha deklarata të ngjashme në ditët në vijim, duke bërë të ditur se dyshimet e tyre fillestare ishin sqaruar dhe se ishte e qartë që dokumentet i përkisnin DHS-së/ZPS-së.<sup>840</sup>

403. Të akuzuarit deklaruan gjithashtu në mënyrë të përsëritur se ZPS-ja konfirmoi se grupi i dytë i dokumenteve ishte i saj. Në veçanti, më 16 shtator 2020, pas sekuestrimit të dytë, z. Gucati, në prani të z. Tomë Gashi, deklaroi se grupi i dytë i

---

<sup>834</sup> P9, f. 4-5, 6.

<sup>835</sup> P24, f. 2.

<sup>836</sup> P24, f. 5.

<sup>837</sup> P24, f. 7.

<sup>838</sup> P21, f. 4. *Shih gjithashtu* P21, f. 5.

<sup>839</sup> P18, f. 7.

<sup>840</sup> P6, f. 3, 30; P34, f. 2; P19, f. 2; P7, f. 2-3; P17, f. 5.

dokumenteve i përkiste DHS-së sepse përndryshe “këta s’i kishin marrë”.<sup>841</sup> Z. Tomë Gashi konfirmoi mendimin e z. Gucati.<sup>842</sup>

404. Më 18 shtator 2020, gjatë një interviste në televizion, dhe në prani të z. Tomë Gashi, z. Haradinaj deklaroi se “u vërtetu saktësia dhe sensitiviteti i saj që u vërtetu edhe nga Prokuroria”,<sup>843</sup> duke vënë re se “e kanë pranuar”.<sup>844</sup> Z. Tomë Gashi e konfirmoi këtë mendim.<sup>845</sup>

405. Më 20 shtator 2020, pyetjes lidhur me prejardhjen e materialit, z. Haradinaj iu përgjigj se për të nuk kishte rëndësi nga kishte ardhur materiali por nëse ishte i vërtetë.<sup>846</sup> Ai deklaroi gjithashtu se “në momentin që i kanë verifikuar, thom jemi shumë të lumtur”.<sup>847</sup>

406. Sa i takon grupit të tretë të dokumenteve, në konferencën e tretë për shtyp, z. Gucati deklaroi se “na supozojmë edhe besojmë, se janë të dalura nga Gjykata Speciale e Kosovës”.<sup>848</sup> Z. Haradinaj shtoi se ishin “kopje të origjinalit” dhe se “e kanë emblemën e tyre”.<sup>849</sup> Ai shpjegoi se “ne dojmë me ua ruajt, veç me konfirmu saktësinë sikur e kanë konfirmu për ato të dyja. Që mos me mujt me spekuluar, jo janë, jo s’janë”.<sup>850</sup>

407. Po atë ditë, më 22 shtator 2020, pas sekuestrimit të tretë, z. Haradinaj deklaroi se “tri herë që e konfirmuam që është materiali i tyre dhe që rrjedhën prej Dhomave t’atyre”.<sup>851</sup> Në një tjetër intervistë po atë ditë, z. Gucati tha: “Prapë kanë ardhë Dhomat e Specializume të Gjykatës Speciale që janë këtu për me marrë materialin. Dhe, *de facto*,

---

<sup>841</sup> P4, f. 1, 4.

<sup>842</sup> P4, f. 4.

<sup>843</sup> P7, f. 2.

<sup>844</sup> P7, f. 11.

<sup>845</sup> P7, f. 3, 12. *Shih gjithashtu* P7, f. 10-11, 14. (z. Tomë Gashi).

<sup>846</sup> P8, f. 14. *Shih gjithashtu* P8, f. 13, 24-25.

<sup>847</sup> P8, f. 4.

<sup>848</sup> P35, f. 1.

<sup>849</sup> P35, f. 4.

<sup>850</sup> P35, f. 7.

<sup>851</sup> P30, f. 1, 9-10; P11, f. 23-24, 26-28, 38, 47, 59.

këta e pranojnë që materiali është i tyre [...] këta e pranojnë se materiali është direkt i Dhomave, apo i Gjykatës Speciale, që ka dalë prej tyre”.<sup>852</sup> Në të njëjtën intervistë, z. Gashi i bëri jehonë mendimit të dy të akuzuarve në praninë e tyre.<sup>853</sup>

408. Gjatë një tjetër paraqitjeje në media më vonë më 22 shtator 2020, z. Gucati deklaroi se dokumentet ishin “dokumente të kopjuara, -- janë të Gjykatës Speciale”.<sup>854</sup> Përsëri në një tjetër dalje në media po atë ditë, z. Gucati deklaroi se “të gjitha ato që kanë rrjedhë do të thotë, kanë rrjedhë prej zynës së tyre se ata vetë e pranojnë. Hetusit që kanë qenë që tri dit te na rresh te na që kanë qenë, e pranojnë që dokumentacioni është i tyre”.<sup>855</sup>

409. Më 24 shtator 2020, në lidhje me të tri grupet e dokumenteve, z. Gucati konfirmoi se “ai zotëria kur e kemi bërë dorëzim-pranimin të gjithë atyre dokumentacioneve që kanë qenë edhe herën e parë edhe të dytën edhe të tretën, do të thotë që është me pranim-dorëzim, me nënshkrimin e tyre [të Gjykatës] edhe pranon *de facto* vetë e nxjerr dokumentacionin që e ka pru prej Hage edhe thotë janë dokumentet tona”.<sup>856</sup> Z. Gucati gjithashtu bëri të ditur se dokumentet kishin stemat dhe nënshkrimet e prokurorëve ndërkombëtarë.<sup>857</sup>

410. Së fundi, dy të akuzuarit tërthorazi pranuan dijeninë e tyre për autenticitetin e tri grupeve të dokumenteve me anë të deklaratave të shumta që dhanë në lidhje me “rrjedhjet” prej ZPS-së dhe mosmbrojtjen e “sekreteve” të veta nga ZPS-ja.<sup>858</sup>

---

<sup>852</sup> P12, f. 1.

<sup>853</sup> P12, f. 2.

<sup>854</sup> P29, f. 1. *Shih gjithashtu* P31, f. 2 (z. Gucati).

<sup>855</sup> P28, f. 1. *Shih gjithashtu* P28, f. 7, 13.

<sup>856</sup> P31, f. 2-3.

<sup>857</sup> P31, f. 2.

<sup>858</sup> *Shih më lart* para. 218, 271, 280, 289 (Ngjarjet në fjalë).



(b) Dëshmitë e të akuzuarve

411. Trupi Gjykses vëren se, në deklaratat me shkrim të cilat i dorëzuan Trupit Gjykses si edhe gjatë dëshmimeve të tyre, të akuzuarit kundërshtuan pjesërisht deklaratat e tyre të periudhës së Aktakuzës lidhur me autenticitetin e dokumenteve.

i) Dëshmia e z. Gucati

412. Z. Gucati duket se e konfirmon në deklaratën që ka dhënë si dëshmitar se e konsideronte si autentik grupin e parë të dokumenteve. Ai bëri të ditur se “ishim duke shikuar dokumentat dhe konstatuam se dokumentat ishin nga DHSK-ja/ZPS-ja. Ne e kuptuam se ishin dokumente zyrtare por aty kishte dhe dokumente nga Serbia.”<sup>859</sup>

413. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, z. Gucati deklaroi se në lidhje me grupin e parë të dokumenteve “ne për fillim s’e kemi ditë se janë të Gjykatës Speciale,” dhe se “ne kemi thënë në media, këtu duhen verifikuar këto dokumentacione a janë të Gjykatës Speciale apo nuk janë.”<sup>860</sup> Kur u ballafaqua me deklaratën e tij si dëshmitar, z. Gucati pretendoi se “kjo ka qenë pas konferencës për shtyp dhe pasi mundëm të konstatojmë se ishin nga DHSK-ja”<sup>861</sup> Sa i takon grupit të parë të dokumenteve, z. Gucati më tej deklaroi se “s’kemi mujt të themi nëse dokumentet janë origjinale, apo janë kopje të njëri tjetrit”<sup>862</sup>

414. Sidoqoftë, nga fundi i dëshmisë së tij, z. Gucati deklaroi se “në bazë të stemës të Gjykatës dhe mbas emrave që i kemi parë, ne kemi besuar se këto dokumentacione mund të jenë të Gjykatës Speciale.”<sup>863</sup>

415. Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se dëshmia e z. Gucati konfirmon pjesërisht deklaratat e tij të periudhës së Aktakuzës se, në kohën e konferencës së parë për shtyp,

---

<sup>859</sup> 1D3, para. 14.

<sup>860</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2239.

<sup>861</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2241.

<sup>862</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2254.

<sup>863</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2416.

ai veptroi nisur nga supozimi se grupi i parë i dokumenteve ishte autentik. Trupi Gjykues arrin më tej në përfundimin se dëshmia e z. Gucati nuk bie ndesh me deklaratat e tij të periudhës së Aktakuzës lidhur me autenticitetin e grupit të dytë dhe të tretë të dokumenteve.

ii) Dëshmia e z. Haradinaj

416. Në deklaratën e tij si dëshmitar, z. Haradinaj bëri të ditur se nuk e dinte nëse tri grupet e dokumenteve ishin autentike.<sup>864</sup>

417. Gjatë marrjes në pyetje nga pala thirrëse, z. Haradinaj deklaroi se, në lidhje me grupin e parë të dokumenteve, “e kemi ditë që është diçka që i përket materialeve të ZPS-së apo dikush i ka pru në emër të tyre. Apo dikush u mundu të na qesë në lajthitje në emër të tyre.”.<sup>865</sup> Por ai gjithashtu pretendoi se “atë moment, ne nuk dinim, a janë autentike, a janë origjinale, a janë të montume”<sup>866</sup> dhe se “ne nuk e kemi llogaritur 100 për qind që është material tamam i tyre”.<sup>867</sup> Z. Haradinaj gjithashtu sugjeroi se gjatë sekuestrimit të dytë, punonjësi i pranishëm i ZPS-së bëri të ditur se ZPS-ja ishte duke verifikuar autenticitetin e grupit të parë të dokumenteve dhe se kur të përfundonin do ta informonin OVL-UÇK-në.<sup>868</sup>

418. Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, z. Haradinaj pretendoi se ende nuk ishte i qartë për autenticitetin e materialit.<sup>869</sup> Z. Haradinaj deklaroi se “konkretisht, as nga oficerët tuaj, nuk na është thënë se janë dokumentet juaja”.<sup>870</sup> Ai shtoi se “unë çdo herë kam dyshuar mund të mos jenë tuajat. Këtu është ajo esenca, dyshimet që ne i kishim”.<sup>871</sup>

---

<sup>864</sup> 2D1, para. 107, 133.

<sup>865</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2726.

<sup>866</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2726.

<sup>867</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727. *Shih gjithashtu f. 2734.*

<sup>868</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2764.

<sup>869</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2950.

<sup>870</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2950.

<sup>871</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2951.

Pyetjes nëse e dinte që dokumentet të cilat i kishin ardhur OVL-UÇK-së kishin të bënin me DHS-në, z. Haradinaj iu përgjigj “Isha i dyshimtë dhe më shumë ka “Jo”.”.<sup>872</sup> Z. Haradinaj la të kuptohej se arsyeja përse ai deklaroi në atë kohë se dokumentet ishin të vërteta ishte për të kundërshtuar një akuzë se “këto dokumente i kemi mbaruar ne, na i kanë mbaruar serbët dhe na i kanë prurë aty ose na i kanë prurë Hashim Thaçi, Fatmir Limaj, Ramush Haradinaj, ata na i kanë prurë ne aty. Na kanë quajtur vegla [të tyre]”.<sup>873</sup> I përballur me disa prej deklaratave të asokohshme të tij, z. Haradinaj ritheksoi “që kurrë s’e kanë komentuar, a janë a s’janë autentike”.<sup>874</sup> Z. Haradinaj gjithashtu pretendonte në lidhje me një të tjetër prej deklaratave të asokohshme të tij se ai luante me fjalë kur thoshte se dokumentet dolën se ishin të vërteta.<sup>875</sup>

419. Trupi Gjyqësor arrin në përfundimin se dëshmia e z. Haradinaj në gjyq bie konsiderueshëm ndesh me deklaratat e tij të asaj kohe të lidhur me dijeninë e tij se materiali i cili po bëhej publik ishte autentik dhe faktin se ai po vepronte mbështetur mbi këtë supozim. Trupi Gjyqësor gjithashtu vëren një mospërputhje midis dëshmisë së z. Haradinaj dhe qëndrimit të Mbrojtjes së tij. Konkretisht, Mbrojtja e Haradinajt argumentoi se z. Haradinaj duhet konsideruar si sinjalizues në kuptimin e propozuar nga znj. Myers.<sup>876</sup> Aktekspertiza dhe dëshmia e znj. Myers sugjeron se që të konsiderohet sinjalizues, personi duhet të ketë pasur “besim të arsyeshëm” në kohën e zbulimit të materialit se informacioni i zbuluar ishte i vërtetë dhe autentik.<sup>877</sup>

420. Trupi Gjyqësor e sheh dëshminë kundërthënëse të dhënë në gjykim nga z. Haradinaj si një orvatje për të ngritur dyshim lidhur me çfarë dinte mbi llojin e

<sup>872</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2953.

<sup>873</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2951.

<sup>874</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2956.

<sup>875</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2983-2984 (lidhur me deklaratën e z. Haradinaj në P17, f. 5).

<sup>876</sup> Transkripti, 21 janar 2022, f. 3096-3098. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 442-446, 464-477; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3689-3690.

<sup>877</sup> DW1252 (Ana Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3123-3124, 3126, 3131, 3137. *Shih gjithashtu* 2D6, para. 28(iii), 29, 38. *Shih gjithashtu* Transkripti, 21 janar 2022, f. 3096-3098 (përgjigjja e mbrojtësit të z. Haradinaj ndaj pyetjes së anëtarit të Trupit Gjyqësor).

materialit të cilin ai dhe z. Gucati po bënin publik. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e asokohshme të z. Haradinaj janë dëshmi e besueshme e besimit të tij për autenticitetin e dokumenteve.

(c) Përfundim

421. Trupi Gjykses bindet se, në lidhje me grupin e parë të dokumenteve dhe deri në sekuestrimin e parë, të dy të akuzuarit vepruan me besimin, jo sigurinë, se materiali ishte autentik, në kuptimin që kishte të bënte me hetime të TFHS-së/ZPS-së dhe/ose hetime serbe. Trupi Gjykses gjithashtu bindet se, pas sekuestrimit të parë, të dy të akuzuarit vepruan me bindjen se tri grupet e dokumenteve ishin autentike, në kuptimin që kishin të bënin me hetime të TFHS-së/ZPS-së dhe/ose hetime serbe, ose ishin kopje të dokumenteve kosovare ose të TPNJ-së. Rrjedhimisht, në çdo kohë gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit vepruan të vetëdijshëm se tri grupet e dokumenteve ishin autentike.

422. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se deklaratat e asokohshme të të akuzuarve si edhe pjesë të dëshmimeve të tyre lidhur me çfarë mendonin për autenticitetin e tri grupeve të dokumenteve konfirmojnë dëshminë e znj. Pumper dhe pjesët e shkëputura ose versionet e paketave të pranuar si prova.

### 3. Përfundim mbi autenticitetin e paketave

423. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se kategoritë e mëposhtme të dokumenteve që bënin pjesë në paketat janë autentike: (i) kërkesat e TFHS-së, përgjigjet e PSKL-së dhe dokumentet serbe që bënin pjesë në paketën 1; (ii) gjashtë faqet që bënin pjesë në paketën 2; dhe (iii) paketa 3. Duket se janë autentike edhe dokumentet gjyqsore të Kosovës dhe TPNJ-së që bënin pjesë në paketën 2, por Trupi Gjykses nuk do t'i marrë parasysh në lidhje me akuzat.

#### D. KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT TË PAKETAVE

424. Trupi Gjykses vëren se pyetja nëse informacioni të cilin përmbanin paketat ishte apo nuk ishte konfidencial përbën thelbin e Pikave 5 dhe 6. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do të trajtojë aspektet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin sipas kornizës ligjor të DHS-së, lidhjen midis konfidencialitetit dhe nenit 392 të KPK-së, autoritetit dhe përgjegjësisë së TFHS-së/ZPS-së lidhur me informacionin konfidencial dhe kundërshtimeve përkatëse të Mbrojtjes në diskutimin që bën për këto pika të Aktakuzës.

425. Për këtë pjesë, Trupi Gjykses: (i) do të verifikojë provat ku mbështetet pretendimi i ZPS-së lidhur me konfidencialitetin e paketave; dhe (ii) do të bëjë konstatim lidhur me dijeninë e të akuzuarve lidhur me këtë. Për këtë qëllim, Trupi Gjykses mbështetet në: (i) dëshminë e znj. Pumper, pjesë të shkëputura ose versione të paketave, pamje të fotografuara nga ekrani të pjesëve të shkëputura që kanë dalë nëpër artikuj të mediave dhe dëshmisë si ekspert të z. Rid; dhe (ii) deklaratat e të akuzuarve.

#### 1. Dëshmia e znj. Pumper dhe provat materiale në lidhje me të

426. Znj. Pumper dëshmoi se, si punonjëse e ZPS-së, ajo e konsideronte konfidencial klasifikimin e dokumentacionit të TFHS-së dhe ZPS-së në hetime penale. Ajo bëri gjithashtu të ditur se, me sa dinte, kërkesat për ndihmë me dokumentacion penal ishin pjesë e hetimeve dhe ishin gjithashtu konfidenciale.<sup>878</sup> Dëshmisë së znj. Pumper i bëri jehonë edhe z. Rid, i cili pranoi se, në praktikë, dokumentacioni i hetimeve të papërfunduara penale ishte konfidencial nëse ky klasifikim nuk shfuqizohej nga një autoritet kompetent.<sup>879</sup> Sipas tij, për shembull kjo përfshinte produktin e punës së

---

<sup>878</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, p 861.

<sup>879</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3277-3279, 3281-3283.

brendshme<sup>880</sup> dhe të gjithë informacionin që ka të bëjë me dëshmitarë.<sup>881</sup> Dëshmia e z. Rid në këtë pikë nuk u kundërshtua nga Mbrojtja.

(a) Paketat 1 dhe 4

427. Në lidhje me përmbajtjen e përgjithshme të paketës 1, znj. Pumper bëri të ditur se, si kërkesat e TFHS-së, ashtu edhe përgjigjet e PSKL-së, kishin të bënin me hetime dhe procedura penale konfidenciale të TFHS-së/ZPS-së,<sup>882</sup> dhe se trajtoheshin si konfidenciale nga TFHS-ja/ZPS-ja.<sup>883</sup> Znj. Pumper deklaroi gjithashtu se, në bazë të përmbajtjes, përfshirë autorësinë, datën e dokumentit dhe/ose objektin, duket se dokumentet serbe kishin të bënin me hetime konfidenciale. Ajo shpjegoi më tej se shtatëmbëdhjetë nga dokumentet serbe përmendnin shprehimisht konfidencialitetin.<sup>884</sup>

428. Në tabelën e paketës 1, znj. Pumper renditi ato që ajo i konsideronte si tregues të konfidencialitetit. Këtu përfshiheshin: (i) autori i dokumentit, konkretisht subjekte gjyqësore, hetimore dhe/ose prokuroriale; (ii) identiteti dhe funksioni i nënshkruesit të dokumentit; (iii) marrësi i synuar; (iv) tema ose pikat e trajtuara në dokument; (v) përmendja e hetimeve penale dhe e llojit të tyre konfidencial; (vi) shënime ose shkurtime të konfidencialitetit (të rreptë); (vii) emra, kode, nënshkrime dhe të dhëna të tjera dëshmitarësh dhe/ose dëshmitarësh të mundshëm, lista ose kalendarë takimi me dëshmitarë; (viii) numra të çështjeve; dhe (ix) stema, vula dhe shënime të tjera zyrtare të autoriteteve, në veçanti stema e TFHS-së.<sup>885</sup> Znj. Pumper bëri të qartë se këta

---

<sup>880</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3285-3287.

<sup>881</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3280, 3310-3312.

<sup>882</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 860-866; Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1055-1062; Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1471; P86, para. 7.

<sup>883</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1474.

<sup>884</sup> P88, para. 7.

<sup>885</sup> P90, Shtojca 1 – Tabela e paketës 1. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1058-1059; Transkripti, 18 tetor 2021, f. 872-876.

tregues i shihte në tërësi dhe jo veças.<sup>886</sup> Gjithashtu, znj. Pumper paraqiti pamje të fotografuara nga ekrani të shembujve të treguesve të tillë, disa prej të cilëve përmendnin shprehimisht konfidencialitetin.<sup>887</sup>

429. Trupi Gjykues gjithashtu bindet se pjesë të shkëputura nga paketa 1 të pranuar si prova mbështetin praninë e treguesve të konfidencialitetit të identifikuar nga znj. Pumper.<sup>888</sup> Gjithashtu, disa tregues konfidencialiteti të paketës përfshiheshin në pamje të fotografuara nga ekrani të dokumenteve të riparaqitura në artikuj të mediave pas konferencës së parë për shtyp.<sup>889</sup>

430. Lidhur me përmbajtjen e përgjithshme të paketës 4, znj. Pumper renditi në tabelën e paketës 4 të njëjtat kategori të treguesve të konfidencialitetit me ata që identifikohen në paragrafin 428.<sup>890</sup> Znj. Pumper paraqiti gjithashtu pamje të fotografuara nga ekrani të shembujve të treguesve të tillë, disa prej të cilëve përmendnin shprehimisht konfidencialitetin.<sup>891</sup> Prania dhe dukshmëria e këtyre treguesve u konfirmua edhe nga z. Berisha, i cili i vuri re shënimet konfidenciale në dokumentet gjatë një këqyrjeje që zgjati afërsisht 30-45 minuta.<sup>892</sup> Megjithëse ai dhe kolegët e tij nuk i konsideruan konfidenciale stemën e TFHS-së apo emrat e zyrtarëve serbë, ata i redaktuan emrat e dëshmitarëve dhe të dhënat e tyre personale, si edhe numrat e titujt e çështjeve.<sup>893</sup>

---

<sup>886</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 26 tetor 2021, p 1473.

<sup>887</sup> P90, Shtojca 2.

<sup>888</sup> P93; P94; P95; P96; P97.

<sup>889</sup> *Krahaso*: (i) P90, Shtojca 2(a) me P125, f. 2, 5-7 dhe P124, f. 1-2, 4-5; (ii) Shtojca 2(b) me P125, f. 2, dhe P124, f. 4-5.

<sup>890</sup> P89, para. 8-13; P91, para. 4, Shtojca 1 – Tabela e paketës 4; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 893-895.

<sup>891</sup> P91, Shtojca 2.

<sup>892</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1523-1524.

<sup>893</sup> W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 27 tetor 2021, f. 1602, 1607, 1613-1614, 1626-1627-1628. *Shih gjithashtu* P125, P129, 1D2.

431. Lidhur me dëshmitarët emrat e të cilëve ishin në paketën 1, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë në paragrafin 345 se: (i) shtojcat konfidenciale të kërkesave të TFHS-së rendisnin me qindra emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm; dhe (ii) edhe dokumentet serbe përmbanin emrat e dhjetëra dëshmitarëve, përfshirë edhe të atyre të intervistuar nga TFHS-ja/ZPS-ja. Lidhur me emrat e lartpërmendur, znj. Pumper bëri të ditur se nuk ishin nxjerrë në publik në kuadër të procedurave të TFHS-së/ZPS-së.<sup>894</sup>

432. Lidhur me dëshmitarët emrat e të cilëve ishin në paketën 4, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë në paragrafin 346 se kërkesat shtesë të TFHS-së dhe dokumentet serbe përmbanin emrat e dhjetëra dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së/ZPS-së. Lidhur me këta emra, znj. Pumper bëri të ditur se ata nuk ishin identifikuar kurrë në publik nga TFHS-ja/ZPS-ja.<sup>895</sup>

(b) Paketa 2

433. Lidhur me përmbajtjen e përgjithshme të gjashtë faqeve, znj. Pumper renditi në tabelën e paketës 2 ato që ajo i konsideronte si tregues konfidencialiteti, përkatësisht: (i) numrat e çështjeve; (ii) stema të subjekteve përkatëse, konkretisht të TFHS-së; (iii) prania e emrave ose listave të dëshmitarëve; (iv) emri dhe funksioni i nënshkruesit dhe i personit ose subjektit të cilit i drejtohej; (v) përmendja shprehimisht e konfidencialitetit të hetimeve ose të materialit përkatës; dhe (vi) vula dhe shënime të tjera zyrtare.<sup>896</sup> Znj. Pumper paraqiti edhe pamje të fotografuara nga ekrani të shembujve të treguesve të tillë, disa prej të cilëve përmendnin shprehimisht konfidencialitetin.<sup>897</sup>

---

<sup>894</sup> P86, para. 9, 12.

<sup>895</sup> P89, para. 11.

<sup>896</sup> P90, Shtojca 3 – Tabela e paketës 2.

<sup>897</sup> P90, Shtojca 4.



434. Sa i takon pjesës tjetër të paketës 2, ZPS-ja nuk pretendoi se përmbante dokumente konfidenciale.<sup>898</sup>

435. Lidhur me dëshmitarët emrat e të cilëve përmendeshin në gjashtë faqet, Trupi Gjykyes ka konstatuar tashmë në paragrafin 350 se atje përfshiheshin emrat dhe të dhëna të tjera personale të së paku dy dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Trupi Gjykyes rikujton se gjashtë faqet janë të përfshira edhe në paketën 1.<sup>899</sup> Rrjedhimisht, informacioni përkatës i znj. Pumper se dëshmitarët e përmendur me emër në paketën 1 nuk ishin identifikuar kurrë në publik nga TFHS-ja/ZPS-ja vlen edhe për emrat në gjashtë faqet.<sup>900</sup>

(c) Paketa 3

436. Trupi Gjykyes ka konstatuar në paragrafët 393-394 se paketa 3 përmbante stema të ZPS-së dhe shënimet “KONFIDENCIALE” dhe/ose “Produkt i punës së brendshme”. Znj. Pumper paraqiti gjithashtu pamje të fotografuara nga ekrani të stemës dhe të shënimeve.<sup>901</sup>

437. Trupi Gjykyes gjithashtu bindet se pjesët e shkëputura nga paketa 3 të pranuar si prova konfirmojnë praninë e treguesve të konfidencialitetit të identifikuar nga znj. Pumper.<sup>902</sup> Gjithashtu, versione të plota dhe të pjesshme të këtyre treguesve përfshiheshin në pamje të fotografuara nga ekrani të dokumenteve të riparqitura në artikuj të mediave pas konferencës së tretë për shtyp.<sup>903</sup>

---

<sup>898</sup> P104, f. 496-523, 835-930. *Shih gjithashtu* P2, f. 4-5; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3519-3520.

<sup>899</sup> P86, para. 22.

<sup>900</sup> P86, para. 9, 12, 22.

<sup>901</sup> P90, para. 10, Shtojca 5.

<sup>902</sup> P106; P107; P108; P109; P110; P111; P112; P113; P114; P115; P116; P117; P118; P119.

<sup>903</sup> *Krahaso*: (i) P90, Shtojca 5(a) me P120, f. 2-5; P121, f. 2-3, 5-6; P122, f. 2-3, 5-6; P155, f. 4, 6-11; P157, f. 5-10; P159, f. 1, 3-8; (ii) P90, Shtojca 5(b)(2) me P121, f. 2-3, 5-6; P122, f. 2-3, 5-6; P155, f. 4-11; dhe (iii) P90, Shtojca 5(c) me P120, f. 2-5; P121, f. 2-3, 5-6; P122, f. 2-3, 5-6; P157, f. 5-10; P159, f. 1, 3-8.

438. Gjithashtu, Trupi Gjykues ka konstatuar në paragrafin 355 se në paketën 3 përmendeshin afërsisht 150 dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm. Në këtë aspekt, znj. Pumper bëri të ditur se, më 22 shtator 2020, emrat e dëshmitarëve, dëshmitarëve të mundshëm, individëve të tjerë dhe informacione dhe prova që kishin lidhje, të përfshira në paketën 3, nuk ishin nxjerrë në publik në kuadër të hetimeve të TFHS-së/ZPS-së apo procedurave të DHS-së.<sup>904</sup> Ajo deklaroi gjithashtu se dëshmitarët emrat e të cilëve ishin në paketën 3 ishin objekt i: (i) urdhrave të një paneli të DHS-së ose kërkesave të ZPS-së për mosnxjerrje;<sup>905</sup> (ii) masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata kosovare;<sup>906</sup> dhe (iii) konfidencialitetit dhe kufizimeve mbi përdorimin të vendosura nga organizatat ndërkombëtare të cilat ia kishin dhënë informacionin ZPS-së me këto kushte.<sup>907</sup>

## 2. Deklaratat e të akuzuarve

439. Trupi Gjykues ka shqyrtuar deklaratat e asokohshme dhe dëshmitë e të akuzuarve në lidhje me konfidencialitetin e informacionit që përmbanin tri grupet e dokumenteve për të konstatuar nëse dhe deri ku: (i) këto konfirmonin provat lidhur me konfidencialitetin e paketave; dhe (ii) të akuzuarit ishin të vetëdijshëm për konfidencialitetin e informacionit që shpërndanë dhe përshkruan publikisht.

---

<sup>904</sup> P86, para. 30.

<sup>905</sup> P86, para. 32; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 954-960 ku i referohet P151, P152 dhe P154.

<sup>906</sup> P86, para. 33; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 961-966, 1007-1008, 1329-1333 ku i referohet, ndër të tjera, P161.

<sup>907</sup> P86, para. 34; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 967-971 ku i referohet P126.

(a) Deklaratat e asaj kohe

i) Urdhri i Parë dhe Urdhri i Dytë

440. Trupi Gjykses vëren se Urdhri i Parë dhe Urdhri i Dytë bënin të ditur se grupet përkatëse të dokumenteve përmbanin informacion të ndjeshëm.<sup>908</sup> Po këta urdhra dhe Urdhri i ZPS-së i kërkonin z. Gucati, OVL-UÇK-së dhe cilindo individ tjetër që posedonte dokumentet dhe/ose përmbajtjen e tyre të mos kopjonin në asnjë lloj mënyre dhe të mos shpërndanin me asnjë mjet komunikimi dokumentet dhe përmbajtjen e tyre.<sup>909</sup>

441. Këta urdhra do t'ua kenë bërë të ditur të akuzuarve se posedonin material të cilin nuk u lejohej ta kishin apo t'ua shpërndanin të tjerëve.<sup>910</sup>

ii) Dokumentet ishin "sekrete", "të ndjeshme" ose "konfidenciale"

442. Dy të akuzuarit dhanë disa deklarata lidhur me llojin "sekret", "konfidencial" ose "të ndjeshëm" të tri grupeve të dokumenteve.

443. Lidhur me grupin e parë të dokumenteve, z. Haradinaj, në praninë e z. Gucati në konferencën e parë për shtyp, përshkroi se grupi i dokumenteve përmbante "të dhëna sekrete",<sup>911</sup> "konfidenciale dhe top sekrete"<sup>912</sup> dhe "shumë, shumë top sekret".<sup>913</sup> Z. Haradinaj gjithashtu deklaroi se zyrtari i ZPS-së i cili sekuestroi grupin e parë të dokumenteve konfirmoi se ishte "sensitiv".<sup>914</sup> Z. Gucati më vonë e përshkroi grupin e

---

<sup>908</sup> P52, para. 21; P53, para. 21.

<sup>909</sup> P52, para. 22(c); P53, para. 22(c); P54, f. 1. *Shih më poshtë* para. 896 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>910</sup> P4, f. 8 (z. Gucati); P17, f. 6 (z. Haradinaj); P83. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288-2293; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2927-2936.

<sup>911</sup> P1, f. 2.

<sup>912</sup> P1, f. 3.

<sup>913</sup> P1, f. 5.

<sup>914</sup> P7, f. 3.

parë të dokumenteve si “dosje konfidenciale”<sup>915</sup> dhe “dokumente tepër sekrete dhe shumë të ndjeshme”.<sup>916</sup>

444. Lidhur me grupin e dytë të dokumenteve, duket se z. Gucati i ka konsideruar konfidenciale.<sup>917</sup> Po kështu, z. Haradinaj, në konferencën e dytë për shtyp, në praninë e z. Gucati, deklaroi se “ka sekrete” në dokumente.<sup>918</sup> Ai vuri re edhe vendndodhje në lidhje me të cilat ishin bërë kërkesa për bashkëpunim dhe pa shënime “top sekret”.<sup>919</sup> Në një paraqitje në media pas sekuestrimit të dytë, z. Haradinaj pretendoi se ZPS-ja “e pranoi, tha është prej neve, tha është material sensitiv”.<sup>920</sup> Z. Haradinaj shprehu gjithashtu mendimin: “Për kë sensitive janë? Janë për Gjykatën e Hagës që bashkëpunon me Serbinë sensitive. Për mu s’janë”.<sup>921</sup> Në një paraqitje tjetër në media, z. Haradinaj gjithashtu deklaroi se zyrtari i ZPS-së i cili sekuestroi grupin e dytë të dokumenteve bëri të ditur se kishte ardhur në selinë e OVL-UÇK-së sepse “është do material sensitiv”.<sup>922</sup>

445. Lidhur me grupin e tretë të dokumenteve, gjatë konferencës së tretë për shtyp, pasi z. Gucati përshkroi se përmbanin “emra të ndryshëm që ne s’jemi të autorizum t’i përmendim këto emna”,<sup>923</sup> z. Haradinaj u zotua se “asnjë send ne s’kemi majt msheft”.<sup>924</sup> Në një aktivitet të mëpasshëm, z. Haradinaj deklaroi se grupi i tretë i dokumenteve kishte të bënte me një “[çështje] shumë sensitive”.<sup>925</sup> Pak pas

---

<sup>915</sup> P59, f. 1 (Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* i datës 21 shtator 2020, ku me sa duket bëhet fjalë për grupin e parë të dokumenteve dhe/ose grupin e dytë të dokumenteve).

<sup>916</sup> P59, f. 3 (Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* i datës 21 shtator 2020, ku me sa duket bëhet fjalë për grupin e parë të dokumenteve).

<sup>917</sup> P59, f. 1.

<sup>918</sup> P2, f. 3. *Shih gjithashtu* P19, f. 2 (z. Haradinaj: “ku a shkrun “Top Sekret”).

<sup>919</sup> P2, f. 3.

<sup>920</sup> P6, f. 30. *Shih gjithashtu* P17, f. 4.

<sup>921</sup> P6, f. 20.

<sup>922</sup> P7, f. 3. *Shih gjithashtu* P17, f. 6.

<sup>923</sup> P35, f. 1.

<sup>924</sup> P35, f. 3.

<sup>925</sup> P30, f. 9.

sekuestrimit të tretë, z. Tomë Gashi, në prani të dy të akuzuarve, shprehu mendimin se materiali “duket që është material me ndjeshmëri të lartë”.<sup>926</sup>

iii) Dokumentet përmbanin emra të dëshmitarëve të mbrojtur

446. Të akuzuarit dhanë gjithashtu deklaratat lidhur me statusin si të mbrojtur të dëshmitarëve emrat e të cilëve ishin në tri grupet e dokumenteve.

447. Gjatë konferencës së parë për shtyp, në prani të z. Gucati, z. Haradinaj i informoi të pranishmit se “këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë i kemi në mbrojtje. Të gjithëve”.<sup>927</sup> Në një paraqitje në media pak pas konferencës së parë për shtyp, z. Gucati pretendoi se ai nuk do t’i nxirrte emrat e dëshmitarëve sepse nuk i njihnte këta individë.<sup>928</sup> Në konferencën e dytë për shtyp, dy të akuzuarit ritheksuan se nuk do të përmendnin asnjë emër dëshmitari, me sa duket pasi ishin këshilluar nga avokati se “asgjë prej emnash që s’i përmendim, nuk është e dënume”.<sup>929</sup> Deklaratat e mëposhme të akuzuarve lidhur me mospërmendjen e emrave duket se vinin nga të kuptuarit se kjo ishte e ndaluar. Në një paraqitje në media pak pas konferencës së dytë për shtyp, z. Haradinaj ritheksoi se “në dosjen e parë kanë pasur [shumë] emra ashtu....Nuk merrem me ta, as nuk i përflasim ne këta”.<sup>930</sup> Më 17 shtator 2020, në një paraqitje në media pas sekuestrimit të dytë, z. Haradinaj ritheksoi se “i kemi ruajt” emrat, sepse “ne s’i kemi publiku”.<sup>931</sup> Gjatë konferencës së tretë për shtyp, në prani të z. Haradinaj, z. Gucati tha në lidhje me grupin e tretë të dokumenteve se përmbante emra të cilat ai nuk ishte i autorizuar t’i nxirrte.<sup>932</sup> Më 22 shtator 2020, në një paraqitje në media pas sekuestrimit të tretë, z. Gucati deklaroi se OVL-UÇK-ja nuk kishte bërë

---

<sup>926</sup> P12, f. 2-3.

<sup>927</sup> P1, f. 2.

<sup>928</sup> P9, f. 6-7.

<sup>929</sup> P2, f. 7.

<sup>930</sup> P18, f. 3. *Shih gjithashtu* P8, f. 11.

<sup>931</sup> P6, f. 40.

<sup>932</sup> P35, f. 1, 13. *Shih gjithashtu* P29, f. 1.

asnjë të paligjshme sepse kishte mbrojtur “çdo emën apo çdo dokument që ka qenë”<sup>933</sup> dhe nuk shpalli apo nuk bëri publik emra dëshmitarësh.<sup>934</sup>

448. Deklaratat e bëra nga z. Tomë Gashi, avokati i OVL-UÇK-së, në prani të një ose dy të akuzuarve e konfirmojnë më tej se ata ishin të vetëdijshëm se tri grupet e dokumenteve përmbanin emra dëshmitarësh të mbrojtur. Në veçanti, më 18 shtator 2020, në një paraqitje në media me z. Haradinaj, z. Tomë Gashi deklaroi se ata “që i kanë marrë dosjet” u bëhej e ditur “që në asnjë mënyrë mos të bëjnë publik identitetin e dëshmitarëve pa marrë parasysh do të thotë a janë dëshmitarë të rëndomtë, të fshehur apo anonimë sepse kjo është në kundërshtim me ligjin”.<sup>935</sup>

(b) Dëshmitë e të akuzuarve

449. Gjatë dëshmive të tyre, të akuzuarit konfirmuan disa prej deklaratave të asokohshme të tyre lidhur me konfidencialitetin e materialit, ndërkohë që minimizuan disa të tjera.

450. Në dëshminë e dhënë gojarisht, z. Gucati pranoi se grupi i parë i dokumenteve përmbante material të ndjeshëm.<sup>936</sup> Ai deklaroi se nuk kishte parë kurrë asnjë prej këtyre dokumenteve të bëra publike më parë.<sup>937</sup> Lidhur me grupin e dytë të dokumenteve, ai deklaroi se megjithëse pa “disa dokumente me shenja serbe, [...] veç ishin publike. [...] Kjo ka qenë publike dhe seancat kanë qenë edhe publike dokumentacioni i tijna kështu që [...] s'ka qenë kurrë gjë sekrete.”.<sup>938</sup> Megjithatë, më vonë ai deklaroi se nuk e dinte “deri vonë” se “dokumentet e TFHS-së dhe ZPS-së në

---

<sup>933</sup> P28, f. 1.

<sup>934</sup> P28, f. 2, 11.

<sup>935</sup> P7, f. 4. *Shih gjithashtu* P12, f. 3.

<sup>936</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2418, 2420-2421.

<sup>937</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288.

<sup>938</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2278.

paketën e parë dhe të dytë” ishin konfidenciale.<sup>939</sup> Z. Gucati gjithashtu pretendoi se e kuptoi që dokumentet ishin konfidenciale pasi “kanë ardhur hetuesit e juaj”.<sup>940</sup>

451. Gjatë gjykimit, z. Gucati pretendoi se gjatë të tri konferencave për shtyp, ai mbajti parasysh privatësinë e personave, të mbrojtur në Kosovë,<sup>941</sup> dhe se, bazuar në këtë, nuk u nxorën emra të dëshmitarëve.<sup>942</sup> Z. Gucati gjithashtu vërejti se OVL-UÇK-ja ndaloi së publikuari emrat dhe deklaratat me ta kuptuar se ishin të ndjeshme dhe se përmendja e tyre ishte e ndaluar.<sup>943</sup> Z. Gucati gjithashtu bëri të ditur se ai i këshilloi gazetarët të mos nxirrnin emra sepse e kuptonte se duheshin respektuar të drejtat për privatësi të dëshmitarëve dhe se nxjerrja e emrave të tyre ndalohej me ligj.<sup>944</sup>

452. Trupi Gjykses konstaton se pjesë të dëshmisë së z. Gucati konfirmojnë deklaratat e asokohshme të tij se ai kuptoi se emrat e dëshmitarëve nuk duheshin nxjerrë. Trupi Gjykses konstaton se pjesë të tjera pasqyrojnë orvatje të z. Gucati për të hedhur dyshime sa i takon asaj që dinte për llojin e materialit.

<sup>939</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2285.

<sup>940</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2287.

<sup>941</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2264.

<sup>942</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, p. 2308.

<sup>943</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2420-2421. *Shih gjithashtu* Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2207 (z. Gucati: “nëse një dëshmitar e ndjen veten që [unë ose] Haradinaj kanë nxjerrë një emër dhe një mbiemër të një dëshmitari shqiptar apo një dëshmitari rom, apo një turk apo një boshnjak që jetojnë në Kosovë, i bëj ftesë të lajmërohet në Gjykatën Speciale. Unë jam i hapur të ballafaqojna me atë”); Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2308 (z. Gucati: “Ne s’kemi nxjerrë asnjë emër publikisht. Asnjë deklaratë. Më tregoni në cilin medium ka dalë një emër i një dëshmitari që kemi nxjerrë apo një deklaratë e një dëshmitari që ka jep te ju. Apo unë që e kam përmend një dëshmitar X apo Y”), 2308-2309 (z. Gucati: “Unë s’kam nxjerrë emër asnjë dëshmitari. As [...] kryesia, as unë s’kemi nxjerrë një emër të një dëshmitari për ta dëmtuar. Asnjë [emër] s’kemi qit në media. [...] Në momentin që thamë është e ndalume dhe momentin që kam thënë gjithmonë nëpër çdo konferencë që është e ndalume nxjerrja e emrave, le të kuptoj fjala vet, kupton që është e ndalume të publikohet emri i ndonjë dëshmitari të mbrojtur. {...} edhe s’e kam bë këtë asnjëherë”); Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2417 (z. Gucati: “pikërisht se e dishim ne që ka emra aty, ne nuk kemi publikuar emra dhe dëshmi. Kjo është shumë e vërtetë. Kjo ka qenë arsyeja pse ne s’kemi dërguar asnjë emër dhe asnjë dëshmi. Vetëm e vetëm që të ruhet identiteti i tyre dhe pavarësia e tyre”).

<sup>944</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2175; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2308.

453. Gjatë dëshmisë së tij, z. Haradinaj pretendoi se hetuesi i ZPS-së nuk ishte në gjendje t'i thoshte nëse grupi i parë i dokumenteve ishte konfidencial.<sup>945</sup> Megjithëse z. Haradinaj konfirmoi se hetuesi i ZPS-së që sekuestroi grupin e dytë të dokumenteve i tha se materialet “mund të jenë të ndjeshme”, ai theksoi se “kurrë s’na ka dhënë përgjigje që ekzakt, a ishin me të vërtetë ato të ndjeshme apo jo”.<sup>946</sup> Më përgjithësisht, lidhur me tri grupet e dokumenteve, z. Haradinaj deklaroi se hetuesit e ZPS-së nuk e informuan asnjëherë se ishin të ndjeshme<sup>947</sup> dhe “s’na është [thënë] kurrë që është material sekret”.<sup>948</sup> Ai gjithashtu pretendoi se nuk e dinte “as kush ka qenë publike, a s’ka qenë publike”<sup>949</sup> dhe nëse dokumentet e ZPS-së të cilat ai dhe z. Gucati i shpërndanë dhe përshkruan ishin konfidenciale.<sup>950</sup> Z. Haradinaj gjithashtu deklaroi se shënimet “top sekret” në dokumente nuk do të thoshin medoemos se ishin sekret, sepse “sekretet nuk dalin e nuk vijnë në zyrat tona”.<sup>951</sup> Megjithatë, z. Haradinaj gjithashtu ritheksoi se “ne s’kemi dashur të mbajmë [asgjë] të fshehtë”.<sup>952</sup> Një pyetjeje se si e kuptonte autenticitetin e dokumenteve, z. Haradinaj iu përgjigj, mes të tjerash, se “s’e ka kuptimin e rëndësisë, a janë top sekret, a s’janë top sekret”.<sup>953</sup>

454. Gjatë dëshmisë së tij Z. Haradinaj gjithashtu pretendoi se emrat e dëshmitarëve as u përmendën, as u publikuan sepse ai pajtohej me mendimin se emrat mund të keqpërdreshin nëse do të përmendeshin.<sup>954</sup> Z. Haradinaj deklaroi se ai i këshilloi

---

<sup>945</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2765.

<sup>946</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2936.

<sup>947</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2773.

<sup>948</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2956.

<sup>949</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2941.

<sup>950</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2825.

<sup>951</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2941-2942. *Shih gjithashtu* DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2945, 2963.

<sup>952</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2948.

<sup>953</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2952.

<sup>954</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2852 (Përfaqësuesi i ZPS-së: “Pra ju e dinit që dokumentet me emrat e dëshmitarëve mund të keqpërdreshin, a është kështu?” [...] z. Haradinaj: “Po mund të keqpërdreshin po t’i kishim citu na, po t’i kishim [shitur] na ose po t’i kishim publiku, ndoshta edhe mund të keqpërdreshin, ndoshta. Pajtohem me këtë. Prandaj ne nuk i kemi thonë, as



gazetarët të mos publikonin asnjë emër dëshmitarësh sepse kishte dëgjuar “gjatë paneleve, nga ekspertë të ndryshëm, qoftë të jurisprudencës, qoftë të lamisë të shoqërisë civile, qoftë avokatë” se “nuk është kurrfarë thyerje e ligjit nëse nuk përmenden emrat”.<sup>955</sup> Bazuar në këtë, z. Haradinaj dëshmoi se “krijam bindje që nuk bëjmë kurrfarë thyerje të ligjit, por edhe iu lutëm atyre që të [ndjekin të njëjtën logjikë]”.<sup>956</sup> Megjithatë, z. Haradinaj më vonë e modifikoi përgjigjen e tij duke thënë se vetë personalisht nuk mendonte se nxjerrja e emrave të dëshmitarëve mund t’i dëmtonte.<sup>957</sup> Ai gjithashtu pretendoi se nuk nxori emra dëshmitarësh, sepse nuk i dinte.<sup>958</sup> Sidoqoftë, më vonë, ai dëshmoi se kishte parë emrat e dëshmitarëve në material dhe se e dinte se ishin nën mbrojtje.<sup>959</sup> Gjithashtu, u duk se z. Haradinaj u distanca pjesërisht nga mendimi i shprehur nga z. Tomë Gashi lidhur me nxjerrjen e emrave të dëshmitarëve. Megjithatë z. Haradinaj e identifikoi z. Tomë Gashi si “avokat i yni”, ai tha se “qe ashtu një opinion i tij ma shumë i juristit dhe i moderatores”.<sup>960</sup> Z. Haradinaj shtoi se megjithatë OVL-UÇK-ja i merrte mendimet e z.

---

nuk i kemi citu këta emna. Duke dëgjuar këtë opinion sepse dhe ky opinion kështu i thonun është opinion që kam dëgjuar prej paneleve. [...] kështu që unë pajtohena plotësisht me atë mendim derisa kanë thonë njerëzit që janë profesionalë të asaj lëmie. Pajtohem edhe sot”).

<sup>955</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2759. *Shih gjithashtu* Transkripti, 12 janar 2022, f. 2831 (Përfaqësuesi i ZPS-së: “[Dhe] është e gabuar të nxirren emrat e dëshmitarëve sepse kjo mund t’i dëmtojë ata. A është kështu?” z. Haradinaj: “Kjo është referim i një thënieje që na u ka thënë prej juristëve, panelistëve dhe shoqatat civile [...] dhe e kam e ripërsërit të tyren. [...] S’është mendim i imi personal, është mendim i një opinionit i cili flitej në televizion, të cilit unë i jam referuar.”).

<sup>956</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2759.

<sup>957</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2830 (z. Haradinaj: “Ju kam referue thëniet dhe mediave të tjera që i thonin këto thënie. Nuk janë thënie të miat, as shqetësimi s’ka qenë shqetësim vetëm i imi, shqetësim të cilin e mbjellën tek të gjithë ne, mediat dhe opinionet [publike të shprehura asokohe]”. Përfaqësuesi i ZPS-së: “Dhe ky opinion publik që përmendët, nxjerrja e emrave të dëshmitarëve të mbrojtur mund të shkaktonte vdekjen e tyre sepse njerëz të tjerë mund t’i dëmtonin ata, t’i lëndonin ata, kështu e kuptuat?” z. Haradinaj: “Jo as e kam kuptuar kështu, as nuk shoh arsye që dëshmitarët të lëndohen”).

<sup>958</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2830-2831.

<sup>959</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2962-2964.

<sup>960</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2850.

Tomë Gashi “të mirëqena”,<sup>961</sup> personalisht ai mendonte se nuk kishte asnjë arsye që dikush t’u bënte shantazh dëshmitarëve.<sup>962</sup>

455. Trupi Gjykses i konsideron pjesë të dëshmisë së z. Haradinaj si një orvatje për të hedhur dyshime lidhur me atë se çfarë dinte për llojin e materialit që ai dhe z. Gucati zbuluan.

### (c) Përfundim

456. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses bindet se të akuzuarit shpërndanë tri grupet e dokumenteve dhe publikisht përshkruan informacionin që ndodhej në to me dijeninë se përfshinte informacion konfidencial dhe emrat e dëshmitarëve të mbrojtur. Konstatime të mëtejshme lidhur me bindjen e të akuzuarve se veprimet e tyre ishin të ligjshme do të bëhen në lidhje me argumentet mbrojtëse të paraqitura.<sup>963</sup>

457. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se deklaratat e asokohshme të të akuzuarve si edhe pjesë të dëshmimeve të tyre lidhur me konfidencialitetin e informacionit që përmbanin tri grupet e dokumenteve konfirmojnë provat që vijnë nga znj. Pumper, z. Berisha, versione ose pjesë të shkëputura nga paketat të pranuar si prova dhe artikujt në media lidhur me konfidencialitetin e informacionit që përmbanin paketat.

### **3. Përfundim mbi konfidencialitetin e informacionit që përmbanin paketat**

458. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses bindet se TFHS-ja/ZPS-ja, në ushtrim të funksioneve të veta, i trajtoi si konfidenciale kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së që bënin pjesë në paketat 1, 2 dhe 4 si edhe produktin e punës së brendshme që përkon me paketën 3. Trupi Gjykses gjithashtu bindet se TFHS-ja/ZPS-ja e trajtoi si konfidenciale përmbajtjen e këtyre kategorive dokumentesh, përfshirë emrat, të dhënat dhe deklaratat e dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Trupi Gjykses

---

<sup>961</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2850.

<sup>962</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2850-2851.

<sup>963</sup> *Shih më poshtë* para. 896-907 (Argumentet mbrojtëse).

gjithashtu vëren se TFHS-ja/ZPS-ja mendonte se dokumentet serbe dhe përmbajtja e tyre kishin të bënin me hetime konfidenciale, ndonëse jo domosdoshmërisht në lidhje me TFHS-në/ZPS-në.

## VI. PIKAT E AKTAKUZËS

459. Trupi Gjykses vëren se i njëjti grup faktesh dhe rrethanash është relevant për disa pika të Aktakuzës. Duke pasur parasysh përgjegjësinë e vet sipas rregullës 158(2) të Rregullores, Trupi Gjykses do ta trajtojë secilën akuzë veç e veç, por do t'u referohet, kur është e përshtatshme, fakteve dhe rrethanave të diskutuara për akuza të tjera. Trupi Gjykses do të vlerësojë më poshtë provat që janë relevante për çdo pikë dhe parashtrimet përkatëse të palëve. Meqenëse shpërndarja e tri grupeve të dokumenteve dhe përshkrimi i informacionit që përmbajnë ato është pikënisja për të gjitha akuzat, Trupi Gjykses do të trajtojë së pari Pikat 5 dhe 6. Më tej, meqenëse kërcënimi i rëndë që buron nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve ka të bëjë me dëshmitarë, Trupi Gjykses do të trajtojë Pikat 3 dhe 4 dhe, në fund, Pikat 1 dhe 2. Argumentet e palëve lidhur me interpretimin juridik të elementeve të veprave penale në Aktakuzë dhe format e përgjegjësisë janë trajtuar në pjesën "Dispozitat ligjore përkatëse" të këtij Aktgjykimi.<sup>964</sup>

460. Trupi Gjykses e zbaton kriterin e fajësisë së shumëfishtë siç është përkufizuar në paragrafin 167.

---

<sup>964</sup> *Shih më lart* para. 68-203 (Dispozitat ligjore përkatëse).

## A. SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS – INFORMACIONI I MBROJTUR (PIKA 5)

### 1. Parashtrimet e palëve

461. ZPS-ja pretendoi se, gjatë periudhës që përfshin Aktakuza, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre,<sup>965</sup> zbuluan informacion konfidencial pa autorizim.<sup>966</sup>

462. Sipas ZPS-së, të akuzuarit e bënë këtë, midis tjerash, duke u shpërndarë pjesë të tri grupeve të dokumenteve pjesëmarrësve në tri konferencat për shtyp dhe duke përmendur publikisht informacionin konfidencial që përmbanin gjatë paraqitjeve publike ose në rrjete sociale.<sup>967</sup> ZPS-ja pretendoi se të akuzuarit gjithashtu nxitën, udhëzuan dhe këshilluan: (i) disa persona nga publiku që posedonin ose kishin qasje në informacionin konfidencial lidhur me procedurat të DHS-së<sup>968</sup> që të vazhdonin t'ia jepnin atë informacion OVL-UÇK-së; dhe (ii) disa përfaqësues të shtypit dhe publikut që ta merrnin, incizonin dhe shpërndanin e publikonin më tej informacionin konfidencial.<sup>969</sup> ZPS-ja parashtrroi më tej se provat treguan se të akuzuarit: (i) nuk ishin të autorizuar të zbulonin informacionin konfidencial në tri grupet e dokumenteve;<sup>970</sup> (ii) vepruan me vetëdije dhe dëshirë për zbulimin e informacionit konfidencial pa autorizim, ose së paku ishin të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve apo mosveprimeve të tyre, dhe u pajtuan që ato të ndodhnin;<sup>971</sup> (iii) synonin që ta shpërndanin këtë informacion duke qenë të vetëdijshëm se ishte konfidencial dhe për shkak se ishte konfidencial;<sup>972</sup> dhe (iv) pranuan publikisht se i kishin këqyrur tri

---

<sup>965</sup> *Shih më lart* para. 14 (Akuzat).

<sup>966</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 33; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 193; F447, para. 53, 56; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 250-251; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3430-3432, 3434-3435. *Shih më lart* para. 5 (Akuzat).

<sup>967</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3430; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 251.

<sup>968</sup> *Shih më lart* para. 5 (Akuzat).

<sup>969</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 33; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3433.

<sup>970</sup> F447, para. 57; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare ZPS-së, para. 252-253.

<sup>971</sup> F447, para. 58; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 252.

<sup>972</sup> F447, para. 253. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3430-3431.

grupet e dokumenteve dhe vetë e përshkruan përmbajtjen e tyre si konfidenciale ose të ndjeshme.<sup>973</sup> Sipas ZPS-së, informacioni konfidencial nuk duhej të zbulohet sipas Ligjit dhe/ose ishte klasifikuar nga autoritetet kompetente, përfshirë DHS-në, TFHS-në/ZPS-në dhe organizatat dhe shtetet bashkëpunëtoresh në përputhje me marrëveshjen me TFHS-në/ZPS-në.<sup>974</sup> ZPS-ja parashtroi se informacioni ishte i klasifikuar në përputhje me nenet 4(2), 23, 35(2)(d)-(f), 39, 54(8), 61(3)-(4), dhe 62 të Ligjit.<sup>975</sup>

463. Mbrojtja e kundërshtoi argumentin se informacioni në tri grupet e dokumenteve ishte konfidencial.<sup>976</sup> Konkretisht, Mbrojtja parashtroi se: (i) klasifikimet nga TFHS-ja/ZPS-ja të materialit si autentik dhe konfidencial nuk ishin gjithmonë të duhura dhe të domosdoshme;<sup>977</sup> (ii) një pjesë e informacionit tashmë njihej prej publikut;<sup>978</sup> (iii) të akuzuarit ishin të autorizuar të zbulonin informacionin për shkak të faktorëve të interesit publik;<sup>979</sup> dhe (iv) të akuzuarit ua zbuluan materialin vetëm mediave profesionale.<sup>980</sup> Mbrojtja më tej parashtroi se Pika 5 duhej të hidhej poshtë sepse ZPS-ja nuk kishte arritur të vërtetonte burimin, autenticitetin, konfidencialitetin dhe kronologjinë e mbajtjes në ruajtje të paketave me dokumente, e si rrjedhojë nuk kishte arritur të provonte se të akuzuarit kishin nxjerrë informacion të mbrojtur apo se kishin

---

<sup>973</sup> F565 SPO Dosja Gjyqësore Përfundimtare, para. 253. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3434, 3436; F447, para. 54.

<sup>974</sup> *Shih gjithashtu* F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 195.

<sup>975</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 33. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3434.

<sup>976</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 51, 53, 264, 268; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 309, 311. *Shih gjithashtu* F258/RED. *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3657-3664, 3695-3696.

<sup>977</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3654-3662, 3695-3696; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 51-53, 264-265, 268-269; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 310. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1055-1072, 1074-1076; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1198, 1203, 1205, 1214.

<sup>978</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3656-3657; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 115, 126; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 271, 308, 335; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 220; F440, para. 151.

<sup>979</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3647-3651; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 95-99.

<sup>980</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3813; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 80, 246, 255, 257, 277, 287, 327, 335, 340, 369, 373.

shkelur fshehtësinë.<sup>981</sup> Mbrojtja pretendoi se nuk është paraqitur asnjë provë se: (i) ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent e kishte shpallur të fshehtë informacionin e zbuluar nga të akuzuarit;<sup>982</sup> (ii) materiali relevant ishte nxjerrë për të akuzuarit në procedurë zyrtare;<sup>983</sup> ose (iii) të akuzuarit e dinin se informacioni ishte shpallur i fshehtë nga autoriteti kompetent.<sup>984</sup> Mbrojtja me tej ngriti pyetjen se si mund të konsideroheshin kriminale veprimet e të akuzuarve kur sjellja e gazetarëve që pasqyrojnë atë të të akuzuarve nuk konsiderohej kriminale.<sup>985</sup>

## 2. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm

464. Trupi Gjykses do të vlerësojë më poshtë nëse të akuzuarit zbuluan, pa autorizim, informacion të nxjerrë në procedurë zyrtare që sipas ligjit nuk duhej të zbulohesh ose që ishte shpallur i fshehtë me vendim të një gjykate ose autoriteti kompetent.<sup>986</sup>

(a) Informacioni i cili “sipas ligjit nuk mund të zbulohet” ose “është shpallur fshehtësi me vendim të gjykatës ose organit kompetent”

465. Siç theksohet në paragrafin 76, në mënyrë që informacioni të jetë objekt i nenit 392(1) të KPK-së, ai duhet të përmbushë njërin nga dy kriteret alternative: (i) zbulimi i tij duhet të jetë i ndaluar me ligj; ose (ii) duhet të jetë i shpallur i fshehtë nga gjykata ose autoriteti kompetent.

<sup>981</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3653-3654, 3662-3663, 3696; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 78; F439, para. 83; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 258-274, 301-302, 309-312, 334; F440, para. 141-142, 154-155, 161; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 222, 245-246. *Shih gjithashtu* F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 181, 186, 188-189, 253-256; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 275-300, 303, 307-310, 313; F440, para. 143, 146-153.

<sup>982</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 68-72; F439, para. 77. *Shih gjithashtu* F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 13, 34.

<sup>983</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 73-74; F439, para. 78-79.

<sup>984</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 75-76; F439, para. 80-81.

<sup>985</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 329-333; F440, para. 156-160. *Shih gjithashtu* F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 171-172, 346; dhe, lidhur me faktin se kundër ndihmësve nuk u ngritën akuza, F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 244, 247.

<sup>986</sup> *Shih më lart* para. 69 (Dispozitat ligjore përkatëse).

466. Trupi Gjykues tashmë ka konstatuar në paragrafin 458 se TFHS-ja/ZPS-ja, gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, i trajtoi si konfidenciale kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së në paketat 1, 2 dhe 4 me dokumente si dhe produktet e punës së brendshme që përkojnë me paketën 3. Kjo gjithashtu vlente edhe për përmbajtjen e këtyre kategorive të dokumenteve, përfshirë emrat, të dhënat dhe deklaratat e dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm. Disa nga këto dokumente gjithashtu kishin shenja ose tregues për statusin e tyre konfidencial.<sup>987</sup>

467. Trupi Gjykues gjithashtu vuri në dukje se TFHS-ja/ZPS-ja konsideronte se dokumentet serbe dhe përmbajtja e tyre kishin të bënin me hetime konfidenciale.<sup>988</sup> Megjithatë, Trupit Gjykues nuk iu paraqitën prova bindëse lidhur me bazën ligjore ose provuese për këtë pretendim. Znj. Pumper vuri në dukje se disa prej dokumenteve serbe përmbanin emrat e dëshmitarëve, ose të dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së/ZPS-së.<sup>989</sup> Znj. Pumper gjithashtu vuri në dukje se disa prej këtyre dokumenteve serbe u referoheshin masave të marra për avancimin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.<sup>990</sup> Trupi Gjykues mundi të konstatonte se shumica e dokumenteve serbe që u referoheshin hetimeve të TFHS-së/ZPS-së gjithashtu përmbanin emra të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm.<sup>991</sup> Kjo tregon se një pjesë e informacionit që përmbanin këto dokumente *mund* të jetë trajtuar si konfidencial nga TFHS-ja/ZPS-ja, ose kur autoriteteve serbe iu dërguan kërkesa për ndihmë, ose kur ai informacion iu dërgua TFHS-së/ZPS-së. Sidoqoftë, provat nuk tregojnë nëse TFHS-ja/ZPS-ja kishte marrë ndonjë prej këtyre dokumenteve që të bëheshin pjesë e dokumentacionit të tyre hetimor. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk është në gjendje të verifikojë nëse

---

<sup>987</sup> *Shih më lart* para. 428-430, 433, 436-437 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>988</sup> *Shih më lart* para. 427 (Konstatime mbi paketat).

<sup>989</sup> *Shih më lart* para. 431-432 (Konstatime mbi paketat).

<sup>990</sup> *Shih më lart* para. 336 (Konstatime mbi paketat).

<sup>991</sup> P90 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 1), f. 16, 18, 19, 23, 30, 45, 47.

dokumentet serbe u bënë pjesë e dokumentacionit të TFHS-së/ZPS-së dhe nëse u trajtuan si konfidenciale gjatë ushtrimit të funksioneve të TFHS-së/ZPS-së.

468. Për më tepër, Trupi Gjykses rikujton se mund të bëjë gjykimin e akuzave për aq sa kanë të bëjnë me procedurat dhe zyrtarët e DHS-së/ZPS-së.<sup>992</sup> Ndërsa dokumentet serbe të lartpërmendura u referohen masave të marra për avancimin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së, klasifikimi i tyre kontrollohet nga një autoritet i ndryshëm nga TFHS-ja/ZPS-ja dhe Trupi Gjykses nuk ka kompetenca të ndëshkojë shkeljen e konfidencialitetit të urdhëruar nga pala e tretë. Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk do të bëjë konstatime në lidhje me dokumentet serbe.

469. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të bëjë konstatime vetëm për kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së që përmbajnë paketat 1, 2 dhe 4, dhe paketa 3. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë nëse: (i) TFHS-ja/ZPS-ja është autoriteti kompetent sipas nenit 392(1) të KPK-së; dhe nëse po, (ii) nëse trajtimi i kategorive të lartpërmendura dhe përmbajtjes së tyre si konfidenciale përbën shpallje të atij informacioni si i fshehtë sipas të njëjtës dispozitë.

470. Sa i përket autoritetit kompetent, Trupi Gjykses vëren si më poshtë. TFHS-ja kishte për detyrë që të kryente hetime në lidhje me pretendimet e raportuara në Raportin 12462 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të 7 janarit 2011.<sup>993</sup> Siç dëshmohet në nenet 24(2) dhe 35(10) të Ligjit, kur u krijua, ZPS-ja mori përsipër mandatin dhe punonjësit e TFHS-së si dhe, midis tjerash, të gjitha marrëveshjet dhe ujdite që TFHS-ja kishte me subjekte të tjera. Në përputhje me nenin 35(2)(f) të Ligjit, gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, ZPS-ja ka autoritet dhe përgjegjësi, midis tjerash, të marrë masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtjen e çdo personi. Duke pasqyruar këtë autoritet dhe përgjegjësi, rregulla

---

<sup>992</sup> *Shih më lart* para. 10 (Akuzat).

<sup>993</sup> Neni 1(2) i Ligjit. *Shih gjithashtu* <https://www.scp-ks.org/en/spo/special-investigative-task-force> (hapur më 13 maj 2022).



30(2)(a) e Rregullores përcakton që, gjatë hetimit ZPS-ja duhet të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezik për shkak të informacionit të dhënë Prokurorit të Specializuar dhe bashkëpunimit me të.

471. Interpretimi i këtyre dispozitave prej Trupit Gjykses është se i japin ZPS-së kompetencën – dhe përgjegjësi – për të mbrojtur informacion dhe persona gjatë hetimeve të saj, përfshirë atyre të kryera më herët nga TFHS-ja. Trupi Gjykses thekson se kjo kompetencë është mishërim i domosdoshëm i parimit të pranuar gjerësisht të konfidencialitetit të hetimeve penale.<sup>994</sup> Gjatë ushtrimit të kësaj kompetence, ZPS-ja ka autoritet që ta deklarojë çdo dokument si jopublik, konfidencial ose rreptësisht konfidencial, përmes shënimit ose trajtimit të tyre, nëse është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit dhe personave gjatë hetimit.<sup>995</sup> Kjo zbatohet pa dallim edhe për dokumentet që përdoren së brendshmi, apo që janë pjesë e bashkëpunimit me palë të treta. Statusi i mbrojtur i dokumentacionit të ZPS-së mund të ndryshohet nga vetë ZPS-ja, në pajtim me nenin 61(4) të Ligjit, ose nga një panel i DHS-së, në përputhje me rregullat 80-84 të Rregullores.

472. Duke iu kthyer materialit përkatës, Trupi Gjykses konstaton se TFHS-ja/ZPS-ja kishte kompetencë që, gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, t'i shënonte ose trajtonte si konfidenciale kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së në paketat 1, 2 dhe 4 dhe dokumentet në paketën 3. Trupit Gjykses nuk i janë paraqitur prova se TFHS-ja ose ZPS-ja e ka bërë këtë në mënyrë abuzive apo të panevojshme sa i përket çfarëdo informacioni që është relevant për këtë proces.

473. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së që përmbajnë paketat 1, 2 dhe 4 dhe dokumentet në paketën 3 (“informacioni i mbrojtur”) konsiderohen si informacion i shpallur i fshehtë nga autoritetet kompetente brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

---

<sup>994</sup> *Shih gjithashtu DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3312-3313.*

<sup>995</sup> *Shih më lart para. 78 (Dispozitat ligjore përkatëse).*

474. Duke konstatuar se është përmbushur njëri nga dy kriteret alternative sipas nenit 392(1) të KPK-së, nuk është e nevojshme që Trupi Gjykses të vërtetojë përmbushjen e tjetrit. Sidoqoftë, për hir të plotësisë, Trupi Gjykses vendosi që ta bëjë këtë.

475. Rrjedhimisht, krahas konstatimeve më lart lidhur me informacionin e mbrojtur, Trupi Gjykses vëren si në vijim. Së pari, paketa 3 përmbante produkte të punës së brendshme të ZPS-së, që ishin shënuar si të tilla dhe si konfidenciale.<sup>996</sup> Zbulimi i këtyre të dhënave është i ndaluar shprehimisht në rregullën 106 të Rregullores, sipas së cilës, raportet, memorandumet dhe dokumentet e tjera të brendshme në lidhje me hetimin apo përgatitjen e një çështjeje të përgatitura nga ZPS-ja ose TFHS-ja, apo nga ndihmësit ose përfaqësuesit e tyre, nuk janë objekt i nxjerrjes së informacionit apo njoftimit. Së dyti, siç u konstatua më lart, neni 62(1) i Ligjit përcakton një kufizim të përgjithshëm lidhur me qasjen në dokumentacionin e DHS-së ose të ZPS-së, që është i barasvlershëm me ndalimin e nxjerrjes publike të tyre.<sup>997</sup> Qasja në të mund të sigurohet vetëm sipas kriterëve dhe brenda kufijve të paraparë me nenin 62(2) të Ligjit, ose sipas dispozitave të tjera të Ligjit dhe Rregullores në bazë të të cilave lejohet riklasifikimi i dokumenteve. Meqenëse informacioni i mbrojtur është pjesë e të dhënave të ZPS-së, zbulimi i tij ndalohet në bazë të nenit 62(1) të Ligjit.

476. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se informacioni i mbrojtur gjithashtu konsiderohet informacion që nuk duhet të zbulohet sipas ligjit, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

(b) Informacioni “i nxjerrë në procedurë zyrtare”

477. Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se hetimet e ZPS-së konsiderohen si “procedurë zyrtare” në kuadër të nenit 392(1) të KPK-së.<sup>998</sup> Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi në të njëjtin paragraf se “i nxjerrë” duhet të interpretohet se përfshin

---

<sup>996</sup> *Shih më lart* para. 393-394 (Konstatime mbi paketat).

<sup>997</sup> *Shih më lart* para. 77 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>998</sup> *Shih më lart* para. 74 (Dispozitat ligjore përkatëse).

shkëmbimin e informacionit brenda TFHS-së/ZPS-së për hetim dhe ndjekje penale si dhe informacionin që TFHS-ja/ZPS-ja dhe homologët e tyre kanë shkëmbyer në kuadër të bashkëpunimit për qëllime hetimore.

478. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së në paketat 1, 2 dhe 4 i përmbushin kriteret e informacionit të shkëmbyer midis TFHS-së dhe autoriteteve serbe në kuadër të bashkëpunimit për qëllime hetimore. Trupi Gjykses është bindur gjithashtu se paketa 3 i përmbush kriteret e informacionit të shkëmbyer brenda ZPS-së për hetim dhe ndjekje penale. Duket se produktet e punës së brendshme në paketën 3 janë përpiluar dhe përgatitur nga punonjësit e ZPS-së për t'u përdorur nga të tjerë brenda zyrës së tyre, dhe për rrjedhojë janë nxjerrë nga një punonjës për tjetrin.

479. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se informacioni i mbrojtur u nxor në procedurë zyrtare, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

(c) "Zbulon informacion"

480. Siç u konstatua më lart, të akuzuarit e këqyrën materialin pas secilës nga tri dorëzimet.<sup>999</sup> Si pjesë e këtij procesi, ata gjithashtu lejuan anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së dhe punonjës të KFOR-it që t'i këqyrnin një pjesë të dokumenteve.<sup>1000</sup> Z. Haradinaj gjithashtu bëri të ditur se para dhe gjatë sekuestrimit të dytë, një gazetar ishte lejuar ta këqyrte dhe filmonte paketën e dytë.<sup>1001</sup>

---

<sup>999</sup> *Shih më lart* para. 211, 246, 276-277 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1000</sup> Lidhur me anëtarët e tjerë të OVL-UÇK-së: 1D3, para. 12-17; 2D1, para. 47, 51. Lidhur me personelin e KFOR-it: P35, f. 9 (z. Gucati: "Edhe na si kena msheh KFOR-it gjerman, i kena tregu fletë për fletë. Z. Haradinaj: Ça ka dashtë me bo. Çka ka dashtë. Ça ka dashtë. I kanë fotografu, edhe KFOR-i gjerman i fotografon. Kenë prezent edhe ata. Kanë që do të thotë, ka qellu sot KFOR-i gjerman"); P11, f. 5; 1D3, para. 46; 1D4, para. 33; 2D1, para. 102-104, 106, 108-109; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2198-2200; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2459; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2777-2778.

<sup>1001</sup> P7, f. 7-8; 2D1, para. 85. *Shih gjithashtu* 1D3, para. 38.

481. Në tri konferencat për shtyp, të akuzuarit, në prani të njëri-tjetrit, ndërmorën veprimet në vijim në lidhje me tri grupet e dokumenteve. Ata: (i) i ekspozuan dokumentet në tavolinën para tyre, theksuan se ato ishin të disponueshme,<sup>1002</sup> dhe ftuan ose lejuan të pranishmit që t'i këqyrnin dokumentet;<sup>1003</sup> (ii) ua treguan dokumentet gazetarëve dhe/ose i ftuan ose i lejuan ata që kishin kamera që t'i filmnin ose fotografonin dokumentet;<sup>1004</sup> (iii) i ftuan ose i lejuan të pranishmit që t'i merrnin dokumentet me vete;<sup>1005</sup> (iv) prezantuan dhe iu referuan ose cituan (z. Gucati) ose përshkruan në hollësi (z. Haradinaj) informacionin në dokumente;<sup>1006</sup> (v) u betuan se do të vazhdonin publikimin e dokumenteve të pranuar dhe deklaruan se ishte detyrë e tyre ta bënin këtë;<sup>1007</sup> (vi) nxitën gazetarët e pranishëm të që t'i bënin publike dokumentet dhe qortuan disa prej tyre që nuk e bëjnë këtë;<sup>1008</sup> dhe (vii) bëjnë të ditur se nëse do t'u sillnin dokumente të tjera, OVL-UÇK-ja do t'i pranonte ato.<sup>1009</sup>

482. Gjithashtu, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit morën pjesë edhe në mbi njëzet paraqitje të tjera në media, së bashku, vetëm, ose në prani të të tjerëve.<sup>1010</sup> Gjatë këtyre paraqitjeve në media, të akuzuarit: (i) i diskutuan tre grupet e dokumenteve në

<sup>1002</sup> P1 material filmik, minuta 00:00:32-00:00:35 (z. Gucati), 00:00:46-00:00:48 (z. Gucati).

<sup>1003</sup> P1, f. 6-9 (z. Haradinaj); P50, f. 1 (z. Haradinaj); P35, f. 2 (z. Gucati), 14 (të dy të akuzuarit).

<sup>1004</sup> P1 material filmik, minuta 00:01:14-00:01:18 (z. Gucati), 00:14:20-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:14:44-00:14:49 (z. Gucati), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj); P2 material filmik, minutat 00:00:58-00:01:10 (z. Gucati), 00:11:14-00:11:16 (z. Gucati), 00:11:44-00:11:46 (z. Gucati); P50 material filmik, minutat 00:15:55-00:16:19 (z. Gucati); P35 material filmik, minutat 00:14:33-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj); 1D3, para. 49. *Shih gjithashtu* W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1519-1520.

<sup>1005</sup> P1, f. 5-6 (z. Haradinaj); P2, f. 1 (z. Gucati), f. 4 (z. Haradinaj); P50, f. 1 (z. Haradinaj); P35, f. 4-5 (z. Haradinaj), 15 (të dy të akuzuarit); 2D1, para. 79, 111; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2201; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2281-2283.

<sup>1006</sup> P1, f. 1, 7-8; P2, f. 1-2, 10-11; P35, f. 1-2 (z. Gucati); P1, f. 1-3, 6-7; P2, f. 2-3, 10-11; P35, f. 2-3 (z. Haradinaj).

<sup>1007</sup> P2, f. 4; P35, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1008</sup> P1, f. 4-5 (z. Haradinaj); P2, f. 2, 7 (z. Haradinaj); P35, f. 4-5, 12-13 (z. Haradinaj), 14 (z. Gucati).

<sup>1009</sup> P2, f. 8 (të dy të akuzuarit); P35, f. 8, 10 (z. Haradinaj).

<sup>1010</sup> *Shih p.sh.* në rend kronologjik të përafërt: P9, P24, P21, P18, P33, P4, P6, P19, P7, P17, P8, P25, P12, P30, P11, P28, P29, P31, P16, P15, P27, P26, P32.

përgjithësi, lexuan prej tyre ose e përshkruan përmbajtjen e tyre;<sup>1011</sup> (ii) u betuan në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin të publikonin çfarëdo dokumentesh që do t'u vinin;<sup>1012</sup> (iii) deklaruan se ishte detyrë e tyre që t'ua jepnin dokumentet mediave;<sup>1013</sup> (iv) konfirmuan ose u betuan se kopjet ishin në dispozicion ose do të viheshin në dispozicion të mediave;<sup>1014</sup> dhe/ose(v) në mënyrë të përsëritur nxitën gazetarët që t'i publikonin dokumentet dhe i qortuan disa që nuk e bënë këtë.<sup>1015</sup>

483. Gjithashtu, gjatë periudhës së Aktakuzës, në profilet e të akuzuarve në *Facebook*<sup>1016</sup> dolën postime të artikujve të mediave me përshkrime ose pamje të fotografuara nga ekrani të dokumenteve nga tri grupet e dokumenteve.<sup>1017</sup> Në postime të tjera në *Facebook* shkruhej se dorëzimi i një apo më shumë prej tri grupeve të dokumenteve ishte e mirëpritur.<sup>1018</sup>

<sup>1011</sup> P9, f. 5; P28, f. 10, 14; P29, f. 1; P31, f. 3 (z. Gucati); P6, f. 19-20; P17, f. 2-4, 9; P18, f. 2-3; P19, f. 1-4; P21, f. 4-5; P24, f. 7-8; P33, f. 2 (z. Haradinaj).

<sup>1012</sup> P4, f. 3, 8; P28, f. 7, 11, 12-13; P29, f. 2; P31, f. 2 (z. Gucati); P6, f. 4, 14; P15, f. 2; P18, f. 1-2; P21, f. 3-5; P24, f. 7-8; P26, f. 4-5 (z. Haradinaj).

<sup>1013</sup> P9, f. 6 (z. Gucati); P21, f. 3-5; P26, f. 2, 4-5 (z. Haradinaj).

<sup>1014</sup> P9, f. 6 (z. Gucati); P6, f. 17-18; P7, f. 7; P8, f. 10; P11; f. 4; P17, f. 6; P21, f. 3-4; P24, f. 3, 5-6 (z. Haradinaj).

<sup>1015</sup> P6, f. 6, 9; P8, f. 20-22; P17, f. 6-7; P19, f. 2-3; P21, f. 5; P24, f. 2-3, 10; P30, f. 5-8; P33, f. 3; P11, f. 4, 28-29 (z. Haradinaj).

<sup>1016</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2929; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2286, 2418-2421, lidhur me P00059, dhe Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2354-2363, lidhur me P00083, f. 59-62, 63-66 ku konfirmon se profili "hisni.gucati" në *Facebook* është i veti; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2434, ku konfirmon se postimet në profilin e tij në *Facebook* janë publikuar nga ai vetë, ose me autorizimin e tij, dhe se ai do ta hiqte menjëherë çdo postim pa autorizimin e tij.

<sup>1017</sup> Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook*: P83, f. 46. Postime në profilin e z. Haradinaj në *Facebook*: P60, f. 1 (gjithashtu në P84, f. 3): Lidhje e intervistës në *Euronews Albania* (P16), 24 shtator 2020; [REDAKTUAR]; f. 8-9 (gjithashtu në P70): Lidhje e *ABC News Albania* (P17), 16 shtator 2020; f. 12-13: Lidhje e intervistës në "Prime Time" (P5, P18), 16 shtator 2020; f. 14-15: Lidhje e intervistës në *Euronews Albania* (P19), 18 shtator 2020; f. 21-22, Lidhje e intervistës në "Imazh" (P21), 11 shtator 2020; f. 23-24 (gjithashtu në P76, P77), Lidhje e intervistës së Faton Klinakut (P22), 10 shtator 2020; f. 29, Lidhje e intervistës në "Imazh" (P24), 9 shtator 2020; P61, f. 1: [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; f. 3-4 (gjithashtu në P82): Pamje e fotografuar nga ekrani e artikullit në *InFokus* për dorëzimin e paketës 4, 9 shtator 2020.

<sup>1018</sup> P83, f. 49 (Postim i z. Gucati, që paraqet postimin e z. Haradinaj); P75 (Postim i z. Haradinaj, gjithashtu i paraqitur nga z. Gucati, *shih* P83, f. 47).

484. Trupi Gjykses vë në dukje se gjatë dëshmisë së tyre të akuzuarit këmbëngulën se nuk kishin “publikuar” apo “shpërndarë” materialin, por vetëm ua kishin në vënë në dispozicion mediave profesionale,<sup>1019</sup> të cilat, sipas Mbrojtjes, duhej t’u përmbaheshin detyrimeve të tyre ligjore dhe etike kur të vendosnin se çfarë materiali të (mos) publikonin.<sup>1020</sup> Trupi Gjykses konsideron se, në kuadër të nenit 392(1) të KPK-së, gazetarët ose shtypi janë anëtarë të publikut dhe, si të tillë, statusi i tyre nuk e përcakton nocionin e “zbulimit” në lidhje me këtë vepër penale. Për më tepër, sipas nenit 392(1) të KPK-së, nuk lejohet që një person t’ia delegojë tjetrit obligimin për të mos zbuluar informacion të mbrojtur. Në çdo rast, Trupi Gjykses rikujton se zbulimi i informacionit nuk nënkupton vetëm “publikimin” e materialit, në kuptimin e shpalljes, shpërndarjes ose transmetimit të përmbajtjes së tij publikisht.<sup>1021</sup> Në fakt, pas shqyrtimit të provave të lartpërmendura, Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit zbuluan informacionin e mbrojtur: (i) duke ekspozuar dhe vënë në dispozicion tri grupet e dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp; (ii) duke cituar, përshkruar ose iu referuar përmbajtjes së tyre gjatë këtyre konferencave, paraqitjeve të tjera në media dhe përmes postimeve në *Facebook*; dhe (iii) duke i lejuar dhe ftuar personat e pranishëm në selinë e OVL–UÇK-së dhe në tri konferencat për shtyp që të lexonin, shfletonin, këqyrnin, fotografonin, filmonin dhe të merrnin kopje të tri grupeve të dokumenteve ose pjesëve të tyre.

485. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit e zbuluan informacionin e mbrojtur, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

---

<sup>1019</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2218; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2281; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2417; DW1249 (Nasim Haradinaj), 12 janar 2022, f. 2811-2812; Transkripti, 13 janar 2022, f. 2932.

<sup>1020</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3813; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 246, 255, 257, 277, 287, 327, 335, 340, 369, 373.

<sup>1021</sup> *Shih më lart* para. 72 (Dispozitat ligjore përkatëse).

(d) “Pa autorizim”

486. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e vet se zbulimi i informacionit është “pa autorizim” nëse nuk lejohet me ligj ose me vendim të gjykatës apo autoritetit kompetent.<sup>1022</sup> Sa i përket informacionit të mbrojtur, Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se statusi i tij mund të ndryshohet vetëm përmes masave në përputhje me nenet 61(4) dhe 62 të Ligjit ose rregullat 80-84 të Rregullores.<sup>1023</sup>

487. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes se autorizimi mund të burojë prej faktorëve të interesit publik sipas nenit 392(1) të KPK-së, Trupi Gjykses vëren si në vijim. Së pari, as neni 392(1) i KPK-së, as ndonjë dispozitë tjetër e atij kodi nuk përmban shprehimisht ndonjë arsye mbi të cilën mund të autorizohet zbulimi i informacionit. Së dyti, në pajtim me nenin 200(2) dhe (4) të KPK-së, në qoftë se vërtetohet në lidhje me këtë veprë penale, interesi publik do të përjashtonte përgjegjësinë penale, por nuk do të ndryshonte apo hidhte poshtë veprimin e fajshëm të veprës penale. Duke përdorur të njëjtën logjikë për veprën penale aktuale, faktorët e interesit publik nuk do të përbënin autorizim për kryerjen e veprës së ndaluar sipas nenit 392(1) të KPK-së. Një interpretimi i tillë do t’i mundësonte çdo personi që pretendon se vepron për interesin publik që të pretendonte se ekziston autorizimi për zbulimin e informacionit të mbrojtur sipas nenit 392(1) të KPK-së. Kjo do të zhvlerësonte ose cenonte vetë qëllimin e kësaj dispozite. Në rastet kur faktorët e interesit publik kanë më shumë peshë se interesi për mbrojtjen e informacionit, ata mund të përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit *pavarësisht nga* kryerja e veprës penale. Trupi Gjykses do t’i trajtojë këta faktorë gjatë analizimit të argumenteve mbrojtëse të paraqitura.<sup>1024</sup>

488. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se të akuzuarit do kishin qenë të autorizuar të zbulonin informacionin e mbrojtur sepse tashmë ai ishte në sferën publike, Trupi

---

<sup>1022</sup> Shih më lart para. 73 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1023</sup> Shih më lart para. 471, 475.

<sup>1024</sup> Shih më poshtë para. 805-824 (Argumentet mbrojtëse).

Gjykues vëren si në vijim. Së pari, Trupit Gjykues nuk i është paraqitur asnjë provë se ndonjë pjesë e tri grupeve të dokumenteve, përveç dokumenteve publike në paketën e dytë, ishte tashmë në sferën publike. Në fakt, të dy të akuzuarit i përshkruan në mënyrë të përsëritur dokumentet si konfidenciale,<sup>1025</sup> dhe z. Gucati madje pranoi gjatë dëshmisë se nuk kishte parë asnjë pjesë të paketës së dytë në sferën publike para se ta merrte.<sup>1026</sup> Së dyti, Trupi Gjykues konsideron se çfarëdo zbulimi i mëhershëm i paautorizuar i informacionit të mbrojtur nuk do të kishte efektin e heqjes së statusit të mbrojtur, duke i bërë kështu zbulimet e mëvonshme të “autorizuara” brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së. Një interpretim i tillë do ta zhvlerësonte ose cenonte vetë qëllimin e kësaj dispozite.<sup>1027</sup> Së fundi, edhe nëse në material kishte *disa* informacione publike, kjo nuk justifikonte nxjerrjen e pjesës tjetër të informacionit që nuk ishte ende në sferën publike.

489. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se të akuzuarit zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur, brenda kuptimit të nenit 392(1) të KPK-së.

(e) Përfundim

490. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues është bindur se *veprimi i fajshëm* i veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392(1) të KPK-së është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykues mbi synimin kriminal

491. Para vlerësimit të synimit kriminal të të akuzuarve për këtë vepër penale, Trupi Gjykues rikujton konstatimet e veta më herët se të akuzuarit vepruan me dijeninë se tri grupet e dokumenteve ishin autentike dhe përmbanin informacion konfidencial.<sup>1028</sup>

---

<sup>1025</sup> *Shih më lart* para. 442-445 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>1026</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288.

<sup>1027</sup> *Shih p.sh.* ICTY (TPNJ), [Hartmann Trial Judgment](#), para. 43, 46.

<sup>1028</sup> *Shih më lart* para. 421, 456 (Konstatimet mbi paketat).



Duke pasur parasysh këto konstatime, Trupi Gjykses do të analizojë nëse të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë ose eventual për të zbuluar, pa autorizim, informacionin e mbrojtur.

492. Fillimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se veprimet e përshkruara në paragrafët 480-483 pasqyrojnë vendosmëri të qartë për të zbuluar informacionin e mbrojtur.

493. Së pari, të akuzuarit e shpallën qartë synimin për ta zbuluar këtë informacion. Z. Gucati deklaroi se detyra e OVL-UÇK-së “ka qenë që ta bëjë [opinionin] me dije”.<sup>1029</sup> Z. Haradinaj deklaroi në prani të Z. Gucati: “[n]e duhet t’jua qesim [paketën e parë]. Pse mos të jua qesim? Ne i bëmë publike për me u ditë”.<sup>1030</sup>

494. Së dyti, shpjegimi i të akuzuarve për zbulimin e informacionit të mbrojtur tregon qëllimin e qartë për ta bërë publik faktin se ZPS-ja bashkëpunonte me autoritetet serbe dhe me persona të cilët i përshkruan si dëshmitarë jo të besueshëm, dhe se OVL-UÇK-ja kishte pasur të drejtë kur e kishte thënë këtë në të kaluarën.<sup>1031</sup>

495. Së treti, të akuzuarit i mirëpritën tri dorëzimet dhe/ose kërkuan që t’u sillej më shumë material i ngjashëm.<sup>1032</sup> Në gjykim, të dy të akuzuarit mohuan se e kishin bërë këtë.<sup>1033</sup> Z. Haradinaj pretendoi se thirrja e tij për më shumë nxjerrje të informacionit kishte për qëllim zbulimin e identitetit të personit që e solli materialin.<sup>1034</sup> Ky pretendim është në kundërshtim me deklaratat e përsëritura të z. Haradinaj se: (i) nuk i interesonte se kush ishte ky individ;<sup>1035</sup> (ii) individi ishte i mirëpritur dhe se “nuk do

---

<sup>1029</sup> P9, f. 6.

<sup>1030</sup> P1, f. 5. *Shih gjithashtu* P1, f. 8 (z. Haradinaj: “ne me pat dashtë si kishim bë publik hiç”).

<sup>1031</sup> P1, f. 1 (z. Gucati), 3 (z. Haradinaj); P4, f. 3, 8 (z. Gucati); P28, f. 2, 11 (z. Gucati); P29, f. 2 (z. Gucati); P31, f. 2 (z. Gucati). *Shih gjithashtu më poshtë* para. 600-602 (Pika 3), 662 (Pika 1).

<sup>1032</sup> *Shih p.sh.* P35, f. 2, 8, 10; P17, f. 5; P25, f. 3, 9-10; P30, f. 2; P7, f. 2; P34, f. 2-3. *Shih gjithashtu* P33, f. 2-3; P18, f. 2, 4; P29, f. 2.

<sup>1033</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2981; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2223-2233.

<sup>1034</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2981, 2983-2984.

<sup>1035</sup> *Shih* P7, f. 13; P8, f. 17. *Shih gjithashtu* P24, f. 5.

ia nxjerrim identitetin edhe nëse vjen pa maskë”;<sup>1036</sup> dhe (iii) shpresonte se identiteti i tij nuk do të bëhej kurrë i njohur.<sup>1037</sup> Po kështu, ai kundërshtohet edhe më shumë nga provat se të dy të akuzuarit e qortuan z. Klinaku sepse u përpoq t’i shkonte pas personit që solli paketën pas dorëzimit të dytë.<sup>1038</sup>

496. Së katërti, zotimet e përsëritura të të akuzuarve për ta “shpërndarë”, “vënë në dispozicion”, “bërë publik” dhe “publikuar” çdo dokument të ri të DHS-së/ZPS-së që do të merrnin tregojnë vendosmëri të qartë për t’i përsëritur veprimet e tyre në të ardhmen.<sup>1039</sup>

497. Sa i përket pretendimit të z. Gucati gjatë dëshmisë së tij, se të akuzuarit i zbuluan tri grupet e dokumenteve sepse kishin frikë se dokumentet mund të binin “në dorën e ndonjë matrapazi të caktum”,<sup>1040</sup> Trupi Gjykes konstaton se ky shpjegim është në kundërshtim me provat më lart lidhur me mënyrën dhe qëllimin e zbulimit, si dhe me vendosmërinë e qartë të të akuzuarve për të vazhduar zbulimin e këtij materiali. Së dyti, nuk ka prova se ky material i ishte dhënë ndokujt tjetër para se t’i dorëzohej OVL-UÇK-së, apo se të akuzuarit kishin informacion se kjo kishte ndodhur. Gjithashtu,

---

<sup>1036</sup> P35, f. 10.

<sup>1037</sup> *Shih* P33, f. 3.

<sup>1038</sup> Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2189; Transkripti, 11 janar 2022, f. 2741.

<sup>1039</sup> P24, f. 7 (z. Haradinaj: “apet me marr material, apet e proklamoj”); P21, f. 3 (z. Haradinaj: “Sa herë të na vijnë dosje, ne do t’i bëjmë publike, sepse këtë detyrë kemi.”); P2, f. 4 (z. Haradinaj: “Ne sa herë të na bin, kemi me i qitë”); P18, f. 1 (z. Haradinaj: “ne deklarëtë ne veç kemi thënë që ne veç çdo që na vjen...materiale të tilla që i kam që e komprometon Gjykatën dhe Prokurorinë Speciale, ne do ta nxjerrim”); P4, f. 3 (z. Gucati: “Dhe ne ju thamë atyne që çdo moment që ne na vjen material nga Gjykata Speciale, ne do t’i bëjmë publike për media”), 8 (z. Gucati: “Interesi jonë është sa më shumë me i shpërnda në media, edhe me e bind opinionin edhe juve si media”); P35, f. 3 (z. Haradinaj: “Asnjë send që na vjen këtu, ne s’kemi majt msheft. [...] Ne këtë detyrë e kemi. Ky është qëndrimi jonë”); P28, f. 7 (z. Gucati: “Pamvarsisht sakrificës që do vjen, po të thom këtu me sinqeritetin më të madh, unë do ti publikoj të gjitha dosjet”), 11 (z. Gucati: “Çdo dokument që më vjen mu prej Gjykatës Speciale [...], ne do ta bëjm publik”), 12-13 (z. Gucati: “se në se i bin CD, unë do ti publikoj. Ne nuk do të mshefin asnjë, ne do t’ju dërgojmë, do të jem të hapun”); P29, f. 2 (z. Gucati: “Ne prapë do të veprojmë njëjtë, sikur na sot qysh kemi vepruar apo në ditët e kalume qysh kemi vepru. Ne [...] do ta informojmë opinionin kosovar”); P31, f. 2 (z. Gucati: “çdo dokumentacion i tyre që vjen para dere, ne do ta bëjmë publike”).

<sup>1040</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2169-2170.

edhe sikur ky të kishte qenë shqetësim i vërtetë, ai nuk i përlligj veprimet e ndërmarra nga të akuzuarit.

498. Për më tepër, nxitjet e shumta drejtuar gazetarëve gjatë tri konferencave për shtyp për të këqyrur, filmuar ose marrë kopje të tri grupeve të dokumenteve tregojnë vendosmëri për t'i shpërndarë dokumentet sa më gjerësisht që ishte e mundshme. Për shembull, z. Gucati i ftoi gazetarët "me fokus" kamerat në dokumente, t'i "marrin" ato, "t'i këqyrnin... prej së afërmi", dhe u tha "bujrum, lexo[jjini]".<sup>1041</sup> Po kështu, z. Haradinaj i nixti gazetarët të merrnin "kopje sa të doni", "këqyrni deklaratat e tyne, këqyrni emnat", "keni merr e zgjedh ose lë e ec" dhe "preki, preki, lajv [...] qe ku i keni...".<sup>1042</sup> Vendosmëria e të akuzuarve për t'i shpërndarë gjerësisht këto dokumente u konfirmua më tej nga këmbëngulja e tyre që gazetarët ta publikonin materialin.<sup>1043</sup>

Z. Haradinaj deklaroi në mënyrë të përsëritur se mediat ishin "shtylla" ose "forca" e

<sup>1041</sup> P1, f. 1 (z. Gucati: "ndoshta muj dhe me ju fokus"), 6 (z. Gucati: "Ktheje [...] Ktheje! Veç q'ishtu, çuje!"), 8 (z. Gucati: "Qe dy prej tyre nëse keni mundësi me i rrok [me kamera]."); P2, f. 1 (z. Gucati: "Ça mundemi me ba? Mujsh me i marrë"); P35, f. 2 (z. Gucati: "Mujshi dhe ju me ardh edhe afër me e vrojtu, qe i keni!"), 14 (z. Gucati: "Eke materialin ta vemë përpara, ta dhajmë materialin").

<sup>1042</sup> P1, f. 5 (z. Haradinaj: "juve ju japim kopje sa të doni"), 6 (z. Haradinaj: "Potë doni me e marrë ndonjë kopje. Këtë [tregon dokumentin që ka në dorë] me e pa kështu"), 8 (z. Haradinaj: "Këqyre deklaratat e tyne, këqyri emnat. Këqyri deklaratat! [...] Qe ku e kini UILLIAMSON. [...] Po deshe e kam."); P2, f. 4 (z. Haradinaj: "Për informata më të tjera, merrini vetë. Qe ku i keni dosjet. Urdhoni, keni merr e zgjedh, ose lë e ec. Ne i qesim qetu, për kush të ka qejf me i marrë"), 9 (z. Haradinaj: "Edhe jua japim s'ka problem"); P50, f. 1 (z. Haradinaj: "Qysh s' guxon, guxon me i marr n'xhep krejt [të qeshura]. Preki, preki, lajv ... kqyre, urdhno, zotni, urdhnoni, kqyre ku i kini."); P35, f. 2 (z. Haradinaj: "Ju i keni në disponim këto çka i kemi na në disponim."), 5 (z. Haradinaj: t'i marri mor, kush të ketë qejf"), (z. Haradinaj: Hajde këqyre! Shpjegoj ti këtu."), 7 (z. Haradinaj: "Kështu qe ku i kini. Këqyreni! Një kopje mund me e marrë situ duket."), 14 (z. Haradinaj: "Hajde lexoje. Gucati: Qe ku e ki, bujrum, lexo.").

<sup>1043</sup> P6, f. 9 ([Gazetari]: "Jo që i keni kërku mediave me i publiku. z.. Haradinaj: Po normal."), 17 (z. Haradinaj: "Me të dëgju ty unë asht dasht me e çu në gjykatë Kjo e para Edhe s'du me të dëgju ty por kam dash me e qit qe ktu."), 23 (z. Haradinaj: "Qe unë me i pat marr qe unë përkundrazi si gazetar kisha mendu që duhet me i qit."); P30, f. 7 (z. Haradinaj: "Ne po i publikojm për ju, na s'po publikojm, për ju po ja u qesim, ju po i publikoni."); P35, f. 14 (z. Gucati: "Qysh keni bë publike emnat e veteraneve te rrejtshëm. [...] Ju merreni qat guxim njejtë, si guximin e veteranëve.").

katërt<sup>1044</sup> dhe se ishte përgjegjësi e tyre të publikonin “aq sa guxojn me bo”.<sup>1045</sup> Ai gjithashtu i qortoi gazetarët që nuk bënë “punën” e tyre dhe nuk e publikonin materialin.<sup>1046</sup>

499. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për ta zbuluar pa autorizim informacionin e mbrojtur. Zbulimi i këtij informacioni kryesisht në mediat profesionale nuk ndikon aspak në këtë konstatim.

500. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se synimi kriminal i veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurave sipas nenit 392(1) të KPK-së është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

#### 4. Përfundim

501. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja i ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e veprës penale në Pikën 5 të Aktakuzës lidhur me të dy të akuzuarit.

---

<sup>1044</sup> P11, f. 4 (z. Haradinaj: “Ne e kemi llogarit që forca e katërt në këtë pushtet jeni ju mediat. Dhe prandaj ja kemi dorëzuar të ju.”), 31 (z. Haradinaj: “Prandaj unë ja u kam çu ju, e dini ju çka a profesionalja, jeni forcë”); P30, f. 5 ([Gazetari]: “[...] po ju po mbani në arkivën tuaj kopje të ktyre dosjeve? z. Haradinaj: Jo. Ne ju kemi ju arkiv, sepse ju jeni forca e katërt n’shtet. Na e llogaritim të ju.”); P8, f. 22 (“z.. Haradinaj: “Eh, derisa ju jeni fuqia e katërt, forca e katërt [...] Ne kemi pas besim se ju jeni me profesional, jeni më të guximshëm, keni mbrojtje ligjore.”); P35, f. 4-5 (z. Haradinaj: “[N]e duke ju llogaritur ju që jeni forca e katërt këtu! Te paktën duhet me u kanë, sa jeni e dini ju! Ne po jua dorëzojmë juve.”), 12-13 (z. Haradinaj: “përgjegjës është forca e katërt. Sikur të isha kanë unë në media, e kishe pa a i publikoj. [...] Ça kam unë punë me ty. Ti je media. [...] Je forca e katërt e shtetit.”).

<sup>1045</sup> P30, f. 20 (z. Haradinaj: “Media deshta të bojnë publike aq sa guxojnë me bo.”); P24, f. 10 (z. Haradinaj: “kështu që, kur t’ja u mban, qitni.”).

<sup>1046</sup> P6, f. 6 (z. Haradinaj: “I ke marrë dhe s’i ke qit dhe ti s’e ka realizu detyrën.”); P24, f. 3 (z. Haradinaj: “mbetet ata që i kanë marr kopjet, me zotimin se do t’i publikojnë edhe sidomos unë kam llogarit gjithmonë guximin e mediave tona, mirëpo, si po e shoh, po m’duket nuk u ka ja man zuza kërrkuj me fol për to dhe pse i kanë marr kopjet.”); P33, f. 3 (z. Haradinaj: “mediat tona në Kosovë e dinë që një ministër e ka pa dhënë dorëheqjen vetëm për me jua siguru ju ligjin për mbrojtjen e burimeve dhe nuk po e respektoni. Dy, kur ka ra puna për shqiptarë, qoftë në televizione, në të gjitha. Tash ju dhejshin liri po i keni njerëzit që i kanë vu në televizione të tjera. [...]. Deri sa kur ka ardh për ndërkombëtarët, po dilni ndryshe, po heziton! Urdhëroni merrni materialin, qitne edhe mos e lejoni, o vëlla [...] me jua hup mundin një ministri [...]”).

## B. SHKELJA E FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS– PERSONAT E MBROJTUR (PIKA 6)

### 1. Parashtrimet e palëve

502. Sipas ZPS-së, gjatë periudhës së Aktakuzës të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre zbuluan apo tentuan të zbulonin identitetin dhe të dhënat personale të dëshmitarëve nën mbrojtje në procedurat e DHS-së dhe në procedura të mëparshme penale në Kosovë.<sup>1047</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendoi se të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre gjithashtu inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan përfaqësues të shtypit që të zbulonin pa autorizim këtë informacion.<sup>1048</sup>

503. ZPS-ja parashtrroi se identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve ishin të mbrojtura duke qenë se ishin objekt i: (i) urdhrave të një paneli të DHS-së ose kërkesave të ZPS-së për mosnxjerrje të informacionit; (ii) masave mbrojtëse të lëshuara nga gjykatat e Kosovës; (iii) konfidencialitetit dhe i kufizimeve në përdorim të vendosura nga organizatat ndërkombëtare që i dhanë informacion ZPS-së me ato kushte; dhe (iv) konfidencialitetit dhe i kufizimeve në përdorim të vendosura për shkak të faktit se identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve ishin të përfshira në materialin konfidencial.<sup>1049</sup> Sipas ZPS-së, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre: (i) deklaruan publikisht se informacioni konfidencial përfshinte identitetin, të dhënat personale dhe dëshmi të dëshmitarëve dhe se ai lidhej me hetimet e TFHS-së/ZPS-së;<sup>1050</sup> dhe (ii) pranuan që, me ligj, identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve nuk duhej të shpërndareshin publikisht.<sup>1051</sup>

---

<sup>1047</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3431-3432, 3436; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 255-258; F477, para. 59, 68; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 197, 205; F251/A01 Aktakuza, para. 34.

<sup>1048</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 34.

<sup>1049</sup> Transkripti, 14 mars 2022, 3437-3438, 3440; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para.238; F477, para. 63-66; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 198-202.

<sup>1050</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3436-3438; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 236-237, 241; F251/A01 Aktakuza, para. 34.

<sup>1051</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 34. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3430-3431, 3433.

504. ZPS-ja gjithashtu pretendoi se zbulimi i paautorizuar i identitetit dhe të dhënave personale dëshmitarëve kishte çuar në pasoja serioze për dëshmitarët dhe i kishte penguar rëndë hetimet e ZPS-së.<sup>1052</sup> Në veçanti, ZPS-ja parashtroi se dëshmitarët dhe/ose familjet e tyre ishin frikësuar. Ishin kërcënuar siguria, privatësia, reputacioni dhe mjetet e tyre të jetesës.<sup>1053</sup> Gjithashtu, ZPS-ja u detyrua të merrte masa për t'i trajtuar pasojat konkrete dhe të mundshme, përfshirë ato për dëshmitarët dhe procedurat e DHS-së.<sup>1054</sup> ZPS-ja parashtroi se të akuzuarit synonin të shkaktonin pasoja të rënda për dëshmitarët e mbrojtur në procedurat e DHS-së ose se, më së paku, ata ishin të vetëdijshëm se mund të ndodhnin këto pasoja dhe u pajtuan me shkaktimin e tyre.<sup>1055</sup> ZPS-ja shtoi gjithashtu se kishte bërë përpjekje urgjente për të marrë secilën nga tre paketat e dokumenteve dhe asnjëherë nuk i kishte thënë të akuzuarve se mund ta mbanin paketën 1 deri në një muaj.<sup>1056</sup>

505. Në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare të saj, ZPS-ja parashtroi se të akuzuarit përmendën me emër një numër zyrtarësh serbë, bashkëpunimi i të cilëve me ZPS-në u zbulua për herë të parë. ZPS-ja gjithashtu pohoi se këta emra ishin në paketën 1. Në veçanti, ZPS-ja bëri të ditur se emrat, adresat e fundit të ditura dhe numrat telefonikë të [REDAKTUAR] përfshiheshin në shtojcat konfidenciale të kërkesave të TFHS-s, midis dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të tjerë të cilët TFHS-ja donte t'i intervistonte.<sup>1057</sup> Sipas ZPS-së, këta individë i përmbushnin kriteret si dëshmitarë sepse ishin persona që kishin informacion për krimet brenda juridiksionit të DHS-së.<sup>1058</sup> Gjithashtu, ZPS-ja pretendoi se të akuzuarit përmenden edhe emra të

---

<sup>1052</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3440-3441; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 259; F477, para. 67; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 204; F251/A01 Aktakuza, para. 35.

<sup>1053</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 22, 32.

<sup>1054</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 22.

<sup>1055</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3442-3443; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 259. *Shih gjithashtu* F477 para. 62.

<sup>1056</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 247-249.

<sup>1057</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 243.

<sup>1058</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 244.

dëshmitarëve shqiptarë në dëshminë e të cilëve mbështetj ZPS-ja, [REDAKTUAR]. Sipas ZPS-së, emri i këtij personi ishte përmendur në paketën 3 dhe, ndonëse ky person njihej publikisht në atë kohë, ZPS-ja nuk e kishte konfirmuar asnjëherë nëse ai ose ndonjë person tjetër ishte dëshmitar në hetimet që po kryente.<sup>1059</sup>

506. Mbrojtja parashtroi se ZPS-ja nuk kishte arritur të provonte se informacioni i nxjerrë nga të akuzuarit u përkiste personave nën mbrojtje në kohën e veprave penale të pretenduara ose se të akuzuarit kishin dijeni për këtë.<sup>1060</sup> Për më tepër, Mbrojtja e Gucatit pretendoi se nuk ka prova për pasoja të rënda për personat nën mbrojtje ose për pamundësimin apo pengimin e rëndë të procedurës penale.<sup>1061</sup>

507. Mbrojtja kundërshtoi gjithashtu edhe dëshminë e z. Jukiq, ndër të tjera,<sup>1062</sup> për: (i) numrin e dëshmitarëve që ZPS-ja thirri pas ngjarjeve të paraqitura në Aktakuzë;<sup>1063</sup> (ii) numrin e dëshmitarëve që deklaruan se kishin marrë kërcënime të drejtpërdrejta gjatë ose pas ngjarjeve në Aktakuzë;<sup>1064</sup> (iii) dëshminë e z. Jukiq për disa nga bisedat që kishte pasur me dëshmitarët pas ngjarjeve të paraqitura në Aktakuzë;<sup>1065</sup> (iv) numrin e dëshmitarëve të zhvendosur me vendbanim;<sup>1066</sup> dhe (v) koha që z. Jukiq kishte shpenzuar duke u marrë me pasojat e veprimeve të të akuzuarve.<sup>1067</sup>

---

<sup>1059</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 245.

<sup>1060</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3664, 3696; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 84-87; F439, para. 89-92, 94-95; F440, para. 41, 164-167.

<sup>1061</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 92.

<sup>1062</sup> *Shih më lart* para. 52-58 (Pranimi dhe vlerësimi i provave).

<sup>1063</sup> *Shih p.sh.* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 237.

<sup>1064</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 146-147, 153-159, 238; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3609-3611. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1834.

<sup>1065</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 144; *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3621-3622; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1703-1706, 1758-1759; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1833, 1880-1881.

<sup>1066</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 170, 173-175, 371-372. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1888-1889; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3618-3621.

<sup>1067</sup> *Shih* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 70-71, 88; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1823-1824. *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3609, 3626.

## 2. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale

508. Trupi Gjykses do të shqyrtojë më poshtë nëse të akuzuarit zbuluan, pa autorizim, informacion për identitetin ose të dhënat personale të personit nën mbrojtje në procedura penale.<sup>1068</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk pretendon se të akuzuarit zbuluan informacion për identitetin apo të dhënat personale të personit në një program special të mbrojtjes dhe për rrjedhojë ky element alternativ nuk do të trajtohet.

### (a) "Personi i mbrojtur në procedurë penale"

509. Trupi Gjykses rikujton konstatimin e mësipërm se nocioni i "personit të mbrojtur në procedurën penale" përfshin çdo person lidhur për të cilin ekziston kusht ligjor, urdhër ose masë mbrojtëse e lëshuar ose zbatuar në procedurë penale. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do të përcaktojë fushëveprimin e termit "person" për këtë pikë të Aktakuzës para se të përcaktojë nëse këta persona ishin "të mbrojtur në procedurë penale".<sup>1069</sup>

#### i) Përkufizimi i termit "person"

510. Trupi Gjykses vë në dukje se pretendimet e ZPS-së në këtë pikë të Aktakuzës u referohen "dëshmitarëve" dhe jo "personave", duke e ngushtuar kështu fushëveprimin e zbatimit të nenit 392(2) KPK-së. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të vlerësojë përkufizimin e termit "dëshmitar" në lidhje me Pikën 6.

511. ZPS-ja e përkufizon dëshmitarin si "të gjithë personat që me gjasë kanë informacion për vepra penale, kryes apo rrethana të rëndësishme në lidhje me

---

<sup>1068</sup> *Shih më lart* para. 89 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1069</sup> *Shih më lart* para. 95 (Dispozitat ligjore përkatëse).



procedurat e DHS-së”.<sup>1070</sup> Trupi Gjykses vëren se ky përkufizim është më i gjerë se ai i përdorur nga znj. Pumper.<sup>1071</sup> Ajo e përkufizoi dëshmitarin si person të cilin TFHS-ja/ZPS-ja e kishte takuar dhe prej të cilit kishte marrë informacion, ndër të tjera edhe në formën e intervistës.<sup>1072</sup> Znj. Pumper gjithashtu përkufizoi dëshmitarin e mundshëm si dikë prej të cilit ZPS-ja donte të merrte informacion, përfshirë përmes organizatave të tjera, ndër të tjera edhe në formën e intervistës.<sup>1073</sup> Trupi Gjykses vëren se përkufizimet e znj. Pumper janë të krahasueshme me ato të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, i cili përkufizoi “dhënësin e informacionit” si çdo person që i jep informacion TFHS-së dhe/ose ZPS-së për çfarëdo krimi ose veprë penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së dhe “dhënësin e mundshëm të informacionit” si çdo person që ka të ngjarë t’i japë informacion TFHS-së, ZPS-së ose ndonjë paneli të DHS-së për çfarëdo krimi ose veprë penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së.<sup>1074</sup> Përkufizimi i znj. Pumper gjithashtu përputhet me përkufizimin e “dëshmitarit” të përcaktuar në Ligjin nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, që është përfshirë shprehimisht në nenin 23(1) dhe (4) të Ligjit. Përkufizimi i znj. Pumper është gjithashtu përgjithësisht në përputhje me përkufizimin e nocionit të “dëshmitarit” të miratuar në instrumentet e tjera që merren me mbrojtjen e dëshmitarëve në procedura gjyqësore.<sup>1075</sup>

512. Trupi Gjykses konsideron se përkufizimet e znj. Pumper i përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe të arsyeshme nocionet e dëshmitarit dhe dëshmitarit të mundshëm në hetime penale. Në anën tjetër, Trupi Gjykses konsideron se përkufizimi i “dëshmitarit” nga ZPS-ja është tepër i gjerë dhe nuk bazohet në ligjet përkatëse, as në provat që paraqiti. Në veçanti, problemi thelbësor për Pikën 6 është zbulimi i

---

<sup>1070</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 4. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 18; F281, para. 3.

<sup>1071</sup> *Shih më lart* para. 344 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1072</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080.

<sup>1073</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080.

<sup>1074</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 54, 61.

<sup>1075</sup> *Shih p.sh.* [Council of Europe Recommendation on Witness Protection](#), Appendix, section 1 (“Definitions”).

pretenduar i identitetit të “dëshmitarëve” që përmbajnë paketat me dokumente. Këto pretendime janë gjithashtu pjesë e Pikave 1-4. E vetmja dëshmi që ka paraqitur ZPS-ja mbi praninë e emrave dhe të dhënave të dëshmitarëve në paketat me dokumente ishte dëshmia e znj. Pumper. Trupi Gjykses është bindur se analiza dhe përfundimet e saj lidhur me praninë dhe numrin e këtyre emrave ose të dhënave të tjera identifikuese në paketa u bazuan në përkufizimet e saj të sakta dhe të arsyeshme të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm. Ndonëse Mbrojtja e kundërshtoi mënyrën në të cilën znj. Pumper verifikoi se kush ishte dëshmitar (i mundshëm) i ZPS-së, ajo nuk kundërshtoi përkufizimet e saj për këta terma.<sup>1076</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se mund të bazohet në përkufizimet e lartpërmendura të znj. Pumper (“dëshmitar”, “dëshmitar i mundshëm”) dhe në përfundimet e saj lidhur me praninë e emrave të këtyre personave në materialin e shqyrtuar prej saj.

513. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se termi “person” në Pikën 6 mbulon dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm. Në vijim të konstatimeve të veta në paragrafët 379-381, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të TFHS-së/ZPS-së të përmendur me emër në kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së që përmbajnë paketat 1, 2 dhe 4 dhe paketa 3 i përmbushin kriteret si dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm në kuadër të Pikës 6 dhe brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.

514. Lidhur me katër zyrtarët serbë të cilët znj. Pumper i identifikoi se ishin në listë “midis dëshmitarëve të tjerë dhe dëshmitarëve të mundshëm” në kërkesat e TFHS-së në paketën 1,<sup>1077</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se zbulimi i pretenduar i emrave të tyre ose të dhënave identifikuese të tjera ka të bëjë me Pikën 6 vetëm në qoftë se individët në fjalë i përmbushin kriteret si dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm. Sa i përket zbulimit të pretenduar të identiteteve të katër zyrtarëve serbë të cilët nuk i përmbushin

---

<sup>1076</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1080-1084.

<sup>1077</sup> *Shih më lart* para. 345 (Konstatime mbi paketat).

kushtet si më lart, Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja nuk e ka përfshirë këtë si pretendim të veçantë në asnjë pikë të Aktakuzës dhe Trupi Gjykses nuk e konsideron si të tillë. Sidoqoftë, duke qenë se emrat ose të dhënat e tjera identifikuese të zyrtarëve serbë ishin në informacionin e mbrojtur, zbulimi i tyre do të përfshihej brenda kuadrit të Pikës 5, si pjesë e përmbajtjes së këtij informacioni. Kjo nuk vlen për z. Vukçeviq, bashkëpunimi i të cilit me TFHS-në është bërë publik nga kryeprokurori i mëparshëm i saj.<sup>1078</sup>

ii) “Të mbrojtur në procedurë penale”

515. Siç u konstatua në paragrafin 458, TFHS-ja/ZPS-ja, gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, e trajtoi si konfidencial informacionin e mbrojtur dhe përmbajtjen e tij, përfshirë emrat, të dhënat dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm. Trupi Gjykses konstatoi se TFHS-ja/ZPS-ja kishte kompetencë ta bënte këtë për shkak të autoritetit dhe përgjegjësisë që kishte për të mbrojtur informacionin dhe personat gjatë hetimeve të veta,<sup>1079</sup> që janë pjesë e procedurave penale.<sup>1080</sup> Trupi Gjykses konsideron se vendimi i TFHS-së/ZPS-së për ta trajtuar informacionin e mbrojtur si konfidencial ishte gjithashtu një masë që ajo e miratoi në përputhje me nenin 35(2)(f) të Ligjit dhe rregullën 30(2)(a) të Rregullores për t’i vendosur nën mbrojtje dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm.<sup>1081</sup> Prova se kjo masë ishte ende në fuqi ishte fakti që TFHS-ja/ZPS-ja nuk i nxori publikisht emrat e këtyre dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm brenda kornizës së hetimeve të saj.

516. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm në informacionin e mbrojtur, ishin të mbrojtur në procedurat penale, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.

---

<sup>1078</sup> C1, f. 6. *Shih gjithashtu* Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2146-2147 (Urdhër Gojor mbi Përdorimin e Emrave të Përmendur në Paketa).

<sup>1079</sup> *Shih më lart* para. 471-473 (Pika 5).

<sup>1080</sup> *Shih më lart* para. 74 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1081</sup> *Shih më lart* para. 95 (Dispozitat ligjore përkatëse).

517. Sa u përket parashtrimeve të ZPS-së se dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm në paketën 3 ishin të mbrojtur edhe në bazë të urdhrave të paneleve të DHS-së, kërkesave të ZPS-së, urdhrave të gjykatave kosovare, ose kufizimeve të vendosura nga organizatat ndërkombëtare (“masat mbrojtëse shtesë”), Trupi Gjykses vëren se nuk është paraqitur asnjë provë që tregon se të akuzuarit ishin në dijeni të masave mbrojtëse shtesë, ose për statusin e mbrojtur të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm për shkak të këtyre masave. Ndonëse Trupi Gjykses pajtohet me ZPS-në se nuk është e nevojshme që të akuzuarit të ishin në dijeni të ligjit konkret apo urdhrat të gjykatës që i jep mbrojtje dëshmitarit,<sup>1082</sup> kjo nuk do të thotë se Trupi Gjykses mund t’u ngarkojë të akuzuarve shkeljen e masave mbrojtëse për të cilat të akuzuarit nuk mund të kenë qenë në dijeni dhe për të cilat qartazi nuk ishin në dijeni. Nëse do ta bënte këtë, do të lindnin pyetje të rëndësishme për disponueshmërinë e bazës ligjore që penalizon sjellje të caktuara dhe për parashikueshmërinë e përgjegjësisë penale të bazuar në të.<sup>1083</sup> Për shembull, KPK-ja, Ligji dhe Rregullorja janë ligje të disponueshme që penalizojnë sjellje të caktuara dhe që e bëjnë përgjegjësinë të parashikueshme për cilindo individ. Në anën tjetër, urdhrat ose masat jopublike, edhe nëse burojnë nga këto ligje, mund të shërbejnë vetëm si bazë ligjore e pavarur për përgjegjësi penale në qoftë se mund të provohet se personi në fjalë ka qenë në dijeni për ekzistencën ose efektin e tyre, në atë masë që i mundëson atij të vlerësojë lidhjen e tyre me ligjshmërinë e sjelljeve të tij. Në çështjen aktuale, ndonëse të akuzuarit ishin plotësisht në gjendje të përcaktonin konfidencialitetin e informacionit dhe emrave në tri grupet e dokumenteve dhe ishin gjithashtu të vetëdijshëm se publikimi i tyre mund të çonte në përgjegjësi penale,<sup>1084</sup> ata nuk mund

---

<sup>1082</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 239.

<sup>1083</sup> *Shih* ECtHR (GJEDNJ), [Müller et al. Judgment](#), para. 29; [Cantoni Judgment](#), para. 29; [Kafkaris GC Judgment](#), para. 140; [Del Río Prada GC Judgment](#), para. 79.

<sup>1084</sup> *Shih më lart* para. 440-448 (Konstatime mbi paketat), *më poshtë* para. 896-900 (Argumentet mbrojtëse).

të kenë qenë në dijëni të urdhrave ose masave konkrete dhe jopublike për mbrojtje shtesë.

518. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do të bazohet në masat mbrojtëse shtesë për të përcaktuar nëse dëshmitarët ose dëshmitarët e mundshëm ishin të mbrojtur në procedura penale në kuadër të kësaj çështjeje.

(b) “Zbulon informacion mbi identitetin ose të dhënat personale”

519. Trupi Gjykses ka konstatuar se të akuzuarit zbuluan informacion të mbrojtur përmes veprimeve të përshkruara në paragrafët 481-483. Përmes të njëjtave veprime, të akuzuarit gjithashtu u vunë në dispozicion të tjerëve identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në informacionin e mbrojtur.

520. Përveç veprimeve të lartpërmendura, të akuzuarit përmendën se tri grupet e dokumenteve përmbanin emrat, vendbanimet e mëparshme dhe aktuale, numrat e telefonit, kombësinë, vendet ku ishin mbajtur intervistat dhe përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve. Ata e bënë këtë gjatë tri konferencave për shtyp, gjatë paraqitjeve të tjera në media dhe në postime në *Facebook*.<sup>1085</sup> Të akuzuarit gjithashtu i

---

<sup>1085</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj: “këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë i kemi në mbrojtje”), 4 (z. Gucati: “Në 2013 që janë marrë informacionet [...] për dëshmitarë që i kanë thirrë i kanë çu në Beograd krejt.”), 5 (z. Haradinaj: “Pra, këtu ka edhe deklaratat, ka emën, ka mbiemën të personit, vendin ku ka banu, vendin ku jeton tash. Numra telefoni diku-diku.”); P8, f. 11 (z. Haradinaj, kur u pyet nëse njihje ndonjë person të përfshirë në dosjet: “Normal, qata që ja kam lexu emrin, e kam njoft, e kam njoft.”); P9, f. 6-7 (z. Gucati: “Jo, me emna nuk lëshojm [...] se un nuk e njoh gjinin [...]. aty ka prej t’gjitha viseve Shqiptare ka. E ka Serb, e ka Rom, e ka Turq ...”), 7, 10 (z. Gucati duke treguar vendin dhe datat e disa intervistave të dëshmitarëve, duke deklaruar se disa dëshmitarë ishin shqiptarë dhe duke konfirmuar se përmbajtja e intervistave të dëshmitarë është në grupin e Parë); P18, f. 3 (z. Haradinaj: “në dosjen e parë kanë pasur emra ashtu”); P11, f. 30 (z. Haradinaj); P28, f. 2, 11, 13 (z. Gucati); P29, f. 1 (z. Gucati); P30, f. 4, 12 (z. Haradinaj); P35, f. 1 (z. Gucati: “Ka figura të ndryshme, emra të ndryshëm që ne s’jemi të autorizim t’i përmendim këto emna.”), 3 (z. Haradinaj: “ka emna këtu sinë bazë të shkafit që janë ngrit ato [...] aktakuza. [...] Përmenden edhe te dhënat të shumë njerëzve këtu. [REDAKTUAR] përmenden emnat e shumë njerëzve, shumë njerëzve këtu.”), 14 (z. Gucati: “Edhe këta janë shqiptarë. 80% janë shqiptarë që kanë deshmua atje.”); P59, f. 1 (z. Gucati: “ Dosje [...] në të cilat figurojnë shumica e emrave të dëshmitarëve.”).

ftuan gazetarët ta këqyrnin atë informacion.<sup>1086</sup> Z. Haradinaj përmendi me emër së paku pesë dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm, konkretisht [REDAKTUAR].<sup>1087</sup>

521. Sa u përket argumenteve të Mbrojtjes se të akuzuarit nuk i zbuluan emrat e dëshmitarëve sepse nuk i thanë me gojë dhe se në mënyrë të përsëritur u kërkuan gazetarëve që të mos i publikonin këta emra,<sup>1088</sup> Trupi Gjykses së pari vë në dukje se, siç u tha më lart, z. Haradinaj në fakt përmendi me emër pesë dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm. Më poshtë do të trajtohet nëse ishte i autorizuar ta bënte këtë.<sup>1089</sup> Së dyti, Trupi Gjykses rikujton se zbulimi i informacionit përfshin më shumë se vetëm thëniet me gojë apo deklaratat publike.<sup>1090</sup> Pas shqyrtimit të provave të lartpërmendura, Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm që përmbante informacioni i mbrojtur: (i) duke i ekspozuar dhe vënë në dispozicion tri grupet e dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp; (ii) duke vënë në dukje në mënyrë publike dhe të përsëritur praninë e emrave, vendbanimeve të mëparshme dhe aktuale, numrave të telefonit, kombësisë, vendeve të mbajtjes së intervistave dhe përmbajtjeve të deklaratave të dëshmitarëve, gjatë tri konferencave për shtyp, paraqitjeve të tjera në media dhe në postimet në *Facebook*; dhe (iii) duke lejuar ose ftuar personat e pranishëm në selinë e OVL-UÇK-së dhe në tri konferencat për shtyp që t'i shihnin emrat dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe, në përgjithësi, të lexonin, këqyrnin, shqyrtonin, fotografonin, filmonin ose të merrnin kopje të tri grupeve të dokumenteve

---

<sup>1086</sup> P1, f. 5 (z. Haradinaj: "ju japim kopje satë doni. Satë guxoni me lexu ju emna këtu keni."); P35, f. 2 (z. Gucati: "Kështu këtu emnat sot, ka emna të bollshëm, ka emna figura të ndryshme. [...] Mujshi dhe ju me ardh edhe afër me e vrojtu, qe i keni!"), 13-14 ([Gazetari]: "A është edhe [REDAKTUAR]? [...] z. Haradinaj: Hajde lexo këtu! z. Gucati: E ke materialin ta vëmë përpara, ta dhajmë materialin. z. Haradinaj: Hajde lexoje. z. Gucati: Qe ku e ki, bujrum, lexo."). *Shih gjithashtu më lart* poshtëshënimi. 1042.

<sup>1087</sup> P1, f. 2; [REDAKTUAR].

<sup>1088</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 384-385; F440, para. 165-166.

<sup>1089</sup> *Shih më poshtë* para. 523-526.

<sup>1090</sup> *Shih më lart* para. 72 (Dispozitat ligjore përkatëse), 484 (Pika 5).

ose pjesëve të tyre. Argumenti lidhur me këshillën e të akuzuarve që gazetarët të mos i publikonin këta emra do të diskutohet më tej lidhur me synimin kriminal të nevojshëm për këtë vepër penale dhe atë në Pikën 3.<sup>1091</sup>

522. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.

(c) “Pa autorizim”

523. Trupi Gjykses ka konstatuar se të akuzuarit zbuluan informacion të mbrojtur pa autorizim,<sup>1092</sup> sepse statusi i atij informacioni mund të ndryshojë vetëm përmes masave në përputhje me nenet 61(4), 62 të Ligjit ose rregullat 80-84 të Rregullores.<sup>1093</sup> Trupi Gjykses gjithashtu ka konstatuar se identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm ishin të mbrojtura për shkak se ishin në informacionin e mbrojtur.<sup>1094</sup>

524. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se emrat e disa dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm nuk ishin të mbrojtur, ose nuk ishin të mbrojtur më, sepse ishin tashmë në sferën publike në kohën që lidhet me akuzat, Trupi Gjykses vëren si në vijim. Së pari, siç u vu në dukje më lart,<sup>1095</sup> fakti që identiteti i një personi dihet publikisht nuk mund të barazohet me zbulimin e identitetit të tij si *person i mbrojtur në procedurë penale*. Në veçanti, fakti që identiteti ose funksioni zyrtar i një personi dihet publikisht nuk do të thotë se statusi i tij si dëshmitar dhe dëshmitar i mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së mund të bëhet publik. Së dyti, fakti që një person u ka dhënë dëshmi prokurorëve të Kosovës apo të TPNJ-së ose ka dëshmuar para gjykatave të TPNJ-së ose të Kosovës, nuk do të thotë se atij i është hequr statusi i mbrojtur si

---

<sup>1091</sup> Shih më poshtë para. 531 (Pika 6), 590 (Pika 3).

<sup>1092</sup> Shih më lart para. 489 (Pika 5).

<sup>1093</sup> Shih më lart para. 77-78 (Dispozitat ligjore përkatëse), 471 (Pika 5).

<sup>1094</sup> Shih më lart para. 515-516 (Pika 6).

<sup>1095</sup> Shih më lart para. 98 (Dispozitat ligjore përkatëse).

dëshmitar ose si dëshmitar i mundshëm në hetimet e TFHS-së/ZPS-së. Së treti, fakti që një dëshmitar ose dëshmitar i mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së e bën publik statusin e vet të mbrojtur, nuk do të thotë se TFHS-ja/ZPS-ja nuk ka detyrimin ta mbrojë atë person ose se të tjerët kanë të drejtë ta shpërndajnë më tej atë informacion. Trupi Gjykues thekson se statusi i mbrojtur i dëshmitarit ose dëshmitarit të mundshëm në hetimet e TFHS-së/ZPS-së buron prej kornizës ligjore të DHS-së. Rrjedhimisht, vetëm ZPS-ja ose DHS-ja mund ta heqin ose ndryshojnë këtë status të mbrojtur në pajtim me dispozitat përkatëse. Me fjalë të tjera, autoriteti dhe përgjegjësia e ZPS-së dhe DHS-së për ruajtjen e statusit të mbrojtur të një personi nuk përfundojnë për shkak të faktit se ai status është bërë i njohur në një nga mënyrat e lartpërmendura, ose në ndonjë mënyrë tjetër që nuk autorizohet nga korniza ligjore e DHS-së.<sup>1096</sup>

525. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se të akuzuarit ishin të autorizuar të zbulonin emrat e disa zyrtarëve serbë të cilët pretendohet se kishin kryer krime, Trupi Gjykues konsideron se konstatimet e veta në paragrafin 487 lidhur me faktin që interesi publik nuk është burim alternativ autorizimi vlejné edhe këtu. Lidhur me atë nëse të njëjtët faktorë mund të përjashtojnë përgjegjësinë penale, do të diskutohet gjatë analizës së argumenteve mbrojtëse të paraqitura.<sup>1097</sup>

526. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se të akuzuarit zbuluan pa autorizim identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.

---

<sup>1096</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Hartmann Trial Judgment](#), para. 43, 46. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1759-1760.

<sup>1097</sup> *Shih më poshtë* para. 810-824 (Argumentet mbrojtëse).



(d) Përfundim

527. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes është bindur se veprimi i fajshëm i veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392(2) të KPK-së është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

### **3. Konstatimet e Trupit Gjykes mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale**

528. Para se të shqyrtojë synimin kriminal të të akuzuarve për këtë vepër penale, Trupi Gjykes rikujton konstatimet se të akuzuarit vepruan me dijeninë se tri grupet e dokumenteve: (i) ishin autentike;<sup>1098</sup> dhe (ii) përmbanin emra dëshmitarësh të mbrojtur.<sup>1099</sup> Trupi Gjykes gjithashtu ka konstatuar se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për të zbuluar pa autorizim informacionin e mbrojtur.<sup>1100</sup> Duke pasur parasysh këto, Trupi Gjykes do të vlerësojë më poshtë nëse të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë ose eventual kur zbuluan pa autorizim identitetin ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së.

529. Trupi Gjykes vë në dukje që në fillim se veprimet e përshkruara në paragrafët 519-520 pasqyrojnë vendosmërinë e qartë të të akuzuarve që të zbulonin identitetin dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së.

530. Konkretisht, të akuzuarit e bënë të disponueshëm informacionin e mbrojtur për gazetarët, me vetëdije të plotë se ai përmbante emrat dhe të dhënat e dëshmitarëve që ata vetë i konsideronin se ishin të mbrojtur.<sup>1101</sup> Ata e bënë këtë pavarësisht nga urdhrat

---

<sup>1098</sup> *Shih më lart* para. 423 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1099</sup> *Shih më lart* para. 379-381, 456, 467 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1100</sup> *Shih më lart* para. 499 (Pika 5).

<sup>1101</sup> *Shih më lart* para. 446-448, 456 (Konstatime mbi paketat).

gjyqësorë dhe kërkesat e ZPS-së që mos ta shpërndanin atë informacion.<sup>1102</sup> Për më tepër, siç u konstatua më lart, të akuzuarit gjithashtu u betuan në mënyrë të përsëritur se do t'i bënin publike të gjitha dokumentet e DHS-së/ZPS-së që do të merrnin, pa bërë dallim sa i takon përmbajtjes së tyre.<sup>1103</sup>

531. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se të akuzuarit vepruan në mënyrë të ligjshme sepse i këshilluan gazetarët që të mos publikonin emra, Trupi Gjykses rikujton se të dy të akuzuarit ishin në dijeni se, sipas Urdhrit të Parë, Urdhrit të Dytë dhe Urdhrit të ZPS-së, shumëfishimi dhe shpërndarja e dokumenteve ishin të ndaluara.<sup>1104</sup> Me gjithë këta urdhra, të akuzuarit vazhduan t'u jepnin gazetarëve informacion të mbrojtur që përmbante emra të tillë. Për më tepër, ata tërhoqën vëmendjen në mënyrë të përsëritur për praninë e emrave në materialin që zbuluan, dhe këtë e bënë në veçanti gjatë tri konferencave për shtyp dhe në paraqitjet e tjera në media,<sup>1105</sup> që u transmetuan në televizion që me gjasë kishin shikueshmëri të lartë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se, gjatë gjithë kohës në fjalë, të akuzuarit kishin synimin t'i zbulonin emrat e dëshmitarëve në tri grupet e dokumenteve. Argumenti se ata nuk i thanë me gojë emrat e dëshmitarëve do të diskutohet më tej më poshtë.<sup>1106</sup>

532. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për të zbuluar pa autorizim identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së.

---

<sup>1102</sup> *Shih më lart* para. 440-441 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>1103</sup> *Shih më lart* para. 481-482 (Pika 5). *Shih gjithashtu* P2, f. 4 (z. Haradinaj); P4, f. 3, 8 (z. Gucati); P18, f. 1 (z. Haradinaj); P21, f. 3 (z. Haradinaj); P24, f. 7 (z. Haradinaj); P28, f. 7, 11-13 (z. Gucati); P29, f. 2 (z. Gucati); P31, f. 2 (z. Gucati); P35, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1104</sup> P4, f. 8 (z. Gucati); P17, f. 6 (z. Haradinaj).

<sup>1105</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj), 4 (z. Gucati), 5 (z. Haradinaj); P8, f. 11 (z. Haradinaj); P9, f. 6-7, 10 (z. Gucati); P11, f. 30 (z. Haradinaj); P18, f. 3 (z. Haradinaj); P28, f. 2, 11, 13 (z. Gucati); P29, f. 1 (z. Gucati); P30, f. 4, 12 (z. Haradinaj); P35, f. 1 (z. Gucati), 3 (z. Haradinaj), 14 (z. Gucati).

<sup>1106</sup> *Shih më poshtë* para. 590 (Pika 3), 896-906 (Argumentet mbrojtëse).

533. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se synimi kriminal i veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurave sipas nenit 392(2) të KPK-së, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

#### 4. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi formën e rëndë të veprës penale

534. Trupi Gjykses rikujton se neni 392(3) i KPK-së penalizon dhe ZPS-ja argumenton dy lloje formash të rënda të veprës penale bazë sipas nenit 392(2) të KPK-së: (i) pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së; dhe (ii) procedura penale pengohet në masë të madhe, ose pamundësohet.<sup>1107</sup>

(a) Pasoja të rënda për personat e mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së

535. Siç u konstatua më lart, informacioni i mbrojtur përmbante emrat dhe të dhëna të tjera identifikuese të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.<sup>1108</sup> Të akuzuarit e zbuluan këtë informacion, ndër të tjera duke i lejuar gazetarët të merrnin dhe të bënin kopje të tij, që çoi në shpërndarjen e 70-80% të materialit.<sup>1109</sup> Si rezultat, iu la rastësisë se ku dhe në duart e kujt do të përfundonte informacioni i zbuluar nga të akuzuarit.<sup>1110</sup>

i) Pasoja të rënda

536. Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e z. Jukiq se, si rezultat i zbulimit të informacionit të mbrojtur, dy dëshmitarë u zhvendosën jashtë Kosovës.<sup>1111</sup> Kjo u bazua në vlerësimin individual për rrezikun e lartë ndaj personave në fjalë.<sup>1112</sup> Trupi Gjykses vëren se

<sup>1107</sup> *Shih më lart* para. 100 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1108</sup> *Shih më lart* para. 379-381 (Konstatimet mbi paketat).

<sup>1109</sup> P4, f. 3; P6, f. 17-18, 36; P7, f. 7, 11; P17, f. 6; P35, f. 6; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2281-2283.

<sup>1110</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 5; P24, f. 3, 6.

<sup>1111</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1707-1709, 1761-1762; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1887-1892, 1901-1902, 1905-1906.

<sup>1112</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1707-1709, 1760-1761.

Mbrojtja e kundërshtoi dëshminë e z. Jukiq lidhur me numrin e dëshmitarëve të zhvendosur.<sup>1113</sup> Trupi Gjykses sidoqoftë konsideron se është e qartë nga dëshmia e z. Jukiq se dy individët në fjalë u zhvendosën në bazë të procedurave të ndryshme, por sipas z. Jukiq, të dyja masat përbënin zhvendosje.<sup>1114</sup> Nuk ka të dhëna të besueshme se z. Jukiq ekzagjeroi apo gënjeu për numrin e dëshmitarëve të zhvendosur. Përkundrazi, Trupi Gjykses është bindur se rreziku i lartë që e bëri të domosdoshme zhvendosjen e këtyre personave dhe pasojat negative të lidhura me masa të tilla (*p.sh.* pamundësia për të jetuar në shtëpi, komunitet dhe familje) përbëjnë pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së në lidhje me këta dy dëshmitarë.

537. Z. Jukiq gjithashtu bëri të ditur se si rezultat i zbulimit të informacionit të mbrojtur, u ndërмор planifikim urgjent për shkak të rrezikut ndaj një numri dëshmitarësh.<sup>1115</sup> Z. Jukiq shpjegoi se planifikimi urgjent për shkak të rrezikut është masë e jashtëzakonshme e miratuar mbi baza individuale, kur rreziku ndaj një dëshmitari konsiderohej i lartë dhe duhej planifikuar largimi i tyre në rast se rreziku materializohej.<sup>1116</sup> Trupi Gjykses është bindur se shkalla e lartë e rrezikut që i bëri të domosdoshme masa të tilla dhe fakti se personat në fjalë ishin të vetëdijshëm se si rezultat rrezikoheshin të dëmtoheshin si edhe zhvendosja e pritshme e shpejtë e tyre, përbëjnë pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së lidhur me këta dëshmitarë.

---

<sup>1113</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 170, 173-175, 371-372. *Shih gjithashtu* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1888-1889; Transkripti, 15 mars 2022, f. 3618-3621.

<sup>1114</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1901-1902. *Shih gjithashtu* Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1707-1709, 1760, 1762-1763; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1888-1889.

<sup>1115</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se z. Jukiq bëri të ditur se, përveç dy zhvendosjeve, ishin miratuar rreth 20-30 masa të tjera sigurie ose mbrojtëse si rezultat i zbulimit të informacionit. *Shih* W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1763. Z. Jukiq nuk saktësoi sa masa të tilla ishin plane emergjente të menaxhimit të rrezikut. Gjithashtu, e vetmja masë tjetër e përmendur nga z. Jukiq ishte dhënia e telefonave, që ai tha se ishte bërë për 5-10 dëshmitarë dhe që, sipas interpretimit të Trupit Gjykses nuk përbën planifikim emergjent të rrezikut. *Shih* Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1882-1883.

<sup>1116</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1708, 1760-1761. *Shih gjithashtu* Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1885.

538. Gjithashtu, Trupi Gjykues vë në dukje se, [REDAKTUAR], Z. Haradinaj e identifikoi konkretisht [REDAKTUAR] që përmendej në grupin e tretë të dokumenteve.<sup>1117</sup> [REDAKTUAR].<sup>1118</sup> Mbi këtë bazë, Trupi Gjykues është bindur se, në kontekstin e Kosovës, ku çështjet që kanë të bëjnë me pretendimet për krime të kryera nga anëtarët e UÇK-së janë dëmtuar dhe dihet se janë dëmtuar nga rastet e frikësimit të dëshmitarëve,<sup>1119</sup> frika dhe shqetësimi si rezultat i përmendjes publikisht të emrit si dëshmitar, në vijim të deklaratave nënçmuese të mëhershme,<sup>1120</sup> përbëjnë pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së në lidhje me atë dëshmitar.

539. Së fundi, sa i përket dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të tjerë identiteti ose të dhënat personale të të cilëve u zbuluan nga të akuzuarit, z. Jukiq bëri të ditur se, si rezultat i zbulimit të informacionit të mbrojtur: (i) “shumë njerëz” ishin të shqetësuar, të frikësuar, shprehën frikë dhe u ndien të kërcënuar;<sup>1121</sup> (ii) disa nga individët që ZPS-ja i telefonoi për t’i informuar për rrjedhjen e informacionit bërtitën në telefon dhe disa kërkuan që të mos kontaktoheshin më;<sup>1122</sup> (iii) individët që i telefonuan ZPS-së ishin shumë të zemëruar;<sup>1123</sup> dhe (iv) dy persona i larguan familjet

---

<sup>1117</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1118</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1790-1793.

<sup>1119</sup> P165 (z. Rid: “Kërcënimi i dëshmitarëve në gjykimet e Kosovës, nuk kam parë asnjëherë ndonjë gjë të tillë”); DW1253 (Robert Rid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3304-3307; Transkripti, 28 janar 2022, f. 3359-3361; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor, f. 1704 (“Më kujtohet një rast ku njëri na tha që kishte pasur besim te ne dhe si mundet që emri i tij të ketë dalë në publik dhe se familja e tij ishte e rrezikuar dhe më tha 'E di shumë mirë se çfarë ka ndodhë me dëshmitarët në Kosovë.'”), 1758-1759 (“Unë kam një farë njohurie, përvoja nga rajoni i Ballkanit, nga puna që kam bërë, për punën që kam bërë për TPNJ-në. Ka pasur shumë incidente që u kanë ndodhur dëshmitarëve dhe nga përvoja ime di se kanë ndodhur disa incidente edhe gjatë kohës së UNMIK-ut dhe EULEX-it, ku disa dëshmitarë janë kërcënuar dhe mendoj që atë kishte parasysh ky person në telefonatën e tij.”); Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1885-1886 (duke dëshmuar se ishin miratuar dy ose tri plane emergjente të menaxhimit të rrezikut gjatë dy viteve para 7 shtatorit 2020, në dukje pa ndonjë lidhje me të akuzuarit).

<sup>1120</sup> [REDAKTUAR], Postimi i një personi tjetër i paraqitur në profilin e z. Haradinaj në *Facebook*, [REDAKTUAR].

<sup>1121</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1693, 1699. *Shih gjithashtu* P130; P131; P132; P135; P136; P137.

<sup>1122</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1702-1703.

<sup>1123</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1703

e tyre si masë parandaluese.<sup>1124</sup> Z. Jukiq deklaroi se dy persona morën kërcënime të drejtpërdrejta,<sup>1125</sup> por Trupi Gjykses mendon se nuk është e qartë nëse këto kërcënime ishin rezultat i veprimeve të të akuzuarve; për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk do të bazohet në këto prova në këtë kontekst. Z. Jukiq gjithashtu bëri të ditur se individë të tjerë nuk ishin të shqetësuar për këto ngjarje.<sup>1126</sup>

540. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja i kundërshtoi shumë nga treguesit e lartpërmendur.<sup>1127</sup> Sa u përket kundërshtimeve të Mbrojtjes lidhur me numrin e dëshmitarëve të thirrur nga ZPS-ja, Trupi Gjykses vëren se vetëm një pjesë e shënimeve për kontaktet u pranuan si prova.<sup>1128</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është në gjendje që të vlerësojë, në bazë të shënimeve për kontaktet që u pranuan, se sa dëshmitarë saktësisht thirri apo takoi ZPS-ja. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se një pjesë e shënimeve për kontaktet kanë të bëjnë me shkëmbimet e bëra me më shumë se një dëshmitar.<sup>1129</sup> Si rezultat, Trupi Gjykses nuk gjen arsye të nxjerrë përfundimin se z. Jukiq ekzagjeroi apo gënjeu për numrin e dëshmitarëve të kontaktuar. Sa i përket kundërshtimit të Mbrojtjes lidhur me vërtetësinë e dëshmisë së z. Jukiq për disa biseda që kishte pasur me dëshmitarë, Trupi Gjykses vë në dukje se shënimet për kontaktet nuk janë raportime fjalë për fjalë të atyre shkëmbimeve. Përkundrazi, ato janë përmbledhje të bisedave të shumta me dëshmitarë të shënuara brenda një periudhe relativisht të shkurtër. Fakti që në asnjë nga shënimet për kontaktet të përgatitura nga z. Jukiq nuk përmendej shprehimisht se ndonjë dëshmitar kishte “bërtitur” në telefon, apo që nuk kishte shënime për mënyrën apo tonin me të cilin dëshmitarët i shprehën shqetësimet e tyre, nuk vë në dyshim saktësinë ose besueshmërinë e dëshmisë së z.

---

<sup>1124</sup> P131; P136; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1714, 1727-1728. *Shih gjithashtu* Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1748-1749.

<sup>1125</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1833-1834.

<sup>1126</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1722-1723. *Shih gjithashtu* P133.

<sup>1127</sup> *Shih më lart* para. 506-507 (Pika 6).

<sup>1128</sup> P130-132, 135-P137.

<sup>1129</sup> *Shih* P135; P136; W04842 (Miro Jukiq), 28 tetor 2021, f. 1726; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1819.

Jukiq. Po kështu, fakti që në asnjë nga shënimet për kontaktet nuk ishte shënuar se ndonjë dëshmitar kishte thënë se e dinte çfarë u ndodhte dëshmitarëve në Kosovë, nuk do të thotë se nuk mund të mbështetesh në këtë dëshmi. Duke pasur parasysh se shumë prej këtyre dëshmitarëve u shprehën frikë dhe shqetësim atyre që i telefonuan, ka shumë të ngjarë që shënimet për thirrjet telefonike nuk do të përmbanin çdo aspekt të asaj që ishte thënë. Mbi këtë bazë, nuk ka tregues se dëshmia e z. Jukiq mbi këto pika ishte i pavërtetë.

541. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se, ZPS-ja vendosi që të mos thërriste asnjë prej këtyre dëshmitarëve që të dëshmonin për pasojat e veprimeve të të akuzuarve tek ta dhe për bazën mbi të cilën i kishin krijuar bindjet e tyre për ato pasoja. Ky aspekt i veçon provat lidhur me këta dëshmitarë nga kategoritë e diskutuara më herët. Në veçanti, Trupi Gjykses konstatoi më lart se ishin vërtetuar pasoja të rënda lidhur me një numër dëshmitarësh, bazuar në dëshminë e z. Jukiq për masat e marra nga ZPS-ja si rezultat i vlerësimit të rrezikut që ai dhe kolegët e tij kryen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Mbrojtja pati mundësi të shumta që të verifikonte saktësinë dhe mbështetshmërinë e këtyre provave. Nga ana tjetër, Mbrojtja nuk pati mundësi që gjatë gjykimit të verifikonte dëshmitë e dëshmitarëve shqetësimet e të cilëve ishin shënuar në shënimet për kontaktet. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të bëjë konstatime lidhur me këta dëshmitarë individualë ose me këto kategori dëshmitarësh. Si rezultat, ndonëse Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se veprimet e të akuzuarve do të kishin krijuar atmosferë frike dhe shqetësimi në mesin e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, dhe se ajo frikë dhe ai shqetësim nuk ishin aspak të parëndësishëm,<sup>1130</sup> Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar pasoja të rënda lidhur me asnjë nga këta dëshmitarë dhe dëshmitarë të mundshëm të tjerë brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.

---

<sup>1130</sup> Shih më poshtë para. 582-585 (Pika 3).

ii) Të vetëdijshëm se mund të ndodhin pasoja të rënda

542. Trupi Gjykues vë në dukje se të dy të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se zbulimi i identiteteve ose i të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm mund të sillte pasoja të rënda për dëshmitarët. Kjo është e qartë nga fakti se të akuzuarit u kërkuan në mënyrë të përsëritur gazetarëve që të mos i publikonin këta emra, duke treguar kështu se ishin të vetëdijshëm për rreziqet e lidhura me këtë.<sup>1131</sup>

543. Kur zotit Gucati iu tërhoq vërejtja se “mund të ndodhin edhe gjëra shumë të tjera” sepse “mund t’ dalin emrat pastaj”, ai ishte i prerë në indiferencën e vet: “mund të ndodhin ...”.<sup>1132</sup> Gjithashtu, në një postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* shkruhej se DHS-ja duhej të ndiqej penalisht për “rrezikimin e dëshmitarëve që gjenden në këto dokumente”.<sup>1133</sup>

544. Z. Haradinaj ishte gjithashtu i vetëdijshëm për pasojat e mundshme negative për personat në fjalë. Ai besonte se DHS-ja/ZPS-ja kishte “luajt me jetat e njerëzve” duke i lejuar rrjedhjet e informacionit dhe deklaroi se “është gjynah me luft me jetat e njerëzve këtu, se ata kan luft”.<sup>1134</sup> Z. Haradinaj gjithashtu ishte i vetëdijshëm se zbulimi i informacionit “ka kriju ndjenjë shqetësimi dhe vet kuptimi... se ka qen i mashtrim”, dhe se “kjo ka kriju vetndjesim të personit”.<sup>1135</sup> Kur një gazetar hamendësoi se “nëse botohet publikimi i këtyre emrave, në rast se ndodhin po supozoj, vrasjet e këtyre personave”, z. Haradinaj u përgjigj se “për ta mbajt gojën, duhet me u thirr ti në pyetje nëse vritet dikush, se ti po e din që ka me u vra dikush. Na nuk po besojmë që vritet dikush”.<sup>1136</sup> Pyetjes nëse zbulimi i dokumenteve mund të përbënte rrezik “për dikënd,

---

<sup>1131</sup> *Shih më lart* para. 531.

<sup>1132</sup> P9, f. 8.

<sup>1133</sup> P59, f. 1.

<sup>1134</sup> P11, f. 39.

<sup>1135</sup> P11, f. 65.

<sup>1136</sup> P2, f. 7.



për dëshmitarët”, z. Haradinaj u përgjigj se gazetaret të cilëve ua kishin dhënë materialin duhej të merrnin përgjegjësi për këtë.<sup>1137</sup> Kur z. Tomë Gashi komentoj se “dikush edhe mund ta shantazhojë dikë, por është çështje e tij”, z. Haradinaj u kundërpërgjigj se “dëshmitarët nuk kanë nevojë [...] nuk kanë nevojë me u shantazhu prej këtyne njerëzve, se s’kan çfarë me i shantazhu”.<sup>1138</sup> Ai gjithashtu u pajtua se keqpërdorimi i informacionit ishte vepër penale, por të tilla ishin edhe dëshmitë e rreme dhe fabrikimi i fakteve.<sup>1139</sup> Ai gjithashtu refuzoi sistematikisht sugjerimin nga të tjerë se veprimet e tyre do të shkaktonin ndjenjën e frikës tek dëshmitarët.<sup>1140</sup> Sipas fjalëve të z. Haradinaj: “çështja nuk është [...] te dëshmitarët, se s’janë tue na interesu ne”.<sup>1141</sup>

545. Gjatë dëshmisë, të akuzuarit u përpoqën të mohonin se ishin të vetëdijshëm për rreziqet, por në fund pranuan se informacioni i zbuluar mund të keqpërdorej.<sup>1142</sup>

---

<sup>1137</sup> P6, f. 22-23.

<sup>1138</sup> P7, f. 8-9.

<sup>1139</sup> P7, f. 8-9.

<sup>1140</sup> *Shih p.sh.* P11, f. 65 ([Bashkëbiseduesi 1]: “Kjo ka krijuar ndjenje frike të dëshmitart. [Bashkëbiseduesi 2]: Patjetër. z. Haradinaj: Jo bre [...]. [Bashkëbiseduesi 1]: Hiç mos me pas ... emne thot noshta dikush ma lexon.”); P25, f. 7 ([Gazetari]: “Po, Po a mendoni që po i rrezikoni dëshmitart me nxjerrjen e këtyne dosjeve, se kur po delni në publik e po thoni kemi dosjet e emrat e tyre ...z. Haradinaj: Jo, nuk u ka thot kush ne kemi, ne skem thon asnjëherë ... [Gazetari]: Jo unë po ju thom ... ju, a po mendoni që po i friksoni? z. Haradinaj: [...] nuk o përgjegjësia jon, është përgjegjësia atij që ka pranuar mu kon i manipulim, i spekulim edhe i shantazh. [...]”); P34, f. 3 ([Bashkëbiseduesi]: “a është në një mënyrë, pra ky fakti që dosjet e Tribunalit vijnë tek Shoqata e Veteranëve të Luftës, a o një lloj intimidimi që i bahet, përpos dëshmitarëve edhe të gjithë procesit, për shkak se ju e dini se pra mbrenda atyne është thonë që ka edhe emna të dëshmitarëve të ndryshëm, pra të Tribunalit. Pra, a është një kërcënim pra që i bahet me këto dëshmitarëve, të cilët mund të dëshmojnë për krimet të ndryshme që kanë ndodh gjatë dhe pas luftës? Z. Haradinaj: Aspak, aspak nuk është sepse dëshmitarët shihet që kanë dëshmu në kohën e dhunës, në kohën e luftës kur ata kanë bo presion, ku kanë ushtrua presion ndaj atyne. Dhe pastaj janë këto deklaratat e tyne ma vone që s’shihet a kanë vullnet a s’kanë vullnet dhe ne nuk do ta japim këtë qasje sepse ne për këtë arsyeje nuk i kemi qit emrat dhe s’do të dalin nga Organizata të Veteranëve të Luftës asnjëherë emrat, sepse ne nuk kryejmë detyrat e përçarjes së popullit tonë, por jemi për unifikim.”).

<sup>1141</sup> P7, f. 2. *Shih gjithashtu* P1, f. 5 (z. Haradinaj: “Në fund të fund përgjegjësia ta mbajnë ata te cilët kanë marrë përsipër mbrojtjen e dëshmitarëve. Dhe unë mendoj që është jo korrekte, se unë pak e kam dert punën e atyre dëshmitarëve te Hagës, më kupton.”).

<sup>1142</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2308-2309; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2833, 2843-2852.

546. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se mund të kishte pasoja të rënda si rezultat i veprimeve të tyre, dhe u pajtuan me ato pasoja.

iii) Përfundim

547. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se zbulimi nga të akuzuarit i identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm rezultoi në pasoja të rënda brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së për dy dëshmitarët që u zhvendosën, për dëshmitarët që ishin objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut dhe për personin që u përmend publikisht me emër si dëshmitar (“dëshmitarët e rrezikuar”). Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se mund të ndodhnin këto pasoja dhe u pajtuan me ato pasoja.

(b) Procedura penale të penguar ndjeshëm ose të pamundësuar

548. Trupit Gjykses i janë paraqitur prova se ZPS-së iu desh të shpenzonte kohë dhe kapacitete për kontaktimin dhe takimin e dëshmitarëve që patën pasoja nga zbulimi i informacionit të mbrojtur.<sup>1143</sup> Në veçanti, z. Jukiq dëshmoi se ZPS-ja bëri rreth 200 thirrje telefonike me dëshmitarë në shtator 2020 dhe në vijim;<sup>1144</sup> ai mori pjesë në afërsisht tridhjetë thirrje të tilla dhe afërsisht 10 dëshmitarë të tjerë i takoi personalisht.<sup>1145</sup> Ai gjithashtu dëshmoi se ZPS-ja përgatiti shënime për kontaktet ku evidentoi këto thirrje dhe se, si pasojë e frikës dhe shqetësimeve të shprehura nga

---

<sup>1143</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1692-5, 1697-1701, 1711, 1715, 1761; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1803-1805, 1818-1825, 1837-1838, 1906-1907. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 1009-1012.

<sup>1144</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1698, 1761; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1824-1825, 1907.

<sup>1145</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1698 (shpjegon procesin e thirrjeve telefonike për dëshmitarët që ishin prekur nga rrjedhja e informacionit duke dhënë numrin prej rreth 200 thirrjesh gjithsej, ku ai kishte marrë pjesë në ndoshta 30 prej tyre). *Shih gjithashtu* Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1701-1703.

dëshmitarët, u ripërcaktuan prioritetet e operacioneve të sigurisë së dëshmitarëve.<sup>1146</sup> Ndonëse nga dokumentacioni nuk është e qartë se sa kohë dhe punonjës shtesë u nevojiten për këto masa, provat tregojnë se pa veprimet e të akuzuarve, nuk do të kishte ndodhur ky shpenzim i kapaciteteve hetimore dhe prokuroriale. Kjo vazhdoi afërsisht deri nga mesi i dhjetorit 2020.<sup>1147</sup> Gjithashtu, siç u konstatua më lart, ZPS-së iu desh të merrte një numër masash sigurie në përgjigje të kërcënimit të perceptuar ndaj dëshmitarëve të caktuar si rezultat i sjelljes së të akuzuarve.<sup>1148</sup> Nga kjo u ndikuan midis 20 dhe 30 dëshmitarë.<sup>1149</sup> Për më tepër, ZPS-ja ndërmori tri operacione sekuestrimi për marrjen e paketave me dokumente dhe një operacion kontrollimi dhe sekuestrimi kur u arrestuan të akuzuarit.<sup>1150</sup>

549. Mbrojtja argumentoi se z. Jukiq e ekzagjeroi sasinë e kohës që kishte shpenzuar duke u marrë me pasojat e veprimeve të të akuzuarve dhe la të kuptohej se ai e bëri këtë për të përforcuar argumentet e ZPS-së.<sup>1151</sup> Trupi Gjykses nuk pajtohet me këtë. Nuk mund të pritej që z. Jukiq të mbante shënime për çdo minutë të shpenzuar duke u marrë me këto çështje. Nëse atij i kërkohet më shumë se një vit më vonë që të mbajë mend sa kohë saktësisht kishte shpenzuar, kjo medoemos do të përfshijë një element pasigurie dhe vlerësimi të përafërt.

550. Ndonëse Trupi Gjykses pranon se ky devijim i kapaciteteve ishte ngarkesë shtesë për operacionet e ZPS-së, ai nuk është bindur se devijimi ishte aq i konsiderueshëm sa

---

<sup>1146</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1698-1699 (lidhur me përgatitjen e shënimeve), f. 1700-1701 (lidhur me procesin e planifikimit dhe ndryshimin e prioriteteve të aktiviteteve).

<sup>1147</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1832.

<sup>1148</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1707-1709 (ku përfshihen shpërndarja e telefonave, planifikimi urgjent për menaxhimin e rrezikut, zhvendosja e dy dëshmitarëve); Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1882-1884 (ku bëhet e qartë se një numri dëshmitarësh u ishin dhënë telefona si rezultat i rrjedhjes së informacionit në shtator 2020).

<sup>1149</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1763.

<sup>1150</sup> *Shih më lart* para. 228-231, 256-258, 285, 297-299 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1151</sup> *Shih* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 70-71, 88; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1823-1824. *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3609, 3626.

të pengonte ndjeshëm, vononte ose pamundësonte hetimet e ZPS-së.<sup>1152</sup> Po kështu, Trupi Gjykses nuk ka dëgjuar dëshmi se përdorimi i lartpërmendur i kohës dhe kapaciteteve shtesë pamundësoi ose vështirësoi mbledhjen e provave nga ZPS-ja. Ndonëse Trupit Gjykses i janë paraqitur prova se së paku një dëshmitar refuzoi të komunikonte me ZPS-në pasi iu zbulua emri,<sup>1153</sup> në mungesë të provave të tjera për këtë,<sup>1154</sup> Trupi Gjykses nuk mund të nxjerrë përfundimin se ZPS-ja nuk ishte më në gjendje ose pati vështirësi në mbledhjen e provave. Gjithashtu, megjithëse Trupi Gjykses konstatoi se u shkaktuan pasoja të rënda lidhur me dëshmitarët e rrezikuar, ai nuk mund të nxjerrë mbi këtë bazë përfundimin se kjo shkaktoi humbjen ose dobësimin e aftësisë së ZPS-së për të ruajtur sigurinë e hetimeve apo për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve. Përkundrazi, dëshmitë që dëgjoji Trupi Gjykses treguan se ZPS-ja mori masa të përshtatshme për t'iu përgjigjur situatës.

551. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se zbulimi nga të akuzuarit i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm i pamundësoi ose pengoi ndjeshëm hetimet e ZPS-së brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.

## 5. Përfundim

552. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e formës bazë të veprës penale të Pikës 6 në lidhje me të dy të akuzuarit. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën e rëndë të së njëjtës veprë penale për të dy të akuzuarit lidhur me dëshmitarët e rrezikuar.

---

<sup>1152</sup> *Shih më lart* para. 100 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1153</sup> W04841 (Zdenka Pumper), 19 tetor 2021, f. 1012; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1703; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1905.

<sup>1154</sup> *Shih më poshtë* para. 651-656 (Pika 1).

## C. FRIKËSIM GJATË PROCEDURËS PENALE (PIKA 3)

### 1. Parashtrimet e palëve

553. ZPS-ja pretendoi se gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre përdorën kërcënime të rënda për t'i nxitur ose për të tentuar t'i nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratat ose të jepnin deklaratat të rreme, ose në ndonjë mënyrë tjetër të mos i jepnin informacion të vërtetë or ZPS-së dhe/ose DHS-së.<sup>1155</sup>

554. ZPS-ja parashtrroi se të akuzuarit: (i) njoftuan publikisht se dokumente me emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve i ishin dhënë shtypit;<sup>1156</sup> dhe (ii) përmendën emra, vendet e banimit, dhe të dhëna të tjera personale të dëshmitarëve konkretë dhe bënë të qartë se njerëzit do të mësonin se kush ishin këta dëshmitarë.<sup>1157</sup> Sipas ZPS-së ishte e qartë që kjo synonte të paralajmëronte të gjithë ata që bashkëpunonin me ZPS-në se tani identiteti i tyre dihej dhe se nuk do të mbroheshin.<sup>1158</sup> ZPS-ja pretendoi se të akuzuarit bënë komente nënçmuese dhe akuza për dëshmitarët, duke i quajtur “shqipfolës”, “tradhtarë”, “kriminelë, gjakpirës dhe spiunë”,<sup>1159</sup> dhe shtoi se këto fjalë duhej të kuptoheshin në prizmin e klimës së frikësimit të dëshmitarëve në procedurat penale kundër anëtarëve të UÇK-së që mbizotëron në Kosovë.<sup>1160</sup> Në këtë aspekt, ZPS-ja mori parasysh: (i) domosdoshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve për kryerjen e hetimeve dhe gjykimeve penale; (ii) interesin dhe detyrimin ligjor të ZPS-së për të mbrojtur sigurinë e dëshmitarëve; dhe (iii) shkallën e gjerë dhe natyrën publike të

<sup>1155</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 29-30.

<sup>1156</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 216; F447, para. 41; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 179.

<sup>1157</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 216; F447, para. 41; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 179.

<sup>1158</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 198, 200, 217; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3444-3445; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 180.

<sup>1159</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 200, 217; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3445; F447, para. 44; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 183.

<sup>1160</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 202, 218; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3446.

kërcënimeve.<sup>1161</sup> ZPS-ja parashtrroi se të akuzuarit “ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratë, ose të jepnin deklaratë të rreme, apo të mos i jepnin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose DHS-së”.<sup>1162</sup> Si alternativë, ZPS-ja parashtrroi se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se si rezultat i veprimeve të tyre, mund të ndodhte kjo pasojë e ndaluar me ligj dhe u pajtuan që kjo pasojë e ndaluar me ligj të ndodhte.<sup>1163</sup>

555. Mbrojtja e Gucatit parashtrroi se nuk janë paraqitur prova se ndonjë person ishte nxitur të mos jepte deklaratë, të jepte deklaratë të rreme ose të mos i jepte informacion të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit.<sup>1164</sup> Mbrojtja e Gucatit shtoi se nuk është paraqitur asnjë provë se të akuzuarit përdorën forcën, kërcënimet e rënda, dhe premtimet për dhurata ose të ndonjë forme tjetër përfitimi për të nxitur ndonjë prej atyre sjelljeve.<sup>1165</sup> Mbrojtja e Gucatit pretendoi se Trupi Gjykoës ka dëgjuar vetëm për dy ankesa anonime se dëshmitarët ishin kërcënuar, por pohoi se: (i) asnjë prej ankesave nuk është e pranueshme për sa i përket vërtetësisë së përmbajtjes; (ii) njëra ankesë është thjesht shprehje e një mendimi tjetër anonim; dhe (iii) për tjetrën nuk mund të bëhej lidhja e drejtpërdrejtë me veprimet e të akuzuarve.<sup>1166</sup>

556. Mbrojtja e Haradinajt parashtrroi se nuk është dhënë asnjë hollësi qoftë edhe për një individ të vetëm që të ishte frikësuar konkretisht nga të akuzuarit ose veprimet e tyre.<sup>1167</sup> Mbrojtja e Haradinajt deklaroi se asnjë individ që thuhet se ka pasur pasoja

---

<sup>1161</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3457-3458.

<sup>1162</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 219; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3448; F447, para. 46; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 185.

<sup>1163</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 219; F447, para. 46; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 185.

<sup>1164</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 52; F439, para. 60. *Shih gjithashtu* Transkripti, 15 mars 2022, f. 3610-3616.

<sup>1165</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 53-55; F439, para. 61-63.

<sup>1166</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 55(b); Transkripti, 15 mars 2022, f. 3610-3611; F439, para. 63(b).

<sup>1167</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 140-141; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3685; F440, para. 85-88; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 22.

drejtpërdrejt nga tri nxjerrjet e informacionit nuk ka dhënë dëshmi; në vend të kësaj, ZPS-ja u bazua në shënimet për kontaktet që u përpiluan nga punonjësit e ZPS-së, shumë prej të cilëve, gjithashtu, nuk u thirrën të dëshmonin.<sup>1168</sup> Mbrojtja e Haradinajt shtoi se nuk kishte prova se dy individët që u zhvendosën me vendbanim për shkak të nxjerrjes së informacionit ishin kërcënuar, ose se zhvendosja e tyre kishte ndonjë lidhje me çështjen gjyqësore aktuale.<sup>1169</sup> Për më tepër, Mbrojtja e Haradinajt argumentoi se z. Haradinaj nuk kishte synimin e nevojshëm, meqë ai i paralajmëroi gazetarët që të mos i publikonin emrat e dëshmitarëve dhe deklaroi se ishte i vetëdijshëm se kjo do të rrezikonte jetën e tyre.<sup>1170</sup>

## 2. Konstatimet e Trupit Gjyqësor mbi veprimin e fajshëm

557. Trupi Gjyqësor do të shqyrtojë në vijim nëse të akuzuarit përdorën kërcënimin e rëndë kundër ndonjë personi që kishte dhënë ose kishte gjasa të jepte deklaratë ose t'i jepte informacion policisë, prokurorit ose gjykatësit.<sup>1171</sup> Trupi Gjyqësor vëren se ZPS-ja nuk pretendon se të akuzuarit përdorën forcën, ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtimin e ndonjë dhurate apo ndonjë përfitimi tjetër<sup>1172</sup> dhe, për këtë arsye këto elemente alternative nuk do të trajtohen.

### (a) Kërcënimi i rëndë

558. Për të vlerësuar nëse sjellja e të akuzuarve përbënte ose kishte të bënte me kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së,<sup>1173</sup> Trupi Gjyqësor do të mbajë parasysh: (i) mënyrën se si u zbulua informacioni i mbrojtur; (ii) deklaratat e të akuzuarve lidhur me disa nga pasojat e zbulimit të tij; (iii) deklaratat e të akuzuarve

---

<sup>1168</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 165; F440, para. 90; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 116.

<sup>1169</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 170-171.

<sup>1170</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 384-385; F440, para. 165-166.

<sup>1171</sup> *Shih më lart* para. 109 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1172</sup> *Shih gjithashtu* F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 115.

<sup>1173</sup> *Shih më lart* poshtëshënimi. 182 (Dispozitat ligjore përkatëse).

lidhur me emrat e zbuluar; (iv) kontekstin në të cilin u zbulua informacioni dhe u dhanë deklaratat e të akuzuarve; dhe (v) shkallën e ndonjë kërcënimi pasues.

i) Shkalla e zbulimit

559. Të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në informacionin e mbrojtur. Të akuzuarit vunë në dukje numrin e madh të dëshmitarëve, të cilët i identifikuan duke thënë se tri grupet e dokumenteve përmbanin “emnat e të gjithë dëshmitarëve”<sup>1174</sup>, “të gjithë”<sup>1175</sup>, “aty ka prej t’gjitha viseve shqiptare, ka”<sup>1176</sup>, “shumë emra”<sup>1177</sup>, “emra të ndryshëm”<sup>1178</sup> “shumë njerëzve, shumë njerëzve këtu”<sup>1179</sup>, “ shumica e emrave të dëshmitarëve”.<sup>1180</sup>

560. Trupi Gjykues është bindur se numri i madh i identiteteve të zbuluara, së bashku me deklaratat e të akuzuarve lidhur me numrin e tyre, do t’u kenë shkaktuar frikë dhe shqetësime shumë prej atyre që i dhanë dëshmi DHS-së/ZPS-së, ose që kishin gjasë ta bënin këtë.

ii) Zbulimi publik dhe shpërndarja e gjerë

561. Të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve të lartpërmendur: (i) duke ekspozuar dhe shpërndarë tri grupet e dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp; (ii) duke përmendur publikisht dhe në mënyrë të përsëritur

<sup>1174</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj: “[...] këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë i kemi në mbrojtje.”).

<sup>1175</sup> P1, f. 4 (z. Gucati: “Në 2013 që janë marrë informacionet [...] për dëshmitare që i kanë thirrë i kanë çu në Beograd krejt.”).

<sup>1176</sup> P9, f. 6-7 (z. Gucati: “Jo, me emna nuk lëshojm [...] se un nuk e njoh gjinin [...]. aty ka prej t’gjitha viseve Shqiptare ka. E ka Serb, e ka Rom, 8 e ka Turq ...”).

<sup>1177</sup> P18, f. 3 (z. Haradinaj: “në dosjen e parë kanë pasur emra ashtu...”).

<sup>1178</sup> P35, f. 1 (z. Gucati: “Ka figura të ndryshme, emra të ndryshëm që ne s’jemi të autorizim t’i përmendim këto emna.”).

<sup>1179</sup> P35, f. 3 (z. Haradinaj: “Ka emna këtu sinë bazë të shkafit që janë ngrit ato [...] aktakuzat. [...] përmenden edhe të dhënat e shumë njerëzve këtu. Përmendet emnat e [...] përmenden emnat e shumë njerëzve, shumë njerëzve këtu”).

<sup>1180</sup> P59, f. 1 (z. Gucati: “Dosjet [...] në të cilat figurojnë shumica e emrave të dëshmitarëve.”).



se në to ishin emrat, vendbanimet aktuale dhe të mëparshme, numrat e telefonit, kombësia, vendet e intervistave dhe përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve, gjatë tri konferencave për shtyp, në paraqitjet e tjera në media dhe në postime në *Facebook*; dhe (iii) duke i lejuar ose ftuar personat e pranishëm në selinë e OVL-UÇK-së dhe në tri konferencat për shtyp që t'i këqyrnin emrat dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe, përgjithësisht, t'i lexonin, shfletonin, këqyrnin, fotografonin, filmonin ose të merrnin kopje të tri grupeve të dokumenteve ose pjesëve të tyre.<sup>1181</sup>

562. Të akuzuarit ua dhanë informacionin e mbrojtur gazetarëve duke qenë plotësisht në dijeni se përmbante emrat e dëshmitarëve që ata vetë i konsideronin se ishin të mbrojtur.<sup>1182</sup> Këtë e bënë pavarësisht nga urdhrat gjyqësorë dhe kërkesat e ZPS-së që të mos e shpërndanin atë informacion.<sup>1183</sup> Për më tepër, të akuzuarit u betuan në mënyrë të përsëritur se do të bënin publike çfarëdo dokumentesh të tjera të DHS-së/ZPS-së që do të merrnin, pa bërë dallim sa i takon përmbajtjes së atyre dokumenteve.<sup>1184</sup>

563. Gjithashtu, mënyra në të cilën u zbulua informacioni i mbrojtur çoi në shpërndarjen e 70-80% të materialit të marrë. Si rezultat, iu la rastësisë se ku dhe në duart e kujt do të përfundonte informacioni i zbuluar nga të akuzuarit.<sup>1185</sup> Deklaratat e z. Haradinaj janë domethënëse në këtë drejtim. Ai pyeti në mënyrë retorike, “si ju garantohet dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush”,<sup>1186</sup> duke theksuar kështu cenueshmërinë e dëshmitarëve si pasojë e veprimeve të tyre. Ai gjithashtu vërejti se “ato kopje tash më nuk po na i nal kërrkush” dhe se “më në Kosovë kjo dosje

---

<sup>1181</sup> *Shih më lart* para. 521 (Pika 6).

<sup>1182</sup> *Shih më lart* para. 456 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1183</sup> *Shih më lart* para. 440-441 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1184</sup> *Shih më lart* para. 481-482 (Pika 5), 530 (Pika 6).

<sup>1185</sup> *Shih më lart* para. 535 (Pika 6).

<sup>1186</sup> P1, f. 5.

mund të fshihet”.<sup>1187</sup> Ai madje pranoi se kishte siguruar që dokumentet të shpërndareshin sa më shumë që ishte e mundshme:

More nuk mund i zhdukim ata ato më kurr..! Rrini shir jan edhe 3 kopje të tjera të shpërndara dhe se ata i kan shpërnda edhe nja 10 vende ku këta 10 kan detyrë nga 3 me i shpërnda secili nga 3 tjera... Unë kam punu me rregullin e 3-shës qe....<sup>1188</sup>

564. Trupi Gjykues është bindur se këto veprime dhe deklarata krijuan mjaft publicitet sa i përket zbulimit të identiteteve të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në informacionin e mbrojtur. Gjithashtu, të akuzuarit arritën të shpërndanin gjerësisht tri grupet e dokumenteve që e përmbanin këtë informacion. Së bashku me numrin e dëshmitarëve që u zbuluan, këto veprime do të kenë kontribuar më tej në shkaktimin e frikës dhe shqetësimit tek shumë prej atyre që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t’i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së.

iii) Dëshmitarët tani “dihen” dhe nuk mund të mbrohen

565. Së bashku me zbulimin publik dhe shpërndarjen e gjerë të identiteteve të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm që përmbante informacioni i mbrojtur, të akuzuarit deklaruan shprehimisht se publiku, përfshirë dëshmitarët, tani e dinin se kush ishin ata.<sup>1189</sup>

566. Të akuzuarit gjithashtu deklaruan në mënyrë të përsëritur se DHS-ja/ZPS-ja nuk ishte në gjendje të garantonte privatësinë dhe sigurinë e atyre dëshmitarëve, duke theksuar edhe më tej cenueshmërinë e tyre. Z. Gucati vuri në dyshim se a i mbronte

---

<sup>1187</sup> P24, f. 3, 6.

<sup>1188</sup> P80, f. 1.

<sup>1189</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 3 (z. Haradinaj: “Këto shënime, këta emna, këta mbiemna, tash le ta dinë se janë emna të lexun dhe nuk po del këtu diçka që është dikush i fshehtë.”); P8, f. 30-31 (z. Haradinaj: “Ka me u rrëxu krejt. Sepse tash edhe dëshmitarët që po e dinë që po dihen”); P9, f. 6 (z. Gucati: “Po e jonja ka qën e detyrës që ne të lajmërojm.”); P11, f. 64-65 (Bashkëbiseduesi: “Po edhe secili dëshmitar që e she emnin e vet që i ka dal dika ... ai ka me llogarit, ka me lyp llogari tek Tribunali. z. Haradinaj: Jo ... ai munet me mos me i pa hiç, po ai e din që është dëshmitar, e nuk ka me i nihmu.”).

dëshmitarët e DHS-së/ZPS-së ndokush<sup>1190</sup> dhe pretendoi se DHS-ja duhej të ndiqej penalisht për rrezikimin e dëshmitarëve të vet,<sup>1191</sup> dhe se e kishte humbur të gjithë besueshmërinë si rezultat i zbulimit.<sup>1192</sup>

567. Z. Haradinaj u shpreh veçanërisht me forcë se DHS-ja nuk ishte në gjendje të mbronte dëshmitarët e vet dhe se lejoi të zbuloheshin emrat e tyre.<sup>1193</sup> Në veçanti, ai tha:

Dhe aq më keq kur i merr në qafë edhe dëshmitarët kur ju thonë qe datë jeni në mbrojtje. [...] Dhe këto shënime, këta emna, këta mbiemna, tash le ta dinë se janë emna të lexun dhe nuk po del këtu diçka qe është dikush i fshehtë.<sup>1194</sup>

568. Trupi Gjykses është bindur se këto deklarata, së bashku me zbulimin publik të emrave dhe shpërndarjen e gjerë të materialit që i përmbante ata emra, do të kenë

---

<sup>1190</sup> P9, f. 5 (z. Gucati: "Se ata e kan çu Gjykatës Speciale në Hagë, pra e kan hjek prej Kosove në Hagë për shkak të sigurisë e kan çu, un e dim, për ti mbrojt dëshmitarët, për ti mbrojt t'gjith. Edhe sot kush i mbron ndoshta këta dëshmitar, kush i mbron t'gjith këto dokumentacione.")

<sup>1191</sup> P59, f. 1.

<sup>1192</sup> P28, f. 13.

<sup>1193</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj: "Ku është logjika e mbrojtjes së dëshmitarëve për arsye e cila është kryesore, kanë thanë "jemi ka e formojmë jashtë"! Për derisa të dhëna të tyne, sekrete, me emna, mbiemna, shqiptarë, romë, serb, çdo person e ka datën kur, ne ç'vend, a marrë në pyetje [treguar këtu]?"), 5 (z. Haradinaj: "Si ju garantohet dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush, ose ku je i sigurt që ai sot nuk i shpërndan, q'ai që na i ka pru ne, nuk i qetë sot nëpër rrugë?"); P2, f. 2 (z. Haradinaj: "një absurditet i madh ku prej një institucioni ndërkombëtar dhe kaq me rëndemesë, sidomos prestigjioz, [...] [g]ljoja për ruajtjen e njerëzve e komunikatave [...] këta si përngajnë as do gjykatave të xhunglës, se le më të Kosovës. Se ata janë mundu me na fy drejtësinë tonë, por po del që ata janë nën drejtësinë tonë. Ata s'janë as në nivelin e drejtësisë tonë."); P7, f. 6 (z. Haradinaj: "Gjykata [...] ju ka premtu sekret. Do të thotë mbajtje sekreti të dosjeve. I ka shantazhu me çdo gjë. Dhe tash këta dëshmitarë për mu janë të shantazhum, këta janë të shantazhum. Këta nuk janë dëshmitarë që kanë me mujt me u përdor aty."); P8, f. 26 (z. Haradinaj: "Materiali i parë qe për me kallxu vetëm kështu. O qyqona, u budallë, o spiuna të lind, o spiuna, mos mendoni që ju mbron kush, veç ça t'u shfrytëzon, se kurrë ne bot nuk mbahet mend që e ka mbrojt dikush spiunin mbasi e ka shfrytëzu. Përkundrazi, o e ka vra, o e ka diskretitu, o e ka bo kare. Tash të presësh ti, ta tradhtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh, me fakte të armikut?"); P21, f. 5 (z. Haradinaj: "ne na ka befasu fakti se kjo Gjykate është arsyetu shumë me faktin se nga atje nuk mund të rrjedhin dhe do të mbrohen dëshmitarët. Aty ka emra të dëshmitarëve, të ish-dëshmitarëve, bash të gjithëve, ka boll."); *Shih gjithashtu* P8, f. 14; P11, f. 3; P17, f. 9; P18, f. 2, 7; P19, f. 3; P25, f. 2; P30, f. 12; P33, f. 1; P34, f. 2.

<sup>1194</sup> P1, f. 3.

shtuar frikën dhe shqetësimin e konsiderueshëm të shumë prej atyre që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së.

iv) Komentet poshtëruese dhe nënçmuese

569. Së bashku me pretendimet e tyre se dëshmitarët tani ishin të njohur dhe nuk mund të mbroheshin, të akuzuarit gjithashtu bënë komente të përsëritura poshtëruese dhe nënçmuese për ta. Këto komente nuk ishin të reja; siç do të saktësohet më poshtë, ato ishin përsëritje e komenteve të ngjashme që të akuzuarit i bënë para periudhës së Aktakuzës.

570. Së pari, të akuzuarit vunë në dyshim vërtetësinë e informacionit të dhënë nga dëshmitarët, emrat dhe dëshmitë e të cilëve ishin në informacionin e mbrojtur. Në veçanti, z. Gucati i përshkroi këta dëshmitarë si gënjeshtarë, azilkërkues ose vegla të partive politike që i kishin sajuar dëshmitë e tyre,<sup>1195</sup> duke përsëritur kështu deklaratat poshtëruese që kishte bërë para periudhës së Aktakuzës.<sup>1196</sup> Z. Haradinaj i përshkroi

<sup>1195</sup> P9, f. 11 (z. Gucati: "Un besoj që shumë ... edhe ata dëshmitar që jan bo, jan bo ndoshta për ndonjë letër me marr n'azil, me fitu në perëndim ndonjë dokumentacion, ndonjë vend qëndrim n'azil atje me fitu. [...] po, mu s'ma kan mbush shumë synin po t'thom sinqerisht."), 12 ("të çon dikë, ta qet në bonkën e të akuzuarve edhe ta gjon një Shqipfol, apo një tradhtar apo një Serb edhe del gënjen atu e t'rren, thot, që këta kan bo këto..."); P59, f. 2 ("E kemi thënë publikisht edhe më herët se [...] [disa dëshmitarë] janë nga radhët e azilkërkuesve që kanë thënë diçka sa për ta marrë statusin e azilantit, pra kan rrejt në dëshmitë e tyre kundër UÇK-së. Kurse një pjesë tjetër e dëshmitarëve janë pjesë e instrumentalizuar e partive politike të cilët i kanë cytur të bëhen dëshmitarë për shkak të rivalitetit politik.").

<sup>1196</sup> P36, f. 1 (24 qershor 2020), (z. Gucati: "Ne e dimë që kemi dëshmitarë edhe jashtë vendit tonë që kanë dalë dhe kanë gënju për me i ba një palë letra në perëndim, në Angli, apo në gjermani apo Zvicër apo. Ka me qindra kësi dëshmitar. Po në fund ata kane me pa që kanë gabu dhe kanë me ra pishman me atë arsye se e dinë që kanë me dështu me gënjeshtat e veta që i kanë bo për një palë letra t'i rregullojnë në perëndim."); P42, f. 1 (12 dhjetor 2018), (z. Gucati: "/Ma tregoni/ një rast, një krim të luftës që kemi pas mundësi që ta bëjmë. Këto janë disa të dorës së zgjatur të Serbisë, disa dëshmitarë që i unë i mendoj të fabrikuar"); P83, f. 34 (20 korrik 2019), Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* ("Për të gjitha rastet, që po ftohen pjesëtarët e UÇK-së, akuzat janë të ngritura nga Serbia dhe bashkëpunëtorët e saj."); P83, f. 59 (4 korrik 2020), Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* ("dua të them se 80% e të dënuarve nga radhët e UÇK-së që kaluan nëpër këto gjyqe dolën të pafajshëm, sepse provat dhe faktet ishin vetëm gënjeshttra, shpifje"); P83, f. 63, 65 (26 prill 2020), Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook* ("[grup i personave] të mbështetur kurdoherë nga Serbia dhe mbështetësit e saj ndërkombëtar, organizuan dhjetra e dhjetra gjyqe kundër UÇK-së, ndërtuan lloj-lloj historie kundër tyre, blenë dhe paguan më shumë se 70% të dëshmitarëve për të dëshmuar në këto procese, kjo është

këta dëshmitarë si persona që kishin dhënë dëshmi të rreme,<sup>1197</sup> që ishin “shpifje dhe të montuara”,<sup>1198</sup> edhe këto përsëritje të komenteve të bëra para periudhës së Aktakuzës.<sup>1199</sup> Të akuzuarit gjithashtu pretenduan se deklaratat ishin marrë me forcë ose nën trysni dhe rrjedhimisht nuk mund të besoheshin.<sup>1200</sup>

571. Së dyti, të akuzuarit iu referuan dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm emrat e të cilëve ishin në informacionin e mbrojtur si “spiunë”, “tradhtarë”, “kolaboracionistë” dhe “shqipfolës”. Ata i përdorën këto emërtime në mënyrë përkëmbje dhe me të njëjtin kuptim si në deklaratat e dhëna prej tyre para Aktakuzës.<sup>1201</sup>

572. Para periudhës së Aktakuzës, z. Haradinaj i kishte përshkruar “spiunët” si persona “që u paguan për të dhënë dëshmi kundër UÇK-së”.<sup>1202</sup> Në një paraqitje në media më 20 shtator 2020, z. Haradinaj i quajti dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm emrat e të cilëve ishin në grupin e parë të dokumenteve “spiuna të lind” dhe tha “të tradhtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh, me fakte të

---

e ditur publike [...] Gjykata e Hagës, Gjykata Speciale, Gjyqet vendore të cilat kanë qenë shumë më të ashpra se sa gjykata e Hagës, kanë ngritur padi ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, në të gjitha rastet mbi baza të shpifjeve dhe dëshmive të rreme”).

<sup>1197</sup> P25, f. 7 (z. Haradinaj: “ata që jepin deklarat shpifse në ngrit një aktakuzë, kurdo që të jesh, ather, bashkpuntor të Serbisë.”).

<sup>1198</sup> P8, f. 31.

<sup>1199</sup> P49, f. 13 (30 tetor 2018), (z. Haradinaj: “mos t’harrojmë se dëshmitaret kanë me i dështu atij komplet sepse dëshmitarët aq fort e kanë qetësu... keqësu gjendjen në Kosovë prej njerëzve, sa për një kërkesë të azilit, për me lypë vetëm azil kanë qenë në gjendje edhe me rrejtë. Unë veç atëherë kam përkthyer nja tridhjetë shoferë të Ibrahim RUGOVËS, m’kanë pat ardh atëherë, lypshin azil, sepse jam shoferi i Ibrahim RUGOVËS, e din. [...] Mos harro se njerëzit kanë qenë aq me probleme ekonomike. Aq keq, sa një palë letra... të ashtu quajtura jashtë diku... ai ka dhënë një deklaratë. Pra, ata... ata mendojnë që është një dëshmi. Po ka me u vërtetu shpejt se ato janë dëshmi të rreme. Ato dëshmitarët ishalla ja kanë parë hajrin letrave të paktën.”).

<sup>1200</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 2 (z. Haradinaj); P6, f. 25-26; P7, f. 5-6 (z. Tomë Gashi dhe z. Haradinaj); P8, f. 7, 31-32 (z. Haradinaj); P17, f. 2 (z. Haradinaj); P25, f. 5-6 (z. Haradinaj); P59, f. 2 (z. Gucati).

<sup>1201</sup> P37, f. 5 (24 qershor 2020), (z. Haradinaj: “çdo anti-UÇK dhe çdo bashkëpunëtor, dhe çdo kuisling, dhe çdo tradhtar është spiun, dhe çdo rob spiuni, ka me qenë pro kësaj gjykate - në këtë kuptim, të kësaj Gjykate, të këtij lloji”); P83, f. 21-22 (13 nëntor 2020), (z. Haradinaj), 59 (4 korrik 2020), (z. Gucati).

<sup>1202</sup> P83, f. 21-22 (13 nëntor 2019), Postim në profilin e z. Haradinaj në *Facebook*.

armikut”.<sup>1203</sup> Kur u pyet gjatë dhënies së dëshmisë se kujt i referohej kur fliste për “spiuna të lind”, z. Haradinaj përmendi konkretisht me emër [REDAKTUAR].<sup>1204</sup> Për më tepër, z. Haradinaj tentoi ta përshkruante deklaratën e tij si referencë historike e thënë me humor.<sup>1205</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses është bindur se përmendja konkrete nga z. Haradinaj e “paketës së parë” gjatë asaj paraqitjeje në media bën fjalë për dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm emrat e të cilëve ishin në grupin e parë të dokumenteve.

573. Para periudhës së Aktakuzës, z. Gucati e përkufizoi “bashkpuntorin” si një person që jepte dëshmi kundër ish-anëtarëve të UÇK-së,<sup>1206</sup> përfshirë edhe ata të thirrur si dëshmitarë nga DHS-ja/ZPS-ja.<sup>1207</sup> Në një paraqitje në media më 7 shtator 2020, z. Gucati deklaroi se grupi i parë i dokumenteve tregonte se “[Gjykata Speciale] është një trillim”, “është një bashkëpunim, me një rreth shqipfolësve edhe të Serbis...”.<sup>1208</sup> Z. Haradinaj përdori terma të ngjashëm dhe i përshkroi “kolaboracionistët” si “ata që jepin deklarat shpifse në ngrit një Aktakuz, kurdo që të jesh”.<sup>1209</sup> Në një paraqitje në media pas sekuestrimit të dytë, z. Haradinaj shprehu mendimin se pa kolaboracionistë DHS-ja nuk do të kishte qenë në gjendje të paraqiste aktakuza.<sup>1210</sup> Në një paraqitje tjetër në media më 20 shtator 2020, ai i përshkoi personat mbi bazën e dëshmive të të cilëve i ngriti akuzat DHS-ja si “[kriminelë, gjakpirës,] që

---

<sup>1203</sup> P8, f. 26.

<sup>1204</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2882. *Shih gjithashtu* W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1137, 1138, 1141 ku znj. Pumper konfirmoi se [REDAKTUAR] ishte në paketën 1.

<sup>1205</sup> *Shih* DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2882-2885.

<sup>1206</sup> P83, f. 59 (4 korrik 2020), Postim në profilin e z. Gucati në *Facebook*: (“[...] u ngritën aktakuza të shumta gjatë këtyre njëzet viteve të ndaj strukturave drejtuese të UÇK-së [...] U pa se gjitha gjyqet ishin të ndikuara politikisht dhe të sponsorizuara nga shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, nga Rusia, Serbia e miqtë e tyre. Pos kësaj, të gjithë dëshmitarët të cilët dëshmuuan për tu ngritur këto aktakuza ishin bashkëpunëtorë të shërbimit sekret serb apo atij ushtarak”).

<sup>1207</sup> P40, f. 2 (12 dhjetor 2018), (z. Gucati).

<sup>1208</sup> P9, f. 11.

<sup>1209</sup> P25, f. 7. *Shih gjithashtu* P17, f. 3; P30, f. 2.

<sup>1210</sup> P6, f. 14.

kan dhën urdhër ... jo vetëm që kan kry, por kanë dhënë urdhër për dhunime, vrasje, kallje, përndjekje, dhe, në një mënyrë, gjenocid total të kombit”.<sup>1211</sup> Ndonëse pretendoi se nocioni i “kolaboracionistëve” ishte thjesht një referencë historike,<sup>1212</sup> gjatë dëshmisë së tij Haradinaj konfirmoi se të akuzosh dikë se “je bashkëpunëtor i shërbimit serb’, unë mendoj nuk ka fyerje më të rëndë”.<sup>1213</sup>

574. Para periudhës së Aktakuzës, z. Gucati e përshkroi shqipfolësin si dikë që nuk “e don t’ mirën e Ushtris Çlirimtare t’ Kosovës”.<sup>1214</sup> Në një paraqitje të tij në media më 7 shtator 2020, z. Gucati iu referua dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm emrat e të cilëve ishin në grupin e parë të dokumenteve si “shqipfolsa” dhe “tradhtar t’ kombit”,<sup>1215</sup> të cilët “nuk ja dojn t’ mirën këtij veni dhe ata të cilët nuk e don t’ mirën e Ushtris Çlirimtare t’ Kosovës”.<sup>1216</sup> Kur u pyet gjatë dëshmisë se çfarë nënkuptonte me këtë term, z. Gucati tha se i referohej vetëm një personi konkret.<sup>1217</sup> Ai gjithashtu bëri të ditur se shqipfolësit ishin “ata që flasin dhe mendojnë kundër vendit tim. [...] njerëz të cilët kanë marrë pjesë nëpër ofensiva, që kanë ra që kanë masakra, kanë përdhunuar kanë djegë, kanë protestua”.<sup>1218</sup> Në mënyrë të ngjashme, para periudhës së Aktakuzës, z. Haradinaj tha se “lakejtë [...] që flasin shqip” nuk duhej të quheshin shqiptarë, po “Lakenj. Pinjollë të Titizmit, pinjollë të Rankoviqit, bashkëpunëtorë, kolonë e pestë”.<sup>1219</sup> Në postimin e një personi tjetër, që z. Haradinaj e vuri në profilin e tij në *Facebook* para periudhës së Aktakuzës, përmendej nocioni i “shqipfolsave” “shpifës”

---

<sup>1211</sup> P8, f. 7.

<sup>1212</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2811.

<sup>1213</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2749.

<sup>1214</sup> P44, f. 1 (15 janar 2019).

<sup>1215</sup> P9, f. 12.

<sup>1216</sup> P9, f. 12.

<sup>1217</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2366-2367.

<sup>1218</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2425.

<sup>1219</sup> P37, f. 8, 11 (24 qershor 2020).

ose “special” shoqëruar me terma si “ushtarë të ndyrë”, “llum” dhe “ultra-kriminelë”.<sup>1220</sup>

575. Trupi Gjykses është bindur se deklaratat e bëra nga të akuzuarit gjatë periudhës së Aktakuzës, që ata i përdorën më herët për të denoncuar, fyer dhe qortuar personat që jepnin dëshmi për krimet e pretenduara të ish-anëtarëve të UÇK-së, do të kenë kontribuar dhe do të kenë shtuar frikën dhe shqetësimin e shumë personave që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t’i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së.

v) Konteksti në lidhje me Kosovën

576. Trupit Gjykses i janë paraqitur prova mbi përpjekjet për frikësimin e dëshmitarëve në gjykime të mëparshme lidhur me pretendimet për krime të kryera nga ish-anëtarë të UÇK-së. Trupi Gjykses konsideron se nuk mund t’i vlerësojë veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve në vakum dhe se duhet të mbajë parasysh kontekstin në të cilin kanë ndodhur. Arsyeja për këtë është se diçka që mund të jetë kërcënuese në një kontekst mund të mos jetë në një kontekst tjetër. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do të vlerësojë kontekstin në të cilin u bënë zbulimet publike dhe shpërndarja e gjerë e informacionit të mbrojtur, pretendimet se dëshmitarët tashmë diheshin dhe nuk mund të mbroheshin, si dhe komentet poshtëruese të lartpërmendura.

577. Provat tregojnë për ekzistencën e një atmosfere mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, në veçanti sa u përket hetimeve/ndjekjeve penale të krimeve që u atribuohen ish-anëtarëve të UÇK-së.<sup>1221</sup> Trupi Gjykses thekson se kjo atmosferë ka sunduar me vite. Z. Rid dëshmoi se ajo pati pasoja të rënda për proceset në TPNJ

---

<sup>1220</sup> [REDAKTUAR], Postim i një personi tjetër i paraqitur në profilin e z. Haradinaj në *Facebook*, [REDAKTUAR].

<sup>1221</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3305-3313; DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3360-3361; P165, f. 5-6.



në lidhje me ndjekjen penale të ish-anëtarëve të UÇK-së.<sup>1222</sup> Gjatë dëshmisë së tij, ai konfirmoi një deklaratë të mëhershme që kishte dhënë në një intervistë:

Frikësimi i dëshmitarëve në gjykimet për Kosovën... me të vërtetë nuk kam parë kurrë më parë diçka të tillë. Kam qenë polic për 20 vjet dhe kam 23 vjet që punoj këtu, dhe kurrë nuk kam parë frikësim si ai. Ishte me të vërtetë shumë e frikshme. Dhe këtë nuk e lidh me ndonjë individ apo organizatë. Por, thjesht frika e krijuar në shoqëri, nuk kam parë të tillë – as në krim të organizuar nuk kam parë diçka të tillë.<sup>1223</sup>

578. Në këtë kontekst, z. Rid gjithashtu shpjegoi se etiketimi si dëshmitar që bashkëpunon me prokurorinë në hetimin e krimeve të pretenduara të ish-anëtarëve të UÇK-së shihej si akuzë se ishte “tradhtar i kauzës”,<sup>1224</sup> që do të ketë pasur efekt frikësues të dëshmitarët.<sup>1225</sup> Frikësimi i dëshmitarëve gjithashtu ndikoi edhe në proceset në gjykatat e Kosovës.<sup>1226</sup>

579. Për më tepër, z. Jukiq dëshmoi se ishin hartuar dy ose tri plane urgjente për menaxhimin e rrezikut në dy vitet para shtatorit 2020,<sup>1227</sup> në dukje pa ndonjë lidhje me sjelljen e të akuzuarve. Kjo dëshmi sugjeron se mbrojtja e dëshmitarëve vazhdonte të ishte problem aktual dhe kritik në Kosovë. Kjo dëshmi hedh poshtë pretendimin e Mbrojtjes se në kohën e veprave penale të pretenduara, frikësimi i dëshmitarëve në Kosovë ishte problem i së kaluarës.<sup>1228</sup> Në fakt, të akuzuarit pranuan në mënyrë të përsëritur se shqetësimet për frikësimin e dëshmitarëve ishin një nga arsyet kryesore për krijimin e DHS-së.<sup>1229</sup>

<sup>1222</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3307-3313; DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3359-3361. *Shih gjithashtu* P166, para. 6.

<sup>1223</sup> P165, f. 5.

<sup>1224</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3306.

<sup>1225</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3306-3310.

<sup>1226</sup> C2, f. 2-3.

<sup>1227</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1885-1886.

<sup>1228</sup> Transkripti, 15 mars 2022, f. 3538, 3626. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 252.

<sup>1229</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj); P9, f. 5 (z. Gucati). *Shih gjithashtu* P18, f. 7; P19, f. 3.

580. Për më tepër, dhe gjithashtu e lidhur me këtë kontekst është se të akuzuarit nuk vepruan në cilësinë e tyre si individë. Të akuzuarit deklaruan në mënyrë të përsëritur se vepronin në emër të OVL-UÇK-së.<sup>1230</sup> Ata gjithashtu bënë të qartë se, me veprimet dhe deklaratat e tyre, ata po mbronin anëtarët e OVL-UÇK-së.<sup>1231</sup> Këto veprime u miratuan bashkërisht dhe zyrtarisht me vendimin e kryesisë me 23 anëtarë të OVL-UÇK-së të 14-15 shtatorit 2020, për publikimin e materialeve të DHS-së/ZPS-së sa herë

<sup>1230</sup> P1, f. 1 (z. Gucati: "Organizata e Veteranëve të Luftës ka një lajm të jap për median edhe për qytetarët edhe për të gjithë. Edhe për politikanët e Kosovës edhe për Parlamentin e Kosovës.. [...] Ato çka ka thanë Organizata e Veteranëve do të thotë, po del e vërtetë, po del në shesh."); P6, f. 14 (z. Haradinaj: "Unë nuk po foli si privat ktu. [Gazetari] Ju jeni përfaqësuesi i veteranëve. z. Haradinaj. Si përfaqësues pra prandaj..."); P9, f. 8 (z. Gucati: "Kështu që unë besoj, ato që ka thënë Organizata e Veteranëve po del, ne e kemi dhënë që sa vite, katër, pesë vite, se jemi kundër Gjykatës Speciale, nuk jemi kundër drejtësisë, po jem kundër Gjykatës Speciale"); P29, f. 1 (z. Gucati: "po me siguri këto dosje vijnë për arsye se Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë dhe është kundër Gjykatës Speciale. [...] Dhe me siguri për këtë arsye këto dosje ne na vijnë në Organizatë të Veteranëve pse ne jemi kundër kësaj Gjykate."); 2 (z. Gucati: "Ne prapë do të veprojmë njëjtë, sikur na sot qysh kemi vepruar apo në ditët e kalume qysh kemi vepru, ne do të veprojmë, që ne do ta informojmë opinionin kosovar dhe gjithë shqiptarët mbarë rruzullit tokësor, ka janë, që do t'ju tregojmë që Gjykata Speciale është bashkëpunëtore me Gjykatën e Serbisë, me Gjykatën Supreme të Serbisë e cila bashkëpunon dhe merr materiale nga Serbia ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kështu që për ne është me rëndësi që ne t'i bindim qytetarët e Kosovës. T'ju tregojmë që kjo Gjykatë është pavlerë. Momentin kur them është "pavlerë", është duke punuar dhe bashkëpunuar me prokurorë serbë, ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."); P35, f. 4 (z. Haradinaj: "ne jemi ne cilësinë e veteraneve te luftës dhe Organizatës se Veteraneve te Luftës qe përfaqëson vetëm veteranet e luftës.").

<sup>1231</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj: "Organizata e Veteraneve te Luftës don te mbroje ose don te paktën ta qet -- është për zbulimin e krimeve."); P28, f. 3 (z. Gucati: "të paktën ju ka hije këtyne të dalin dhe të kërkojn falje para publikut dhe para qytetarve të Kosovës, dhe para veteranve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gabimin që kan bo që kan votu Gjykatën Speciale."); 4 (z. Gucati: "të kërkojn dhe të pranojn gabimin që kan bo, se gabimi qëtu mund të falet, gabimet pa qëllime gjithmonë falen, gabimet me qëllim s'falen, po të paktën të del moralisht para veteranve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po sidomos para dëshmorve, fëmijve të dëshmorve dhe para neve edhe para opinionit ton para që kta të kërkojn falje, moralisht kemi gabu, nuk e kemi kqyr [në projekt ligjin që themeloi DHS-në/ZPS-në]); P29, f. 1 (z. Gucati: "shpresoj që kjo Gjykatë të shuhet sa ma parë dhe të ndalë veprimtarinë e saj që është duke punuar ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."); P34, f. 2 (z. Haradinaj: "Ne s'na interesojnë emrat, ne na intereson anëtarësia dhe ne përfaqësojmë ata. Ne me i mbrojtë o fjala, me i mbrojtë prej të padrejtave."); P35, f. 5 (z. Haradinaj: "Edhe njëherë po thojm, nuk jam tuj mbroj emnat. Të jenë kush të dojnë! Jemi tuj mbrojt anëtarët e OVL-UÇK-së. [...] Ne jemi ka mbrojt, sepse kanë sulmuar UÇK-në në mënyrë parciale dhe po mbrojm atë shtyllën mbi te cilën janë këta ka lëvrojnë, ka çojnë gishta, edhe deputetë, edhe politika, edhe ju mediat jeni të lira."); P59, f. 1 (z. Gucati: "ne jemi për ti mbrojtur vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës").

që ato të vinin në organizatë.<sup>1232</sup> Rrjedhimisht, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve bartnin idenë se u miratuan dhe kryen në emër të një organizate që përfaqësonte mijëra persona, disa prej të cilëve mund të ishin objekt i procedimit në DHS.

581. Për këtë arsye, Trupi Gjykses është bindur se, në atmosferën e lartpërmendur të frikësimit të dëshmitarëve, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve si përfaqësues kryesorë të mijëra veteranëve të UÇK-së do të kenë kontribuar dhe rritur frikën dhe shqetësimet e shumë prej atyre që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së.

vi) Sa të rënda ishin kërcënimet

582. Frika dhe shqetësimet e rënda që shkaktuan veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve konfirmohen më tej nga provat lidhur me masat mbrojtëse që u detyrua të merrte ZPS-ja si dhe nga shqetësimet e shprehura nga dëshmitarët si rezultat i zbulimit të informacionit të mbrojtur. Trupi Gjykses thekson se për veprën penale të frikësimit sipas nenit 387 të KPK-së nuk kërkohen prova se sjellja për të cilën ngrihet akuzë të ketë pasur ndonjë ndikim të caktuar tek personi.<sup>1233</sup> Megjithatë, çdo ndikim i tillë, nëse vërtetohet, mund shërbejë si bazë për përcaktimin e nivelit dhe peshës së kërcënimit si rezultat i veprimeve dhe deklaratave të të akuzuarve.

583. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij se zbulimi i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nga të akuzuarit shkaktoi pasoja të rënda për dëshmitarët e rrezikuar brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.<sup>1234</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se nuk bëri konstatime mbi provat për të cilat Mbrojtja nuk pati mundësi të bënte pyetje, lidhur me

---

<sup>1232</sup> 1D4, para. 26; 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475.

<sup>1233</sup> *Shih më lart* para. 115 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1234</sup> *Shih më lart* para. 547.

shqetësimet e shprehura nga dëshmitarë të tjerë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se këto prova tregojnë më së paku se veprimet e të akuzuarve e detyruan ZPS-në të kontaktonte dëshmitarët dhe të vlerësonte, për disa prej tyre, nëse shkalla e rrezikut të shkaktuar e bënte të nevojshëm miratimin e masave të sigurisë në lidhje me ta.<sup>1235</sup>

584. Trupi Gjykses është bindur se këto prova konfirmojnë më tej frikën dhe shqetësimin e rëndë që do të kenë pasur shumë persona që i dhanë dëshmi ose që kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së, si pasojë e veprimeve dhe deklaratave të të akuzuarve.

vii) Përfundim

585. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së dhe do t'u kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda shumë personave që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së, që përbënte një faktor të fortë shkurajues për dhënien e informacioneve (të mëtejshme) nga këta persona lidhur me krimet që përfshihen në juridiksionin e DHS-së.

(b) Çdo person që jep ose ka të ngjarë t'i japë deklaratë ose informacion policisë ose gjykatësit

586. Trupi Gjykses konstaton se kërcënimet e rënda të shkaktuara nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve do t'u kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda shumë dëshmitarëve (*d.m.th.* personave që i dhanë dëshmi DHS-së/ZPS-së) ose dëshmitarëve të mundshëm (*d.m.th.* personave që kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së), brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së.

---

<sup>1235</sup> *Shih p.sh.* P130; P131, para. 4; P132, para. 2; P134, para. 2; P135, para. 2-4; P136, para. 3; P137, para. 1; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1693, 1703, 1705-1707, 1714-1715, 1719, 1722, 1726-1728, 1731-1732, 1751-1752, 1761-1762.

(c) Përfundim

587. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se veprimi i fajshëm i veprës penale të frikësimit sipas nenit 387 të KPK-së është vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal

588. Trupi Gjykses do të vlerësojë në vijim nëse të akuzuarit përdorën kërcënime të rënda kundër ndonjë personi që i kishte dhënë ose kishte të ngjarë t'i jepte deklaratë ose informacion policisë, prokurorit ose gjykatësit, me synimin e drejtpërdrejtë ose eventual të nxitjes së atij personi që të mos jepte deklaratë ose të jepte deklaratë të rreme ose ndryshe të mos jepte informacion të vërtetë.

589. Veprimet e të akuzuarve tregojnë se ata donin të realizonin një shpërndarje sa më të gjerë të mundshme të tri grupeve të dokumenteve. Ata i thirrën tri konferencat për shtyp për këtë qëllim – që të tria u filmuan dhe patën pjesëmarrje të gjerë. Paraqitjet e tyre të përsëritura në media gjithashtu tregojnë se ata donin t'u bënin më shumë publicitet veprimeve të tyre për zbulimin e informacionit të mbrojtur. Përmendjet e shpeshta publike të pranisë së emrave në tri grupet e dokumenteve tregojnë se ata donin të tërhiqnin vëmendjen te këta emra, edhe pse nuk i thanë konkretisht me gojën e tyre.<sup>1236</sup>

590. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses hedh poshtë mundësinë që, duke mos i përmendur shprehimisht emrat e dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm në informacionin e mbrojtur dhe duke i këshilluar gazetarët për të njëjtën gjë, të akuzuarit donin t'i mbronin këta individë. Së pari, siç u konstatua më lart, z. Haradinaj faktikisht i përmendi me emër së paku pesë nga këta dëshmitarë ose dëshmitarë të

---

<sup>1236</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj), 4 (z. Gucati), 5 (z. Haradinaj); P8, f. 11 (z. Haradinaj); P9, f. 6-7, 10 (z. Gucati); P11, f. 30 (z. Haradinaj); P18, f. 3 (z. Haradinaj); P28, f. 2 (z. Gucati), 11 (z. Gucati); P29, f. 1 (z. Gucati); P35, f. 1 (z. Gucati), 3-4 (z. Haradinaj), 13 (z. Gucati).

mundshëm.<sup>1237</sup> Së dyti, të akuzuarit nuk morën asnjëherë masa për të kufizuar zbulimin e emrave. Këtë e bënë vazhdimisht së paku deri më 22 shtator 2020. Ata nuk morën masa paraprake për të redaktuar emrat ose për të parandaluar zbulimin e dokumenteve që i përmbanin ata emra, sikurse bënë disa gazetarë.<sup>1238</sup> Përkundrazi, të akuzuarit publikuan pikërisht faktin që tri grupet e dokumenteve e përmbanin këtë informacion. Në fakt, deklaratat e tyre tregojnë qartë se të akuzuarit donin t'u përcillnin mesazh dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm që i identifikuan në informacionin e mbrojtur: e dimë se kush jeni dhe shumë të tjerë e dinë se kush jeni. Siç u shpreh z. Haradinaj:

Ai munet me mos me i pa hiç [emrin e vet], po ai e din që është dëshmitar, e nuk ka me i nihmu.<sup>1239</sup>

591. Gjithashtu, deklaratat e tyre sa i përket pamundësisë së DHS-së/ZPS-së për t'i mbrojtur dëshmitarët e tyre kishin edhe një mesazh tjetër për dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, që ata i identifikuan në informacionin e mbrojtur: tani që gjithkush e di se kush jeni, askush nuk mund t'ju mbrojë. Siç u shpreh z. Gucati:

Se ata e kan çu Gjykatës Speciale në Hag, pra e kan hjek prej Kosove në Hag për shkak të sigurisë e kan çu, un e dim, për ti mbrojt dëshmitarët, për ti mbrojt t'gjith. Edhe sot kush i mbron ndoshta këta dëshmitar, kush i mbron t'gjith këto dokumentacione?<sup>1240</sup>

592. I njëjti mesazh u përsërit edhe nga z. Haradinaj:

Si ju garantohet dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush, ose ku je i sigurt që ai sot nuk i shpërndan, q'ai që na i ka pru ne, nuk i qetë sot nëpër rrugë?<sup>1241</sup>

<sup>1237</sup> *Shih më lart* para. 520 (Pika 6).

<sup>1238</sup> *Shih* P125.1:f. 2 (1D11, f. 2, 3) pjesë nga një kërkesë e TFHS-së me emrat e redaktuar; P129, f. 1 (1D2, f. 1, 9) me fotografitë e mjegulluara të dokumenteve; P129, f. 3 (1D2, f. 20) duke iu referuar politikës së gazetës lidhur me publikimin e informacionit të ndjeshëm: "Gazeta Infokus të hënën me kujdesin më të madh ka raportuar ekskluzivisht për dosjet në fjalë, duke ruajtur konfidencialitetin dhe duke mos zbuluar asnjë të dhënë të ndjeshme të cilat gjenden brenda dokumenteve".

<sup>1239</sup> P11, f. 64-65. *Shih gjithashtu* P1, f. 3, 5 (z. Haradinaj); P8, f. 30-31 (z. Haradinaj); P9, f. 6 (z. Gucati).

<sup>1240</sup> P9, f. 5.

<sup>1241</sup> P1, f. 5. *Shih gjithashtu* P1, f. 2; P2, f. 2; P21, f. 5; P11, f. 3; P17, f. 9; P18, f. 2, 7; P30, f. 12; P33, f. 1.

593. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses hedh poshtë mundësinë që të akuzuarit donin vetëm t'i paralajmëronin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, emrat e të cilëve i gjetën në informacionin e mbrojtur, se identiteti i tyre nuk ishte më i mbrojtur. Ky sugjerim kundërshtohet nga vetë veprimet e të akuzuarve për shpërndarjen e tri grupeve të dokumenteve, pa bërë asnjë dallim sa i takonte përmbajtjes së tyre dhe pa asnjë redaktim të emrave. Ai hidhet poshtë edhe nga komentet nënçmuese të përsëritura ndaj këtyre dëshmitarëve, me pasoja konkrete në atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.<sup>1242</sup> Me fjalë të tjera: tani që shumë të tjerë e dinë se kush je, askush nuk mund të të mbrojë, sepse je “tradhtar”, “spiun”, “kolaboracionist”, “shqipfolës” që nuk “ia [do] të mirën Kosovës dhe UÇK-së”.<sup>1243</sup> Sipas z. Haradinaj:

Materiali i parë që për me kallxu vetëm kështu. O qyqona, u budallë, o spiuna të lind, o spiuna, mos mendoni që ju mbron kush, veç po ju shfrytëzon, se kurrë në botë nuk mbahet mend që e ka mbrojt dikush spiunin mbasi e ka shfrytëzu. Përkundrazi, o e ka vra, o e ka diskretitu, o e ka bo kare. Tash të presësh ti, ta tradhëtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh, me fakte të armikut?<sup>1244</sup>

594. Duke pasur parasysh aspektet e mësipërme, Trupi Gjykses gjithashtu hedh poshtë mundësinë se deklaratat e të akuzuarve kishin për qëllim vetëm të dëmtonin besueshmërinë e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm sepse kishin bashkëpunuar me DHS-në/ZPS-në. Të akuzuarit nuk u ndalën vetëm duke i quajtur dëshmitarët “gënjeshtarë” dhe duke u atribuar atyre motive të pandershme, si për shembull synimin për të fituar azil; përkundrazi, ata përdorën qëllimisht dhe vazhdimisht terma si “spiunë”, “tradhtarë”, “shqipfolsa”, duke përsëritur retorikën e njohur mirë që kishte për qëllim t'i përshkruante dëshmitarët sikur ishin kundër

---

<sup>1242</sup> *Shih më lart* para. 569-581.

<sup>1243</sup> *Shih më lart* para. 569-574.

<sup>1244</sup> P8, f. 26.

interesave të UÇK-së. Siç u vu në dukje më lart, z. Haradinaj madje pranoi gjatë dëshmisë së tij se të quhesh “bashkëpunëtor” ishte “fyerja më e rëndë” në Kosovë.<sup>1245</sup>

595. Për më tepër, Trupi Gjykses hedh poshtë mundësinë që të akuzuarit i përdorën këta terma poshtërues pa pasur dijeni për rastet e mëparshme të frikësimit të dëshmitarëve gjatë ndjekjes penale të ish-anëtarëve të UÇK-së.<sup>1246</sup> Së pari, z. Gucati pranoi gjatë dëshmisë së tij se i kishte përcjellë procedurat e TPNJ-së në çështjen *Ramush Haradinaj*, por pretendoi – në mënyrë jo të besueshme – se, për arsye personale, nuk dinte asgjë për ndërhyrjet ndaj dëshmitarëve në atë çështje.<sup>1247</sup> Së dyti, vetë të akuzuarit e lidhën krijimin e DHS-së dhe vendosjen e saj jashtë Kosovës me mbrojtjen e dëshmitarëve.<sup>1248</sup> Fakti që ata e bënë këtë për të penguar aftësinë e DHS-së/ZPS-së për të mbrojtur dëshmitarët e vet nuk përjashton se ata ishin të vetëdijshëm për ekzistencën e asaj atmosfere. Së treti, thirrjet e tyre të vazhdueshme drejtuar gazetarëve që të mos i publikonin emrat e dëshmitarëve dhe këshilla e z. Tomë Gashi për këtë, gjithashtu flisnin për vetëdijen se nxjerrja publike e emrave mund të çonte në pasoja të dëmshme për personat në fjalë.

596. Rrjedhimisht, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve tregojnë qartë se ata që u zbuluan se kishin “bashkëpunuar” me DHS-në/ZPS-në, tani rrezikoheshin të dëmtoheshin. Kjo u shoqërua me mospërfilljen e qartë e të akuzuarve për mundësinë që dëmi, në fakt, mund të ndodhte. Kur z. Gucati iu tërhoq vëmendja se “mund të

<sup>1245</sup> Transkripti, 11 janar 2022, f. 2749 (“ti akuzosh që “ti je bashkëpunëtor i shërbimit serb”, unë mendoj nuk ka fyerje më të rëndë.”).

<sup>1246</sup> P36, f. 1 (z. Gucati: “Asnjë dëshmitar nuk ka dalë deri sot në media apo dikun që të thotë që “mu më kanë kërcënu”. Unë nuk kam dëgju për vete. Qe 20 vite pas luftës që jam këtu unë nuk kam dëgju.”); DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2310-2312; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2343-2344. Z. Haradinaj, kur u pyet për postimin në profilin e Gucatit në *Facebook* dhe për dëshmitarin që pretendohet se është vrarë, konfirmoi se kishte marrë pjesë në debate [lidhur me këtë temë], *shih* Transkripti, 12 janar 2022, f. 2899.

<sup>1247</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2310-2313; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2343-2351. z. Gucati gjithashtu tentoi ta anashkalonte deklaratën e vet se dëshmitarët kundër anëtarëve të UÇK-së ishin vrarë. *Shih* Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2359-2363; P83, f. 63-67.

<sup>1248</sup> P1, f. 2; P9, f. 5; P18, f. 7; P19, f. 3; P21, f. 5.



ndodhin edhe gjëra shumë të tjera” sepse “mund t’ dalin emrat pastaj”, ai u përgjigj: “Mund të ndodhin...”.<sup>1249</sup> Z. Haradinaj tha se “unë pak e kam dert punën e atyre dëshmitarëve të Hagës”.<sup>1250</sup>

597. Ajo për të cilën të akuzuarit ishin qartësisht të shqetësuar ishte mbrojtja e të gjithë anëtarëve të OVL-UÇK-së nga çka ata e konsideronin se ishte padrejtësia e gjyqimit të tyre.<sup>1251</sup> Siç tha z. Haradinaj:

Ne na intereson anëtarësia dhe ne përfaqësojmë ata. Ne me i mbrojtë o fjala, me i mbrojtë prej të padrejtave.<sup>1252</sup>

598. Ky qëllim përfshinte mbrojtjen e anëtarëve të OVL-UÇK-së, që ata të mos dënoheshin. Sipas z. Haradinaj:

Ne kemi detyrë që Kosova të mos dënohet si kriminele dhe djemtë e Kosovës të mos dënohen si kriminelë.<sup>1253</sup>

599. Për t’i mbrojtur anëtarët e OVL-UÇK-së nga ajo që të akuzuarit e përshkruan si “padrejtësi”, DHS-ja/ZPS-ja duhej të pushonin së ekzistuari. Sipas z. Gucati:

Edhe unë shpresoj që kjo Gjykatë të shuhet sa më parë dhe të ndalë veprimtarinë e saj që është duke punuar ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.<sup>1254</sup>

600. Sipas mendimit të të akuzuarve, fara e dështimit tashmë ishte brenda punës së DHS-së/ZPS-së, sepse ajo kishte “bashkëpunuar” me autoritetet serbe dhe me dëshmitarë të cilët sipas tyre ishin, midis tjerash, “gënjeshtarë”, “azilkërkues”, “tradhtarë” ose “shqipfolsa”.<sup>1255</sup> Z. Gucati ishte i bindur për këtë shumë kohë para periudhës së Aktakuzës:

<sup>1249</sup> P9, f. 8. *Shih gjithashtu* para. 543 (Pika 6).

<sup>1250</sup> P1, f. 5. *Shih gjithashtu* P7, f. 2. *Shih gjithashtu* para. 544 (Pika 6).

<sup>1251</sup> P1, f. 2 (z. Haradinaj); P28, f. 3-4 (z. Gucati); P35, f. 2 (z. Gucati), 5 (z. Haradinaj); P59, f. 3 (z. Gucati).

<sup>1252</sup> P34, f. 2.

<sup>1253</sup> P8, f. 6.

<sup>1254</sup> P29, f. 1.

<sup>1255</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3).

Gjithmonë do të dështojë kjo Gjykatë. Arsyeja pse do të dështojnë, se këta kanë arritur të marrin disa dëshmitarë, që unë do t'i quaja në thonjëza “bashkëpunëtorë” të armikut dhe disa dëshmitarë që fare s'kanë qenë në Kosovë hiç! Kjo unë besoj që kjo Gjykatë do të dështojë.<sup>1256</sup>

601. Në këtë kontekst, të akuzuarit e panë ardhjen e tri grupeve të dokumenteve si një “mrekulli”<sup>1257</sup>, sepse “Ato ça ka thanë Organizata e Veteranëve do të thotë, po del e vërtetë, po del në shesh”<sup>1258</sup>: emrat e atyre që i konsideronin si “kolaboracionistë” ishin aty dhe më në fund mund të zbuloheshin. Sipas z. Haradinaj, personat emrat e të cilëve u zbuluan ishin “shantazhu me çdo gjë”<sup>1259</sup>, dhe kishin “ndjenjë shqetësimi”,<sup>1260</sup> “vetndjesim”<sup>1261</sup> që “për t'u duartrokitur”.<sup>1262</sup> Kjo u interpretua sikur do të çonte në shpërbërjen e DHS-së/ZPS-së:

[DHS-ja/ZPS-ja] ka me u rrëxu krejt. Çka lexova ... në bazë të cilave dëshmi u bo. Ka me u rrëxu krejt. Sepse tash edhe dëshmitaret që po e dinë që po dihen.<sup>1263</sup>

602. Rrjedhimisht, sipas mendimit të të akuzuarve, DHS-ja/ZPS-ja “nuk besoj se ka kredibilitet ma”<sup>1264</sup> sepse nuk është në gjendje “t'i ruajn dosjet e veta” dhe sepse i ka “merr në qafë”<sup>1265</sup> dëshmitarët e saj, dhe kështu “Kësaj Gjykate s'i besohet, apo sot a nesër apo masnesër”.<sup>1266</sup>

603. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se synimi i kërcënimit të rëndë që buronte nga veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve ishte që t'i bënte dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm që të mos i jepnin dëshmi (të mëtejshme) DHS-së/ZPS-së. Ky ishte mjeti për të arritur qëllimin, konkretisht, për të parandaluar kryerjen e

<sup>1256</sup> P40, f. 2 (12 dhjetor 2018).

<sup>1257</sup> P7, f. 2 (z. Haradinaj); P35, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1258</sup> P1, f. 1 (z. Gucati).

<sup>1259</sup> P7, f. 6 (z. Haradinaj).

<sup>1260</sup> P11, f. 65 (z. Haradinaj).

<sup>1261</sup> P11, f. 65 (z. Haradinaj).

<sup>1262</sup> P11, f. 65 (z. Haradinaj).

<sup>1263</sup> P8, f. 30-31.

<sup>1264</sup> P28, f. 13 (z. Gucati).

<sup>1265</sup> P1, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1266</sup> P31, f. 2 (z. Gucati).

hetimeve dhe ndjekjeve penale të efektshme të ish-anëtarëve të UÇK-së nga DHS-ja/ZPS-ja. E thënë thjesht: pa dëshmitarë nuk do të kishte gjykime; pa gjykime nuk do të kishte dënime të “djemve të Kosovës”.<sup>1267</sup>

604. Trupi Gjykues gjithashtu është bindur se deklaratat e të akuzuarve se DHS-ja/ZPS-ja nuk ishte në gjendje të mbronte dëshmitarët e saj nuk synonin vetëm të theksonin dështimet dhe paaftësinë e DHS-së/ZPS-së dhe në këtë mënyrë të diskreditonin dhe dëmtonin legjitimitetin e saj. Këto deklarata, të ndërthurura me komentet nënçmuese dhe kërcënuese të shprehura nga të akuzuarit, synonin t'i bënin dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të ndiheshin të cenueshëm. Në fakt, të gjitha veprimet dhe deklaratat e lartpërmendura të të akuzuarve ishin pjesë e vetëdijshme dhe thelbësore të kërcënimit të rëndë që ata përdorën për t'i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të mos jepnin dëshmi (të mëtejshme) për DHS-në/ZPS-në.

605. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për t'i nxitur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mbrojtur të identifikuar në informacionin e mbrojtur, që të mos i jepnin dëshmi (të mëtejshme) DHS-së/ZPS-së.

#### **4. Përfundim**

606. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e veprës penale në Pikën 3 lidhur me të dy të akuzuarit.

---

<sup>1267</sup> P8, f. 6.

## D. HAKMARRJA (PIKA 4)

### 1. Parashtrimet e palëve

607. ZPS-ja pretendoi se, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre ndërmorën ose tentuan të ndërmerrnin veprime të dëmshme kundrejt dëshmitarëve me synimin për t'u hakmarrë për dhënien ZPS-së të informacionit të vërtetë lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.<sup>1268</sup> Sipas Aktakuzës, ata e bënë këtë duke përdorur të njëjtat mjete dhe përmes të njëjtave veprime që pretendohet se kanë lidhje edhe me Pikën 3.<sup>1269</sup>

608. ZPS-ja parashtrroi se zbulimi i emrave të dëshmitarëve të mbrojtur cilësohet si veprim i dëmshëm,<sup>1270</sup> sepse të akuzuarit e bënë këtë për t'i turpëruar, demaskuar dhe izoluar ata që tashmë kishin bashkëpunuar me ZPS-në.<sup>1271</sup> ZPS-ja shtoi se veprimi që faktikisht kishte shkaktuar dëmin nuk është element i veprës penale, por megjithatë dëshmitarët ishin dëmtuar: (i) duke u ndier të shqetësuar, stresuar, kërcënuar, frikësuar dhe duke humbur besimin se ata dhe familjet e tyre do të mbroheshin;<sup>1272</sup> dhe (ii) në rastin e dy dëshmitarëve, duke u zhvendosur si rezultat i rrezikut me të cilin u përballën.<sup>1273</sup> Sipas ZPS-së të akuzuarit nuk ishin përpjekur të përcaktonin nëse informacioni ishte i vërtetë apo i rremë dhe as nuk ishin në gjendje të bënin dallimin midis personave që kishin dhënë informacion të vërtetë apo të pavërtetë nga qindra identitete që i shpërndanë.<sup>1274</sup> Për këtë arsye, ZPS-ja parashtrroi se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se dëshmitë mund të ishin të vërteta dhe synonin të hakmerreshin kundër

---

<sup>1268</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 31.

<sup>1269</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 32.

<sup>1270</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 220.

<sup>1271</sup> Transkripti, 14 mars 2022.f. 3449.

<sup>1272</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 222; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3450; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 189.

<sup>1273</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 222; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3450.

<sup>1274</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 225, 228; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3451-3452.

dëshmitarëve për dhënien e informacionit të vërtetë,<sup>1275</sup> dhe se ata ishin të vetëdijshëm që zbulimi i identitetit të dëshmitarëve do të shkaktonte shqetësime për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.<sup>1276</sup> Në Dosjen Gjyqësore Përfundimtare, ZPS-ja pretendon se ndër ata kundër të cilëve ishte kryer hakmarrje ishin edhe “autoritetet shtetërore që dhanë dokumentacion që vërtetonte krimet/kryesit përkatës ose mundësuan kontakte me ata që kishin informacion të tillë”.<sup>1277</sup>

609. Mbrojtja e Gucatit parashtroi se nuk ka prova se dëshmitarëve u ishte shkaktuar ndonjë dëm konkret, apo se u ishte shkaktuar frikë dhe kishin humbur besimin.<sup>1278</sup> Ajo shtoi se nuk ishte paraqitur asnjë provë lidhur me: (i) vërtetësinë ose pavërtetësinë e informacionit të dhënë nga ata që ishin objekt i pretenduar i hakmarrjes;<sup>1279</sup> (ii) përmbajtjen e informacionit;<sup>1280</sup> dhe (iii) bindjen e të akuzuarve se informacioni i dhënë ishte i vërtetë.<sup>1281</sup> Mbrojtja e Gucatit parashtroi se, përkundrazi, provat e vetme që u paraqitën tregojnë se të akuzuarit besonin se ishte dhënë informacion i rremë.<sup>1282</sup> Pavarësisht nga kjo, Mbrojtja e Gucatit argumentoi se pretendimi i ZPS-së se të akuzuarit mendonin se informacioni “mund të ketë qenë i vërtetë” është i pamjaftueshëm për të vërtetuar synimin kriminal të nevojshëm.<sup>1283</sup>

610. Mbrojtja e Haradinajt parashtroi se: (i) nuk ka prova për synimin e të akuzuarve për hakmarrje;<sup>1284</sup> dhe (ii) nuk ka prova se viktimat e pretenduara të hakmarrjes kishin

---

<sup>1275</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 228; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3452-3453. *Shih gjithashtu* F447, para. 52; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 192.

<sup>1276</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 229.

<sup>1277</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 221.

<sup>1278</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3641.

<sup>1279</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 62; F439, para. 70.

<sup>1280</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 62; F439, para. 70.

<sup>1281</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 63; F439, para. 71.

<sup>1282</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 63; F439, para. 71.

<sup>1283</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3641.

<sup>1284</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 203-204; F440, para. 95-98.

dhënë informacion të vërtetë.<sup>1285</sup> Mbrojtja e Haradinajt shtoi se, sa u përket dy dëshmitarëve që u zhvendosën, ZPS-ja nuk ka vërtetuar se zhvendosjet ishin rezultat i ndonjë veprimi të të akuzuarve.<sup>1286</sup>

## 2. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm

611. Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse të akuzuarit ndërmorën veprim të dëmshëm kundër cilitdo personi që i kishte dhënë policisë, hetuesit të autorizuar, prokurorit apo gjykatësit informacion lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të ndonjë vepr penale.<sup>1287</sup>

### (a) "Cilitdo personi"

612. Trupi Gjykses gjithashtu merr shënim pretendimet e ZPS-së se dëshmitarët kundër të cilëve ishte kryer hakmarrje përfshinin: (i) persona që i dhanë intervista ZPS-së ose të cilët ZPS-ja donte t'i intervistonte; dhe (ii) autoritete shtetërore që dhanë dokumentacion lidhur me krimet ose kryesit përkatës.<sup>1288</sup>

613. Sa i përket kategorisë së parë, Trupi Gjykses u bazua në përkufizimin e znj. Pumper për dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm, që ai konstatoi se ishte në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe kornizën ligjore të DHS-së.<sup>1289</sup> Mbi këtë bazë, lidhur me Pikën 6, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nën mbrojtjen e TFHS-së/ZPS-së, brenda kuptimit të nenit 392(2) të KPK-së.<sup>1290</sup> Trupi Gjykses thekson se pretendimi i ZPS-së lidhur me hakmarrjen kundër personave në kategorinë e parë bazohet në të njëjtat veprime dhe deklarata të të akuzuarve të

---

<sup>1285</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 206; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3695; F440, para. 100.

<sup>1286</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 225.

<sup>1287</sup> *Shih më lart* para. 126 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1288</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 221.

<sup>1289</sup> *Shih më lart* para. 511-512 (Pika 6).

<sup>1290</sup> *Shih më lart* para. 519-522 (Pika 6).

paraqitura në Pikat 3 dhe 6. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konsideron se konstatimet për ato pika për sa u përket numrit të personave të vënë në shënjestër, vlejné gjithashtu edhe për këtë pikë. Megjithatë, Trupi Gjykses vë në dukje se neni 388(1) të KPK-së bën fjalë vetëm për personat që kanë dhënë ose janë duke dhënë informacionin relevant, dhe jo për personat që ka të ngjarë të japin informacion në të ardhmen.

614. Sa i përket kategorisë së dytë, Trupi Gjykses vë në dukje se akuza a paraqitur në Aktakuzë u kufizua te “dëshmitarët” dhe, me gjithë përkufizimin e gjerë të tyre, ZPS-ja nuk saktësoi se nocioni përfshinte edhe “autoritetet shtetërore” që kontribuan duke u dhënë përgjigje kërkesave të TFHS-së. Rrjedhimisht, kjo kategori del jashtë kuadrin të akuzave të paraqitura nga ZPS-ja në Aktakuzë në lidhje me këtë pikë. Sidoqoftë, në lidhje me Pikën 6 Trupi Gjykses konstatoi se vetëm katër zyrtarë serbë i përmbushnin kriteret si dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm dhe se zbulimi i identitetit të kujtdo zyrtari tjetër serb përfshihej në Pikën 5.<sup>1291</sup>

615. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se termi “cilitdo personi” në Pikën 4 mbulon vetëm dëshmitarët, në kontekstin kur këta dëshmitarë i kanë dhënë TFHS-së/ZPS-së informacion lidhur me kryerjen ose kryerjen e mundshme të një krimi apo vepre penale brenda juridiksionit të DHS-së.

(b) “Veprim të dëmshëm”

616. Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar në lidhje me Pikën 3 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së dhe do t’u kenë shkaktuar frikë dhe shqetësime të rënda atyre që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t’i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së.<sup>1292</sup>

---

<sup>1291</sup> *Shih më lart* para. 514 (Pika 6).

<sup>1292</sup> *Shih më lart* para. 585 (Pika 3).

617. Trupi Gjykses arriti në këtë përfundim duke pasur parasysh: (i) shkallën e zbulimit;<sup>1293</sup> (ii) natyrën publike të zbulimit dhe shpërndarjen e gjerë të informacionit të mbrojtur, përfshirë identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm;<sup>1294</sup> (iii) deklaratat e të akuzuarve se dëshmitarët tani “dihen” dhe nuk mund të mbrohen;<sup>1295</sup> (iv) komentet poshtëruese dhe nënçmuese të të akuzuarve për dëshmitarët;<sup>1296</sup> (v) atmosferën mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë;<sup>1297</sup> (vi) faktin që të akuzuarit vepruan në emër të OVL-UÇK-së;<sup>1298</sup> dhe (vii) shkallën e rëndë të kërcënimit sikurse pasqyrohet në disa nga pasojat për dëshmitarët.<sup>1299</sup>

618. Meqenëse pretendimi për veprime të dëmshme në Pikën 4 bazohet në të njëjtat veprime dhe deklaratat e të akuzuarve të paraqitura në Pikën 3, Trupi Gjykses konsideron se konstatimet e mësipërme e vërtetojnë atë element edhe për sa i përket kësaj pike.

619. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin veprime të dëmshme brenda kuptimit të nenit 388(1) të KPK-së.

### (c) Përfundim

620. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprimi i fajshëm i veprës penale të hakmarrjes sipas nenit 388(1) të KPK-së.

---

<sup>1293</sup> *Shih më lart* para. 559-560 (Pika 3).

<sup>1294</sup> *Shih më lart* para. 561-564 (Pika 3).

<sup>1295</sup> *Shih më lart* para. 565-568 (Pika 3).

<sup>1296</sup> *Shih më lart* para. 569-575 (Pika 3).

<sup>1297</sup> *Shih më lart* para. 576-VI (Pika 3).

<sup>1298</sup> *Shih më lart* para. 580 (Pika 3).

<sup>1299</sup> *Shih më lart* para. 582-584 (Pika 3).



### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal

621. Në Pikën 3, Trupi Gjykses vuri në dukje se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve vunë në shënjestër personat që mendohej se kishin “bashkëpunuar” me DHS-në/ZPS-në.<sup>1300</sup> Për të përmbushur kriteret e synimit të hakmarrjes brenda kuptimit të nenit 388(1) të KPK-së, duhet të provohet se të akuzuarit vepruan kundër dëshmitarëve të caktuar, me dijeninë se informacioni që kishin dhënë dëshmitarët ishte i vërtetë, së paku deri në njëfarë mase.<sup>1301</sup> Për qëllimet e nenit 388(1) të KPK-së, nuk është e mjaftueshme të vërtetohet se të akuzuarit dinin që informacioni mund të ishte i vërtetë, apo se ishin indiferentë sa i përket vërtetësisë së informacionit.<sup>1302</sup>

622. Në Pikën 3, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit, bashkë me zbulimin e identitetit dhe/ose të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, vunë në dyshim publikisht vërtetësinë e dëshmimeve të tyre, duke i akuzuar se kishin gënjyer, ose i kishin sajuar dëshmitë në shkëmbim të përfitimeve, si rezultat i forcës ose trysnisë, ose sepse ishin “kolaboracionistë” ose “shqipfolës” që u shërbenin interesave të regjimit serb.<sup>1303</sup>

623. Trupi Gjykses thekson se pretendimet e të akuzuarve se dëshmitë e dëshmitarëve ishin të pavërteta nuk vërtetojnë, në vetvete, se të akuzuarit e besonin faktikisht këtë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk paraqiti prova për t'i kundërshtuar këto deklaratat dhe për të treguar se të akuzuarit, apo ndihmësit e tyre, ishin në dijeni se informacioni i dëshmitarëve ishte, së paku deri në njëfarë mase, i vërtetë.

624. Ndërsa dokumentacioni tregon se të dy të akuzuarit ishin përgjithësisht në dijeni të përmbajtjes së disa prej dëshmimeve të dëshmitarëve në informacionin e mbrojtur,<sup>1304</sup>

---

<sup>1300</sup> *Shih më lart* para. 573, 590-596 (Pika 3).

<sup>1301</sup> *Shih më lart* para. 138 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1302</sup> *Shih më lart* para. 138 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1303</sup> *Shih më lart* para. 569-575 (Pika 3).

<sup>1304</sup> *Shih më lart* para. 358-377 (Konstatime mbi paketat).

nuk ka tregues: (i) se dijenia e tyre për materialin ishte e tillë që t'u mundësonte të vlerësonin vërtetësinë e informacionit; dhe (ii) edhe nëse do të ishte ashtu, se ata i zbuluan ato dëshmi për t'u hakmarrë kundër individëve që u kishin thënë të vërtetën autoriteteve kompetente. Kjo është sidomos e vërtetë sa i përket z. Gucati, dijenia e të cilit për përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve ishte më e përgjithshme se ajo e z. Haradinaj.<sup>1305</sup> Sidoqoftë, , kjo është e vërtetë edhe sa i përket z. Haradinaj, i cili kishte dijeni më të hollësishme për tri grupet e dokumenteve dhe i cili shprehimisht identifikoi së paku pesë dëshmitarë emrat e të cilëve i kishte pikasur në informacionin e mbrojtur.

625. Gjatë konferencës së parë për shtyp, z. Haradinaj identifikoi publikisht [REDAKTUAR].<sup>1306</sup> Z. Haradinaj i përmendi me emër këta individë për të shprehur shqetësimin lidhur me bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe. Provat nuk tregojnë se z. Haradinaj i zbuloi këta emra për hakmarrje sepse këta persona kishin dhënë informacion të vërtetë. Në fakt, z. Haradinaj nuk e përmendi përmbajtjen e informacionit që këta individë mund të kenë dhënë dhe dokumentacioni nuk tregon nëse ai kishte dijeni për përmbajtjen. Përkundrazi, zbulimi i informacionit të mbrojtur u bë pa bërë dallim.

626. [REDAKTUAR], z. Haradinaj identifikoi publikisht [REDAKTUAR].<sup>1307</sup> Provat tregojnë se emri i këtij personi ishte në paketën 3 [REDAKTUAR].<sup>1308</sup> Sidoqoftë, provat nuk tregojnë se z. Haradinaj e identifikoi [REDAKTUAR] për t'u hakmarrë sepse i kishte dhënë informacion të vërtetë TFHS-së/ZPS-së. Përkundrazi, gjatë dëshmisë, z. Haradinaj e përshkroi [REDAKTUAR] si person i pavlerë,<sup>1309</sup> "i çmendun që don me i

---

<sup>1305</sup> *Shih më lart* para. 362, 365, 368, 373-374, 377 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1306</sup> P1, f. 2.

<sup>1307</sup> [REDAKTUAR].

<sup>1308</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 953; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1790-1793.

<sup>1309</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2998.

bë vetes popullaritet".<sup>1310</sup> Kur u pyet nëse kishte bërë përpjekje të përcaktonte vërtetësinë apo pavërtetësinë e asaj që kishte thënë ai person, z. Haradinaj deklaroi se nuk e kishte lexuar dokumentin për të ditur plotësisht se çfarë thuhej aty.<sup>1311</sup>

627. Gjatë dëshmisë së tij, z. Haradinaj e përshkroi [REDAKTUAR] si "spiun"<sup>1312</sup>. Asnjëri prej të akuzuarve nuk e identifikoi konkretisht këtë person si dëshmitar gjatë periudhës së Aktakuzës, por dokumentacioni tregon se [REDAKTUAR] ishte në paketën 1, [REDAKTUAR].<sup>1313</sup> Z. Haradinaj [REDAKTUAR].<sup>1314</sup> Nuk ka prova që [REDAKTUAR] mund të ketë ardhur nga ndonjë burim tjetër dhe jo nga informacioni i mbrojtur. Në çdo rast, nuk ka prova se z. Haradinaj ose z. Gucati zbuluan informacionin e mbrojtur për t'u hakmarrë kundër [REDAKTUAR] për dhënien e informacionit të vërtetë autoriteteve kompetente.

628. Përkundrazi, provat tregojnë se të akuzuarit e zbuluan informacionin e mbrojtur pa bërë dallim lidhur me përmbajtjen dhe pa konsideruar në mënyrë të individualizuar se çfarë ishte thënë nga cilido dëshmitar ose kategori dëshmitarësh. Si rrjedhim, nuk ka prova të drejtpërdrejta ose rrethanore se zbulimi i ndonjë prej emrave të lartpërmendur u bë për t'u hakmarrë kundër këtyre dëshmitarëve për dhënien e informacionit të vërtetë TFHS-së/ZPS-së.

629. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se të akuzuarit vepruan me synimin e nevojshëm në lidhje me ndonjë prej dëshmitarëve identiteti dhe të dhënat personale të të cilit u zbuluan.

---

<sup>1310</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2997.

<sup>1311</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2996.

<sup>1312</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2811-2812, 2882.

<sup>1313</sup> W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1137; [REDAKTUAR].

<sup>1314</sup> [REDAKTUAR].

#### 4. Përfundim

630. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ndonjëri prej të akuzuarve kreu veprën penale në Pikën 4 të Aktakuzës.

#### E. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË ME ANË TË KËRCËNIMIT TË RËNDË (PIKA 1)

##### 1. Parashtrimet e palëve

631. ZPS-ja pretendoi se, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre penguan ose tentuan të pengonin procedurat e DHS-së me anë të kërcënimit të rëndë.<sup>1315</sup>

632. ZPS-ja argumentoi se të akuzuarit në mënyrë të përsëritur u vunë në dispozicion informacion konfidencial dhe/ose ua përmendën përmbajtjen e tij përfaqësuesve të shtypit, teleshikuesve dhe personave të tjerë nga publiku.<sup>1316</sup> Sipas ZPS-së, të akuzuarit kërcënuan në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin shpërndarjen e informacionit lidhur me hetimet konfidenciale, përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe se do të pengonin mandatin e DHS-së/ZPS-së.<sup>1317</sup> Ata gjithashtu bënë komente nënçmuese dhe kërcënime lidhur me dëshmitarët.<sup>1318</sup>

633. ZPS-ja gjithashtu pretendon se për shkak të veprimeve të të akuzuarve, dëshmitarët u ndien të kërcënuar dhe të frikësuar dhe ZPS-ja devijoi kapacitetet dhe kohën e vet, çka vuri në rrezik aftësinë e ZPS-së për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht

---

<sup>1315</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 25; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 189; F447, para. 9; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 97.

<sup>1316</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 189; F447, para. 9, 15; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 98.

<sup>1317</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 189; F447, para. 9, 16; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 99.

<sup>1318</sup> F447, para. 9, 17; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 100.

krimet.<sup>1319</sup> ZPS-ja argumentoi se kërcënimet u bënë për t'i penguar zyrtarët e DHS-së në vazhdimin e kryerjes së hetimeve dhe procedurave penale me kërcënimin se, në të kundërtën, do të rrezikohej rëndë siguria dhe mirëqenia e dëshmitarëve.<sup>1320</sup>

634. Sipas ZPS-së, të akuzuarit: (i) synuan ta ndalonin DHS-në/ZPS-në të përmbushte mandatin e vet;<sup>1321</sup> (ii) deklaruan publikisht synimin që të pengonin punën e DHS-së/ZPS-së përmes publikimit të dokumenteve;<sup>1322</sup> (iii) shprehimisht i pranuan pasojat e mundshme të veprimeve të tyre.<sup>1323</sup>

635. Mbrojtja argumentoi se nuk ishin paraqitur prova se ZPS-ja ose zyrtarë të ZPS-së ishin penguar nga të akuzuarit në kryerjen e detyrave zyrtare, e as se ishin ose nuk ishin bërë kërcënime të rënda, të drejtpërdrejta ose tërthorta, nga të akuzuarit kundër ZPS-së apo zyrtarëve të ZPS-së.<sup>1324</sup> Mbrojtja e Gucatit i kundërshtoi pretendimet lidhur me synimin për dëmtimin e administrimit të drejtësisë nga z. Gucati.<sup>1325</sup>

## **2. Konstatimet e Trupit Gjyqësor mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale**

636. Trupi Gjyqësor do të shqyrtojë në vijim nëse të akuzuarit, me anë të kërcënimit të rëndë, penguan ose tentuan të pengonin persona zyrtarë në kryerjen e detyrave

---

<sup>1319</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 189-191; F447, para. 18; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 101. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 171, 173-174.

<sup>1320</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3457-3458. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 190.

<sup>1321</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 175-182, 193. *Shih gjithashtu* F447, para. 20-21, 27; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 102; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3453-3455.

<sup>1322</sup> F447, para. 22, 25, 28; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 104-130, 147-155, 168-172. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 183-188.

<sup>1323</sup> F447, para. 26; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 156-167.

<sup>1324</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3645-3646, 3695; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 21-24; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 65-66; F439, para. 29-32; F440, para. 24-25; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 8, 192-193, 208; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 227.

<sup>1325</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3646; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 197, 200, 202, 223, 236, 241.

zyrtare.<sup>1326</sup> Trupi Gjykues vë në dukje se ZPS-ja nuk pretendon se të akuzuarit përdorën forcën ose se detyruan persona zyrtarë të kryenin detyrat zyrtare,<sup>1327</sup> dhe rrjedhimisht këto elemente alternative nuk do të shqyrtohen. Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se formulimi i nenit 401(1) të KPK-së tregon se vepra penale kryhet kur pengimi ndodh faktikisht ose kur ai tentohet nga kryesi.<sup>1328</sup>

(a) “Personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

637. Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet se, brenda kornizës ligjore të DHS-së:

(i) “personi zyrtar” përfshin çdo person të autorizuar të veprojë në emër të DHS-së ose ZPS-së, përfshirë gjykatësin, prokurorin, hetuesin ose çdo zyrtar tjetër të DHS-së ose ZPS-së;<sup>1329</sup> dhe (ii) “detyrat zyrtare” dhe “funksionet zyrtare” kanë të bëjnë me çdo përgjegjësi ose punë të zyrtarit të DHS-së ose ZPS-së brenda kontekstit të procedurave zyrtare të DHS-së, përfshirë hetimet e ZPS-së.<sup>1330</sup>

638. Për këtë arsye, vlerësimi i Trupit Gjykues do të përqendrohet te verifikimi nëse të akuzuarit, duke përdorur kërcënim të rëndë, penguan ose tentuan të pengonin ndonjë person të autorizuar të vepronte në emër të DHS-së ose ZPS-së (“zyrtar i DHS-së/ZPS-së”) në ushtrimin e çfarëdo përgjegjësie ose pune brenda kontekstit të procedurave zyrtare të DHS-së, përfshirë hetimet e ZPS-së (“puna e DHS-së/ZPS-së”).

(b) “Kërcënim i rëndë”

639. Trupi Gjykues vë në dukje që në fillim se nuk ka prova që të akuzuarit të kenë kërcënuar drejtpërdrejt ndonjë zyrtar të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Sidoqoftë, Trupi Gjykues rikujton konstatimin e vet se neni 401 i KPK-

---

<sup>1326</sup> *Shih më lart* para. 141 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1327</sup> *Shih gjithashtu* F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 119.

<sup>1328</sup> *Shih më lart* para. 141 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1329</sup> *Shih më lart* para. 146 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1330</sup> *Shih më lart* para. 147 (Dispozitat ligjore përkatëse).

së nuk kërkon që kërcënimi i rëndë të jetë drejtuar vetëm kundër personit zyrtar dhe se kërcënimi i rëndë mund të jetë drejtuar kundër një personi ose objekti tjetër.<sup>1331</sup>

640. Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar në lidhje me Pikën 3 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 387 të KPK-së dhe do të kenë krijuar frikë dhe shqetësime të rënda te ata që i dhanë dëshmi ose kishin të ngjarë t'i jepnin dëshmi DHS-së/ZPS-së, çka mund të shërbente për t'i dekurajuar këta persona që të jepnin vullnetarisht informacion për krimet e përfshira në juridiksionin e DHS-së.<sup>1332</sup>

641. Trupi Gjykses arriti në këtë përfundim duke pasur parasysh: (i) shkallën e zbulimit;<sup>1333</sup> (ii) zbulimin publik dhe shpërndarjen e gjerë të informacionit të mbrojtur, përfshirë të identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm;<sup>1334</sup> (iii) deklaratat e të akuzuarve se dëshmitarët tani “dihen” dhe nuk mund të mbrohen;<sup>1335</sup> (iv) komentet poshtëruese dhe nënçmuese të të akuzuarve për dëshmitarët; <sup>1336</sup> (v) atmosferën mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë;<sup>1337</sup> (vi) faktin që të akuzuarit vepruan në emër të OVL-UÇK-së;<sup>1338</sup> dhe (vii) shkallën e rëndë të kërcënimit sikurse pasqyrohet në disa nga pasojat për dëshmitarët.<sup>1339</sup>

642. Meqë kërcënimi i rëndë i pretenduar në Pikën 1 bazohet në të njëjtat veprime dhe deklarata të të akuzuarve të paraqitura në Pikën 3, Trupi Gjykses konsideron se konstatimet e mësipërme e vërtetojnë atë element edhe për sa i përket kësaj pike.

---

<sup>1331</sup> *Shih më lart* para. 146 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1332</sup> *Shih më lart* para. 585 (Pika 3).

<sup>1333</sup> *Shih më lart* para. 559-560 (Pika 3).

<sup>1334</sup> *Shih më lart* para. 561-564 (Pika 3).

<sup>1335</sup> *Shih më lart* para. 565-568 (Pika 3).

<sup>1336</sup> *Shih më lart* para. 569-575 (Pika 3).

<sup>1337</sup> *Shih më lart* para. 576-VI (Pika 3).

<sup>1338</sup> *Shih më lart* para. 580 (Pika 3).

<sup>1339</sup> *Shih më lart* para. 582-584 (Pika 3).

643. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së.

(c) “Pengon”

i) Rëndësia e dëshmitarëve për procedurat penale

644. Trupi Gjykses vë në dukje që në fillim se gatishmëria dhe mundësia e dëshmitarëve për t’u paraqitur dhe për të dhënë lirisht dëshmitë e tyre janë me rëndësi kritike në procedurat penale në përgjithësi dhe në punën e DHS-së/ZPS-së në veçanti.<sup>1340</sup> Rëndësia thelbësore e dëshmitarëve për drejtësinë penale u theksua nga z. Jukiq gjatë dëshmisë së tij:

Për zyrën tonë të mbrojtjes së dëshmitarëve ky është prioriteti më i lartë. Ne e dimë nga përvoja se pa dëshmitarë nuk mund të kesh çështje gjyqësore dhe për ne, emrat e dëshmitarëve janë të prioritetit më të lartë. Pra kur them për ne, për mua, e kam fjalën për oficerët e sigurisë së dëshmitarëve.<sup>1341</sup>

645. Rrjedhimisht, çdo përpjekje për të bërë që një dëshmitar të mos i japë informacion relevant autoriteteve hetimore ose gjyqësore për një vepër penale duhet të trajtohet në një mënyrë që pasqyron rëndësinë e mbrojtjes së dëshmitarëve nga dëmtimi dhe frikësimi.<sup>1342</sup> Nevoja për t’i mbrojtur këta individë është veçanërisht e rëndësishme në

<sup>1340</sup> *Shih p.sh. Council of Europe Recommendation on Witness Protection*, Preamble: “Gjithmonë e më shumë po njihet roli i veçantë i dëshmitarëve në procese penale dhe se dëshmia e tyre shpesh është kyçe për dënimin e kryesve të krimeve, sidomos në lidhje me krimet e rënda”. *Shih gjithashtu Council of Europe Recommendation Concerning Witness Intimidation*; HRRP, *G.T. against EULEX Admissibility Decision*, para. 36 (dhe referencat e cituara). *Shih gjithashtu HRRP, F. and Others against EULEX Decision and Findings*, para. 44-45; *Nazmi Maloku against EULEX Inadmissibility Decision*, para. 24-26. *F. and Others against EULEX Decision and Findings*, para. 44-45; *Nazmi Maloku against EULEX Inadmissibility Decision*, para. 24-26.

<sup>1341</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1702. *Shih gjithashtu DW1253 (Robert Reid)*, Transkripti, 24 janar 2022, f. 3311-3313.

<sup>1342</sup> *Shih p.sh. Council of Europe Recommendation on Witness Protection*, Parathënia, ku thuhet se: “është e papranueshme që sistemi i drejtësisë penale të mos i nxjerrë të pandehurit para gjyqit dhe të mos jepet aktgjykim, për shkak se dëshmitarët faktikisht janë shkurajuar të japin dëshmi të lirë dhe të vërtetë”.



situatat pas konfliktit, si në Kosovë, sepse rreziku i frikësimit dhe hakmarrjes kundër dëshmitarëve dhe familjeve të tyre në ato situata është edhe më i madh.<sup>1343</sup>

646. Atmosfera e frikësimit të dëshmitarëve i përball dëshmitarët me rrezikun e dëmtimit dhe ka ndikim dekurajues në gatishmërinë dhe/ose aftësinë e tyre për të dëshmuar, çka dëmton përpjekjet hetimore dhe/ose prokuroriale. Kjo u konfirmua nga z. Rid:

Rrjedhja e informacionit që ka të bëjë me dëshmitarët është dyfish më e rëndë, pasi jo vetëm që ndikon në potencialin e çështjes, por ndikon edhe në psikologjinë e një dëshmitari të caktuar. Dhe nëse [...] dëshmitarët e tjerë e mësojnë këtë, kjo ndikon edhe tek dëshmitarët e tjerë.

Pra [...] nëse e marrin vesh dhjetë dëshmitarë të tjerë, kjo ka një ndikim të madh në çështje. Tani shqetësimi nuk është më vetëm për një dëshmitar. Nëse [informacioni] rrjedh dhe bëhet i njohur publikisht, atëherë bëhen dhjetë deri, të themi, 15 deri 20 dëshmitarë mbi të cilët ndikon kjo.<sup>1344</sup>

647. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konsideron se kërcënimi i rëndë kundër një apo më shumë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, në parim, mund të pengonte punën e DHS-së/ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së, sepse mund të bëhej pengesë ose t'i krijonte vështirësi ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet ose t'u pamundësonte paneleve të DHS-së që të dëgjonin dëshmi në lidhje me ato krime.

ii) Kuadri i vlerësimit në kontekstin e kësaj çështjeje

648. Ndonëse Trupi Gjykses është plotësisht i vetëdijshëm për aspektet kontekstuale, ai do t'i vlerësojë akuzat aktuale bazuar në rrethanat e kësaj çështjeje dhe provat e

---

<sup>1343</sup> *Shih p.sh. [Resolution on protection of witnesses in the Balkans](#), para. 4: "Asambleja është tejet e shqetësuar që në rajonin e ish-Jugosllavisë, disa dëshmitarë janë vvarë dhe shumë të tjerë janë frikësuar, kërcënuar ose u është zbuluar identiteti nga njerëz të vendosur që të pengojnë procesin e drejtësisë dhe të fshehin të vërtetën. Asambleja shpreh keqardhjen që, për shkak të këtyre kërcënimeve, shumë dëshmitarë në fund vendosin të mos japin dëshmi sepse kanë frikë për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre".*

<sup>1344</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3361.

përfshira në dokumentacionin gjyqësor. Rrjedhimisht dhe në vijim të provave të paraqitura nga ZPS-ja për këtë pikë,<sup>1345</sup> Trupi Gjykes do të shqyrtojë nëse provat vërtetojnë se si pasojë e veprimeve dhe deklaratave të të akuzuarve: (i) u frikësuan dëshmitarët; (ii) u kërcënua aftësia e ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet në mënyrë efektive; dhe (iii) u devijuan kapacitetet dhe koha e ZPS-së për të trajtuar pasojat faktike dhe të mundshme. Pas kësaj, Trupi Gjykes do të shqyrtojë nëse ndonjë nga këto pretendime, në qoftë se vërtetohen, përbën pengim ose tentativë për pengim brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së.

iii) Frikësimi i dëshmitarëve

649. Trupi Gjykes tashmë ka konstatuar në lidhje Pikën 6 se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve shkaktuan pasoja të rënda për dëshmitarët e rrezikuar.<sup>1346</sup> Megjithatë, Trupit Gjykes nuk i janë paraqitur prova se ndonjë prej dëshmitarëve të rrezikuar u nxit nga sjellja e të akuzuarve që të mos i jepte dëshmi DHS-së/ZPS-së.

650. Trupi Gjykes gjithashtu mori parasysh provat lidhur me frikën dhe shqetësimet e shprehura nga dëshmitarë të tjerë,<sup>1347</sup> dhe konstatoi se ato tregonin më së paku që veprimet e të akuzuarve u bënë shkas për kontaktet midis ZPS-së dhe dëshmitarëve lidhur me sigurinë e tyre.<sup>1348</sup> Trupit Gjykes gjithashtu iu paraqitën prova se së paku një dëshmitar refuzoi të komunikonte me ZPS-në pas zbulimit të emrit të tij ose të saj.<sup>1349</sup> Sidoqoftë, siç u vu në dukje më lart, ZPS-ja vendosi të mos thërriste as këtë dëshmitar dhe asnjë prej dëshmitarëve të tjerë për të dëshmuar për pasojat e veprimeve të të akuzuarve tek ta dhe bazën mbi të cilën i krijuan bindjet e tyre lidhur me ato pasoja. Rrjedhimisht, Mbrojtja nuk pati mundësi të verifikonte në mënyrë

---

<sup>1345</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 28.

<sup>1346</sup> *Shih më lart* para. 536-541, 547 (Pika 6).

<sup>1347</sup> *Shih më lart* para. 539, 541 (Pika 6).

<sup>1348</sup> *Shih më lart* para. 583 (Pika 3).

<sup>1349</sup> W04841 (Zdenka Pumper), 19 tetor 2021, f. 1012; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1703; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1905.

efektive pretendimet e këtyre dëshmitarëve. Gjithashtu, ZPS-ja nuk paraqiti prova se refuzimi i atij dëshmitari për kontakte të mëtejshme me ZPS-në pati ndonjë ndikim material në aftësinë e saj për t'i kryer detyrat në mënyrë efektive. Për këtë arsye, ashtu si për Pikën 6, Trupi Gjykses nuk do të bëjë asnjë konstatim nëse ndonjë prej këtyre dëshmitarëve u nxit që të mos i jepte më dëshmi DHS-së/ZPS-së.

iv) Ndikimi në aftësinë e ZPS-së për të hetuar dhe ndjekur penalisht krime

651. Trupi Gjykses thekson se asnjë dëshmitar nuk dëshmoi se u nxit të mos i jepte më dëshmi DHS-së/ZPS-së. Megjithatë, Trupi Gjykses pranon se marrja e dëshmisë nga një dëshmitar i cili nuk dëshiron të komunikojë me ZPS-në ose që është frikësuar nga zbulimi i informacionit të mbrojtur, mund të paraqesë vështirësi të veçanta për ZPS-në. Sidoqoftë, ZPS-ja nuk ka demonstruar asnjë pengesë konkrete dhe faktike për hetimet e saj që mund t'i atribuoheshin sjelljes së të akuzuarve.

v) Devijimi i kapaciteteve të ZPS-së

652. Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar për Pikën 6 se ZPS-ja shpenzoi kohë dhe kapacitete shtesë për të kontaktuar dhe takuar dëshmitarët e ndikuar nga zbulimi i informacionit të mbrojtur. Ndonëse nga dokumentacioni nuk është e qartë se sa kohë dhe punonjës shtesë u nevojitën për këto masa, provat tregojnë se, pa veprimet e të akuzuarve ky përdorim i kapaciteteve prokuroriale nuk do të kishte ndodhur. Shpenzimi i kohës dhe përdorimi i kapaciteteve shtesë vazhdoi deri në mes të dhjetorit 2020. Gjithashtu, siç u konstatua më lart, ZPS-ja u detyrua të merrte një numër masash sigurie në përgjigje të kërcënimit të perceptuar për dëshmitarët e rrezikuar. Për më tepër, ZPS-ja ndërmori tre operacione sekuestrimi për marrjen e paketave dhe një operacion kontrollimi dhe sekuestrimi kur u arrestuan të akuzuarit.<sup>1350</sup>

---

<sup>1350</sup> Shih më lart para. 548 (Pika 6).

653. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk ka vënë në dukje asnjë veprim që parandaloi, pengoi, vështirësoi ose vonoi kryerjen e detyrave nga zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kuadër të punës së DHS-së/ZPS-së, si rezultat i veprimeve të të akuzuarve. Gjithashtu nuk ka ndonjë të dhënë se si rezultat i devijimit të kohës dhe kapaciteteve, ZPS-ja u pengua ose vonua në kryerjen e funksioneve të zakonshme hetimore të saj.

654. Trupi Gjykses thekson gjithashtu se përdorimi i kapaciteteve nga autoritetet hetimore ose prokuroriale në përgjigje ndaj veprimtarisë kriminale që cenon punën e tyre janë veprime normale dhe të pritura. Përdorimi i këtyre kapaciteteve nuk është patjetër provë e pengimit. Në çështjen aktuale, Trupi Gjykses konsideron se përdorimi i kapaciteteve nga ZPS-ja është tregues i seriozitetit me të cilin e trajtoi ajo situatën dhe i zellit të ZPS-së për t'iu përgjigjur asaj.

655. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk mund të arrijë në përfundimin se devijimi i kapaciteteve të ZPS-së ishte aq i konsiderueshëm sa që çoi në pengimin e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.

vi) Përfundim

656. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve penguan zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së.

(d) "Tentativat për pengim"

657. Trupi Gjykses rikujton se vepra penale sipas nenit 401(1) të KPK-së mund të kryhet edhe nëse kryesi vetëm tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Siç u konstatua më lart, tentativë do të thotë që kryesi duhet të ketë filluar kryerjen e një apo më shumë elementeve materiale.<sup>1351</sup> Trupi Gjykses tashmë ka

---

<sup>1351</sup> Shih më lart para. 0 (Dispozitat ligjore përkatëse).

konstatuar se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së, që në parim mund të kishte rezultuar në pengim të zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Rrjedhimisht, të akuzuarit e përmbushën njërin nga elementet e veprimit të fajshëm të veprës penale aktuale që përbën tentativë për kryerjen e kësaj vepre penale.

(e) Përfundim

658. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se veprimi i fajshëm i veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(1) të KPK-së është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale

659. Trupi Gjykses tani do të shqyrtojë nëse të akuzuarit vepruan me synim të drejtpërdrejtë apo eventual për të penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Trupi Gjykses ka konstatuar në Pikën 3 se një prej synimeve të të akuzuarve ishte të mbronin OVL-UÇK-në nga ajo që ata e perceptonin si padrejtësi.<sup>1352</sup> Kjo përfshinte përpjekjet për të garantuar që anëtarët e OVL-UÇK-së të mos dënoheshin për krimet e pretenduara, që nënkuptonte dëmtimin apo pengimin e DHS-së/ZPS-së.<sup>1353</sup> Këto synime u shprehën në mënyrë të përsëritur nga të akuzuarit para dhe gjatë periudhës së Aktakuzës. Rrjedhimisht, të akuzuarit deklaruan në mënyrë të përsëritur se: (i) nuk e njihnin DHS-në/ZPS-në;<sup>1354</sup> (ii) ishin kundër saj;<sup>1355</sup>

---

<sup>1352</sup> *Shih më lart* para. 597, 603 (Pika 3).

<sup>1353</sup> *Shih më lart* para. 597-605 (Pika 3).

<sup>1354</sup> P5, f. 1 (z. Haradinaj: “Na, anëtarët e organizatës, nuk e njohim këtë gjykatë dhe e njohim si me mandat të skadum, në bazë të Kushtetutës tonë.”); P7, f. 3 (z. Haradinaj: “ne nuk ju njohim ju”); P18, f. 1 (z. Haradinaj: “Nuk e njohim atë Gjykatë dhe kemi me e qit.”); P21, f. 3 (z. Haradinaj: “ne nuk e njohim Gjykatën, nuk e njohim Tribunalin dhe këtë Gjykatë e Prokuror Special”).

<sup>1355</sup> P9, f. 8 (z. Gucati: “ne e kemi dhënë që sa vite, katër, pesë vite, se jemi kundër Gjykatës Speciale”), 12 (z. Gucati: “Për ne kjo ka qenë e papranueshme gjithmonë, kjo Gjykatë, kemi thënë me kohë, prapë është e

(iii) donin që ajo të shfuqizohej në mënyrë të ligjshme;<sup>1356</sup> (iv) nuk e pranonin autoritetin e saj;<sup>1357</sup> (v) donin ta turpëronin, diskreditonin dhe dëmtonin atë;<sup>1358</sup> dhe (vi) ishin të përkushtuar që të punonin për t'i arritur këto synime.<sup>1359</sup>

660. Trupi Gjykses vë në dukje që në fillim se këto deklarata dhe qëllime nuk janë të paligjshme në vetvete dhe nuk mund të konsiderohen, të marra veças, si prova të veprës penale. Megjithatë, kur këto deklarata shoqërohen me veprime të paligjshme për t'i arritur këto synime, deklaratat mund të bëhen relevante për konstatimin se të akuzuarit vepruan duke pasur qëllimin e pengimit.

661. Trupi Gjykses konstatoi në Pikën 3 se synimi i të akuzuarve për të frikësuar dëshmitarët ishte mjet për të arritur qëllimin, konkretisht, për të penguar ndjekjen penale dhe gjykimin e ish-anëtarëve të UÇK-së nga DHS-ja/ZPS-ja ose për të dëmtuar efektivitetin e këtyre përpjekjeve.<sup>1360</sup> Kërcënimi i rëndë që përdorën të akuzuarit për t'i bindur dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm që të mos i jepnin dëshmi (të

---

papranueshme.”); P42, f. 1 (12 dhjetor 2018), (z. Gucati); P43, f. 1-3 (10 dhjetor 2019), (z. Gucati); P49, f. 1-2, (31 tetor 2018), (z. Haradinaj).

<sup>1356</sup> P38, f. 1 (25 qershor 2020), (z. Haradinaj: “kërkesa jonë e parë do të jetë kështu: me e zhbërë Gjykatën”); P46, f. 1 (25 tetor 2019) (z. Gucati: “Nëse Albin Kurti arrin të zhbëjë Gjykatën Speciale, do të jetë heroi i Kosovës”); P47, f. 1 (24 qershor 2020), (z. Gucati: “do të ulemi me grupet parlamentare, do të bisedojmë me ta, se qysh mund të arrijmë deri te ndalesa e Gjykatës Speciale apo te shfuqizimi...”).

<sup>1357</sup> P26, f. 2 (z. Haradinaj: “nuk zbatoj urdhrat e kësaj Gjykate, sepse o turp për mu dhe nuk e njoh.”); P32, f. 1-2 (z. Haradinaj).

<sup>1358</sup> P2, f. 4 (z. Haradinaj: “E jonja është me e demolu, në kuptimin, jo demolim, po me e diskreditu arsyen e vërtetë të kësaj Gjykate që po thotë: ‘Jam edhe e fortë, edhe i mbaj këto, edhe kam prova të sakta.’ [...] Dhe askush s’u ka diskreditoj më fort se ajo vetveten, duke leju me iu dalë rrjedhat edhe me i dalë informatat.”); P28, f. 9 (z. Gucati: “e jemja është me çdo form me demantu Gjykatën Speciale”); P30, f. 15 (z. Haradinaj: “[Veteranët e luftës së UÇK-së] Jan kundra Gjykate, jan kon kundra Gjykate do të bëjnë çdo gjë që me e demadu kët gjykat raciste, raciale që asht selektive, politike, të gjitha të kqijat që jan për Shqiptar e për e bazune në të dhënat serbe”); P34, f. 2 (z. Haradinaj: “Ajo çka është e vërteta është se, po -- nuk a kuptimi vetëm me e diskreditu këta, sepse kjo ka qenë e diskreditume prej momentit kur u bo, por na po e qesim se po e demantojmë atë profesionalizmin e tyre...”).

<sup>1359</sup> P15, f. 1 (z. Haradinaj: “Sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund.”); P26, f. 2 (z. Haradinaj: “Ne e kemi detyr që t’punojm kundra kësaj Gjykate, ne e kemi detyr që t’mbrojm anëtarët tan, ne kët detyr e kemi.”); P39, f. 3 (30 qershor 2020), (z. Haradinaj: “kësaj Gjykate do ti vijë një fund. Ne mendojmë që do të punojmë...Organizata e Veteranëve të Luftës do të punojë edhe për zhbërjen e kësaj gjykate.”).

<sup>1360</sup> *Shih më lart* para. 603 (Pika 3).

mëtejshme) DHS-së/ZPS-së përbëhej dhe u shoqërua me një varg deklaratash; disa prej tyre u drejtuan kundër këtyre dëshmitarëve, të tjera vunë në shënjestër DHS-së/ZPS-së. Për këtë arsye, Trupi Gjykses do të shqyrtojë nëse këto deklarata, së bashku me veprimet e të akuzuarve, përbënin synim për të penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.

662. Trupi Gjykses rikujton se të akuzuarit zbuluan identitetet dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm.<sup>1361</sup> Duke bërë këtë, ata gjithashtu tërhoqën shprehimisht vëmendjen te një numër i madh emrash që i identifikuan në tri grupet e dokumenteve.<sup>1362</sup> Në këtë kontekst, të akuzuarit pretenduan se ishte detyra e tyre që të zbulonin informacionin e mbrojtur, pa bërë asnjë dallim sa i përket përmbajtjes së tij, për të zbuluar se sa “skandaloze”<sup>1363</sup> e “turpshme”<sup>1364</sup> dhe e “papurueshme”<sup>1365</sup> ishte që DHS-ja/ZPS-ja kishte “punu” me autoritetet serbe dhe me dëshmitarë jo të besueshëm, dhe që nuk i kishte mbrojtur dëshmitarët e vet. Z. Gucati deklaroi:

Interesi jonë është sa më shumë me i shpërnda në media, edhe me e bind opinionin edhe juve si media, se kjo Gjykatë është e papurueshme edhe gjithmonë kemi qenë kundër sajna.<sup>1366</sup>

663. Z. Haradinaj gjithashtu bëri të ditur se “nuk e njohim atë Gjykatë dhe kemi me e qit [dokumentet]”.<sup>1367</sup>

<sup>1361</sup> *Shih më lart* para. 522 (Pika 6).

<sup>1362</sup> *Shih më lart* para. 559 (Pika 3).

<sup>1363</sup> P1, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1364</sup> P1, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1365</sup> P4, f. 8 (z. Gucati).

<sup>1366</sup> P4, f. 8. *Shih gjithashtu* P4, f. 8 (z. Gucati: “Ne jemi të interesu me demasku këtë Gjykatë Speciale. Me ju tregu juve çdo material që na vjen neve këtu, ne do t’jua tregojmë juve se ne jemi kundër Gjykatës Speciale.”); P28, f. 9 (z. Gucati: “Po mu smë intereso kush ça ka bo, kush i ka nxjerr. Mu më interesojn që më kan ardh deri në zyre edhe e jemja është me çdo form me demantu Gjykatën Speciale dhe me tregu opinionit, e me tregu të gjithve se Gjykata Speciale punon me Prokurorin Serbe”).

<sup>1367</sup> P18, f. 1.

664. Gjatë kryerjes së “detyrës” së tyre për zbulimin e informacionit të mbrojtur, pa bërë asnjë dallim sa i përket përmbajtjes së tij, të akuzuarit gjithashtu pretenduan se veprimet e tyre tregonin se sa “e pavlerë”<sup>1368</sup> ishte DHS-ja/ZPS-ja dhe se shpërbërja e saj ishte e pashmangshme.<sup>1369</sup> Sipas të akuzuarve, kjo ishte për faktin se, pas zbulimit të informacionit të mbrojtur, shpërndarja e përmbajtjes dhe e emrave brenda tij nuk mund të ndalej, sepse tani çdokush i dinte emrat e dëshmitarëve dhe sepse DHS-ja/ZPS-ja nuk ishte në gjendje t’i mbronte dëshmitarët e vet.<sup>1370</sup> Z. Haradinaj e përshkroi DHS-në/ZPS-në si “qebaptore” ose edhe më keq,<sup>1371</sup> si “ëmbëltore”,<sup>1372</sup> “pastiçeri” serbe,<sup>1373</sup> ose “posllastiçar”<sup>1374</sup>; më zi se “gjykatat e xhunglës”;<sup>1375</sup> dhe me një gjykatës që ka bërë “zero”.<sup>1376</sup> Z. Gucati deklaroi se zbulimi i informacionit tregonte se DHS-ja/ZPS-ja “e ka marrë rrugën për të dështuar”<sup>1377</sup>, “nuk besoj se ka kredibilitet”<sup>1378</sup> dhe se “Kësaj gjykate s'i besohet, apo sot a nesër apo masnesër”.<sup>1379</sup>

665. Të akuzuarit gjithashtu theksuan se, në çdo rast, dëshmitarët të cilët DHS-ja/ZPS-ja nuk ishte në gjendje t’i mbronte ishin jo të besueshëm, sepse ishin “tradhtarë”, “spiunë”, “kolaboracionistë” dhe “shqipfolës” që autoritetet serbe ia kishin servirur DHS-së/ZPS-së.<sup>1380</sup> Sipas z. Gucati, kjo konfirmonte se DHS-ja/ZPS-ja

---

<sup>1368</sup> P29, f. 2 (z. Gucati).

<sup>1369</sup> P8, f. 30-31 (z. Haradinaj: “O, ka me u rrëxu krejt. Çka lexova, në bazë të cilave dëshmi u bo. Ka me u rrëxu krejt. Sepse tash edhe dëshmitarët që po e dinë që po dihen, që kan pas një”); P7, f. 6 (z. Haradinaj: “unë mendoj që kjo gjykatë ka marrë fund.”); P11, f. 56 (z. Haradinaj: “Edhe rrjedhja e dosjeve, diskretitim.”), 65 (z. Haradinaj: “se kjo pun ju ka ra n’uj.”).

<sup>1370</sup> *Shih më lart* para. 565-567 (Pika 3).

<sup>1371</sup> P17, f. 9; P18, f. 7; P19, f. 3; P34, f. 2.

<sup>1372</sup> P25, f. 2, 8.

<sup>1373</sup> P19, f. 3.

<sup>1374</sup> P34, f. 2.

<sup>1375</sup> P2, f. 2.

<sup>1376</sup> P7, f. 6.

<sup>1377</sup> P9, f. 11.

<sup>1378</sup> P28, f. 13.

<sup>1379</sup> P31, f. 2.

<sup>1380</sup> *Shih më lart* para. 569-574571 (Pika 3). *Shih gjithashtu* P40, f. 2 (z. Gucati: “kjo Gjykatë do të dështojë. Gjithmonë do të dështojë kjo Gjykatë. Arsyeja pse do të dështojnë, se këta kanë arritur të marrin disa



ishte “raciste”<sup>1381</sup>, “degraduese”<sup>1382</sup>, “njëetnike” dhe e “njëanshme”<sup>1383</sup>. Ai deklaroi se “bota gjer më tani nuk njeh gjykatë më të padrejtë më raciste e degraduese pos gjyqeve që kanë ndodhur në kohën e inkuizicionit”.<sup>1384</sup> Z. Haradinaj vuri në dukje se DHS-ja/ZPS-ja ishte “raciste, njëetnike, selektive”<sup>1385</sup>. Z. Haradinaj besonte se DHS-ja/ZPS-ja e kishte marrë “drejtësinë” nga (Sllobodan) Millosheviqi; ai deklaroi në mënyrë të prerë se “Ata drejtësi që merret prej MILLOSHEVIQIT, në ta dhefsha!”.<sup>1386</sup>

666. Mbi këtë bazë, të dy të akuzuarit e bënë të qartë synimin e tyre për të mos i bindur urdhrave të DHS-së/ZPS-së. Z. Gucati e bëri këtë edhe para periudhës së Aktakuzës, kur i nxiti “të gjithë shokët e mi” që të mos i përgjigjeshin fletëthirrjeve të ZPS-së.<sup>1387</sup> Gjithashtu, të dy të akuzuarit u betuan në mënyrë të përsëritur që t’i bënin publike të gjitha dokumentet e DHS-së/ZPS-së që do t’u vinin, pavarësisht nga urdhrat gjyqësorë dhe të ZPS-së që të mos e shpërndanin atë informacion.<sup>1388</sup> Pak para arrestimit, z. Haradinaj deklaroi se nuk do t’u bindej urdhrave të DHS-së/ZPS-së.<sup>1389</sup>

667. Për më tepër, të dy të akuzuarit deklaruan shprehimisht se donin t’i ndalnin ose dëmtonin procedurat e DHS-së/ZPS-së, në mënyrë që kjo gjykatë e “pavlerë” dhe e “njëanshme” të mos mund t’i ndiqte penalisht “djemtë e Kosovës”.<sup>1390</sup> Kur u pyet nëse ishte i vetëdijsëm se zbulimi i informacionit mund ta dëmtonte procesin gjyqësor, z. Haradinaj u përgjigj:

---

dëshmitarë, që unë do t’i quaja në thonjëza “bashkëpunëtorë” të armikut dhe disa dëshmitarë që fare s’ kanë qenë në Kosovë hiç! Kjo unë besoj që kjo gjykatë do të dështojë.”).

<sup>1381</sup> P4, f. 8 (z. Gucati); P40, f. 1 (12 dhjetor 2018), (z. Gucati); P59, f. 1 (z. Gucati).

<sup>1382</sup> P59, f. 1 (z. Gucati).

<sup>1383</sup> P4, f. 8 (z. Gucati), P40, f. 1 (z. Gucati); P41, f. 1 (z. Gucati); P59, f. 1 (z. Gucati).

<sup>1384</sup> P59, f. 1 (z. Gucati).

<sup>1385</sup> P21, f. 4. *Shih gjithashtu* P1, f. 2; P2, f. 3; P17, f. 1; P38, f. 1-2 (25 qershor 2020); P49, f. 2 (31 tetor 2018).

<sup>1386</sup> P18, f. 6.

<sup>1387</sup> P40, f. 1 (12 dhjetor 2018); P41, f. 1 (14 janar 2019).

<sup>1388</sup> P4, f. 3, 8; P6, f. 4, 14; P15, f. 2; P18, f. 1-2; P21, f. 3-5; P24, f. 7-8; P26, f. 4-5 (z. Haradinaj); P28, f. 7, 11, 12-13; P29, f. 2; P31, f. 2 (z. Gucati).

<sup>1389</sup> P26, f. 2.

<sup>1390</sup> P8, f. 6.

Pooo qejfi im është...po ky qejfi im është.<sup>1391</sup>

668. Ndërsa fillimisht mohoi se synonte të pengonte DHS-në/ZPS-në,<sup>1392</sup> z. Haradinaj konfirmoi gjatë dëshmisë së tij se ishte i gatshëm ta pengonte DHS-në “nëse është DHSK-ja që bazohet në të dhënat dhe idetë e Millosheviqit”.<sup>1393</sup>

669. Z. Gucati gjithashtu shprehu dëshirën që DHS-ja/ZPS-ja të shuhej,<sup>1394</sup> “e hjekum krejt”<sup>1395</sup> për “pes minuta”.<sup>1396</sup> Ai deklaroi:

Edhe unë shpresoj që kjo Gjykatë të shuhet sa më parë dhe të ndalë veprimtarinë e saj që është duke punuar ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.<sup>1397</sup>

670. Në gjykim, z. Gucati pretendoi se nuk kishte dashur që ta minonte apo shkatërronte DHS-në/ZPS-në, “po ta këshillojmë që të mos punojë me kriminelë lufte, po të punojë me njerëz që de fakto e dinë ngjarjen”.<sup>1398</sup> Ky shpjegim kundërshtohet nga provat për veprimet dhe deklaratat e z. Gucati gjatë periudhës së Aktakuzës, që nuk tregojnë asnjë tentim për ta bërë punën e DHS-së/ZPS-së më gjithëpërfshirëse, por qartësisht synonin të pengonin ndjekjen penale dhe dënimin e anëtarëve të UÇK-së.

671. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për t'i penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.

#### 4. Përfundim

672. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e formës bazë të veprës penale në Pikën 1 të

---

<sup>1391</sup> P18, f. 5.

<sup>1392</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2813-2814; 2D1, para. 130.

<sup>1393</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2877.

<sup>1394</sup> P29, f. 1.

<sup>1395</sup> P28, f. 11.

<sup>1396</sup> P28, f. 11.

<sup>1397</sup> P29, f. 1.

<sup>1398</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2433.

Aktakuzës lidhur me të dy të akuzuarit. Forma e rëndë e kësaj vepre penale diskutohet në paragrafët 711-713.

## F. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË—PËRMES VEPRIMIT TË PËRBASHKËT NË GRUP (PIKA 2)

### 1. Parashtrimet e palëve

673. ZPS-ja pretendoi se gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre, me anë të veprimeve të përbashkëta, penguan ose tentuan të pengonin procedurat e DHS-së. Z. Gucati dhe z. Haradinaj e organizuan dhe koordinuan grupin që i kreu këto veprime.<sup>1399</sup>

674. ZPS-ja parashtrroi se në grup përfshiheshin z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së.<sup>1400</sup> Sipas ZPS-së, të akuzuarit koordinuan dhe kontribuan në veprimet e grupit, së bashku me ndihmësit e tyre: (i) duke organizuar dhe drejtuar tri konferencat për shtyp, ku morën pjesë edhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së, ndër të cilët z. Klinaku dhe z. Çelë Gashi,<sup>1401</sup> (ii) duke marrë pjesë në paraqitje në media lidhur me tri dorëzimet, herë bashkë me z. Klinaku ose z. Tomë Gashi dhe herë duke shpërndarë më tej informacion konfidencial;<sup>1402</sup> (iii) duke lavdëruar publikisht, së bashku me z. Tomë Gashi, personat që kryen tri dorëzimet dhe duke mirëpritur dorëzime të tjera;<sup>1403</sup> (iv) duke kërcënuar se do të vazhdonin të shpërndanin

---

<sup>1399</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 25.

<sup>1400</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3458-3459; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 194; F447, para. 29-30; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 8(b), 173-174; F251/A01 Aktakuza, para. 25-28, 48.

<sup>1401</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3458-3459; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 195; F447, para. 33; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 175.

<sup>1402</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 195; F447, para. 33; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 175.

<sup>1403</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 196; F447, para. 34; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 176. *Shih gjithashtu* Transkripti, 14 mars 2022, f. 3460.

informacionin konfidencial, përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe të pengonin mandatin e DHS-së/ZPS-ës;<sup>1404</sup> dhe (v) duke bërë komente frikësuese dhe/ose kërcënime në lidhje me dëshmitarët.<sup>1405</sup> Gjithashtu, ZPS-ja pretendoi se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të merrnin pjesë në grup për të penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare ose, në alternativë, ishin të vetëdijshëm se si rezultat i pjesëmarrjes në këtë grup, mund të ndodhte kjo pasojë e ndaluar, dhe u pajtuan që ajo të ndodhte.<sup>1406</sup> ZPS-ja parashtrroi se synimi i anëtarëve të tjerë të grupit, konkretisht i z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi, ishte i njëjtë me atë të të akuzuarve.<sup>1407</sup> ZPS-ja gjithashtu parashtrroi se dy të akuzuarit udhëhoqën dhe organizuan grupin gjatë ndërmarrjes së këtyre veprimeve.<sup>1408</sup>

675. Mbrojtja parashtrroi se të akuzuarit nuk kishin marrë pjesë në veprim të përbashkët të një grupi për pengimin e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare dhe se të akuzuarit duhej të shpallehin të pafajshëm për Pikën 2.<sup>1409</sup> Mbrojtja argumentoi se ZPS-ja nuk kishte paraqitur prova për: (i) veprim të përbashkët ose tentativë të veprimit të përbashkët për përdorim të forcës ose kërcënimit të rëndë kundër personit zyrtar;<sup>1410</sup> (ii) pengim;<sup>1411</sup> (iii) si morën pjesë në veprën penale të pretenduar individët e tjerë që pretendohet se ishin pjesë e “grupit,”

---

<sup>1404</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 196; F447, para. 34; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 176.

<sup>1405</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 196; F447, para. 34; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 176.

<sup>1406</sup> Transkripti, 14 mars 2022, f. 3459-3460; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 197; F447, para. 35; F181/A01 Dosja Paraprake e ZPS-së, para. 177.

<sup>1407</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 194; F251/A01 Aktakuza, para. 48.

<sup>1408</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 194; F251/A01 Aktakuza, para. 48.

<sup>1409</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3646-3647; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 37; F439, para. 45; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 7-9, 15-16, 65, 350-352; F440, para. 26-27; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 32(a), 203.

<sup>1410</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3695; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 34-35; F439, para. 41-42; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 55, 60-61, 69.

<sup>1411</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 70-72, 99-100; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 207-208, 276(b).

megjithëse kundër tyre nuk u ngrit aktakuzë;<sup>1412</sup> dhe (iv) koordinim nga të akuzuarit.<sup>1413</sup>

## 2. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi veprimin e fajshëm të formës bazë të veprës penale

676. Trupi Gjykses do të shqyrtojë në vijim nëse të akuzuarit morën pjesë në një grup i cili, përmes veprimit të përbashkët, pengoi ose tentoi të pengonte personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>1414</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se, sipas formulimit të nenit 401(2) të KPK-së, vepra penale kryhet kur pengimi ndodh faktikisht ose kur tentohet nga kryesi.<sup>1415</sup>

(a) “Personi zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

677. Sikurse u vërejt në Pikën 1, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse të akuzuarit penguan ose tentuan të pengonin ndonjë zyrtar të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.<sup>1416</sup> Këto konstatime vlejné këtu *mutatis mutandis*.

(b) “Merr pjesë në një grup personash me veprim të përbashkët”

678. Provat e përfshira në dokumentacionin e çështjes gjyqësore tregojné se në zbulimin e informacionit të mbrojtur, përfshirë të identitetit dhe/ose të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, të akuzuarit nuk vepruan vetëm. Kjo është e qartë nga elementet në vijim.

679. Së pari, të akuzuarit dhe persona të tjerë ndërmorën një numër veprimesh të përbashkëta gjatë përgatitjes dhe mbajtjes së tri konferencave për shtyp dhe lidhur me

---

<sup>1412</sup> Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 104-106, 111-119; F440, para. 69-71, 74-78, 81-82.

<sup>1413</sup> F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 225.

<sup>1414</sup> *Shih më lart* para. 158 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1415</sup> *Shih më lart* para. 158 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1416</sup> *Shih më lart* para. 638 (Pika 1).

sekuestrimin e paketave nga ZPS-ja. Trupi Gjykses vëren se jo të gjitha këto veprime janë në vetvete prova të sjelljes kriminale. Megjithatë, ato pasqyrojnë natyrën e përbashkët të veprimeve të akuzuarve dhe të tjerëve dhe ndarjen e detyrave midis tyre. Në veçanti, të akuzuarit e këqyrën materialin së bashku me z. Klinaku dhe “shokë të tjerë”, d.m.th. me anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së.<sup>1417</sup> Vendimet për të thirrur tri konferencat për shtyp u morën nga kryesia e OVL-UÇK-së, ndër të cilët z. Klinaku dhe z. Çelë Gashi.<sup>1418</sup> Së paku për dy konferencat e para për shtyp, z. Gucati e udhëzoi z. Klinaku që t’i informonte mediat për to dhe t’i ftonte të merrnin pjesë.<sup>1419</sup> Në tri konferencat për shtyp, z. Gucati i drejtoi konferencat në cilësinë e kryetarit të OVL-UÇK-së, bëri komentet hyrëse për dokumentet dhe ia dha fjalën z. Haradinaj për të

<sup>1417</sup> Grupi i parë: P1, f. 1 (z. Gucati: “më shumë edhe është më i informum Nasim [Haradinaj], se Nasimi i ka hulumtu pak. Këto i ka këqyrë, i ka analizu me Fatonin [Klinikun] e me shokë të tjerë.”); 1D3, para. 13-17; 1D9, para. 14; 2D1, para. 50-51. Shih gjithashtu DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2241, 2253; DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2583-2584, 2591, 2594-2600. Grupi i dytë: 1D3, para. 34; 1D4, para. 18, 20; DW1240 (Hysni Gucati) Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2457; DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2587-2589; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2740. Grupi i Tretë: P35, f. 9 (z. Gucati: “Edhe na si kena msheh KFOR-it gjerman, i kena tregu fletë për fletë.”); 1D3, para. 46; 1D9, para. 31; 2D1, para. 102-104; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2199-2200; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2297.

<sup>1418</sup> Konferenca e parë për shtyp: 1D3, para. 17 (z. Gucati: “Anëtarët e ngushtë të kryesisë, si më lart, përkatësisht Fatoni [Klinikun], Çela [Gashi], Nasimi [Haradinaj] dhe unë dhe ndoshta 2 të tjerë kemi mbajhu një mbledhje urgjente. Duke pasur parasysh qëndrimin tonë lidhur me DHSK-në/ZPS-në, ne vendosëm se duhet ta bëjmë publik dorëzimin e dokumenteve. Ishte kjo për shkak se ne dyshuam se këto dokumente ishin nga DHSK-ja/ZPS-ja. Prandaj vendosëm të thërrasim një konferencë për shtyp.”); 2D1, para. 52. Shih gjithashtu DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2169; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727. Konferenca e dytë për shtyp: 1D3, para. 35; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190-2191 (ku z. Gucati bën të qartë se, ashtu si herën e parë, vendimi se çfarë të bëhej me materialin ishte objekt i diskutimit dhe pajtimit të anëtarëve të udhëheqjes së OVL-UÇK-së); Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410 (lidhur me z. Gucati, z. Haradinaj, z. Klinaku, z. Çelë Gashi, z. Kryeziu, dhe anëtarë të tjerë të kryesisë së ngushtë). Konferenca e tretë për shtyp: 1D3, para. 47; 2D1, para. 107; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2200; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410-2411 (ku z. Gucati pretendoi se vendimi kishte të bënte me këta persona: atë vetë, z. Haradinaj, z. Klinikun, z. Çelë Gashi, z. Kryeziu dhe ndoshta Migjen Shalën, ndonëse nuk është e qartë se çfarë roli pati ky i fundit, nëse kishte ndonjë rol, në atë vendim).

<sup>1419</sup> 1D3, para. 18; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170, 2190-2191. Shih gjithashtu 2D1, para. 56, 73; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

përshkruar përmbajtjen e tyre.<sup>1420</sup> Z. Klinaku ishte i pranishëm në konferencën e dytë për shtyp dhe në konferencën e tretë për shtyp.<sup>1421</sup> Për më tepër, dorëzimi i grupit të parë të dokumenteve ZPS-së nga z. Klinaku u autorizua nga z. Gucati.<sup>1422</sup> Z. Klinaku nënshkroi vërtetimin e dorëzimit të dokumenteve në sekuestrimin e parë.<sup>1423</sup> Z. Klinaku gjithashtu koordinoi me ZPS-në para sekuestrimit të dytë,<sup>1424</sup> gjatë të cilit ishin të pranishëm ai, z. Gucati, z. Haradinaj, anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së dhe më vonë z. Tomë Gashi.<sup>1425</sup>

680. Së dyti, më 14 ose 15 shtator 2020, kryesia e OVL-UÇK-së e përbërë nga 23 anëtarë mori vendimin që t'i publikonte materialet e DHS-së/ZPS-së sa herë që organizata t'i merrte ato.<sup>1426</sup> Të akuzuarit gjithashtu pohuan në mënyrë të përsëritur se vepronin në emër të OVL-UÇK-së.<sup>1427</sup>

681. Së treti, të akuzuarit, z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi morën pjesë në një numër paraqitjesh në media.<sup>1428</sup> Në disa raste, z. Tomë Gashi u paraqit në praninë e njërit apo të dy të akuzuarve.<sup>1429</sup> Z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi gjithashtu shprehën mendimet e tyre në një numër paraqitjesh në media, që ishin në përputhje me deklaratat e të akuzuarve.<sup>1430</sup>

---

<sup>1420</sup> P1, f. 1; P2, f. 1-2, 9; P35, f. 1-2, 14.

<sup>1421</sup> 2D1, para. 80.

<sup>1422</sup> *Shih më lart* para. 231 (Ngjarjet në fjalë), 308 (Konstatime mbi paketat). *Shih gjithashtu* 1D3, para. 28; 1D4, para. 15, 17; 2D1, para. 115; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2182-2183; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2393-2394.

<sup>1423</sup> P56; P57; P92. *Shih më lart* para. 231 (Ngjarjet në fjalë), 308 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1424</sup> P33, f. 1; 2D1, para. 81.

<sup>1425</sup> *Shih më lart* para. 257 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1426</sup> 1D4, para. 26; 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473. *Shih gjithashtu më lart* para. 242 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1427</sup> *Shih më lart* para. 580 (Pika 3). P1, f. 1; P9, f. 8; P29, f. 1-2; P35, f. 4.

<sup>1428</sup> *Shih më lart* para. 233-296 (Ngjarjet në fjalë). z. Klinaku: P13, P23; z. Tomë Gashi: P4, P7, P34.

<sup>1429</sup> P4 (z. Gucati dhe z. Tomë Gashi); P7 (z. Haradinaj dhe z. Tomë Gashi); P34 (z. Haradinaj dhe z. Tomë Gashi); P35 (z. Gucati, z. Haradinaj, me 2D1, para. 80 duke bërë të ditur se z. Klinaku ishte i pranishëm).

<sup>1430</sup> *Shih më poshtë* para. 685-691. *Shih gjithashtu më poshtë* para. 904 (Argumentet mbrojtëse).

682. Trupi Gjykues është bindur se këto veprime demonstrojnë përpjekjen e përbashkët për të zbuluar informacionin e mbrojtur. Ato gjithashtu tregojnë se të akuzuarit dhe persona të tjerë ndanë midis tyre detyrat për organizimin e tri konferencave për shtyp, paraqitjen e informacionit që përmbanin tri grupet e dokumenteve, komunikimin me ZPS-në dhe shprehjen e mendimeve të përbashkëta gjatë paraqitjeve në media. Natyra e përbashkët e mendimeve dhe veprimeve të tyre u pranua zyrtarisht në vendimin e kryesisë të 14/15 shtatorit 2020 dhe në deklaratat e tyre publike se vepronin në emër të OVL-UÇK-së.

683. Megjithatë, Trupi Gjykues thekson se veprimi i përbashkët në Pikën 2 duhet të ketë si qëllim pengimin e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Ndonëse provat e lartpërmendura tregojnë se në përpjekjet e përbashkëta për të zbuluar informacionin e mbrojtur morën pjesë edhe disa individë të tjerë përveç të akuzuarve, provat për identifikimin e tyre dhe për të përshkruar në hollësi veprimet dhe shkallën e kontributit të tyre në këto përpjekje të përbashkëta janë të pamjaftueshme.

684. Sidoqoftë, Trupi Gjykues rikujton se “grupi” duhet të përbëhet së paku nga tre persona.<sup>1431</sup> Trupi Gjykues është bindur se të dy të akuzuarit morën pjesë në përpjekjet e përbashkëta për të zbuluar informacionin e mbrojtur. Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi në Pikën 1 se të dy të akuzuarit synuan t’i pengonin zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.<sup>1432</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues është bindur se të dy të akuzuarit morën pjesë në “grup” lidhur me këtë pikë të Aktakuzës. Siç u vërejt më lart, Trupi Gjykues i shqyrton veprimet e individëve kundër të cilëve nuk është ngritur aktakuzë vetëm për aq sa është e domosdoshme për vlerësimin e

---

<sup>1431</sup> *Shih më lart* para. 161 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1432</sup> *Shih më lart* para. 671 (Pika 1).



përgjegjësishë penale të dy të akuzuarve.<sup>1433</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë vetëm nëse provat vërtetojnë pjesëmarrjen e një personi të tretë.

i) Z. Klinaku

685. Trupi Gjykses vë në dukje se sekretari i OVL-UÇK-së,<sup>1434</sup> z. Klinaku: (i) ishte i pranishëm në tri dorëzimet dhe tri sekuestrimet;<sup>1435</sup> (ii) mori pjesë në këqyrjen e tri grupeve të dokumenteve;<sup>1436</sup> (iii) mori pjesë në vendimet për mbajtjen e konferencave për shtyp dhe në vendimin e kryesisë të 14/15 shtatorit 2020;<sup>1437</sup> (iv) sipas udhëzimeve të z. Gucati, i ftoi gazetarët të merrnin pjesë në dy konferencat e para për shtyp;<sup>1438</sup> (v) ishte i pranishëm në konferencën e dytë për shtyp dhe në konferencën e tretë për shtyp;<sup>1439</sup> (vi) i dorëzoi ZPS-së paketën 1 gjatë sekuestrimit të parë dhe komunikoi me

<sup>1433</sup> *Shih më lart* para. 16 (Ndryshimet). *Shih gjithashtu* ECtHR (GJEDNJ), [Karaman Judgment](#), para. 40-44, 64.

<sup>1434</sup> 1D3, para. 18; 2D1, para. 66.

<sup>1435</sup> Dorëzimi i parë: 1D3, para. 12; 2D1, para. 47; 1D4, para. 7; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2164, 2168; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2297. Sekuestrimi i parë: 1D3, para. 28; 2D1, para. 115; 1D4, para. 15, 17; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2182-2183; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2393-2394; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2760; Transkripti, 13 janar 2022, f. 2928-2929. Dorëzimi i dytë: 1D3, para. 32-34; 2D1, para. 70-71; 1D4, para. 20; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2187, 2188-2189; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2740-2742; Sekuestrimi i dytë: 1D3, para. 40; 2D1, para. 81, 87; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2196-2197; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2761, 2764-2765. Dorëzimi i tretë dhe sekuestrimi i tretë: DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2198, 2202.

<sup>1436</sup> *Shih më lart* para. 211, 246, 276-277 (Ngjarjet në fjalë). *Shih gjithashtu* 2D1, para. 51; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2241, 2253, 2297; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 3007.

<sup>1437</sup> 1D3, para. 17, 35, 47; 1D4, para. 26; 2D1, para. 52, 73, 107; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190-2191; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>1438</sup> 1D3, para. 18; 2D1, para. 56; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170, 2190-2191; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410. *Shih gjithashtu* DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>1439</sup> P2 material filmik, minutat 00:00:11, 00:14:01-00:14:36; 2D1, para. 80; P35 material filmik, minutat 00:00:27-00:03:23.

ZPS-në para sekuestrimit të dytë;<sup>1440</sup> (vii) mori pjesë në së paku tri paraqitje në media në të cilat përshkroi informacionin e mbrojtur dhe shprehu mendime të ngjashme me ato të të akuzuarve;<sup>1441</sup> dhe (viii) ishte i pranishëm gjatë kontrollit të 25 shtatorit 2020 të selisë së OVL-UÇK-së nga ZPS-ja si përfaqësues i organizatës, i autorizuar të vepronte si i tillë nga z. Gucati.<sup>1442</sup>

686. Veprimet e z. Klinaku u miratuan nga z. Haradinaj, i cili në dy raste vuri në dukje se z. Klinaku kishte vepruar në pajtim me vendimin e kryesisë së OVL-UÇK-së.<sup>1443</sup>

687. Vetë z. Klinaku përsëriti vazhdimisht të njëjtat deklaratat dhe mendime të shprehura nga të akuzuarit. Në një paraqitje në media pak para sekuestrimit të parë, z. Klinaku shpjegoi se OVL-UÇK-ja u kishte dhënë mediave kopje të grupit të parë të dokumenteve dhe i kishte këshilluar që “t’i shumëzoni t’i merrni të gjithë [dokumentet]” sepse “Gjykata Speciale për neve është inekzistente dhe ne nuk e kemi pranuar as atëherë, as nuk e pranojmë as sot”.<sup>1444</sup> Gjatë së njëjtës intervistë, ai vuri në dukje se DHS-ja/ZPS-ja “Dokumentacionet nuk duhet me i mbajt sekrete”.<sup>1445</sup> Më 10 shtator 2020, në një paraqitje tjetër në media, z. Klinaku deklaroi se:

Kësaj Gjykatës Speciale ne nuk i besojmë sepse ma shumë merret me dëshmi që i jep pushtuesi serb. Dhe, për neve, dëshmitë që i marrin nga pushtuesi serb, ato nuk janë valide për ne.<sup>1446</sup>

<sup>1440</sup> P56; P57; P89, para. 10; P92, para. 7. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 66-67; P33, f. 1 (z. Haradinaj: “Po de, ne po presim simbas thirrjes që i kanë bo Sekretarit tonë, mbrëmë mbas orës 18:40 minuta diku, që kanë kërkuar dosjet... Dhomave të Specializuara dhe kanë kërkuar që mbrëmë me jau dorëzu ato.”).

<sup>1441</sup> P13; P22; P23.

<sup>1442</sup> 1D3, para. 55.

<sup>1443</sup> P6, f. 3 (z. Haradinaj: “Sekretari ju ka përgjigj adekuat konform vendimit të kryesisë të ngushtë që e kemi marr sepse ne kemi një kryesi të ngushtë që e mbajm ku pastaj na mbështet edhe kryesia e gjerë që na ka mbështet në mbledhjen se edhe ata dashtën me i përgju. Dhe kemi thënë se ne ato nuk i dorëzojmë o pa praninë e ndonjë organi shtetëror tonin o pa praninë e një avokati.”); P33, f. 1 (z. Haradinaj: “Sekretari ja ka bo shumë të qartë për vendimin që ka marr Shoqata. Ne kemi marr vendim sepse në fund të fundit kjo Gjykatë ne nuk e njohim, përpos që s’e kemi njoh prej fillimit”).

<sup>1444</sup> P13, f. 1.

<sup>1445</sup> P13, f. 1.

<sup>1446</sup> P22, f. 1.

688. Kjo deklaratë më vonë u lavdërua nga z. Haradinaj.<sup>1447</sup>

689. Më 24 shtator 2020, në një paraqitje tjetër në media, z. Klinaku refuzoi të pranonte se të akuzuarit dhe ai kishin zbuluar emra të dëshmitarëve.<sup>1448</sup> Kur i thanë se duhej të ndiqej penalisht për “ndërhyje në proces, për zbulim të dëshmitarëve, për presion”, z. Klinaku u përgjigj: “I ka zbulu gjykata, pseudo-Gjykata Speciale i ka zbulu që bashkëpunon me Serbinë. I kan dal dosjet nga zyrat”.<sup>1449</sup>

690. Trupi Gjykues është bindur se veprimet dhe deklaratat e z. Klinaku tregojnë se ai veproi së bashku me dy të akuzuarit, duke përsëritur shprehimisht mendimet e tyre dhe duke ushtruar funksione që kishin lidhje me përpjekjen e tyre të përbashkët. Rrjedhimisht, këto veprime demonstrojnë se z. Klinaku dhe dy të akuzuarit morën pjesë në një grup që funksionoi përmes veprimit të përbashkët, që në parim mund të kishte rezultuar në pengimin e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.

ii) Z. Tomë Gashi

691. Trupi Gjykues vëren se ka prova që z. Tomë Gashi mori pjesë, si avokat i OVL-UÇK-së, në përpjekjet e përbashkëta për zbulimin e informacionit të mbrojtur. Megjithatë, pasi përcaktoi se dy të akuzuarit dhe z. Klinaku përbënin grup brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së, nuk është e nevojshme që Trupi Gjykues të përcaktojë nëse veprimet dhe deklaratat e z. Tomë Gashi do të përmbushnin kriteret që ai të konsiderohej si anëtari i katërt i atij grupi.

---

<sup>1447</sup> P60, f. 23-24 (z. Haradinaj: “Bravo, Faton!”).

<sup>1448</sup> P23, f. 6 (z. Klinaku: “Kush ua ka publiku emrat?? [Bashkëbiseduesi]: Ju. Ju keni shpërnda – z. Klinaku: Emrat e kujt?? [Bashkëbiseduesi]: Ju keni shpërnda, ju keni shpërnda dokumente sa keni mujt. z. Klinaku: VUKÇEVIQIT a? VUKÇEVIQIT ja kam publiku emrin, a? [Bashkëbiseduesi]: Krejt. Krejt keni publiku. z. Klinaku: Mos ja fut kot. S’ka publiku kush emrat. [Bashkëbiseduesi]: Krejt. Krejt”).

<sup>1449</sup> P23, f. 7.

## (c) "Pengon"

692. Trupi Gjykues konstatoi në Pikën 1 se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte që veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve i penguan zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së.<sup>1450</sup> Meqenëse pengimi i pretenduar në Pikën 1 bazohet në të njëjtat veprime dhe deklarata të të akuzuarve të paraqitura në Pikën 2, Trupi Gjykues konsideron se konstatimet e lartpërmendura vlejné edhe për këtë pikë.<sup>1451</sup>

693. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve penguan zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së.

## (d) "Tentativa për pengim"

694. Trupi Gjykues rikujton se vepra penale sipas nenit 401(2) të KPK-së mund të kryhet edhe nëse pengimi vetëm është tentuar.<sup>1452</sup>

695. Siç u konstatua më lart, tentativë do të thotë që kryesi duhet të ketë filluar kryerjen e një ose më shumë elementeve materiale.<sup>1453</sup> Trupi Gjykues tashmë ka konstatuar se të akuzuarit morën pjesë në veprimin e përbashkët të grupit, brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së,<sup>1454</sup> që në parim mund të ketë rezultuar në pengimin e zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Rrjedhimisht, të akuzuarit përmbushën njërin nga elementet e veprimit të fajshëm të kësaj vepre penale.

696. Për këto arsye, Trupi Gjykues konstaton se pjesëmarrja e të akuzuarve në veprimin e përbashkët të grupit përbënte tentativë të pengimit të zyrtarëve të DHS-

---

<sup>1450</sup> *Shih më lart* para. 656 (Pika 1).

<sup>1451</sup> *Shih më lart* para. 649-655 (Pika 1).

<sup>1452</sup> *Shih më lart* para. 158 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1453</sup> *Shih më lart* para. 201 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>1454</sup> *Shih më lart* para. 678-691.

së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së.

(e) Përfundim

697. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprimi i fajshëm i veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(2) të KPK-së.

### **3. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal të formës bazë të veprës penale**

698. Trupi Gjykses konstatoi në Pikën 1 se të akuzuarit vepruan me vetëdijen dhe dëshirën që të pengonin zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.<sup>1455</sup> Meqenëse synimi për pengim i pretenduar në Pikën 1 bazohet në të njëjtat veprime dhe deklarata të të akuzuarve të paraqitura në Pikën 2, Trupi Gjykses konsideron se konstatimet e lartpërmendura vlejné edhe për këtë pikë, në lidhje me dy të akuzuarit.<sup>1456</sup>

699. Gjithashtu, veprimet e përshkruara në paragrafët 678-683 demonstrojnë se të dy të akuzuarit synuan të merrnin pjesë në veprimin e përbashkët të grupit për të arritur qëllimet e tyre penguese. Në veçanti, veprimet e bashkërenduara dhe ndarja e detyrave lidhur me organizimin e tri konferencave për shtyp, paraqitjen e informacionit që përmbanin tri grupet e dokumenteve, komunikimin me ZPS-në dhe shprehjen e mendimeve të përbashkëta gjatë paraqitjeve në media tregojné synimin e qartë për të marrë pjesë në veprimin e përbashkët të grupit. Ky synim konfirmohet më tej nga vendimi i kryesisë i 14/15 shtatorit 2020 dhe deklaratat e përsëritura të të akuzuarve se vepronin si përfaqësues të OVL-UÇK-së.<sup>1457</sup>

---

<sup>1455</sup> *Shih më lart* para. 671 (Pika 1).

<sup>1456</sup> *Shih më lart* para. 659-670 (Pika 1).

<sup>1457</sup> *Shih më lart* para. 680.

700. Sa i përket z. Klinaku, Trupi Gjykses vë në dukje se veprimet dhe deklaratat e tij të përshkruara në paragrafët 686-690 tregojnë përputhje të mendimeve me të akuzuarit. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se z. Klinaku i bëri deklaratat në funksionin e tij si sekretar i OVL-UÇK-së dhe shprehimisht bëri të ditur se vepronte nën autoritetin e z. Gucati.<sup>1458</sup> Kjo tregon vendosmërinë e tij për të marrë pjesë në veprimin e përbashkët të grupit që përfshinte dy të akuzuarit. Z. Klinaku gjithashtu e mbështeti shprehimisht zbulimin e informacionit të mbrojtur,<sup>1459</sup> bëri të ditur mosbesimin e tij për DHS-në/ZPS-në,<sup>1460</sup> dhe theksoi "skandalin" e DHS-së/ZPS-së për rrjedhjen e dokumentacionit kur u përball me kritika se kishte "çu mesazh të kërcënimit të dëshmitarëve" dhe "të ndërhyrjes në proces gjyqësor".<sup>1461</sup> Trupi Gjykses gjithashtu është bindur se veprimet dhe deklaratat e z. Klinaku tregojnë se, më së paku, ai veproi me vetëdijen se si pasojë e pjesëmarrjes në grup me të akuzuarit dhe përmes veprimit të përbashkët mund të ndodhte pengimi i zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së, dhe u pajtua që kjo të ndodhte. Sidoqoftë, Trupi Gjykses thekson se përfundimet e lartpërmendura nuk përbëjnë konstatim për fajësi të z. Klinaku.<sup>1462</sup> Ato janë përfundime të domosdoshme për vlerësimin e përgjegjësisë penale të dy të akuzuarve.

701. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit vepruan në grup me vetëdije dhe dëshirë dhe me anë të veprimit të përbashkët, për t'i penguar zyrtarët e DHS-së/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së.

---

<sup>1458</sup> P13, f. 1.

<sup>1459</sup> P13, f. 1.

<sup>1460</sup> P22, f. 1.

<sup>1461</sup> P23, f. 2.

<sup>1462</sup> *Shih më lart* para. 16 (Akuzat).

#### 4. Konstatimet e Trupit Gjykses mbi formën e rëndë të veprës penale

702. Trupi Gjykses rikujton se neni 401(3) të KPK-së penalizon dhe ZPS-ja argumenton formën e rëndë për udhëheqësin ose organizatorin e grupit që kryen veprën penale sipas nenit 401(2) të KPK-së. Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja argumenton formën e rëndë në lidhje me të dy të akuzuarit.<sup>1463</sup>

703. Trupi Gjykses konstatoi më lart se grupi, brenda kuptimit të nenit 401(2) të KPK-së, përbëhej së paku nga z. Gucati, z. Haradinaj dhe z. Klinaku ("grupi"). Trupi Gjykses gjithashtu vuri në dukje edhe deklaratat e përsëritura të të akuzuarve se ata vepronin në emër të OVL-UÇK-së,<sup>1464</sup> dhe fjalët e z. Klinaku që tregonin se kishte vepruar sipas udhëzimeve të z. Gucati.<sup>1465</sup>

704. Brenda OVL-UÇK-së, z. Gucati ishte, *de jure*, udhëheqësi i organizatës si kryetari i saj.<sup>1466</sup> Z. Haradinaj ishte një prej dy zëvendëskryetarëve.<sup>1467</sup> Autoriteti *de jure* i z. Gucati gjithashtu konfirmohet nga fakti se ai ishte personi të cilit iu drejtuan me emër Urdhri i Parë, Urdhri i Dytë dhe Urdhri i ZPS-së.<sup>1468</sup>

705. Trupi Gjykses vë në dukje se autoriteti i z. Gucati si kryetar është vetëm një ndër treguesit se ai ishte udhëheqës *de facto* i grupit. Roli i tij si udhëheqës i grupit ishte i dukshëm dhe të akuzuarit dhe z. Klinaku u mbështetën në të si pjesë përpjekjeve të tyre për të zbuluar informacionin e mbrojtur dhe për të penguar zyrtarët e DHS-në/ZPS-së gjatë kryerjes së punës së DHS-së/ZPS-së. Në veçanti, roli i z. Gucati është i qartë sepse ai: (i) urdhëroi z. Klinaku të dërgonte ftesat për gazetarët për konferencat

---

<sup>1463</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 194.

<sup>1464</sup> *Shih më lart* para. 580 (Pika 3); P1, f. 1; P9, f. 8; P6, f. 14; P35, f. 4; P29, f. 1-2.

<sup>1465</sup> P13, f. 1.

<sup>1466</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2159-2160, 2217; 1D3, para. 9-10.

<sup>1467</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2217.

<sup>1468</sup> P52; P53; P54. *Shih gjithashtu* P4, f. 3 (z. Gucati: "Toma veç ju tregoj për një ftesë që e kanë dërgu. Ftesa është në emnin tim personal. Unë si Kryetar i Veteranëve të Luftës...").

për shtyp;<sup>1469</sup> (ii) u pajtua që z. Haradinaj të kishte rolin kryesor në konferencat për shtyp;<sup>1470</sup> (iii) bëri prezantimin e temës në tri konferencat për shtyp dhe pastaj ia dha fjalën z. Haradinaj,<sup>1471</sup> i cili foli nën autoritetin e tij;<sup>1472</sup> (iv) udhëzoi z. Klinaku që t'ia dorëzonte ZPS-së pjesët e mbetura të grupit të parë të dokumenteve;<sup>1473</sup> (v) foli në tri konferencat për shtyp dhe në paraqitje të tjera në media në cilësinë e kryetarit të OVL-UÇK-së;<sup>1474</sup> dhe (vi) autorizoi z. Klinaku të vepronte si përfaqësues i OVL-UÇK-së gjatë kontrollimit të selisë së saj më 25 shtator 2020.<sup>1475</sup>

706. Gjatë dëshmisë, z. Gucati konfirmoi se në cilësinë e kryetarit të OVL-UÇK-së, ai mori vendime dhe dha udhëzime lidhur me zbulimin e tri grupeve të dokumenteve në tri konferencat për shtyp:

Vetëm Zoti mund të më detyron mua. Se unë jam Kryetar i asaj Organizatës të Veteraneve të Luftës. Asnjë njeri fuqi që ka, që më detyron mua që të mbaj konferencë për media për një punë të caktume. Këto nuk mundet, vetëm Zoti. Nëse besoni në Zot. [...]

Unë thashë dhe një herë. Unë jam Kryetar i Veteranëve të Luftës dhe kam 2 nënkryetarë. Kështu që mua s'mund të më bindë dikush që të bëj këtë punë apo atë punë. Unë mund të këshillohem me shokë, brenda organizate, jashtë organizate.<sup>1476</sup>

<sup>1469</sup> 1D3, para. 18; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170, 2190-2191. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 56; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410; Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>1470</sup> 1D3, para. 20.

<sup>1471</sup> P1, f. 1; P2, f. 1; P35, f. 1-2.

<sup>1472</sup> 1D3, para. 48 (z. Gucati: "E pranoj se ai [z. Haradinaj] ka folur me autorizimin tim dhe me autorizimin e kryesisë").

<sup>1473</sup> 1D7, para. 20; P7, f. 3 (z. Haradinaj: "dhe kryetari, me një urdhëresë telefoni, thotë jepjani."); P13, f. 1 (z. Klinaku: "unë e kam kryetarin Hysni GUCATI dhe tha që një kopje që na ke mbet neve, sepse katër kopje na kan ardh neve, që kemi pas me ja dorëzu prokurorisë së Kosovës, me vendim të kryetarit u vendos që atë kopje t'ia japim hetuesve të Dhomave të Specializuara"); P17, f. 3 (z. Haradinaj: "Dhe ky [sekretari], pa dhanë urdhër kryetari, se ishte edhe ai në pushime, nuk ia ka dhanë."); P28, f. 6-7 (z. Gucati); P57 ("pasi kryetari vendos me ua dhënë (kontakt përmes telefonit)").

<sup>1474</sup> P1, f. 1; P2, f. 1-2; P9, f. 1; P28, f. 1, 7; P29, f. 1.

<sup>1475</sup> 1D3, para. 55.

<sup>1476</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2216-2217.



707. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se z. Gucati veptoi si udhëheqës i grupit.

708. Sa i përket z. Haradinaj, provat tregojnë se ai veptoi nën autoritetin e z. Gucati. Në veçanti, ai kërkoi dhe u autorizua të kishte rolin kryesor në konferencat për shtyp dhe foli në to pasi iu dha fjala nga z. Gucati.<sup>1477</sup> Në paraqitjet e tjera në media, ai e pranoi shprehimisht autoritetin e z. Gucati.<sup>1478</sup> Pas arrestimit të z. Gucati, z. Haradinaj deklaroi:

Mu më thirri Zoti Gucati, me kërkesën e këtyne që të vij, sepse tha, mu po më transferojn për Hag, mirpo ajo që un u nisa është urdhni i Kryetarit tem me zbatu.<sup>1479</sup>

709. Për këto arsye, ndonëse vë dukje rolin e konsiderueshëm të z. Haradinaj si anëtar i grupit, Trupi Gjykses nuk është bindur se ai veptoi si udhëheqës i tij.

## 5. Përfundim

710. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e formës bazë të veprës penale në Pikën 2 të Aktakuzës lidhur me të akuzuarit. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën e rëndë sipas nenit 401(3) të KPK-së lidhur me z. Gucati. Forma e rëndë sipas nenit 401(5) të KPK-së diskutohet më poshtë.

## G. PENGIMI I PERSONAVE ZYRTARË– FORMA E RËNDË E PËRBASHKËT

711. Forma e rëndë sipas nenit 401(5) të KPK-së vlen për të dyja veprat penale në Pikat 1 dhe 2 dhe kërkon që vepra penale të jetë kryer, ndër të tjera, kundër gjykatësit, prokurorit ose zyrtarit të gjykatës.

---

<sup>1477</sup> P1, f. 1; P2, f. 1-2; P35, f. 1-2; 1D3, para. 20.

<sup>1478</sup> P7, f. 3.

<sup>1479</sup> P26, f. 2.

712. Trupi Gjykses vëren se përkufizimi i zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së domosdoshmërisht përfshin gjykatësit dhe prokurorët e DHS-së. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se të dy të akuzuarit shprehën dëshirën që DHS-ja/ZPS-ja të shpërbëhej, çka sugjeron një vendosmëri të përgjithshme për të penguar ose për të tentuar të pengonin punën e të gjithë zyrtarëve të DHS-së/ZPS-së, përfshirë gjykatësit, prokurorët dhe të gjithë punonjësit e DHS-së/ZPS-së. Sa u përket hetuesve dhe prokurorëve të ZPS-së, Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve në Pikat 1 dhe 2, pasqyrojnë qartë dëshirën për të penguar mbledhjen e dëshmive të dëshmitarëve nga këta zyrtarë të ZPS-së.<sup>1480</sup> Lidhur me gjykatësit e DHS-së, z. Haradinaj tha se shpresonte që zbulimi i informacionit të mbrojtur do të ndikonte në punën dhe vendimmarrjen e gjykatësit që konfirmoi aktakuzat.<sup>1481</sup> Sidoqoftë, në mungesë të provave të tjera bindëse, Trupi Gjykses nuk mund të arrijë në përfundimin se komentet e lartpërmendura vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm që të akuzuarit synuan të pengonin ndonjë gjykatës të DHS-së në kryerjen e detyrave.

713. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën e rëndë të veprave penale në Pikat 1 dhe 2 lidhur me të dy të akuzuarit për aq sa ata tentuan të pengonin prokurorët dhe hetuesit e DHS-së.

## VII. FORMAT E PËRGJEGJËSISË PENALE

### A. PARASHTRIMET E PALËVE

714. Format e përgjegjësisë penale janë trajtuar në paragrafin 8. Në lidhje me elementet objektive të formave të përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, ZPS-ja parashtroi më tej se: (i) të akuzuarit i kryen krimet e paraqitura në Aktakuzë dhe, si

---

<sup>1480</sup> *Shih më lart* para. 659-669 (Pika 1), 699 (Pika 2).

<sup>1481</sup> P7, f. 6, 12-13; P34, f. 2.

alternativë, të akuzuarit u përpoqën t'i kryenin të gjitha veprat penale të paraqitura në Aktakuzë me përjashtim të Pikës 5;<sup>1482</sup> (ii) të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre i kryen krimet në bashkëkryerje dhe/ose u morën vesh t'i kryenin ato;<sup>1483</sup> (iii) të akuzuarit nxitën kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë përmes ushtrimit të ndikimit psikologjik mbi njëri-tjetrin dhe mbi persona të tjerë;<sup>1484</sup> dhe (iv) të akuzuarit i ofruan ndihmë njëri-tjetrit dhe personave të tjerë për kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë.<sup>1485</sup>

715. Në lidhje me elementet subjektive të të gjitha formave të përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, ZPS-ja parashtroi se sjellja e qëllimshme e të akuzuarve vërteton se ata synonin t'i kryenin krimet e përfshira në Aktakuzë si dhe të nxisnin e të ndihmonin kryerjen e atyre krimeve.<sup>1486</sup> Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se, sa u përket disa formave të përgjegjësisë penale, këto synime i kishin edhe persona të tjerë.<sup>1487</sup> Si alternativë, ZPS-ja parashtron se të akuzuarit dhe personat e tjerë, sipas rastit, ishin të vetëdijshëm se mund të ndodhnin krimet e përfshira në Aktakuzë si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të tyre dhe u pajtuan me kryerjen e tyre.<sup>1488</sup>

716. ZPS-ja i kërkoi Trupit Gjyqësor të bënte konstatime për të gjitha format e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzë, edhe pse janë forma alternative të përgjegjësisë penale, për të garantuar që dokumentacioni në lidhje me këtë aspekt të jetë i qartë për procedurën e apelit. Kur e njëjta sjellje mund të cilësohet sipas të gjitha formave të përgjegjësisë penale, të akuzuarit duhet të shpallen fajtorë sipas cilësdo

---

<sup>1482</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 277.

<sup>1483</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 278.

<sup>1484</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 279-281.

<sup>1485</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 282.

<sup>1486</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 275.

<sup>1487</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 275.

<sup>1488</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 276.

forme përgjegjësie penale kryesore (kryerje ose bashkëkryerje) që Trupi Gjykses e konsideron se pasqyron më mirë përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarve.<sup>1489</sup>

717. Mbrojtja e Gucatit parashtrori se kur format alternative të përgjegjësisë penale lidhen me të njëjtin (ose në thelb të njëjtin) grup faktesh, atëherë vendimi i fajësisë sipas formës më të lehtë të përgjegjësisë penale është subsidiar në situatat kur nuk vërtetohet forma më e rëndë e përgjegjësisë penale.<sup>1490</sup> Më tej, Mbrojtja e Gucatit parashtrori se lloji i marrëdhënies konkrete (pra cila është forma më e lehtë apo më e rëndë e përgjegjësisë penale) mes bashkëkryerjes dhe nxitjes së kryerjes së krimit do të varet nga vendimet e Trupit Gjykses sa i përket synimit kriminal dhe veprimit të fajshëm të këtyre formave të përgjegjësisë penale.<sup>1491</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e Gucatit shtoi se nuk është paraqitur asnjë provë në mbështetje të argumentit për përgjegjësi penale të të akuzuarve për tentativë, nxitje, ndihmë apo marrëveshje në ato rrethana.<sup>1492</sup>

718. Mbrojtja e Haradinajt pretendon se ZPS-ja duket se ngatërron kryerjen e drejtpërdrejtë, bashkëkryerjen dhe format e përgjegjësisë penale për krime paraprake. Po ashtu sipas Mbrojtjes qasja nuk fokusohet në provat dhe pretendimet konkrete kundër të akuzuarve.<sup>1493</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e Haradinajt parashtron se pretendimi se të paktën edhe dy persona të tjerë që nuk ngarkohen me akuza, janë bashkërisht përgjegjës, dëmton z. Haradinaj pasi ai nuk është në gjendje të kundërshtojë asnjë nga provat përkatëse në këtë aspekt.<sup>1494</sup>

---

<sup>1489</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 322; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3504.

<sup>1490</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 143.

<sup>1491</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 144.

<sup>1492</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 91; F439, para. 96.

<sup>1493</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 49-50. *Shih gjithashtu* F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 257-272.

<sup>1494</sup> F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 106.

## B. KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES

719. Ashtu si për pikat e Aktakuzës, Trupi Gjykses vëren se të njëjtat fakte dhe rrethana vlejné edhe për një numër formash të përgjegjësisë penale. Duke mbajtur parasysh përgjegjësinë sipas rregullës 158(2) të Rregullores, Trupi Gjykses do të trajtojë secilën formë të përgjegjësisë penale, por do t'u referohet, aty ku është e mundshme, fakteve dhe rrethanave të diskutuara për format e tjera të përgjegjësisë penale.

720. Sa u përket Pikave 1, 2, 3, 5 dhe 6, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë në lidhje me të dy të akuzuarit. Trupi Gjykses do të trajtojë format e përgjegjësisë penale lidhur me këto akuza.

721. Sa i përket Pikës 4, Trupi Gjykses konstaton se elementi i synimit kriminal për këtë vepër penale nuk është përmbushur as nga të akuzuarit dhe as nga ndihmësit e tyre. Duke qenë se Trupi Gjykses konstatoi që ZPS-ja nuk ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre e kishin këtë synim kriminal, atëherë Trupi Gjykses nuk do të trajtojë asnjë nga format e përgjegjësisë penale në lidhje me këtë akuzë.

### 1. Bashkëkryerja

722. Trupi Gjykses do të trajtojë bashkëkryerjen për Pikat 1, 3, 5 dhe 6. Për Pikën 2, kryerja e drejtpërdrejtë si formë kryerje do të trajtohet në pjesën vijuese.

723. Për të përcaktuar nëse të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale si bashkëkryes për veprat penale në Pikat 1, 3, 5 dhe 6 të Aktakuzës, Trupi Gjykses shqyrtoi nëse: (i) të akuzuarit së bashku (ii) morën pjesë apo kontribuan thelbësisht në kryerjen e veprave penale në ndonjë mënyrë tjetër me (iii) elementin subjektiv të nevojshëm.<sup>1495</sup>

---

<sup>1495</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 82, 84.

(a) **Sjellja e përbashkët e të akuzuarve**

724. Pas çdo dorëzimi të dokumenteve në selinë e OVL-UÇK-së, të akuzuarit, së bashku me persona të tjerë, morën vendime të përbashkëta për organizimin e një konference për shtyp dhe për t'i bërë publike dokumentet e marra.<sup>1496</sup> Për më tepër, më 14 ose 15 shtator 2020, kryesia e OVL-UÇK-së e përbërë nga 23 anëtarë (ku bënin pjesë që të dy të akuzuarit) mori njëzëri vendim që të publikonte çfarëdo dokumentesh të tjera të ngjashme në të ardhmen.<sup>1497</sup>

725. Në pajtim me këto vendime, të akuzuarit së bashku: (i) këqyrën materialet dhe lejuan personat e tjerë në selinë e OVL-UÇK-së të shfletonin materialet;<sup>1498</sup> (ii) morën pjesë bashkërisht në konferencat për shtyp në lidhje me tri grupet e dokumenteve;<sup>1499</sup> (iii) i ekspozuan tri grupet e dokumenteve mbi tavolinën përballë dhe lejuan gazetarët t'i shfletonin, fotografonin, filmonin dhe të merrnin me vete kopje të tyre;<sup>1500</sup> dhe (iv) në mënyrë të përsëritur bënë deklaratat, përfshirë edhe në prani të njëri-tjetrit,<sup>1501</sup> të cilat pasqyronin pikëpamjet dhe veprimet e përbashkëta të tyre, jo vetëm në lidhje

---

<sup>1496</sup> *Shih më lart* para. 679 (Pika 2).

<sup>1497</sup> P9, p. 8 (z. Gucati: "Kemi diskutu me kryesin, kemi fol me ta"); 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746.

<sup>1498</sup> *Shih më lart* fn. 1417.

<sup>1499</sup> P1; P2; P35.

<sup>1500</sup> P1 material filmik, minuta 00:00:32-00:00:35 (z. Gucati), 00:00:46-00:00:48 (z. Gucati), minuta 00:01:14-00:01:18 (z. Gucati), 00:14:20-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:14:44-00:14:49 (z. Gucati), 00:15:55-00:16:03 (z. Gucati), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj); P1, p. 6-9 (z. Haradinaj); P2 material filmik, minuta 00:00:58-00:01:10 (z. Gucati), 00:11:14-00:11:16 (z. Gucati), 00:11:44-00:11:46 (z. Gucati); P35 material filmik, minuta 00:14:33-00:14:35 (z. Haradinaj), 00:15:55-00:16:03 (z. Haradinaj), 00:16:35-00:16:52 (z. Haradinaj); P35, p. 2 (z. Gucati), 14 (të dy të akuzuarit); P50 material filmik, minuta 00:15:55-00:16:19 (z. Gucati); P50, p. 1 (z. Haradinaj); 1D3, para. 49. *Shih gjithashtu* W04866 (Halil Berisha), Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1519-1520.

<sup>1501</sup> P1; P2; P35; P12.

me nxjerrjen e dokumenteve,<sup>1502</sup> por edhe lidhur me dëshmitarët<sup>1503</sup> dhe ndikimin te DHS-ja/ZPS-ja.<sup>1504</sup>

726. Në lidhje me sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit vepruan së bashku kur ndërmorën veprimet që përbëjnë bazën e akuzave të paraqitura në Aktakuzë.

(b) Pjesëmarrja e z. Gucati në bashkëkryerje

727. Trupi Gjykses konstatoi se z. Gucati ishte në dijeni të përmbajtjes së përgjithshme të tri grupeve të dokumenteve, ndonëse më pak se z. Haradinaj.<sup>1505</sup> Po kështu, Trupi Gjykses konstatoi se gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës z. Gucati veproi me dijeninë se tri grupet e dokumenteve ishin autentike.<sup>1506</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vlerësoi se kur shpërndau tri grupet e dokumenteve dhe përshkroi informacionin që gjendej në

---

<sup>1502</sup> P1, f. 8 (z. Haradinaj: “ne me dasht ... ne me patë dasht, s’i kishim bë publik hiç”) (theksimi i shtuar); P2, f. 4 (z. Haradinaj: “Ne sa herë të na i bin, kemi me i qitë. Dhe [ne] nuk mbajmë pikë përgjegjësie, as nuk lodhem për këtë punë”); P4, f. 3 (z. Gucati: dhe ne ju thamë atyne që “çdo moment që ne na vjen material nga Gjykata Speciale, ne do t’i bëjmë publike për media”) (theksimi i shtuar); P35, f. 2 (z. Gucati: “ne do t’i bëjmë publike për qytetarët e Kosovës, për vendin tonë dhe për të gjithë ata”); f. 3 (z. Haradinaj: “Asnjë send që na vjen këtu, ne s’kemi majt msheft. [...] pa tjetër. Ne këtë detyrë e kemi”), p. 13 (z. Haradinaj: “Po flas në emër tim dhe të gjithë kryesisë. [Folësit flasin njëkohësisht] jemi të gatshëm të kalojmë 300 vjet [në burg]. Jemi gati të vdesim”) (theksimi i shtuar).

<sup>1503</sup> P2, p. 4 (z. Haradinaj: “Dhe dhe një, ata që mendojnë me shantazhu kanë – do të thonë si i kemi dosjet, ja u dimë emnat. Ata janë njerëz antikombëtarë dhe njerëz që nuk e dunë Kosovën”) (theksimi i shtuar); P35, f. 2 (z. Gucati: “do të tregojmë një të vërtetë që [këta të përmendur] këtu kanë mundu edhe po mundohen me çdo kusht që Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ta zhveshin”) (theksimi i shtuar).

<sup>1504</sup> P2, f. 6 (z. Haradinaj: “Sepse ne jemi prej – si Shoqatë e Organizatë ne jemi kundër kësaj Gjykate”) (theksimi i shtuar); P4, f. 3 (z. Gucati: “Arsyeja pse do t’i bëjmë publike. Ne do të vërtetojmë fjalën tonë që kemi thënë para tri vjetëve edhe ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë apo qytetarëve të Kosovës”) (theksimi i shtuar); f. 8 (z. Gucati: “Është në interesin tonë t’i shpërndajmë sa më shumë në media dhe të bindim publikun dhe median se kjo Gjykatë është e papranueshme”) (theksimi i shtuar); P7, f. 6 (z. Haradinaj: “Qëllimi pse i kemi qit është kjo. I kemi qit sepse po dojm me i tregu gjykatësit, me këto punë që ke bo, je zero”) (theksimi i shtuar); P18, f. 1 (z. Haradinaj: “Nuk e njohim atë Gjykatë dhe kemi me e qit”) (theksimi i shtuar); P26, p. 2 (z. Haradinaj: “Ne e kem detyr që t’punojm kundra kësaj Gjykate, ne e kemi detyr që t’mbrojm antarët tan, ne këtë detyr e kem”) (theksimi i shtuar).

<sup>1505</sup> *Shih më lart* para. 377 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1506</sup> *Shih më lart* para. 421 (Konstatime mbi paketat).

to, z. Gucati ishte në dijëni se ato përmbanin informacion konfidencial dhe emrat e dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>1507</sup>

i) Pika 5

728. Z. Gucati i këqyri tri grupet e dokumenteve dhe lejoi punonjës të tjerë të OVL-UÇK-së<sup>1508</sup> të këqyrnin përmbajtjen e dokumenteve.<sup>1509</sup> Në vijim të vendimit të përbashkët për të organizuar konferencë për shtyp pas secilit prej tre dorëzimeve, z. Gucati autorizoi z. Klinaku, të paktën në dy raste,<sup>1510</sup> që të informonte median dhe t'i ftonte të merrnin pjesë.<sup>1511</sup>

729. Gjatë tri konferencave për shtyp, z. Gucati: (i) drejtoi konferencat në cilësinë e kryetarit të OVL-UÇK-së, bëri komentet hyrëse lidhur me tri grupet e dokumenteve dhe ia dha fjalën z. Haradinaj të përshkruante përmbajtjen e tyre;<sup>1512</sup> (ii) tha se dokumentet mbi tavolinën përballë të akuzuarave ishin të disponueshme,<sup>1513</sup> dhe ftoi ose lejoi personat e pranishëm t'i këqyrnin dokumentet;<sup>1514</sup> (iii) u tregoi dokumentet gazetarëve dhe/ose ftoi ata që kishin kamera që të fokusonin objektivin te dokumentet;<sup>1515</sup> (iv) ftoi dhe lejoi personat e pranishëm të merrnin dokumente me vete;<sup>1516</sup> (v) përmendi ose citoi informacione që gjendeshin në dokumente, ku

<sup>1507</sup> *Shih më lart* para. 456 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1508</sup> 1D3, para. 14-17; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, p. 2168; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor, p. 2455, 2457; 1D9, para. 13, 15, 31.

<sup>1509</sup> P9, f. 6; P35, f. 2, 14; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, p. 2200; Transkripti, 7 dhjetor, f. 2297. *Shih gjithashtu më lart* para. 211, 246, 276-277 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1510</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, p. 2170, 2190-2191; 1D3, para. 18; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, p. 2727.

<sup>1511</sup> *Shih p.sh.* 1D3, para. 16-18; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2168-2170; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727.

<sup>1512</sup> P1, p. 1; P2, p. 1-2; P35, p. 1-2.

<sup>1513</sup> P1 material filmik, minuta 00:00:32-00:00:35, 00:00:46-00:00:48.

<sup>1514</sup> P35, f. 2, 14.

<sup>1515</sup> P1 material filmik, minuta 00:01:17-00:01:18, 00:14:44-00:14:49, 00:15:55-00:16:03; P2 material filmik, minuta 00:01:00-00:01:08, 00:01:17-00:01:18, 00:11:14-00:11:16, 00:11:44-00:11:46.

<sup>1516</sup> P2, f. 1; P35, f. 15.



përfshiheshin emrat e zyrtarëve të ZPS-së ose atyre serbë,<sup>1517</sup> (vi) inkurajoi gazetarët që t'i publikonin materialet,<sup>1518</sup> dhe (vii) tha se nëse do të vinin dokumente të tjera, OVL-UÇK-ja do t'i pranonte me qëllim që t'ia jepte medias.<sup>1519</sup>

730. Z. Gucati ishte i pranishëm në një paraqitje në media bashkë me z. Haradinaj, ku z. Tomë Gashi u shpreh në emër të OVL-UÇK-së se organizata do të informonte publikun sa herë që të merrte materiale që kishin lidhje me DHS-në/ZPS-në.<sup>1520</sup>

731. Gjithashtu edhe z. Gucati mori pjesë në paraqitje të tjera në media, vetëm ose bashkë me z. Tomë Gashi.<sup>1521</sup> Gjatë këtyre paraqitjeve në media, z. Gucati: (i) lexoi nga dokumentet ose përshkroi përmbajtjen e dokumenteve;<sup>1522</sup> (ii) në mënyrë të përsëritur u betua se do të vazhdonte të publikonte çdo dokument që do të merrte;<sup>1523</sup> (iii) deklaroi se e kishte për detyrë t'ia jepte dokumentet medias;<sup>1524</sup> dhe/ose (iv) konfirmoi ose u betua se kopjet ishin në dispozicion ose do t'i viheshin në dispozicion medias.<sup>1525</sup>

732. Gjatë periudhës së Aktakuzës, në profilin e z. Gucati në *Facebook* dolën dy postime:<sup>1526</sup> (i) një postim i z. Haradinaj ku thuhej se e mirëpriste personin që la grupin e parë të dokumenteve;<sup>1527</sup> dhe (ii) një artikull i medias me një pamje të fotografuar nga ekrani të një dokumenti të TFHS-së.<sup>1528</sup>

---

<sup>1517</sup> P2, f. 1-2; P35, f. 1-2.

<sup>1518</sup> P35, f. 14.

<sup>1519</sup> P2, f. 9.

<sup>1520</sup> P12, f. 4.

<sup>1521</sup> P9; P4 (me z. Tomë Gashi); P28; P29, P31.

<sup>1522</sup> P9, f. 5; P28, f. 10, 14; P29, f. 1; P31, f. 3.

<sup>1523</sup> P4, f. 3, 8; P28, f. 7, 11, 12-13; P29, f. 2; P31, f. 2.

<sup>1524</sup> P9, f. 6.

<sup>1525</sup> P9, f. 6.

<sup>1526</sup> Z. Gucati pranoi se profili "hisni.gucati" në *Facebook* është i tij. DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2354-2363, 2434.

<sup>1527</sup> P83, f. 49.

<sup>1528</sup> P83, f. 46.

733. Veç të tjerave, gjatë gjithë kohës z. Gucati ushtroi detyrën e kryetarit të OVL-UÇK-së. Gjatë dëshmisë së tij ai konfirmoi se mbështeste të gjitha ato që kishte thënë z. Haradinaj.<sup>1529</sup>

734. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykues është bindur se z. Gucati mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në nxjerrjen e informacionit të mbrojtur.

ii) Pika 6

735. Krahas veprimeve dhe deklaratave të përshkruara në paragrafët 728-733, z. Gucati: (i) deklaroi publikisht se tri grupet e dokumenteve përfshinin “një numër të madh njerëzish”<sup>1530</sup>, “shumicën e dëshmitarëve”<sup>1531</sup>, “të gjithë ata”<sup>1532</sup>; (ii) në mënyrë publike përmendi praninë e emrave, përkatësive etnike, datat e intervistave, vendndodhjet dhe përmbajtjet e dëshmimeve të dëshmitarëve në tri grupet e dokumenteve, ndonëse pranoi se emrat nuk duheshin thënë;<sup>1533</sup> (iii) inkurajoi gazetarët të publikonin emrat e dëshmitarëve dhe qortoi ata që nuk pranuan;<sup>1534</sup> dhe (iv) ishte i pranishëm dhe heshti kur z. Haradinaj përmendi faktin se tri grupet e dokumenteve përmbanin emra ose të dhëna të tjera të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm.<sup>1535</sup>

---

<sup>1529</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2374 (“Ne nuk muj të autorizojmë se s’kemi nevojë unë jam kryetar dhe Nasimi është nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës, nuk kemi përgatit një deklaratë të shkruar që të çaj të flas unë para mediave, kam thanë edhe në ditët në vijim. Kam thanë që ne kemi ftuar konferencë për shtyp dhe ne nuk e dimë çaj na pyesin gazetarët. Kështu që ato autorizimi nuk kemi pas nevojë të ketë as Nasimi, e asnjë. Po do të thotë që mendimin e tij e kam përkrah se çaj ka fol”).

<sup>1530</sup> P9, f. 6-7.

<sup>1531</sup> P59, f. 1.

<sup>1532</sup> P1, f. 4.

<sup>1533</sup> P9, f. 6-7, 10; P28, f. 1, 11; P35, f. 1-2, 13; P59, . 1, 3.

<sup>1534</sup> P35, f. 13-14.

<sup>1535</sup> P1; P2; P35.

736. Zbulimi i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nga z. Gucati shkaktoi pasoja të rënda për dëshmitarët e rrezikuar, brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPK-së.<sup>1536</sup>

737. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykes është bindur se z. Gucati mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në zbulimin e identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.

iii) Pika 3

738. Krahas veprimeve dhe deklaratave të përshkruara në paragrafët 728-735, z. Gucati shprehu publikisht dyshimin nëse ndokush i mbronte dëshmitarët e DHS-së/ZPS-së,<sup>1537</sup> dhe deklaroi se DHS-ja duhej ndjekur penalisht sepse kishte vënë në rrezik dëshmitarët e vet,<sup>1538</sup> dhe se kishte humbur të gjithë besueshmërinë si rezultat i zbulimit të informacionit.<sup>1539</sup>

739. Në të njëjtën kohë, z. Gucati në mënyrë publike shprehu dyshim mbi vërtetësinë e dëshmive të dëshmitarëve, duke i përshkruar si: (i) persona që kishin gënjyer<sup>1540</sup> ose kishin bërë “fabrikime t’mdhaja”<sup>1541</sup> në deklaratat e tyre me qëllim që të përfitonin azil në perëndim;<sup>1542</sup> ose (ii) “pjesë e instrumentalizuar e politike” që “i kanë cytur të bëhen dëshmitarë për shkak të rivalitetit politik”.<sup>1543</sup> Ai gjithashtu pretendoi se deklaratat e dëshmitarëve ishin marrë përmes forcës ose trysnisë dhe për këtë arsye nuk duheshin besuar.<sup>1544</sup>

---

<sup>1536</sup> *Shih më lart* para. 547 (Pika 6).

<sup>1537</sup> P9, f. 5.

<sup>1538</sup> P59, f. 1.

<sup>1539</sup> P28, f. 13.

<sup>1540</sup> P59, f. 2.

<sup>1541</sup> P9, f. 11.

<sup>1542</sup> P9, f. 11; P59, f. 2.

<sup>1543</sup> P59, f. 2.

<sup>1544</sup> P59, f. 2.

740. Për më tepër, z. Gucati i përshkroi dëshmitarët si: (i) “shqipfolsa”<sup>1545</sup> që ishin “me Serbinë”;<sup>1546</sup> (ii) “ata të cilët nuk ia don të mirën këtij vendi dhe ata të cilët nuk e don t’mirën e Ushtrisë Çlirimtare t’Kosovës”;<sup>1547</sup> (iii) “një bashkëpunim, mes një rreth shqipfolsve dhe të Serbisë”;<sup>1548</sup> (iv) “disa tradhtar t’kombit” që “del gënjen”;<sup>1549</sup> (v) “shumë gjin që na kemi besu n’ta [...], i kemi mbajt nëpër oda, tubime ... i kemi respektu e sene”;<sup>1550</sup> dhe (vi) “bashkëpunëtor”.<sup>1551</sup>

741. Komentet e z. Gucati ishin të njëjta me komentet e bëra prej tij edhe para periudhës së Aktakuzës,<sup>1552</sup> kur pranoi se DHS-ja/ZPS-ja do të dështonte për shkak të dëshmitarëve “bashkëpunëtorë”.<sup>1553</sup> Deklaratat e tij përcollën mesazhin se sapo ta merrnin vesh të gjithë kush ishin dëshmitarët, askush nuk do t’i mbronte më, sepse ishin “tradhtarë”, “bashkëpunëtorë”, “shqipfolsa” të cilët “nuk ia don të mirën këtij vendi dhe ata të cilët nuk e don t’mirën e Ushtrisë Çlirimtare t’Kosovës”.<sup>1554</sup> Z. Gucati po ashtu pranoi se edhe gjëra të tjera “mund [t’u] ndodhnin” dëshmitarëve emrat e të cilëve u bënë publikë.<sup>1555</sup>

742. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se z. Gucati mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës penale në Pikën 3.

---

<sup>1545</sup> P9, f. 6, 13.

<sup>1546</sup> P9, f. 6.

<sup>1547</sup> P9, f. 6.

<sup>1548</sup> P9, f. 11.

<sup>1549</sup> P9, f. 12.

<sup>1550</sup> P9, f. 9.

<sup>1551</sup> P9, f. 11.

<sup>1552</sup> *Shih më lart* para. 569-570, 573-574 (Pika 3).

<sup>1553</sup> P40 (12 dhjetor 2018), f. 2.

<sup>1554</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3).

<sup>1555</sup> P9, f. 8.

## iv) Pika 1

743. Gjatë kohës që kryente veprimet dhe bënte deklaratat e përshkruara në paragrafët 728-740, z. Gucati e lidhi vendimin, “interesin”<sup>1556</sup> dhe “detyrën”<sup>1557</sup> e tij për të publikuar informacionin e mbrojtur me dëshirën e tij për të “demantuar”<sup>1558</sup> dhe “hjekur krejt”<sup>1559</sup> DHS-në/ZPS-në “për pes minuta”<sup>1560</sup>. Ai i përshkroi DHS-në/ZPS-në si “të papranueshme”<sup>1561</sup>, “të pavlerë”<sup>1562</sup>, “raciste”<sup>1563</sup>, “degraduese”<sup>1564</sup>, “monoetnike” dhe “e njëanshme”,<sup>1565</sup> sepse ishte mbështetur në provat e dëshmitarëve “kolaboracionistë”.<sup>1566</sup> Ai shprehu shpresën që DHS-ja/ZPS-ja të shpërbëhej sa më shpejt edhe të ndërpriste të gjitha veprimtaritë kundër anëtarëve të UÇK-së.<sup>1567</sup>

744. Në Pikën 1, Trupi Gjykses konstatoi se veprimet dhe deklaratat e z. Gucati përbënin tentativë për pengim të personave zyrtarë në kuptim të nenit 401(1) të KPK-së. Sjellja e tij gjithashtu përbënte tentativë për pengimin e prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(5) të KPK-së.

745. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se z. Gucati mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës penale në Pikën 1.

---

<sup>1556</sup> P4, f. 8.

<sup>1557</sup> P9, f. 6.

<sup>1558</sup> P28, f. 9.

<sup>1559</sup> P28, f. 11.

<sup>1560</sup> P28, f. 11.

<sup>1561</sup> P4, f. 8.

<sup>1562</sup> P29, f. 2.

<sup>1563</sup> P4, f. 8; P40, f. 1 (12 dhjetor 2018); P59, f. 1.

<sup>1564</sup> P59, f. 1.

<sup>1565</sup> P4, f. 8; P40, f. 1; P41, f. 1; P59, f. 1.

<sup>1566</sup> P40 (12 dhjetor 2018), f. 2.

<sup>1567</sup> P29, f. 1.

(c) Pjesëmarrja e z. Haradinaj në bashkëkryerje

746. Trupi Gjykues konstatoi se z. Haradinaj ishte në dijeni të hollësishme të përmbajtjes së tri grupeve të dokumenteve.<sup>1568</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues konstatoi se, gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës, z. Haradinaj veproi me dijeninë se tri grupet e dokumenteve ishin autentike.<sup>1569</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykues vlerësoi se kur shpërndau tri grupet e dokumenteve dhe përshkroi përmbajtjen e tyre, z. Haradinaj ishte në dijeni se ato përmbanin informacion konfidencial dhe emrat e dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>1570</sup>

i) Pika 5

747. Z. Haradinaj i këqyri të tri grupet e dokumenteve dhe lejoi palë të tjera të paaautorizuara, si punonjës të OVL-UÇK-së dhe anëtarë të KFOR-it që ishin të pranishëm në seli,<sup>1571</sup> të këqyrnin ose fotografonin përmbajtjen e dokumenteve.<sup>1572</sup>

748. Gjatë tri konferencave për shtyp, z. Haradinaj: (i) përshkroi gjerësisht përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve, llojin dhe natyrën e dokumenteve, emrat e zyrtarëve të ZPS-së dhe atyre serbë që përmendeshin në dokumente;<sup>1573</sup> (ii) ftoi ose lejoi personat e pranishëm t'i këqyrnin dokumentet;<sup>1574</sup> (iii) u tregoi kamerave përmbajtjen e disa prej këtyre dokumenteve;<sup>1575</sup> (iv) u betua se do t'u jepte gazetarëve sa kopje të dëshironin dhe i inkurajoi të merrnin kopje;<sup>1576</sup> (v) u betua se do të vazhdonte të publikonte çfarëdo dokumentesh që do të merrnin,<sup>1577</sup> duke thënë se e

---

<sup>1568</sup> *Shih më lart* para. 377 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1569</sup> *Shih më lart* para. 421 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1570</sup> *Shih më lart* para. 456 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1571</sup> P7, f. 7-8; P35, f. 9; 2D1, para. 85, 102-103, 108-109; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor, f. 2459; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar, f. 2777-2779.

<sup>1572</sup> *Shih më lart* para. 211, 246, 276-277 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1573</sup> P1, f. 1-3, 6-7; P2, f. 2-3; P35, f. 2-3.

<sup>1574</sup> P1, f. 6-9; P35, f. 14.

<sup>1575</sup> P1 material filmik, minuta 00:14:33-00:14:35, 00:16:35-00:16:52; P2 material filmik, minuta 00:14:33-00:14:35, 00:16:35-00:16:52; P35 material filmik, minuta 00:14:33-00:14:35, 00:16:35-00:16:52.

<sup>1576</sup> P1, f. 5-6; P2, f. 4; P50, f. 1; P35, f. 4-5, 15.

<sup>1577</sup> P2, f. 4; P35, f. 3.

kishte për detyrë ta bënte këtë;<sup>1578</sup> (vi) inkurajoi gazetarët e pranishëm që të publikonin emrat e dëshmitarëve dhe qortoi disa prej tyre që nuk e kishin bërë këtë;<sup>1579</sup> dhe (vii) tha se nëse do t'u vinin dokumente të tjera, OVL-UÇK-ja do t'i pranonte dhe se personi që solli tri grupet e dokumenteve ishte i mirëpritur të sillte dhe të tjera.<sup>1580</sup>

749. Z. Haradinaj ishte i pranishëm në një paraqitje në media bashkë me z. Gucati, ku z. Tomë Gashi u shpreh në emër të OVL – UÇK-së se organizata do të informonte publikun sa herë që të merrte materiale që kishin lidhje me DHS-në/ZPS-në.<sup>1581</sup>

750. Z. Haradinaj po ashtu mori pjesë në paraqitje të tjera në media, vetëm ose bashkë me z. Tomë Gashi dhe persona të tjerë.<sup>1582</sup> Gjatë këtyre paraqitjeve në media, z. Haradinaj: (i) përshkroi llojin, natyrën dhe/ose përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve,<sup>1583</sup> duke treguar emrat e zyrtarëve të ZPS-së dhe atyre serbë që gjendeshin në të;<sup>1584</sup> (ii) në mënyrë të përsëritur u betua se do të vazhdonte të publikonte çdo dokument që do të merrte,<sup>1585</sup> se e kishte për detyrë ta bënte këtë;<sup>1586</sup> (iii) konfirmoi ose u betua se kopjet ishin në dispozicion ose do t'i viheshin në dispozicion medias;<sup>1587</sup> dhe (iv) në mënyrë të përsëritur inkurajoi gazetarët t'i publikonin dokumentet dhe qortoi disa prej tyre që nuk e kishin bërë këtë.<sup>1588</sup>

---

<sup>1578</sup> P2, f. 4; P35, f. 3.

<sup>1579</sup> P1, f. 4, 5; P2, f. 2, 7; P35 f. 4-5, 12-13.

<sup>1580</sup> P2, f. 8-9; P35, f. 8, 10.

<sup>1581</sup> P12, f. 4.

<sup>1582</sup> P6; P7 (me z. Tomë Gashi); P8; P11; P15; P16; P17; P18; P19; P21; P24; P25; P27; P26; P30; P32; P33.

<sup>1583</sup> P6, f. 19-20; P17, f. 2-4; P19, f. 2-3; P21, f. 4-5; P24, f. 7-8.

<sup>1584</sup> P18, f. 2-3; P19, f. 1, 3-4; P33, p. 2.

<sup>1585</sup> P6, f. 4, 14; P18, f. 1-2; P21, p. 4; P24, p. 7; P26, f. 4-5.

<sup>1586</sup> P21, p. 3; P24, f. 8; P26, p. 2.

<sup>1587</sup> P6, f. 17-18; P7, p. 7; P8, p. 10; P11, p. 4; P17, p. 6; P21, f. 3-4; P24, f. 3, 6.

<sup>1588</sup> P6, f. 6, 9, 18; P8, f. 21-22; P17, f. 6-7; P21, p. 5; P24, f. 2-3, 5, 10; P30, f. 5-8; P33, p. 3; P11, f. 4, 28-29.

751. Gjatë periudhës së Aktakuzës, në profilin e z. Haradinajt në *Facebook* dolën disa postime<sup>1589</sup>, që ishin ripublikime të artikujve të mediave me përshkrime ose pamje të fotografuara nga ekrani të dokumenteve.<sup>1590</sup>

752. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se z. Haradinaj mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në zbulimin e informacionit të mbrojtur.

ii) Pika 6

753. Veç veprimeve dhe deklaratave të përshkruara në paragrafët 747-750, z. Haradinaj: (i) tregoi në mënyrë publike se tri grupet e dokumenteve përmbanin “emrat e të gjithë dëshmitarëve”,<sup>1591</sup> “shumë emra”<sup>1592</sup> dhe “e shumë njerëzve, shumë njerëzve”;<sup>1593</sup> (ii) në mënyrë publike dhe të përsëritur tregoi ku ndodheshin emrat, adresat e shkuara dhe aktuale, numrat e telefonit, përkatësitë etnike, datat dhe vendet e intervistave si dhe përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve;<sup>1594</sup> (iii) përmendi publikisht emrat e pesë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm, emrat e të cilëve ishin në grupin e parë dhe të dytë të dokumenteve;<sup>1595</sup> dhe (iv) inkurajoi gazetarët të publikonin emrat që ishin në dokumente dhe qortoi disa prej tyre që nuk donin ta bënin këtë.<sup>1596</sup>

754. Zbulimi i identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm nga z. Haradinaj shkaktoi pasoja të rënda për dëshmitarët e rrezikuar brenda kuptimit të nenit 392(3) të KPP-së.<sup>1597</sup>

---

<sup>1589</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2812; Transkripti, 13 janar 2022, f. 2929.

<sup>1590</sup> *Shih më lart* fn. 1017. *Shih gjithashtu* P60; P61; P62, P70; P72; P73; P74; P75; P77; P78; P79; P80; P82; P83.

<sup>1591</sup> P1, f. 2.

<sup>1592</sup> P18, f. 3.

<sup>1593</sup> P35, f. 3.

<sup>1594</sup> P1, f. 2-3, 5; P8, f. 11; P11, f. 30; P18, f. 3; P21, f. 5; P24, f. 8; P30, f. 4; P35, f. 2-3.

<sup>1595</sup> P1, f. 2; P11, f. 30; P35, f. 3; [REDAKTUAR].

<sup>1596</sup> P2, f. 7; P6, f. 9; P35, f. 4. *Shih gjithashtu* P25, f. 7.

<sup>1597</sup> *Shih më lart* para. 547 (Pika 6).



755. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykues është bindur se z. Haradinaj mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në zbulimin e identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mbrojtur.

iii) Pika 3

756. Krahas veprimeve dhe deklaratave të përshkruara në paragrafët 747-750 dhe 753, z. Haradinaj u shpreh veçanërisht me forcë se DHS-ja nuk ishte në gjendje t'i mbronte dëshmitarët e vet dhe lejoi të dilnin emrat e tyre, duke thënë se askush nuk mund të garantonte mbrojtjen e dëshmitarëve, sepse tri grupet e dokumenteve mund t'i lexonte kushdo.<sup>1598</sup> Z. Haradinaj vuri në dukje se “kopje tash më nuk po na i nal kërrkush [që të bëhen publike]”.<sup>1599</sup>

757. Në të njëjtën kohë, z. Haradinaj shprehu publikisht dyshim mbi vërtetësinë e deklaratave të dëshmitarëve, duke thënë që këta dëshmitarë kishin dhënë dëshmi të rreme,<sup>1600</sup> “shpifëse dhe të montuara”.<sup>1601</sup> Ai po ashtu pretendoi se dëshmitarët i kishin dhënë dëshmitë nën trysni, dhunë ose shantazh.<sup>1602</sup>

758. Për më tepër, para dhe gjatë periudhës së Aktakuzës, z. Haradinaj i përshkroi dëshmitarët si: (i) “o qyqona, o budallë, spiuna të lind, spiuna” të cilët “të tradhtosh popullin tënd, ushtrinë tënde, të rrejsh, të shpifësh me fakte të armikut”;<sup>1603</sup> (ii) “spiunët serb që u paguan për të dhënë dëshmi kundër UÇK-së”;<sup>1604</sup> (iii) “kolaboracionist”;<sup>1605</sup> (iv) “kriminelë, gjakpirës që kan dhënë urdhër”;<sup>1606</sup> dhe

---

<sup>1598</sup> P1, f. 2, 5; P8, f. 26; P21, f. 5. *Shih gjithashtu* P7, f. 6; P8, f. 14; P11, f. 3; P17, f. 9; P18, f. 2, 7; P19, f. 3; P30, f. 12; P33, f. 1; P34, f. 2. *Shih gjithashtu më lart* poshtëshënimi. 1193 (Pika 3).

<sup>1599</sup> P24, f. 3.

<sup>1600</sup> P25, f. 7.

<sup>1601</sup> P8, f. 31.

<sup>1602</sup> P1, f. 2; P6, f. 25-26; P7, f. 5-6; P8, f. 7, 31-33; P17, f. 2; P24, f. 8; P25, f. 5-6.

<sup>1603</sup> P8, f. 26.

<sup>1604</sup> P83, f. 21-22.

<sup>1605</sup> P6, f. 14; P17, f. 3; P25, f. 7.

<sup>1606</sup> P8, f. 7.

(v) “shqipfolës që kanë prit me duar në amin”.<sup>1607</sup> Në komentin e një personi tjetër, që u vu në profilin e z. Haradinaj në *Facebook* para periudhës së Aktakuzës flitej për “shqipfolsa” “shpifsa” ose “special” së bashku me terma si “shajzen ushtarë”, “njerëz kaq të ultë” dhe “ultrakriminelë”.<sup>1608</sup>

759. Z. Haradinaj pretendoi gjithashtu se DHS-ja/ZPS-ja do të dështonin “se edhe dëshmitarët secili e dinë kush a konë”.<sup>1609</sup> Deklaratat e tij përmbanin mesazhin se të gjithë e dinin kush ishin dëshmitarët dhe askush nuk do t’i mbronte se ishin “shqipfolsa” dhe “spiun [të lindur]” që “tradhtojnë [kombin e tyre]”.<sup>1610</sup> Z. Haradinaj e tha hapur se “pak e ka dert punën e atyre dëshmitarëve të Hagës” dhe se “ka qejf krejt me i qitë”.<sup>1611</sup>

760. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se z. Haradinaj mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në veprën penale në Pikën 3.

iv) Pika 1

761. Gjatë kohës që kryente veprimet dhe bënte deklaratat e përshkruara në paragrafët 747-758, z. Haradinaj shprehimisht e lidhi vendimin e tij për publikimin e informacionit të mbrojtur me faktin se ai nuk e njihte DHS-në/ZPS-në.<sup>1612</sup> Ai e përshkroi DHS-në/ZPS-në si “skandaloze”,<sup>1613</sup> “të turpshme”,<sup>1614</sup> të ngjashme apo dhe më keq se “qebaptore”,<sup>1615</sup> “ëmbëltoare”,<sup>1616</sup> “pastiçeri serbe”<sup>1617</sup> ose “posllastiçar”,<sup>1618</sup>

<sup>1607</sup> P37 (24 qershor 2020), f. 8, 11.

<sup>1608</sup> [REDAKTUAR], Postimi i dikujt tjetër i paraqitur në profilin e z. Haradinaj në *Facebook*, [REDAKTUAR].

<sup>1609</sup> P8, f. 30-31.

<sup>1610</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3).

<sup>1611</sup> P1, f. 5.

<sup>1612</sup> P18, f. 1.

<sup>1613</sup> P1, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1614</sup> P1, f. 3 (z. Haradinaj).

<sup>1615</sup> P17, f. 9; P18, f. 2, 7; P19, f. 3; P34, f. 2.

<sup>1616</sup> P25, f. 2, 8.

<sup>1617</sup> P19, f. 3.

<sup>1618</sup> P34, f. 2.

më keq se “gjykatat e xhunglës”;<sup>1619</sup> dhe me një gjykatës që kishte bërë “zero”.<sup>1620</sup> Z. Haradinaj u shpreh se DHS-ja/ZPS-ja ishte “raciste, monoetnike, selektive”.<sup>1621</sup> Ai tha se ishte detyra e tyre të siguronin që Kosova të mos dënohej për krime dhe bijtë e Kosovës të mos dënoheshin si kriminelë.<sup>1622</sup> Kur e pyetën nëse e dinte që zbulimi i informacionit mund të dëmtonte procesin gjyqësor, z. Haradinaj u përgjigj: “Pooo qejfi im është ... po ky qejfi im është”.<sup>1623</sup>

762. Trupi Gjykses konstaton në lidhje me Pikën 1 se veprimet dhe deklaratat e mësipërme të z. Haradinaj përbëjnë tentativë për pengim brenda kuptimit të nenit 401(1) të KPK-së. Sjellja e tij gjithashtu përbën tentativë për pengimin e punës së prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(5) të KPK-së.

763. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se z. Haradinaj mori pjesë dhe kontribuoi në mënyrë thelbësore në veprën penale të paraqitur në Pikën 1.

(d) Pjesëmarrje me synim e të akuzuarve

764. Vendimet e përbashkëta dhe veprimet e bashkërenduara të të akuzuarve si dhe veprimet e deklaratat e tyre individuale të përshkruara në paragrafët 724-725, 728-744 dhe 747-762 vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se të dy morën pjesë me synim dhe kontribuan në mënyrë thelbësore në veprat penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6.

(e) Përfundim

765. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit morën pjesë bashkërisht dhe kontribuan thelbësisht si bashkëkryes në kryerjen e veprave penale në Pikat 1, 3, 5 dhe 6.

---

<sup>1619</sup> P2, f. 2.

<sup>1620</sup> P7, f. 6.

<sup>1621</sup> P21, f. 4. *Shih gjithashtu* P1, f. 2; P2, f. 6; P17, f. 1; P38, f. 1-2 (25 qershor 2020); P49, f. 2 (31 tetor 2018).

<sup>1622</sup> P8, f. 6.

<sup>1623</sup> P18, f. 5.

## 2. Kryerja individuale

766. Z. Gucati i bëri personalisht veprimet dhe deklaratat e përshkruara në paragrafët 728-744. Po kështu, z. Haradinaj i bëri personalisht veprimet dhe deklaratat e përshkruara në paragrafët 747-762. Këto veprime dhe deklarata u bënë në kuadër të pjesëmarrjes dhe kontributit thelbësor të tyre si bashkëkryes për veprat penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6. Për këto arsye, Trupi Gjykes nuk do të shqyrtojë kryerjen individuale si formë më vete të përgjegjësisë penale në kuadër të marrjes së vendimit mbi fajësinë lidhur me këto Pika.

767. Meqenëse faktet dhe rrethanat përkatëse në Pikën 2 kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në veprimin e përbashkët të një grupi dhe rrjedhimisht nënkuptojnë vetvetiu sjellje të përbashkët nga të akuzuarit, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve në lidhje me këtë pikë Trupi Gjykes i trajton si kryerje individuale.<sup>1624</sup>

### (a) Z. Gucati

768. Krahas veprimeve dhe deklaratave të tij të përshkruara në paragrafët 728-744, z. Gucati veproi si anëtar dhe si udhëheqës i grupit, që, me anë të veprimeve të përbashkëta tentoi të pengonte zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e punës së ZPS-së.<sup>1625</sup> Veçanërisht, z. Gucati mori pjesë dhe udhëhoqi grupin: (i) duke urdhëruar z. Klinaku t'u dërgonte ftesa gazetarëve për konferencat e ardhshme për shtyp;<sup>1626</sup> (ii) duke u pajtuar që z. Haradinaj të kishte rolin kryesor gjatë konferencave për shtyp;<sup>1627</sup> (iii) prezantoi temën e tri konferencave për shtyp dhe më pas ia dha fjalën

---

<sup>1624</sup> F74 Vendimi i Konfirmimit, para. 87.

<sup>1625</sup> *Shih më lart* para. 678-690, 704-707 (Pika 2).

<sup>1626</sup> 1D3, para. 18; 2D1, para. 52, 56; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2170, 2190-2191. *Shih gjithashtu* 2D1, para. 73; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2410; Transkripti, 11 janar 2022, f. 2727, 2746.

<sup>1627</sup> 1D3, para. 20.

z. Haradinaj,<sup>1628</sup> i cili foli nën autoritetin e z. Gucati;<sup>1629</sup> (iv) duke udhëzuar z. Klinaku t'i dorëzonte ZPS-së ato çka kishin mbetur nga grupi i parë i dokumenteve;<sup>1630</sup> (v) duke folur në tri konferencat për shtyp dhe në paraqitje të tjera në media në cilësinë e kryetarit të OVL-UÇK-së;<sup>1631</sup> dhe (vi) duke autorizuar z. Klinaku të vepronte si përfaqësues i OVL-UÇK-së gjatë kontrollimit të selisë më 25 shtator 2020.<sup>1632</sup> Z. Gucati mori pjesë në vendimin e kryesisë së OVL-UÇK-së më 14/15 shtator 2020, për të bërë publike materiale të DHS-së/ZPS-së sa herë që do të merreshin prej organizatës.<sup>1633</sup>

769. Veprimet dhe deklaratat e z. Gucati demonstrojnë se ai kreu me synim veprën penale të Pikës 2.<sup>1634</sup> Gjithashtu, sjellja e tij përbënte tentativë për pengimin e prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së në kuptim të nenit 401(5) të KPK-së.

770. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykues konstaton se z. Gucati kreu individualisht veprën penale të Pikës 2 dhe veprimi i tij përmbush kriteret e të dyja formave të rënda të kësaj vepre penale.

(b) Z. Haradinaj

771. Krahas veprimeve dhe deklaratave të tij, të përshkruara në paragrafët 747-762, z. Haradinaj veproi edhe si anëtar i grupit, i cili me anë të veprimeve të përbashkëta, tentoi të pengonte zyrtarët e DHS-së/ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare të ZPS-së.<sup>1635</sup> Konkretisht, z. Haradinaj mori pjesë në ndarjen e detyrave të grupit: (i) duke këqyrrur tri grupet e dokumenteve bashkë me z. Gucati, z. Klinaku dhe persona të

<sup>1628</sup> P1, f. 1; P2, f. 1-1; P35, f. 1-2.

<sup>1629</sup> 1D3, para. 48 (z. Gucati: "E pranoj se [z. Haradinaj] ka folur me autorizimin tim dhe autorizimin e kryesisë").

<sup>1630</sup> 1D7, para. 20; P13, f. 1; P57.

<sup>1631</sup> P1, f. 1; P9, f. 1; P2, f. 1-2; P28, f. 1, 7; P29, f. 1.

<sup>1632</sup> 1D3, para. 55.

<sup>1633</sup> P9, f. 8; 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746.

<sup>1634</sup> *Shih më lart* para. 671 (Pika 1).

<sup>1635</sup> *Shih më lart* para. 678-690 (Pika 2).

tjerë;<sup>1636</sup> (ii) duke përshkruar gjerësisht përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve, me miratimin e z. Gucati;<sup>1637</sup> dhe (iii) duke marrë pjesë në disa paraqitje në media, në emër të OVL-UÇK-së, ku z. Haradinaj, ndër të tjera, përshkroi llojin dhe/ose përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve dhe në mënyrë të përsëritur u betua se do të publikonte çdo dokument tjetër të DHS-së/ZPS-së që do të merrte.<sup>1638</sup> Z. Haradinaj mori pjesë në vendimin e kryesisë së OVL-UÇK-së më 14/15 shtator 2020, për të bërë publike materiale të DHS-së/ZPS-së sa herë që do të merreshin prej organizatës.<sup>1639</sup>

772. Veprimet dhe deklaratat e z. Haradinaj demonstrojnë se ai kreu me synim veprën penale të Pikës 2.<sup>1640</sup> Sjellja e tij përbënte tentativë për pengimin e prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së brenda kuptimit të nenit 401(5) të KPK-së.

773. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se z. Haradinaj kreu personalisht veprën penale të Pikës 2 dhe sjellja e tij përmbush gjithashtu kriteret e të dyja formave të rënda të veprës penale të paraparë në nenin 401(5) të KPK-së.

### 3. Tentativa

774. Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit bashkëkryen veprat penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6, si dhe kryen individualisht veprën penale në Pikën 2. Trupi Gjykses rithekson se veprat penale të Pikave 1 dhe 2 quhen të kryera edhe kur pengimi vetëm u tentua.<sup>1641</sup>

775. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë tentativën si formë të përgjegjësisë penale në kuadër të marrjes së vendimit mbi fajësinë dhe rrjedhimisht nuk do ta trajtojë më tej.

---

<sup>1636</sup> *Shih më lart* poshtëshënimi 1417.

<sup>1637</sup> P1, f. 1-3, 6-7; P2, f. 2-3, 10-11; P35, f. 2-3; 1D3, para. 20.

<sup>1638</sup> *Shih më lart* poshtëshënimi 1585.

<sup>1639</sup> 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746.

<sup>1640</sup> *Shih më lart* para. 671 (Pika 1).

<sup>1641</sup> *Shih më lart* para. 141, 158 (Ligji në fuqi).

#### 4. Marrëveshja për kryerjen e veprës penale

##### (a) Marrëveshja për kryerjen e veprës penale

776. Sikurse u konstatua në paragrafin 724, pas çdo dorëzimi të dokumenteve në selinë e OVL-UÇK-së, të akuzuarit bashkë me persona të tjerë vendosën bashkërisht të organizonin konferencë për shtyp dhe t'i bënin publike dokumentet e marra. Për më tepër, më 14 ose 15 shtator 2020, kryesia e OVL-UÇK-së e përbërë nga 23 anëtarë (ku bënin pjesë edhe dy të akuzuarit) vendosi njëzëri të publikonte materialet e DHS-së/ZPS-së sa herë që të merreshin prej organizatës.<sup>1642</sup> Të akuzuarit, z. Klinaku dhe persona të tjerë ndërmorën një sërë veprimesh të përbashkëta për përgatitjen dhe mbajtjen e tri konferencave për shtyp si dhe në lidhje me sekuestrimin e paketave nga ZPS-ja. Të akuzuarit, z. Klinaku dhe z. Tomë Gashi morën pjesë në disa paraqitje në media, ku shprehën pikëpamje përputhëse lidhur me zbulimin e informacionit të mbrojtur, dëshmitarët dhe pengimin e DHS-së/ZPS-së.<sup>1643</sup>

##### (b) Marrëveshja për veprime thelbësore për kryerjen e veprës penale

777. Veprimet dhe deklaratat personale të dy të akuzuarve, të përshkruara në paragrafët 728-744 dhe 747-762 përfshijnë hapa përgatitorë thelbësorë për kryerjen e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë. Konkretisht, sikurse përshkruhet në paragrafët 728-729, z. Gucati i këqyri të tri grupet e dokumenteve, dhe vendosi, bashkë me persona të tjerë, të thërriste konferencë për shtyp pas çdo dorëzimi si dhe udhëzoi z. Klinaku, të paktën në dy raste, të ftonte median në konferencat për shtyp. Në mënyrë të ngjashme, sikurse përshkruhet në paragrafin 747, z. Haradinaj i këqyri me hollësi tri grupet e dokumenteve para tri konferencave për shtyp dhe mori pjesë në vendimin për të mbajtur tri konferencat për shtyp.

---

<sup>1642</sup> 1D8, para. 9; 1D9, para. 23, 29; 2D1, para. 73. *Shih gjithashtu* DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2458, 2472-2473, 2475; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746.

<sup>1643</sup> *Shih më lart* para. 678-691 (Pika 2).

(c) Synimi

778. Veprimet dhe deklaratat e të dy të akuzuarve vërtetojnë se të dy u morën vesh me synim që të kryenin veprat penale të paraqitura në Aktakuzë.

(d) Përfundim

779. Duke pasur parasysh sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit u morën vesh të kryenin veprat penale për të cilat akuzohen dhe të dy ndërmorën veprime përgatitore thelbësore për kryerjen e tyre. Sidoqoftë, Trupi Gjykses gjykon se kjo formë e përgjegjësisë penale është pjesë e përgjegjësisë penale individuale të të akuzuarve si bashkëkryes për veprat penale në Pikat 1, 3, 5 dhe 6 dhe si kryes individual për veprën penale në Pikën 2 – aspekte që tashmë janë argumentuar.

780. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do ta konsiderojë marrëveshjen për kryerjen e veprës penale si formë të përgjegjësisë penale në kuadër të marrjes së vendimit mbi fajësinë.

## 5. Nxitja

781. Trupi Gjykses konstaton se forma e tretë e nxitjes, sipas nenit 32(3) të KPK-së, nuk mund të zbatohet për asnjë nga gjashtë akuzat.<sup>1644</sup> Si rrjedhojë, Trupi Gjykses do të shqyrtojë vetëm formën e parë dhe të dytë të nxitjes (neni 32(1)-(2) i KPK-së).

782. Trupi Gjykses rikujton se ZPS-ja i akuzoi të akuzuarit për nxitje në lidhje me pesë kategori personash: (i) njëri-tjetrin; (ii) z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe anëtarë ose përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së; (iii) personat që morën pjesë, vëzhguan ose që u informuan lidhur me tri konferencat për shtyp dhe paraqitje të tjera në media; (iv) disa

---

<sup>1644</sup> *Shih më lart* para. 193 (Dispozitat ligjore përkatëse).



përfaqësues të shtypit; dhe (v) persona që kishin në zotërim ose kishin qasje në informacion konfidencial dhe jopublik lidhur me proceset e DHSK-së.<sup>1645</sup>

783. Në lidhje me kategorinë e parë, Trupi Gjykses nuk është bindur se provat vërtetojnë që njëri apo të dy të akuzuarit nxitën njëri-tjetrin të kryenin veprat penale të paraqitura në Aktakuzë. Në fakt, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se të akuzuarit bashkëkryen veprat penale në Pikat 1, 3, 5 dhe 6 dhe kryen individualisht veprën penale në Pikën 2. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se asnjërit nga të akuzuarit nuk iu bënë pyetje nga ZPS-ja në lidhje me këtë pretendim.

784. Në lidhje me kategorinë e dytë, Trupi Gjykses nuk është bindur se provat vërtetojnë se njëri apo të dy të akuzuarit nxitën z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe anëtarë apo përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së. Sa i takon z. Klinaku, Trupi Gjykses ka vërtetuar tashmë se ai ishte pjesë e grupit që përfshinte dhe të akuzuarit, të cilët, me veprimet e përbashkëta tentuan të pengonin DHS-në/ZPS-në.<sup>1646</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se z. Klinaku vazhdimisht përsëriti deklaratat dhe pikëpamjet e shprehura prej të akuzuarve.<sup>1647</sup> Nuk ka asnjë provë që të tregojë se kjo ishte rezultat i nxitjes nga të akuzuarit. Sa i takon z. Tomë Gashi, provat tregojnë se ai i këshilloi të akuzuarit dhe se pikëpamjet e tij ishin përgjithësisht në përputhje me pikëpamjet e të akuzuarve.<sup>1648</sup> Nuk ka asnjë provë se kjo ishte rezultat i nxitjes nga të akuzuarit. Sa u takon anëtarëve të tjerë të OVL-UÇK-së, provat janë të pamjaftueshme për të përcaktuar ndonjë akt nxitjeje nga ana e të akuzuarve.

785. Në lidhje me kategorinë e tretë dhe të katërt, fillimisht Trupi Gjykses vëren se rrethi i personave në këto kategori u përkufizua në mënyrë të përgjithshme nga ZPS-ja. Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit i vunë tri grupet e dokumenteve në

---

<sup>1645</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 41-43. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 275 (me numërtim tjetër të kategorive).

<sup>1646</sup> *Shih më lart* paras 685-690 (Pika 2).

<sup>1647</sup> *Shih më lart* para. 687 (Pika 2).

<sup>1648</sup> *Shih më poshtë* para. 904 (Argumentet mbrojtëse).

dispozicion të gazetarëve dhe i inkurajuan ata të publikonin përmbajtjen e tyre.<sup>1649</sup> Po ashtu, Trupi Gjykses konstatoi se pas çdo konference për shtyp, në media dolën artikuj me përshkrime apo pamje të fotografuara nga ekrani të disa faqeve nga tri grupet e dokumenteve.<sup>1650</sup> Megjithatë, kjo në vetvete nuk vërteton përtej dyshimit të arsyeshëm se inkurajimi, nxitja apo ushtrimi i trysnisë nga ana e të akuzuarve shkaktoi apo përforcoi vendimin e përfaqësuesve të pidentifikuar të shtypit për të publikuar artikujt e përmendur më lart. Po ashtu, kjo nuk vërteton se përfaqësuesit e pidentifikuar të shtypit zbuluan informacion konfidencial me synimin kriminal të nevojshëm. Trupi Gjykses nuk është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se kritikantët e z. Haradinaj ndaj medias apo gazetarëve për mospublikimin e informacionit patën ndonjë ndikim me rëndësi materiale në vendimin e disa gazetarëve për ta publikuar materialin. Është domethënë fakti që ZPS-ja nuk i bëri pyetje z. Berisha në lidhje me këtë sugjerim dhe është e qartë nga dëshmia e z. Berisha se ai vendosi të publikonte pjesë të informacionit me bindjen se do t'i shërbente publikut dhe jo se u nxit prej të akuzuarve që t'i publikonte. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se të akuzuarit nxitën ndonjë person tjetër në këto kategori që të kryenin veprat penale të paraqitura në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se me kryerjen e veprave penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të akuzuarit nxitën gazetarët të publikonin tri grupet e dokumenteve dhe qortuan disa prej gazetarëve që nuk e kishin bërë këtë,<sup>1651</sup> në përpjekje për të zgjeruar rrezën e shpërndarjes së informacionit të mbrojtur.<sup>1652</sup> Trupi Gjykses mendon se këto konstatime, që janë pjesë e përgjegjësinë individuale të të

---

<sup>1649</sup> *Shih më lart* para. 481-482 (Pika 5).

<sup>1650</sup> *Shih më lart* para. 225, 235, 252, 266-267, 278, 291-292 (Ngjarjet në fjalë), 343, 356 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1651</sup> *Shih më lart* paras 481-482 (Pika 5), 729, 735, 748, 750, 753 (Format e përgjegjësisë penale).

<sup>1652</sup> *Shih më lart* paras 561-564 (Pika 3).

akuzuarve si bashkëkryes apo kryes individualë, i pasqyrojnë më së miri provat e përfshira në dokumentacionin e çështjes.

786. Në lidhje me kategorinë e pestë, Trupi Gjykses vëren njësoj si më lart se ZPS-ja bëri vetëm një përkufizim të përgjithshëm të rrethit të personave. Për më tepër, provat tregojnë se tri grupet e dokumenteve u dorëzuan nga persona të ndryshëm.<sup>1653</sup> Sidoqoftë, pretendimi për nxitje mund të zbatohet vetëm për personat që dorëzuan grupin e dytë dhe të tretë të dokumenteve, pasi ZPS-ja nuk pretendon se deklaratat e të akuzuarve para periudhës së Aktakuzës mund të kenë shërbyer si nxitje për personin që dorëzoi grupin e parë të dokumenteve. Në lidhje me këtë, gjatë gjykimit nuk u paraqit asnjë provë se personat që dorëzuan grupin e dytë dhe të tretë të dokumenteve e bënë këtë për shkak të ndikimit psikologjik që ushtruan të akuzuarit mbi ta. Trupi Gjykses pranon se u kryen tri dorëzime dhe se të akuzuarit i mirëpritën ato dhe madje inkurajuan dorëzime të mëtejshme. Sidoqoftë, kjo në vetvete nuk vërteton se deklaratat inkurajuese të të akuzuarve krijuan apo përforcuan vendimin e personave të paidentifikuar për t'i dorëzuar dokumente OVL-UÇK-së. Arsyet pse ata e bënë këtë nuk janë përcaktuar dhe nuk ka asnjë tregues që sjellja e tyre u ndikua në ndonjë mënyrë nga ato që bënë a thanë të akuzuarit. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se të akuzuarit nxitën personat në këtë kategori të kryen apo tentuan të kryen veprat penale në Aktakuzë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se, me kryerjen e veprave penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të akuzuarit bënë me dije se nëse u çoheshin më shumë dokumente, OVL-UÇK-ja do t'i pranonte dhe ftuan personin apo personat që dorëzuan dokumentet që të sillnin të tjera.<sup>1654</sup> Trupi Gjykses konstaton se këto konstatime, që janë pjesë e

---

<sup>1653</sup> P4, f. 6 (ku z. Gucati tregon se personi që solli paketën 1 nuk është i njëjti person që solli paketën 2); 1D4, f. 34 (ku znj. Miftari tregon se personi që solli paketën 3 nuk është i njëjti person që solli paketat 1 dhe 2). *Shih gjithashtu* P12, f. 3 (z. Tomë Gashi: "Një person i caktuar, do të thotë gjithmonë i ndryshëm, po i sjell dhe po i len këto dokumente").

<sup>1654</sup> *Shih më lart* para. 729, 748.

përgjegjesisë penale individuale të të akuzuarve si bashkëkryes dhe kryes individuale, i pasqyrojnë më së miri provat e përfshira në dokumentacionin e çështjes.

787. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë nxitjen si formë të përgjegjesisë penale në kuadër të marrjes së vendimit mbi fajësinë.

## 6. Ndihma

788. Trupi Gjykses rikujton se ZPS-ja i akuzoi të akuzuarit për ndihmë në lidhje me pesë kategori personash: (i) njëri-tjetrin; (ii) z. Klinaku, z. Tomë Gashi dhe persona të tjerë apo përfaqësues të OVL-UÇK-së; (iii) personat që morën pjesë, vëzhguan apo u informuan lidhur me tri konferencat për shtyp dhe paraqitjet e tjera në media; (iv) disa përfaqësues të shtypit; dhe (v) personat që zotëronin apo kishin qasje në informacion konfidencial dhe jopublik lidhur me proceset e DHS-së.<sup>1655</sup>

789. Në lidhje me kategorinë e parë, Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6. Çdo ndihmë që mund të kenë dhënë të akuzuarit është pjesë e veprimeve të tyre si bashkëkryes apo kryes individuale.

790. Në lidhje me kategorinë e dytë, Trupi Gjykses përsërit se sa u përket veprimeve të personave kundër të cilëve nuk janë paraqitur akuza, ai do t'i marrë ato në shqyrtim vetëm për aq sa janë të nevojshme për vlerësimin e përgjegjesisë penale të dy të akuzuarve.<sup>1656</sup> Pretendimi i ZPS-së lidhur me kategorinë e dytë do të kërkonte që Trupi Gjykses të bënte konstatime për sjelljen e personave kundër të cilëve nuk janë ngritur akuza, si kryes kryesorë. Një konstatim i tillë nuk është i nevojshëm për marrjen e vendimit lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarve, sepse Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se ata i kryen veprat penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6. Sidoqoftë,

---

<sup>1655</sup> F251/A01 Aktakuza, para. 44. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 275 (me numërtim tjetër të kategorive).

<sup>1656</sup> *Shih më lart* para. 16 (Pikat e Aktakuzës). *Shih gjithashtu* ECtHR, [Karaman Judgment](#), para. 40-44, 64.

Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja nuk përcaktoi qartë sjelljen konkrete të të akuzuarve që ndihmoi një person konkret për të cilin nuk është ngritur aktakuzë, dhe mënyrën konkrete të ndihmës. Po ashtu, Trupi Gjykses nuk e ka të qartë se çfarë sjellje nuk kishte marrë parasysh në konstatimet e veta lidhur me kryerjen, që do të përbënte provë për ndihmë të fajshme nga të akuzuarit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se të akuzuarit ndihmuan ndonjë prej personave në kategorinë e dytë në kryerjen e veprave penale në Aktakuzë.

791. Në lidhje me kategorinë e tretë dhe të katërt, Trupi Gjykses përsërit se ZPS-ja bëri vetëm një përkufizim të përgjithshëm të rrethit të personave. Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit u vunë në dispozicion gazetarëve tri grupet e dokumenteve dhe i inkurajuan ata të publikonin përmbajtjet e tyre.<sup>1657</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se pas çdo konference për shtyp, në media dolën artikuj me përshkrime ose pamje të fotografuara nga ekrani të faqeve nga tri grupet e dokumenteve.<sup>1658</sup> Për këtë arsye, Trupi Gjykses pranon se vënia e tri grupeve të dokumenteve në dispozicion të gazetarëve mund të përbëjë një formë ndihme në kryerjen e veprave penale në Pikat 5 dhe 6. Sidoqoftë, kjo në vetvete nuk vërteton se përfaqësues të pidentifikuar të shtypit zbuluan informacion të mbrojtur me synimin kriminal të nevojshëm, si kryes kryesorë të veprave penale në Pikat 5-6. Po kështu, kjo nuk vërteton as se përfaqësues të pidentifikuar të shtypit vepruan si kryes kryesorë për ndonjë nga veprat e tjera penale në Aktakuzë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses merr parasysh pranimin e ZPS-së se ajo nuk po argumenton që z. Berisha kreu vepër penale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se të akuzuarit ndihmuan ndonjë prej personave të kësaj kategorie në kryerjen e veprave penale në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se me kryerjen e veprave penale në Pikat 1, 2, 3,

---

<sup>1657</sup> *Shih më lart* para. 481-482 (Pika 5).

<sup>1658</sup> *Shih më lart* para. 225, 235, 252, 266-267, 278, 291-292 (Ngjarjet në fjalë), 343, 356 (Konstatime mbi paketat).

5 dhe 6, të akuzuarit i inkurajuan gazetarët të publikonin tri grupet e dokumenteve dhe qortuan disa gazetarë që nuk e kishin bërë këtë,<sup>1659</sup> në përpjekje për të zgjeruar rrezen e shpërndarjes së informacionit të mbrojtur.<sup>1660</sup> Trupi Gjykses vlerëson se këto konstatime, që janë pjesë e përgjegjësisë individuale të të akuzuarve si bashkëkryes ose kryes individuale, pasqyrojnë më së miri provat e përfshira në dokumentacionin e çështjes.

792. Në lidhje me kategorinë e pestë, Trupi Gjykses vëren sikurse më lart, se rrethi i personave përkatës është përkufizuar në mënyrë të përgjithshme nga ZPS-ja. Për më tepër, provat tregojnë se tri grupet e dokumenteve u dorëzuan nga tre persona të ndryshëm.<sup>1661</sup> Trupi Gjykses konstatoi se ishin bërë tre dorëzime dhe se të akuzuarit i mirëpritën e madje inkurajuan dorëzime të mëtejshme dokumentesh.<sup>1662</sup> Megjithatë, Trupi Gjykses nuk ka dëgjuar asnjë dëshmi se deklaratat e të akuzuarve ndihmuan, në çfarëdo forme, personat që dorëzuan materialet. Faktikisht, nuk u paraqit asnjë provë për identitetin, veprimet, dhe dijeninë për llojin e materialeve apo synimin e fajshëm kriminal të këtyre personave. Gjithashtu, ZPS-ja në mënyrë të përsëritur ka këmbëngulur se dorëzimi i tri grupeve të dokumenteve ishte jashtë kuadrit të çështjes. Trupi Gjykses vëren edhe se tre dorëzimet shkaktuan frikë në një nga punonjësit e OVL-UÇK-së dhe z. Klinaku u përpoq ta ndiqte një prej personave në fjalë, e kjo e hedh poshtë pretendimin se të akuzuarit ndihmuan personat që dorëzuan informacionin. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë se të akuzuarit ndihmuan ndonjë person të kësaj kategorie në kryerjen e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë. Sidoqoftë, Trupi Gjykses tashmë ka konstatuar se me kryerjen e veprave penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të akuzuarit bënë me dije se nëse do t'u sillnin më shumë dokumente, OVL-UÇK-ja do t'i pranonte dhe

---

<sup>1659</sup> *Shih më lart* para. 481-482 (Pika 5), 729, 735, 748, 750, 753.

<sup>1660</sup> *Shih më lart* para. 561-564 (Pika 3).

<sup>1661</sup> P4, f. 6; 1D4, f. 34.

<sup>1662</sup> *Shih më lart* para. 253, 255, 270-272, 298 (Ngjarjet në fjalë), 729, 748.

se ftuan personin apo personat që dorëzuan dokumentet që të sillnin edhe të tjera.<sup>1663</sup>

Trupi Gjykses vlerëson se këto deklarata, që janë pjesë e përgjegjësinë individuale të të akuzuarve si bashkëkryes apo kryes individuale, i pasqyrojnë më së miri provat e përfshira në dokumentacionin e çështjes.

793. Për këto arsye, Trupi Gjykses nuk do të shqyrtojë ndihmën si formë të përgjegjësisë penale në kuadër të marrjes së vendimit mbi fajësinë.

## 7. Përfundim

794. Në lidhje me sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit janë penalisht përgjegjës si bashkëkryes për veprat penale në Pikat 1, 3, 5 dhe 6 dhe si kryes individuale për veprën penale në Pikën 2.

## VIII. ARGUMENTET MBROJTËSE

### A. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

795. Si pjesë të mbrojtjes së tyre, të akuzuarit paraqitën një sërë arsyesh për sjelljen e tyre. Në veçanti, ata argumentuan se ata: i) vepruan në shërbim të interesit publik;<sup>1664</sup> (ii) ishin objekt i "shtytjes për kryerjen e veprës penale" nga ZPS-ja;<sup>1665</sup> (iii) bënë gabim ligjor dhe/ose gabim faktik;<sup>1666</sup> (iv) vepruan nga nevoja;<sup>1667</sup> dhe/ose (v) sjelljet e tyre përbënin veprime me rëndësi të vogël.<sup>1668</sup>

---

<sup>1663</sup> *Shih më lart* paras 729, 748.

<sup>1664</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 95-97, 102, 104; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 19, 131, 391, 441, 443, 477, 491, 497. *Shih gjithashtu* F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 29-34; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 283-298.

<sup>1665</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 36-50; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(a), 278-280.

<sup>1666</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(a) dhe (c); F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(b)-(c), 281-282.

<sup>1667</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(b).

<sup>1668</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(d).

796. Pasi ka konstatuar se të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për veprat penale në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, Trupi Gjykses tani do të përcaktojë nëse ndonjë nga argumentet mbrojtëse të paraqitura përjashton përgjegjësinë e tyre penale. Para se të trajtojë secilin prej pretendimeve të lartpërmendura, Trupi Gjykses do të përcaktojë interpretimin e tij të “argumenteve mbrojtëse” sipas kornizës ligjore të DHS-së.

## **B. ARGUMENTET MBROJTËSE NË KORNIZËN LIGJORE TË DHS-SË**

797. Në përputhje me rregullën 95(5) të Rregullores, Mbrojtja mund të përdorë alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar, ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore. Formulimi i kësaj dispozite sugjeron se “argumentet mbrojtëse” dhe “baza që përjashton përgjegjësinë penale” kanë kuptim të njëjtë, domethënë, ato shfaqësojnë sjelljen që përndryshe është kriminale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do t’u referohet këtyre arsyeve si “argumentet mbrojtëse”.

798. Rregullorja nuk përmend asnjë kategori tjetër argumentesh mbrojtëse që mund të ndikojë në përgjegjësinë penale individuale të të akuzuarve.<sup>1669</sup> As rregulla 95(5) e Rregullores dhe asnjë dispozitë tjetër e Ligjit ose e Rregullores nuk tregojnë se cili legjislacion – vendor apo ndërkombëtar – zbatohet për argumentet mbrojtëse, arsyet që përjashtojnë përgjegjësinë penale, ose faktorë të tjerë përligjës që mund të ndikojnë në përgjegjësinë penale individuale.

799. Në lidhje me veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, neni 16(3) i Ligjit parasheh se zbatohen dispozitat për përgjegjësi penale individuale të përfshira në KPK. Sidoqoftë, neni 16(3) i Ligjit nuk përfshin shprehimisht dispozitat e KPK-së që trajtojnë argumentet mbrojtëse. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se rregulla 95(5) e Rregullores rendit shprehimisht tri nga argumentet mbrojtëse të ngritura nga të akuzuarit,

---

<sup>1669</sup> Rregulla 163(1)(a)(i) e Rregullores parashikon se rrethanat që nuk janë të mjaftueshme si arsye për përjashtimin e përgjegjësisë penale mund të konsiderohen rrethana lehtësuese.



domethënë, nevoja ekstreme, gabimet faktike dhe gabimet ligjore, që përkufizohen përkatësisht në nenet 12, 25 dhe 26 të KPK-së. Më tej, Trupi Gjykes vë në dukje se neni 11 i KPK-së rregullon një mënyrë tjetër mbrojtjeje të ngritur nga të akuzuarit, domethënë, vepra me rëndësi të vogël. Në këtë kontekst, Trupi Gjykes është i vetëdijshëm se mohimi i disponueshmërisë së mbrojtjeve të parapara në KPK për gjykimin e veprave penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, mund të cenojë të drejtat e të akuzuarve dhe të shkaktojë pabarazi në trajtimin e tyre. Për këtë arsye, Trupi Gjykes do t'i marrë parasysh këto dispozita kur të trajtojë argumentet mbrojtëse përkatëse.

800. As rregulla 95(5) e Rregullores. as ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit ose Rregullores nuk rendisin shprehimisht veprat në shërbim të interesit publik ose shtytjen për kryerjen e veprës penale si arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale. Megjithatë, për arsyet e përshkruara më poshtë, Trupi Gjykes do t'i trajtojë këto pretendime.

## C. INTERESI PUBLIK

### 1. Parashtrimet e palëve

801. Mbrojtja e Gucatit nuk pretendoi se interesi publik përbënte argument mbrojtës në kuptimin teknik, por sugjeroi se mbrojtja e interesit publik legjitim nga të akuzuarit ishte e rëndësishme për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së tyre, në kuadër të ushtrimit të të drejtave të tyre themelore, veçanërisht në lidhje me Pikat 5 dhe 6.<sup>1670</sup> Mbrojtja e Haradinajt, nga ana tjetër, ngriti pretendimin se mbrojtja e interesit publik do të ishte "mbrojtje aktive" kundër akuzave – ndonëse argumentet e saj lidhur me këtë pikë kanë evoluar.<sup>1671</sup>

---

<sup>1670</sup> F470, para. 45-48. *Shih gjithashtu* F345, para. 20-22; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 461, 466.

<sup>1671</sup> F342, para. 11; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277 (d); Transkripti, 1 shtator 2021, f. 475. *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3690-3692.

802. Sipas Mbrojtjes, veprat e të akuzuarve përbëjnë ushtrim të ligjshëm të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës për të pasur qasje në dokumentet e institucioneve publike dhe organeve të autoriteteve shtetërore, siç garantohet në Kushtetutë.<sup>1672</sup> Mbi këtë bazë, të akuzuarit argumentuan se ata vepruan në shërbim të interesit publik.<sup>1673</sup> Baza ligjore mbi të cilën u mbështet Mbrojtja përfshin: (i) nenet 22, 40, 41 dhe 42 të Kushtetutës; (ii) nenin 200(2) të KPK-së; (iii) nenin 10 të KEDNJ-së; (iv) nenin 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut ("DUDNJ"); dhe (v) nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ("KNDCP").<sup>1674</sup>

803. Mbrojtja e Gucatit parashtrori se informimi i publikut për "bashkëpunimin" e ZPS/TFHS-së me autoritetet serbe dhe zyrtarë të caktuar shtetërorë serbë ishte në të mirë të interesit publik, sa i takon ngritjes së shqetësimeve për pavarësinë dhe paanshmërinë e ZPS-së.<sup>1675</sup> Mbrojtja e Haradinajt pretendoi se zbulimi i dokumenteve të kundërshtuara, nëse vërtetohet, ishte i përligjur, sepse ishte në interesin publik dhe ishte i nevojshëm për ta vënë publikun në dijeni të polemikave lidhur me DHS-në, duke mbrojtur kështu "interestin publik ndërkombëtar dhe kosovar".<sup>1676</sup> Sipas Mbrojtjes së Haradinajt, bërja publike e këtyre fakteve ishte e rëndësishme për të vërtetuar mungesën e pavarësisë dhe/ose të paanshmërisë së ZPS-së dhe/ose DHS-së.<sup>1677</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e Haradinajt argumentoi se z. Haradinaj veproi si

---

<sup>1672</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 21-24, 188, 259-263, 279-282.

<sup>1673</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72-73, 76, 140, 161, 184, 190, 222, 231, 237, 240, 256, 284, 297, 321, 334, 358; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277 (d), 283-298. *Shih gjithashtu* F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 95-97, 102, 104, 108; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 19, 131, 391, 441, 443, 477, 491, 497.

<sup>1674</sup> F345, para. 20-21; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 462, 465.

<sup>1675</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72, 91, 124, 140, 161, 184, 190, 196, 222, 231, 237, 240, 256, 284, 297, 321, 334, 358, 360-362. *Shih gjithashtu* F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 95-97, 102, 104, 108; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 473-474; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3648-3653.

<sup>1676</sup> F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 296. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 19, 131, 391, 441, 443, 477, 491, 497; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3686, 3690-3692, 3696, 3701-3702, 3713-3714.

<sup>1677</sup> F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 289; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 442. *Ngjashëm*, F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 76.

“sinjalizues”, që sipas Mbrojtjes, ishte argument mbrojtës kundër akuzave.<sup>1678</sup> Në mbështetje të argumenteve të saj lidhur me atë pikë, Mbrojtja e Haradinajt thirri znj. Majers (Myers) si eksperte.<sup>1679</sup> Mbrojtja e Gucatit nuk e përfshiu shprehimisht konceptin e “sinjalizuesit” në argumentet mbrojtëse të saj për interesin publik.<sup>1680</sup>

804. Në përgjigje, ZPS-ja parashtrroi se nuk pranonte që interesi publik përbënte argument mbrojtës ndaj akuzave, si dhe kundërshtoi që publikimi i bashkëpunimit ndërmjet Serbisë dhe TFHS-së/ZPS-së ishte në interesin publik. Si alternativë, ZPS-ja argumentoi se edhe nëse do të kishte një interes të tillë publik, ai nuk do të përligjte sjelljen që i atribuohet të akuzuarve.<sup>1681</sup> ZPS-ja hodhi poshtë pretendimin se të akuzuarit mund të konsiderohen sinjalizues, apo që ky është argument mbrojtës ndaj akuzave.<sup>1682</sup>

## 2. Ushtrimi i ligjshëm i të drejtave kushtetuese dhe interesi publik

### (a) Aspekte ligjore

805. Trupi Gjykues thekson se *mungesa* e faktorit të interesit publik nuk është element i asnjërës prej veprave penale në këtë çështje gjyqësore. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme që ZPS-ja të provojë që nuk ka pasur faktor të interesit publik për të vërtetuar elementet e ndonjërës prej veprave penale.<sup>1683</sup> Gjithashtu, në lidhje me Pikat 5 dhe 6, Trupi Gjykues konstatoi se faktorët e interesit publik nuk mund të japin

---

<sup>1678</sup> F301, para. 33-35; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 463. *Shih gjithashtu* F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 477; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3689-3690.

<sup>1679</sup> DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3102-3187.

<sup>1680</sup> DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3095-3096; 16 mars 2022, f. 3724-3725.

<sup>1681</sup> F312, para. 13-14; F341, para. 28; F388, para. 4; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 459-460. *Shih gjithashtu* F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 283-286, 290-294; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3492-3496, 3516-3518.

<sup>1682</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 295-299.

<sup>1683</sup> *Shih për krahasim* F345, para. 20-22; F342, para. 11.

“autorizim” për zbulimin e informacionit brenda kuptimit të nenit 392(1)-(2) të KPK-së.<sup>1684</sup>

806. Trupi Gjykses vëren se Kushtetuta e përmend interesin publik në nenet 46 dhe 119, por në lidhje me tema që nuk kanë të bëjnë me këtë diskutim. Ligji nuk ka referencë apo përkufizim të konceptit “interes publik”. Trupi Gjykses thekson më tej se Rregullorja nuk parashikon mbrojtjen e përgjithshme të interesit publik, as nuk bën përkufizimin e tij. Megjithatë, si Ligji ashtu edhe Kushtetuta kërkojnë që DHS-ja të respektojë dhe zbatojë standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë ato të përcaktuara në KEDNJ.<sup>1685</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se neni 40 i Kushtetutës dhe neni 10 i KEDNJ-së garantojnë lirinë e shprehjes,<sup>1686</sup> dhe se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”) ka përcaktuar se ushtrimi i lirisë së shprehjes në funksion të interesit publik përligj mbrojtje të veçantë.<sup>1687</sup> Duke pasur parasysh nenin 40 të Kushtetutës, nenin 10 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së në lidhje me këtë dispozitë, Trupi Gjykses do të trajtojë pretendimin e Mbrojtjes lidhur me interesin publik në kontekstin e lirisë së shprehjes së të akuzuarve dhe si një përligje të mundshme që mund të ndikojë në përgjegjësinë penale individuale të tyre.

807. Trupi Gjykses konstatoi se përkufizimi i interesit publik i përfshirë në nenin 200(4) të KPK-së ishte përgjithësisht në përputhje me nocionin e interesit publik të njohur nga GJEDNJ-ja dhe nuk ndryshonte në thelb nga neni 10 i KEDNJ-së.<sup>1688</sup> Palët nuk e kundërshtuan relevancën e përkufizimit në nenin 200(4) të KPK-së për këtë

---

<sup>1684</sup> *Shih më lart* para. 487 (Pika 5), 525 (Pika 6).

<sup>1685</sup> Neni 22 i Kushtetutës; Nenet 1(2), 2, 3(2)(e), dhe 21 të Ligjit.

<sup>1686</sup> Neni 40 i Kushtetutës; Neni 10 i KEDNJ-së.

<sup>1687</sup> *Shih p.sh.* ECtHR, [Von Hannover \(no. 2\) GC Judgment](#), para. 109; [Leempoel Judgment](#), para. 68; [Standard Verlags \(No. 2\) Judgment](#), para. 46; [Von Hannover Judgment](#), para. 60. *Shih gjithashtu Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy GC Judgment, para. 171; [Castells Judgment](#), para. 43.*

<sup>1688</sup> F470, para. 54.

proces.<sup>1689</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerësoi pretendimin se të akuzuarit vepruan në funksion të interesit publik brenda kornizës normative të përcaktuar në Kushtetutë, në legjislacionin përkatës të Kosovës të cituar më lart, si edhe në KEDNJ dhe në jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së.

808. Nocionin e interesit publik në kontekstin e bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me Serbinë, Trupi Gjykses e përkufizoi si më poshtë:

Interesi publik në fjalë në lidhje me të cilin mund të nxirren prova të rëndësishme është i kufizuar vetëm në provat që do të sugjeronin se një pjesë e materialit që pretendohet të jetë nxjerrë nga të akuzuarit përmban tregues të veprimeve të papërshtatshme që kanë ndodhur në kontekst të bashkëpunimit midis Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe TFHS-së/ZPS-së, që do të kishte ndikuar në pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.<sup>1690</sup>

809. Asnjëra palë nuk e kundërshtoi këtë konstatim. Në vijim, Trupi Gjykses e zbatoi këtë përkufizim,<sup>1691</sup> të cilit do t'i përmbahet atij në këtë Aktgjykim.

#### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

810. Bazuar në përkufizimin e mësipërm, Trupi Gjykses do të shqyrtojë: (i) nëse informacioni i mbrojtur i zbuluar nga të akuzuarit përmbante ndonjë tregues veprimesh të papërshtatshme në hetimet e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe; (ii) duke supozuar se ishte e arsyeshme që të akuzuarit të besonin se informacioni i mbrojtur përmbante tregues të tillë, nëse veprimet e tyre u nxitën nga faktorë të interesit publik; dhe (iii) duke supozuar se këto veprime u nxitën, të paktën në njëfarë mase, nga faktorë të tillë, nëse kufizimi i të drejtave të tyre ishte i ligjshëm. Mbi këtë

---

<sup>1689</sup> F302, para. 9-10; F301, para. 34. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 469. Mbrojtja e Haradinajt përmendi një numër instrumentesh të tjera në këtë kontekst, pa identifikuar asnjë përkufizim tjetër të "interesit publik" që të ishte i ndryshëm ose të kishte përparësi mbi atë që u citua më sipër. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 469; F300.

<sup>1690</sup> F470, para. 61.

<sup>1691</sup> F502, Vendimi për Provat Jogojore të Gucatit, para. 28, 33. Më 14 janar 2022, Mbrojtjes së Haradinajt iu përmend edhe një herë përkufizimi i "interesit publik" i përdorur nga Trupi Gjykses dhe Mbrojtja nuk e kundërshtoi atë përkufizim. *Shih* Transkripti, 14 janar 2022, f. 3041.

bazë, Trupi Gjykses do të vendosë nëse faktorët e interesit publik përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve.

i) Tregues veprimesh të papërshtatshme në informacionin e mbrojtur

811. Trupit Gjykses iu paraqitën prova se, në kuadër të hetimeve të tyre, TFHS-ja dhe ZPS-ja bashkëpunuan me autoritetet e Republikës së Serbisë për të marrë të dhënat e kontaktit të dëshmitarëve dhe/ose disa të dhëna të rëndësishme për hetimet e TFHS-së/ZPS-së.<sup>1692</sup> Trupi Gjykses konstatoi se paketat 1, 2, dhe 4 përfshinin kërkesa të TFHS-së, përgjigje të PSKL-së dhe dokumente serbe; në këto të fundit kishte, ndër të tjera, emra të zyrtarëve serbë.<sup>1693</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit zbuluan informacion të mbrojtur, i cili përmbante emra të zyrtarëve serbë.<sup>1694</sup> Për më tepër, Trupit Gjykses iu paraqitën prova se të dy të akuzuarit identifikuan publikisht një numër zyrtarësh serbë,<sup>1695</sup> dhe konstatoi se z. Haradinaj përmendi katër persona të cilët cilësoheshin si dëshmitarë ose si dëshmitarë të mundshëm.<sup>1696</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses mori prova se mediat publikuan pamje të fotografuara nga ekrani ose pjesë të shkëputura nga kërkesat e TFHS-së, ose përshkrime se çka mendohej se përmbanin ato dokumente.<sup>1697</sup>

---

<sup>1692</sup> P86, para. 5-12, 22-27; P88; P89; P90, Shtojca 1; P91, Shtojca 1; P93; P94; P95; P96; P97; P139; P140; P141; P142; P143; P144; P145; P146; P147; P148; P149; P150. *Shih gjithashtu* Transkripti, 18 tetor 2021, f. 860-867, 914-915; Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1060, 1075-1078; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1207.

<sup>1693</sup> P90 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 1); P90 (Shtojca 3 – Tabela e paketës 2); P91 (Shtojca 1 – Tabela e paketës 4).

<sup>1694</sup> *Shih më lart* para. 514 (Pika 6).

<sup>1695</sup> P1, f. 2; P2, f. 1-3; P11, f. 9, 30, 55-56; P14, f. 3; P15, f. 2; P17, f. 7; P18, f. 3; P19, f. 1, 4; P24, f. 8-9; P35, f. 3.

<sup>1696</sup> *Shih më lart* para. 345 (Konstatime mbi paketat), 514 (Pika 6).

<sup>1697</sup> P86, para. 13-18, 36-74; P120; P121; P122; P123; P124, f. 2, 4, 6; P125AT, f. 1,4, 9, 11, 14 (P125; P125.1; P125.2; P125.3; P125.4); P128; P129, f. 1, 13-15; P155; P156; P157; P158; P159; P160; 1D2, f. 1, 9, 47, 50, 55, 61; 1D11; 1D12; 1D13; 1D14; 1D15; 1D16; 1D17; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 19 tetor 2021, f. 973-996, 1001-1004; 20 tetor 2021, f. 1103-1115, 1119-1128, 1132-1133, 1143-1146; 26 tetor 2021, f. 1515-1517, 1537-1542, 1584, 1588, 1599-1609, 1612, 1627-1628.

812. Trupi Gjykues pranon se në çdo shoqëri demokratike publiku ka interes legjitim të dijë se si funksionojnë institucionet që veprojnë në emër të tij, dhe nëse ato funksionojnë në nivel të pranueshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues pranon se ekziston, në parim, interes publik legjitim për të ekspozuar çdo veprim të papërshtatshëm shqetësues në mënyrën se si mund t'i kenë kryer hetimet e tyre TFHS-ja dhe ZPS-ja.

813. Trupi Gjykues vëren se bashkëpunimi ndërmjet TFHS-së/ZPS-së dhe Serbisë ishte qartazi i njohur për publikun dhe se kishte qenë publik për shumë kohë para ngjarjeve të shtatorit 2020.<sup>1698</sup> Kjo u pranua lirisht nga të akuzuarit.<sup>1699</sup> Duke e diskutuar faktin se TFHS-ja/ZPS-ja ka bashkëpunuar me Serbinë, të akuzuarit nuk kontribuan në publikimin e diçkaje që nuk dihej publikisht. Megjithatë, Trupi Gjykues pranon argumentin e Mbrojtjes së Gucatit se fakti që informacioni ishte bërë publik jo domosdoshmërisht ia heq atij informacioni vlerën e “interetit publik”.<sup>1700</sup> Ka arsye të tjera që mund ta bëjnë të njëjtin informacion çështje të interesit publik.

814. Në lidhje me këtë, Mbrojtja pretendoi se mbështetja e TFHS-së/ZPS-së tek disa zyrtarë serbë dhe bashkëpunimi me ta ishte provë për veprime të papërshtatshme, pasi ata i konsideronin këta individë përgjegjës për krime lufte ose vegla të regjimit të Millosheviqit. Megjithatë, Trupit Gjykues nuk iu paraqit asnjë provë që ndonjë nga këta individë ishte ndjekur penalisht për ndonjë nga krimet e pretenduara e aq më pak që të ishte dënuar për ndonjë krim.<sup>1701</sup> Fakti që këta individë mund të kenë shërbyer në disa administrata të njëpasnjëshme (përfshirë edhe gjatë kohës së konfliktit në Kosovë) nuk është bazë për të nxjerrë përfundimin se ata kanë marrë pjesë në krime dhe as arsye e vlefshme për të sugjeruar se bashkëpunimi me individë të tillë i heq legjitimitetin hetimit. Edhe nëse ndonjë nga këta individë ishte përfshirë në kryerjen e

---

<sup>1698</sup> C1, f. 6.

<sup>1699</sup> P7, f. 2, 13 (Z. Haradinaj: “Se kan bashkëpunu me serbët, nuk është që e ka dit ky. Këtë e ka dit edhe lopa në arë në Kosovë”); P28, f. 2-3, 9-10; P42; P44; P59, f. 1; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2711, 2713-2714.

<sup>1700</sup> Transkripti, 1 shtator 2021, f. 471. *Shih gjithashtu* Transkripti, 21 janar 2022, f. 3158-3159.

<sup>1701</sup> F470, para. 60.

ndonjë krimi, Trupit Gjykues nuk i janë dhënë prova se TFHS-ja/ZPS-ja ishte në dijeni të këtij fakti në kohën përkatëse dhe, edhe në qoftë se ishte në dijeni, mund të kishte kërkuar mbi atë bazë që të bashkëpunonte me zyrtarë shtetërorë të tjerë. Për sa i përket zyrtarëve serbë me të cilët TFHS-ja/ZPS-ja mund të ketë kontaktuar në kryerjen e detyrave të veta, Trupi Gjykues ka konstatuar më parë se TFHS-ja/ZPS-ja nuk kishte kompetencë dhe nuk mund t'i zgjidhte sipas dëshirës zyrtarë shtetërorë të Republikës së Serbisë me të cilët të bashkëpunonte për përmbushjen e mandatit të vet.<sup>1702</sup> Ky konstatim përputhet dhe mbështetet nga dëshmia e z. Rid.<sup>1703</sup> Në lidhje me zyrtarët serbë të cilët përmbushnin kriteret për të qenë si dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm, Trupi Gjykues ka konstatuar më parë se ZPS-ja ishte e lirë të mblidhte prova nga çdo person për të cilin kishte interes, përfshirë persona të dyshuar ose të dënuar.<sup>1704</sup> Thjesht fakti që ZPS-ja intervistoi ose kërkoi të intervistonte dikë që pretendohet apo mendohej se kishte kryer krim, ose ishte dënuar për një krim, nuk përbën veprim të papërshtatshëm.<sup>1705</sup> Përgjithësisht, mbledhja e provave nga këta persona ose mbledhja e provave jo të besueshme jo domosdoshmërisht tregon se TFHS-ja/ZPS-ja e mori informacionin si të mirëqenë. Sikurse tha edhe z. Rid, provat e dhëna nga dëshmitarët gjatë hetimit gjithmonë duhet të verifikohen dhe të konfirmohen.<sup>1706</sup>

815. Gjithashtu, të akuzuarit pretenduan se deklaratat e mbledhura nga TFHS-ja dhe/ose ZPS-ja mund të jenë marrë me anë të shtrëngimit ose të presionit.<sup>1707</sup> Këto pretendime bazoheshin ose në argumentin se intervistat u zhvilluan në Serbi ose mbi bazën se disa dëshmitarë i konfirmuan TFHS-së/ZPS-së një version që ata mund ta kishin dhënë në kohën e konfliktit. Trupi Gjykues është i mendimit se asnjë nga këta

---

<sup>1702</sup> F470, para. 59. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator, 2021, f. 476; F302, para. 11-23; F301, para. 36-47.

<sup>1703</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3362-3365.

<sup>1704</sup> F502 Vendimi për Provat Jogojore të Gucatit, para. 33.

<sup>1705</sup> F502 Vendimi për Provat Jogojore të Gucatit, para. 33.

<sup>1706</sup> DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 28 janar 2022, f. 3363-3364.

<sup>1707</sup> P1, f. 2; P6, f. 26; P7, f. 5-6, 9-10; P8, f. 7; P17, f. 2; P25, f. 5-6; P59, f. 2, 5.



faktorë – edhe sikur të ishin të vërtetë – nuk tregojnë se deklaratat janë marrë me anë të shtrëngimit ose të presionit në kontekstin e bashkëpunimit të TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe. Thjesht nuk ka asnjë provë që e mbështet atë pretendim.

816. Së fundi, të akuzuarit pretenduan se dëshmitarët kishin dhënë deklarata të rreme gjatë hetimit, për të siguruar të drejtën e banimit ose azilin.<sup>1708</sup> Trupi Gjykyes thekson se nuk ka asnjë provë që vërteton pretendimet e të akuzuarve për këtë.

817. Rrjedhimisht, Trupi Gjykyes gjykon se nuk ka arsye të besueshme për të arritur në përfundimin se në informacionin e mbrojtur që zbuluan të akuzuarit kishte tregues të veprimeve të papërshtatshme të cilat mund t'i atribuohen TFHS-së/ZPS-së.

ii) Qëllimi i të akuzuarve në zbulimin e informacionit të mbrojtur

818. Në qoftë se për hir të argumentit supozohet se ishte e arsyeshme që të akuzuarit të besonin se informacioni i mbrojtur kishte tregues veprimesh të papërshtatshme që ndikuan në hetimet e TFHS-së/ZPS-së; Trupi Gjykyes rikujton konstatimin e vet për Pikën 6 se të akuzuarit zbuluan emra, vendbanime të kaluara dhe të tanishme, numra telefonikë, përkatësi etnike, vendndodhje të intervistave dhe përmbajtje të deklaratave të dëshmitarëve.<sup>1709</sup> Ata zbuluan dhe emra të të pandehurve të mundshëm, vende krimesh të mundshme dhe produkt sensitiv të punës së brendshme të ZPS-së.<sup>1710</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykyes konstatoi se të akuzuarit zbuluan informacionin e mbrojtur pa dallim, pa e përzgjedhur përmbajtjen e tij,<sup>1711</sup> dhe se ata u përpoqën që të arrinin shpërndarje të gjerë të materialit.<sup>1712</sup> Veprime të tilla u shoqëruan me vërejtje nënçmuese ndaj dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm dhe konfirmime të përsëritura të dëshirës së tyre për të dëmtuar punën e DHS-së/ZPS-së.<sup>1713</sup>

---

<sup>1708</sup> P9, f. 11; P25, f. 7; P59, f. 2, 5. *Shih gjithashtu* P37, f. 11-12; P49, f. 13.

<sup>1709</sup> *Shih më lart* para. 520 (Pika 6).

<sup>1710</sup> *Shih më lart* para. 362-371 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1711</sup> *Shih më lart* para. 530 (Pika 6), 628 (Pika 4).

<sup>1712</sup> *Shih më lart* para. 498 (Pika 5), 564 (Pika 3).

<sup>1713</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3), 662-669 (Pika 1).

819. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se veprime të tilla shkojnë shumë më tej dhe përgënjeshtrojnë çdo përfundim se qëllimi i të akuzuarve ishte vetëm që të demaskonin ato që ata i quanin veprime të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me Serbinë.

iii) Ligjshmëria e kufizimit të të drejtave të të akuzuarve

820. Duke supozuar përsëri, për hir të argumentit, se megjithatë veprimet e të akuzuarve përfshiheshin pjesërisht në pretendimin e “interetit publik”, Trupi Gjykses do të shqyrtojë në vijim nëse, në rrethana të tilla, ishte i ligjshëm kufizimi i së drejtës së lirisë së fjalës dhe i qasjes në informacion përmes ndjekjes penale.

821. Trup Gjykses thekson se e drejta e lirisë së fjalës (dhe e qasjes në informacionin përkatës) e të akuzuarve nuk është absolute.<sup>1714</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konstaton se, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, kufizimi i të drejtave të të akuzuarve si pasojë e arrestimit, hetimit dhe ndjekjes penale të tyre ishte përcaktuar me ligj, pasi bazohej në dispozitat e KPK-së (nenet 387, 388, 392 dhe 401) dhe në Ligj (neni 15(2)). Për më tepër, kufizimi i të drejtave të të akuzuarve u bë për mbrojtjen e një vargu interesash publike legjitime, të tilla si mbrojtja e dëshmitarëve nga dëmtimi, për t'i mundësuar ZPS-së përmbushjen efektive të mandatit të vet dhe për të ruajtur besimin e publikut në integritetin e proceseve të DHS-së.<sup>1715</sup> Gjithashtu, duke marrë parasysh rëndësinë e dëshmitarëve për hetimet penale nga njëra anë dhe llojin e informacionit të zbuluar, mënyrën jopërzgjedhëse të zbulimit, numrin e madh të dëshmitarëve të prekur dhe qëllimet e deklaruara të zbulimit nga ana tjetër, Trupi Gjykses është bindur se kufizimi ishte gjithashtu i domosdoshëm në një shoqëri

---

<sup>1714</sup> Neni 40(2) i Kushtetutës; Neni10(2) i KEDNJ-së.

<sup>1715</sup> *Shih p.sh.* ECtHR, [Bédat GC Judgment](#), para. 55; *Shih gjithashtu* DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3172-3173. *Shih gjithashtu* para. 644-647 (Pika 1).

demokratike, për të mbrojtur një nevojë sociale urgjente dhe në proporcion me qëllimet legjitime të synuara.<sup>1716</sup>

822. Trupi Gjykes konstaton më tej se kufizimi i të drejtave të të akuzuarve si pasojë e arrestimit, hetimit dhe ndjekjes penale nuk cenon thelbin e të drejtave të tyre. Të akuzuarit u lejuan të ushtronin lirinë e fjalës, ndër të tjera, kur shprehën dyshim mbi legjitimitetin e DHS-së, kritikuan veprimet e saj, kundërshtuan bashkëpunimin ndërmjet TFHS-së/ZPS-së dhe Serbisë dhe pretenduan se DHS-ja ishte etnikisht e njëanshme dhe kërkuan mbylljen e saj. Megjithatë, veprimet e të akuzuarve shkuan shumë përtej ushtrimit legjitim të lirisë së fjalës kur ata ndërhyjnë rëndë në interesa të tjera legjitime publike të mbrojtura me ligj, siç përshkruhet më sipër.

823. Trupi Gjykes konstaton se ndërhyrja në të drejtat e të akuzuarve si pasojë e arrestimit, hetimit dhe ndjekjes penale të tyre ishte e ligjshme dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre themelore.

(c) Përfundim

824. Për arsyet e lartpërmendura dhe duke marrë parasysh në favor të të akuzuarve të gjitha shpjegimet alternative lidhur me pretendimin e tyre, Trupi Gjykes gjykon se përgjegjësia penale e tyre nuk mund të përjashtohet prej faktorëve të interesit publik.

---

<sup>1716</sup> *Shih p.sh.* ECtHR, [Chap Ltd Judgment](#), para. 48; [Butkevich Judgment](#), para. 98; [Bédat GC Judgment](#), para. 56, 58; [Morice GC Judgment](#), para. 154; [Delfi GC Judgment](#), para. 133; [Amihalachioaie Judgment](#), para. 30; [Savva Terentyev Judgment](#), para. 82-84; [Campos Dâmaso Judgment](#), para. 35; [Tourancheau and July Judgment](#), para. 75; [Dupuis and Others Judgment](#), para. 44. *Shih gjithashtu* DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3173.

### 3. Argumenti mbrojtës bazuar në rolin e sinjalizuesit

#### (a) Aspekte ligjore

825. Trupi Gjykses thekson se Ligji, Rregullorja dhe KPK-ja nuk parashikojnë shprehimisht paraqitjen e argumenteve mbrojtëse të bazuara në rolin e “sinjalizuesit”. Megjithatë, argumenti mbrojtës i bazuar në rolin e sinjalizuesit, siç përcaktohet më poshtë, përfshihet në kornizën ligjore të DHS-së përmes Kushtetutës dhe angazhimit të shprehur aty për zbatimin e standardeve të përcaktuara në KEDNJ.<sup>1717</sup> Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, sinjalizuesit gëzojnë mbrojtje të posaçme të lirisë së shprehjes së tyre, sikurse garantohet nga neni 10 i KEDNJ-së.<sup>1718</sup>

826. Gjithashtu, Mbrojtja e Haradinajt iu referua Ligjit nr. 06/L-085 të Republikës së Kosovës për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (“Ligji për Sinjalizuesit”), si një ligj që ka lidhje me këtë proces.<sup>1719</sup> Megjithatë, ky ligj nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm në kontekstin e proceseve të DHS-së.<sup>1720</sup> Sidoqoftë, për të siguruar që interpretimi i nocionit të “sinjalizuesit” nga Trupi Gjykses nuk i cenon padrejtësisht të akuzuarit, Trupi Gjykses i ka kushtuar vëmendje të kujdesshme këtij ligji në kontekstin e interpretimit të nocionit.

#### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

827. Siç u përmend më lart, Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e ekspertës së Mbrojtjes, znj. Majers, e cila paraqiti përkufizimin e “sinjalizuesit” të përdorur nga Raportuesi

---

<sup>1717</sup> Nenet 22(2), 53 të Kushtetutës.

<sup>1718</sup> ECtHR, [Guja GC Judgment](#), para. 70. *Shih gjithashtu* ECtHR, [Marchenko Judgment](#), para. 46; [Heinisch Judgment](#), para. 63; [Goryaynova Judgment](#), para. 50.

<sup>1719</sup> Transkripti, 21 janar 2022, f. 3096. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 469; F300; F301, para. 33-35.

<sup>1720</sup> Nenet 3(2)(c) dhe (4), 6(2), 15(2) dhe 16(3) të Ligjit. *Shih gjithashtu* DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3144-3145, 3147.

Special për Lirinë e Shprehjes, z. Dejvid Kei (David Kaye).<sup>1721</sup> Në veçanti, znj. Majers sugjeroi se nuk duhet të zbatohet kriteri që personi në fjalë duhej të kishte qenë punonjës i subjektit (publik ose privat) të cilit i përkiste informacioni.<sup>1722</sup> Në mënyrë të ngjashme, znj. Majers sugjeroi se në kontekstin aktual nuk duhet të zbatohet kriteri që sinjalizuesi duhet të ketë vepruar “me ndershmëri”, i zbatueshëm sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së.<sup>1723</sup>

828. Trupi Gjykses thekson se përkufizimi i pretenduar nga znj. Majers për “sinjalizuesin” është i diskutueshëm.<sup>1724</sup> Si në bazë të Ligjit për Sinjalizuesit ashtu edhe në bazë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, sinjalizuesi duhet të ketë qenë në marrëdhënie pune me subjektin në fjalë për të përfutuar mbrojtje të posaçme.<sup>1725</sup> Në mënyrë të ngjashme, shumë instrumente ligjore vendase dhe ndërkombëtare e kufizojnë mbrojtjen e sinjalizuesve tek ata që nxjerrin informacione në kontekstin e marrëdhënieve të punës.<sup>1726</sup> Për më tepër, Trupi Gjykses konstaton se mbështetja e znj. Majers<sup>1727</sup> në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit është e pasaktë pasi ajo: (i) nuk është ratifikuar nga Kosova<sup>1728</sup>; dhe (ii) nuk përmban përkufizim të

---

<sup>1721</sup> Znj. Majers e përkufizoi sinjalizuesin si “[...]person që jep informacion për të cilin ai ose ajo beson në mënyrë të arsyeshme që, në kohën që u nxor, ishte i vërtetë dhe përbënte kërcënim ose dëmtim të një interesi publik konkret, si për shembull shkelja e së drejtës shtetërore ose ndërkombëtare, keqpërdorim i pushtetit, shpërdorimi, mashtrimet ose dëmtimi i mjedisit, rendi publik dhe siguria publike”. 2D6, para. 10 me korrigjimet që u bënë gjatë dëshmisë: DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3112-3113, 3139-3142.

<sup>1722</sup> DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3112-3119.

<sup>1723</sup> DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3123-3126, 3137, 3178-3180.

<sup>1724</sup> 2D6, para. 10-14, 16; DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3113-3115.

<sup>1725</sup> Nenet 7(2.2-2.3), 24(4) të Ligjit për Sinjalizuesit; ECtHR, [Medžlis Islamske Zajednice Brčko and Others GC Judgment](#), para. 80; [Bucur and Toma Judgment](#), para. 93, [Kudeshkina Judgment](#), para. 85; [Guja GC Judgment](#), para. 70; [Fuentes Bobo Judgment](#), para. 38, [Vogt GC Judgment](#), para. 53. *Shih gjithashtu* Transkripti, 21 janar 2022, f. 3148, 3175-3177.

<sup>1726</sup> Nenet 3(1.1) dhe (1.12), 20(2) të Ligjit për Sinjalizuesit; UK Public Interest Disclosure Act 1998, Article 43B; [EU Whistle-blowing Directive](#), Article 4; [Council of Europe Recommendation on the Protection of Whistle-blowers](#), p. 6.

<sup>1727</sup> 2D6, para. 11; DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3133.

<sup>1728</sup> [United Nations Convention Against Corruption](#), Signature and Ratification Status, <https://www.unodc.org/unodc/en/corruption/ratification-status.html> (parë për herë të fundit më 13 maj 2022).

nocionit të “sinjalizuesit”.<sup>1729</sup> Gjithashtu, përkufizimi i përdorur nga z. Kei nuk është miratuar nga GJEDNJ-ja dhe nuk duket se është pranuar nga gjykatat shtetërore. Më tej, Trupi Gjykses thekson se jurisprudenca e GJEDNJ-së kërkon që sinjalizuesi duhet të ketë vepruar me “ndershmëri”.<sup>1730</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjen arsye për t’iu shmangur përkufizimit të sinjalizuesit të bërë nga GJEDNJ-ja, që e kufizon këtë mbrojtje për personin që ka nxjerrë me ndershmëri informacion në kontekstin e marrëdhënies së punës.

829. Trupi Gjykses konstaton se nuk përmbushen kushtet për klasifikimin e të akuzuarve si sinjalizues. Në atë kohë, as z. Gucati dhe as z. Haradinaj nuk punonin në TFHS/ZPS, DHS dhe/ose në Republikën e Serbisë. Rrjedhimisht, ata nuk ishin në marrëdhënie pune me subjektin nga i cili mund ta kishte prejardhjen materiali. Për rrjedhojë, asnjëri prej tyre nuk përfshihet në përkufizimin e “sinjalizuesit”.

830. Gjithashtu, Trupi Gjykses gjykon se të akuzuarit nuk mund të konsiderohen se përfitojnë nga mbrojtja për sinjalizuesit si individë “të lidhur” me një sinjalizues. Trupi Gjykses pranon sugjerimin e znj. Majers se, ndryshe nga sinjalizuesi, nuk është e nevojshme që një person “i lidhur” me sinjalizuesin të jetë në marrëdhënie pune ose punësimi me personin ose subjektin praktikant e të cilit po denoncohen.<sup>1731</sup> Një pikëpamje e tillë është në përputhje, në veçanti, me Ligjin për Sinjalizuesit, i cili nuk kërkon që vetë personi të jetë në marrëdhënie pune/punësimi me personin/subjektin në fjalë.<sup>1732</sup> Megjithatë, që të ketë një person “të lidhur” me sinjalizuesin brenda kuptimit të nenit 10 të KEDNJ-së (dhe Ligjit për Sinjalizuesit), duhet të ketë një sinjalizues sipas kuptimit të përcaktuar më sipër, domethënë, dikush që është në marrëdhënie pune me personin ose subjektin sjellja e të cilit po denoncohet. Në

---

<sup>1729</sup> *Shih* [United Nations Convention Against Corruption](#), Article 33.

<sup>1730</sup> ECtHR, [Guja GC Judgment](#), para. 77; [Heinisch Judgment](#), para. 69. *Shih gjithashtu* DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3178-3180.

<sup>1731</sup> 2D6, para. 16; DW1252 (Anna Myers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3117-3119, 3148-3149.

<sup>1732</sup> Nenet 3(1.12), 8, 24(1) të Ligjit për Sinjalizuesit.

çështjen gjyqësore aktuale, nuk ka asnjë provë se rrjedhja e informacionit ishte pasojë e veprimeve të një sinjalizuesi nga ZPS-ja apo autoritetet serbe. Në mungesë të provave të besueshme se materiali u nxor nga një individ që përfshihet në nocionin e “sinjalizuesit” në përputhje me përkufizimin e përdorur nga Trupi Gjyqësor, nuk është e mundur që të akuzuarit të konsiderohen se janë “të lidhur” me një individ të tillë.

831. Gjithashtu, edhe nëse të akuzuarit do të përmbushnin kriteret për t’u konsideruar sinjalizues, Trupi Gjyqësor është bindur se, për arsyet e parashtruara më lart,<sup>1733</sup> ndërhyrja në lirinë e shprehjes së tyre si pasojë e arrestimit, hetimit dhe ndjekjes penale ishte e parashikuar me ligj, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale me qëllimet e mbrojtjes së dëshmitarëve nga dëmtimi, duke i mundësuar ZPS-së të përmbushte mandatin e vet në mënyrë të efektshme dhe duke ruajtur besimin e publikut në integritetin e proceseve të DHS-së.

#### (c) Përfundim

832. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjyqësor konstaton se asnjë prej të akuzuarve nuk mund të konsiderohet se ka të drejtën e mbrojtjes së posaçme si sinjalizues dhe se sjellja e tyre nuk përfshihet në mbrojtjen e sinjalizuesve të garantuar në Kushtetutë, legjislacionin e Kosovës dhe KEDNJ.

#### D. SHTYTJA PËR KRYERJEN E VEPRËS PENALE

833. Mbrojtja pretendon se të akuzuarit u shtynë nga zyrtarë të DHS-së/ZPS-së që të kryenin veprat penale të paraqitura në Aktakuzë (“pretendimi i shtytjes”).<sup>1734</sup>

---

<sup>1733</sup> *Shih më lart* para. 820-822.

<sup>1734</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3666-3676; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 120-141; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 392-440; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 36-50; F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(a), 278-280; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 442, 446-452, 457-458; Transkripti, 2 shtator 2021, f. 594-595; Transkripti, 31 janar 2022, f. 3382-3385.

## 1. Aspekte ligjore

### (a) Parashtrimet e palëve

834. Sa i përket bazës ligjore për pretendimin e shtytjes, Mbrojtja e Gucatit citoi nenet 3(2)(a) dhe (e) të Ligjit, 22(2) të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.<sup>1735</sup> Mbrojtja e Haradinajt argumentoi se, ndonëse shtytja për kryerje të veprës penale nuk përmendet shprehimisht si arsye mbrojtëse në KPPK, ajo “përmendet në Rregullore edhe pse jo e përkufizuar shprehimisht” dhe njihet nga GJEDNJ-ja dhe, për rrjedhojë, mund të paraqitet në mënyrë legjitime si argument mbrojtës para DHS-së.<sup>1736</sup> ZPS-ja parashtrroi se korniza ligjore e zbatueshme në DHS nuk parashikon mbrojtje të bazuar në argumentin e shtytjes.<sup>1737</sup>

### (b) Konstatimet e Trupit Gjyqësor

835. As Ligji dhe as Rregullorja nuk e trajtojnë nocionin e shtytjes për kryerjen e veprës penale. KPK-ja nuk ofron mbrojtje në bazë të argumentit të shtytjes për kryerje të veprës penale në lidhje me pikat e Aktakuzës, e as nuk trajton as ndikimin – nëse ka – të shtytjes për kryerje të veprës penale mbi akuzat penale dhe/ose pranueshmërinë e provave. KPPK-ja e trajton nocionin e shtytjes për kryerje të veprës penale vetëm në kontekstin e zbatimit të një urdhri për hetime të fshehta, blerjen e simuluar të një sendi ose simulimin e një veprë të korrupsionit.<sup>1738</sup> Rrjedhimisht, e drejta procedurale penale e Kosovës nuk parashihet shtytjen për kryerjen e veprës penale si nocion të përgjithshëm të zbatueshëm në çfarëdo rrethanash.

---

<sup>1735</sup> F288, para. 14-15. *Shih gjithashtu* F288/RED. *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3667.

<sup>1736</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 392-394, 399, 428, *shih gjithashtu* para. 395-405; F287, para. 30-48.

<sup>1737</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 283-286, 300; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3484, 3516-3518; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 444; Transkripti, 2 shtator 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>1738</sup> Nenet 93(8.1) dhe (9) të KPPK-së. *Shih gjithashtu* nenin 97 të KPPK-së.



836. Sikurse vërehet më lart,<sup>1739</sup> si Ligji ashtu dhe Kushtetuta kërkojnë që DHS-ja të respektojë dhe zbatojë standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë dhe ato të parapara në KEDNJ.<sup>1740</sup> GJEDNJ-ja e përkufizon shtytjen për kryerjen e veprës penale si një rrethanë ku zyrtarët e rendit e të ligjit, ose personat që veprojnë nën drejtimin ose kontrollin e tyre, nuk kufizohen në hetimin e veprimtarisë kriminale në një mënyrë që është në thelb pasive, por ushtrojnë te personi një ndikim të tillë që e nxit atë të kryejë një vepër penale që përndryshe nuk do të ishte kryer, për të mundësuar kryerjen e veprës penale, domethënë, për të siguruar prova dhe për të filluar ndjekjen penale.<sup>1741</sup> Për të vlerësuar nëse hetimi ishte “në thelb pasiv”, duhet të përcaktohet nëse kishte dyshime objektive se i akuzuari ishte përfshirë në veprimtari kriminale ose ishte i predispozuar të kryente vepër penale.<sup>1742</sup>

837. GJEDNJ-ja ka zhvilluar një jurisprudencë të qartë mbi kushtet në të cilat zbatohet neni 6 i KEDNJ-së në rastet e shtytjes për kryerjen e veprës penale, konkretisht: (i) sjellja e agjentëve sekretë (të cilët mund të jenë agjentë shtetërorë ose palë private që veprojnë sipas udhëzimeve dhe janë nën kontrollin e agjentëve shtetërorë)<sup>1743</sup> duhet të jetë objekt i kufizimeve dhe masave mbrojtëse të qarta dhe ata nuk duhet të nxisin kryerjen e krimeve;<sup>1744</sup> (ii) i akuzuari duhet të ketë efektivisht mundësi të paraqesë argumentin e shtytjes për kryerjen e veprës penale gjatë gjykimit, qoftë me anë të një kundërshtimi ose në mënyrë tjetër; masat mbrojtëse të përgjithshme, si parimi i

<sup>1739</sup> *Shih më lart* para. 806 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>1740</sup> Nenet 22, 40-41 të Kushtetutës; Nenet 1(2), 2, 3(2)(e), dhe 21 të Ligjit.

<sup>1741</sup> ECtHR, [Ramanauskas GC Judgment](#), para. 55.

<sup>1742</sup> ECtHR, [Bannikova Judgment](#), para. 38. *Shih gjithashtu* ECtHR, [Guide on Article 6 of the ECHR](#), para. 242-247 (and references cited).

<sup>1743</sup> ECtHR, [Shannon Judgment](#).

<sup>1744</sup> [Guide on Article 6 of the ECHR](#), para. 232-233. *Shih gjithashtu* ECtHR, [Khudobin Judgment](#), para. 128. Trupi Gjykses vë në dukje argumentin e Mbrojtjes së Gucatit i cili sugjeron se, sipas [Ramanauskas GC Judgment](#), veprimi i një elementi të pakontrolluar (d.m.th., i një personi që nuk vepron nën drejtimin ose kontrollin e policisë) mund të shërbejë si bazë për pretendimin për shtytje. Sidoqoftë, Trupi Gjykses konstaton se aktgjykimi i cituar nuk e mbështet këtë sugjerim.

barazisë midis palëve ose të drejtat e Mbrojtjes, nuk janë të mjaftueshme;<sup>1745</sup> (iii) provat e marra si rezultat i shtytjes për kryerjen e veprës penale duhet të përjashtohen, ose të zbatohet një procedurë me pasoja të ngjashme;<sup>1746</sup> (iv) i takon prokurorisë të provojë se nuk ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale, përveç nëse pretendimet e të akuzuarve janë tërësisht të pagjasa;<sup>1747</sup> (v) nëse pretendohet shtytje për kryerjen e veprës penale dhe ka prova *prima facie* për të, gjykata duhet të shqyrtojë faktet e çështjes dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të zbuluar nëse ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale, nëpërmjet një procesi ballafaques, të plotë, gjithëpërfshirës dhe përfundimtar;<sup>1748</sup> (vi) në kontekstin e mosnxjerrjes së informacionit nga autoritetet hetimore, duhet t'i jepet rëndësi e veçantë respektimit të parimeve të procesit ballafaques dhe të barazisë midis palëve;<sup>1749</sup> dhe (vii) hedhja poshtë e pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale duhet të arsyetohet mjaftueshëm.<sup>1750</sup>

838. Gjithashtu, Trupi Gjykues thekson se një shqyrtim i shpejtë i juridiksioneve të shteteve tregon për një larmi të madhe qasjesh, jo vetëm për sa i përket ekzistencës së nocionit të shtytjes për kryerjen e veprës penale, por edhe, aty ku ai ekziston, cilësimit ligjor dhe pasojave të tij (*p.sh.*, pezullimi i procesit,<sup>1751</sup> arsye për përjashtimin e provave,<sup>1752</sup> ose faktor për zbutjen e dënimit<sup>1753</sup>).

<sup>1745</sup> ECtHR, [Ramanauskas GC Judgment](#), para. 69.

<sup>1746</sup> ECtHR, [Akbay and Others Judgment](#), para. 123-124; [Ramanauskas GC Judgment](#), para. 54; [Bannikova Judgment](#), para. 54.

<sup>1747</sup> Shih ECtHR, [Guide on Article 6 of the ECHR](#), para. 248.

<sup>1748</sup> ECtHR, [Bannikova Judgment](#), para. 57; [Ramanauskas GC Judgment](#), para. 70.

<sup>1749</sup> ECtHR, [Bannikova Judgment](#), para. 58.

<sup>1750</sup> ECtHR, [Tchokhoniidze Judgment](#), para. 52.

<sup>1751</sup> Shih *p.sh.* United Kingdom: [Crown Prosecution Service Legal Guidance](#) (parë për herë të fundit më 13 maj 2022).

<sup>1752</sup> Shih *p.sh.* France: [French Cour de cassation Annual Report 2004](#), p. 141-152.

<sup>1753</sup> Shih *p.sh.* në Zvicër: neni 293(4) i Kodit të Procedurës Penale të Zvicrës. Shih gjithashtu në Gjermani: si faktor që çon në zbutjen e dënimit: BGHSt 32, 345 = NJW 1984, 2300; BGHSt 45, 321 = NJW 2000, 1123; BGHSt 47, 44 = NJW 2001, 2981; BGHSt 60, 238 = NStZ 2015, 541; BGH NStZ 2014, 277; BVerfG NJW 2015, 1083; por shih gjithashtu si faktor që shkakton pengesë procedurale BGHSt 60, 276 = NJW 2016, 91.

(c) Përfundim

839. Ky shqyrtim i shkurtër i jurisprudencës së GJEDNJ-së tregon se ajo e ka trajtuar aspektin e shtytjes për kryerjen e veprës penale në këndvështrimin e garancisë për gjykim të drejtë. Nga ky këndvështrim, Trupi Gjykses konsideron se shtytja për kryerjen e veprës penale nuk përbën argument mbrojtës formal ndaj akuzave, por përcakton kriteret procedurale që duhet të zbatohen nga gjykatat dhe autoritetet prokuroriale për të garantuar drejtësinë e procesit në një çështje gjyqësore që përfshin një pretendim të shtytjes për kryerjen e veprës penale.

## 2. Aspekte në lidhje me gjykimin e drejtë

(a) Parashtrimet e palëve

840. Mbrojtja argumentoi se u pengua aftësia e saj për të paraqitur në mënyrë të efektshme pretendimin e vet të shtytjes për kryerjen e veprës penale dhe se rrjedhimisht, të akuzuarve iu mohua gjykimi i drejtë.<sup>1754</sup> ZPS-ja e kundërshtoi këtë pretendim.<sup>1755</sup>

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

841. Gjatë gjithë procesit, Trupi Gjykses ndërmori hapa të shumtë për të siguruar që Mbrojtjes t'i jepej çdo mundësi për të paraqitur pretendimin e vet të shtytjes për kryerjen e veprës penale.<sup>1756</sup> Këtu Trupi Gjykses do të përshkruajë edhe një herë hapat më të rëndësishëm.

---

<sup>1754</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 399, 408-416, 430-436; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3676, 3703-3704, *shih gjithashtu* f. 3707-3708, 3710.

<sup>1755</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 301; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3463-3465, 3484.

<sup>1756</sup> Shumica e këtyre hapave janë paraqitur në: Shtojcën 1 të Aktgjykimit, para. 31, 46-50, 52-53, 55, 57, 59-61, 63-64, 67-68, 70-71, 74, 77-78, 85, 89, 93, 101-107.

842. Së pari, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrime mbi aspekte të nxjerrjes së provave dhe shtytjes për kryerjen e veprës penale në konferencën për përgatitjen e gjykimit.<sup>1757</sup>

843. Së dyti, në marrjen e vendimeve mbi aspektet të nxjerrjes së provave, Trupi Gjykses gjithmonë kreu një vlerësim të plotë dhe të bazuar në informacion të të gjitha materialeve të rregullës 102(3).<sup>1758</sup> Trupi Gjykses ishte i kujdesshëm që në këto shqyrtime *ex parte* të siguronte që ZPS-ja i kishte nxjerrë Mbrojtjes çdo provë që mund të ofrohej në mbështetje të pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale. Në këtë kontekst, në disa raste, përkundrejt kundërshtimeve të ZPS-së, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që: (i) t'i nxirrte Mbrojtjes materialet që ishin identifikuar se kishin lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale;<sup>1759</sup> (ii) t'i jepte Mbrojtjes njoftime të hollësishme, të redaktuara ose të përditësuara të materialeve që *prima facie* dukeshin se kishin lidhje dhe ishin objekt i nxjerrjes;<sup>1760</sup> (iii) të paraqiste parashtrime të mëtejshme lidhur me bazën faktike për pohimin e ZPS-së se disa nga materialet nuk ishin juridikisht thelbësore për pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale;<sup>1761</sup> dhe (iv) të zbatonte masat e propozuara dhe t'i raportonte Trupit Gjykses.<sup>1762</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëroi masa kompensuese ndaj mosnxjerrjes së materialeve.<sup>1763</sup>

844. Së treti, Trupi Gjykses mbajti seanca gjyqësore *ex parte* për t'i bërë ZPS-së pyetje për: (i) pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale dhe hapat që duheshin

---

<sup>1757</sup> *Shih* Shtojca 1 e Aktgjykimit, para. 45-47. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 442-443 (Urdhër në lidhje me Njoftimin e Përditësuar të Rregullës 102(3)). Transkripti, 2 shtator 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>1758</sup> F304, para. 23-25; F413, para. 58-78; F435, para. 14-19; *shih gjithashtu* F479, para. 14-17; F533, para. 17-21; F541, para. 16-20. *Shih gjithashtu* F413/RED; F435/RED; F546/COR. *Shih gjithashtu* Transkripti, 31 janar 2022, f. 3381-3385; F543.

<sup>1759</sup> F413, para. 95(b). *Shih gjithashtu* F413/RED; F423, para. 64 që i referohet F413, para. 95(b).

<sup>1760</sup> Transkripti, 2 shtator 2021, f. 638 (Urdhër në lidhje me Listën e ZPS-së sipas Rregullës 102(3)); F304, para. 23, 26; F361.

<sup>1761</sup> F320.

<sup>1762</sup> F413, para. 76-78, 95(c).

<sup>1763</sup> F413, para. 67-68, 73-74.

ndërmarrë për të siguruar që Mbrojtja të paraqiste në mënyrë efektive dhe të plotë pretendimin e vet;<sup>1764</sup> dhe (ii) masat kompensuese *efektive* që mund të merreshin nëse konsiderohej mosnxjerrja e materialeve.<sup>1765</sup> Gjatë këtyre seancave, shqetësimi kryesor i Trupit Gjykses ishte që të siguronte që Mbrojtjes të mos i shkaktohej asnjë paragjykim apo padrejtësi si rezultat i seancave *ex parte*. Gjithashtu, Trupi Gjykses mori në konsideratë të gjitha aspektet përkatëse gjatë marrjes së vendimit nëse disa prova të caktuara mund të kishin lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale.

845. Së katërti, në marrjen e vendimit lidhur me kundërshtimet e ZPS-së ndaj nxjerrjes së materialeve, Trupi Gjykses sqaroi lidhjen ndërmjet sistemit të nxjerrjes së materialeve dhe pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale.<sup>1766</sup> Konkretisht, Trupi Gjykses vuri në dukje se “Në kuadër të procesit të nxjerrjes së materialeve, Mbrojtja duhet të lejohet të marrë informacion relevant dhe të nxjerrshëm që mund të ndihmojë pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale”.<sup>1767</sup> Më tej, Trupi Gjykses bëri të qartë se vendimi nëse pretendimi i shtytjes për kryerjen e veprës penale ishte tërësisht i pagjasë do të jepej vetëm në Aktgjykim, pasi të ishin dëgjuar të gjitha dëshmitë.<sup>1768</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses e shtyu marrjen e vendimit mbi aspektet ende të patrajuara të nxjerrjes së materialeve pasi të kishte dëgjuar dëshmitë e znj. Pumper dhe z. Jukiq, sepse në atë kohë Trupi Gjykses gjykoi se, nëse këta dëshmitarë mund të jepnin dëshmi për këto aspekte, kjo mund ndikonte në vendimin që do të merrte ai mbi nxjerrjen e provave.<sup>1769</sup>

---

<sup>1764</sup> Transkripti, 2 shtator 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>1765</sup> Transkripti, 4 tetor 2021, konfidencial dhe *ex parte*; Transkripti, 21 tetor 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>1766</sup> F413, para. 37, 51, 53-56.

<sup>1767</sup> F413, para. 53.

<sup>1768</sup> Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2608 (Urdhër Gojor mbi Kërkesën e Mbrojtjes për t'i Bërë Pyetje Shtesë Dëshmitarëve të ZPS-së W04841 dhe W04842). *Shih gjithashtu* F546/COR, para. 20, 26; F413, para. 53.

<sup>1769</sup> Transkripti, 18 tetor 2021, f. 816-817. *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 1756.

846. Së pesti, Trupi Gjykues theksoi në mënyrë të përsëritur, për shembull kur i mohoi ZPS-së lejen për të apeluar Vendimin mbi Nxjerrjen e Provave, rëndësinë që ka procesi ballafaques në kontekstin e mosnxjerrjes së informacionit, kur është ngritur pretendim i shtytjes për kryerje të veprës penale.<sup>1770</sup>

847. Së gjashti, sa u përket dëshmitarëve, bazuar në faktin se provat e propozuara mund të jenë relevante për pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale, Trupi Gjykues: (i) refuzoi kërkesën e ZPS-së për përjashtimin e dëshmisë së z. Qalaj dhe lejoi Mbrojtjen të thërriste disa nga dëshmitarët e tjerë të propozuar;<sup>1771</sup> (ii) lejoi Mbrojtjen që t'i merrte në pyetje më tej z. Pumper dhe z. Jukiq, bazuar në faktin se disa materiale që Trupi Gjykues urdhëroi të nxirreshin u morën nga Mbrojtja pas mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe për këtë arsye Mbrojtja nuk mundi t'i përdorte ato kur i mori në pyetje fillimisht këta dëshmitarë;<sup>1772</sup> (iii) lejoi Mbrojtjen t'i bënte pyetje z. Moberg lidhur me pretendimin se një punonjës i ZPS-së u kishte thënë të akuzuarve se mund ta mbanin paketën 1 për një muaj;<sup>1773</sup> dhe (iv) autorizoi Mbrojtjen që të thërriste z. Çelë Gashi për ta mbështetur këtë pretendim.<sup>1774</sup>

848. Së shtati, sa u përket provave, Trupi Gjykues pranoi si prova, mbi bazën se ishin relevante për pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale: (i) materiale që kishin të bënin me pretendimin e Mbrojtjes për mangësi hetimore të ZPS-së lidhur me

---

<sup>1770</sup> F423, para. 38-40, 61-62. *Shih gjithashtu* Transkripti, 8 nëntor 2021, f. 1974-2029; konkretisht f. 2011, 2014-2015, 2020-2021, 2024-2026, 2028. *Shih gjithashtu* Transkripti, 8 nëntor 2021, f. 2017 (ku Mbrojtja e Gucatit shpreh miratimin).

<sup>1771</sup> *Shih p.sh.*, DW1242 (Elmedina Ballhazhi), DW1241 (Taibe Miftari), DW1244 (Metush Kryeziu), DW1246 (Rashit Qalaj): F470, para. 77-79, 88-90.

<sup>1772</sup> Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2608 (Urdhër Gojor mbi Kërkesën e Mbrojtjes për t'i Bërë Pyetje Shtesë Dëshmitarëve të ZPS-së W04841 dhe W04842); F413, para. 79, 95.

<sup>1773</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1951.

<sup>1774</sup> *Shih* 1D9, para. 20. *Shih gjithashtu* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2602-2603.

rrethanat e rrjedhjes së informacionit;<sup>1775</sup> dhe (ii) deklaratën dhe shtesën e deklaratës së z. Qalaj (kundrejt kundërshtimit të ZPS-së).<sup>1776</sup>

849. Së fundi, gjatë gjithë procesit, Trupi Gjykses: (i) hodhi poshtë kundërshtimet e ZPS-së ndaj pyetjeve të Mbrojtjes që synonin marrjen e dëshmime lidhur me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale;<sup>1777</sup> dhe (ii) bëri vazhdimisht pyetje në lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale.<sup>1778</sup>

850. Trupi Gjykses më tej thekson se gjatë gjykimit Mbrojtja: (i) nuk shpjegoi qartë se si ishin shtyrë të akuzuarit që të kryenin vepër penale; dhe as (ii) nuk paraqiti prova prej të cilave Trupi Gjykses mund të nxirrte përfundim se ishte bërë shtytje për kryerjen e veprës penale.

### (c) Përfundim

851. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses është bindur se Mbrojtjes iu ofrua mundësi e plotë dhe e drejtë për të paraqitur pretendimin e saj të shtytjes për kryerjen e veprës penale në përputhje me standardet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja.

## 3. Vlerësimi i pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale

### (a) Parashtrimet e palëve

852. Mbrojtja argumentoi se kishte demonstruar që shtytja për kryerje e veprës penale nuk ishte “tërësisht e pagjasë” dhe se ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte se nuk kishte pasur

---

<sup>1775</sup> F502 Vendimi për Provat Jogojore të Gucatit, para. 19-24.

<sup>1776</sup> Transkripti, 14 janar 2022, f. 3056-3057.

<sup>1777</sup> *Shih p.sh.*, Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1037, 1124, 1157; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1168, 1217, 1226; Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1776; Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2624, 2628-2632; Transkripti, 14 janar 2022, f. 3056-3057.

<sup>1778</sup> *Shih p.sh.*, Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1478; Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1756; Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1958; Transkripti, 2 shtator 2021, konfidencial dhe *ex parte*.

shtytje për kryerjen e veprës penale.<sup>1779</sup> Mbrojtja e Gucatit parashtroi se Trupi Gjykses duhet t'i hedhë poshtë akuzat me arsyetimin se të akuzuarit nuk mund të kenë gjykim të drejtë, të pezullojë procesin, ose të shqiptojë vendim pafajësie duke i përjashtuar tërësisht provat e ZPS-së.<sup>1780</sup> Mbrojtja e Haradinajt parashtroi se për të gjitha provat që rrjedhin nga shtytja për kryerjen e veprës penale duhej të merrej vendim se ishin të papranueshme, përndryshe e tërë procedura do të përbënte "shpërdorim të procesit".<sup>1781</sup>

853. ZPS-ja parashtroi se në dokumentacionin e çështjes nuk kishte asnjë bazë që të mbështeste pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale dhe se ai duhej të hidhej poshtë si "tërësisht i pagjasë".<sup>1782</sup>

#### (b) Konstatimet e Trupit Gjykses

854. Gjatë vlerësimit të pretendimit të shtytjes për kryerjen e veprës penale, Trupi Gjykses mori në konsideratë të gjitha rrethanat e ngritura nga Mbrojtja, dhe provat që kanë të bëjnë me to. Gjithashtu, Trupi Gjykses shqyrtoi me kujdes të gjithë dokumentacionin për të përcaktuar nëse kishte ndonjë fakt apo rrethanë tjetër relevante.

##### i) Qëndrimi i të akuzuarve

855. Para periudhës së Aktakuzës, të dy të akuzuarit bënë disa deklarata gjatë intervistave, programeve televizive, ose në *Facebook*, ku shprehën armiqësi ndaj DHS-

---

<sup>1779</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3666-3676, 3703-3704; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 130-139; F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 406-440; F288, para. 17-19. *Shih gjithashtu më poshtë* para. 879 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>1780</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3676; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 141; F288, para. 23-24.

<sup>1781</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 399, 429, 439-440; F287, para. 48 *por shih* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3703.

<sup>1782</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 300-313; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3484-3491, 3515-3516; Transkripti, 1 shtator 2021, f. 444-446, 450; Transkripti, 2 shtator 2021 konfidencial dhe *ex parte*.



së.<sup>1783</sup> Në të njëjtën mënyrë, gjatë periudhës së Aktakuzës, të akuzuarit vazhdimisht deklaruan se nuk e njihnin DHS-në,<sup>1784</sup> se ishin kundër saj,<sup>1785</sup> nuk pranonin autoritetin e saj,<sup>1786</sup> donin që ajo të shfuqizohej,<sup>1787</sup> ishin të përkushtuar që të punonin për shpërbërjen<sup>1788</sup> dhe demaskimin e saj.<sup>1789</sup>

856. Pas secilit prej tri dorëzimeve, të akuzuarit vazhdimisht shprehën kënaqësinë për rrjedhjen e informacionit,<sup>1790</sup> e përshkruan atë si mrekulli,<sup>1791</sup> dhe e lavdëruan personin që i solli dokumentet sepse ai kishte bërë diçka që sipas tyre ishte akt i rëndësishëm patriotik dhe fitore kombëtare.<sup>1792</sup> Të akuzuarit diskutuan për origjinën e tri grupeve të dokumenteve, duke shqyrtuar mundësinë që materiali mund të kishte ardhur nga Serbia,<sup>1793</sup> ose mund të ishte nxjerrë qëllimisht nga ZPS-ja,<sup>1794</sup> të ishte blerë ose vjedhur.<sup>1795</sup> Të akuzuarit shprehën vazhdimisht indiferencë në lidhje me burimin e tri grupeve të dokumenteve, pasi për ta rëndësi kishte se ato ishin materiale autentike të TFHS-së/ZPS-së.<sup>1796</sup> Për më tepër, kur u pyetën se përse, sipas mendimit të tyre, ua kishin sjellë atyre materialin, të akuzuarit u përgjigjën se mund të ishte pasojë e kundërshtimit të tyre publik dhe të zëshëm ndaj DHS-së.<sup>1797</sup> Më 14 ose 15 shtator 2020,

<sup>1783</sup> P36; P37; P38; P39, f. 1, 3-4; P40; P41; P42, f. 1; P43; P44; P45; P46; P47; P48; P49, f. 3, 7, 13, 15; P83, f. 18, 42, 67, 80-84.

<sup>1784</sup> *Shih p.sh.*, P5, f. 1; P7, f. 3; P18, f. 1; P21, f. 3.

<sup>1785</sup> *Shih p.sh.*, P7, f. 3; P9, f. 12; P13, f. 1; P42; P43.

<sup>1786</sup> *Shih p.sh.*, 1D3, para. 57-58; 2D1, para. 18, 22.

<sup>1787</sup> *Shih p.sh.*, P32, f. 2; P38, f. 1; 2D1, para. 37; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2861, 2863-2864. *Shih për krahasim* 2D1, para. 17; Transkripti, 12 janar 2022, f. 2858, 2860, 2862; 1D3, para. 67.

<sup>1788</sup> P15, f. 2; P26, f. 2.

<sup>1789</sup> P30, f. 15.

<sup>1790</sup> *Shih p.sh.*, P1, f. 1; P2, f. 8; P8, f. 24; P17, f. 5; P18, f. 2; P25, f. 3; P34, f. 2; P35, f. 10.

<sup>1791</sup> P7, f. 2; P30, f. 2-3; P35, f. 3.

<sup>1792</sup> P2, f. 8; P6, f. 3, 30; P7, f. 2; P8, f. 2-4, 24, 29, 35 *Shih gjithashtu* P7, f. 5 (Tomë Gashi në praninë e z. Haradinaj).

<sup>1793</sup> P6, f. 32; P7, f. 13-14; P8, f. 14; P21, f. 4; P23, f. 9; P24, f. 5, 9; P28, f. 14; P30, f. 18.

<sup>1794</sup> *Shih p.sh.*, P1, f. 5; P11, f. 67, 69.

<sup>1795</sup> P2, f. 3; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2230-2231; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2401. *Shih gjithashtu* P8, f. 17; 2D1, para. 35.

<sup>1796</sup> *Shih p.sh.*, P1, f. 4-5; P6, f. 2; P8, f. 14, 17, 24; P11, f. 2-3, 39; P24, f. 5; P28, f. 9, 13; P30, f. 18-19; P33, f. 1.

<sup>1797</sup> *Shih p.sh.*, P2, f. 6; P8, f. 3. P29, f. 1. *Shih gjithashtu* P4, f. 10 (Tomë Gashi).

të akuzuarit bashkë me 23 anëtarët e kryesisë së OVL-UÇK-së morën vendimin e përbashkët dhe të njëzëshëm që të bënin publik çfarëdo materiali që do t'u vinte.<sup>1798</sup>

Pasi i nxorën tri grupet e dokumenteve, të akuzuarit përsëritën gatishmërinë e tyre për të bërë publik çfarëdo materiali tjetër të këtij lloji që mund t'u jepej.<sup>1799</sup>

857. Në dëshmitë e tyre, të akuzuarit kaluan nga pretendimi i shtytjes për kryerjen e veprës penale, tek sugjerimi se të tri grupet e dokumenteve mund të ishin vjedhur nga ZPS-ja, dhe të pranimit se nuk e dinin se nga vinte materiali.<sup>1800</sup> Z. Gucati tha se, si kryetar i OVL-UÇK-së, vetëm Zoti mund ta detyronte që të thërriste tri konferenca për shtyp.<sup>1801</sup>

858. Në lidhje me Pikën 1, Trupi Gjyqësor konstatoi se shprehja e armiqësisë ndaj DHS-së/ZPS-së nuk është në vetvete provë se është kryer veprë penale;<sup>1802</sup> deklarata të tilla përbëjnë, në njëfarë masë të caktuar, ushtrim legjitim të lirisë së shprehjes së të akuzuarve. Për më tepër, përderisa disa nga veprimet dhe deklaratat e mësipërme mund të jenë të rëndësishme në përcaktimin e prirjes së të akuzuarve për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen, Trupi Gjyqësor konstaton se, edhe nëse vërtetohet një prirje e tillë, ajo nuk do ta përjashtonte tërësisht mundësinë që të akuzuarit u shtynë nga dikush për të vepruar ashtu siç vepruan. Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor gjykon se as deklaratat e tyre të asaj kohe, as dëshmitë e tyre në gjykim nuk

---

<sup>1798</sup> *Shih më lart* para. 242 (Ngjarjet në fjalë). *Shih gjithashtu* 2D1, para. 73; Transkripti, 11 janar 2022, f. 2746.

<sup>1799</sup> *Shih p.sh.*, P2, f. 4; P4, f. 3, 9 (Z. Gucati, përmes Tomë Gashit); P6, f. 4, 14, 35; P7, f. 2; P8, f. 4, 6, 26; P12, f. 2-4 (Tomë Gashi); P15, f. 2; P17, f. 5; P18, f. 1-2; P21, f. 3-4; P24, f. 7; P26, f. 4-5; P28, f. 7, 11; P29, f. 2; P31, f. 2; P33, f. 1; P34, f. 2-3; P35, f. 2-3. *Shih gjithashtu* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2221-2222. *Shih për krahasim* DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2222-2223, 2226, 2230-2232.

<sup>1800</sup> *Shih p.sh.*, 2D1, para. 34-35, 45, 54, 129, 135; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2180, 2215; Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2021, f. 2734; Transkripti, 12 janar 2022, f. 2841-2843.

<sup>1801</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2215-2217.

<sup>1802</sup> *Shih më lart* para. 660 (Pika 1).

tregojnë se ka bazë objektive për të besuar që të akuzuarit në fakt u shtynë për kryerjen e veprës penale.

ii) Origjina e rrjedhjes së informacionit dhe personat që bënë tri dorëzimet

859. Trupi Gjykues nuk mori asnjë provë se nga ku ishin marrë tri grupet e dokumenteve dhe në çfarë mënyre. Trupi Gjykues thekson se paketat 1, 2 dhe 4 përmbanin, ndër të tjera, përgjigje të PSKL-së dhe dokumente serbe, të cilat nuk kishin numër regjistrimi të provës NRP (ERN) dhe disa prej të cilave ishin shkruar në serbishte, me germa latine ose cirilike.<sup>1803</sup> Kjo sugjeron se grupi i parë dhe i dytë i dokumenteve *mund* ta ketë pasur origjinën nga dokumentacioni i autoriteteve serbe që bashkëpunonin me TFHS-në/ZPS-në. Megjithatë, këta faktorë nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar se këto dokumente u nxorën nga një vendndodhje në Republikën e Serbisë, apo me dijeninë dhe pëlqimin e autoriteteve serbe. Gjithsesi, nuk ka asnjë tregues që grupi i parë dhe i dytë i dokumenteve e kishin burimin nga TFHS-ja/ZPS-ja, ose se ndonjë prej këtyre institucioneve ishte përfshirë në dorëzimin e tyre tek OVL-UÇK-ja.

860. Trupi Gjykues konstaton se informacioni i përfshirë në paketën 3 sugjeron se grupi i tretë i dokumenteve duhej ta kishte burimin nga dokumentacioni i ZPS-së. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vë në dukje se [REDAKTUAR].<sup>1804</sup> Raporti nxjerr përfundimin se nuk ka asnjë provë se një punonjës i ZPS-së e nxori dokumentin qëllimisht.<sup>1805</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk është në gjendje të përcaktojë se si dhe me çfarë mjeti u mor grupi i tretë i dokumenteve nga dokumentacioni i ZPS-së. Megjithatë, nuk ka asnjë tregues se ai u nxor qëllimisht nga ZPS-ja.

---

<sup>1803</sup> Procesi i caktimit numrave të regjistrimit të provave (NRP/ERN) u shpjegua nga znj. Pumper: W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 18 tetor 2021, f. 848-849. *Shih gjithashtu* Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1046-1047; P88, para. 6. *Shih më lart* para. 335-336, 347, 379-381 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1804</sup> 1D33, f. 1, 3.

<sup>1805</sup> 1D33, f. 2.

861. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se në dy artikuj të mediave që janë pranuar si prova pretendohet se informacioni i publikuar në ta vinte nga një burim në ZPS.<sup>1806</sup> Trupi Gjykses konstaton se baza për këtë pretendim nuk është vërtetuar dhe se vërtetësia e këtij pohimi nuk mund të verifikohet.

862. Trupi Gjykses mori prova se tri dorëzimet u kryen nga tre individë të ndryshëm dhe se të paktën dy prej tyre flisnin shqip.<sup>1807</sup> Trupi Gjykses nuk ka marrë asnjë provë në lidhje me identitetin e këtyre individëve; po kështu, nuk ka asnjë provë që t'i lidhë ata me DHS-në/ZPS-në.<sup>1808</sup> Tiparet identifikuese të vërejtura nga z. Miftari ose të tjerët që i këqyrën pamjet e filmuara të kamerave të sigurisë së OVL-UÇK-së, nuk e bënë të mundur identifikimin e këtyre individëve. Të akuzuarit në mënyrë të përsëritur deklaruan se nuk e dinin identitetin e tyre.<sup>1809</sup> Trupi Gjykses nuk ka asnjë provë që do të sugjeronte se këta individë ishin punonjës të DHS-së/ZPS-së dhe/ose vepruan sipas udhëzimeve apo ishin nën kontrollin e tyre.<sup>1810</sup>

iii) Përpjekjet hetimore të ZPS-së

863. Sa i përket argumentit të Mbrojtjes se mangësitë e pretenduara në hetimin e ZPS-së për rrjedhjen e informacionit mbështesin pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale,<sup>1811</sup> Trupi Gjykses vëren rezistencën e ZPS-së për t'i nxjerrë Mbrojtjes materiale lidhur me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale, me arsyen se nxjerrja mund të ndikonte në hetimet që po kryente mbi rrjedhjen e informacionit.<sup>1812</sup>

<sup>1806</sup> P155; P156.

<sup>1807</sup> P1, f. 1; P35, f. 10-11; P4, f. 3, 6-7; P6, f. 3-4; P8, f. 1-2, 4; P12, f. 2-3, 6; P17, f. 5; P25, f. 2; P28, f. 9; P33, f. 3; P35, f. 10. *Shih gjithashtu* 1D4, para. 4, 6, 8, 22, 34; DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2454-2455, 2459, 2474. *Shih më lart* para. 209, 244, 275 (Ngjarjet në fjalë).

<sup>1808</sup> *Shih* 1D19-1D30.

<sup>1809</sup> *Shih p.sh.*, P1, f. 1. *Shih gjithashtu* P4, f. 3; 2D1, para. 45, 48, 71, 105; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 11 janar 2022, f. 2743; Transkripti, 13 janar 2022, f. 2963.

<sup>1810</sup> W04841, (Zdenka Pumper), Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1478-1479; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1756; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1957-1958.

<sup>1811</sup> F566 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Haradinajt, para. 417-426.

<sup>1812</sup> F304; F354; F320; F420; F423, F435. *Shih gjithashtu* F435/RED.

Sidoqoftë, pretendimi se ZPS-ja nuk kreu hetime për origjinën e rrjedhjes kundërshtohet nga provat, të cilat tregojnë se ZPS-ja ndërmori hapa për të identifikuar përgjegjësit e rrjedhjes. Ajo: (i) [REDAKTUAR];<sup>1813</sup> (ii) mblodhi pamjet nga kamerat e sigurisë ku ishin filmuar tri dorëzimet;<sup>1814</sup> dhe (iii) mori nga një prej të akuzuarve fotografitë e një automjeti që mund të kishte lidhje me rrjedhjen.<sup>1815</sup>

864. Sa u përket provave lidhur me një automjet Folksvagen ngjyrë të kaltër dhe fotografinë e një punonjësi të ZPS-së,<sup>1816</sup> Mbrojtja nuk arriti të tregonte se makina dhe/ose punonjësi i ZPS-së kishin ndonjë lidhje me ngjarjet që kanë të bëjnë me këtë çështje.<sup>1817</sup> Mbrojtja nuk vërtetoi asnjë lidhje midis ndonjë punonjësi tjetër të ZPS-së dhe rrjedhjes, që do të përlligjte kryerjen e hetimeve.<sup>1818</sup>

865. Sa i përket pretendimit se gjatë sekuestrimit të parë një përfaqësues i ZPS-së sugjeroi që OVL-UÇK-ja mund ta mbante materialin për një muaj,<sup>1819</sup> Trupi Gjykses thekson se ky pretendim u kundërshtua në mënyrë të besueshme nga z. Moberg, i cili ishte i pranishëm gjatë sekuestrimit të parë.<sup>1820</sup> Po kështu, ai kundërshtohet edhe nga reagimi i shpejtë i ZPS-së për sekuestrimin e materialit.<sup>1821</sup> Trupi Gjykses arrin në përfundimin se ZPS-ja nuk u dha leje të akuzuarve që ta mbanin grupin e parë të dokumenteve për një muaj.

---

<sup>1813</sup> 1D33.

<sup>1814</sup> P136; P164; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 3007-3015.

<sup>1815</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2190; 1D3, para. 31.

<sup>1816</sup> W04841, (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1154-1157; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1165-1179; Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1305-1310. *Shih gjithashtu* 1D31; 1D32; 1D34.

<sup>1817</sup> W04841, (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1154; Transkripti, 21 tetor 2021, f. 1165-1179; Transkripti, 25 tetor 2021, f. 1305-1310.

<sup>1818</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3675.

<sup>1819</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 102, 133; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2196-2197; Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2398-2400; 1D3, para. 42; 2D1, para. 88; 1D9, para. 20, 22. *Shih gjithashtu* DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2586, 2602-2603.

<sup>1820</sup> W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1936-1937, 1948.

<sup>1821</sup> *Shih më lart* para. 228-231, 256-258, 285 (Ngjarjet në fjalë).

866. Sa i përket mosmarrjes prej ZPS-së të hapave për marrjen e materialit që e dinte se mediat e kishin në zotërim, dhe/ose për të kërkuar heqjen nga sfera publike të artikujve që thuhej se përmbanin referenca të materialit të nxjerrë,<sup>1822</sup> ZPS-ja nuk shpjegoi pse nuk e bëri këtë. Megjithatë, Trupi Gjykses konsideron se kjo nuk do të thotë se mund të nxirret përfundim se ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale.

867. Së fundi, sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se ZPS-ja i kishte kërkuar policisë së Kosovës që të mos ta hetonte çështjen, nga dëshmia e z. Qalaj është e qartë se vendimi për mospërfshirjen e policisë së Kosovës erdhi nga Prokuroria e Kosovës, domethënë, nga PSRK-ja.<sup>1823</sup> Nuk ka asnjë provë se ZPS-ja pati ndonjë rol në atë vendim.

868. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur nga argumentet e Mbrojtjes. Gjithsesi, edhe nëse Trupi Gjykses do ta konsideronte të mangët hetimin e ZPS-së për rrjedhjen e informacionit, kjo nuk do të tregonte se ZPS-ja i shtyu të akuzuarit në kryerjen e veprës penale. Në rastin më të mirë, kjo do të ishte provë për mangësi hetimore dhe/ose se ZPS-ja pranoi se disa prej informacioneve të nxjerra do të mbeteshin publike.

#### iv) Faktorët rrethanorë të Gucatit

869. Së fundi, Mbrojtja e Gucatit argumentoi se kishte prova rrethanore të shtytjes për kryerjen e veprës penale të të akuzuarve nga ZPS-ja;<sup>1824</sup> të cilën ZPS-ja e

---

<sup>1822</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3673; W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1101-1109, 1128-1131, 1133. *Shih gjithashtu* 1D10.

<sup>1823</sup> DW1246 (Rashit Qalaj), Transkripti, 14 janar 2022, f. 3071-3073.

<sup>1824</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3667-3668; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134-137; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 41; F288, para. 20. *Shih gjithashtu* F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 278.

kundërshtoi.<sup>1825</sup> Trupi Gjyqësor, pasi shqyrtoi me radhë secilin prej faktorëve, vëren sa vijon.

870. Mbrojtja argumentoi se, përpara tri dorëzimeve, materiali në tri grupet e dokumenteve kishte qenë në kontrollin e ZPS-së dhe se asnjë subjekt tjetër nuk kishte pasur qasje në dokumentet që përbënin grupin e tretë.<sup>1826</sup> Edhe nëse materiali i të tri grupeve të dokumenteve kishte dalë nga ZPS-ja, kjo nuk do të thotë se rrjedhja e tij ishte rezultat i një plani të qëllimshëm për të shtyrë të akuzuarit të kryenin veprën penale, e jo rezultat i cenimit të sigurisë ose i një veprimi keqdashës.<sup>1827</sup> Po ashtu, fakti që hetimi i OVL-UÇK-së u koordinua nga dy zyrtarët më të lartë të ZPS-së<sup>1828</sup> nuk është tregues i shtytjes për kryerjen e veprës penale.

871. Mbrojtja argumentoi se, ndonëse ZPS-ja ishte paralajmëruar për dorëzime të tjera të mundshme pas dorëzimit së parë dhe të dytë, ajo nuk bëri asnjë përpjekje për parandalimin e tyre. Mbrojtja nxori përfundimin se ZPS-ja donte që tri dorëzimet të realizoheshin.<sup>1829</sup> Trupi Gjyqësor mendon se paaftësia e ZPS-së për t'i parandaluar dorëzimet e tjera nuk të çon në përfundimin se ZPS-ja donte që ato të kryheshin, e aq më pak që ajo bëri koordinimin e tyre. Ky pretendim kundërshtohet gjithashtu edhe nga një kërkesë e punonjësve të ZPS-së drejtuar të akuzuarve, që ta lajmëronin ZPS-në nëse do të merrnin materiale të reja përpara se t'i publikonin ato (gjë që të akuzuarit e refuzuan dhe nuk e bënë).<sup>1830</sup>

---

<sup>1825</sup> *Shih p.sh.*, F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 308-311; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3486-3490.

<sup>1826</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3668; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(a); F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 41(b); F288, para. 20(c)(ii).

<sup>1827</sup> *Shih më lart* para. 859-862 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>1828</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(b). *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3670.

<sup>1829</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3671-3672; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(c); F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 41(c); F288, para. 20(c)(vi)(vii).

<sup>1830</sup> *Shih p.sh.*, DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2292.

872. Mbrojtja argumentoi se pas konferencës së parë dhe të dytë për shtyp, ZPS-ja qëllimisht i la grupin e parë dhe të dytë të dokumenteve në duart e OVL-UÇK-së deri të nesërmen.<sup>1831</sup> Kohët e lëshimit të dy urdhrave të Gjykatësit të Vetëm tregojnë se ZPS-ja veproi me shpejtësi për të kërkuar urdhra prej tij.<sup>1832</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk është bindur se ZPS-ja nuk reagoi mjaftueshmërisht me shpejtësi dhe, gjithsesi, nuk arrin të kuptojë logjikën se si lënia e materialit deri të nesërmen në duart e OVL-UÇK-së tregon shtytje për kryerjen e veprës penale.

873. Mbrojtja argumentoi se ka prova se anëtarët e OVL-UÇK-së ishin vënë nën vëzhgim.<sup>1833</sup> Z. Gucati vuri re një makinë që e ndiqte në ditët para dorëzimit të dytë dhe të tretë; ai ia tregoi këtë ZPS-së, e cila nuk tregoi asnjë interes.<sup>1834</sup> Mbrojtja pretendoi se përfundimi që duhej nxjerrë ishte se ZPS-ja po vëzhgonte të akuzuarin në vend që të vëzhgonte selinë e OVL-UÇK-së për të parandaluar dorëzime të mëtejshme.<sup>1835</sup> Së pari, Trupi Gjykues vëren se nuk ka asnjë tregues se makina në fjalë (e paidentifikuar) kishte ndonjë lidhje me rrjedhjen e informacionit. Së dyti, fakti se punonjësi i ZPS-së u perceptua nga i akuzuari si “i painteresuar”, nuk tregon shtytje për kryerjen e veprës penale. Argumenti nuk është bindës dhe nuk bazohet në prova. Edhe nëse pranohet, pretendimi se ZPS-ja e kishte vëzhguar të akuzuarin bie ndesh me pretendimin se ZPS-ja nuk po përpiquej të identifikonte personat që qëndronin pas rrjedhjes.

874. Mbrojtja argumentoi se, dukej se dorëzimi i tretë ishte parashikuar nga urdhri i ZPS-së 13 ditë para se të ndodhte sepse i referohej “produktit të punës së brendshme”,

---

<sup>1831</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(d). *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3671.

<sup>1832</sup> P52 (07/09/2020 20:16:00); P53 (Data në origjinal: 17/09/2020 08:24:00).

<sup>1833</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(e).

<sup>1834</sup> F288, para. 20(c)(ix)-(x).

<sup>1835</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(e).



çka sugjeron planifikim nga ana e ZPS-së.<sup>1836</sup> Ky pretendim nuk ka asnjë bazë. ZPS-ja ka shpjeguar në mënyrë të besueshme se data fillestare (9 shtator 2020), e korrigjuar më vonë me shkrim dore nga një punonjës i ZPS-së (më 22 shtator 2020), ishte gabim shtypi.<sup>1837</sup>

875. Mbrojtja argumentoi se të akuzuarit i dhanë ZPS-së numrin e targës së një makine që kishte lidhje me dorëzimin e dytë, por ZPS-ja nuk ndërmori asnjë kontroll deri në fund të nëntorit 2020, pa asnjë shpjegim.<sup>1838</sup> Fakti që ZPS-ja nuk e kontrolloi menjëherë targën nuk të çon në përfundimin se kishte shtytje për kryerjen e veprës penale dhe arsyet e vonesës nuk u përcaktuan në gjykim. Pretendimi se ZPS-ja duhej të kishte kryer më shumë hetime (pa vonesë) mbi këtë duket se nuk ka asnjë lidhje me këtë çështje gjyqësore.

876. Mbrojtja argumentoi se ZPS-ja kishte treguar pak ose aspak interes që t'i merrte tri grupet e dokumenteve nga personat e tjerë përveç të akuzuarve, në veçanti materialin që ende e kishin mediat.<sup>1839</sup> Fakti që ZPS-ja i përqendroi përpjekjet e saj në marrjen e materialit nga OVL-UÇK-ja, sipas mendimit të Trupit Gjyqësor, nuk tregon shtytje për kryerjen e veprës penale.

877. Mbrojtja argumentoi [REDAKTUAR].<sup>1840</sup> Ndonëse pranohet se hipoteza e rrjedhjes së qëllimshme të informacionit nga një punonjës i ZPS-së nuk mund të përjashtohet plotësisht, Trupi Gjyqësor rikujton se raporti nxori përfundimin se nuk kishte prova që punonjësit e ZPS-së nxorën qëllimisht grupin e tretë të dokumenteve [REDAKTUAR].<sup>1841</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjyqësor nuk pranon që mundësia hipotetike e rrjedhjes së qëllimshme të dokumenteve nga një punonjës i ZPS-së përbën bazë të

---

<sup>1836</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3672; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(f); F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 41(d); F288, para. 20(c)(xi).

<sup>1837</sup> P54; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 309-310.

<sup>1838</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(g); F288, para. 20(c)(viii).

<sup>1839</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3673; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(h).

<sup>1840</sup> Transkripti, 16 mars 2022, f. 3673-3675; F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(i).

<sup>1841</sup> 1D33.

arsyeshme për të arritur në përfundimin se ZPS-ja i shtyu të akuzuarit të kryenin veprë penale.

878. Mbrojtja argumentoi se një punonjës i ZPS-së ishte i implikuar si burimi i rrjedhjes së dokumenteve dhe ai nuk u thirr nga ZPS-ja si dëshmitar.<sup>1842</sup> Trupi Gjykses është bindur se ky pretendim ishte tejet hamendësues, është kundërshtuar në mënyrë të besueshme nga ZPS-ja, dhe nuk ka bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se punonjësi ishte implikuar në ndonjë mënyrë në rrjedhjen e dokumenteve. Për më tepër, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja nuk kërkoi që ta intervistonte apo ta thërriste këtë individ si dëshmitar.

879. Mbrojtja argumentoi se ZPS-ja kishte motivin që të kryente një “operacion të fshehtë” kundër OVL-UÇK-së dhe se nuk ishte krejtësisht e pagjasë që një operacion i tillë kishte qëllim të shtynte të akuzuarit që të kryenin veprën penale.<sup>1843</sup> Ky pretendim nuk mbështetet në prova dhe është i pabazuar.

880. Trupi Gjykses vëren se disa nga rrethanat e përmendura fillimisht nga Mbrojtja e Gucatit lidhur me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale nuk u përsëritën në dosjen gjyqësore përfundimtare ose deklaratat përmbyllëse. Megjithatë, Trupi Gjykses do t’i trajtojë ato më poshtë.

881. Mbrojtja argumentoi se veprimet e ZPS-së kishin treguar se ajo do ta përdorte rrjedhjen e materialit si mjet për të arritur qëllimet e veta, duke i zbuluar publikut ekzistencën e një aktakuzë të pakonfirmuar kundër z. Thaçi dhe të tjerëve, në kundërshtim me Ligjin dhe Rregulloren.<sup>1844</sup> Ky argument është i pathemeltë. ZPS-ja kërkoi autorizim gjyqësor nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për ta bërë publike

---

<sup>1842</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 134(i), 137; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3675.

<sup>1843</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 135-137; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 42-43; F288, para. 20(c)(xii), 22. *Shih gjithashtu* Transkripti, 16 mars 2022, f. 3673.

<sup>1844</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 41(a); F288, para. 20(c)(i).

këtë çështje.<sup>1845</sup> Rrjedhimisht, sjellja e ZPS-së ishte e ligjshme dhe nuk ka tregues të shtytjes për kryerjen e veprës penale.

882. Mbrojtja argumentoi se ZPS-ja i kishte përdorur rrethanat në të cilat u kryen tri dorëzimet kundër z. Thaçi dhe të tjerëve, si arsye për të kundërshtuar lirimin e përkohshëm të tyre, edhe pse nuk u ngrit asnjë akuzë kundër tyre në lidhje me to.<sup>1846</sup> Ky pretendim është i pabazë. Gjithashtu, fakti që ZPS-ja konsideronte se nxjerrja e këtyre dokumenteve kishte lidhje me paraburgimin e disa të akuzuarve nuk është provë se ajo e nxori qëllimisht materialin në mënyrë që të mund të paraqiste atë argument.

883. Mbrojtja argumentoi se grupi i parë i dokumenteve u dorëzua nga një mashkull i panjohur me udhëzimin që t'u vihej në dispozicion mediave.<sup>1847</sup> Kjo nuk përbën provë rrethore të shtytjes për kryerjen e veprës penale. Në vend të kësaj dhe në rastin më të mirë, ajo do të demonstronte synimin që informacioni të publikohej më tej.

884. Mbrojtja argumentoi se zyrtarët e ZPS-së më pas i thanë OVL-UÇK-së që t'i mbante dokumentet e mbetura nga grupi i parë deri në një muaj.<sup>1848</sup> Ky pretendim u trajtua dhe u hodh poshtë më lart.<sup>1849</sup>

885. Mbrojtja argumentoi se, gjatë sekuestrimit të parë, ZPS-së iu tha se pamjet e kamerave të sigurisë mund të kishin ndihmuar në identifikimin e individit që bëri dorëzimin e parë, por zyrtarët e ZPS-së nuk ishin të interesuar. Mbrojtja nxori përfundimin se ZPS-ja e dinte tashmë identitetin e dorëzuesit.<sup>1850</sup> Pretendimi se ZPS-

---

<sup>1845</sup> KSC-BC-2020-06, F9.

<sup>1846</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 44; F288, para. 20(c)(xiii).

<sup>1847</sup> F288, para. 20(c)(iii).

<sup>1848</sup> F288, para. 20(c)(iv).

<sup>1849</sup> *Shih më lart* para. 865.

<sup>1850</sup> F288, para. 20(c)(v).

ja ishte “e paineresuar” kundërshtohet nga dokumentacioni, pasi duket se ZPS-ja në fakt e mori materialin.<sup>1851</sup>

886. Mbrojtja argumentoi se ZPS-ja nuk e kontaktoi gazetaren që filmoi dorëzimin e dytë, në mënyrë që të përpiqej të identifikonte dorëzuesin, duke arritur në përfundimin se ZPS-ja e dinte tashmë se kush ishte ai person.<sup>1852</sup> Ky argument u diskutua gjatë gjykimit.<sup>1853</sup> Trupi Gjykses vëren se pamjet filmike u publikuan në internet pak pas ngjarjeve dhe rrjedhimisht mund të siguroheshin lehtësisht pa ndihmën e gazetares në fjalë. Fakti që ZPS-ja nuk e kontaktoi gazetaren nuk të çon në përfundimin se ZPS-ja “tashmë e dinte identitetin e personit që dorëzoi dokumentet”. As nuk ka tregues që shikimi i pamjeve filmike do të mundësonte identifikimin e këtij personi.

887. Mbrojtja argumentoi se: (i) z. Gucati i dha një punonjësi të ZPS-së një pamje të automjetit që supozohej se ishte përdorur nga individit që bëri dorëzimin e dytë, por punonjësi i ZPS-së nuk e mbajti atë; dhe (ii) ZPS-ja kreu një “intervistë sa për sy e faqe” me pronarin e automjetit vetëm më 18 dhjetor 2020.<sup>1854</sup> Mbrojtja deklaroi se përfundimi që duhej të nxirrej ishte se ZPS-ja e dinte gjatë gjithë kohës identitetin e personin që bëri dorëzimin e dytë dhe nuk u përpoq të ndalonte një dorëzim të mëtejshëm. Trupi Gjykses e gjykon të pabazë pretendimin se intervista e ZPS-së me pronarin e automjetit, që sipas të akuzuarve kishte lidhje me dorëzimin, ishte sa për sy e faqe. Fakti që kjo intervistë u krye vetëm në dhjetor 2020 nuk mbështet përfundimin se ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale, dhe arsytet e vonës as u shtjelluan, as u përcaktuan në gjykim. Po kështu, nuk është vërtetuar as që automjeti në fjalë apo shoferi i saj, të ketë luajtur ndonjë rol në nxjerrjen e dokumenteve. Nga kjo rrjedh se pretendimi se ZPS-ja duhej të kishte kryer më shumë hetime (pa vonesë) lidhur me

---

<sup>1851</sup> P163; P164.

<sup>1852</sup> F288, para. 20(c)(vii).

<sup>1853</sup> 1D5, para. 31; DW1242 (Elmedina Ballhazhi), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2495.

<sup>1854</sup> F288, para. 20(c)(viii). *Shih gjithashtu më lart para. 875.*

këtë pikë nuk mbështet nxjerrjen e përfundimit se ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale.

888. Trupi Gjykses konstaton se propozimet e paraqitura nga Mbrojtja e Gucatit si prova rrethanore të shtytjes për kryerjen e veprës penale janë të pabazuara dhe hipotetike dhe, gjithsesi, nuk mbështesin, qoftë më vete apo në tërësinë e tyre, përfundimin se ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale.

#### 4. Përfundim

889. Trupi Gjykses është bindur se nuk ka bazë të arsyeshme për të arritur në përfundimin se secili nga të akuzuarit është shtyrë të kryejë vepër penale nga zyrtarët e ZPS-së ose nga ndonjë individ që vepronte sipas udhëzimeve ose ishte nën kontrollin e ZPS-së. Së pari, as deklaratat e tyre të asaj kohe dhe as dëshmitë e tyre në gjyq nuk tregojnë arsye objektive për të besuar që të akuzuarit u shtynë të kryenin vepër penale. Së dyti, [REDAKTUAR]. Së treti, ndonëse ZPS-ja ngurroi të angazhohej plotësisht lidhur me pretendimin e shtytjes për kryerjen e veprës penale për shkak të shqetësimit të qartë për konfidencialitetin e hetimeve të saj, as ky, as ndonjë faktor apo rrethanë tjetër e paraqitur nga Mbrojtja nuk ofron bazë të besueshme për të nxjerrë përfundimin se pati shtytje për kryerjen e veprës penale. Së fundi, nuk ka asnjë tregues se ndonjë nga provat e paraqitura nga ZPS-ja u mor ose siguroa me anë të shtytjes për kryerjen e veprës penale.

890. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se pretendimi i shtytjes për kryerjen e veprës penale është krejtësisht i pagjasë dhe i pabazuar.

## E. GABIMI LIGJOR

### 1. Parashtrimet e palëve

891. Mbrojtja parashtrroi se të akuzuarit nuk janë penalisht përgjegjës sepse ata nuk e dinin që sjellja e tyre ishte e ndaluar.<sup>1855</sup> Mbrojtja pretendoi se të akuzuarit vepruan me bindjen se po vepronin në mënyrë të ligjshme, në përputhje me këshillën juridike të z. Tomë Gashi.<sup>1856</sup>

892. ZPS-ja parashtrroi se mospajtimi i të akuzuarve me cilësimin e veprimeve të tyre si të paligjshme nuk është i njëjtë me të vepruarit në bazë të gabimit ligjor.<sup>1857</sup> ZPS-ja shtoi se këshilla juridike e z. Tomë Gashi nuk ka asnjë ndikim sepse: (i) ai u caktua vetëm pas konferencës së dytë për shtyp; dhe (ii) çfarëdo këshille juridike e dhënë prej tij thjesht miratoi atë që të akuzuarit tashmë e kishin bërë me materialet.<sup>1858</sup>

### 2. Aspekte ligjore

893. Trupi Gjykses thekson se, në përputhje me nenin 26(1) të KPK-së, sipas argumentit mbrojtës për gabim ligjor: (i) për shkaqe të arsyeshme, (ii) personi nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se vepra është e ndaluar.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses

894. Trupi Gjykses konstatoi se të dy të akuzuarit ishin penalisht përgjegjës për veprat penale të përfshira në Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6.<sup>1859</sup> Trupi Gjykses tani do të vlerësojë nëse përgjegjësia penale e të akuzuarve mund të përjashtohet në bazë të gabimit ligjor.

<sup>1855</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 114; F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(a); F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 281; Transkripti, 16 mars 2022, f. 3704-3705.

<sup>1856</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 114.

<sup>1857</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 288.

<sup>1858</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 288; Transkripti, 14 mars 2022, f. 3491.

<sup>1859</sup> *Shih më lart* para. 501 (Pika 5), 552 (Pika 6), 606 (Pika 3), 672 (Pika 1), 710 (Pika 2), 794 (Format e përgjegjësive penale).

895. Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit shpërndanë tri grupet e dokumenteve dhe përshkruan informacionin në to, duke ditur se aty përfshiheshin informacione konfidenciale dhe emrat e dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>1860</sup> Në konferencën e parë për shtyp, z. Haradinaj, në prani të z. Gucati, përshkroi grupin e parë të dokumenteve që përmbante të gjitha “të dhënat [...] sekrete”,<sup>1861</sup> si “konfidenciale dhe [...] top sekrete”<sup>1862</sup> dhe si “shumë, shumë top sekret”.<sup>1863</sup> Në konferencën e dytë për shtyp, z. Haradinaj, përsëri në praninë e z. Gucati, tregoi se e kishin diskutuar çështjen e zbulimit të dokumenteve me avokatin e tyre, i cili i këshilloi se “asgjë prej emnash që s’i përmendim, nuk është e dënime”.<sup>1864</sup> Bazuar në atë këshillë, të akuzuarit deklaruan se zbulimi publik i bashkëpunimit midis TFHS-së/ZPS-së dhe zyrtarëve serbë ose shpërndarja e tri grupeve të dokumenteve, megjithëse përmbanin emra të mbrojtur, nuk ishte vepër penale.<sup>1865</sup>

896. Trupi Gjykses fillimisht do të vlerësojë nëse të akuzuarit e dinin ose kanë mundur ta dinin se kjo sjellje ishte e ndaluar. Trupi Gjykses rikujton se me Urdhrin e Parë, Urdhrin e Dytë dhe Urdhrin e ZPS-së z. Gucati, OVL-UÇK-ja dhe çdo individ tjetër që kishte në zotërim këto dokumente dhe/ose dinte përmbajtjen e tyre, u urdhëruan që të mos kopjonin në çfarëdo forme dhe të mos shpërndanin më tej, me çfarëdo mjeti komunikimi, dokumentet apo përmbajtjen e tyre.<sup>1866</sup> Gjithashtu, në të tre urdhrat të njëjtët persona apo subjekte u paralajmëruan se shkelja e kushteve të

---

<sup>1860</sup> *Shih më lart* para. 456 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1861</sup> P1, f. 2.

<sup>1862</sup> P1, f. 3.

<sup>1863</sup> P1, f. 5.

<sup>1864</sup> P2, f. 4 (Z. Haradinaj: “Po them, se ne u diskutum me avokatin tonë, se e kemi marrë një avokat paraprak për punën e kësaj, dhe na tha: “Asgjë prej emnash që si përmendim, nuk është e dënime”. Ne s’jemi tuj përmend emna edhe Holanda s’përmendi emna [...] Emnat e zyrtarëve unë nuk mendoj që a vepër penale me i qit.”).

<sup>1865</sup> P6, f. 40 (Z. Haradinaj); P18, f. 3 (Z. Haradinaj); P28, f. 1-2 (Z. Gucati). *Shih gjithashtu më lart* para. 447 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1866</sup> P52, para. 22(c); P53, para. 22(c); P54, f. 1.

urdhrave mund të përbënte vepër penale sipas KPK-së.<sup>1867</sup> Për më tepër, një hetues i ZPS-së e përforcoi Urdhrin e Dytë edhe gojarisht gjatë sekuestrimit të dytë.<sup>1868</sup>

897. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se të akuzuarit ishin në dijeni të ndalimit të përfshirë në urdhrat. Z. Haradinaj vuri një fotografi të Urdhrit të Parë në profilin e tij në *Facebook*.<sup>1869</sup> Z. Gucati nënshkroi vërtetimin e dorëzimit të dytë për sekuestrimin e dytë.<sup>1870</sup> Gjatë një paraqitje në media menjëherë pas kësaj, në prani të z. Tomë Gashi, z. Gucati deklaroi se zyrtarët e ZPS-së “mu më thanë në ren, që s’është mirë këto dokumentacione të shumëzohen, të shpërndahen, apo të publikohen emnat e dëshmitarëve siç tha edhe avokati”.<sup>1871</sup> Duke treguar me gisht Urdhrin e Dytë, z. Gucati tha se “që është qetu që shkrun [...] ‘shumëzimi i tyne s’bën të jetë edhe shpërndamje e tyne’ thotë ‘nuk bën’”.<sup>1872</sup> Gjatë një paraqitjeje në media më 19 shtator 2020, z. Haradinaj i tregoi kamerës një kopje të Urdhrit të Dytë dhe deklaroi: “qyre ku i keni, se i keni rreshtat në anglisht dhe obligimet që ata na shtijnë në obligime”.<sup>1873</sup> Kur gazetarja komentoj se besonte që ato detyrime ishin që OVL-UÇK-ja “të mos e publikonte” materialin, z. Haradinaj u përgjigj: “ Po, ne s’kemi nevojë me i publiku. Ne i kemi dhanë kush i publikon”.<sup>1874</sup> Me gjithë këtë deklaratë, më 22 shtator 2020 të akuzuarit zbuluan grupin e tretë të dokumenteve.<sup>1875</sup>

---

<sup>1867</sup> P52, para. 25; P53, para. 25; P54, f. 1.

<sup>1868</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2292-2293, 2295.

<sup>1869</sup> P83, f. 1. *Shih gjithashtu* P78, P79.

<sup>1870</sup> P55; 2D1, para. 94, 115; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2291.

<sup>1871</sup> P4, f. 8.

<sup>1872</sup> P4, f. 8 (Z. Gucati shtoi: “Ata kërkojnë prej Organizatës së Veteranëve, që mos të shumëzohen këto dokumente dhe të mos të ruhet në Organizatë. Ne e kuptojmë, s’është interesi jonë me mujt me i ru. Interesi jonë është sa më shumë me i shpërnda në media”).

<sup>1873</sup> P17, f. 6.

<sup>1874</sup> P17, f. 6.

<sup>1875</sup> *Shih më lart* para. 279-283 (Ngjarjet në fjalë).



898. Në gjykim, të akuzuarit përsëritën qëndrimin e tyre lidhur me ligjshmërinë e sjelljes së tyre,<sup>1876</sup> por të dy pranuan se e kuptonin detyrimin e tyre bazë që të mos shumëfishonin dhe/ose shpërndanin grupet e dokumenteve.<sup>1877</sup> Z. Gucati mohoi që kjo i ishte dhënë me shkrim, por pranoi që një hetues i ZPS-së i tha me gojë “është e ndalume që të shumëzohen dokumentacionet apo të shpërndahen.”<sup>1878</sup> Z. Haradinaj fillimisht deklaroi se ai “vetë nuk e dinte” se çfarë përmbante Urdhri i Dytë, por më vonë u përgjigj: “Nëse më pyet se çka është thënë këtu, na kanë thënë mos me i shtyp, mos me i shumëzuar, mos me i shpërnda”.<sup>1879</sup>

899. Gjithashtu, disa gazetarë u bënë pyetje të akuzuarve për (pa)ligjshmërinë e sjelljes së tyre.<sup>1880</sup> Kur diskutoi pasojat e mundshme penale me një gazetar, z. Gucati u përgjigj se nuk ishte penduar për zbulimin e materialit “dhe pes vjet burg mi jep”.<sup>1881</sup> Z. Haradinaj iu përgjigj këtyre pyetjeve me: “në se për këtë ata më arrestojn, mu do të më nderojn”;<sup>1882</sup> “në këtë rast po shkoj edhe unë në burg, tash me tute”;<sup>1883</sup> “ti je ka më tut me dhjetë vjet. 300 vjet të më japshin për qitë punë, unë e qes”;<sup>1884</sup> ose “na jena të përgatitun 300 vjet. Ne jemi kanë të përgatitun me vdek”.<sup>1885</sup>

900. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se gjatë periudhës që përfshin Aktakuza të akuzuarit e dinin se sjellja e tyre ishte ligjrisht e ndaluar dhe mund të çonte në dënim me burgim.

---

<sup>1876</sup> *Shih p.sh.*, 1D3, para. 21-26, 36, 59-66; 2D1, para. 126-131; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2205-2206; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2810-2814; Transkripti, 13 janar 2022, f. 3021-3022; Transkripti, 14 janar 2022, f. 3045-3047. *Shih gjithashtu* F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 117-119.

<sup>1877</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2288-2293; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2930-2935.

<sup>1878</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2293.

<sup>1879</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2932, 2935.

<sup>1880</sup> *Shih p.sh.*, P6, f. 15; P11, f. 28-29; P28, f. 12; P30, f. 8; P35, f. 12-13.

<sup>1881</sup> P28, f. 12.

<sup>1882</sup> P25, f. 2.

<sup>1883</sup> P35, f. 12.

<sup>1884</sup> P35, f. 13.

<sup>1885</sup> P35, f. 13.

901. Sidoqoftë, nëse supozohet se të akuzuarit nuk e dinin ose nuk mund të kenë ditur se sjellja e tyre ishte ligjrisht e ndaluar, sipas nenit 26(1) i KPK-së gabimi i tyre duhet të jetë rezultat i “shkaqeve të arsyeshme”. Trupi Gjykues thekson se qëndrimi i të akuzuarve në lidhje me ligjshmërinë e sjelljes së tyre duket se bazohet në këshillën juridike të z. Tomë Gashi.<sup>1886</sup>

902. Trupi Gjykues thekson se këshilla juridike e z. Tomë Gashi u përmend për herë të parë nga z. Haradinaj në konferencën e dytë për shtyp, që do të thotë se grupi i parë i dokumenteve u zbulua pa këshillën e tij. Menjëherë pas sekuestrimit të dytë, vetë z. Tomë Gashi e shpjegoi këshillën e dhënë si vijon:

Këta [Organizata e Veteranëve të Luftës], sigurisht që i kanë publikuar ato, për shkak se kështu kanë vendosur. Mendojnë që nuk është e ndaluar fare që të publikohen këto dokumentacione. Mirëpo, ju duhet të keni parasysh që nëse gjeni në këto dokumentacione emra, mbiemra, dhe të dhëna të tjera të dëshmitarëve, nuk mundeni në asnjë mënyrë që t'i bëni publike, por nuk është e ndaluar që të publikoni relacionet që i kanë pas zyrtarë të Prokurorisë Speciale, të Gjykatës Speciale me organet e ndjekjes së Serbisë.<sup>1887</sup> [...]

z. Gucati tregoi në -- e tha në cilësinë e Kryetarit që sa herë të marrim materiale të tilla do t'i publikojnë, që populli ta ketë të qartë me çfarë Gjykate jemi duke u përball. Dhe nuk ka asgjë të keqe, prapë e them, është -- [...], ju edhe nëse keni ardh dhe nëse keni pas qasje në këto dokumente, është rreptësisht e ndaluar që t'i publikoni emrat e dëshmitarëve, sepse atëherë ju vetë mund të viheni në situata të pakëndshme.

Por jo z. Gucati apo dikush tjetër që jua ka dhënë mundësinë që të keni qasje dhe t'i shifni komunikimet zyrtare në mes -- ndërinstitucionale -- të Serbisë me Gjykatën Speciale.<sup>1888</sup>

903. Trupi Gjykues vëren se duket që z. Tomë Gashi u dha këshillë për herë të parë të akuzuarve përpara konferencës së dytë për shtyp. Kjo këshillë nuk duket se ka ndryshuar, pavarësisht nga fakti se ai ishte plotësisht në dijeni të ndalimit të urdhëruar në Urdhrin e Dytë, pasi: (i) z. Tomë Gashi ishte i pranishëm në sekuestrimin e dytë;<sup>1889</sup>

<sup>1886</sup> P2, f. 4; P4; P7; P12.

<sup>1887</sup> P4, f. 3 (z. Tomë Gashi). *Shih gjithashtu* P7; P12.

<sup>1888</sup> P4, f. 9 (z. Tomë Gashi). *Shih gjithashtu* P7; P12.

<sup>1889</sup> *Shih më lart* para. 257 (Ngjarjet në fjalë).

dhe (ii) z. Gucati deklaroi në praninë e tij, në të njëjtën paraqitje në media ku z. Tomë Gashi bëri përmbledhjen e këshillave të tij, se në bazë të Urdhrit të Dytë dhe asaj që thanë punonjësit e ZPS-së, ai nuk lejohej të shumëfishonte apo shpërndante grupin e dytë të dokumenteve.<sup>1890</sup> Z. Tomë Gashi ishte gjithashtu në dijeni se “është dokumentacion me ndjeshmëri për [ZPS-në]”<sup>1891</sup> dhe se “rrjedhja e informacionit do të thotë është diçka tepër e ndjeshme”.<sup>1892</sup> Kjo nuk e pengoi z. Tomë Gashi që të deklaronte se dhënia e qasjes në dokumente nuk ishte e paligjshme dhe se vetëm publikimi i emrave të dëshmitarëve mbartte rrezikun e ndjekjes penale.

904. Sidoqoftë, provat tregojnë se arsyet pse z. Tomë Gashi dha këshilla të tilla kishin lidhje me pikëpamjet e tij personale për DHS-në/ZPS-në, të cilat përputheshin me ato të të akuzuarve. Në veçanti, z. Tomë Gashi: (i) kur u pyet nëse dëshmitarët po mbroheshin në mënyrë efektive nga DHS-ja;<sup>1893</sup> (ii) tha se mbrojtja e dëshmitarëve ishte “problem [që] kanë ata [DHS-ja/ZPS-ja] dhe jo ne”;<sup>1894</sup> (iii) lavdëroi individët që dorëzuan tri grupet e dokumenteve;<sup>1895</sup> (iv) pretendoi se të akuzuarit ishin të interesuar të demaskonin bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe dhe përsëriti përkushtimin e të akuzuarve që të vazhdonin të publikonin materiale të tilla sa herë që t’i merrnin;<sup>1896</sup> (v) shprehu pikëpamjen se tri grupet e dokumenteve mund

---

<sup>1890</sup> P4, f. 8.

<sup>1891</sup> P7, f. 3.

<sup>1892</sup> P7, f. 11.

<sup>1893</sup> P7, f. 5 (Z. Tomë Gashi: “Tani po vërtetohet teoria që dëshmitarët s’po mujkan të mbrohen në Kosovë. Po qysh po u mbrojnë në Hagë?”).

<sup>1894</sup> P4, f. 6.

<sup>1895</sup> P7, f. 4-5 (Z. Tomë Gashi: “ne jemi falënderues, dhe jo të kundërtën, për dy persona, sepse nuk ka qenë personi i njëjtë, që i ka sjellë këto dokumente në Shoqatën e Veteranëve të UÇK-së. Dhe ai person, sipas meje, ka kry një punë atdhetare, në të mirë të përgjithshme, por posaçërisht në të mirë të atyre që do të jenë të akuzuar në Gjykatën Speciale”).

<sup>1896</sup> P12, f. 2 (Z. Tomë Gashi: “kemi parë atë që edhe më herët e kemi ditur, bashkëpunimin në mes të organeve të Serbisë dhe Gjykatës Speciale. Dhe besoj që kryetari, zoti GUCATI, zoti HARADINAJ dhe të tjerë kanë thënë gjithmonë se çfarëdo që të bjerë, a kushdo që t’i sjellë këtu, do t’i bëjnë publike, në kuptimin që opinioni shqiptar kudo që të jemi dhe të jenë ta marrë vesh se çfarë është duke ndodhur me Gjykatën Speciale”).

të përdoreshin për të dëmtuar besueshmërinë e DHS-së në qoftë se do të ngriheshin akuza;<sup>1897</sup> dhe (vi) shprehu shpresën se zbulimi i dokumenteve do ta bënte gjykatësin e DHS-së “të mendojë dy herë” përpara se të konfirmonte aktakuzën kundër z. Thaçi dhe të tjerëve.<sup>1898</sup>

905. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se sjellja e të akuzuarve nuk ndryshoi thelbësisht pasi morën këshillat e z. Tomë Gashi. Për rrjedhojë, ato këshilla nuk patën asnjë ndikim të dukshëm në sjelljen e të akuzuarve. Ata vazhduan, siç kishin bërë edhe më parë, të zbulonin pa dallim materiale që e dinin se ishin konfidenciale dhe përmbanin emrat e dëshmitarëve të mbrojtur.

906. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se këshilla juridike e z. Tomë Gashi nuk mund të konsiderohet “shkak i arsyeshem” brenda kuptimit të nenit 26(1) të KPK-së.

907. Për këto arsye, Trupi Gjykses gjykon se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet në bazë të argumentit mbrojtës për gabim ligjor brenda kuptimit të nenit 26 të KPK-së.

---

<sup>1897</sup> P12, f. 2 (Z. Tomë Gashi: “Ne mendojmë që në të ardhmen, nëse aktakuzat e ngritura kundër pjesëtarëve të UÇK-së të konfirmohen, atëherë mund të jenë materiale që mund të përdoren dhe mund të dëmtohet dhe të sulmohet kredibiliteti i Gjykatës Speciale, për shkak se OVL e UÇK-së i mbron, faktikisht, anëtarët e vet, pa marrë parasysh kushdo që të jetë”).

<sup>1898</sup> P7, f. 16 (“Z. Tomë Gashi: “Dhe publikimi i këtyre dokumenteve, po vetë publikimi i ardhjes së mijërave dosjeve në Organizatën e Veteranëve të UÇK-së ... ai gjyqtar para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit THAÇI dhe të tjerëve duhet të mendojë edhe një herë. Duhet të mendojë dy herë me konfirmu diçka apo mos me konfirmu”), 17 (Z. Tomë Gashi: “shpresojmë që Gjykata, edhe me ndihmën e këtyre rrjedhjeve të dokumentacionit të Gjykatës Speciale, mos ta konfirmojë aktakuzën ndaj Presidentit THAÇI”).

## F. NEVOJA EKSTREME

### 1. Parashtrimet e palëve

908. Mbrojtja argumentoi se të akuzuarit vepruan vetëm për të shmangur rrezikun e afërt e të paprovokuar për të tjerët (konkretisht, ndjekjen penale keqdashëse) që nuk mund të shmangej ndryshe dhe, rrjedhimisht, sjellja e tyre nuk mund të përbënte vepër penale në rrethanat e parapara në nenin 13 të KPK-së.<sup>1899</sup>

### 2. Aspekte ligjore

909. Trupi Gjykses thekson se, në përputhje me nenin 13(2) të KPK-së, mbrojtja në nevojë ekstreme ekziston kur: (i) personi e ka kryer veprën (ii) për të zbrapsur rrezikun e afërt e të paprovokuar (iii) prej vetes ose tjetrit (iv) i cili nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër, (v) me kusht që e keqja e shkaktuar të mos jetë më e madhe se e keqja që është kanosur.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses

910. Trupi Gjykses nuk mori asnjë provë në mbështetje të pretendimit të “nevojës ekstreme” sipas përkufizimit të nenit 13 të KPK-së.<sup>1900</sup> Trupi Gjykses konstatoi se në informacionin e mbrojtur që u zbulua nga të akuzuarit nuk kishte asnjë tregues për veprime të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe.<sup>1901</sup> Trupi Gjykses nuk mund të përcaktojë nëse informacioni i mbledhur nga TFHS-ja/ZPS-ja ishte jo i besueshëm. Sidoqoftë, edhe nëse ZPS-ja kishte mbledhur informacion që më vonë do të dilte se ishte jo i besueshëm, ky nuk është tregues se ZPS-ja do ta përdorte atë informacion për të nisur procese të pabaza dhe të

---

<sup>1899</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(b). *Shih gjithashtu* F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 94.

<sup>1900</sup> 1D3, para. 70; DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2209-2210.

<sup>1901</sup> *Shih më lart* para. 811-817 (Argumentet mbrojtëse).

papërligjura kundër ndonjë të dyshuari apo të akuzuari. Asnjë rrezik i afërt dhe i paprovokuar për ndjekje penale keqdashëse nuk buron nga këta faktorë.

911. Gjithashtu, edhe nëse do të kishte ekzistuar rreziku i ndjekjes penale keqdashëse, nuk ka asnjë bazë për të pretenduar se zbulimi i informacionit të mbrojtur, në veçanti i emrave dhe të dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, do të kishte ndihmuar efektivisht në shmangien e rrezikut të një ndjekjeje të tillë penale dhe se dëmi i shkaktuar si pasojë nuk do të ishte më i madh se dëmi i kërcënuar.

912. Për këto arsye, Trupi Gjykes gjykon se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet nga mbrojtja përmes argumentit mbrojtës të nevojës ekstreme brenda kuptimit të nenit 13 të KPK-së.

## **G. GABIM FAKTIK**

### **1. Parashtrimet e palëve**

913. Si alternativë, Mbrojtja ka argumentuar se në qoftë se konstatohet se nuk kishte asnjë rrezik të afërt dhe të paprovokuar të ndjekjes penale keqdashëse për të tjerët, të akuzuarit besuan gabimisht se ai rrezik ekzistonte dhe vepruan me atë bindje, dhe për këtë arsye përjashtohen nga përgjegjësia penale në përputhje me nenin 25 të KPK-së.<sup>1902</sup>

914. ZPS-ja e hodhi poshtë pretendimin e Mbrojtjes se të akuzuarit vepruan mbi bazën e gabimit faktik.<sup>1903</sup>

### **2. Aspekte ligjore**

915. Trupi Gjykes thekson se, në pajtim me nenin 25(1) të KPK-së, argumenti mbrojtës për gabim faktik kërkon që: (i) në kohën e kryerjes së veprës penale,

---

<sup>1902</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(c); F260 Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 282.

<sup>1903</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 287-289.

- (ii) personi nuk ishte i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e asaj vepre ose
- (iii) gabimisht mendoi se ekzistonin rrethana, të cilat faktikisht po të ekzistonin,
- (iv) kjo vepër do të ishte e lejuar.

### 3. Konstatimet e Trupit Gjykses

916. Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk bëri parashtrime dhe nuk paraqiti prova për mungesën e dijenisë së të akuzuarve lidhur me veçoritë e veprimeve të tyre, apo për një bindje të gabuar lidhur me rrethanat, gjë që do t'i kishte bërë të besonin se ndjekja penale keqdashëse ishte e afërt dhe do ta bënte sjelljen e tyre të lejueshme. Trupi Gjykses mund të supozojë vetëm se ky argument mbrojtës ka të bëjë me pikëpamjet e të akuzuarve për DHS-në/ZPS-në, përfshirë bashkëpunimin e saj me autoritetet serbe dhe mbështetjen e saj në disa dëshmitarë të cilët të akuzuarit i konsideronin kriminelë.

917. Trupi Gjykses konstatoi se informacioni i mbrojtur që zbuluan të akuzuarit nuk përmbante asnjë tregues për veprime të papërshtatshme në bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe.<sup>1904</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se ZPS-ja ishte e lirë të mblidhte dëshmi nga çdo person për të cilët kishte interes, përfshirë personat e dyshuar ose të dënuar.<sup>1905</sup> Mbledhja e provave nga persona të tillë ose mbledhja e dëshmive jo të besueshme në përgjithësi nuk do të thotë se TFHS-ja/ZPS-ja e mori informacionin si të mirëqenë,<sup>1906</sup> e aq më pak se do ta përdorte atë për të filluar procedime të pabaza kundër ndonjë të dyshuari apo të akuzuari.

918. Trupi Gjykses thekson se dëshira e të akuzuarve për të penguar ose dëmtuar punën e DHS-së/ZPS-së me qëllim që të parandalonin ndjekjen penale të ish-anëtarëve të UÇK-së nuk është domosdoshmërisht bindje e gabuar se ndjekja penale keqdashëse nga DHS-ja/ZPS-ja ishte e afërt. Në fakt, të akuzuarit ishin kundër DHS-së/ZPS-së

---

<sup>1904</sup> *Shih më lart* para. 811-817 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>1905</sup> *Shih më lart* para. 814 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>1906</sup> *Shih më lart* para. 814 (Argumentet mbrojtëse).

sepse bashkëpunimin e saj me autoritetet serbe dhe mbledhjen përkatëse të provave ata i perceptonin se ishin në shërbim të interesave serbe dhe si qëndrim të njëanshëm kundër Kosovës.<sup>1907</sup> Të akuzuarit i konfirmuan pikëpamjet e tyre gjatë dëshmime të tyre.<sup>1908</sup>

919. Sidoqoftë, edhe nëse të akuzuarit besuan gabimisht se ndjekja penale keqdashëse nga DHS-ja/ZPS-ja ishte e afërt, nuk ka asnjë bazë për pretendimin se informacioni i mbrojtur, në veçanti emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve të mundshëm, do të ishte mjet efektiv për shmangien e rrezikut të një ndjekjeje penale të tillë, ku dëmi i shkaktuar nuk do të ishte më i madh se dëmi i kërcënuar.

920. Për këto arsye Trupi Gjykes gjykon se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet përmes argumentit mbrojtës për gabim faktik brenda kuptimit të nenin 25 të KPK-së.

## H. VEPRA E RËNDËSISË SË VOGËL

### 1. Parashtrimet e palëve

921. Mbrojtja argumentoi se, në mungesë të provave të pranueshme dhe provuese lidhur me ndonjë pasojë të dëmshme, sjellja e të akuzuarve nuk përbën vepër penale në përputhje me nenin 11 të KPK-së.<sup>1909</sup>

---

<sup>1907</sup> *Shih më lart* para. 662-665 (Pika 1).

<sup>1908</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2433 (Z. Gucati deklaroi se ai nuk dëshironte që ta dëmtonte ose pengonte DHS-në/ZPS-në, “po ta këshillojmë që të mos punojë me kriminelë lufte, po të punojë me njerëz që *de facto* e dinë ngjarjen dhe kanë qenë në ngjarje”); DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 12 janar 2022, f. 2877 (Z. Haradinaj konfirmoi gjatë dëshmisë së tij se ai ishte i gatshëm ta pengonte DHS-në “nëse është DHSK-ja që bazohet mbi të dhënat dhe idetë e Millosheviqit”).

<sup>1909</sup> F258 Dosja Paraprake e Gucatit, para. 35(d).



## 2. Aspekte ligjore

922. Trupi Gjykses thekson se, në përputhje me nenin 11 të KPK-së, argumenti mbrojtës për vepra të rëndësisë së vogël kërkon që rreziku nga sjellja e të akuzuarve të jetë i papërfillshëm për shkak të cilitdo prej kriterëve në vijim (i) llojit ose peshës së veprës; (ii) mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme; (iii) rrethanave në të cilat është kryer vepra; (iv) shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të kryesit; ose (v) rrethanave personale të kryesit.

## 3. Konstatimet e Trupit Gjykses

923. Trupi Gjykses nuk pranon se sjellja e të akuzuarve përbën vepër të rëndësisë së vogël sipas kuptimit të nenit 11 të KPK-së.

924. Për veprat penale për të cilat Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit janë penalisht përgjegjës, parashihen dënime të konsiderueshme me burgim. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka parasysh rëndësinë e interesave të mbrojtur prej dispozitave në lidhje me këto vepra penale – veçanërisht, mbrojtja e dëshmitarëve nga dëmi, krijimi i mundësive që ZPS-ja të përmbushë mandatin e saj në mënyrë të efektshme dhe ruajtja e besimit të publikut në integritetin e proceseve të DHS-së. Trupi Gjykses rikujton se DHS-ja u krijua pjesërisht për t'iu përgjigjur vështirësive lidhur me sigurinë e dëshmitarëve për shkak të frikësimit<sup>1910</sup> dhe se, për këtë arsye dëshmitarët, janë veçanërisht të cenueshëm në një mjedis të tillë.<sup>1911</sup>

925. Trupi Gjykses ka konstatuar se të akuzuarit nxorën identitetin dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.<sup>1912</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit e zbuluan informacionin e mbrojtur pa bërë

---

<sup>1910</sup> *Shih p.sh.*, Shkëmbimi i Letrave.

<sup>1911</sup> W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1699-1700, 1703-1705, 1758-1759; DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2022, f. 3311-3313; Transkripti, 28 janar 2022, f. 3359-3361.

<sup>1912</sup> *Shih më lart* para. 519-522 (Pika 6).

asnjë përzgjedhje, pa asnjë dallim sa i takon përmbajtjes së tyre, dhe se bënë përpjekje për ta shpërndarë materialin sa më gjerësisht.<sup>1913</sup> Këto veprime u shoqëruan me komente nënçmuese për dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe konfirmime të përsëritura të dëshirës së tyre për të dëmtuar punën e DHS-së/ZPS-së.<sup>1914</sup> Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre veprimeve dhe deklaratave, rreziku i shkaktuar nga sjellja e të akuzuarve nuk mund të konsiderohet i parëndësishëm.

926. Për këto arsye, Trupi Gjykses gjykon se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet në bazë të argumentit mbrojtës të veprës me rëndësi të vogël brenda kuptimit të nenit 11 të KPK-së.

## I. PËRFUNDIM

927. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e asnjë prej argumenteve mbrojtëse të ngritura.

## IX. STATUSI I INFORMACIONIT TË PAKETAVE

928. Trupi Gjykses është shprehur më herët gjatë gjykimit se materiali që pretendohet se zbuluan të akuzuarit përmbante emrat dhe të dhënat e personave të ndryshëm që kishin lidhje me hetimet e kryera nga TFHS-së ose ZPS-ja.<sup>1915</sup> Trupi Gjykses urdhëroi që, derisa të përcaktonte nëse materiali ishte apo nuk ishte konfidencial, palët të mos bënin asnjë përmendje publike të informacionit në fjalë.<sup>1916</sup> Trupi Gjykses e përsëriti këtë urdhër edhe më vonë gjatë gjykimit.<sup>1917</sup>

---

<sup>1913</sup> *Shih më lart* para. 480-485, 498 (Pika 5), 561-564 (Pika 3).

<sup>1914</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3), 662-669 (Pika 1).

<sup>1915</sup> Transkripti, 7 tetor 2021, f. 781.

<sup>1916</sup> Transkripti, 7 tetor 2021, f. 781.

<sup>1917</sup> Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2146-2147 (Urdhër Gojor lidhur me Përdorimin e Emrave të Përmendur në Paketat).

929. Pas ka përcaktuar se çfarë përfshihet në informacionin e mbrojtur në kuadër të këtij Aktgjykimi, Trupi Gjykses konstaton se urdhrat e tij të mëparshëm në lidhje me klasifikimin e parashtrimeve të protokolluara dhe provave materiale mbeten në fuqi. Sa u takon versionit konfidencial të transkripteve dhe incizimeve zanore e filmike të seancave gjyqësore, Trupi Gjykses ka shqyrtuar parashtrimet e palëve në lidhje me to,<sup>1918</sup> dhe ka marrë parasysh konstatimet e bëra në këtë Aktgjykim, konfidencialitetin e emrave të punonjësve të ZPS si dhe informacionin lidhur me praktikën e brendshme të ZPS-së. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses urdhëron riklasifikimin e pjesëshëm të transkripteve konfidenciale të seancave dhe të incizimeve zanore e filmike përkatëse si publike, sikurse përcaktohet në Shtojcën 3 të këtij Aktgjykimi.

## X. DËNIMI

930. Pasi ka konstatuar se z. Gucati dhe z. Haradinaj janë fajtorë për Pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6 në Aktakuzë, tani Trupi Gjykses do të përcaktojë dënimin e duhur për secilin prej tyre.

### A. PARASHTRIMET E PALËVE

931. ZPS-ja parashtrroi se veprat penale të kryera prej të akuzuarve ishin padyshim të rënda pasi sjellja e tyre përbënte një sfidë të drejtpërdrejtë ndaj integritetit të proceseve gjyqësore të DHS-së.<sup>1919</sup> Sipas ZPS-së, pesha e veprave penale nuk kishte të bënte vetëm me elementin objektiv të veprës penale, por edhe me rrethanat konkrete të kësaj çështjeje gjyqësore, formën dhe shkallën e pjesëmarrjes së të akuzuarve në veprat penale, si dhe pasojat e veprimeve të të akuzuarve.<sup>1920</sup> Në lidhje me këtë, ZPS-ja

---

<sup>1918</sup> F587; F588; F589.

<sup>1919</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 341.

<sup>1920</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 343.

parashtron se pjesëmarrja e të akuzuarve në kryerjen e veprave penale ishte e drejtpërdrejtë, sistematike, e vazhdueshme, e qëllimshme dhe entuziaste.<sup>1921</sup> Sipas ZPS-së, fakti që të akuzuarit penguan punën e një institucioni të tërë gjyqësor, marrë së bashku me periudhën, llojin dhe sasinë e informacionit që ata e bënë publik, e bënë veçanërisht të rëndë sjelljen e të akuzuarve.<sup>1922</sup> Për më tepër, ZPS-ja argumenton se krimet e të akuzuarve shkaktuan pasoja të gjera për dëshmitarët.<sup>1923</sup>

932. Sa u takon rrethanave rënduese, ZPS-ja parashtron se të akuzuarit shpërdoruan kompetencat ose detyrën zyrtare për të kryer krimet (rregulla 163(1)(b)(ii) e Rregullores),<sup>1924</sup> kryen apo morën pjesë në kryerjen e krimeve me disa viktime veçanërisht të cenueshme apo të pambrojtura (rregulla 163(1)(b)(iii)-(iv) e Rregullores),<sup>1925</sup> dhe shprehën qartë synimin e tyre për kryerjen e krimeve të tjera të ngjashme.<sup>1926</sup> Sa u takon rrethanave lehtësuese, ZPS-ja parashtrroi se nuk ka asnjë faktor zbutës për dënimin që do t'u shqiptohet të akuzuarve.<sup>1927</sup>

933. ZPS-ja parashtron se arsyet konkrete dhe të përgjithshme lidhur me rëndësinë e parandalimit, përligjin dënimin me burgim të dy të akuzuarve.<sup>1928</sup> Për rrjedhojë, ZPS-ja kërkon për secilin nga akuzuarit dënim të njësuar me gjashtë vjet burgim dhe gjobë prej 100 eurosh.<sup>1929</sup>

---

<sup>1921</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 344-353. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3784.

<sup>1922</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 354-365. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3773-3774, 3790-3791, 3796-3798.

<sup>1923</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 366-370. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3777-3780, 3784-3790.

<sup>1924</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 372-376.

<sup>1925</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 377-383.

<sup>1926</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 384-395. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3775-3777, 3791-3793.

<sup>1927</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 397-405. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3775, 3794-3796, 3798-3804.

<sup>1928</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 406-422. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3772-3773, 3780-3781, 3798-3804.

<sup>1929</sup> F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 426. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3781-3783, 3843-3845.

934. Mbrojtja e Gucatit pretendon se i akuzuari nuk kishte asnjë lidhje me rrjedhjen fillestare të dokumentacionit prej ZPS-së.<sup>1930</sup> Sipas Mbrojtjes së Gucatit, dokumentacioni përkatës iu vu në dispozicion vetëm shtypit profesionist dhe tri konferencat për shtyp u transmetuan vetëm nga mediat profesioniste.<sup>1931</sup> Për më tepër, Mbrojtja e Gucatit parashtron se emrat e përmendur në tri konferencat për shtyp ishin të paktë, nuk u përdor asnjë formë dhune apo kërcënimi si dhe nuk u konstatuan pasoja negative për ndonjë hetim a ndjekje penale konkrete.<sup>1932</sup>

935. Mbrojtja e Gucatit argumenton se, vetëm aspektet që vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm mund të përbëjnë rrethana rënduese, dhe se i njëjti aspekt nuk duhet vlerësuar një herë si element përbërës i veprës penale dhe një herë tjetër si rrethanë rënduese.<sup>1933</sup> Mbrojtja e Gucatit shton se z. Gucati është me karakter të mirë, nuk ka dënime të mëparshme, është njeri familjar dhe ka lidhje të forta me komunitetin.<sup>1934</sup> Mbrojtja e Gucatit argumenton se, gjithashtu, duhet mbajtur parasysh edhe fakti që z. Gucati ka probleme shëndetësore si dhe kushtet e parburgimit në kontekstin e pandemisë mbarëbotërore.<sup>1935</sup>

936. Mbrojtja e Gucatit tërhoqi vëmendjen e Trupit Gjykses lidhur me faktin se veprat penale sipas neneve 387, 392(1), 401(2) dhe 388(1) të KPK-së janë të ndëshkueshme me gjobë dhe se Trupi Gjykses mund të shqiptojë dënim me kusht në pajtim me nenet 48 dhe 49 të KPK-së.<sup>1936</sup>

---

<sup>1930</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 163(c).

<sup>1931</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 163(d)-(e).

<sup>1932</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 163(f)-(h).

<sup>1933</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 163(a)-(b).

<sup>1934</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 157.

<sup>1935</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 158-159.

<sup>1936</sup> F567 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Gucatit, para. 153, 165. *Shih gjithashtu* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3809-3822, 3824-3825, 3829-3830.

937. Mbrojtja e Haradinajt parashtroi se z. Haradinaj kishte qenë plotësisht bashkëpunues dhe transparent.<sup>1937</sup> Gjithashtu, Mbrojtja paralajmëroi Trupin Gjykses lidhur me dënimin e dyfishtë, domethënë kur dy vepra penale të ndryshme burojnë nga të njëjtat fakte,<sup>1938</sup> dhe i kërkoi të mbante parasysh se dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprave penale dhe se z. Haradinaj veprroi në interes të publikut.<sup>1939</sup> Mbrojtja e Haradinajt vuri në dukje se: (i) z. Haradinaj nuk ishte përfshirë në marrjen e dokumenteve nga zyrat e ZPS-së; (ii) dokumentet nuk u publikuan nga i akuzuari, por vetëm iu shpërndanë gazetarëve profesionistë; (iii) nuk u ushtrua dhunë dhe nuk u bë asnjë kërcënim për dhunë; dhe (iv) nuk ka asnjë provë që vërteton se u ushtrua dhunë fizike mbi ndonjë person apo se u komprometua ndonjë hetim a ndjekje penale si rezultat i sjelljes së të akuzuarit.<sup>1940</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e Haradinajt tërhoqi vëmendjen e Trupit Gjykses për praktikën e shqiptimit të dënimeve në tribunalët penalë ndërkombëtarë në çështjet gjyqësore për mosbindje ndaj gjykatës.<sup>1941</sup> Së fundi, Mbrojtja e Haradinajt shton se rrethanat personale të familjes së z. Haradinajt përlligjin zbutjen e dënimit.<sup>1942</sup>

## B. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

### 1. Qëllimi i dënimit

938. Qëllimet e dënimit janë, ndër të tjera, parandalimi (i veçantë dhe i përgjithshëm), ndëshkimi dhe rehabilitimi.<sup>1943</sup> Qëllimi i parandalimit të veçantë është dhënia e një dënimi që shkurajon përsëritjen e krimit nga personi i dënuar pasi të ketë kryer

---

<sup>1937</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3833-3835.

<sup>1938</sup> F570, para. 9

<sup>1939</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3835-3839; F570, para. 13.

<sup>1940</sup> F570, para. 11-12.

<sup>1941</sup> F570, para. 31-61.

<sup>1942</sup> Transkripti, 17 mars 2022, f. 3839-3842.

<sup>1943</sup> Neni 38 i KPK-së. *Shih gjithashtu* TPNJ, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 802.

dënimin dhe të jetë liruar.<sup>1944</sup> Parandalimi i përgjithshëm synon të shkurajojë kryes të tjerë të mundshëm nga kryerja e krimeve të njëjta apo të ngjashme.<sup>1945</sup> Ndëshkimi nuk duhet parë si një mënyrë hakmarrjeje apo shpagimi, por si përcaktim objektiv, i arsyeshëm dhe i matur i dënimit të duhur që pasqyron fajësinë e një personi.<sup>1946</sup> Dënimi proporcional me peshën e sjelljes kriminale përmban pashmangshmërisht në vetvete edhe ndëshkimin dhe parandalimin e duhur.<sup>1947</sup> Rehabilitimi ka për qëllim riintegrimin në shoqëri të personit të dënuar pas lirimit.<sup>1948</sup>

939. Trupi Gjykses është në dijeni se gjykatat dhe tribunalët penalë ndërkombëtarë e të ndërkombëtarizuar vazhdimisht kanë konstatuar se rehabilitimi luan rol të kufizuar duke pasur parasysh peshën e brendaqenësishme të krimeve ndërkombëtare.<sup>1949</sup> Megjithatë, Aktakuza i ngarkon të akuzuarit me kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin e Kosovës dhe, për rrjedhojë, Trupi Gjykses vlerëson se të gjitha qëllimet e lartpërmendura, ndër të cilat edhe rehabilitimi, janë faktorë që kanë lidhje me dënimin. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh se qëllimi parësor i përcaktimit të dënimit është të sigurojë që dënimi përfundimtar të pasqyrojë tërësinë e sjelljes kriminale dhe tërësinë e fajësisë së personit të shpallur fajtor.<sup>1950</sup>

---

<sup>1944</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 805; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 1076-1078.

<sup>1945</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 805; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 1076-1078.

<sup>1946</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 1075.

<sup>1947</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 777.

<sup>1948</sup> Neni 10(3) i KNDCP-së. *Shih p.sh.* ECtHR, [Vinter and Others GC Judgment](#), para. 111-114; [Murray GC Judgment](#), para. 101. *Shih gjithashtu* Rregullat 6, 102.1 dhe 103.8 të Rregullores Evropiane të Burgimit.

<sup>1949</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stakić Appeal Judgment](#), para. 402; [Kordić and Čerkez Appeal Judgment](#), para. 1079; [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 806; [Popović et al. Trial Judgment](#), para. 2130.

<sup>1950</sup> *Shih p.sh.* IRMCT, [Stanišić and Simatović Trial Judgment](#), para. 611; [Mladić Appeal Judgment](#), para. 545; ICTY, [Martić Appeal Judgment](#), para. 350; [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 430.

940. Në përcaktimin e dënimit të duhur për veprat penale kundër administrimit të drejtësisë,<sup>1951</sup> Trupi Gjykses mban parasysht nevojën për të parandaluar përsëritjen e veprave penale dhe nga i akuzuari dhe i sjelljeve të ngjashme nga persona të tjerë.<sup>1952</sup>

## 2. Dënimet për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit

941. Në pajtim me nenin 44(4) të Ligjit, dënimi i shqiptuar për krimet e parapara në nenin 15(2) të Ligjit duhet të jetë në përputhje me dënimet e përcaktuara për ato vepra penale në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012.<sup>1953</sup> Sipas interpretimit të Trupit Gjykses, kjo dispozitë kërkon nga Trupi Gjykses që të shqiptojë dënimet e parapara për veprat penale në dispozitat e zbatueshme të Kodit Penal të Kosovës.

942. Bazuar në nenin 3(2)(b)-(c) dhe (4) të Ligjit, në përcaktimin e dënimit, Trupi Gjykses zbaton sistemin e paraparë në nenet 44(4)-(5) të Ligjit dhe rregullat 163 dhe 165 të Rregullores. Megjithatë, Trupi Gjykses mbështetet edhe në dispozita të tjera përkatëse të legjislacionit të Kosovës si dhe në jurisprudencën e gjykatave/tribunalëve ndërkombëtarë, siç përshkruhet më poshtë.

## 3. Përcaktimi dhe drejtpeshimi i faktorëve përkatës

(a) Faktorët e përmendur në Ligj dhe Rregullore

943. Neni 44(5) i Ligjit parasheh që DHS-ja duhet të marrë parasysht faktorët rëndues dhe lehtësues, peshën e veprës penale dhe pasojat e saj si dhe rrethanat individuale të personit të shpallur fajtor. Rregulla 163(1) e Rregullores përcakton që Trupi Gjykses drejtpeshon faktorët rëndues dhe lehtësues.

---

<sup>1951</sup> Trupi Gjykses e interpreton nocionin “vepra penale kundër administrimit të drejtësisë” se përfshin edhe veprat penale kundër rendit publik (si ato në Pikat 1 dhe 2) kur u referohen procedurave gjyqësore.

<sup>1952</sup> *Shih p.sh.* IRMCT, [Nzabonimpa et al. Trial Judgment](#), para. 397; TPNJ, [Šešelj Trial Judgment](#), para. 77.

<sup>1953</sup> Trupi Gjykses vë në dukje se dënimet e përcaktuara për veprat penale në nenet 387, 392(1)-(3) dhe 401(1)-(3) dhe (5) të KPK-së janë të njëjta me ato në dispozitat përkuese të KPK-së të vitit 2012. *Shih gjithashtu* poshtëshënimin 122 (Dispozitat ligjore përkatëse).



944. Në pajtim me rregullën 163(1)(a) të Rregullores, ndër rrethanat lehtësuese mund të përfshihen: (i) rrethana që nuk janë të mjaftueshme si arsye për përjashtimin e përgjegjësive penale; dhe (ii) veprimet e personit të shpallur fajtor pas kryerjes së veprës penale, përfshirë çfarëdo përpjekje të personit për të zhdëmtuar viktimat, dorëzimin vullnetar dhe bashkëpunimin me Prokurorin e Specializuar dhe Dhomat e Specializuara. Rrethanat rënduese të renditura në rregullën 163(1)(b) të Rregullores janë: (i) çfarëdo fajësie penale përkatëse e mëhershme për vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara ose të ngjashme; (ii) shpërdorimi i kompetencave apo i detyrës zyrtare; (iii) kryerja ose pjesëmarrja në kryerjen e veprës penale ku viktimat është veçanërisht e cenueshme ose e pambrojtur; dhe (iv) kryerja ose pjesëmarrja në kryerjen e veprës penale në një mënyrë veçanërisht mizore, ose kur ka pasur disa viktimat. Lista e rrethanave lehtësuese dhe rënduese nuk është shteruese.

945. Rregulla 163(2) e Rregullores autorizon ulje të dënimit nëse bëhet pranim i fajësisë. Rregulla 163(3) e Rregullores parashtron që në përcaktimin e dënimit të një personi të shpallur fajtor merret parasysh dosja penale e paraqitur prej Prokurorit të Specializuar.

#### (b) Faktorët e përmendur në KPK

946. Në përcaktimin e faktorëve përkatës rëndues dhe lehtësues, Trupi Gjykses, gjatë ushtrimit të kompetencës së vet diskrecionale, orientohet prej nenit 70 të KPK-së. Kjo dispozitë përmend rrethanat rënduese si: shkalla e lartë e synimit kriminal dhe/ose e pjesëmarrjes në veprën penale së personit të shpallur fajtor; numri i viktimave; shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i shpallur fajtor; shpërdorimi i kompetencave ose detyrës zyrtare në kryerjen e veprës penale; dhe dënime penale të mëparshme të personit të shpallur fajtor.<sup>1954</sup>

---

<sup>1954</sup> *Shih* nenin 70(2) të KPK-së.

947. Sa u përket rrethanave lehtësuese, neni 70 i KPK-së përmend, ndër të tjera, rrethanat që nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për përjashtimin e përgjegjesisë penale; rrethanat personale dhe karakterin e personit të shpallur fajtor; moshën e personit; bashkëpunimin e personit me gjykatën; si dhe pendesën e shfaqur nga personi i shpallur fajtor.<sup>1955</sup>

(c) Faktorët e përmendur në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare

948. Gjatë ushtrimit të kompetencës së vet diskrecionale, Trupi Gjykses orientohet edhe nga jurisprudenca e gjykatave/tribunalëve ndërkombëtare apo të ndërkombëtarizuara,<sup>1956</sup> ku përmenden faktorë të mundshëm rëndues si: shpërdorimi i pozitës eprore nga i akuzuari;<sup>1957</sup> zelli me të cilin është kryer krimi;<sup>1958</sup> numri i viktimave dhe pasojat e krimit tek ta;<sup>1959</sup> karakteri i personit të dënuar;<sup>1960</sup> rrethanat e veprës penale në përgjithësi;<sup>1961</sup> dhe mbizotërimi i qëndrimeve publike negative si rezultat i veprimtarisë së të akuzuarve.<sup>1962</sup>

<sup>1955</sup> *Shih* nenin 70(3) të KPK-së.

<sup>1956</sup> Trupi Gjykses vëren se të gjitha palët pajtohen se praktika e këtyre juridiksioneve mund të shërbejë si udhëzues jodetyrues për identifikimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues. *Shih* Transkripti, 17 mars 2022, f. 3806, 3816-3819, 3822-3823, 3833.

<sup>1957</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 896, i referohet [Blagojević and Jokić Appeal Judgment](#), para. 324; [Galić Appeal Judgment](#), para. 412; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 686. *Shih gjithashtu* ICTY, [Jokić Sentencing Judgment](#), para. 61-62; [Stakić Appeal Judgment](#), para. 411; [Babić Sentencing Appeal Judgment](#), para. 80-81.

<sup>1958</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 896, i referohet ICTR, [Simba Appeal Judgment](#), para. 320; ICTY, [Kvočka et al. Trial Judgment](#), para. 705.

<sup>1959</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 896, i referohet [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 686. *Shih gjithashtu* ICTY, [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 864, 866; [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 355; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 181, 198; [Akhbar Beirut S.A.L. and Al Amin Sentencing Judgment](#), para. 19; ICC, [Ntaganda Sentencing Judgment](#), para. 121.

<sup>1960</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 896, i referohet [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 686. *Shih gjithashtu* ICTY, [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 788.

<sup>1961</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 896, i referohet [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 686.

<sup>1962</sup> *Shih p.sh.* STL, [Akhbar Beirut S.A.L. and Al Amin Sentencing Judgment](#), para. 19.

949. Sa u përket faktorëve lehtësues, jurisprudenca ndërkombëtare përfshin, ndër të tjera,: bashkëpunimin me prokurorinë;<sup>1963</sup> shprehjen e pendesës;<sup>1964</sup> dorëzimin vullnetar;<sup>1965</sup> karakterin e mirë dhe mungesën e dënimeve penale të mëparshme;<sup>1966</sup> sjelljen gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim;<sup>1967</sup> rrethanat personale dhe familjare;<sup>1968</sup> dhe problemet shëndetësore.<sup>1969</sup>

(d) Drejtpeshimi i faktorëve përkatës

950. Sipas pikëpamjes së Trupit Gjykses, faktorët që lidhen me përcaktimin e dënimit duhen trajtuar në tri kategori: (i) pesha e veprave penale; (ii) lloji dhe shkalla e përfshirjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale; dhe (iii) rrethanat individuale të të akuzuarve.

951. *Pesha e veprave penale*. Kategoria e parë lidhet me llojin dhe rrethanat e veprave penale. Ky faktor duhet vlerësuar gjithmonë në raport me rrethanat individuale të secilës çështje.<sup>1970</sup> Trupi Gjykses vëren se veprat penale kundër administrimit të

<sup>1963</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet rregullës 101(B)(ii) të Rregullores së ICTY-së; [Blagojević and Jokić Appeal Judgment](#), para. 344; [Vasiljević Appeal Judgment](#), para. 180; [Jokić Sentencing Judgment](#), para. 95-96; STL, [Al Khayat Sentencing Judgment](#), para. 18.

<sup>1964</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Strugar Appeal Judgment](#), para. 365; [Jokić Sentencing Judgment](#), para. 89; [Kunarac et al. Trial Judgment](#), para. 869; ICTY, [Erdemović Sentencing Judgment](#), para. 16(iii); STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 200.

<sup>1965</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Jokić Sentencing Judgment](#), para. 73; [Plavšić Sentencing Judgment](#), para. 84; [Kupreškić et al. Appeal Judgment](#), para. 430; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 200.

<sup>1966</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Kupreškić et al. Appeal Judgment](#), para. 459; [Erdemović Sentencing Judgment](#), para. 16(i); STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 200; [Al Khayat Sentencing Judgment](#), para. 19.

<sup>1967</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Jokić Sentencing Judgment](#), para. 100; [Nikolić Sentencing Judgment](#), para. 268; ICC, [Bemba Sentencing Judgment](#), para. 81; [Ntaganda Sentencing Judgment](#), para. 22.

<sup>1968</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Kunarac et al. Appeal Judgment](#), para. 362, 408. *Shih gjithashtu* ICTY, [Simić et al. Trial Judgment](#), para. 1088; [Erdemović Sentencing Judgment](#), para. 16(i); ICC, [Ongwen Sentencing Judgment](#), para. 87.

<sup>1969</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 897, i referohet [Babić Sentencing Appeal Judgment](#), para. 43; [Blaškić Appeal Judgment](#), para. 696.

<sup>1970</sup> *Shih p.sh.* ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 23; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 169.

drejtësisë përbëjnë cenim të rëndë të sigurisë dhe integritetit të proceseve gjyqësore.<sup>1971</sup> Këto vepra penale mund të dëmtojnë zbulimin e të vërtetës dhe të pengojnë drejtësinë për viktimat<sup>1972</sup> dhe për shoqërinë në përgjithësi. Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të peshës së veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, Trupi Gjykses shqyrton llojin dhe kuadrin e veprave penale dhe çdo rrethanë tjetër përkatëse lidhur me çështjen. Faktorët që duhen mbajtur parasysh në vlerësimin e këtyre veprave penale, përfshijnë: (i) shkallën e ndërhyrjes në sigurinë dhe/ose integritetin e proceseve të DHS-së, në veçanti përsëritjen e veprimeve dhe numrin e dëshmitarëve të përfshirë;<sup>1973</sup> (ii) ndikimin e veprave penale në besimin e publikut lidhur me efektshmërinë e urdhrave dhe vendimeve të DHS-së, ndër të tjera edhe të atyre lidhur me masat mbrojtëse;<sup>1974</sup> (iii) ndikimin e veprave penale në bashkëpunimin e DHS-së/ZPS-së me shtete të treta ose organizata ndërkombëtare;<sup>1975</sup> (iv) pasojat e mundshme dhe të vërtetuara personale dhe psikologjike tek personat e ndikuar nga veprat penale;<sup>1976</sup> (v) numrin dhe cënueshmërinë e personave të ndikuar nga veprat penale;<sup>1977</sup> dhe (vi) mënyrat dhe mjetet me të cilat u krye sjellja penale.<sup>1978</sup>

952. *Përfshirja e të akuzuarve.* Kategoria e dytë ka të bëjë me llojin dhe shkallën e përfshirjes së të akuzuarve në veprat penale si dhe rrethanat rënduese apo lehtësuese të sjelljes së tyre.

953. *Rrethanat individuale të të akuzuarve.* Kategoria e tretë lidhet me situatën personale të të akuzuarve, si për shembull mosha, gjendja shëndetësore, arsimi apo karakteri,

---

<sup>1971</sup> Shih p.sh. IRMCT, [Nzabonimpa et al. Trial Judgment](#), para. 397.

<sup>1972</sup> Shih p.sh. ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 46.

<sup>1973</sup> Shih p.sh. IRMCT, [Nzabonimpa et al. Trial Judgment](#), para. 398.

<sup>1974</sup> Shih p.sh. ICTY, [Šešelj Trial Judgment](#), para. 80; [Margetić Trial Judgment](#), para. 87; [Hartmann Trial Judgment](#), para. 80; [Marijačić and Rebić Trial Judgment](#), para. 49; ICTR, [Nshogoza Trial Judgment](#), para. 219.

<sup>1975</sup> Shih p.sh. ICTY, [Hartmann Trial Judgment](#), para. 80.

<sup>1976</sup> Shih p.sh. ICTY, [Margetić Trial Judgment](#), para. 86.

<sup>1977</sup> Shih p.sh. ICTY, [Margetić Trial Judgment](#), para. 86.

<sup>1978</sup> Shih p.sh. ICTY, [Šešelj Trial Judgment](#), para. 78; [Haxhiu Trial Judgment](#), para. 34.

dhe rrethanat rënduese apo lehtësuese që rrjedhin prej tyre. Trupi Gjykses do të trajtojë më poshtë këta faktorë për secilin të akuzuar.

954. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se një element i veprës penale apo i formës së përgjegjësive penale, nuk mund të konsiderohet njëkohësisht edhe rrethanë rënduese për të njëjtën vepër penale.<sup>1979</sup> Në mënyrë të ngjashme, faktorët që merren parasysh si elemente të peshës së krimit nuk mund të merren parasysh edhe si rrethana rënduese më vete dhe anasjellas.<sup>1980</sup>

955. Rrethanat rënduese duhet të vërtetohen përtej dyshimit të arsyeshëm.<sup>1981</sup> Rrethanat lehtësuese duhen të vërtetohen në bazë të tërësisë së gjasave.<sup>1982</sup>

#### 4. Përcaktimi i dënimit të duhur

956. Në pajtim me rregullën 163(4) të Rregullores, Trupi Gjykses përcakton dënimin në lidhje me çdo akuzë të Aktakuzës për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe jep një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit. Dënimi i njësuar nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë. Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të konsiderueshme në përcaktimin e dënimit të duhur.<sup>1983</sup> Sidoqoftë, Trupi Gjykses duhet ta përshtasë dënimin në një mënyrë të tillë që të pasqyrojë peshën e krimeve, llojin dhe shkallën e

---

<sup>1979</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 894; ICC, [Ntaganda Sentencing Judgment](#), para. 20; [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 25; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 181.

<sup>1980</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Stanišić and Župljanin Trial Judgment](#), para. 894; ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 23; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 181.

<sup>1981</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 763; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 181.

<sup>1982</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Bralo Sentencing Appeal Judgment](#), para. 8; ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 24; STL, [Ayyash Sentencing Judgment](#), para. 200.

<sup>1983</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Krajišnik Appeal Judgment](#), para. 734; ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 36; [Lubanga Sentencing Appeal Judgment](#), para. 1, 34, 40.

përfshirjes së të akuzuarve në kryerjen e veprave penale si dhe rrethanat individuale të secilit prej të akuzuarve.<sup>1984</sup>

957. Gjatë përcaktimit të dënimit të duhur, Trupi Gjykes mund – por nuk është i detyruar – të marrë parasysh praktikat shtetërore dhe ndërkombëtare të dënimit. Megjithatë, për shkak se përcaktimi i dënimit të duhur varet shumë nga rrethanat individuale të secilës çështje konkrete, është e vështirë që nga dënimi i dhënë në një çështje gjyqësore të deduktohet dënimi i duhur në një çështje tjetër.<sup>1985</sup>

958. Në pajtim me rregullën 163(6) të Rregullores, në përcaktimin e dënimit me burgim, Trupi Gjykes zbret kohën që i akuzuari është mbajtur në paraburgim para ose gjatë gjykimit, në rast se është mbajtur.

959. Trupi Gjykes vëren se Ligji dhe Rregullorja nuk përmbajnë dispozita për dënime alternative, ndër të cilat mundësinë e dënimit me kusht. Neni 46 i KPK-së i parasheh dënimet alternative ndërsa nenet 47-49 të KPK-së trajtojnë kushtet për dhënien e dënimit me kusht. Trupi Gjykes vëren se, në bazë të nenit 3(4) të Ligjit, këto dispozita nuk janë detyruese për të. Megjithatë, Trupi Gjykes vlerëson se, në pajtim me standardet bazë të të drejtave të njeriut të zbatueshme në çdo juridiksion shtetëror, dënimet alternative duhen marrë parasysh në përcaktimin e dënimit të duhur. Për më tepër, Trupi Gjykes vëren TPNJ-ja, me gjithë mungesën e dispozitave të tilla, ka shqiptuar dënime me kusht në disa raste.<sup>1986</sup> Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykes do të vlerësojë nëse mund të jepen dënime me kusht, në kuadër të kompetencës së vet diskrecionale.

---

<sup>1984</sup> *Shih p.sh.* IRMCT, [Stanišić and Simatović Trial Judgment](#), para. 611.

<sup>1985</sup> *Shih p.sh.* ICC, [Bemba et al. Sentencing Judgment](#), para. 38; [Lubanga Sentencing Appeal Judgment](#), para. 77.

<sup>1986</sup> *Shih p.sh.* ICTY, [Bulatović Trial Decision](#), para. 18-19; [Rašić Appeal Judgment](#), para. 17. *Shih gjithashtu* SCSL, [Bangura et al. Sentencing Judgment](#), para. 92, 101.

## C. KONSTATIMET E TRUPIT GJYKUES

960. Trupi Gjykses i shpalli fajtorë z. Gucati dhe z. Haradinaj për bashkëkryerjen e këtyre veprave penale: (i) shkelje e fshehtësisë së procedurës (Pikat 5 dhe 6), me synim të drejtpërdrejtë; (ii) frikësim gjatë procedurës penale (Pika 3), me synim të drejtpërdrejtë; dhe (iii) pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pikat 1 dhe 2) me synim të drejtpërdrejtë.<sup>1987</sup>

961. Për përcaktimin e dënimeve të duhura në këtë çështje, Trupi Gjykses shqyrtoi provat në dokumentacionin e çështjes gjyqësore dhe parashtrimet e palëve. Trupi Gjykses shqyrtoi të gjithë faktorët përkatës dhe e përshtati secilin dënim për të pasqyruar peshën e veprave penale të paraqitura në Aktakuzë, llojin dhe shkallën e përfshirjes së secilit prej të akuzuarve, si dhe rrethanat individuale të secilit prej të akuzuarve, duke shmangur llogaritjen e dyfishtë të elementeve të veprave penale ose të formave të përgjegjësisë penale.

### 1. Z. Gucati

#### (a) Pësha e veprave penale

962. Për të vlerësuar peshën e veprave penale për të cilat z. Gucati është shpallur fajtor, Trupi Gjykses shqyrton llojin dhe kuadrin e veprave penale dhe të rrethanave të tjera që lidhen me çështjen.

963. Veprat penale për të cilat është shpallur fajtor z. Gucati janë të rënda për arsyet që shtjellohen në vijim.

964. Së pari, veprat penale lidhen me zbulimin e qindrave dokumenteve që përmbanin informacion të mbrojtur, si kërkesa të THFS-së, përgjigje të PSKL-së, produktit të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe emrat e qindra dëshmitarëve dhe

---

<sup>1987</sup> *Shih më lart* para. 501 (Pika 5), 552 (Pika 6), 606 (Pika 3), 672 (Pika 1), 710 (Pika 2).

dëshmitarëve të mundshëm.<sup>1988</sup> Zbulimi i kësaj sasive të madhe informacioni u bë pa dallim, pa marrë kurrfarë mase paraprake të efektshme,<sup>1989</sup> si për shembull redaktimi i emrave ose përzgjedhja e informacionit që do të zbulohet, si dhe me një shpërfillje të plotë për pasojat që mund të kishin këto veprime.

965. Së dyti, zbulimi i informacionit, të cilin z. Gucati e kreu bashkërisht me z. Haradinaj, u ndërmor në emër të OVL-UÇK-së,<sup>1990</sup> dhe u miratua publikisht më së paku nga një anëtar tjetër i organizatës.<sup>1991</sup> Zbulimi i informacionit të mbrojtur dhe i të dhënave të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm në platformën e OVL-UÇK-së nga ai dhe nga z. Haradinaj në cilësinë e udhëheqësve të OVL-UÇK-së, krijoi përshtypjen se ky informacion po zbulohet në emër dhe për mbrojtjen e mijëra anëtarëve të organizatës, disa prej të cilëve mund të ndiqeshin penalisht brenda këtij juridiksioni. Gjithashtu, Trupi Gjykues merr parasysh se z. Gucati e konsideroi zbulimin e informacionit të mbrojtur si detyrën e tij.<sup>1992</sup>

966. Së treti, zbulimi i informacionit, të cilin z. Gucati e kreu bashkërisht me të tjerë, u bë në mënyrë flagrante në shkallë të gjerë, jo vetëm sa i përket sasisë së informacionit të zbuluar, por edhe sa i përket: (i) numrit të personave të ndikuar; dhe (ii) numrit të personave të cilëve iu treguan dokumentet. Sikurse vërehet më lart, materiali i zbuluar nga të akuzuarit përmbante emrat dhe/ose të dhënat e qindra dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Me ftesën e z. Gucati apo me miratimin e tij, dokumentet e zbuluara u filmuan, fotografuan, shumëfishuan apo u morën nga një numër i panjohur personash të paidentifikuar.<sup>1993</sup> Pasojë përfundimtare e mënyrës se si u shpërndanë këto dokumente është se vendndodhja e materialeve të shpërndara, si dhe numri dhe identiteti i personave që i morën ato, nuk do të dihen asnjëherë. Kjo i bën

---

<sup>1988</sup> *Shih më lart* para. 335-355 (Konstatime mbi paketat).

<sup>1989</sup> *Shih më lart* para. 480-485 (Pika 5), 519-522 (Pika 6).

<sup>1990</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 1; P4, f. 8.

<sup>1991</sup> *Shih më lart* para. 685-690 (Pika 2).

<sup>1992</sup> P9, f. 6.

<sup>1993</sup> *Shih më lart* para. 729 (Format e përgjegjësive penale).



veçanërisht të cenueshëm dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm emrat e të cilëve ishin në informacionin e mbrojtur.

967. Së katërti, veprimet për zbulimin e informacionit të mbrojtur u diskutuan në mënyrë të përsëritur në paraqitjet e tyre televizive apo në mediat në internet dhe në postime në *Facebook*,<sup>1994</sup> ku u bënë komente nënçmuese për dëshmitarët dhe u vu në dyshim aftësia e ZPS-së për të mbrojtur dëshmitarët e saj.<sup>1995</sup> Kjo e shtoi më tej numrin e personave të panjohur që u vunë në dijeni për ekzistencën dhe përmbajtjen e përgjithshme të materialeve. Rrjedhimisht, provat për shpërndarjen e gjerë të këtij informacioni përmes platformave televizive ose në internet rrëzojnë argumentin e të akuzuarit se informacioni iu zbulua vetëm gazetarëve dhe mediave profesionale.

968. Zbulimi i informacionit të mbrojtur, që përfshinte identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, u bë për t'u shkaktuar pasoja negative personave në fjalë. Megjithëse numri nuk mund të përcaktohet me saktësi, sipas të dhënave, dëshmitarët e rrezikuar u ndikuan ndjeshëm dhe ZPS-së iu desh të kontaktonte shumë dëshmitarë të tjerë për të vlerësuar nivelin e rrezikut të shkaktuar.<sup>1996</sup> Provat nuk tregojnë nëse u zbuluan edhe emrat e dëshmitarëve veçanërisht të cenueshëm, si emrat e të miturve, të moshuarve, viktimave të krimeve të caktuara,<sup>1997</sup> të personave me aftësi të kufizuara apo kategorive të tjera të cenueshme<sup>1998</sup>. Sidoqoftë, shkalla e lartë dhe shtrirja e zbulimit të informacionit të mbrojtur mund të shkurajonte angazhimin apo vazhdimin e angazhimit të

---

<sup>1994</sup> P1, P2, P4, P9, P12, P28, P29, P31, P35, P59, P83, f. 44-49.

<sup>1995</sup> *Shih më lart* para. 738-741 (Format e përgjegjesisë penale).

<sup>1996</sup> *Shih më lart* paras 536-541 (Pika 6).

<sup>1997</sup> *Shih* rregullën 2 të Rregullores që përkufizon si viktimë "[një] person fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si rezultat i drejtpërdrejtë i krimit të pretenduar në Aktakuzën e konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake".

<sup>1998</sup> Neni 23(2) i Ligjit; Rregulla 80(4)(c) e Rregullores; 2D13, f. 20. *Shih gjithashtu* [ICC Protocol on Vulnerable Witnesses](#).

dëshmitarëve në hetimet apo proceset gjyqësore të DHS-së/ZPS-së.<sup>1999</sup> Për këto arsye, këto veprime mund të kishin rezultuar në pengimin e DHS-së/ZPS-së për përmbushjen e mandatit të tyre dhe mund t'u kishin mohuar viktimave të krimeve në juridiksionin e DHS-së të drejtën për të mësuar të vërtetën dhe për drejtësi. Këto të drejta janë tepër të rëndësishme për viktimat, ndaj edhe çdo reagim i DHS-së/ZPS-së ndaj tentativave për t'i cenuar ato të drejta duhet të pasqyrojë rëndësinë e tyre. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se veprimet e përshkruara më sipër u kryen në një atmosferë mbizotëruese dhe afatgjatë të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.<sup>2000</sup>

969. Trupi Gjykses i peshon këta faktorë përkitazi me konstatimin e vet se, në fund të fundit, ZPS-ja nuk arriti të vërtetonte që u pengua faktikisht t'i hetonte apo ndiqte penalisht krimet në mënyrë efektive.

(b) Lloji dhe shkalla e pjesëmarrjes së z. Gucati

970. Trupi Gjykses nuk i kushton rëndësi aspektit se z. Gucati nuk mori pjesë në "rrjedhjen fillestare" apo dorëzimin e tri grupeve të dokumenteve. Trupi Gjykses vëren se ky pretendim nuk ka qenë asnjëherë pjesë e akuzave dhe nuk mund të luajë asnjë rol në përcaktimin e dënimit të duhur. Mungesa e veprimeve kriminale të mëtejshme nga personi i shpallur fajtor nuk përbën faktor lehtësues.

971. Trupi Gjykses vëren se pas çdo dorëzimi të dokumenteve z. Gucati përsëriti të njëjtat veprime: ai e këqyri materialin; më pas udhëzoi z. Klinaku, më së paku dy herë, që të organizonte konferencë për shtyp, të cilën e drejtoi ai vetë; prezantoi temën e

---

<sup>1999</sup> *Shih p.sh.* W04841 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1905 (Anëtari i Trupit Gjykses: "Në përvojën tënde si oficer i mbrojtjes së dëshmitarëve, pra, a është ekspozimi i të dhënave personale të një personi një shkak i mundshëm për ta shkurajuar këtë person për të bashkëpunuar me ju ose për të dhënë informacionin e vet për sa i takon hetimeve, ose ndjekjes penale?" z. Jukiq: "Nga përvoja ime mund të them po". Anëtari i Trupit Gjykses: "me aq sa dini ju, a ka ndodhur kjo lidhur me rrjedhjen e informacionit të ndodhur në shtator të 2020-ës?" z. Jukiq: "Po, kjo ka ndodhur gjatë këtij ushtrimi"); DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2021, f. 3306-3308.

<sup>2000</sup> *Shih më lart* para. 576-VI (Pika 3).

konferencës duke dhënë disa hollësi për tri grupet e dokumenteve dhe më pas ia dha fjalën z. Haradinaj; nuk e ndërpreu dhe as nuk ndërhyri për të korrigjuar apo moderuar thëniet e z. Haradinaj; më pas mori pjesë në intervista me median për të njëjtën temë.<sup>2001</sup> Z. Gucati e përsëriti këtë rend veprimesh tri herë, edhe pasi mori dy urdhra nga Gjykatësi i Vetëm dhe një nga ZPS-ja që i kërkonin të ndalonte shpërndarjen e informacionit të marrë.<sup>2002</sup> Trupi Gjykues pranon se gjatë këtyre veprimeve të përsëritura, z. Gucati nuk përmendi në mënyrë publike emrin e asnjë dëshmitari dhe mori pjesë në më pak paraqitje në media se z. Haradinaj. Sidoqoftë, provat tregojnë se, pavarësisht nga urdhrat për t'i ndaluar ato veprime, z. Gucati i përsëriti ato me vendosmëri të konsiderueshme dhe vazhdimisht u betua se do të vijonte të publikonte materialet e marra prej DHS-së/ZPS-së.<sup>2003</sup>

972. Trupi Gjykues konstaton se nuk ka faktorë të tjerë rëndues sa i përket kontributit të z. Gucati në kryerjen e veprave penale. Roli i z. Gucati si udhëheqës i grupit u shqyrtua në kuadër të formës së rëndë të Pikës 2, ndërsa funksioni i tij si udhëheqës i OVL-UÇK-së u trajtua si tregues i peshës së krimeve të tij.

973. Trupi Gjykues vëren se z. Gucati nuk bëri asnjë kërcënim të drejtpërdrejtë me vdekje apo lëndim të rëndë në lidhje me asnjë dëshmitar. Gjithashtu, z. Gucati nuk kërcënoi drejtpërdrejt asnjë zyrtar të ZPS-së dhe ishte bashkëpunues gjatë sekuestrimeve që kreu ZPS-ja. Megjithatë, Trupi Gjykues vëren se z. Gucati e bëri këtë në përputhje me urdhrat e Gjykatësit të Vetëm dhe ZPS-së. Për më tepër, sikurse përmendet më lart, mungesa e veprimeve kriminale të mëtejshme nuk përbën faktor lehtësues.

---

<sup>2001</sup> *Shih më lart* para. 728-733 (Format e përgjegjesisë penale).

<sup>2002</sup> P4, f. 8. *Shih gjithashtu* P52, para. 22(c); P53, para. 22(c); P54, para. 2.

<sup>2003</sup> *Shih më lart* para. 728-731 (Format e përgjegjesisë penale).

## (c) Rrethanat individuale të z. Gucati

974. Z. Gucati është 55 vjeç,<sup>2004</sup> është i martuar dhe ka shtatë fëmijë.<sup>2005</sup>

975. Në përcaktimin e dënimit për z. Gucati, Trupi Gjykses vlerëson si faktorë lehtësues faktin që z. Gucati: (i) ka punuar në shkollë dhe ka kryer veprimtari të gjera vullnetare dhe humanitare për komunitetin e tij,<sup>2006</sup> dhe (ii) vuan nga probleme të rënda shëndetësore.<sup>2007</sup> Trupi Gjykses merr parasysh edhe gjendjen familjare të z. Gucati dhe faktin se dënimin me burg ai do ta kryejë larg familjes e komunitetit të tij, me vështirësitë financiare dhe emocionale që rrjedhin prej kësaj.<sup>2008</sup>

976. Në përcaktimin e dënimit të duhur, Trupi Gjykses merr parasysh se z. Gucati nuk ka dënime të mëparshme dhe për rrjedhojë nuk ka faktorë rëndues në këtë drejtim. Më tej, duke mbajtur parasysh komentet nënçmuese të z. Gucati lidhur me dëshmitarët që bashkëpunonin me TFHS-së/ZPS-në,<sup>2009</sup> Trupi Gjykses nuk mendon se karakteri i mirë apo motivimi i përgjithshëm për të vepruar në interes të publikut dhe për të kërkuar të vërtetën, duhen konsideruar si faktorë lehtësues në rastin e tij. Trupi Gjykses vë në dukje se z. Gucati nuk tregoi pendesë për veprimet e tij dhe u betua në mënyrë të përsëritur se do t'i kryente sërish këto veprime në të ardhmen.<sup>2010</sup> Për këtë

---

<sup>2004</sup> 1D3, para. 1.

<sup>2005</sup> 1D3, para. 1; 1D42, para. 2-3, 7-8; 1D44, para. 2.

<sup>2006</sup> 1D3, para. 11; 1D35, para. 16-18; 1D36, para. 3-4, 8; 1D37, para. 6-8; 1D38, para. 8; 1D39, para. 10; 1D40, para. 3, 5, 7; 1D41, para. 14, 16, 18; 1D43, para. 7-12; 1D44, para. 15.

<sup>2007</sup> 1D3, para. 6-7; 1D35, para. 11; 1D38, para. 8; 1D39, para. 6; 1D41, para. 9-12; 1D42, para. 6-7; 1D44, para. 10-14, 17, 20.

<sup>2008</sup> 1D42, para. 10; 1D44, para. 21-28; 1D46.

<sup>2009</sup> *Shih më lart* para. 569-574 (Pika 3).

<sup>2010</sup> DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2222 (z. Gucati: "Thashë s'jam tuj u frigu prej as punës time ça kam bo. Unë e thashë, çdo dokumentacion që vjen në zyrën time, në dëm të vendit tim, unë do ta bëj publike."); Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2401 (Përfaqësuesi i ZPS-së: "A jeni penduar, keni pendesë për veprimet për të cilat jeni nxjerrë përpara gjyqit?" z. Gucati: "Deri më ditën e sotit, për 54 vite të miat që jam dhe mbi 30 që punoj, nuk e di që jam i penduar në ndonjë punë. Pendohna aty ku gaboj me qëllim. Kërkoj falje. Aty ku unë e di që s'kam bë gabimin, nuk kam nevojë të kërkoj falje se këto dokumentacione unë nuk i kam vjedhë dhe nuk i kam pru në Organizatën e Veteranëve të Luftës. Po t'i kisha vjedhur unë këto dokumentacione, publikisht do të kërkoja falje për hajninë që e kam bë. Unë hajni s'kam bërë dhe unë s'kam fyer asnjë njeri, asnjë dëshmitar, asnjë deklaratë s'e kam lexuar.

arsye, Trupi Gjykues vlerëson se dënimi i z. Gucati nuk duhet të ulet si rrjedhojë e sjelljes së tij pas kryerjes së veprës penale.

977. Ndonëse Trupi Gjykues merr parasysh se pandemia e Kovid-19 çoi në kufizimin e vizitave familjare për z. Gucati, kjo situatë ndikoi edhe në shumë persona të tjerë të mbajtur në burg në mbarë botën dhe për rrjedhojë ka pak peshë në përcaktimin e dënimit të duhur.

978. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se nuk është vërtetuar gabim ligjor,<sup>2011</sup> e për rrjedhojë Trupi Gjykues nuk do shqyrtojë nëse ky gabim ishte i shmangshëm brenda kuptimit të nenit 26(3) të KPK-së, për të përligjur uljen e dënimit.

(d) Përcaktimi i dënimit për z. Gucati

979. Trupi Gjykues merr parasysh dënimet e shqiptuara për personat e shpallur fajtorë për vepra penale të ngjashme në gjykata apo tribunalë ndërkombëtarë.<sup>2012</sup> Megjithatë, siç përmendet dhe në paragrafin 957, është e vështirë që nga dënimi i dhënë në një çështje gjyqësore të deduktohet dënimi i duhur në një çështje tjetër. Veprat penale për të cilat u shpall fajtor z. Gucati lidhen me zbulimin e më së paku njëqind kërkesave të TFHS-së, disa përgjigjeve të PSKL-së, të gjitha të trajtuara si konfidenciale prej ZPS-së, të një produkti tejet të ndjeshëm të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe të emrave të *qindra* dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm.

---

Dhe kështu, nuk kam arsye që të kërkojë falje përderisa unë s'kam vjedhë dhe se s'kam thy kërrkënd shpirtnisht". Përfaqësuesi ZPS-së: "A do ta bënit po të njëjtën?" z. Gucati: "Unë jam deklaruar edhe ma herët dhe ditën e djeshme dhe të pardjeshme jam deklaruar, e nderuara. Unë s'jam gardian i askujt, asnjë institucioni në vendin tim ma së pari, po as në Hagë, këtu në Holandë. Unë ruaj zyrat e mia ku unë punoj unë. Jam gardian i asaj pune ku jam i thirrur. Kështu që unë ju kisha bërë lutje mos na provokoni me dokumentacione"). *Shih gjithashtu* Transkripti, 7 dhjetor 2021, f. 2266.

<sup>2011</sup> *Shih më lart* para. 907 (Argumentet Mbrojtëse).

<sup>2012</sup> *Shih p.sh.* ICTY: [Marijačić and Rebić Trial Judgment](#), para. 53: secili nga të akuzuarit u dënua me gjobë prej 15.000 eurosh; [Jović Trial Judgment](#), para. 27: i akuzuari u dënua me gjobë prej 20.000 eurosh. STL: [Akhtar Beirut S.A.L. and Al Amin Sentencing Judgment](#), f. 8: Akhtar Beirut S.A.L u dënua me gjobë prej 6.000 eurosh dhe z. Al Amin u dënua me 20.000 euro gjobë. [Al Khayat Sentencing Judgment](#): znjsh. Khayat u dënua me 10.000 euro gjobë. IRMCT: [Nzabonimpa et al. Trial Judgment](#), para. 407-408: z. Nzabonimpa, z. Ndagijimana dhe znj. Fatuma u dënuan me të njëjtën periudhë burgimi që kishin kaluar në paraburgim (11 muaj), ndërsa z. Ngirabatware u dënua me dy vjet burgim.

Veprat penale përfshijnë: (i) shpërndarjen në shkallë të gjerë të informacionit që kishte të bënte me një numër të madh dëshmitarësh të mbrojtur; (ii) përmes përdorimit të një platforme organizative dhe një numri paraqitjesh të transmetuara në media; (iii) përmes sjelljes së përsëritur dhe betimeve të vazhdueshme se do t'i kryente përsëri njëjtat vepra penale; (iv) shoqëruar me komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve; dhe (v) me pasojën e mundshme që informacioni i mbrojtur të ishte i disponueshëm për një numër të madh personash dhe për një kohë të gjatë. Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerëson se në përcaktimin e dënimit të z. Gucati duhen marrë parasysh vetëm faktet dhe rrethanat e kësaj çështje gjyqësore dhe të asnjë çështjeje tjetër.

980. Trupi Gjykses vëren se dënimet e përcaktuara në dispozitat përkatëse të KPK-së janë: (i) dënim me gjobë ose burgim deri në një (1) vit (neni 392(1));<sup>2013</sup> (ii) burgim deri në tre (3) vjet (neni 392(2)); (iii) burgim nga gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet (neni 392(3)); (iv) gjobë deri në njëqind e njëzet e pesë mijë (125,000) euro dhe burgim nga dy (2) deri në dhjetë (10) vjet (neni 387); (v) burgim nga tre (3) muaj deri në tre (3) vjet (neni 401(1)); (vi) gjobë ose burgim deri në tre (3) vjet (neni 401(2)); (vii) burgim nga një (1) deri në pesë (5) vjet (neni 401(3)); dhe (viii) burgim nga një (1) deri në pesë (5) vjet (neni 401(5)).

981. Trupi Gjykses; (i) pasi peshoi veç e veç dhe në tërësi të gjithë faktorët e përcaktuar më lart, përfshirë peshën e veprave penale; dhe (ii) pasi mori parasysh qëllimet e dënimit të përmendura më sipër, përcakton dënimet e mëposhtme për z. Gucati, për secilën nga akuzat e paraqitura në Aktakuzë:

- a. Për Pikën 5, një vit burgim;

---

<sup>2013</sup> *Shih nenin 42(1) të KPK-së, sipas të cilit dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet për një kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë. Shih gjithashtu nenin 43(1) të KPK-së, sipas të cilit gjoba nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) euro. Këto dispozita janë të zbatueshme në bazë të nenit 44(4) të Ligjit.*

- b. Për Pikën 6, përfshirë formën e rëndë, dy vjet burgim;
- c. Për Pikën 3, gjobë prej 100 eurosh dhe katër vjet burgim;
- d. Për Pikën 1, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh formën e rëndë, një vit burgim; dhe
- e. Për Pikën 2, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh të dyja format e rënda, një vit burgim.

982. Në lidhje me Pikën 3, Trupi Gjykses kujton se neni 387 i KPK-së parasheh vendosjen e një gjobe. Duke mbajtur parasysh se efekti ndëshkues apo parandalues i gjobës do të ishte i vogël në këtë çështje, Trupi Gjykses është i mendimit se një shumë simbolike prej **100 eurosh** është e përshtatshme.

983. Në lidhje me Pikat 1 dhe 2, Trupi Gjykses ka marrë parasysh faktin se z. Gucati është shpallur fajtor për të dyja pikat dhe se mund të ishte shpallur fajtor vetëm për një nga këto pika sipas një sistemi të ndryshëm për fajësinë e shumëfishtë.<sup>2014</sup>

984. Pasi ka përcaktuar këto dënime, Trupi Gjykses shqipton një dënim të njësuar prej **katër vjetësh e gjysmë (4.5)**, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale dhe të veprave të shumëfishta penale të kryera prej z. Gucati.

985. Në lidhje me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses merr parasysh se z. Gucati u arrestua më 25 shtator 2020 dhe që prej asaj dite ndodhet në paraburgim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i njësuar periudhën që z. Gucati ka kaluar në paraburgim që prej 25 shtatorit 2020.

986. Në lidhje me dënimin me kusht, Trupi Gjykses merr parasysh nenet 47 dhe 49(4) të KPK-së, sipas së cilëve qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra penale të lehta kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme që ta ndalojë kryesin të kryejë vepra penale. Pasi: (i) përcaktoi peshën e veprave penale në këtë çështje; (ii) drejtpeshoi faktorët e lartpërmendur; dhe

---

<sup>2014</sup> *Shih më lart* para. 165-170 (Dispozitat ligjore përkatëse).

(iii) mori parasysh të gjitha qëllimet e dënimit, Trupi Gjykes gjykon se dënimi me kusht në këtë çështje nuk është dënimi i duhur, pasi tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit nuk do të mjaftonte për të parandaluar kryerjen nga z. Gucati të veprave penale të ngjashme me ato për të cilat u shpall fajtor dhe të cilat ai u betua se do t'i përsëriste.

## 2. Z. Haradinaj

### (a) Pesha e veprave penale

987. Për të vlerësuar peshën e veprave penale për të cilat është shpallur fajtor z. Haradinaj, Trupi Gjykes shqyrton llojin dhe kuadrin e veprave penale dhe të rrethanave të tjera që lidhen me çështjen.

988. Veprat penale për të cilat është shpallur fajtor z. Haradinaj janë të rënda për arsyet që shtjellohen në vijim.

989. Së pari, veprat penale lidhen me zbulimin e qindrave dokumenteve që përmbanin informacion të mbrojtur, si kërkesa të THFS-së, përgjigje të PSKL-së, produktit të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe emrat e qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.<sup>2015</sup> Zbulimi i kësaj sasive të madhe informacioni u bë pa dallim, pa marrë kurrfarë mase paraprake të efektshme,<sup>2016</sup> si redaktimi i emrave apo përzgjedhja e informacionit që do të zbulohet.

990. Së dyti, zbulimi i informacionit, të cilin z. Haradinaj e kreu bashkërisht me z. Gucati, u ndërmor në emër të OVL-UÇK-së,<sup>2017</sup> dhe u miratua publikisht më së paku nga një anëtar tjetër i organizatës.<sup>2018</sup> Zbulimi i informacionit konfidencial dhe i të

---

<sup>2015</sup> *Shih më lart* para. 335-355 (Konstatime mbi paketat).

<sup>2016</sup> *Shih më lart* para. 480-485 (Pika 5), 519-522 (Pika 6).

<sup>2017</sup> *Shih p.sh.* P1, f. 1 (z. Haradinaj: "Ne, Organizata e Veteranëve, jemi befasu për mirë"); P15, f. 2 (z. Haradinaj: "Nuk do me thënë që me kon unë, zoti Gucati, z. Faton BINAKU që do bëjmë...edhe anëtari më i mbramë i UÇK-së ka me e kry këtë detyrë"); P35, f. 4 (z. Haradinaj: "ne jemi në cilësinë e veteranëve të luftës dhe Organizata e Veteranëve të Luftës përfaqëson vetëm veteranët e luftës").

<sup>2018</sup> *Shih më lart* para. 685-690 (Pika 2).



dhënave të dëshmitarëve në platformën e OVL-UÇK-së, nga ai dhe nga z. Gucati në cilësinë e udhëheqësve OVL-UÇK-së, krijoi përshtypjen se ky informacion po zbulohet në emër dhe për mbrojtjen e mijëra anëtarëve të organizatës, disa prej të cilëve mund të ndiqeshin penalisht brenda këtij juridiksioni. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se z. Haradinaj e konsideroi zbulimin e informacionit të mbrojtur si detyrën e tij.<sup>2019</sup>

991. Së treti, zbulimi i informacionit, të cilin z. Haradinaj e kreu bashkërisht me të tjerë, u bë në mënyrë flagrante në shkallë të gjerë jo vetëm sa i përket sasisë së informacionit të zbuluar, por edhe sa i përket: (i) numrit të personave të ndikuar; dhe (ii) numrit të personave të cilëve iu treguan dokumentet. Sikurse vërehet më lart, materiali i zbuluar nga të akuzuarit përmbante emrat dhe/ose të dhënat e qindra dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Me ftesë të z. Haradinaj apo me miratimin e tij, dokumentet e zbuluara u filmuan, fotografuan, shumëfishuan apo u morën nga një numër i panjohur personash të pidentifikuar.<sup>2020</sup> Pasojë përfundimtare e mënyrës se si u shpërndanë këto dokumente është se vendndodhja e materialeve të shpërndara, si dhe numri dhe identiteti i personave që i morën ato, nuk do të dihen asnjëherë. Kjo i bën veçanërisht të cenueshëm dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm emrat e të cilëve ishin në informacionin e mbrojtur.

992. Së katërti, veprimet për zbulimin e informacionit të mbrojtur u diskutuan në mënyrë të përsëritur në paraqitjet e tyre televizive apo në mediat në internet dhe në postime në *Facebook*,<sup>2021</sup> ku u bënë komente nënçmuese për dëshmitarët, u vu në dyshim aftësia e ZPS-së për të mbrojtur dëshmitarët e saj dhe ata u tallën me rrjedhjen e informacionit.<sup>2022</sup> Kjo e shtoi më tej numrin e personave të panjohur që u vunë në dijeni për ekzistencën dhe përmbajtjen e përgjithshme të materialeve. Rrjedhimisht, provat për shpërndarjen e gjerë të këtij informacioni përmes platformave televizive

---

<sup>2019</sup> *Shih p.sh.* P26, f. 2; P11, f. 1; P24, f. 8. *Shih gjithashtu* P34, f. 2.

<sup>2020</sup> *Shih më lart* para. 747-748 (Format e përgjegjësisë penale).

<sup>2021</sup> P6; P7; P12; P18; P19; P21; P24; P33; P8; P11; P15; P16; P17; P25; P26; P27; P30; P32.

<sup>2022</sup> *Shih më lart* para. 757-761 (Format e përgjegjësisë penale).

ose në internet rrëzojnë argumentin e të akuzuarve se informacioni iu zbulua vetëm gazetarëve dhe mediave profesioniste.

993. Zbulimi i informacionit të mbrojtur, që përfshinte identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm, u bë për t'u shkaktuar pasoja negative personave në fjalë. Megjithëse numri nuk mund të përcaktohet me saktësi, sipas të dhënave, dëshmitarët e rrezikuar u ndikuan ndjeshëm dhe ZPS-së iu desh të kontaktonte shumë dëshmitarë të tjerë për të matur nivelin e rrezikut të shkaktuar.<sup>2023</sup> Provat nuk tregojnë nëse u zbuluan edhe emrat e dëshmitarëve veçanërisht të cenueshëm, si emrat e të miturve, të moshuarve, viktimave të krimeve të caktuara, të personave me aftësi të kufizuara apo kategorive të tjera të cenueshme<sup>2024</sup>. Sidoqoftë, shkalla e lartë dhe shtrirja e zbulimit të informacionit të mbrojtur mund të shkurajonte angazhimin apo vazhdimin e angazhimit të dëshmitarëve në hetimet apo proceset gjyqësore të DHS-së/ZPS-së.<sup>2025</sup> Për këto arsye, këto veprime mund të kishin rezultuar në pengimin e DHS-së/ZPS-së për përmbushjen e mandatit të tyre dhe mund t'u kishin mohuar viktimave të krimeve në juridiksionin e DHS-së të drejtën për të mësuar të vërtetën dhe për drejtësi. Këto të drejta janë tepër të rëndësishme për këto viktime, prandaj dhe çdo reagim i DHS-së/ZPS-së ndaj tentativave për të cenuar këto të drejta duhet të pasqyrojë rëndësinë e tyre. Së fundi, Trupi Gjykses thekson se veprimet e përshkruara më sipër, ndodhën në një atmosferë mbizotëruese dhe afatgjatë frikësimi dëshmitarësh në Kosovë.<sup>2026</sup>

994. Trupi Gjykses i peshon këta faktorë përkitazi konstatimit të vet se, në fund të fundit, ZPS-ja nuk vërtetoi që u pengua faktikisht t'i hetonte apo ndiqte penalisht krimet në mënyrë të efektshme.

---

<sup>2023</sup> *Shih më lart* para. 536-541 (Pika 6).

<sup>2024</sup> *Shih më lart* poshtëshënimin 1998.

<sup>2025</sup> *Shih p.sh.* W04841 (Miro Jukiq), Transkripti, 4 nëntor 2021, f. 1905; DW1253 (Robert Reid), Transkripti, 24 janar 2021, f. 3306-3308.

<sup>2026</sup> *Shih më lart* para. 576-VI (Pika 3).

(b) Lloji dhe shkalla e pjesëmarrjes së z. Haradinaj

995. Sipas Trupit Gjykses, fakti se z. Haradinaj nuk mori pjesë në “rrjedhjen fillestare” apo dorëzimin e tri grupeve të dokumenteve nuk ka rëndësi. Trupi Gjykses vëren se ky pretendim nuk ka qenë asnjëherë pjesë e akuzave dhe nuk mund të luajë asnjë rol në përcaktimin e dënimit të duhur. Mungesa e veprimeve kriminale të mëtejshme nga personi i shpallur fajtor nuk përbën faktor lehtësues.

996. Trupi Gjykses vëren se pas çdo dorëzimi të dokumenteve, z. Haradinaj përsëriti të njëjtat veprime: i këqyri materialet; mori pjesë në konferencën për shtyp që u drejtua nga z. Gucati ku përshkroi me hollësi përmbajtjen e tri grupeve të dokumenteve; më pas mori pjesë në intervista të shumta në media në lidhje me të njëjtën temë.<sup>2027</sup> Z. Haradinaj e përsëriti këtë rend veprimesh tri herë, edhe pasi u vu në dijeni për urdhrat me të cilët z. Gucati dhe OVL-UÇK-së iu kërkua të ndalonin shpërndarjen e informacionit të marrë.<sup>2028</sup> Trupi Gjykses merr parasysh zellin e veçantë me të cilin z. Haradinaj përsëriti veprimet e tij si dhe mllefin në disa prej komenteve të tij për dëshmitarët. Ai jo vetëm që përmendi publikisht emrat e më së paku pesë dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mbrojtur gjatë këtyre sjelljeve të përsëritura,<sup>2029</sup> por mori pjesë edhe në një numër të madh paraqitjesh në media.<sup>2030</sup> Gjithashtu, provat tregojnë se z. Haradinaj u betua në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonte të publikonte materialet e marra nga DHS-ja/ZPS-ja.<sup>2031</sup> Ai gjithashtu shtoi se kishte siguruar që dokumentet të shpërndaheshin sa më gjerësisht.<sup>2032</sup>

997. Trupi Gjykses konstaton se nuk ka faktorë të tjerë rëndues sa i përket kontributit të z. Haradinaj në kryerjen e veprave penale.

---

<sup>2027</sup> *Shih më lart* para. 747-750, 753 (Format e përgjegjësisë penale).

<sup>2028</sup> P17, f. 6; P83, f. 1; 2D1, para. 87; DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 2926-2932.

<sup>2029</sup> P1, f. 2; P2, f. 1, 3; P11, f. 30; P18, f. 3; P35, f. 3

<sup>2030</sup> P6; P7; P12; P18; P19; P21; P24; P33; P8; P11; P15; P16; P17; P25; P26; P27; P30; P32.

<sup>2031</sup> *Shih më lart* para. 748, 750 (Format e përgjegjësisë penale).

<sup>2032</sup> P60, f. 25.

998. Trupi Gjykues vëren se z. Haradinaj nuk bëri asnjë kërcënim të drejtpërdrejtë me vdekje apo lëndim të rëndë në lidhje me asnjë dëshmitar. Po kështu, z. Haradinaj nuk kërcënoi drejtpërdrejt asnjë zyrtar të ZPS-së dhe ishte bashkëpunues gjatë sekuestrimeve që kreu ZPS-ja, në rastet kur ishte i pranishëm. Megjithatë, mungesa e veprimeve kriminale të mëtejshme nuk përbën faktor lehtësues.

(c) Rrethanat individuale të z. Haradinaj

999. Z. Haradinaj është 58 vjeç,<sup>2033</sup> është i martuar dhe ka pesë fëmijë.<sup>2034</sup>

1000. Në përcaktimin e dënimit për z. Haradinaj, Trupi Gjykues konsideron si faktorë lehtësues faktet se bashkëshortja dhe vëllai i tij vuajnë nga probleme të rënda shëndetësore.<sup>2035</sup> Trupi Gjykues merr parasysh edhe gjendjen familjare të z. Haradinaj dhe faktin se dënimin me burg ai do ta kryejë larg familjes e komunitetit të tij, me vështirësitë financiare dhe emocionale që rrjedhin prej kësaj.<sup>2036</sup>

1001. Në përcaktimin e dënimit të duhur, Trupi Gjykues merr parasysh se z. Haradinaj nuk ka dënime të mëparshme dhe për rrjedhojë nuk ka faktorë rëndues në këtë drejtim. Më tej, duke mbajtur parasysh komentet nënçmuese të z. Haradinaj lidhur me dëshmitarët që bashkëpunonin me TFHS-së/ZPS-në,<sup>2037</sup> Trupi Gjykues nuk mendon se karakteri i mirë apo motivimi i përgjithshëm për të vepruar në interes të publikut dhe për të kërkuar të vërtetën, duhen konsideruar si faktorë lehtësues në rastin e tij. Trupi Gjykues vë në dukje se z. Haradinaj nuk tregoi pendesë për veprimet e tij dhe u betua në mënyrë të përsëritur se do t'i kryente sërish këto veprime në të ardhmen.<sup>2038</sup> Duke

---

<sup>2033</sup> 2D1, para. 1.

<sup>2034</sup> 2D1, para. 5, 8; 2D17, para. 5.

<sup>2035</sup> 2D17, para. 17, 21-24.

<sup>2036</sup> 2D17, para. 17-18, 20-32; 2D20; 2D18, f. 4.

<sup>2037</sup> *Shih më lart* para. 571-574 (Pika 3), 758-759 (Format e përgjegjësisë penale).

<sup>2038</sup> DW1249 (Nasim Haradinaj), Transkripti, 13 janar 2022, f. 3021 (z. Haradinaj: "Asnjë grimë nuk ndihna i pendum. Sepse e kam bo me vetëdijen time dhe thellë i bindur se është në dobi të transparencës dhe interesit publik. Dhe kështu që e kam kry vetëm një obligim, që unë kam mendu, që më është dashtë ta kryejmë. Asnjë send ma tepër. Dhe ajo është marrja prej atit, qitja deri aty"),

marrë parasysh gjithashtu edhe sjelljen e z. Haradinajt në kohën e arrestimit, Trupi Gjykses vlerëson se dënimi i z. Haradinaj nuk mund të zbutet për shkak të sjelljes së tij pas kryerjes së veprës penale.

1002. Ndonëse Trupi Gjykses mban parasysh se pandemia e Kovid-19 pati si pasojë kufizimin e vizitave familjare për z. Haradinaj, kjo situatë ndikoi edhe në shumë persona të tjerë të mbajtur në burg në mbarë botën dhe për rrjedhojë ka pak peshë në përcaktimin e dënimit të duhur.

1003. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se nuk është vërtetuar gabim ligjor,<sup>2039</sup> e për rrjedhojë Trupi Gjykses nuk do trajtojë nëse ky gabim ishte i shmangshëm brenda kuptimit të nenit 26(3) të KPK-së, për të përligjur uljen e dënimit.

(d) Përcaktimi i dënimit për z. Haradinaj

1004. Trupi Gjykses merr parasysh spektrin e dënimeve të shqiptuara për personat e shpallur fajtorë për vepra penale të ngjashme në gjykata apo tribunale ndërkombëtare.<sup>2040</sup> Megjithatë, siç përmendet dhe në paragrafin 957, është e vështirë që nga dënimi i dhënë në një çështje gjyqësore të deduktohet dënimi i duhur në një çështje tjetër. Veprat penale për të cilat u shpall fajtor z. Haradinaj kanë të bëjnë me zbulimin e më së paku njëqind kërkesave të TFHS-së, disa përgjigjeve të PSKL-së, të gjitha të trajtuara si konfidenciale prej ZPS-së, të një produkti tejet të ndjeshëm të punës së brendshme të ZPS-së, si dhe të emrave të *qindra* dëshmitarëve ose dëshmitarëve të mundshëm. Veprat penale përfshijnë: (i) shpërndarjen e informacionit në shkallë të gjerë; (ii) përmes përdorimit të një platforme organizative dhe një numri paraqitjesh të transmetuara në media; (iii) përmes sjelljes së përsëritur dhe betimeve të vazhdueshme se do t'i kryente përsëri të njëjtat vepra

---

(z. Haradinaj: "Po qe se i bien, të njëjtë do të veprojnë se hala kam mendimin e njëjtë. Për q' aq sa kam vepru që kam bo drejtë dhe kam bo në interes të transparencës dhe informimit publik. Hiç mos e bë. Përderisa mendoj kështu, vetëm kaq hiç ma shumë as ma pak sepse bindja jeme që është dashtë").

<sup>2039</sup> *Shih më lart* para. 907 (Argumentet mbrojtëse).

<sup>2040</sup> *Shih më lart* poshtëshënimi 2012.

penale; (iv) shoqëruar me komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve në një atmosferë të frikësimit të dëshmitarëve; dhe (v) me pasojën e mundshme që informacioni i mbrojtur të ishte i disponueshëm për një numër të madh personash dhe për një kohë të gjatë. Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerëson se në përcaktimin e dënimit të z. Haradinaj duhen marrë parasysh vetëm faktet dhe rrethanat e kësaj çështje gjyqësore dhe të asnjë çështjeje tjetër.

1005. Trupi Gjykses ka përmendur më lart dënimet e përcaktuara në nenet 387, 392(1)-(3) dhe 401(1)-(3) dhe (5) të KPK-së.<sup>2041</sup>

1006. Trupi Gjykses: (i) pasi peshoi veç e veç dhe në tërësi të gjithë faktorët e përcaktuar më lart, përfshirë peshën e veprave penale; dhe (ii) pasi mori parasysh qëllimet e dënimit të përmendura më sipër, përcaktoi dënimet e mëposhtme për z. Haradinaj, për secilën nga akuzat e paraqitura në Aktakuzë:

- a. Për Pikën 5, një vit burgim;
- b. Për Pikën 6, përfshirë formën e rëndë, dy vjet burgim;
- c. Për Pikën 3, një gjobë prej 100 eurosh dhe katër vjet burgim;
- d. Për Pikën 1, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh formën e rëndë, një vit burgim; dhe
- e. Për Pikën 2, tentativë kryerjeje dhe duke marrë parasysh të dyja format e rënda, një vit burgim.

1007. Në lidhje me Pikën 2, Trupi Gjykses shqipton të njëjtin dënim për të dy të akuzuarit, megjithëse për z. Haradinaj u vërtetua vetëm forma e rëndë sipas nenit 401(5) të KPK-së. Kjo për arsye se pesha e veprave penale të përmendura më sipër dhe përfshirja e tij në kryerjen e tyre – si për shembull roli aktiv i z. Haradinaj gjatë tri konferencave për shtyp, vreri dhe mllefi në deklaratat e tij gjatë paraqitjeve të shpeshta

---

<sup>2041</sup> Shih më lart para. 980.

në media si dhe sasia e informacionit të mbrojtur që zbuloi ai vetë– e bëjnë sjelljen e z. Haradinaj po aq të rëndë sa të z. Gucati.

1008. Sikurse përmendet më lart, neni 387 i KPK-së parasheh vendosjen e një gjobe. Duke mbajtur parasysh se efekti ndëshkues apo parandalues i gjobës do të ishte i vogël në këtë çështje, Trupi Gjykses është i mendimit se një shumë simbolike prej **100 eurosh** është e përshtatshme. Gjithashtu, Trupi Gjykses merr parasysh se z. Haradinaj është shpallur fajtor për Pikat 1 dhe 2 dhe se mund të ishte shpallur fajtor vetëm për një nga këto pika sipas një sistemi të ndryshëm për fajësinë e shumëfishtë.<sup>2042</sup>

1009. Pasi ka përcaktuar këto dënime, Trupi Gjykses shqipton një dënim të njësuar prej **katër vjetësh e gjysmë (4.5)**, që pasqyron tërësinë e sjelljes kriminale dhe veprat e shumëfishta penale të kryera prej z. Haradinaj.

1010. Në lidhje me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, Trupi Gjykses merr parasysh se z. Haradinaj u arrestua më 25 shtator 2020 dhe që prej asaj dite ndodhet në paraburgim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses zbret nga dënimi i njësuar periudhën që z. Haradinaj ka kaluar në paraburgim që prej 25 shtatorit 2020.

1011. Në lidhje me dënimin me kusht, Trupi Gjykses merr parasysh nenet 47 dhe 49(4) të KPK-së.<sup>2043</sup> Pasi: (i) përcaktoi peshën e veprave penale në këtë çështje; (ii) drejtpeshoi faktorët e lartpërmendur; dhe (iii) mori parasysh të gjitha qëllimet e dënimit, Trupi Gjykses gjykon se dënimi me kusht në këtë çështje nuk është dënimi i duhur, pasi tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit nuk do të mjaftonte për të parandaluar kryerjen nga z. Haradinaj të veprave penale të ngjashme me ato për të cilat u shpall fajtor dhe të cilat ai u betua se do t'i përsëriste.

---

<sup>2042</sup> *Shih më lart* paras 165-170 (Dispozitat ligjore përkatëse).

<sup>2043</sup> *Shih më lart* para. 986.

## XI. VENDIM

1012. Për arsyet e lartpërmendura, duke marrë parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve, Trupi Gjykses, në bazë të neneve 43 dhe 44 të Ligjit dhe rregullave 158-159, 163 dhe 165 të Rregullores, e shpall z. Gucati **FAJTOR** për:

- a) Pika 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së;
- b) Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së;
- c) Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 387 të KPK-së;
- d) Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(1) të KPK-së; dhe
- e) Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(2)-(3) të KPK-së.

1013. Trupi Gjykses e shpall z. Gucati **TË PAFAJSHËM** për Pikën 4, Hakmarrje.

1014. Trupi Gjykses e dënon z. Gucati me një **dënim të njësuar prej katër vjetësh e gjysmë burgim**, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një **gjobë prej njëqind eurosh (100 Euro)**, të cilën duhet ta paguajë deri më **18 korrik 2022**.



1015. Trupi Gjykses e shpall z. Haradinaj **FAJTOR** për:

- a) Pika 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 401(1) dhe (5) të KPK-së;
- b) Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së;
- c) Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 387 të KPK-së;
- d) Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(1) të KPK-së; dhe
- e) Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, sipas neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392(2)-(3) të KPK-së.

1016. Trupi Gjykses e shpall z. Haradinaj **TË PAFAJSHËM** për Pikën 4, Hakmarrje.

1017. Trupi Gjykses e dënon z. Haradinaj me një **dënim të njësuar prej katër vjetësh e gjysmë burgim**, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një **gjobë prej njëqind eurosh (100 Euro)**, të cilën duhet ta paguajë deri më **18 korrik 2022**.

1018. Trupi Gjykses **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë si publike pjesë të transkripteve të seancave të gjykimit, siç parashikohet në Shtojcën 3, në të gjitha gjuhët dhe duke përfshirë materialin audioviziv përkatës në të gjitha gjuhët.

/nëshkrimi/  
**Gjykatës Çarls L. Smith, III,**  
**Kryegjykatës**

/nëshkrimi/  
**Gjykatës Kristof Barte**

/nëshkrimi/  
**Gjykatës Ginel Metro**

E mërkurë, 18 maj 2022

Hagë, Holandë

## MENDIMI MË VETE I GJYKATËSIT BARTE

1. Pajtohem plotësisht me shpalljen fajtorë dhe me dënimet e dhëna për z. Gucati dhe të z. Haradinaj. Ndonëse pajtohem me kolegët, nuk mund të jem i një mendimi me ta lidhur me dy aspekte të veçanta. Ato kanë të bëjnë me: (i) interpretimin e elementit subjektiv të veprës penale të frikësimit, sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës ("KPK") të vitit 2019,<sup>1</sup> paraqitur në Pikën 3 të Aktakuzës; dhe (ii) arsyetimin konkret në lidhje me shpalljen fajtorë të dy të akuzuarve për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në një grup sipas nenit 401(2), (3) dhe (5), krahas veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet kërcënimit të rëndë sipas nenit 401(1) dhe (5),<sup>2</sup> paraqitur në Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës. Gjithsesi, asnjë nga këto aspekte nuk ndikon në pajtimin tim të përgjithshëm me rezultatin e Aktgjykimit.

### A. INTERPRETIMI I ELEMENTIT SUBJEKTIV TË NENIT 387 TË KPK-SË

2. Kolegët e mi janë të mendimit se vepra penale e frikësimit (neni 387) mund të kryhet me synim të drejtpërdrejtë ose me synim eventual.<sup>3</sup> Nuk pajtohem me konstatimin se vepra penale mund të kryhet me synim eventual, për arsytet e mëposhtme. Është e vërtetë se neni 21 i përmban të dyja format e "synimit"[dashjes]<sup>4</sup> dhe përkufizimin e

---

<sup>1</sup> Në rastet kur nuk jepet titulli i instrumentit juridik, të gjitha nenet e përmendura në këtë mendim janë nene të KPK-së. Rikujtoj se veprat penale të parashikuara në nenet 387, 388, 392 dhe 401 të KPK-së janë analoge me veprat penale përkatëse të parashikuara në nenet 395, 396, 400 dhe 409 të KPK-së të vitit 2012. *Shih gjithashtu* F147/RED, para. 28-34.

<sup>2</sup> Këtu, të kryera në bashkëkryerje, neni 31.

<sup>3</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 122-124. Për qëndrimin e palëve, *shih* z. Gucati: DW1240 (Hysni Gucati), Transkripti, 16 mars 2022, f. 3633, 3715-3719; Transkripti, 8 shtator 2021, f. 660, 671-672; z. Haradinaj: F342, para. 32; SPO: Transkripti, 14 mars 2022, f. 3499-3502; F341, para. 21 dhe poshtëshënimi 37.

<sup>4</sup> Synimi përbëhet nga dy elemente: elementi njohës dhe elementi i vullnetshëm. Në gjuhën angleze, termi "*intent*" ose "*intention*" përdoret ndonjëherë si term i përgjithshëm për të dy elementet përbërëse, ose për t'iu referuar elementit të vullnetshëm, *shih* Ambos K., *Treatise on International Criminal Law*, Volume I, Oxford 2013 ("*Treatise I*"), f. 266: "Synimi mund të ketë ose kuptimin e përgjithshëm, që përfshin aspektet njohëse dhe të vullnetshme të elementit mendor, [...] ose në kuptimin kryesisht të

tyre që zbatohet për veprat e ndryshme penale të parashikuara në KPK.<sup>5</sup> Megjithatë, synimi kriminal i nevojshëm për një vepër penale duhet të vërtetohet për secilën vepër penale më vete dhe në bazë të formulimit të saj. Neni 21 nuk mund të interpretohet se zbatohet “pa dallim për të gjitha veprat penale të parapara në KPK dhe pavarësisht nëse për një vepër penale nevojitet edhe qëllimi konkret”.<sup>6</sup> Përdorimi i fjalëve “për të nxitur” në nenin 387 tregon një veprimtari konkrete me një qëllim ose objektiv të caktuar, domethënë që qëllimi ose objektivi i përdorimit të forcës apo kërcënimit të rëndë etj., është *për ta nxitur* personin tjetër që të mos japë deklaratë ose që të japë deklaratë të rreme, ose që të mos u japë informata të vërteta organeve policore, prokurorit apo gjyqtarit.<sup>7</sup> Ky interpretim i imi mbështetet edhe nga neni 387 i lexuar në kontekstin e neneve 386<sup>8</sup> dhe 388,<sup>9</sup> si edhe nga natyra e rëndë të veprës penale, sikurse pasqyrohet edhe në dënimin e rëndë të parashikuar.<sup>10</sup> Këta faktorë më bindin

---

vullnetit, që bazohet tek qëllimi”. Se cili prej të dy këtyre kuptimeve ka lidhje me rastin, varet nga veçantitë e dispozitës në fjalë.

<sup>5</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 119.

<sup>6</sup> *Shih për krahasim* Aktgjykimi, para. 120.

<sup>7</sup> Ky interpretim mbështetet nga versioni në shqip i nenit 387 ku përdoret fraza “për të” që mund të përkthehet [në anglishte] si “to, in order to”, ose “with the intent/purpose of”, që konfirmon kuptimin se “diçka kryhet ose tentohet të kryhet me qëllim/synim”. Po kështu, versioni në serbishte i kësaj dispozite përdor shprehjen “da se” që mund të përkthehet [në anglishte] si “to, in order to”. Gjithashtu, mbaj parasysh edhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit, që duket se konfirmon synimin e drejtpërdrejtë për veprën penale të frikësimit. *Shih* Kosovë, [Aktgjykimi në Lëndën L.T. dhe të Tjerët](#), f. 7, paragrafi i parë (mbi interpretimin e nenit 395 të KPK-së të vitit 2012). *Shih gjithashtu* Kosovë, [Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Lëndën Medicus](#), para. 65 dhe 71 ku thuhet se synimi eventual nuk është i përputhshëm me krimet me synim konkret (të drejtpërdrejtë) si kontrabanda e migrantëve, trafikimi i qenieve njerëzore apo krimi i organizuar (*shih* nenet 170, 171 dhe 283 të KPK 2012).

<sup>8</sup> Neni 386, që konsiderohet se mbulon “vepra penale me synim të drejtpërdrejtë”, penalizon sjelljen që pengon, ndër të tjera, mbledhjen e provave në procedurën gjyqësore, me anë të fshehjes, asgjësimit, dëmtimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit të sendeve ose dokumenteve që mund të përdoren si prova. *Shih gjithashtu* Salihu dhe të tjerët, neni 394(1) i KPK-së 2012, mn. 12, f. 1121 dhe neni 394(3) të KPK-së 2012, mn. 3, f. 1123.

<sup>9</sup> Neni 388, që Trupi Gjykses konsideron se kërkon “synimin konkret” që tregon një element qëllimi (*shih* Aktgjykimi, para. 136-137), penalizon sjelljen ndërhyrëse ndaj personave pasi ata u kanë dhënë informacion autoriteteve kompetente. Madje, mund të thuhet se nenet 387 dhe 388 janë “dy anë të së njëjtës medalje”. *Shih, p.sh.,* Salihu dhe të tjerët, neni 396 i KPK-së 2012, mn. 3, f. 1125 ku jepet lidhja mes neneve 396 dhe 394 të KPK-së 2012, që përkohjnë me nenet 388 dhe 386.

<sup>10</sup> Dënimi i përcaktuar në nenin 387 është gjobë deri në 125.000 euro dhe burgim nga dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

të nxjerr përfundimin se, në bazë të parimit të ligjshmërisë (*nullum crimen, nulla poena sine lege [stricta]*),<sup>11</sup> ligji kërkon ekzistencën e një elementi të fortë të dashjes, në kuptimin që kryesi duhet ta ketë dëshiruar efektin frikësues të sjelljes së tij ose të saj.

3. Megjithatë, duke qenë se bashkë me kolegët jemi të bindur se dy të akuzuarit kanë vepruar me këtë synim, nuk nevojiten shpjegime të mëtejshme mbi këtë pikë.<sup>12</sup>

## B. NENI 401 I KPK-SË: PENGIMI INDIVIDUAL DHE/OSE SI GRUP

4. Kolegët e mi i kanë shpallur fajtorë të akuzuarit mbi dy baza juridike,<sup>13</sup> gjegjësisht për pengim individual të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401(1)) dhe për pjesëmarrje në një grup që me veprim të përbashkët pengon ose tenton të pengojë persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 401(2)). Kolegët e mi kanë pranuar zbatueshmërinë e të dyja dispozitave mbi bazën se secila dispozitë ka një element materialisht të dallueshëm të cilin nuk e përmban tjetra, që kërkon vërtetimin e një fakti që nuk e kërkon tjetra.<sup>14</sup>

---

<sup>11</sup> *Shih* neni 2(3) i KPK-së dhe neni 33(1) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. *Shih gjithashtu Ambos, Treatise I*, f. 88 ku thuhet se komponenti *lex stricta* mund të konsiderohet si "barasvlerës" i parimit të interpretimit ose shpjegimit të ngushtë, që përdoret në të drejtën angleze.

<sup>12</sup> Në veçanti, mbetet e hapur për diskutim, në interes të qëllimit dhe vlerës ligjërish të mbrojtur prej nenit 387, nëse mund të vihet shenja e barazimit midis kryesit që vepron me synim të drejtpërdrejtë dhe kryesit që e ka parashikuar praktikisht me siguri efektin frikësues të veprimeve të tij, siç ka argumentuar ZPS-ja (shih Transkripti, 14 mars 2022, f. 3499-3502; F565 Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së, para. 214), sepse në rastin e dytë mungesa e elementit të fortë të dashjes kompensohet nga një element po aq i fortë i dijenisë. Nga ana tjetër, synimi eventual, sikurse u miratua nga shumica e Trupit Gjyqësor, do të kërkonte që kryesi, nga pikëpamja e dijenisë, thjesht ka vetëdijen se veprimet e tij *mund* ta nxisin një person tjetër që të mos japë deklaratë etj., dhe që, nga pikëpamja e dashjes, mjafton të pajtohet që ajo pasojë (të mundshme) të ndodhë. Fakti se "çdo kryes që përdor me synim forcë ose kërcënim të rëndë ndaj dëshmitarëve në një gjykim penal, me pasojën e pranuar, por jo domosdoshmërisht të dëshiruar, që dëshmitarët të mos japin dëshmi, do të mbetet i pandëshkuar" (Aktgjykimi, para. 122), mund të jetë i padëshirueshëm; por, nuk i takon gjykatës penale të bëjë plotësime apo të ndreqë mangësitë në ligj të cilat ligjvënësi (në mënyrë të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme) i ka lënë të hapura për shkak të interpretimit të tepruar.

<sup>13</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 1012 (z. Gucati) dhe para. 1015 (z. Haradinaj).

<sup>14</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 167-170.

5. Ndonëse pajtohem me shpalljen fajtorë të dy të akuzuarve në bazë të dy dispozitave ligjore, nuk mund të pajtohem me arsyetimin e bërë në Aktgjykim. Standardi i lartpërmendur, i përdorur nga kolegët e mi, është marrë nga jurisprudenca ndërkombëtare që ka të bëjë me krime ndërkombëtare. Mirëpo ky standard nuk është i vetmi që mund të përdoret për të përcaktuar marrëdhënien midis dy dispozitave penale. Në rastin konkret, Trupit Gjykses i kërkohet të marrë vendim mbi sjelljen e të akuzuarve në bazë të së drejtës së Kosovës,<sup>15</sup> sikurse është përfshirë në Ligj.<sup>16</sup> Në këtë kontekst të veçantë, mbështes konstatimin tonë për t'u mbështetur në jurisprudencën përkatëse të Kosovës, që, ndonëse nuk është detyruese, i mundëson Trupit Gjykses, në qoftë se është e mundshme, t'i interpretojë dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të ngjashme me atë që kanë zbatuar gjykatat e Kosovës në gjykimin e të njëjtave vepra penale.<sup>17</sup> Në fund të fundit, kjo qasje mundëson që Aktgjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore të jetë pjesë e traditës juridike të Kosovës.

6. Kolegët e mi nuk i pranojnë rregullat e bashkimit të veprave penale të zbatuara nga Gjykata e Apelit e Kosovës në çështjen gjyqësore *M.I. dhe të tjerët*<sup>18</sup> në kontekstin e pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, mbi bazën se (i) ajo nuk shpjegoi mjaftueshëm bazën ligjore përse u mbështet në këtë teori; (ii) palët në çështjen gjyqësore aktuale kanë pranuar se Trupi Gjykses ka kompetencë diskrecionale të ketë si orientim standardin e fajësisë së shumëfishtë që është zbatuar nga tribunalët ndërkombëtarë; dhe (iii) elementet ligjore të paragrafit 2 të nenit 401 janë të ndryshme nga elementet ligjore të paragrafit 1 të nenit 401.<sup>19</sup>

7. Sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës:

---

<sup>15</sup> *Shih gjithashtu* Aktgjykimi, para. 939 (“Megjithatë, Aktakuza i ngarkon të akuzuarit me kryerjen e veprave penale të parashikuara në legjislacionin e Kosovës [...]”).

<sup>16</sup> *Krahaso* nenet 3(2)(c), 6(2), 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

<sup>17</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 67.

<sup>18</sup> Kosovë, [Aktgjykim i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të tjerët](#), pjesa 6.3, f. 28-29.

<sup>19</sup> *Shih* Aktgjykimi, para. 165-169.

*Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 316. 1 dhe 3 i KPK-së)<sup>20</sup> përbëhet nga pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare të sigurisë publike, urdhrit apo punëve policore duke përdorur forcën apo kërcënimin me përdorim të menjëhershëm të forcës dhe është vepër e dënueshme prej 3 muaj deri në 3 vjet. Kjo dispozitë i mbulon situatat në të cilat ka prova rreth veprimeve konkrete individuale të kryesit. Vepra penale pjesëmarrje në grup për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 318.1 i KPK-së)<sup>21</sup> përmban pjesëmarrjen në një veprim të përbashkët të grupit me qëllim të pengimit apo tentativës për pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare apo detyrimin e tij/saj në kryerjen e detyrave zyrtare dhe është vepër e dënueshme me gjobë apo burgim prej deri në 3 vjet. Kjo dispozitë i mbulon situatat kur ekzistojnë provat se kryesi ka qenë në grup dhe ka marrë pjesë në veprimet e përbashkëta, por nuk është e mundur të vërtetohen veprimet konkrete individuale të pengimit të cilat janë kryer nga ana e tij/saj. Shpjegimi i arsyeshëm prapa dënimit më të vogël për veprimet të cilat synojnë të njëjtin rezultat me shkeljen e vlerës së njëjtë të mbrojtur qëndron në faktin se pesha e veprës është më e ulët kur nuk provohet se kryesi [...] i ka kryer veprimet konkrete kundër organit publik. Kolegji i apelit konstaton se këto dispozita janë në raportin e bashkimit ideal në formën e subsidiaritetit të nënkuptuar. Vepra më e lehtë është subsidiare në situatat kur nuk vërtetohet vepra më e rëndë. [...] Për këtë arsye, kolegji i apelit është i mendimit se dënimi për të dyja veprat penale, siç është vendosur nga kolegji i apelit, nuk do të ishte i pranueshëm për shkak se ato nuk janë në raportin e bashkimit real.*

8. Në kundërshtim me mendimin e shumicës së Trupit Gjykses, unë nuk shoh asnjë arsye të fortë për ta përjashtuar kategorikisht standardin e zbatuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës.

9. Së pari, kur aktgjykimi lexohet në tërësinë e tij, bëhet e qartë se Gjykata e Apelit u mbështet në dispozitën e KPK-së që rregullon të ashtuquajturin bashkim të veprave

<sup>20</sup> Shkurtimi [në anglishte] "CCK" përdoret në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës për t'iu referuar Kodit Penal të mëparshëm të Kosovës, *shih* UNMIK, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/REG/ 2003/25, 6 korrik 2003, që më pas u riemërtua dhe ndryshua me Ligjin Nr. 03/L-002, në fuqi deri më 31 dhjetor 2012. Neni 316(1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, përcakton: "Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atëçastshëm të dhunës pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyra zyrtare, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet". Neni 316(3) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës përcakton: "Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryerësit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet."

<sup>21</sup> Neni 318(1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës përcakton: "Kushdo që merr pjesë në grupin e njerëzve që me veprim të përbashkët pengon apo tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose në mënyrë të ngjashme e detyron të ekzekutojë detyra zyrtare dënohet për pjesëmarrje me gjobë ose me burgim deri në tri vjet."

penale (*concursum delictorum, concours de qualifications/d'infractions, concurso de leyes/delitos, concorso di reati, Konkurrenzen*), konkretisht në nenin 71(1) të KPK-së,<sup>22</sup> tani neni 76(1).<sup>23</sup> Fakti që Gjykata e Apelit e Kosovës nuk i referohet shprehimisht dispozitës në fjalë në atë pjesë të aktgjykimit,<sup>24</sup> apo që termat “bashkim ideal” dhe “real” nuk përmenden shprehimisht në nenin 71 të KPK-së (apo gjetkë në KPK [...]), nuk është me rëndësi.

10. Së dyti, megjithëse është e vërtetë se as neni 76 dhe as pararendësi i tij, neni 80 i KPK-së së vitit 2012, nuk janë përfshirë shprehimisht në Ligj, neni 44(4) i Ligjit kërkon nga Trupi Gjykses të sigurojë që “dënimi i shqiptuar kundër personave të shpallur fajtorë për krimet sipas nenit 15(2) është në përputhje me dënimet për krimet e përcaktuara në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2012 [...]”. Kjo dispozitë mund të interpretohet se jo vetëm përfshin masat e dënimeve për veprat penale të parashikuara në KPK (që janë përfshirë dhe, rrjedhimisht, janë të zbatueshme në bazë të nenit 15(2) të Ligjit), por edhe lejon zbatimin e atyre parimeve juridike themelore që janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me shqiptimin e dënimeve (si bashkimi i krimeve) dhe që do të zbatoheshin në raste të ngjashme në gjykatat penale të Kosovës.

11. Së treti, fakti se “palët kanë pranuar se është në kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykses që të ketë si orientim standardin e fajësisë së shumëfishtë që zbatohet në tribunalët ndërkombëtarë”<sup>25</sup> ose, se mund të mos kenë “identifikuar ndonjë bazë

<sup>22</sup> Neni 71(1) i KPK-së-së përcakton: “Nëse kryerësi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.” (theksimi i shtuar).

<sup>23</sup> Neni 76(1) është identik me nenin 71(1) të CCK-së (*shih* Aktgjykimi, poshtëshënimi 266). Për të drejtën penale të ish-Jugosllavisë, *shih* neni 48 i Kodit Penal të RSFJ-së (1976) dhe Munda në Mezger, E. dhe të tjerët (redaktorë), *Das ausländische Strafrecht der Gegenwart*, Berlin 1955, f. 399.

<sup>24</sup> Por Gjykata e Apelit e trajton nenin 71 të CCK-së atëherëshëm në f. 31 të aktgjykimit të saj, në kontekstin e përcaktimit të ndëshkimit të gabuar, sikurse pretendohet.

<sup>25</sup> Aktgjykimi, para. 167 *ku i referohet* të ashtuquajturit standardi *Čelebići* ose *Blockburger*. *Shih* Shtetet e Bashkuara të Amerikës, [Blockburger Judgment](#); TPNJ, [Čelebići Appeal Judgment](#), para. 412-413. Për kritikë ndaj standardit *Čelebići*, sidomos në çështjet penale ndërkombëtare: Fernández-Pacheco Estrada në JICJ 15 (2017), f. 689-712. Një aspekt tjetër që duhet mbajtur parasysh në këtë kontekst është se gjykata ndërkombëtare si TPNJ-ja, TPNR-ja, GJPJ-ja dhe GJSSL-ja, në gjykimin e çështjeve lidhur me



tjetër ligjore që parasheh përdorimin e ndonjë standardi tjetër<sup>26</sup> nuk ka rëndësi, sepse në fund i takon Trupit Gjykses të identifikojë standardin e duhur juridik (*iura novit curia*) dhe ta zbatojë këtë standard në kontekstin e fakteve të çështjes gjyqësore.<sup>27</sup>

12. Së katërti, megjithëse është e vërtetë se secila prej të dyja veprave penale ka një element materialisht të ndryshëm të cilin nuk e përmban tjetra, kjo nuk vërtetohet, pa pasur më shumë informacion, se paragrafi 2 i nenit 401, i krahasuar me paragrafin 1 të nenit 401, “penalizon një formë tjetër pengimi” dhe/ose se vepra e parë penale nuk mund të jetë subsidiare, apo e pazbatueshme, në qoftë se vërtetohet vepra e dytë penale.<sup>28</sup>

---

vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, bazohen në instrumentet juridike ndërkombëtare dhe nuk bazohen apo i referohen legjislacionit të brendshëm të shtetit përkatës.

<sup>26</sup> Aktgjykimi, para. 168.

<sup>27</sup> Gjithsesi, vërej se Mbrojtja e Gucatit iu referua [Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Lëndën M.I. dhe të Tjerët](#) dhe parashtrori shprehimisht se “Neni 401(2) i KPK-së është vepra penale më pak e rëndë dhe është subsidiare në situatat kur nuk është vërtetuar vepra më e rëndë [pra ajo sipas nenit 401(1)]”. (F567 Dosja Përfundimtare e Gucatit, para. 146). *Shih gjithashtu* Aktgjykimi, poshtëshënimi 268.

<sup>28</sup> *Shih për krahasim* Aktgjykimi, para. 169. Sipas Stukenbergut, “ideja bazë” e subsidiaritetit është se “njëra prej dy veprave penale të ndërhyrjes [në administrimin e drejtësisë] funksionon si klauzolë plotësuese – ose përmes zbatimit shprehimisht ose përmes interpretimit (“subsidiariteti i nënkuptuar”) – në raport me një tjetër, zakonisht ngaqë njëra vepër penale përshkruan një formë më pak intensive [...] të të njëjtit lloj sjelljeje penale dhe, rrjedhimisht, supozohet se zbatohet vetëm në qoftë se nuk zbatohet vepra tjetër penale” (*krahaso* Stukenberg in Stahn, C. (ed.), *The Law and Practice of the International Criminal Court*, Oxford 2015, f. 843-844). Fakti që këto parime duket se janë përfshirë në legjislacionin penal të Kosovës bëhet i qartë jo vetëm nga aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës së Apelit të Kosovës, por edhe nga Komentari i KPK-së së viti 2012 (*Salihu dhe të tjerët*, neni 80 i KPK-së 2012, mn. 1b)b), f. 276) i cili shprehimisht i referohet parimit *lex primaria derogat legi subsidiariae*. Për teorinë e bashkimit të veprave penale *shih p.sh.*, Kosovë, [Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Lëndën Medicus](#), para. 80-83; [Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Lëndën R.R. dhe të Tjerët](#), para. 148-151; [Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Lëndën J.D. dhe të Tjerët](#), f. 50, poshtëshënimi 34, ku përmendet bashkimi “ideal ose real, homogjen ose heterogjen”.

13. Në fund të fundit, nëse dispozitat në fjalë mund të zbatohen në mënyrë të shumëfishtë<sup>29</sup> apo nëse është e zbatueshme vetëm njëra prej tyre,<sup>30</sup> kjo është çështje interpretimi, duke marrë parasysh strukturën dhe vlerën ligjrisht të mbrojtur prej tyre. Në këtë aspekt, mund të vërehet si vijon.

14. Paragrafi 2 i nenit 401 nuk është as formë e rëndë, as e privilegjuar e paragrafit 1 të nenit 401, duke qenë se i pari nuk përfshin të gjithë elementet përbërëse të të dytit, plus një element shtesë që e zmadhon ose e zvogëlon peshën e sjelljes kriminale të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 401. Midis dy veprave penale nuk ka një marrëdhënie *genus ad speciem* apo përfshirje logjike<sup>31</sup> (*marrëdhënia e specialitetit, merger of offences/unilateral speciality, especialidad, specialità, Spezialität, lex specialis derogat legi generali*).

15. Fakti se paragrafi 1 dhe 2 të nenit 401 mbrojnë të njëjtin interes ligjor, që është kryerja e papenguar e detyrave zyrtare dhe, si “rrjedhojë” e kësaj mbrojtjeje, mbrojnë edhe vetë personin zyrtar,<sup>32</sup> dhe se i pari parashikon masë më të ulët dënimi se i dyti, mund të jetë argument në favor të një bashkimi “në dukje” ose “të rremë” në formën e subsidiaritetit (të nënkuptuar) (*marrëdhënia e subsidiaritetit, subsidiariedad, sussidiarietà, Subsidiarität, lex primaria derogat legi subsidiariae*). Nga ana tjetër,

---

<sup>29</sup> Në traditën e së drejtës civile, situata e dispozitave konkurruese njihet tradicionalisht si “bashkim ideal” ose “i vërtetë” (*bashkimi ideal i veprave penale, concours de qualifications/concours idéal d’infractions, concurso ideal, concurso ideale/formale di reati, Idealkonkurrenz*), ose, nëse veprat penale janë kryer përmes disa veprimesh, si “bashkim real” (*bashkimi real i veprave penale, concours réel d’infractions, concurso real, concurso materiale di reati, Realkonkurrenz*). Për më shumë hollësi shih Stuckenberg in Stahn, C. (ed.), po aty, f. 844-845.

<sup>30</sup> Në qoftë se një veprim që është njëkohësisht në shkelje të disa dispozitave penale, por rezulton vetëm një vendim fajësie sepse është zbatuar vetëm njëra dispozitë dhe jo të gjitha, në doktrinën kontinentale evropiane njihet si “bashkim fiktiv” ose “i rremë” (*bashkimi fiktiv ideal i veprave penale, concours apparent d’infractions, concurso aparente de leyes, concurso aparente di norme, Gesetzeskonkurrenz/-einheit*) (Stuckenberg in Stahn, C. (ed.), po aty, f. 843-844). Nëse veprime më vete janë në shkelje të dispozitave të ndryshme të së drejtës penale, mund të arsyetohet në mënyrë të ngjashme si në situatat e “bashkimit fiktiv”; në disa rende juridike këto njihen si “*actos anteriores/posteriores impunes/copenados*” ose “*mitbestrafte Vortat/Nachtat*” (Stuckenberg in Stahn, C. (ed.) po aty, f. 845).

<sup>31</sup> Për këta dy terma shih Stuckenberg in Stahn, C. (ed.), po aty, f. 843.

<sup>32</sup> Salihu dhe të tjerët, neni 409 i KPK-së 2012, mn. 2, f. 1164-1165.

konstatimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës se neni 401(2) është “vepra penale më e lehtë” krahasuar me nenin 401(1), nuk është bindës. Kjo sepse rreziqet ndaj interesit ligjor të mbrojtur, që lindin nga “veprimi i përbashkët” i një grupi, mund të jenë faktikisht po aq të mëdha, ose në shumë raste edhe më të mëdha, se rreziqet e shkaktuara nga pengimi individual.<sup>33</sup>

16. Gjithashtu, ekziston në fakt një dallim thelbësor midis rastit kur i akuzuari vetëm ka penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare sipas nenit 401(1), dhe rastit kur ka qenë edhe pjesë e një grupi personash i cili përmes veprimit të përbashkët u përfshi në pengim. Kryesi i cili, duke përdorur forcën ose kërcënimin e rëndë, pengon në mënyrë individuale dhe, përmes së njëjtës sjellje merr pjesë në “veprimin e përbashkët” të një grupi, kryen një shkelje penale shtesë, që duhet të pasqyrohet siç duhet në vendimin e fajësisë. Mosmarrja parasysh e përfshirjes së kryesit në veprimtarinë e grupit nuk është e përligjur. Kjo do ta favorizonte këtë kryes në krahasim me një kryes tjetër që e kryen veprën penale të pengimit i vetëm.

17. Nga ana tjetër, në rastin kur një i akuzuar thjesht merr pjesë në veprimin e përbashkët të një grupi personash në mënyra të tjera që nuk përfshijnë forcën ose kërcënimin e rëndë, duket se është e përshtatshme masa më e ulët e dënimit parashikuar në paragrafin 2 të nenit 401, krahasuar me atë të paragrafit 1 të nenit 401, pra gjoba (në vend të një periudhe minimale burgimi prej tre (3) muajsh) apo burgimi deri në tre (3) vjet.

18. Duke qenë se nuk ka subsidiaritet të nënkuptuar as për arsye të tjera,<sup>34</sup> vij në të njëjtin përfundim si edhe kolegët e mi, por përmes një arsyetimi të ndryshëm,

---

<sup>33</sup> *Shih gjithashtu* Kosovë, [Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Lëndën R.R. dhe të Tjetër](#), para. 138 ku thuhet se “arsyeja përse ka një vepër penale më vete [në nenin 318(1) Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës] ishte që të sigurohet, të ndihmohet, mbrojtja e vlerës juridike, duke pasur parasysh se një grup ka dinamika të ndryshme në vetvete, çka e rrit rrezikshmërinë”.

<sup>34</sup> Për shembull, në qoftë se njëra prej dy dispozitave penalizon vetëm një “fazë kalimtare” të tjetrës (*Durchgangsdelikt*), ose në qoftë se kryerja e njëres vepër penale kërkon shkeljen faktike të vlerës juridike të mbrojtur (*Verletzungsdelikt*), ndërsa për tjetrën mjafton që kryesi thjesht të shkaktojë rrezikimin e së njëjtës vlerë juridike të mbrojtur (*Gefährdungsdelikt*).

*domethënë* duke u mbështetur në interpretimin e KPK-së, dhe jo në standardin e huazuar prej jurisprudencës ndërkombëtare. Rrjedhimisht, shpallja fajtor e dy të akuzuarve për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi sipas nenit 401(2) krahas veprës penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë sipas nenit 401(1) në Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës, qëndron.

### C. NDIKIMI NË AKTGJYKIM

19. Së fundi, edhe sikur të akuzuarit të mos ishin shpallur fajtorë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në grup (në rastin e z. Gucati si udhëheqës i grupit sipas nenit 401(3)), jam bindur se kjo nuk do të kishte pasur asnjë ndikim mbi dënimin, duke pasur parasysh faktin se dënimi “i njësuar” i vendosur sipas rregullës 163(4) të Rregullores është mjaft i moderuar në krahasim me numrin e veprave penale kryera nga të akuzuarit.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Kristof Barte**

E mërkurë, 18 maj 2022

Hagë, Holandë